Tema të zgjedhura nga e drejta
dhe marrëdhëniet ndërkombëtare

BIBLIOTEKA **BESA**

Recensues:
Prof. dr. Xhezair Zaganjori
Prof. dr. Iliriana Islami

Redaktor:
Dr. jur. Getoar M. Mjeku

Botues:
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" • Prishtinë, Kosovë
Shtëpia botuese "Jalifat Publishing" • Hjuston, Teksas, ShBA

Dizajni dhe radhitja:
Plisi.org

Këshilli Botues i Universitetit të Prishtinës e lejoi botimin dhe përdorimin e këtij teksti me Vendimin nr. 3/591, datë 21.11.2016

ISBN 978-9951-00-186-1

© 2016, autori dhe botuesit ruajnë të gjitha të drejtat

Shtypur në Prishtinë, Kosovë

Prof. dr. Enver HASANI

TEMA TË ZGJEDHURA NGA E DREJTA DHE MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Univ. Prishtinës ❀ *Jalifat Publishing*
Prishtinë Hjuston

Viktimave të dhunës seksuale
në luftën e fundit në Kosovë (1998–1999),
pavarësisht gjinisë
e përkatësisë kombëtare

Përmbledhja e përmbajtjes

Kapitulli I. **FILLET E SHPËRBËRJES DHE TË SUKSEDIMIT TË ISH-JUGOSLLAVISË..... 1**

I. VENDIMI I ARBITRAZHIT (S')ËSHTË I DREJTË..... 4

II. NË MARGJINAT E KONVENTAVE TË VJENËS MBI SUKSEDIMIN E SHTETEVE..... 12

III. SUKSEDIMI I SHTETIT JUGOSLLAV DHE INSTRUMENTALIZIMI JURIDIKO-NDËRKOMBËTAR I SUBJEKTIVITETIT TË KOSOVËS..... 22

Kapitulli II. **MBYLLJA E PROCESIT TË VETËVENDOSJES DHE TË TRASHËGIMIT NË KUADËR TË ISH-JUGOSLLAVISË: SPECIFIKAT E TIJ PËR KOSOVËN..... 41**

I. VETËVENDOSJA SIPAS KUSHTEVE TË MARRËVESHJES PËR BASHKIM TË VITIT 2002 NDËRMJET SERBISË DHE MALIT TË ZI: GJURMËVE TË ORIGJINËS SË VETËVENDOSJES SË KOSOVËS..... 48

II. SPECIFIKAT E TRASHËGIMIT TË ISH-JUGOSLLAVISË DHE POZITA E KOSOVËS NË TË..... 77

III. KRITIKË KONCEPTIT SHTET NË NJË VEPËR TË KENNETH WALTZIT..... 120

Kapitulli III. UTI POSSIDETIS JURIS **DHE ÇËSHTJA E CAKTIMIT TË KUFIJVE TË KOSOVËS..... 139**

I. *UTI POSSIDETIS JURIS*: NGA ROMA NË KOSOVË..... 145

II. CAKTIMI I KUFIJVE TË KOSOVËS ËSHTË KRYESISHT ÇËSHTJE E SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE..... 161

Kapitulli IV. **MBI NOCIONIN SHTET, NACIONALIZMIN SERB DHE ASOCIACIONIN E KOMUNAVE, NGA PERSPEKTIVA KUSHTETUESE DHE NDËRKOMBËTARE..... 197**

I. NOCIONI SHTET NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE..... 202

II. Refleksione mbi nacionalizmin serb dhe politikën e pastrimit etnik 242

III. Rasti i asociacionit serb në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës 254

***Kapitulli V*. TË GJITHA GJYKATAT E HAGËS, "MURI I JASHTËM I SANKSIONEVE" DHE FILLIMI I ZBATIMIT TË LIGJEVE TË LUFTËS NË KOSOVË 279**

I. Të gjitha gjykatat e Hagës 283

II. Muri i jashtëm i sanksioneve 316

III. Eksperti ligjor i UÇK-së: së pari protektorati ndërkombëtar, pastaj pavarësia 331

IV. Një vështrim mbi të drejtën ndërkombëtare të luftës në dritën e konfliktit të armatosur në Kosovë 336

Literatura 369

Treguesi 403

Tryeza e përmbajtjes

Përmbledhja e përmbajtjes vii

Tryeza e përmbajtjes ix

Dy fjalë lexuesit xv

Falënderimea xvii

Shkurtesa xxi

***Kapitulli I.* FILLET E SHPËRBËRJES DHE TË SUKSEDIMIT TË ISH-JUGOSLLAVISË..... 1**

I. VENDIMI I ARBITRAZHIT (S')ËSHTË I DREJTË 4

Hyrja 4

Përfundimi 12

II. NË MARGJINAT E KONVENTAVE TË VJENËS MBI SUKSEDIMIN E SHTETEVE 12

III. SUKSEDIMI I SHTETIT JUGOSLLAV DHE INSTRUMENTALIZIMI JURIDIKO-NDËRKOMBËTAR I SUBJEKTIVITETIT TË KOSOVËS 22

Hyrja 22

1. Suksedimi i shtetit jugosllav 23

2. Instrumentalizimi juridiko-ndërkombëtar i subjektivitetit të Kosovës .. 36

***Kapitulli II.* MBYLLJA E PROCESIT TË VETËVENDOSJES DHE TË TRASHËGIMIT NË KUADËR TË ISH-JUGOSLLAVISË: SPECIFIKAT E TIJ PËR KOSOVËN..... 41**

I. VETËVENDOSJA SIPAS KUSHTEVE TË MARRËVESHJES PËR BASHKIM TË VITIT 2002 NDËRMJET SERBISË DHE MALIT TË ZI: GJURMËVE TË ORIGJINËS SË VETËVENDOSJES SË KOSOVËS 48

Hyrje 48

1. Opinionet e Komisionit Badinter 50

a. Më gjerësisht për Komisionin Badinter 50

b. Motivimi politik 54

c. Qasjet inovative 55

2. Modeli i Dejtonit për Bosnjë-Hercegovinën dhe ndikimi i tij në statusin përfundimtar të Kosovës: Trajtimi i Kosovës në një paralele me "Republikën Serbe", në mos më keq 58

3. Marrëveshja e Rambujesë dhe modeli i saj i vetëvendosjes: Krahasimi i modelit të Rambujesë me atë të Dejtonit 65

4. Marrëveshja për Union përfshin modelin për vetëvendosje të Rezolutës 1244 dhe të Rambujesë 75

Përfundim 77

II. Specifikat e trashëgimit të ish-Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të 77

Hyrje 77

1. Koncepti i trashëgimit të shteteve dhe parimet bazë të tij 82

2. Struktura e MT: pjesa kryesore dhe anekset 90

3. Hedhja poshtë e kërkesës së RFJ-së për trashëgimtar të vetëm (kontinuitet) të ish-Jugosllavisë 91

4. Kuadri për bashkëpunim institucional në MT 95

5. Prona e tundshme, prona e patundshme dhe prona e përfaqësive diplomatike e konsullore 98

6. Asetet dhe detyrimet financiare 102

7. Arkivat 108

8. Prona private dhe të drejtat e fituara 110

Përfundim 116

III. Kritikë konceptit shtet në një vepër të Kenneth Waltzit 120

Hyrje 120

1. Kritikë imazhit të parë: Konflikti ndërkombëtar dhe sjellja njerëzore .. 122

2. Kritikë imazhit të dytë: Konflikti ndërkombëtar dhe struktura e brendshme e shteteve 125

3. Kritikë imazhit të tretë: Konflikti ndërkombëtar dhe anarkia ndërkombëtare 128

Përfundim 133

***Kapitulli III. UTI POSSIDETIS JURIS* DHE ÇËSHTJA E CAKTIMIT TË KUFIJVE TË KOSOVËS 139**

I. *UTI POSSIDETIS JURIS*: NGA ROMA NË KOSOVË 145

Hyrje 145

1. Zhvillimi historik 146

2. Arsyeja prapa *uti possidetis juris* 152

3. Ish-federatat komuniste dhe Kosova 155

Në vend të përfundimit: a do të ndryshojnë kalkulimet e palëve? 159

II. CAKTIMI I KUFIJVE TË KOSOVËS ËSHTË KRYESISHT ÇËSHTJE E SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE 161

Hyrje 161

1. Pa delimitim nuk ka demarkacion: trajtimi i koncepteve kyçe në procesin e caktimit të kufijve terrestrialë mes shteteve 165

2. Parimi/rregulla *uti possidetis juris* në kontekstin krahasues dhe ish-jugosllav 171

3. Gabimet me Malin e Zi si pasojë e keqinterpretimit të bazës juridike ndërkombëtare e vendore për kufijtë 178

Përfundim 193

***Kapitulli IV*. MBI NOCIONIN SHTET, NACIONALIZMIN SERB DHE ASOCIACIONIN E KOMUNAVE, NGA PERSPEKTIVA KUSHTETUESE DHE NDËRKOMBËTARE 197**

I. NOCIONI SHTET NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE 202

Hyrje 202

1. Nocioni shtet në të drejtën ndërkombëtare 204

2. Kriteret për të qenë shtet në të drejtën ndërkombëtare 206

2.1. Kriteret klasike të qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare 207

a. Territori 217

b. Populllsia e përhershme 218

c. Qeveria 219

ç. Zotësia për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera 220

d. Pavarësia 221

2.2. Kriteret për të qenë shtet të sugjeruara si rezultat i zhvillimit modern të së drejtës ndërkombëtare 222

a. Normat *jus cogens* në të drejtën ndërkombëtare këtu 223

b. Vetëvendosja në të drejtën ndërkombëtare 225

c. Mosnjohja ndërkombëtare e një entiteti 231

2.3. Kriteret për të qenë shtet për qëllimet e Lidhjes së Kombeve dhe të Organizatës së Kombeve të Bashkuara 233

Përfundim 236

II. Refleksione mbi nacionalizmin serb dhe politikën e pastrimit etnik 242

Hyrje 242

1. Pasqyrë e shkurtër e fenomenit të pastrimit etnik përgjatë historisë 244

2. Fenomeni i pastrimit etnik si bazë e projektit mbi Serbinë e Madhe 246

3. Roli vendimtar i nacionalizmit serb në shkatërrimin e ish-Jugosllavisë 248

4. Cilësitë kryesore të pastrimit etnik të kryer nga serbët gjatë luftërave të fundit në Jugosllavi 251

Përfundim 252

III. Rasti i asociacionit serb në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës 254

Hyrje 254

1. Rrethanat e krijimit të rastit 256

2. Vendi i marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin e brendshëm 261

3. Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga parlamenti 265

4. Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve të paratifikuara ndërkombëtare . 271

Përfundim 277

Kapitulli V. **TË GJITHA GJYKATAT E HAGËS, "MURI I JASHTËM I SANKSIONEVE" DHE FILLIMI I ZBATIMIT TË LIGJEVE TË LUFTËS NË KOSOVË 279**

I. TË GJITHA GJYKATAT E HAGËS 283

Hyrja 283

1. Vështrim i shkurtër historik mbi përgjegjësinë penale individuale 284

2. Idetë për vënien në jetë të një juridiksioni penal ndërkombëtar 289

3. Puna e Komisionit për të Drejtën Ndërkombëtare në realizimin e idesë së formimit të një gjykate penale ndërkombëtare 290

4. Kërkesa e Bosnjë-Hercegovinës kundër Serbisë dhe Malit të Zi lidhur me krimin e gjenocidit kundër popullit dhe shtetit të Bosnjë-Hercegovinës . 293

5. Gjykata *Ad Hoc* për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi 298

5.1. Baza juridike për krijimin e Gjykatës 300

5.2. Kompetenca e Gjykatës 301

5.3. Organizimi i Gjykatës 304

5.4. Hetuesia dhe procedura përgatitore 304

5.5. Procedura për shqyrtimin kryesor të çështjes dhe pas tij 305

5.6. Bashkëpunimi dhe ndihma juridike 306

5.7. Dispozitat e përgjithshme 307

6. Krimet e kryera ne Kosovë në kontekstin e gjykatave të Hagës 307

6.1. Gjykata për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi 308

6.2. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë 310

Shqyrtime përfundimtare 313

II. MURI I JASHTËM I SANKSIONEVE 316

Hyrje 316

1. Filozofia e "murit të jashtëm të sanksioneve" 318

2. Bazat ligjore të konceptit 319

3. Përmbajtja e "murit të jashtëm të sanksioneve" 323

4. Efektet e "murit të jashtëm të sanksioneve" 327

Në vend të përfundimit 329

III. Eksperti ligjor i UÇK-së: së pari protektorati ndërkombëtar, pastaj pavarësia 331

IV. Një vështrim mbi të drejtën ndërkombëtare të luftës në dritën e konfliktit të armatosur në Kosovë 336

Hyrja 336

1. *Jus ad bellum* 338

2. Konfliktet e brendshme dhe konfliktet ndërkombëtare 338

4. *Jus in bello* 342

5. E drejta ndërkombëtare e luftës para dhe pas procesit të dekolonizimit dhe efektet e këtij procesi në planin ndërkombëtar 343

6. E drejta ndërkombëtare e luftës në luftërat për çlirim nacional (çlirimtare) 348

7. Vendi i Kosovës në të drejtën ndërkombëtare të luftës (*jus in bello* dhe *jus ad bellum* në rastin e Kosovës) 350

Përfundim 366

Literatura 369

1. Libra 369

2. Artikuj 376

3. Dokumente dhe materiale të tjera 391

Treguesi 403

Dy fjalë lexuesit

Libri që sot keni para jush, *Tema të përzgjedhura nga e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare*, paraqet përmbledhje të shkrimeve dhe artikujve akademikë të botuar në Kosovë dhe në botën e jashtme, që nga 1991. Viti në fjalë shënon kohën kur nisi me një hov të përshpejtuar shkatërrimi i ish-Jugosllavisë, krijesës nën të cilën kishim jetuar si popull që nga 1918. Ky shkatërrim hapi dyert për çlirim nacional jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të popujve të tjerë, të cilët ishin trajtuar si mos më keq, në veçanti mes dy luftërave botërore. E kemi fjalën për maqedonët dhe popullsinë myslimane të ish-Jugosllavisë, të cilët krahas shqiptarëve, u ishin nënshtruar politikave represive, shkatërrimtare dhe të asimilimit të dhunshëm të ekzekutuara nga hegjemonët serbë në Beograd.

Shkrimi i parë që i ofrohet lexuesit në këtë libër u botua në gazetën *Fjala*, e cila edhe nën okupimin serb të diktatorit Sllobodan Millosheviq dilte nga shtypi në Prishtinë dhe përbënte një dritare të vlefshme për të gjithë ata intelektualë shqiptarë në ish-Jugosllavi që merrnin kurajë për të sfiduar me forcën e penës strukturat e pushtetit serb të instaluar me dhunë në Kosovë. Shkrimet e para të autorit të këtyre rreshtave, deri me daljen në mërgim më 23 nëntor 1992 për të punuar si këshilltar i Qeverisë së Kosovës të prirë nga prof. dr. Bujar Bukoshi, kryesisht kanë të bëjnë me analizat juridiko-politike dhe juridiko-ndërkombëtare të vendimeve/mendimeve të Komisionit Badinter, si dhe me argumentimin e sforcuar me qëllim të hedhjes poshtë të tezës dominante serbe mbi të a.q. kontinuitet (vazhdimësi) të Serbisë me ish-Jugosllavinë. Kjo tezë mëtonte fitimin e tapive nga ana e serbëve, të cilët besonin se mund të trajtoheshin si trashëgimtarët e vetëm dhe ekskluzivë të ish-Jugosllavisë, duke i cilësuar popujt dhe republikat e tjera si jetime dhe të pambrojtur në planin ndërkombëtar. Kjo tezë u mbrojt deri me rrëzimin e diktatorit Millosheviq, pas kapitullimit të tij në Kosovë, më 10 qershor 1999 para trupave të NATO-s, ani se asnjë shtet apo organizëm relevant ndërkombëtar nuk kishte mirëkuptim për pikëpamjen serbe.

Temat mbi trashëgimin dhe kontinuitetin juridiko-ndërkombëtar të shteteve dhe mbi vetëvendosjen si parim dhe si e drejtë dominojnë këtë libër. Nga një lexim i kujdesshëm i tyre shihet se ka pasur një vazhdimësi akademike në diskursin e autorit të këtyre rreshtave. Shumëçka që është thënë këtu,

më vonë, me kalimin e viteve, u vërtetua katërçipërisht nga ngjarjet që pasuan. U pa se diskursi mbi "Kosovën si element konstitutiv i federatës jugosllave", si dhe narracioni për "Konferencën e Bunjajt si bazë për të drejtën e Kosovës për vetëvendosje" kanë qenë dhe akoma janë krejtësisht naive. Kjo u vërtetua në fund me vendimin/mendimin e GjND-së për Kosovën të datës 22 korrik 2010. Këto dhe gjërat lidhur me këto çështje janë trajtuar hollësisht në kapitujt e këtij libri.

Edhe në këtë libër është ndjekur metodologjia e njëjtë si me librin *Tema të përzgjedhura nga e drejta kushtetuese*: në fillim të çdo kapitulli, para se lexuesi të shkojë në përmbajtjen e artikujve që riprodhohen në libër, kemi dhënë një sfond historik për secilin punim, për kohën dhe motivet e shkrimit të tij, për vendin dhe datën e botimit, e për të gjitha aspektet e asaj që mund të quhet sociologjia e shkrimeve të përmbledhura. Këtë e kemi bërë me qëllim që lexuesi ta ketë më lehtë jo vetëm për të përzgjedhur se çka do të lexojë nga kjo antologji, por edhe për të fituar një pasqyrë sado pak të qartë për teknologjinë e secilit shkrim. Shpresojmë se me këtë qasje do të arrijmë t'ia kursejmë kohën dhe mundin lexuesit, duke i bërë më pak të mundimshme përsiatjet që kërkon një tekst të ri. Nganjëherë vështirë që racionalizohen përsiatjet, pikërisht për shkak të kaosit që ndien lexuesi në fillim të një vepre të re. Duke pasur këtë parasysh, u urojmë lexim të këndshëm të gjithë atyre që marrin mundin për ta shkoqitur këtë libër, i cili i kushtohet të gjitha viktimave të dhunës seksuale të luftës së fundit në Kosovë (1998-1999), pa dallim race e etnie, kombi, feje apo gjinie.

Autori, nëntor 2016

Falënderime

Libri që lexuesi e ka sot në dorë, *Tema të përzgjedhura nga e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare*, për nga vëllimi është afërsisht i njëjtë me *Tema të përzgjedhura nga e drejta Kushtetuese*. Në fakt, edhe botimi i tyre është i njëjtë, si në kohë ashtu dhe aspektin e resurseve njerëzore të cilat i pata në anën time dhe që mundësuan që dy këto libra të shohin dritën e tyre. Për rrjedhojë, edhe falënderimet dhe borxhi që kam ndaj familjes sime dhe miqve të caktuar janë krejtësisht të ngjashëm sikur për librin e parë nga lëmi kushtetues. I vetmi dallim është që recensentët e këtij libri janë profesorët dhe miqtë e mi të respektuar, prof. dr. Xhezair Zaganjori dhe prof. dr. Iliriana Islami.

Me profesorin Xhezair Zaganjori na lidhin shumë gjëra. Në rend të parë, puna jonë e përbashkët si diplomatë të shtetit shqiptar në një kohë jashtëzakonisht me rëndësi për Kosovën dhe shqiptarët në Ballkan. E kam fjalën për periudhën 1992-1997, kur prof. Xhezairi shërbente si ambasador në Gjermani. Asokohe, shërbimi diplomatik i Shqipërisë pati vënë në dispozicion të Kosovës tërë fuqinë e vet modeste — vetëm e vetëm që Kosova ta arrinte lirinë dhe pavarësinë që gëzon sot. Më vonë, kur mora postin e kryetarit të parë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në qershor 2006, ka qenë ndërmjetësimi dhe mbështetja e prof. Xhezairit që i hapi dyert këtij autori për të depërtuar në qarqet akademike dhe praktike të gjyqësisë kushtetuese evropiane. Për këtë, jam shumë mirënjohës, siç jam mirënjohës pafundësisht për mirësinë që pati prof. Xhezairi për të lexuar pa përtesë dorëshkrimin e këtij libri. Ky libër, në fakt, përbën specializimin më të ngushtë të cilin prof. Xhezairi për lexuesin shqip disa herë e ka shpërfaqur nëpër librat dhe shkrimet e tij akademike që nuk kanë krahasimin ndër ne. I jam shumë mirënjohës po ashtu edhe për faktin se pa asnjë hezitim pranoi të jetë recensent i këtij libri, kur iu drejtova në pranverë të këtij viti për konceptin dhe vetë idenë e librit që sot lexuesi e ka në dorë.

Prof. Iliriana, përkundër angazhimeve të saj, si prodekane dhe pedagoge në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, nuk ngurroi asnjë moment për të qenë recensenti i dytë, duke dhënë sugjerime të vlefshme gjatë tërë kohës sa kam punuar në kapitujt e librit. Kanë qenë në veçanti të vlefshme komentet e prof. Ilirianës që kanë të bëjnë me njohjen ndërkombëtare

dhe rolin e saj në shtetformimin pas mbarimit të Luftës së Ftohtë. Kjo çështje, së bashku me problemet e tjera të trashëgimit të shteteve në kontekstin ish-komunist, përbën esencën e këtij libri, dhe ekspertiza e prof. Ilirianës gjatë shkrimit të librit dhe radhitjes së temave të përzgjedhura kanë qenë të pazëvendësueshme.

Gjithherë duhet ta përsëris se falënderimi krejt i pafund, ani se mund të duket i dalë nga motivet e mia meskine, shkon për Burbuqen, bashkëshorten time, dhe për fëmijët: Kastriotin, i cili me nipat tanë të dashur jeton prej vitesh në Finlandë (ku punon dhe studion në të njëjtën kohë), dhe Vatanin e Dënesën, të cilët ka kohë që kanë filluar të studiojnë dhe, për pasojë, të mirëkuptojnë mungesën e gjatë të ngrohtësisë prindërore të autorit të këtyre rreshtave. Çdo punë intelektuale serioze kërkon një sakrificë. Lum ata që kanë mirëkuptimin e familjes, si puna ime që e kam pasur prore dhe pa asnjë rezervë, aq sa në sytë e tjerëve nganjëherë është dukur si një marrëzi. Burbuqja, bashkëshortja ime, ka meritë të posaçme për durimin dhe përkushtimin e pafund që ka treguar çdoherë kur unë kam hyrë në lexim e shkrim të ndonjë teksti, pa asnjë kusht. Aq shumë jam i llastuar me mirësjelljen e saj, aq sa kam përshtypjen sikur të sillej ndryshe qoftë edhe një minutë do ta merrja si një shaka të saj ndaj meje. Faleminderit shumë, Buqe!

Me ndjesi të rrallë duhet të ritheksoj edhe këtu fjalë miradije e falënderimi të sinqertë që kam për Ramiz Tafilajn, mikun shqiptaro-amerikan që jeton në Teksas. Kur para gjashtë muajsh fola me të rreth mundësisë së botimit, hasa në mirëkuptimin e tij të parezervë. Shtëpia e tij botuese "Jalifat Publishing", në Hjuston të Teksasit, mori përsipër të nxjerrë këtë dhe librin simotër mbi të drejtën kushtetuese. Me Ramizin u pajtuam që krejt fitimet nga shitja e dy librave t'u shkojnë — pa dallim race e etnie, kombi, feje apo gjinie — viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë (1998-1999). Vetëm ata që kanë punuar me Ramizin dinë të tregojnë për zemërgjerësinë e tij dhe natyrën e butë që nuk ka kulturë njeriu që mund ta keqkuptojë e aq më pak ta refuzojë. Nuk ka fjalë që mund ta shprehë falënderimin tonë për mbështetjen që na ka dhënë miku ynë tej Atlantikut: Ramizi e ka bërë të mundshme që ky libër sot ta shoh dritën e vet.

Dr. jur. Getoar Mjeku, një avokat i shkëlqyer, i shkolluar në ShBA, ka qenë me autorin tërë kohën dhe ka pasur durim të hollë për të ndjekur çdo gabim si në strukturën e tekstit dhe në përmbajtjen e tij. Një ndër dobësitë e mëdha që ka ky autor është refuzimi i përhershëm për të lexuar tekstet e veta pas dorës së parë të tyre, diçka që përbën një hendikep të madh në çdo përpjekje intelektuale, sepse puna e mirë dhe gabimet shihen dhe zbulohen në

leximet e tjera. Këtë mangësi timen e ka mënjanuar Getoari duke u marrë kohërisht me tekstin në dorëshkrim shumë më gjatë se vetë autori. I jam mirënjohës aq shumë Getoarit. Nuk kam fjalë për keqardhjen të cilën e ndiej për mundimin e pafund që i kam shkaktuar duke ia lënë në barrë korrigjimin e gabimeve konstante të teksteve të mia.

Prof. Bekim Bejta, një mik imi i vjetër, ka pasur durimin dhe mirësinë për leximin e dorëshkrimit tim. I jam mirënjohës për sugjerimet e dhëna në stilin dhe në përmbajtjen e tekstit. Elokuencën e sugjerimeve të prof. Bejtës kam provuar ta reflektoj në librin që sot gjendet para jush.

Në fund, krejt atyre që nuk i përmend këtu u jam mirënjohës: ata që në vazhdimësi kanë lexuar pjesët e caktuara të këtij libri, që më kanë dhënë ide dhe materiale për t'i përdorur në këtë libër, atyre që kanë mbështetur që libri t'i kalojë sa më shpejt procedurat burokratike për të dalë si tekst universitar, si dhe atyre që më kanë inkurajuar për në një përmbledhje të vetme të shkrimeve të mia të përzgjedhura. Janë shumë dhe nuk di kah t'ia nis me falënderimet. Më mirë po e lë me kaq: i falënderoj të gjithë ata të cilët më ndihmuan aq shumë që ky libër sot të jetë në duart e lexuesit.

Autori, nëntor 2016

Shkurtesa

APJ — Armata Popullore e Jugosllavisë (ushtria e ish-RSFJ-së)
AShAK — Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës
AShAS — Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë
BB — Banka Botërore
BE — Bashkimi Evropian ose Bashkësia Evropiane
BEE — Bashkësia Ekonomike Evropiane
BRSS — Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike
CASIN — *Center for Applied Studies in International Negotiations*, Qendra për Studime të Aplikuara në Negociata Ndërkombëtare, Gjenevë
CPIJ — *La Cour permanente de justice internationale*, emërtimi në gjuhën frënge i ish-Gjykatës Permanente të Drejtësisë Ndërkombëtare, e cila ka ekzistuar me seli në Hagë nga viti 1920 deri në vitin 1945
DBShTN — Drejtoria e Bashkëpunimit Shumëpalësh dhe e Traktateve Ndërkombëtare, MPJ e Shqipërisë
E drejta — Revistë akademike e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, e cila në kohën e ish-Jugosllavisë është botuar me rezyme në gjuhët shqipe dhe serbe, kurse tani botohet shqip dhe me rezyme anglisht
EPC — *European Peace Conference*, Konferenca e Evropës për Paqe në Jugosllavi
FMN — Fondi Monetar Ndërkombëtar
GIZ — *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit*, Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GjEDNj — Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjND — Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
IBRU — *International Boundaries Research Unit*, Njësia e Hulumtimeve për Kufijve Ndërkombëtarë
ILM — *International Legal Materials*
IMPP — *Institut za medjunarodnu politiku i privredu*, Instituti për politikë dhe ekonomi ndërkombëtare, Beograd
KAÇKJ (AVNOJ) — Këshilli Antifashist i Çlirimit Kombëtar të Jugosllavisë (*Antifašističko vijeće narodnog oslobođenja Jugoslavije*)
KDMSP — *Kosovo Debt Management Support Program* (Programi i Mbështetjes së Menaxhimit të Borxhit të Kosovës)

KEDNj — Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEF — Këshilli Ekzekutiv Federativ, ish-Jugosllavi
KEK — Korportata Energjetike e Kosovës
KFOR — *Kosovo Force*, ushtria e NATO-s në Kosovë
KPP — Komitetit i Përbashkët i Përhershëm (*Joint Standing Committee*)
KPTSTP — Komiteti i Përbashkët mbi Trashëgimin e Sendeve të Tundshme dhe të Patundshme (*Joint Committee on Succession to Movable and Immovable Property*)
KS i OKB — Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
KSAK — Krahina Socialiste Autonome e Kosovës, emërtim i sanksionuar me Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974
KSBE — Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KV I — Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin e Shteteve ndaj Traktateve Ndërkombëtare e vitit 1978
KV II — Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin e Shteteve ndaj Pronës, Arkivave dhe Borxhit të Jashtëm e vitit 1983
KVDT — Konventa e Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve e vitit 1980
LKJ — Lidhja Komuniste e Jugosllavisë, organizatë udhëheqëse e ideologjisë komuniste, e shkatërruar me shpërbërjen e ish Jugolsllavisë
MK — Marrëveshja e Kumanovës, Marrëveshje Teknike Ushtarake mes NATO-s dhe RFJ-së
MPJ — Ministria e Punëve të Jashtme
MT — Marrëveshja për Çështjet e Trashëgimit dhe Anekset A deri G, nënshkruar më 29 qershor 2001 në Vjenë mes Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Sllovenisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë ("Unioni Serbi dhe Mali i Zi", i cili formalisht ka përfshirë dhe Kosovën në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të datës 10 qershor 1999)
NATO — *North Atlantic Treaty Organization*, Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OKB — Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE — Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OUA — *Organization of African Unity*, Organizata e Unitetit Afrikan
PSSP — Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së
QIK — Qendra për Informim e Kosovës (1990-1999)
RFJ — Republika Federale e Jugosllavisë, e përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi, themluar në prill 1992 nga diktatori serb Sllobodan Millosheviq
RSFJ — Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

RSS — Republika Socialiste e Serbisë

SANU — Srpska Akademija Nauka i Umetnosti, Akademia Serbe e Arteve dhe Shkencave (shqip edhe Akademia e Arteve dhe Shkencave e Serbisë, AShAS)

ShBA — Shtetet e Bashkuara të Amerikës

SKS — Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene (1918-1945)

TDN — *Turkish Daily News*, gazetë ditore turke, e cila del në Ankara në gjuhën angleze, e dedikuar për qarqet diplomatike

UÇK — Ushtria Çlirimtare e Kosovës

UE — Unioni Evropian ose Bashkimi Evropian sot (dikur i njohur si Bashkësia Evropiane, shkurt BE, para lidhjes së Traktatit të Mastrihtit në vitin 1993, përkatësisht deri me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës në vitin 2009)

UNMIK — *United Nations Interim Administration Mission in Kosovo*, Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, themeluar më datën 10 qershor 1999 në bazë të Rezolutës 1244 të KS të OKB-së të së njëjtës datë. Mandati i tij akoma është në fuqi në aspektin formal, meqë nuk ka vendim të ri të KS të OKB-së për ta mbyllur këtë mision ndërkombëtar në Kosovë.

USMZ — Unioni Shtetëror Serbi–Mal i Zi (mars 2002–qershor 2006)

Kapitulli I

FILLET E SHPËRBËRJES DHE TË SUKSEDIMIT TË ISH-JUGOSLLAVISË

Sfondi historik: Në këtë kapitull flasim për tri aspekte të problemit të ish-Jugosllavisë dhe vendit të Kosovës në të. I pari ka të bëjë me mendimet e Komisionit Badinter për ish-Jugosllavinë, mendime që kanë pasur forcën rrënuese të iluzioneve të nacionalizmit serb se do të mund të përdorte tërë forcën fizike që kishte në disponim për të pushtuar të tjerët dhe për t'i diktuar rregullat e lojës politike dhe të vetë trashëgimit të ish-Jugosllavisë si shtet. I dyti shkrim lidhet me këtë dhe ka të bëjë me trajtimin e problematikës së suksedimit (trashëgimit) të ish-Jugosllavisë, problematikë kjo që edhe sot e kësaj dite është aktuale dhe po e ndjek Kosovën si hija e djallit. Që nga koha kur kjo temë është hapur në këto hapësira, për çudi, asnjë shkrim serioz ose punim akademik nuk ka pasur, ani se thelbësisht paraqet një çështje jetike për Kosovën dhe statusin e saj juridiko-ndërkombëtar. U mor vesh, këtu nuk llogarisim shkrimet tona akademike dhe librat që i kemi botuar që nga shkrimi i parë që riprodhohet këtu në këtë kapitull, me titull "Vendimi i Arbitrazhit (s')është i drejtë"[1]. Këtu i riprodukojmë të gjitha, në një libër të vetme, me qëllim që lexuesi shqipfolës ta shohë kontinuitetin e diskursit tonë lidhur me këtë problematikë të rëndësishme për Kosovën. I vetmi shkrim që nuk riprodhohet këtu është ai që lidhet më diskutimin tonë për moskontinuitetin në mes të ish-Jugosllavisë dhe Mbretërisë së Serbisë, të cilin nuk kam arritur ta siguroj si pasojë e pamundësisë fizike të pasjes së tij në rrethanat e krijuara pas Luftës së Kosovës (mars 1998–qershor 1999). Ai shkrim qe botuar në Kosovë[2], mirëpo lexuesi e ka pak a shumë të njëjtin shkrim të përfolur dhe të diskutuar deri në fund në librin (disertacionin tim të doktoratës). Për lexuesin e sotëm duket pak çudi pse e cekim Prishtinën si vendin e botimit të shkrimit në fjalë! Atëkohë ka pasur vetëm gazeta e revista shqip ditore, në të cilat botonim edhe shkrimet akademike. Si të tilla, ato në shumicën e rasteve diln-

[1] Enver Hasani, "Vendimi i Arbitrazhit (s) është i drejtë", *Fjala* (dhjetor 1991, Prishtinë).
[2] Enver Hasani, "Mbretëria e Serbëve-Kroatëve-Sllovenëve nuk është vazhdimësi juridike e Mbretërisë së Serbisë", *Fjala* nr. 23 (qershor, 1991, Prishtinë) fq. 10-11.

in në Prishtinë dhe në Tiranë, nganjëherë edhe në diasporë. Kjo është arsyeja pse e theksojmë Prishtinën si vend botimi dhe llojin e botuesit.

Shkrimi i dytë flet në mënyrë ekskluzive për konventat e Vjenës që normojnë materien e suksedimit (trashëgimit) të shteteve në sferën e traktateve, kufijve, pasurisë shtetërore dhe borxhit të jashtëm, arkivave dhe çështjeve të tjera[3]. Këto konventa, pra konventat e Vjenës, kanë një rëndësi të madhe dhe kanë shërbyer si pikë kryesore e referimit për ndërmjetësuesit ndërkombëtarë me rastin e lidhjes së Marrëveshjes së Vjenës për Trashëgimin e ish-Jugosllavisë, e cila u lidh në mes ish-republikave jugosllave në Vjenë më 2001. Kjo materie diskutohet edhe në kapitullin e dytë në vijim të këtij libri monografik dhe më në detaje, sepse ka qenë dhe ngelet një problematikë që e ka lënë jashtë Kosovën si pasojë e mosqenies së saj shtet sovran dhe i pavarur më 2001, kur u mbyll procesi i trashëgimit të ish-Jugosllavisë.

Shkrimi i fundit në këtë kapitull, i titulluar "Suksedimi i shtetit jugosllav dhe instrumentalizimi juridiko-ndërkombëtar i subjektivitetit të Kosovës" u shkrua në fillim të vitit 1992, kurse u prezantua si punim në një simpozium shkencor ndërkombëtar, organizuar në Prishtinë nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës dhe Instituti Albanologjik. Simpoziumi u titullua *Shqiptarët në rrjedhat ballkanike* (prill 1992) dhe u mbajt në një kohë mjaft të vështirë për Kosovën. Më pastaj, në të përditshmet kosovare është ribotuar, por që unë nuk kam pasur mundësi ta kem kopjen e tyre, sepse nuk kam jetuar në Kosovë në atë kohë. Një version të botuar në *Bujku* e shoh shpeshherë të citohet nga studentët e drejtësisë që punojnë temat e masterit në lëmin e së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Vlen të thuhet se, për arsye të vështirësive të kohës, asnjëherë nuk u botuan kumtesat nga ky simpozium, ani se në fillim organizatorët patën premtuar se do t'i botonin.

Sikundër shihet nga vetë tema, esenca e saj ka qenë arsyetimi i ndryshëm i së drejtës për vetëvendosje të shqiptarëve në ish-Jugosllavi në një kohë kur ngrehina e sllavëve të Jugut e quajtur Jugosllavi po i numëronte ditët e fundit. Shkrimi është shkruar në fillim të vitit 1992, kur akoma nuk ka pasur prononcim ndërkombëtar relevant dhe kompetent për fatin e mëtejmë të atij shteti. Ky punim ka provuar sërish si më herët në dy shkrimet tjera që riprodhohen këtu se Kosova dhe e drejta e saj për vetëvendosje dilte jo nga teksti i Kushtetutës së vitit 1974, por nga normat dhe praktikat e së drejtës ndërkombëtare mbi krijimin e shteteve nga shpërbërja e shtetit ekzistues, siç ndodh-

[3] Enver Hasani, "Disa çështje lidhur me Konventat e Vjenës mbi Trashëgimin e Shteteve", botuar në *Fjala* (prill 1992, Prishtinë).

te me ish-Jugosllavinë, e cila ishte në procesin e shpërbërjes. Ne po arsyetonim krejt shkencërisht se trashëgimi i ish-Jugosllavisë duhej t'u takonte edhe shqiptarëve dhe Kosovës si një entitet territorial i veçantë dhe i dallueshëm nga të tjerët në kuadër të ish-Jugosllavisë. Këtu, ne për herë të parë shpalosëm projektin tonë për Kosovën si një protektorat ndërkombëtar, shumë larg para se ai term të niste të përdoret në diskursin publik politik në Kosovë dhe më gjerë. Këtë propozim e kishim arsyetuar me terma krejt shkencorë nga lëmi i së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, duke u bazuar në praktikat dhe standardet që ishin zbatuar gjetiu. Literatura që është përdorur aty pak a shumë është e njëjtë me literaturën që më pastaj gjatë thellimit të studimit tim në lëmin e shpërbërjes dhe trashëgimit të shteteve e kam përdorur nëpër punimet e mia, përfshirë edhe librin (disertacionin tim të doktoratës) i cili u botua në Vjenë më 2003[4]. Ajo çka ka rëndësi, po ashtu, ka të bëjë me frazën latine të cilën e kishim përdorur në fillim të punimit: *tam Marte quam Minerva*. Kësaj sintagme i kam besuar që nga dita e parë e angazhimit tim në jetën publike politike në Kosovë pas rrënimit të komunizmit, ani se në një moshë mjaft të re, duke besuar se edhe lidershipi ynë ka rezonim të njëjtë. Ky rezonim, që përmblidhej në sintagmën e sipërcekur latine, në fakt ka ekzistuar te pjesa dërrmuese e popullit shqiptar në ish-Jugosllavi, i cili ka besuar se rruga paqësore ishte vetëm fitim kohe për t'u përgatitur për një konfrontim me forcat pushtuese serbe, gjithnjë duke shpresuar se edhe ambienti ndërkombëtar do të ishte më vonë më i favorshëm për shqiptarët. Në fakt, në fund ashtu edhe doli të ishte.

[4] Enver Hasani, *Self-Determination, Territorial Integrity and International Stability: the Case of Yugoslavia*, botuar nga "National Defense Academy and Bureau for Security Policy" (2003, Vjenë, Austri).

I. Vendimi i Arbitrazhit (s')është i drejtë

Hyrja

Para se të flasim për këtë çështje juridike, mosnjohja e së cilës mund të ketë pasoja të rënda për popullin shqiptar në momentin e fillimit të zbatimit të saj, e shohim të rrugës të flasim dy-tri fjalë për natyrën juridike të Komisionit të Arbitrazhit, i cili vepron në kuadër të Konferencës së Paqes për Jugosllavinë. Komisioni është themeluar më 7 nëntor 1991, në bazë të Deklaratës mbi Hapjen e Konferencës së Paqes nga ana e BEE-së [Bashkësisë Ekonomike Evropiane][5].

Kur thuhet se mosnjohja e çështjes së vendosur me këtë vendim do të këtë pasoja të rënda në momentin e fillimit të zbatimit tij, atëherë përkujtojmë lexuesit se një gjë e tillë ka filluar më datën 16 dhjetor 1991, me Deklaratën për Jugosllavinë, në të cilën data e 23 dhjetorit 1991 është e fundit për deklarim nga ana e republikave jugosllave para BEE-së se cilat nga to dëshiron të njihet si shtet në pikëpamje ndërkombëtare, kurse 15 janari i vitit 1992 është data kur hyn në fuqi një njohje e tillë për ata që e kërkojnë.

Arbitrazhi si institucion bën pjesë në mjetet për zgjidhjen paqësore të kontesteve ndërkombëtare. Si i tillë, ai ka qenë i njohur qysh nga kohërat më të lashta (p.sh., te popujt e Lindjes së Vjetër, sumerët, te grekët, romakët etj.). Në kohën e moderne, rasti i njohur si "rasti Alabama", i zgjidhur më 1872 mes Anglisë dhe ShBA-së, ka qenë vendimtar për përhapjen dhe popullarizimin e këtij mjeti paqësor për zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare. Në këtë rast Anglia qe ndëshkuar me pagimin ShBA-së rreth të 16 milionë dollarëve për shkak se nuk kishte respektuar detyrimin e saj si shtet neutral në luftën mes shteteve të Veriut dhe të Jugut ku ShBA-ja kishte pësuar dëmin që Anglia duhej ta kompensonte. Anglia në afatin e dhënë njëvjeçar, në mënyrë korrekte dhe në tërësi, zbatoi vendimin e cekur të arbitrazhit[6]. Kur bëhet fjalë, si në rastin e cekur, për gjyqet e arbitrazhit, me këtë mjet zgjidhen zakonisht kontestet e natyrës juridike, mirëpo me të mund të zgjidhen edhe kontestet e

[5] Shih tekstin integral në *Medjunarodna politika* no. 995-7 (Beograd, 1991) fq. 28.
[6] Smilja Avramov — Milenko Kreća, *Medjunarodno javno pravo* (Savremena Administracija: Beograd, 1983) fq. 384.

një natyre politike. Me rastin e vendosjes, arbitrazhi bie vendim që ka formën e aktgjykimit dhe zbaton të drejtën pozitive ndërkombëtare, kurse për çështjet e caktuara mund të jepë edhe mendim juridik, siç është rasti që neve këtu e shqyrtojmë. Edhe pse në rastin tonë që diskutojmë bëhet fjalë për një komision të arbitrazhit, vendimet e të cilit nuk janë të obligueshme. Në "rastin Alabama" ky nuk ka qenë rasti, sepse marrëveshja e palëve ka qenë që vendimet e tij të jenë të detyrueshme, gjë që edhe ka ndodhur, siç u pa më sipër. Autoriteti i dhënësit të tyre, BEE-së, në kuadrin e të cilit punon Komisioni i Arbitrazhit dhe Konferenca e Paqes për Jugosllavinë, me siguri se do të ketë për pasojë që vendimet e tij të respektohen në të ardhmen.

Konstituimi i arbitrazheve mund të bëhet në mënyra të ndryshme, kurse me rastin e konferencave, kongreseve dhe të formave tjera të komunikimit ndërkombëtar, zakonisht parashihet konstituimi i arbitrazhit (qoftë në formë komisioni apo gjyqi) si organ i cili duhet, në mënyrë kompetente, të jepë përgjigje lidhur me çështjet të cilat lindin dhe të cilat kërkojnë zgjidhje. Në këtë mënyrë, BEE në Deklaratën për Jugosllavinë të datës 3 shtator 1991 (Hagë) ka marrë nën patronatin e vet thirrjen e Konferencës për Paqe në Jugosllavi, duke u obliguar njëkohësisht se me këtë rast do të vëjë në veprim edhe një procedurë të arbitrazhit si një mekanizëm të vetin[7]. Më datën 7 shtator 1991, procedura e arbitrazhit e paraparë në Deklaratë mori formën e një mekanizmi institucional të rangut tanimë të njohur si Komisioni i Arbitrazhit, i cili tani e tutje do të shqyrtojë çështjet të cilat janë "objekt i arbitrazhit"[8].

Për bazë të elaborimeve tona kemi marrë tekstin integral të përgjigjes (mendimit) të Komisionit të Arbitrazhit drejtuar Lordit Kerington, i cili në versionin shqip është botuar në gazetën *Fjala*, nr. 47/1991 (fq. 4). Për të parë implikacionet praktike, gjegjësisht për të nxjerrë përfundimet tona në lidhje me këtë çështje, nevojitet që të shqyrtohen veçanërisht:

a. parimet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me ekzistimin e shteteve dhe njohjen e tyre;
b. sovraniteti shtetëror dhe elementet tjera të shtetit;
c. dispozitat juridike mbi rregullimin e brendshëm shtetëror dhe raporti i tyre ndaj të drejtës ndërkombëtare; dhe, së fundi,
ç. çështjet lidhur me atë se çka është "trashëgim (suksedim) i shtetit" sipas së drejtës ndërkombëtare.

---

[7] Shih tekstin integral të Deklaratës në *Medjunarodna politika* nr. 995-7 (Beograd 1991) fq. 27.

[8] Cf. po aty fq. 27.

a.

Gjatë historisë janë bërë ndryshime të shumta në formimin e shteteve. Shtetet e vjetra janë zhdukur si rezultat i bashkimit me shtetet tjera ose është bërë ndarja e tyre në më shumë shtete dhe kësisoj janë krijuar shtete të reja; territoret e mëparme koloniale dhe shtetet vasale kanë fituar shtetësinë, etj. etj. Parimi themelor në lidhje me këtë është se krijimi i shteteve të reja është çështje faktike dhe jo çështje juridike, prandaj merret se shteti i ri me paraqitjen në arenën ndërkombëtare bëhet subjekt i së drejtës ndërkombëtare[9]. Këtë pozicion klasik të së drejtës ndërkombëtare e ka përsëritur Komisioni i Arbitrazhit në pikën 1.A, në të cilën konstatohet se nëse shteti i ka plotësuar kushtet e domosdoshme përbën vetëm një fakt të thjeshtë. Këto fakte është e domosdoshme për t'i pasur parasysh vetëm me qëllim të përcaktimit të ndikimit të qeverisë mbi popullsinë dhe territorin e dhënë. Kjo qasje në mënyrë unanime pohohet në teorinë dhe praktikën e së drejtës ndërkombëtare. Kështu ka vepruar edhe Komisioni kur ka analizuar faktet që kanë të bëjnë me përcaktimin e rolit dhe të pjesëmarrjes së njësive federale (kur flitet për shtetet me rregullim federativ) në kryerjen e funksioneve të pavarura kushtetuese, gjë e cila ka të bëjë me çështjet brenda kufijve të shtetit federal. Për të drejtën ndërkombëtare, kjo çështje është një *res inter alios acta*, gjegjësisht nuk i përket domenit të saj rregullativ.

Një shikim pak më i gjerë i angazhimit të njësive federale (dhe i pjesëve tjera përbërëse në kuadër të shteteve federale) në planin ndërkombëtar, megjithatë, na tregon një pasqyrë të ndryshme për këtë çështje. Si rregull, angazhimi i njësive federale është përjashtim kur flitet për të drejtën aktive dhe pasive të përfaqësimit ndërkombëtar të shtetit. I një natyre të tillë është edhe lëmi i vendosjes mbi luftën dhe paqen, i cili zakonisht është në kompetencë të federatës. Vetëm në sferën e lidhjes së marrëveshjeve të caktuara ndërkombëtare, si një nga aspektet e "aftësisë për komunikim të një shteti", qoftë me ose pa pëlqimin e federatës, mund të hasim në zgjidhje të tilla kushtetuese të cilat duhet të merren parasysh me rastin e shqyrtimit të subjektivitetit të kufizuar ndërkombëtar të shteteve federale[10]. Sovraniteti shtetëror, territori,

---

[9] Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike*, Pjesa I (Rilindja: Prishtinë 1988) fq. 77; ngjashëm edhe te Giovanni Sperduti, "Stati", në *Novissimo Digesto ltaliano* vol. VXII (Torino, 1971) fq. 132 e tutje.

[10] Shih më shumë për këtë, përfshirë këtu edhe kapacitetin e kufizuar të Kosovës në lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, por edhe zgjidhjet kushtetuese komparative të kësaj tematike, në Stevan Djordjević, *Republike i pokrajine u medjunarodnim odnosima jugoslovenske federacije* (Naučna Knjiga : Beograd, 1985)

populsia dhe aftësia për komunikim ndërkombëtar, ndërkaq, ngelin konstante, që d.m.th. se vetëm me pasjen e tyre shteti bëhet subjekt i plotë i së drejtës ndërkombëtare. Njohja e tij, e cila ka karakter deklarativ, sikur do të thoshte prof. Giovanni Sperduti, konkretizohet me vendimin për t'iu përmbajtur rregullave të përgjithshme të sjelljes në komunitetin ndërkombëtar[11]. Kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se njohja e shtetit duhet të minimizohet, ngase historia njeh raste kur akti i njohjes ka pasur peshë të madhe politike thuajse me një karakter konstitutiv, gjegjësisht me efekt krijues të shtetit, siç ka qenë rasti me Sllovenínë dhe Kroacinë. Në këtë kuptim, njohja paraqitet si një *fakt parajuridik*[12], gjegjësisht luftë për zënien e pozicioneve të reja në "rendin e ri ndërkombëtar".

Në vijim si më sipër, duket brengosës fakti se përse Kuvendi i Republikës së Kosovës ende nuk e ka shpallur formalisht *shkëputjen nga Jugosllavia* në mënyrë që pas njohjes së republikave të tjera të mos trajtohemi më si "territor i ish-Jugosllavisë". Me fjalë të tjera, edhe pse ekzistimi politik i shtetit është i pavarur nga njohja prej shteteve tjera, kjo assesi nuk do të thotë se në "rendin e ri Evropian, gjegjësisht ndërkombëtar" kjo çështje nuk ka peshë të barabartë dhe gati konstitutive me paraqitjen faktike të shtetit, sepse, sikur do të thoshte plaku i urtë i Shalës së Bajgorës, *Beçir Voca*, mund të na bëhet vonë e të bëhemi "argatë të huej" (nga biseda e tij me Isa Boletinin në fshatin Selac në fillim të përgatitjeve për kryengritjen e vitit 1912).

b.

Në pikën 1.B, Komisioni ka përcaktuar kushtet qenësore të cilat janë imanencë e çdo shoqërie të organizuar në shtet. Aty, sipas Komisionit dhe kritereve klasike të së drejtës ndërkombëtare, përveç territorit dhe popullsisë gjendet edhe kriteri i sovranitetit shtetëror. Sovraniteti shtetëror nënkupton që shteti është i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta shtetërore ndaj tërë popullsisë që jeton në territorin e tij shtetëror. Nga kjo përjashtohen hapësirat diplomatike dhe personat diplomatiko-konsullor, çështje që neve këtu nuk na hyjnë në punë.

Fjala popull në kuptim të *demos*-it është një nocion i cili në praktikë më së shumti është keqpërdorur si nga ana e regjimeve të majta ashtu edhe atyre të djathta, në ndërkohë që në rastin e shteteve shumënacionale *etnos*-i vogël është majorizuar ashtu që ka pasur për pasojë hegjemonizmin e kombit më

[11] Giovanni Sperduti, "Stati", fq. 122.
[12] Po aty, fq. 127.

të madh në numër. Për këtë arsye, në shoqëritë moderne janë krijuar nocionet fenomenologjike siç janë *legjitimiteti i pushtetit shtetëror* dhe *sundimi i ligjit*.

Legjitimiteti i pushtetit shtetëror do të thotë participimi i barabartë në krijimin dhe ushtrimin e pushtetit shtetëror pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare, fetare, gjuhësore, gjinore etj. etj. Sundimi i së drejtës (*rule of law*) konsiston në zbërthimin praktik të thënies së Montesquieusë (Monteskië) sipas së cilës "ekzistojnë dy lloje të të këqijave, njëra kur populli nuk iu nënshtrohet ligjeve dhe, e keqja tjetër, kur popullin e prishin vetë ligjet, e keqe kjo e pashërueshme sepse gjendet në vetë ilaçin". Çdo qasje tjetër në koncipimin e sovranitetit shtetëror shpie kah "makiavelizmi revolucionar"[13], i cili predikohet në rrethet doktrinare dhe në politikën aktuale serbe dhe ka për pasojë mohimin e sovranitetit nacional të kombeve tjera dhe reduktimin e tyre me dekret në pakica kombëtare.[14] Mbase edhe Komisioni është dashur që të shtojë në pikën 1.B edhe këtë tekst vijues: "mungesa e sovranitetit shtetëror ndaj popullatës e cila jeton në territorin e caktuar shtetëror manifestohet në mos zbatimin e ligjeve, gjegjësisht në zbatimin e tyre me përdorimin e dhunës fizike ndaj popullatës, pa marrë parasysh se për cilat ligje bëhet fjalë". Dhe, më tutje, mbase edhe të theksojë se moszbatimi i ligjeve, gjegjësisht zbatimi me dhunë i ligjeve të cilat në botën e civilizuar zbatohen pa pengesë (p.sh. lëmenjtë e arsimit, shëndetësisë, etj. etj.) është shembull tipik i okupimit i cili si i tillë paraqet gjendje faktike dhe jo gjendje juridike, gjegjësisht gjendje jashtë ligjit. Besojmë se kështu Komisioni do ta lokalizonte jashtë çdo dyshimi se cilat janë gjendjet e tilla okupuese, jo vetëm kur flitet për Kosovën, por edhe ndaj viseve tjera, si p.sh. Bosnjë-Hercegovina, e cila në pjesën më të madhe të territorit i ka suspenduar ligjet federative dhe e cila iu është nënshtruar një "okupimi të qetë" (tani për tani).

c.

Është i drejtë formulimi i Mendimit të Komisionit i dhënë nën pikën l.C, në të cilën thuhet si vijon:

---

[13] Shih qasjen serbe për këtë te Kosta Čavoški, *Revolucionarni makijavelizam i drugi eseji* (Rad: Beograd, 1989)

[14] Shih më shumë për këtë në: Enver Hasani, "Sovraniteti dhe vetëvendosja", kumtesë e lexuar më 24 maj 1991, në simpoziumin shkencor më titull *Shqiptarët dhe Evropa, dje dhe sot*, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (mbajtur në Prishtinë, më 23-26 maj 1991); Enver Hasani, "Sovraniteti dhe vetëvendosja", *Fjala* nr. 24 (Prishinë, 1990) fq. 3 dhe literatura e cekur aty.

> me qëllim të zbatimit të këtyre kritereve, forma e organizimit të brendshëm politik dhe e dispozitave kushtetuese është vetëm një fakt i thjeshtë, ndonëse është e domosdoshme për t'i pasur parasysh ato me qëllim të përcaktimit të ndikimit të qeverisë mbi popullsinë.

Formulimi i cekur nën pikën 1.C të Mendimit të Komisionit, ani se i drejtë, bie në kundërshtim me pikat 2.A dhe 2.B, nisur nga fakti se Kosova është akoma një njësi federale sipas Kushtetutës në fuqi të vitit 1974, të cilën Komisioni (në pikën 2.A, lidhur me pikën 1.C) e ka marrë parasysh krahas deklaratave mbi pavarësinë të Sllovenisë, Kroacisë, Maqedonisë dhe Bosnjë-Hercegovinës. Me fjalë të tjera, nëse Komisioni në pikën 1.C ka konstatuar se dispozitat e brendshme kushtetuese duhet pasur parasysh, atëherë është dashur që edhe Kosova të ketë një trajtim të njëjtë dhe të merret parasysh edhe *Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës* e datës 22 shtator 1991, përfshirë këtu edhe rezultatet e *Referendumit për Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur me të drejtë bashkimi me shtetet e tjera.* Nëse Komisioni ka konsideruar se Deklarata e Kosovës është kundërkushtetuese, atëherë të njëjtin fat e kanë edhe ato të republikave tjera, kjo edhe për faktin se gjendja reale nëpër njësitë federale të Jugosllavisë nuk ka asnjë dallim prej Kosovës, shikuar në aspektin kushtetuese dhe juridik, çka domethënë se Komisioni gjithsesi është dashur ta inkorporojë edhe Kosovën krahas tjerave.

ç.

Pika 1.E e Mendimit të Komisionit i referohet çështjes së trashëgimit (suksedimit) të shteteve, e cila vjen si pasojë e shpërbërjes së një shteti. Sikur të pranohej pikëpamja e doktrinës dhe politikës aktuale serbe se ekziston kontinuiteti i mbretërisë jugosllave me atë serbe, atëherë Sllovenia dhe Kroacia do të trajtoheshin si "secesion i thjeshtë", kurse pjesa tjetër e Jugosllavisë do të quhej ende "Jugosllavi" (e zvogëluar territorialisht), së cilës do t'i pranohej legaliteti/legjitimiteti juridik-ndërkombëtar[15]. Sipas teorisë së legalitetit/legjitimitetit, e cila rrënjët e veta i heq nga fillimi i shekullit XIX, i njohur si "Aleanca e Shenjtë", të drejtat e tyre do të mund t'i parashtronin edhe Turqia bashkë me Austrinë dhe Hungarinë si zotëruese të dikurshme të këtyre territoreve, gjë që do të ishte një absurd. Trashëgimi i shtetit jugosllav, bazuar në premisën se ka diskontinuitet mes Jugosllavisë dhe ish-mbretërisë serbe dhe

---

[15] Për këtë kemi shkruar gjerësisht në punimin tonë me titull "Mbretësia SKS (Jugosllave) nuk është kontinuitet i Mbretërisë Serbe", botuar në *Fjala* nr. 23 (qershor, 1991, Prishtinë) fq. 10-11.

asaj malazeze të para-Luftës së Parë Botërore ka qenë dhe është e vetmja përgjigje meritore në këtë rast.

Për diskontinuitetin e Mbretërisë SKS (Jugosllave), gjegjësisht të Jugosllavisë si shtet i ri që nga vitit 1918, i ndryshëm nga mbretëritë serbe dhe malazeze (të cilat kanë ekzistuar deri në vitin 1918) kemi bërë fjalë gjerësisht në shkrimin tonë të botuar në *Fjala* nr. 23 (1991). Këtu e shohim të rrugës që opinionit t'i ofrojmë disa shqyrtime rreth rregullativës juridiko-ndërkombëtare mbi trashëgimin e shteteve. Ekzistojnë dy konventa ndërkombëtare që merren më këtë çështje: *Konventa e Vjenës mbi Suksedimin e shteteve në raport me marrëveshjet ndërkombëtare e datës 23 gusht 1978* (në tekstin e mëtejmë: Konventa e vitit 1978) dhe *Konventa e Vjenës mbi suksedimin e shteteve në fushën e pasurisë shtetërore, arkivave dhe borxheve e datës 8 prill 1983* (në tekstin e mëtejmë: Konventa e vitit 1983). Ne këtu diskutojmë vetëm aspektet më elementare të suksedimit në të drejtën ndërkombëtare dhe atë nga aspekti kontraktuar i paraparë me këto dy dokumente.

Në preambullën (hyrjen) e Konventës së vitit 1978 janë dhënë arsyet për nxjerrjen e saj. Në mesin e tyre përmenden: ndryshimet e shkaktuara në bashkësinë ndërkombëtare si pasojë e procesit të dekolonizimit, parimi i barazisë së kombeve dhe e drejta e vetëvendosjes, ndalimi i përdorimit të forcës, etj. etj. Menjëherë, po aty, konstatohet se çështjet të cilat nuk rregullohen me Konventë edhe më tej do të rregullohen në bazë të së drejtës ndërkombëtare zakonore. Në nenin 2, pika 1.b të Konventës së vitit 1978 përcaktohet se çfarë nënkuptohet me termin suksedim (trashëgim) në të drejtën ndërkombëtare. Aty thuhet kështu: "shprehja 'suksedim i shteteve' nënkupton ndërrimin e një shteti me tjetrin sa i përket përgjegjësisë për marrëdhëniet ndërkombëtare të një territori".

Siç shihet, suksedimi i referohet të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të një shteti në rastet kur ka zëvendësim të sovranitetit shtetëror territorial, kurse dispozitat e brendshme juridiko-kushtetuese të cilat e determinojnë statusin juridik të territorit të tillë duhet të shërbejnë si pikënisje përveç rastit kur ajo pjesë shkëputet me përdorimin e forcës. Pra, përveç rasteve kur ndryshimi i sovranitetit territorial ka ndodhur si rezultat i përdorimit (ilegal) të forcës.

Nga sa më sipër, apelojmë sërish ne tek Kuvendi i Republikës së Kosovës që edhe formalisht ta shpallë shkëputjen e Kosovës nga Jugosllavia, e cila me këtë mendim (vendim) të Komisionit të Arbitrazhit është shpallur inekzistente. Thënë me fjalë të tjera, mendimi (vendimi) që diskutohet këtu i Komisionit paraqet një aktvdekje *sui generis* të RSFJ-së dhe zënia e pozicioneve nga trashëgimtarët e saj paraqet një *conditio sine qua non* për realizmin e subjek-

tivitetit të ardhshëm ndërkombëtar të secilit territor të ish-Jugosllavisë, pra edhe të Kosovës. E njëjta gjë vlen edhe për territoret tjera shqiptare në ish-Jugosllavi dhe veçanërisht nëse shkatërrimi fizik i RSFJ-së vjen si pasojë e tronditjeve me dhunë nëpër tërë territorin e saj. Kosova duhet të jetë *stozher* (shtyllë gravituese) i viseve tjera shqiptare të ish-Jugosllavisë.

Shprehja tjetër në Konventën e vitit 1978, e dhënë në nenin 2, pika c, ka të bëjë me "shtetin pararendës". Me këtë nënkuptohet shteti të cilin e ka zëvendësuar shteti tjetër me rastin e suksedimit. Ndërsa, "shtet suksesor" quhet shteti i cili e zëvendëson shtetin pararendës me rastin e ndërrimit të sovraniteteve (neni 2, pika 1.d). Në anën tjetër, "shteti i cili e ka fituar pavarësinë" konsiderohet ai shtet trashëgimtar territori i të cilit para datës së suksedimit të shteteve ka qenë i varur dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ka qenë përgjegjës shteti pararendës. Të njëjtat kuptime janë përdorur edhe në nenin 2 të Konventës së vitit 1983.

Për dy këto konventa është me rëndësi të veçantë pika 2 e nenit 2, gjegjësisht formulimi i tyre i përbashkët. Ajo pikë thotë se "dispozitat e pikës 1 të cilat kanë të bëjnë me shprehjet e përdorura në Konventë nuk paragjykojnë përdorimin e këtyre shprehjeve ose domethënien e cila atyre mund t'u jepet në të drejtën e brendshme të shteteve". Meqenëse shprehjet e cekura në të drejtën e brendshme të (ish-)RSFJ-së nuk ekzistojnë, atëherë ka një rrezik real që republikat e sllavëve të jugut të merren vesh për nxjerrjen e ndonjë dokumenti juridik në të cilin do t'i operacionalizonin dispozitat (e dy konventave të cekura) në dëm të Kosovës. Në rastin e tillë eventual, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të duhej ta bëjë notifikimin juridiko-ndërkombëtar që tregon se cilat të drejta dhe detyrime i merr Kosova përsipër në raport më bashkësinë ndërkombëtare, të cilat të drejta e detyrime dikur i kanë takuar shtetit jugosllav. Kjo është kështu sipas bindjes sonë, në rast të zgjidhjes paqësore të trashëgimisë së shtetit jugosllav.

Dispozitat e tjera të konventave të sipërcekura nuk janë të një rëndësie imediate tani për tani. Ato do të jenë aktuale kur të fillojë pranimi i republikave tjera dhe përpilimi i bilancit të ndarjes dhe kur, besojmë, edhe Kosova do të aplikojë për "hisen" e vet në pasurinë e të vdekurit që quhej "Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë".

Përfundimi

Nga e tërë kjo mund të konkludojmë si vijon:

1. Mendimi (Vendimi) i Komisionit të Arbitrazhit paraqet *aktvdekjen* edhe *de jure* të RSFJ-së.
2. Pika 1 (A, B, C) e Mendimit (Vendimit) të Komisionit është parimore, mirëpo me rastin e operacionalizimit të saj të mëtejmë nga ana e Komisionit nën pikën 2 nuk është marrë parasysh gjendja ekzistuese në sistemin juridik-kushtetues të (ish-)RSFJ-së, e cila ka pasur për pasojë mosfutjen e Republikës së Kosovës në pikën 2.A të (Mendimit) Vendimit.
3. Mirëpo, kjo assesi nuk do të thotë se Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të rrijë duarkryq. Përkundrazi, ai së shpejti duhet ta shpallë shkëputjen (daljen) nga RSFJ dhe si territor shtetëror sovran ta bëjë notifikimin e të drejtave dhe detyrimeve të cilat i merr përsipër si subjekt i ri ndërkombëtar.
4. Vonesa në këtë drejtim do të ketë për pasojë që, më vonë, si në vitin 1912, shqiptarët të luftojnë por që frytet e luftës (eventuale) të varen prej të tjerëve. Me fjalë të tjera, do të rrezikonim që të vihemi në pozitën e një "argati të huej". Vendimi i Këshillit Ministror të BEE-së i datës 16 dhjetor 1991 e dëshmon këtë së miri.
5. *Deklarata mbi shkëputjen*, si në pikën e mësipërme të këtij përfundimi, nënkupton edhe bashkëngjitje me shtetin amë. Në këtë rast, çështja e prezantimit të Kosovës jashtë dhe brenda vendit do të bartej në Republikën e Shqipërisë deri në zgjidhjen definitive të çështjeve kontestuese të cilat dalin si pasojë e suksedimit të një pjese të (ish-)RSFJ-së.

II. Në margjinat e konventave të Vjenës mbi suksedimin e shteteve

Trajtesën tonë lidhur me çështjen e suksedimit të shteteve do ta përkufizojmë në dy drejtime: i pari i referohet para së gjithash normimit juridiko-ndërkombëtar të materies së suksedimit (trashëgimit) të shteteve në dy konventat e Vjenës, duke përfshirë këtu edhe elaborimet doktrinare të kësaj çështjeje, kuptohet, gjithnjë në raport me Republikën e Kosovës dhe çështjen shqiptare në ish-RSFJ përgjithësisht; i dyti ka të bëjë me çështjen se a ka bazë

juridike Vendimi i Komisionit të Arbitrazhit pranë Konferencës së Hagës për Jugosllavinë pasi që në qarqet serbe vazhdimisht kontestohet legaliteti i tij.

Kur thuhet "Konventat e Vjenës", atëherë mendohet në Konventat e Vjenës të vitit 1978 dhe 1983 respektivisht, të cilat i referohen suksedimit të shteteve dhe që u diskutuan më herët në seksionin pararendës.

Këto konventa, tani për tani, janë të vetmet marrëveshje ndërkombëtare që normojnë një pjesë bukur voluminoze të kësaj materieje.

1.

Suksedimi (trashëgimi) i shteteve në të drejtën ndërkombëtare ende mbetet një ndër problemet më diskutabile doktrinare — institucion për të cilin praktika, gjer me nxjerrjen e konventave të cekura, nuk ka mundur të gjejë rregullat e përgjithshme. Për më tepër, vetëm me nxjerrjen e tyre janë krijuar sadokudo disa baza mbi të cilat duhet të mbështetet praktika juridiko-ndërkombëtare në këtë fushë. Nxjerrja e Konventës së Vjenës në vitin 1978 paraqet një hap të rëndësishëm në këtë drejtim, përkatësisht një kodifikimin dhe zhvillimin progresiv të materies në fjalë. Kjo konventë ka gjithsej 50 nene dhe shtojcën në fund, ku janë dhënë të drejtat dhe detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në lidhje me Komisionin për Pajtim si organ *ad hoc* për zgjidhjen e kontesteve, të cilat mund të lindin lidhur interpretimin dhe zbatimin e kësaj konvente.

Në hyrjen (preambullën) e kësaj konvente janë dhënë arsyet e nxjerrjes së saj. Aty, mes të tjerash, është thënë se "në të ardhmen faktorët e ndryshëm mund të sjellin suksedimin (trashëgimin) e shteteve", ashtu që "me rregullat e së drejtës ndërkombëtare zakonore edhe më tutje do të rregullohen ato çështje që nuk janë përfshirë me dispozitat e kësaj konvente". Në këtë mënyrë është pranuar se praktika ndërkombëtare në këtë lëmë, sikundër edhe në të tjerat, do të hasë në raste të reja dhe se aplikimi i së drejtës ndërkombëtare zakonore konform nenit 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë do të jetë edhe më tej i nevojshëm duke pasur parasysh tërë ndërlikueshmërinë e materies së suksedimit (trashëgimit) të shteteve. Tekefundit, edhe kjo konventë është rezultat i një praktike të gjatë të shteteve në këtë drejtim.

Në dispozitat e përgjithshme (nenet 1-14) janë rregulluar këto çështje:

- fusha e aplikimit të konventës (neni 1);
- rastet të cilat nuk janë të përfshira me këtë konventë (neni 3);
- shprehjet e përdorura në konventë (neni 2);
- marrëveshjet mbi themelimin e organizatave ndërkombëtare dhe marrëveshjet që i aprovon një organizatë ndërkombëtare (neni 4);

- obligimet ndaj së drejtës ndërkombëtare, apo sipas së drejtës ndërkombëtare pa marrë parasysh kontratat (neni 5);
- rastet e suksedimit (trashëgimit) të shteteve, të cilat janë të përfshira me këtë konventë (neni 6);
- momenti i aplikimit të kësaj konvente (neni 7);
- marrëveshjet mbi bartjen e detyrimeve kontraktuese ose të drejtave nga shteti i mëparshëm në shtetin suksesor (trashëgimtar) (neni 8);
- deklaratat e njëanshme të shtetit suksesor (trashëgimtar) për sa i përket kontratave të shtetit paraprak (neni 9);
- kontratat me të cilat parashihet pjesëmarrja e shtetit suksesor (trashëgimtar) (neni 10); regjimit të kufijve (neni 11);
- sovranitetit mbi pasuritë natyrore dhe resurset (neni 13);
- regjimeve të tjera territoriale (neni 12); dhe, së fundi,
- çështjet që kanë të bëjnë me vlefshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare (neni 14).

Përveç nenit 1 të Konventës, në të cilin është thënë se "kjo konventë aplikohet ndaj fakteve të suksedimit (trashëgimit) të shteteve në raport me traktatet mes shteteve", për ne këtu janë me rëndësi të veçantë edhe dispozitat si vijon: pika 1, nën *g*, e nenit 2, si dhe nenet 6, 8, 9 dhe 13 të Konventës.

Në pikën l, nën *g* të nenit 2 të Konventës është thënë: "shprehja *notifikim* nënkupton notifikimin, pa marrë parasysh se si emërtohet ai, të cilin si të tillë e dërgon shteti suksesor (trashëgimtar) në raport me një marrëveshje multilaterale dhe me të cilin e jep pëlqimin si shtet trashëgimtar për të qenë i lidhur me marrëveshjen konkrete". Sikundër shihet, këtu shprehja *notifikim* në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare e ka marrë kuptimin ekstensiv dhe më fleksibil. Kjo do të thotë se nuk është me rëndësi forma veçse përmbajtja në kuptim të deklaratës së vullnetit me të cilën shteti suksesor jep pëlqimin me të cilin i merr përsipër të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshjet (traktatet) e lidhura nga ana e shtetit paraprak. Me fjalë të tjera, këtu bëhet fjalë për shmangien nga rregulla e së drejtës ndërkombëtare se traktati i obligon vetëm ato shtete të cilat e kanë lidhur atë. Prandaj, obligimet që dalin nga marrëdhëniet kontraktuese mund të merren me aktin e notifikimit me të cilin shteti trashëgimtar pranon pjesën e vet të obligimeve dhe të drejtave. Shtrohet pyetja: a e ka bërë këtë notifikim Kosova?

Nuk ka dyshim se *Kërkesa e Qeverisë dhe e Kuvendit të Republikës së Kosovës,* dërguar Lordit Carrington (Kerington) më datën 20 dhjetor 1991[16], i ka të gjitha elementet e aktit juridik-ndërkombëtar të notifikimit në kuptim të nenit 2, pika l, nën *g*, të Konventës. Aty, mes të tjerash, është shprehur gatishmëria e Republikës se Kosovës (pika B e Kërkesës) për pranimin e dokumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare, nënshkruese e të cilave është ish-RSFJ, duke filluar nga Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut (1948) e gjer te Karta e Parisit për Evropën e re (1990). Shikuar nga aspekti kualitativ, megjithatë, në kërkesën e cekur të Qeverisë dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës, pikës nën B është dashur t'i shtohet edhe një paragraf i veçantë me te cilën do të notifikohej pranimi edhe i obligimeve te tjera kontraktuese të ish-RSFJ-së, të cilat si të tilla nuk janë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe veçanërisht me parimet e saj të përmbajtura në Kartën e OKB-së. Në anën tjetër përveç kësaj, Kuvendi i Kosovës është dashur ta bëjë shkëputjen formale nga RSFJ, *sepse, shikuar juridikisht, Republika e Kosovës pas datës 22 shtator 1991 e ka kapacitetin e kufizuar juridiko-ndërkombëtar. Po nuk u bë kjo, në bisedimet eventuale në lidhje me këtë çështje mund të kontestohet validiteti i një kërkese të tillë të Kosovës për legjitimim ndërkombëtar të subjektivitetit të saj juridiko-ndërkombëtar.*

Konventa i referohet ekskluzivisht suksedimit (trashëgimit) të shteteve dhe efekteve të tij të cilat realizohen në harmoni me të drejtën ndërkombëtare e veçanërisht në haromoni me parimet e Kartës së OKB-së (neni 6). Pa dyshim që politika e popullit shqiptar dhe e Qeverisë së Republikës së Kosovës si politikë paqësore është në harmoni me të drejtën ndërkombëtare dhe parimet e Kartës së OKB-së të përcaktuara në nenin 2. Kërkesa e Qeverisë dhe e Kuvendit të Republikës së Kosovës për suksedimin (trashëgimin) e RSFJ-së, gjegjësisht të një pjese të saj, është e bazuar në parimin e barazisë së shteteve dhe të kombeve; zbatimin me ndërgjegje të obligimeve ndërkombëtare, zgjidhjen e kontesteve me rrugë paqësore, mosaplikimin e dhunës ose kërcënimi me forcë kundër tjerëve, sigurimin e paqes ndërkombëtare në rajonin konkret, etj. etj. U mor vesh, Vendimi i Komisionit të Arbitrazhit[17] paraqet bazën juridike të elaborimeve të sipërcekura, pra, edhe për Kërkesën e Qeverisë dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës për pavarësi dhe suksedim (trashëgim) të një pjese të ish-RSFJ-së. Në qarqet serbe dhe malazeze, siç

[16] Teksti i plotë i Kërkesës u botua në gazetën e përditshme *Bujku* nr. 206, datë 24 dhjetor 1991 (Prishtinë) fq. 1.
[17] Teksti integral në Gazetën *Fjala*, nr. 47/91 (Prishtinë) fq. 4.

cekëm, mohohet legaliteti i Vendimit të Komisionit të Arbitrazhit, gjë që nuk është e drejtë (siç do të shihet në vijim).

Në nenin 8, pika l, Konventa ka paraparë mundësinë e shtrirjes së obligimeve kontraktuese të shtetit paraprak në shtetin trashëgimtar në bazë të marrëveshjes së arritur mes tyre. Mirëpo, në pikën 2 të neni 8 të Konventës është theksuar se "pa marrë parasysh ekzistimin e një marrëveshjeje të tillë, efektet juridike të suksedimit ndaj konventave që kanë qenë në fuqi ditën e suksedimit (trashëgimit) rregullohen me këtë konventë". E njëjta gjë vlen edhe për sa u takon deklaratave të njëanshme të vullnetit të shtetit suksesor (trashëgimtar) me të cilat i pranon të drejtat dhe detyrimet kontraktuese të shtetit paraprak (neni 9). Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se fakti i thjeshtë i ekzistimit të marrëveshjes nga neni 8 i Konventës dhe i deklaratës së njëanshme nga neni 9 nuk mjaftojnë për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve kontraktuese të shtetit paraprak. Në rastin e Kosovës, Kuvendi dhe Qeveria para dorëzimit të kërkesës së cekur është dashur ta bëjnë edhe shkëputjen formale nga RSFJ duke u bazuar në Vendimin e Komisionit të Arbitrazhit, i cili paraqet një *acta mortis de jure* të RSFJ-së. Më pastaj, në po atë *akt-shkëputje* nga RSFJ është dashur të bëhet një elaborim preciz i bazës juridike jo vetëm të vendimit të sipërcekur të Arbitrazhit, por edhe i dokumenteve të tjera ndërkombëtare të cilat përndryshe janë cekur në Kërkesën e Qeverisë dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës për njohje dhe, rrjedhimisht, edhe për suksedim (trashëgim) të ish-RSFJ-së. Mendojmë se vetëm kështu kërkesa e sipërcekur për njohje, të cilës do t'i bashkëngjitej edhe *akti mbi shkëputjen* nga RSFJ, do të kishte prodhuar të gjitha efektet e deklaratës së notifikimit edhe në raport me njohjen edhe me suksedimin (trashëgimin) e ish-RSFJ-së. Kjo nga shkaku se notifikimi juridiko-ndërkombëtar mund të cilësohet si lajmërim zyrtar i një qëndrimi, kërkese, fakti ose ndodhie për të cilat pretendohet se kanë rëndësi juridiko-ndërkombëtare. Notifikimi si i tillë jepet nga ana e një subjekti ndërkombëtar drejtuar tjetrit subjekt, po ashtu ndërkombëtar[18]. Dhe, më tej, notifikimi për të cilin po flasim këtu — të cilin, në pikëpamje më kualitative, është dashur ta bëjë Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës — bën pjesë në të a.q. *notifikime të detyrueshme* në të drejtën ndërkombëtare.

Dy konventat si më sipër për të cilat flasim këtu normojnë suksedimin (trashëgimin) në të gjitha aspektet e mundshme të marrëdhënieve kontraktuese dhe te pasurisë shtetërore, arkivave dhe borxheve, ndërsa shpërbërja e shtetit, si dhe shkëputja e një pjese të territorit (neni 18 i Konventës së vitit

[18] Milan Bartoš, *Medjunarodno javno pravo*, Treća Knjiga (Kultura: Beograd, 1952) fq. 42.

1978), fitimi i pavarësisë (neni 16 po ashtu i Konventës së vitit 1978), etj., etj. paraqesin gjendje reale të cilat nga subjektet ndërkombëtare konstatohen në mënyra të ndryshme. Kështu, ta zëmë, në rastin konkret me njohjen e Sllovenisë dhe Kroacisë, ose kur një organ (komision) ndërkombëtar e jep përgjigjen se a është fjala për shpërbërje apo secesion të pjesëve të një shteti, atëherë gjendja e tillë reale merr ngjyrën juridiko-ndërkombëtare. Kjo gjendje reale e konstatuar kësisoj ka për pasojë aplikimin e dispozitave të cekura të Konventave të Vjenës mbi Suksedimin (Trashëgimin), me qëllim të rregullimit të raporteve juridike të shtetit paraprak dhe atyre shteteve që krijohen ose rregullimin e raporteve mes subjekteve të cekura trashëguese në mënyrë gërshetuese.

Mënyra e shpërbërjes së shtetit ekzistues është irrelevante për të drejtën ndërkombëtare përveç rastit kur ai ndodh si pasojë e intervenimit të jashtëm me dhunë e i cili është i ndaluar me Kartën e OKB-së. RSFJ-a është shpërbërë si pasojë e pakënaqësive të brendshme dhe e aspiratave për liri të popujve të shtypur në të.

Në nenin 13 të Konventës së vitit 1978 është konfirmuar parimi i sovranitetit të popujve dhe i shteteve mbi pasuritë natyrore dhe resurset. Ky segment sikur ka qenë dashur më shumë të elaborohet nga ana e Qeverisë dhe e Kuvendit të Republikës së Kosovës në kërkesën e cekur, gjegjësisht ka qenë dashur të futej një shtojcë mbi arsyeshmërinë ekonomike të pavarësisë së Kosovës si dhe të kompaktësisë së saj ekonomike, si një territor që prore ndër dekada është shfrytëzuar ekonomikisht nga ana e Republikës e Serbisë dhe e pjesës tjetër të ish-RSFJ-së.

Konventa e vitit 1978, më tutje ka paraparë modalitetet e shpërbërjes së shteteve dhe suksedimit (trashëgimit) të tyre. Kështu, ta zëmë, është paraparë suksedimi i një pjese të territorit (neni 16), në rastet kur ajo bëhet pjesë e territorit të një shteti tjetër, pastaj krijimi i shteteve të pavarura (nenet 16-30), bashkimi dhe shkëputja e shteteve (nenet 31-38). Në tri rastet është paraparë se notifikimi mbi suksedimin bëhet në formën me shkrim dhe sipas rregullit duhet ta bëjnë: shefi i shtetit, kryetari i qeverisë ose ministri i punëve të jashtme. Në nenin 39 të Konventës është thënë se ajo nuk i prejudikon çështjet të cilat mund të lindin si pasojë e përgjegjësisë ndërkombëtare të shtetit ose e fillimit të armiqësive që janë në lidhje me suksedimin dhe efektet e tij ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare. Gjithashtu, në nenin 40 është thënë se nuk prejudikohen çështjet të cilat mund të lindin si pasojë e okupimit luftarak e që kanë të bëjnë me suksedimin dhe marrëveshjet ndërkombëtare, d.m.th.,

këto çështje janë domen rregullativ i së drejtës ndërkombëtare të luftës, pra jo i së drejtës ndërkombëtare mbi suksedimin (trashëgimin) e shteteve.

Në pjesën VI (nenet 41-45) të Konventës janë dhënë mënyrat e zgjidhjes së kontesteve, të cilat lindin në lidhje me interpretimin ose zbatimin e konventës në fjalë. Ato janë:

a. Konsultimet dhe bisedimet;
b. Pajtimi (konciliacioni);
c. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe Arbitrazhi; dhe, së fundi,
ç. Zgjidhja e kontesteve me marrëveshje të përbashkët, si mënyrë e fundit e zgjidhjes së kontesteve me rrugë paqësore e paraparë në këtë konventë.

Në pjesën VII të Konventës janë dhënë dispozitat kalimtare dhe shtojca e cekur në fillim të këtij punimi.

2.

Konventa tjetër e Vjenës, e cila i referohet suksedimit (trashëgimit) të shteteve në raport me pasurinë shtetërore, arkivat dhe borxhet, e datës 8 prill 1983, përmban gjithsej 51 nene dhe shtojcën në fund, njëjtë si Konventa e vitit 1978.

Edhe këtu në hyrje (preambullë) jepen arsyet e nxjerrjes së saj. Ndër to vlen të përmenden si vijon:

- nevoja e kodifikimit dhe e zhvillimit progresiv të normave të cilat i referohen suksedimit të shteteve në lëmin e pasurisë shtetërore, arkivave dhe borxheve;
- nevoja e garantimit të sigurisë më të madhe juridike në marrëdhëniet ndërkombëtare; dhe, së fundi,
- bindja se çështjet që kanë të bëjnë me suksedimin e shteteve në sferën e pasurisë shtetërore, arkivave dhe borxheve janë me rëndësi të veçantë për çdo shtet.

Këtu, sikundër edhe në rastin e mëparshëm, do të shkoqisim vetëm disa nga çështjet kyçe që i rregullon kjo konventë, gjegjësisht vetëm ato që janë të ndryshme nga Konventa e vitit 1978.

Me "pasuri shtetërore" Konventa nënkupton pasurinë, të drejtat dhe interesat që i kanë takuar shtetit paraprak në bazë të normave të brendshme gjer në ditën e suksedimit (neni 8). Efektet e suksedimit nuk shtrihen ndaj pasurisë, të drejtave dhe interesave të shtetit të tretë (neni 11). Kjo nënkupton po ashtu se shteti paraprak duhet të ndërmarrë të gjitha masat që të pengojë

dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë shtetërore, e cila kalon në shtetin suksesor (trashëgimtar) në pajtim me këtë Konventë (neni 13).

Shtrohet pyetja: a është duke e bërë këtë ish-RSFJ si "shtet paraprak"? Jo! Përkundrazi, ajo është duke e koncentruar një pjesë të pasurisë në emër të kontinuitetit shtetëror juridiko-ndërkombëtar të Serbisë me ish-RSFJ, në duart e një populli dhe të një politike, të politikës agresive serbe, me qëllim të agresionit fizik ndaj popujve tjerë në ish-RSFJ. Nuk ka dyshim se të gjithë popujt dhe njësit federale të ish-RSFJ-së kanë kontribuar në krijimin e pasurisë shtetërore jugosllave, kurse vlera e kontributit vlerësohet definitivisht në bilancin e ndarjes së pasurisë shtetërore jugosllave, kurdo që llogaritet ky bilanc. Besojmë se do të vijë dita kur para instancave ndërkombëtare do të iniciohet përgjegjësia e Republikës së Serbisë, në rend të parë për cenimin e këtij obligimi sipas Konventës së viti 1983. Një mundësi e tillë është paraparë edhe në nenin 44 të saj, i cili përshkruan rastet kur sjelljet e shtetit paraprak ose të disa pjesëve të tij janë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe obligimin e cekur për ruajtjen e pasurisë së përbashkët shtetërore të shtetit që trashëgohet.

Në kapitullin 2 të pjesës II (nenet 14-18) janë paraparë dispozitat mbi kategoritë e veçanta të suksedimit të shteteve, siç janë dispozitat lidhur me:

- rastin e cedimit (bartjes) të një pjese të territorit shtetëror (neni 14);
- rastin e krijimit të shtetit të ri të pavarur (neni 15), çfarë është rasti me Kosovë dhe disa njësi tjera të ish-RSFJ-së;
- rastin e bashkimit të shteteve (neni 16);
- rastin e shkëputjes së pjesës ose të pjesëve të territorit të një shteti (neni 17); dhe, së fundi,
- rastin e shkatërrimit të shtetit paraprak dhe krijimit të dy ose më shumë shteteve suksesor (trashëgimtare) nga shteti paraprak (neni 18), çfarë po synojnë Serbia dhe Mali i Zi me qëllim të trashëgimit të pjesës sa më të madhe të pasurisë së ish-RSFJ-së dhe vazhdimit të legalitetit dhe kontinuitetit të njëfarë Jugosllavie të tretë.

Pjesa III e Konventës flet për arkivat shtetërore. Me "arkiva shtetërore të shtetit paraprak" nënkuptohen të gjitha dokumentet pa marrë parasysh datën dhe natyrën e tyre, të dhëna ose të pranuara nga shteti paraprak gjatë kryerjes së funksioneve të tij dhe të cilat në ditën e suksedimit (trashëgimit) i kanë takuar shtetit paraprak në pajtim me të drejtën e tij të brendshme, kanë qenë të ruajtura direkt ose kanë qenë nën mbikëqyrjen e tij si arkiva për çfarëdo qëllimi qoftë (neni 20).

Dispozitat e neneve 21-31 u referohen kategorive të veçanta të suksedimit dhe janë të ngjashme me ato të cilat i cekëm më sipër.

Pjesa IV e Konventës i dedikohet borxheve shtetërore me të cilat nënkuptohet çdo obligim financiar i shtetit paraprak ndaj shtetit tjetër, organizatës ndërkombëtare ose çdo subjekti tjetër të së drejtës ndërkombëtare dhe i cili është krijuar në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Sipas së drejtës ndërkombëtare jo vetëm në rastin e suksedimit (trashëgimit), por edhe kur ekziston kontinuiteti ndërkombëtar juridik mes dy shteteve (p.sh., është ndërruar vetëm rendi i brendshëm politik), obligimet financiare të shtetit paraprak të cilat janë krijuar me qëllim të shtypjes së trazirave të brendshme ose për qëllime të tjera të a.q. *intuitu personae* (p.sh., për rregullimin e oborrit mbretëror, për armatim, si dhe për shpenzime të tjera luksoze) nuk trashëgohen (suksedohen) nga subjekti i ri i së drejtës ndërkombëtare. Rrjedhimisht, as Kosova e as tjerët të cilët synojnë pavarësinë nga hegjemonizmi serb nuk do të duhej t'i bartnin obligimet financiare të ish-RSFJ-së që kanë pasur destinimin e mësipërm. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet që këtë rrethanë ta potencojë vazhdimisht në qarqet diplomatike në mënyrë që të lirohet nga përgjegjësia *pro futuro*. Fundja, në praktikën ndërkombëtare notifikimi i një rrethane ka për efekt (pasojë) themelor atë se shtetet e tjera nuk mund të thirren në mosdijeni për rrethanën (çështjen) konkrete e cila notifikohet. Në rastin konkret, koncesionet e ndryshme financiare të cilat i jep ish-RSFJ tani e tutje dhe që kanë qëllime joekonomike, duhet të bien në barrë të dhënësit të tyre dhe jo të shteteve trashëgimtare të ish-RSFJ-së. Ndryshe, suksedimi (trashëgimi) i borxheve shtetërore nuk i dëmton interesat e kreditorëve (neni 36) përveç rastit të mësipërm kur ato janë krijuar *intuitu personae*.

Në kapitullin 2 të pjesës IV (nenet 37-41) janë dhënë rastet e veçanta të suksedimit (trashëgimit) të ngjashme me ato që i cekëm, kurse në pjesën V (nenet 42-46) janë dhënë mënyrat e zgjidhjes në kontesteve. Së fundi, pjesa VI (nenet 47-51) i përmban dispozitat kalimtare dhe shtojcën mbi të drejtat dhe detyrimet e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në lidhje me pajtimin (konciliacionin) si mënyrë të zgjidhjes paqësore të kontesteve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj konvente.

3.

Çështja që vazhdimisht kontestohet në qarqet serbe dhe malazeze ka të bëjë me bazën juridike të Vendimit të Arbitrazhit, gjegjësisht kontestimin e konstatimit të këtij komisioni se "RSFJ është në procesin e shpërbërjes".

Serbët dhe malazezët pohojnë se BE-ja nuk është kompetente për një gjë të tillë, por vetëm OKB-ja.

Baza juridike e Vendimit të Komisionit të Arbitrazhit pranë Konferencës së Hagës duhet të shikohet në marrëdhënien e tij me Kartën e OKB-së, Karta e Parisit për Evropën e Re, parimet e KSBE-së (1976), dhe, së fundi, në marrëdhënien e tij me Marrëveshjen mbi Themelimin e BEE-së (Romë, 1957), gjegjësisht në lidhshmëri me vendin që ka kjo marrëveshjeje në sistemin dhe mekanizmin juridiko-ndërkombëtar.

Në Kreun VIII të Kartës së OKB-së flitet marrëveshjet regjionale. Aty thuhet se OKB-ja i favorizon marrëveshjet regjionale dhe agjencitë të cilat aktivitetin e tyre e bazojnë në parimet dhe qëllimet e OKB-së (neni 52, pika 1). Në pikën 2 të nenit 52 të Kartës së OKB-së më tutje thuhet se anëtarët e OKB-së të cilët lidhin marrëveshjet e cekura ose krijojnë institucione regjionale do të bëjnë përpjekje që *konfliktet lokale para se t'ia parashtrojnë Këshillit të Sigurimit të OKB-së do t'i zgjidhin me ndihmën e institucioneve të tilla regjionale.*

Nuk ka asnjë dyshim se BEE-ja dhe KSBE-ja, gjegjësisht dokumentet ndërkombëtare (marrëveshjet) mbi themelimin e tyre, janë zbatim konsekuent i obligimit nga neni 52 i Kartës së OKB-së. Një gjë e tillë qe bërë e qartë qysh me rastin e nxjerrjes së Deklaratës për Jugosllavinë (Hagë, 5 korr. 1991), pra që në fillet e krizës jugosllave. Në Deklaratë, mes të tjerash, qe thënë se BEE-ja i ka ofruar "shërbimet e mira dhe dialogun" si mënyrë për zgjidhjen paqësore të kontesteve dhe se këto përpjekje të BEE-së bazoheshin në Aktin Final të Helsinkit, Kartën e Parisit për Evropën e Re dhe Kartën e OKB-së. Deklarata tjetër për Jugosllavinë (Hagë, 27 korr. 1991) e BEE-së konstatoi nevojën e thirrjes së Konferencës së Paqes për Jugosllavinë, në kuadrin e së cilës do të vihej në lëvizje edhe Procedura e Arbitrazhit, gjegjësisht Komisioni i Arbitrazhit si një organ i saj. Krejt kjo me qëllim që, në kuptim të nenit 52, pika 2, të Kartës së OKB-së, kontesti të zgjidhej brenda regjionit të Evropës. Në mënyrë analoge, Këshilli i Sigurimit të OKB-së në Rezolutën nr. 713 (25 shtator 1991) pati shprehur mirënjohje për angazhimin e BEE-së dhe të KSBE-së si institucione regjionale, duke potencuar qartë se një ndërmarrje e tillë ka qenë në të njëjtën kohë një obligim ndërkombëtar i shteteve anëtare të institucioneve të cekura. Në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së të datës 25 shtator 1991 në të cilën u miratuar Rezoluta 713, ish-sekretari federativ për punë të jashtme, Budimir Llonçar, konfirmoi legjitimitetin juridiko-ndërkombëtar të aksioneve të BEE-së dhe të KSBE-së si institucione regjionale të cilat duhej të përkujdeseshin për sigurinë dhe paqen në Evropë.

III. Suksedimi i shtetit jugosllav dhe instrumentalizimi juridiko-ndërkombëtar i subjektivitetit të Kosovës

Hyrja

Objekt trajtimi në këtë kumtesë janë çështjet e suksedimit të shtetit jugosllav (1) dhe ato të instrumentalizimit të subjektivitetit (juridiko-ndërkombëtar) të Kosovës (2). Çështja e suksedimit, përkatësisht e kontinuitetit juridiko-ndërkombëtar të entiteteve shtetërore në literaturën kosovare, mjerisht, fare nuk ka zënë vend sado që, si e tillë, përbën temën bosht në rrethanat e krijuara të suksedimit (trashëgimisë) së shtetit jugosllav.

Dy këto çështje si më sipër janë të lidhura ngushtë me nocionin e subjektivitetit juridiko-ndërkombëtar të entiteteve shtetërore sovrane në përgjithësi, pra edhe të Republikës së Kosovës (aktualisht të okupuar) si fakt i dhënë socio-historik. Në anën tjetër, duhet cekur se kundruall entiteteve të reja shtetërore qëndron entiteti i vjetër shtetëror i cili, në rastin tonë, është quajtur Jugosllavi, krijimi i së cilës çështjen shqiptare e ka reduktuar në çështje të pakicës kombëtare duke ia imponuar sovranitetit nacional forcën e sovranitetit shtetëror jugosllav.

Kosova në këtë shkrim është marrë si subjekt dhe objekt trajtimi njëkohësisht për dy arsye: së pari, për arsye juridiko-politike, përkatësisht të parimit *uti possidetis* në të drejtën ndërkombëtare i cili ka për të mundësuar shkëputjen formale të Kosovës nga krijesa e quajtur Jugosllavi; dhe, së dyti, mbase për arsye se Kosova historikisht shikuar, siç e thotë Hamit Kokalari në parathënien e librit të vet *Kosova, djepi i shqiptarizmit* (Tiranë, 1943), "nuk ka qenë vetëm djepi i rilindjes shqiptare, por sidomos faktori kryesor i ngjarjeve historike që shkaktuan dhe siguruan krijimin e shtetit shqiptar".

1. Suksedimi i shtetit jugosllav

Përgjithësisht. Edhe pse, parimisht, e drejta ndërkombëtare ka qëndrim " neutral" në lidhje me regjimet politike të shteteve[19], megjithatë e shohim të rrugës që përciptazi të flasim mbi gjenezën e krijesës shtetërore që quhej Jugosllavi, në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare, ose, në kuptim të së drejtë kushtetuese — "Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë" (RSFJ).

1.1.

Krijimit të shtetit jugosllav më 1 dhjetor 1918 si dhe njohjes së tij ndërkombëtare më pastaj i kanë pararendur ngjarjet të cilat kanë pasur të bënin me krijimin, internacionalizimin dhe zgjidhjen definitive të çështjes lindore, ngjarje këto të cilat janë zhvilluar në periudhën e dy epokave historike: mesjetës dhe kohës së re. Me këtë periodizim gjithnjë e kemi parasysh Ballkanin dhe jo pjesët e tjera të Evropës. Të një rëndësie parësore në zhvillimin e marrëdhënieve të Evropës dhe të Ballkanit si periferi e saj, sikundër edhe në zhvillimin e marrëdhënieve në vetë Ballkanin, kanë qenë ato ndryshime socio-politike të cilat kanë kontribuar në krijimin e rendit të ri evropian, përkatësisht në krijimin e sistemit evropian të Versajës[20].

---

[19] Arangio Ruiz, *Gli enti soggeti dell ordinamento internazionale* (Giufrre: Milano 1951) fq. 344. Në parim, në të drejtën ndërkombëtare nuk jepen kriteret mbi legjitimitetin e shteteve ose të strukturës së tyre të brendshme. Kjo është kështu vetëm sa i përket të kaluarës, sepse e drejta ndërkombëtare konvencionale, jorallëherë, i jep normat të cilat i përkasin regjimit politik të shteteve si dhe normat në lidhje me të drejtat fundamentale të shteteve. Këtu mendohet në të drejtat politike të përfshira në konventat relevante ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, pastaj në rastin e disa traktateve të paqes, si p.sh. rasti i Traktatit të Paqes me Italinë i vitit 1947: në nenet 15 dhe 17 është paraparë obligimi i Italisë për t'i siguruar të drejtat dhe liritë fundamentale për personat që janë vënë nën "juridiksionin" italian (neni 15), sikundër dhe mostolerimi i rikonstruimit të organizatave fashiste (neni 17). I tillë është edhe me neni 3 të Traktatit të Havanës mes Kubës dhe ShBA-së i datës 22 maj 1903, i cili përcakton: "*the government of Cuba consents that the United States my exercise the right to intervene for the maintenance (at Cuba) of government adequate for the protection of life, property and individual liberty*".
Sikundër shihet këtu gjithherë bëhët fjalë për normat institutive të marrëdhënieve obliguese mes shteteve. Në asnjë rast tjetër, që ne dimë, nuk krijohen drejtpërsëdrejti situatat juridikondërkombëtare në favor ose në dëm të shteteve të dhëna ose zyrtareve dhe shtetasve te tyre të cilët janë drejtpërsëdrejti të futura në sistemet e krijuara nga normat e së drejtës kushtetuese (unitare ose federale) mbi të drejtat dhe liritë fundamentale.

[20] Shih më shumë në Akad. Vladimir Potemkin (ed.), *Istorija diplomatije*, Tom III (Savremena Administracija, Beograd, 1951) fq. 24 e tutje; Dr. Branimir Jankoviq, *Balkan u medjunarodnim odnosima* (Naučna Knjiga: Beograd, 1988).

Formimi i shtetit jugosllav më 1 dhjetor 1918, dhe rregullimi i tij kushtetues më 28 korrik 1921 në baza unitariste, ka paraqitur fitoren e forcave politike serbe kundruall forcave tjera në Jugosllavi. Forca e tillë politike ka qenë pasojë imediate e raportit të forcave ku faktori politik serb ka pasur forcën dominante. Forca e tillë ka qenë dominante si në marrëdhëniet e brendshme (për arsye të ekzistimit të ushtrisë së rregullte serbe si e vetmja në mesin e sllavëve të jugut), ashtu dhe në ato të jashtme (meqenëse fuqitë aleate të Serbisë kanë qenë fituese në Luftën e Parë Botërore dhe si të tilla e kanë përcaktuar rendin Evropian të pasluftës)[21]. Shikuar nga aspekti i synimeve nacionale serbe, krijimi i Mbretërisë SKS (Jugosllave) ka qenë realizim thuajse i tërësishëm i programit nacional serb dhe, kundruall popujve tjerë, ka hapur çështjen e hegjemonisë serbe si pasojë e dominimit absolut në strukturën e shtetit në fjalë.[22] Një gjendje e tillë ka zgjatur deri në ditët e sotme kur procesi i shpërbërjes së shtetit jugosllav është në përfundim e sipër, pa marrë parasysh se atëherë[23], njëjtë si më vonë[24], serbët dhe të tjerët kanë pohuar se krijimi i Jugosllavisë më 1918 ka qenë akt i zgjidhjes së çështjes nacionale të sllavëve të jugut, me përjashtim të bullgarëve të cilët kanë mbetur në shtetin e vet.

Sa i përket çështjes shqiptare, krijimi i shtetit në fjalë e ka reduktuar atë në një "çështje të pakicës kombëtare". Kjo ka zgjatur deri më 1974, kur u krijua termi "kombësi", i cili sot e kësaj dite nuk mund të kuptohet si nocion përmbajtjësor e as të futet në suazat e standardeve juridiko-ndërkombëtare që trajtojnë problemet etnike (nacionale). Që nga themelimi i tij më 1918, sidoqoftë, çështja shqiptare ka mbetur një çështje e brendshme e atij shteti i cili ishte subjekt i vetëm i së drejtës ndërkombëtare, në ndërkohë që lufta e pareshtur e popullit shqiptar prej vitit 1918 e këndej nuk ka qenë pos një luftë për dinjitet nacional dhe pavarësi nga ai shtet e assesi luftë për krijimin edhe të "një kombi tjetër shqiptar" ose për krijimin e "vetëdijes shtetëformuese[sic]", sikundër mendohet gabimisht ndër ne ndonjëherë. Për më tepër, shqiptarët në ish-Jugosllavi nuk janë gjetur në bazë të "misionit civilizues" të

---

[21] Krahaso: Oscar Randi, *I Popoli Balcanici* (Cremonese: Roma, 1929); Dr. Bogdan Krizman, *Vanjska politika Jugoslovenske države 1918-1941*, (Školska Knjiga: Zagreb, 1975); Dr. Dušan Subotić, *Misli o ustavu i politici* (Naučna Knjiga: Beograd, 1919).

[22] Oscar Randi, vep. e cit. fq. 141.

[23] Krahaso Dušan Subotić, vep. e cit., pjesa nën "A" (o ustavu za kraljevinu srba, hrvata i slovenaca).

[24] Dr. Radoslav Stojanović, *Jugoslavija, nacije i politika* (Kultura: Beograd, 1988) fq. 119. Krahaso në veçanti literaturën e para-Luftës së Dytë Botërore në të cilën thirret ky autor.

sllavëve për t'ua "krijuar" shqiptarëve vetëdijen shtetformuese, porse si të okupuar, ashtu që rrjedhimisht, edhe lufta shqiptarëve gjatë tërë kësaj periudhe ka qenë refleks i luftës për sovranitet nacional kundrejt sovranitetit shtetëror të imponuar me dhunë nga faktori i jashtëm në Versajë. Fundja, sikur të kuptohej lufta e shqiptarëve si luftë për krijimin e vetëdijes shtetformuese, atëherë do të dilte se e tërë lufta jonë kundër sunduesve të huaj ka qenë luftë për çlirim në mënyrë që më pastaj të jetojmë në bashkësinë primitive dhe jo në një shoqëri të organizuar në shtet[25]. Lufta për sovranitet nacional presupozon ekzistimin e vetëdijes shtetformuese pa marrë parasysh shkallën e ngritjes së saj, çka është një tjetër çështje.

Në shtetin e sipërcekur, ka qenë i mundësuar dominimi serb jo vetëm ndaj shqiptarëve por edhe ndaj popujve tjerë sllav. Kjo "përzierje e mbrapshtë", siç është quajtur përbërja e komplikuar etnike e ish-Jugosllavisë[26], ka ushtruar një dominim politik në marrëdhëniet e jashtme shtetërore në të gjitha drejtimet: të Selanikut dhe Stambollit (Kostandinopojës), Danubit dhe Adriatikut. Hegjemonizmi serb i institucionalizuar përmes shtetit jugosllav, që në themelimin e tij ka provokuar reagimet e përgjithshme të të shtatë popujve si dhe të të gjitha shteteve fqinje të ish-Jugosllavisë[27].

Rregullimi i mëvonshëm politik, pas Luftës së Dytë botërore, i ish-shtetit jugosllav ka qenë dhe mbetet irrelevant për të drejtën ndërkombëtare. Për të drejtën ndërkombëtare është me rëndësi të dihet nëse Mbretëria SKS (Jugosllave) ka qenë kontinuitet i Mbretërisë së Serbisë. Përgjigjja në këtë pyetje implikon përgjigjen tjetër në pyetjen se a ka mundësi që sot Republika e Serbisë dhe e Malit të Zi (RFJ) të cilësohet si trashëgimtare e vetme e subjektivitetit shtetëror të ish-Jugosllavisë, përkatësisht a mund të jetë RFJ (Serbia dhe Mali i Zi) kontinuitet juridiko-ndërkombëtar i shtetit të fundit të përbashkët të sllavëve të jugut, i njohur së fundi në pikëpamje kushtetuese si "Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë" (RSFJ)?!

Në raport me çështjen shqiptare duhet të nënvizohet fakti se, pa shpërbërjen e asaj krijese shtetërore të krijuar kryekëput me ndihmën e faktorit të jashtëm, nuk ka qenë i mundshëm realizimi i së drejtës për vetëvendosje (si komponentë e sovranitetit nacional). Një gjë e tillë, në fakt, nuk ka mund të realizohet jo vetëm për shqiptarët por edhe për sa u përket popujve tjerë të cilët ishin nën hegjemonizmin serb: çështja nacionale dhe nocioni i

---

[25] Kësisoj, në publicistikën tonë gabimisht mendon, p.sh., Fadil Hysa, "Krijimi i vetëdijes shtetëformuese" (intervistë) *Fjala*, datë 12 shkurt 1992, Prishtinë (fq. 6-7).
[26] Oscar Randi, vep. e cit. fq. 14.
[27] Oscar Randi, vep. e cit. fq. fq.141; Dr. Bogdan Krizman, vep. e cit. fq. 25 e tutje.

kombit tani e tutje reduktohen në kontekstin real socio-historik dhe juridiko-ndërkombëtare dhe jo në atë juridiko-politik dhe kushtetues të nocionit që si pikënisje ka shtetin dhe raportet e brendshme në të. Me fjalë tjera, shpërbërja e shtetit jugosllav dhe rrethanat e reja të integrimit evropian i japin sovranitetit nacional dhe atij shtetëror një fizionomi kualitativisht të ndryshme, ndërsa çështjen shqiptare e vëjnë në baza tjera: sovraniteti i Republikës së Kosovës dhe statusi i kombit shtetformues për shqiptarët të cilët jetojnë në trojet e tyre etnike por që janë gjetur nën republikat e ish-shtetit - jugosllav. Këto janë drejtimet kryesore të frontit unik, atij të bashkimit gjithëkombëtar të shqiptarëve në Ballkan. Në të njëjtën kohë, kjo assesi nuk nënkupton se duhet lënë anash faktin se procesi evolutiv dhe imanent i bashkimit kombëtar tani e tutje do të zhvillohet mbi bazat e marrëdhënieve të reja evropiane, të marrëdhënieve të cilat kanë për bazë luftën e botës së zhvilluar për tregje dhe lëvizje të lirë të kapitalit, mallrave, shërbimeve, dhe njerëzve, marrëdhënie këto që nuk njohin sentimentalizëm social apo nacional.

1.2.

Çështja e suksedimit (trashëgimit) të ish-shtetit jugosllav do të trajtohet në dy pjesë: pjesa e parë i referohet shqyrtimeve tona në lidhje me Mbretërinë SKS (Jugosllave) si shtet suksesor i Mbretërisë së Serbisë dhe i territoreve të ish-Perandorisë Austro-Hungareze, kurse pjesa e dytë i referohet suksedimit të shtetit jugosllav nga ana e subjekteve të reja të së drejtës ndërkombëtare, si dhe legalitetit e legjitimitetit juridiko-ndërkombëtar të kontinuitetit të mëtejmë të ish-Jugosllavisë si shtet, përkatësisht si subjekt i së drejtës ndërkombëtare me identitet të njëjtë shtetëror.

1.3.

Në lidhje me pyetjen se ku qëndron esenca e qëllimeve të doktrinës dhe politikës serbe, që insiston se "Mbretëria SKS (Jugosllave) është *de jure* (pra jo *de fakto*, sepse ajo është ashtu) kontinuitet i Mbretërisë së Serbisë", besojmë se qëndrojnë në faktin që, *pro futuro*, në rast të shkatërrimit të Jugosllavisë (çfarë edhe po ndodh) duhet të kërkohet ajo që është fituar me Konferencën e Londrës (1913), përkatësisht që është futur në Mbretërinë e SKS (Jugosllave) në ditën e konstituimit të saj më 1 dhjetor 1918. Pra, me rastin e caktimit të kufijve ndërkombëtar të shteteve që do të formohen në territorin e ish-Jugosllavisë si subjekte të reja juridiko-ndërkombëtare, të merret si fiksion se Londra (1913) dhe Versaja (1919), përkatësisht sistemet

juridiko-ndërkombëtare të sanksionuara atëherë në lidhje me "çështjen serbe" janë në raport kontinuel e jo përjashtues[28]. Nga kjo buron logjika e diskursit aktual serb dhe angazhimi i politikës serbe për kualifikim të proceseve dezintegruese në ish-Jugosllavi si "secesion" ("shkëputje") dhe jo si "shpërbërje" (shkatërrim) i shtetit, çfarë dhe janë në fakt. Kjo logjikë dhe ky angazhim serb synon mbetjen e Serbisë si trashëgimtare të vetme të Jugosllavisë[29]. Natyrisht, pozita juridiko-ndërkombëtare e pjesës së mbetur të ish-Jugosllavisë, pa marrë parasysh logjikën dhe angazhimin serb, do të vlerësohet sipas rrjedhës së ngjarjeve faktike në terren duke u bazuar në kriteret standarde të së drejtës ndërkombëtare (për të cilat edhe ne do të flasim në vijim)[30]. Kjo nga shkaku se akti i njohjes së një shteti prodhon, mes të tjerave, efekte të cilat mund të përcaktojnë një situatë të dhënë juridiko-ndërkombëtare[31]. Në këtë kontekst, njohja e disa prej republikave të ish-Jugosllavisë domosdo që shtron nevojën e përcaktimit të sërishëm të marrëdhënieve ndërmjet popujve të Ballkanit. Kjo nga shkaku se e drejta ndërkombëtare, në instancën e fundit, paraqet të drejtën e popujve (*diritto delle genti*, *Völkerrecht*, *law of nations* etj.). Këtyre çështjeve do t'iu kthehemi në vijim sërish. Këtu, ndërkaq, do të ndalemi në diskutimin e bazës mbi të cilën mbështetet mendimi serb si më sipër lidhur me kontinuitetin ndërkombëtar të Mbretërisë SKS (Jugosllave) me Mbretërinë Serbe, mendim që synon të rezultojë në trajtimin juridiko-ndërkombëtar të Serbisë si trashëgimtare (suksesore) e vetme e ish-Jugosllavisë, duke i trajtuar tjerët si kombe (republika) secesioniste.

Pikëpamja në fjalë e doktrinës dhe politikës serbe në periudhën para Luftës së Parë Botërore ka qenë e bazuar në formulimin e nenit 12 të *Marrëveshjes së Sen-Zhermenit* mbi mbrojtjen e pakicave, e datës 10 shtator 1919, si dhe në vetë mënyrën e lidhjes së Marrëveshjes mbi Paqen në vitin 1918 (Marrëveshja e Versajës). Edhe para Luftës së Dytë Botërore, por edhe pas saj, ka pasur dhe akoma ka dijetarë që shprehimisht ose në mënyrë implicite

---

[28] Një qëllim i tillë shihet nga vet gjeneza e kësaj teorie në qarqet intelektuale serbe. Shih më shumë për këtë në punimin tonë me titull "Mbretëria e Serbëve-Kroatëve-Sllovenëve nuk është vazhdimësi juridike e Mbretërisë së Serbisë", *Fjala* nr. 23 (Prishtinë, qershor, 1991) fq. 10-11.

[29] Njëjtë edhe Dr. Bojko Bučar, "Medjunarodni aspekti jugoslovenske reforme i osamostaljenje Slovenije", *Medjunarodna politika* nr. 988 (Beograd, 1 qershor 1991) fq. 4.

[30] Dr. Bojko Bučar, punimi i cituar, fq. 4.

[31] Gabriella Venturini, *Il Riconoscimento nel Diritto Internazionale* (Giuffre: Milano 1946) fq. 24 e tutje, 75 e tutje: Gaettano Morreli, *Nozioni di Diritto Internazionale* (Cedam: Padova 1967) fq. 128 e tutje.

pranojnë se shteti SKS (jugosllav) ka qenë një "shtet i ri", që do të thotë se nuk ka pasur asnjëherë kontinuitet të tij me Mbretërinë e Serbisë[32].

Në nenin 12 të Marrëveshjes së Sen-Zhermenit ka qenë e paraparë se marrëveshjet e Mbretërisë së Serbisë do të vlejnë derisa Mbretëria SKS t'i lidhë marrëveshjet e reja, kurse pjesëmarrja e Mbretërisë së Serbisë në Konferencën e Paqes më 18 janar 1919 ka qenë pasojë e shtetësisë akoma ekzistuese të saj si dhe e faktit të mosnjohjes ndërkombëtare të shtetit të ri, Mbretërisë SKS, akt i cili është kryer kolektivisht më 18 qershor 1919 në Versajë. Kjo tregon se akti i bashkimit më 1 dhjetor 1918 nuk e ka zhdukur automatikisht Mbretërinë e Serbisë dhe Mbretërinë e Malit të Zi, përkatësisht njohjen e tyre si subjekte ekzistuese ndërkombëtare, gjë e cila ka ndodhur vetëm më 28 qershor 1919 me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Paqes me Gjerminë[33]. Në të njëjtën kohë, vlefshmëria e mëtejme e marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura nga Mbretëria Serbe në bazë të nenit 12 të Marrëveshjes së Sen-Zhermenit ka qenë pasojë e moslënies së vakumit juridik derisa të konsolidohej shteti suksesor (trashëgimtar) i Mbretërisë së Serbisë, shteti i ri i njohur si Mbretëria SKS (Jugosllave). Se kjo është kështu më së miri dëshmohet nëse nisemi nga vetë esenca e suksedimit (trashëgimit), praktika juridiko-ndërkombëtare e ish-shtetit jugosllav lidhur me këtë problematikë, si dhe nga vetë definicioni i suksedimit (trashëgimit) në të drejtën ndërkombëtare.

Me suksedim (trashëgim) të shteteve në të drejtën ndërkombëtare nënkuptohet pranimi i të drejtave dhe detyrimeve të lidhura për territorin e një shteti nga ana një shteti tjetër si pasojë e ndërrimit të sovranitetit në atë territor[34]. Shprehja suksedim (trashëgim) në Konventat e Vjenës mbi Suksedimin e Shteteve të vitit 1978 dhe 1981 nënkupton zëvendësimin e një shteti me tjetrin në pikëpamje të përgjegjësisë për marrëdhëniet ndërkombëtare të një

[32] Shih autorët e cituar te Stevan Djordjević, *O kontinuitetu država s posebnim osvrtom na medjunarodnopravni kontinuitet Kraljevine Jugoslavije i FNRJ* (Naučna Knjiga: Beograd 1967) fq. 163; Në mënyrë implicite, shih te autorët: Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike* (Rilindja: Prishtinë 1988) fq. 83; Smilja Avramov — Milenko Kreća, *Medjunarodno javno pravo* (Savremena Administracija: Beograd 1983) fq. 85, 88; Dr. Milan Bartoš, *Medjunarodno javno pravo*, Knjiga Prva (Kultura: Beograd, 1952) fq. 321.

[33] Dr. Bogdan Krizman, vep. e cit. fq. 14-15; Vladimir Potemkin (ed.), vep. e cit. fq. 51-56.

[34] Zejnullah Gruda, vep. e cit. fq. 82; Smilja Avramov — Milenko Kreća, vep. e cit. fq. 84; Dr. Milan Bartoš, vep. e cit. fq. 321.

territori, që është e njëjta gjë me definimin e sipërm[35]. Sikundër shihet, element i përbashkët, si në definicionet doktrinarë, ashtu edhe në dokumentet ndërkombëtare, paraqitet fakti se suksedimi (trashëgimi) i referohet të gjitha të drejtave dhe detyrimeve, përkatësisht marrëdhënieve ndërkombëtare në tërësinë e tyre, të shtetit që trashëgohet (shtetit pararendës). Vlefshmërinë e mëtejme të marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura nga Mbretëria e Serbisë në bazë të nenit 12 të Marrëveshjes së Sen-Zhermenit parë si një veprim ndërkombëtar që ka pasur për qëllim moslënien e vakumit juridik në marrëdhëniet kontraktuese ndërkombëtare të shtetit të ri, Mbretërisë SKS (jugosllave), derisa sa të konsolidohet si një shtet i ri trashëgimtar (suksesor). Thënë shkurt, këtu nuk bëhet fjalë për kontinuitetin juridiko-ndërkombëtar të këtyre dy shteteve, gjë e cila është konfirmuar edhe në praktikën ndërkombëtare. Kështu, ta zëmë, mohimi i Marrëveshjes mbi Ekstradimin, e lidhur mes ShBA-së dhe Mbretërisë së Serbisë në vitin 1901, mbi bazën e së cilës është kërkuar dorëzimi i Andrija Artukoviqit më 1958, nën akuzat se ka kryer krime luftë gjatë Luftës së Dytë Botërore[36], flet qartë për praktikën ndërkombëtare sipas së cilës suksedimi (trashëgimi) përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrimet e jo vetëm ato që dalin nga marrëdhëniet kontraktuese më mes të shteteve. Mosdorëzimi i Andria Artukoviqit është arsyetuar nga pala amerikane me faktin se nuk ka pasur kontinuitet në marrëdhëniet kontraktuese dhe në marrëdhëniet e tjera mes ish-Mbretërisë së Serbisë dhe Mbretërisë SKS (Jugosllave). Nën të njëjtën prizëm, *mutatis mutandis*, duhet parë edhe sferën e marrëdhënieve diplomatike, që domethënë se, në këtë kontest, pjesëmarrja e delegacionit mbretëror serb në punimet e Konferencës e Paqes më 18 janar 1919 ka qenë pasojë e mosekzistimit të një delegacioni tjetër të shtetit të ri trashëgimtar (suksesor) — Mbretërisë SKS (Jugosllave). Thënë ndryshe, "kontinuiteti serb" në marrëdhëniet kontraktuese dhe pjesëmarrja e delegacionit serb në punimet e Konferencës së Paqes, të cilat merren nga serbët si argument i kontinuitetit juridiko-ndërkombëtar mes dy mbretërive (shteteve) të sipërcekura, në asnjë mënyrë nuk është prezumuar dhe kuptuar si diçka që vlen në mënyrë automatike ashtu siç është rregulla ndërkombëtare me rastin e ndërrimeve të rëndomta të qeverive ose ndërrimeve territoriale të papërfillshme. Ai kontinuitet në sferat e sipërcekura mes Mbretërisë së Serbisë dhe shtetit të ri, Mbretërisë SKS (Jugosllave), është arritur në

[35] Krahaso nenet 2 të përbashkëta të *Konventës së Vjenës mbi Suksedimin e Shteteve në Raport me Marrëveshjet Ndërkombëtare* (1978) dhe *Konventës së Vjenës mbi Suksedimin e Shteteve në Lëmin e Pasurisë Shtetërore, Arkivave dhe Borxheve* (1983).

[36] Shih punimin tonë si në fusnotën nr. 28 si më sipër.

mënyrë kontraktuese përmes pëlqimit të palëve të reja kontraktuese në Marrëveshjen e Paqes të datës 10 shtator 1919. Në mënyrë të njëjtë, në planin diplomatik, delegacioni serb ka qenë i trajtuar si delegacion i Mbretërisë së Serbisë pikërisht për arsye të mosnjohjes kolektive të shtetit të ri suksesor (trashëgimtar), Mbretërisë SKS (Jugosllave), gjë e cila është kryer më datën 28 qershor 1919, ani se shumica e shteteve më herët e kanë pranuar subjektivitetin e këtij subjekti të ri[37]. Krejt këto ndodhi duhen kuptuar si pasojë të shtetësisë ekzistuese të Mbretërisë së Serbisë si dhe synimit për të mos lënë asnjë vakum juridik në marrëdhëniet diplomatike dhe ndërkombëtare në përgjithësi. Më datën 28 qershor 1919, kur është kryer pranimi kolektiv i shtetit të ri, ka pushuar në mënyrë përfundimtare subjektiviteti juridikondërkombëtar i Mbretërisë së Serbisë dhe Mbretërisë së Malit të Zi, pra jo më 1 dhjetor 1918 kur në mënyrë kushtetuese është themeluar ai shtet.

Këto që i cekëm më sipër kanë për qëllim të vetëm argumentimin e tezës se nuk varet nga dëshira e shtetit ose e individëve të caktuar nëse do të konsiderohet një shtet suksesor (trashëgimtar) apo vazhdues i shtetit i cili është në shpërbërje e sipër. Pikëpamja e kundërt doktrinare, e paraqitur nga autori italian Cavaglieri (Kavaljeri), tani thuajse është e braktisur[38]. Si e tillë, ajo pikëpamje fillimisht ka shërbyer si justifikim për dominimin kolonial të fuqive të mëdha. Përkundrazi, tani janë krijuar rregullat e së drejtës ndërkombëtare të përpunuara nga doktrina dhe praktika e veprimit të shteteve, në bazë të të cilave mund të arrihet gjer tek konkludimet shkencore rreth trashëgimit (suksedimit) të shtetit dhe kontinuitetit (vazhdimësisë) shtetërore me shtetin që trashëgohet. I natyrës së tillë doktrinare ka qenë edhe Mendimi i Komisionit të Arbitrazhit drejtuar Lordit Carrington (Hagë, 9 dhjetor 1991), i njohur si "Komisioni Badinter"[39].

1.4.

Mendimi, përkatësisht përgjigjja e sipërcekur e Komisionit, sipas interpretimit tonë, ka trajtuar çështjet e suksedimit (trashëgimit) të shtetit jugosllav nga ana e subjekteve të reja të së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht nga ana e shteteve të reja të cilat janë në formim e sipër mbi gërmadhat e një shteti, ta quajmë kështu, "monstrum", të njohur si Jugosllavi. Thënë shkurt, ai ka trajtuar çështjet e suksedimit (trashëgimit) të shtetit si pasojë e

[37] Dr. Bogdan Krizman, vep. e cit. fq. 13-15.
[38] Arrigo Cavaglieri, *Corso di Diritto Internazionale* (Editoriale Scientifica: Napoli 1932) fq. 194.
[39] Për tekstin integral të mendimit, shih në *Fjala* nr. 47/91 (Prishtinë) fq. 4.

shpërbërjes së tij totale, jo rastet e secesionit (shkëputjes) të thjeshtë të pjesëve të caktuara të territorit shtetëror.

Se mendimi, përkatësisht përgjigjja në fjalë, ka trajtuar çështjet e sipërcekura e dëshmon edhe operacionalizimi i mëtejmë i tij përmes mendimit thetër të Komisionit Badinterit, të datës 11 janar 1992[40]. Ato çështje, në vija më të përgjithshme, i referohen legalitetit dhe legjitimitetit juridiko-ndërkombëtar të shtetit jugosllav, përkatësisht legalitetit dhe legjitimitetit të shteteve të reja të cilat sipas vizionit të Komisionit do të duhej të formoheshin në territorin e ish-Jugosllavisë.

Komisioni Badinter ka vepruar drejt, sipas mendimit tonë, kur në pikën 1.A ka konstatuar se nëse shteti ka plotësuar kushtet e domosdoshme, me paraqitjen e tij bëhet subjekt ndërkombëtar. Si kushte të domosdoshme të paraqitjes së shtetit, rëndom përmenden: territori, popullsia, sovraniteti shtetëror dhe aftësia për komunikim ndërkombëtar. Ndërsa "paraqitja e shtetit" në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare merret si fakt i dhënë, përkatësisht si realitet socio-historik gjë e cila mund të shihet, mes të tjerash, nga vetë mënyra e redaktimit të marrëveshjeve (konventave) ndërkombëtare. Kështu, ta zëmë, në preambullën e Konventave të Vjenës mbi Suksedimin, të cilat përmendën si bazë juridike në mendimin e cekur të Komisionit Badinter, thuhet:

faktorët e ndryshëm mund të shpien, në të ardhmen, gjer tek rastet e suksedimit (trashëgimit) të shteteve, kurse lufta diplomatike për njohjen ndërkombëtare të shtetit të ri është betejë për afirmimin e tij mbi një territor të caktuar të përfshirë në të njëjtën kohë në sferën e pretendimeve të sovranitetit të një shteti tjetër , afirmim që zakonisht kundërshtohet, gjer sa të jetë e mundur, nga sovrani i vjetër.[41]

Njohja ndërkombëtare e një shteti ka shumë dimensione. Për nga natyra, njohja është akt i natyrës politike; për nga efektet, ajo ka efekt edhe të natyrës juridiko-ndërkombëtare; dhe, së fundi, për nga vlera e vet, akti i njohjes ka karakter deklarativ të një gjendje ekzistuese. Njohja është akt politik në kuptim të asaj se shteti ekzistues në gjykimin e vet konstaton:

se në shtetin e ri janë realizuar kushtet e kërkuara nga rendi juridiko-ndërkombëtar për t'u bërë subjekt dhe pranon që shteti i tillë, duke pasur pa-

[40] Teksti integral i mendimeve të janarit 1992 është botuar në gazetën ditore *Bujku* të datave 17, 18 dhe 19 janar 1992 (Prishtinë).

[41] Giuseppe Sperduti, "STATI (Riconoscimento Internazionale Degli)", në *Novissimo Digesto Italiano* vol. XVIII (UTET: Torino 1971) fq. 126.

rasysh territorin në të cilin ai funksionon dhe përgjithësisht mënyrën e tij të krijimit, nuk i cenon të drejtat dhe interesat e tij.[42]

Pjesa e konsiderueshme e doktrinës që e llogarit njohjen jashtë aktivitetit juridikisht relevant të shteteve, nuk do të thotë se konceptin e tillë e nënkupton si të papajtueshëm me efektet juridiko-ndërkombëtare të njohjes. Në të vërtetë, gjendja para njohjes së shtetit është gjendje e një pasiviteti juridiko-social[43] ashtu që akti i njohjes përbën një tregues që rendi juridiko-ndërkombëtar i referohet edhe subjektit të porsanjohur në mënyrë që ta mbrojë atë në jetën sociale kundrejt anëtarëve tjerë ekzistues të bashkësisë ndërkombëtare. Është normale që rendi juridiko-ndërkombëtar i referohet subjekteve të njohura në mënyrën e atillë duke i investuar (veshur) ata me të drejta dhe detyrime[44]. Kjo do të thotë, në të njëjtën kohë, se ekzistimi politik i shtetit është i pavarur nga njohja e cila, përkundër rëndësisë që e ka, është me vlerë deklarative, siç është konstatuar më të drejtë në pikën e cekur të mendimit të Komisionit Badinter[45].

Të gjitha këto i cekëm për t'u ndërlidhur me konstatimin tjetër, gjithashtu të drejtë, të Komisionit të dhënë në pikën 1.B, ku si kushte qenësore të ekzistimit të një shteti i ka theksuar ato që i cekëm më sipër. Në këtë mënyrë, Komisioni ka ripohuar se e drejta ndërkombëtare nuk i cakton kriteret e legalitetit dhe të legjitimitetit politik të shtetit. Ato, d.m.th., legaliteti dhe legjitimiteti juridiko-ndërkombëtar i shtetit, paraqesin koncepte të ndryshme nga konceptet e së drejtës së brendshme.

Formimi i shteteve të reja në territoret ekzistuese mbetet, nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare, një proces faktik. Me fjalë të tjera, shtetet e reja konstituohen gjithherë jashtë kontestit juridik ndërkombëtar dhe si for-

---

[42] Tomaso Perassi, *Lezioni di Diritto Internazionale* vol. I (Cedam: Padova, 1950), ribotuar në "Edizione Italiana: Roma, p.d.b." fq. 48. Edhe në praktikën diplomatike dominon botëkuptimi në fjalë. Kështu, ta zëmë, delegati i ShBA-së në Këshillin e Sigurimit të OKB-së në replikën ndaj kritikave të delegatit të Sirisë për sa i takon njohjes, përkatësisht ngutjes së njohjes, *de facto* të Izraelit nga ana e ShBA-së, ka deklaruar, në seancën e datës 18 maj 1948, si vijon: "*I should regard it as highly improper for me to admit that any country on earth can question the sovereignty of the United States in the exercise of that right political act of recognition.*" Security Council, Official Record, No. 68 (New York, 1948) fq. 16.

[43] Giuseppe Sperduti, punimi i cituar, fq. 127.

[44] Po aty, fq. 123.

[45] Kështu edhe *Institut de droit international* në Rezolutën e datës 24 prill 1936 ka theksuar se ekzistimi politik i shtetit është i pavarur nga njohja e shteteve tjera. Rezoluta është botuar në *Annuaire de l'Institut* Vol. II (Bruxelles, 1936) fq. 300, Po ashtu, në nenin 9 të Kartës së Organizatës së Shteteve Amerikane pohohet se "*the political existence of the State is indipendent of recognition by other states.*"

macione historike nuk kushtëzohen (as para as pas krijimit) nga normat e së drejtës ndërkombëtare. Kështu, ta zëmë, hyrja në pavarësi nga ana e popujve kolonialë dhe e popujve të tjerë të robëruar është "e rregulluar" nga e drejta ndërkombëtare vetëm në kuptimin që popujt dhe territoret e tilla janë objekt i të drejtave dhe detyrimeve të shteteve ekzistuese kundrejt tyre. Komunitetet e ndryshme politike, edhe pse të organizuara normativisht secila brenda rrethit të vet, janë të strukturuara dhe zhvillohen ashtu që ato nuk përbëjnë një trup unik juridiko-politik, ashtu që asnjëherë nga pikëpamja e së drejtës së brendshme nuk paraqesin artikulim të një rendi juridiko-ndërkombëtar universal[46].

Në vijim sa më sipër, duke zbërthyer kushtet elementare të paraqitjes së një shteti në planin ndërkombëtar, Komisioni Badinter në pikën 1.C me të drejtë ka konstatuar se forma e organizimit politik të shtetit dhe e dispozitave kushtetuese nuk janë pos një fakt i thjeshtë, ndonëse është e domosdoshme për t'i pasur parasysh me qëllim të përcaktimit të ndikimit të qeverisë mbi popullsinë dhe territorin shtetëror. Sikundër vërehet, pra, Komisioni nuk ka marrë parasysh shtetësinë serbe as malazeze të Kongresit të Berlinit sepse, besojmë, as që ka menduar për ndonjë kontinuitet të shtetit jugosllav (të para- dhe pas-Luftës së Dytë Botërore) me mbretëritë e cekura. Komisioni ka marrë për bazë vetëm Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974 dhe strukturën e pushtetit federativ së bashku me efektivitetin e qeverisë federative (shih pikën 1.C), sepse shkalla e efektivitetit të një qeverie ndaj popullsisë merret si kusht i ekzistencës, përkatësisht i paraqitjes së shtetit të ri. Fakti i thjeshtë i ekzistimit të tetë njësive në ish-federatën jugosllave nuk është marrë parasysh ashtu që edhe formulimi i pikës 1.C, ani se parimisht i drejtë, bie në kundërshtim me pikën 2.B, sepse Kosova ka qenë një njësi federale e normuar me ish-Kushtetutën e vitit 1974, përkundër faktit se Komisioni në pikën 2.A ka marrë parasysh, konform pikës 1.C, dispozitat e Kushtetutës se RSFJ-së të vitit 1974, si dhe deklaratat mbi pavarësinë të Sllovenisë, Kroacisë, Maqedonisë dhe Bosnjë-Hercegovinës.

Me fjalë të tjera, nëse Komisioni i Arbitrazhit në pikën 1.C ka konstatuar se dispozitat e brendshme kushtetuese duhet pasur parasysh, ndërsa në pikën 2.B ka theksuar "se përbërja dhe veprimtaritë e organeve kryesore të Federatës më nuk i plotësojnë kushtet e pjesëmarrjes dhe të pavarësisë që i përgjigjen shtetit federal", atëherë është dashur që edhe Kosova të ketë tretman të njëjtë

[46] Gaetano Arangio Ruiz, "Stati e altri enti (soggetività internazionale)", në *Novissimo Digesto Italiano* vol. XVIII (UTET, Torino, 1971) fq. 145.

dhe të citohet në pikën 2.A, si dhe Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës e datës 22 shtator 1991, përfshirë këtu edhe rezultatet e referendumit për Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur me të drejtë bashkimi me shtetet tjera. Besojmë se Komisioni Badinter nuk e ka pasur parasysh kundërkushtetutshmërinë e deklaratave të republikave të cekura, sepse me këtë do të merrte rolin e një "gjykate kushtetuese ndërkombëtare". Besojmë se Komisioni e ka pasur parasysh faktin e thjeshte socio-historik të paraqitjes së entiteteve të reja juridiko-politike në pjesën dërmuese të territorit të ish-RSFJ-së.

Nga sa më sipër, megjithatë, dalin dy konsekuenca pozitive të ngërthyera në vendimin e sipërcekur të Komisionit Badinter. E para, ai vendim paraqet aktvdekjen *de jure* të shtetit jugosllav, gjë që edhe shprehimisht është konstatuar në pikat 1.E dhe 3, ku është folur për suksedimin (trashëgimin) e tij si pasojë e shpërbërjes totale, jo si pasojë e secesionit (shkëputjes) të ndonjërës prej pjesëve të atij shteti. Kjo është konfirmuar më pastaj edhe me në detaje. Një konstatim të tillë, në mënyrë lakonike, e shprehu kryetari i Maqedonisë, Kiro Gligorov, në përgjigjen e vet ndaj pyetjes se a do ta njohë Maqedonia Republikën e Serbisë, duke deklaruar se "ende nuk dihet se çka nënkuptohet me shtetin serb".

Konsekuenca e dytë i referohet operimit të organeve më të larta të pushtetit në Republikën e Kosovës: Qeveria e Republikës së Kosovës që nga momenti i dhënies së këtij mendimi të Komisionit, duhet të vlerësojë mirë situatën faktike dhe t'i rekomandojë Kuvendit të Republikës së Kosovës shkëputjen formale nga ish-RSFJ. Kjo duhet të ndodhë në atë moment kur, përkundër rregullave të së drejtës ndërkombëtare mbi suksedimin (trashëgimin) e shteteve si pasojë e shpërbërjes totale të shtetit, bashkësia ndërkombëtare do t'ia pranonte kontinuitetin (vazhdimësinë) e shtetit jugosllav Serbisë dhe Malit të Zi. Në rastin e tillë eventual, në Republikën e Shqipërisë do të duhej të barteshin të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, kurse në planin e brendshëm do të urdhërohej rezistenca totale kundër efektshmërisë së ligjeve serbo-malazeze. Në këtë kontekst, vendimin për të dalë në zgjedhjet e lira në Republikën e Kosovës duhet kuptuar si një dëshmi para opinionit ndërkombëtar se efekti i organeve të ish-federatës jugosllave është vetëm faktik dhe jashtë kritereve kushtetuese, përkatësisht okupim klasik dhe jo efektshmëri e organeve federative jugosllave, sepse pushteti federal në Kosovë nuk mund të ushtrohet sipas mekanizmit normal kushtetues.

Edhe përkundër rrezikut latent të njohjes së kontinuitetit juridiko-ndërkombëtar të ish-federatës jugosllave, thellësisht besojmë se në baza shken-

core një njohje e tillë nuk do të mund të arsyetohet, veçanërisht jo mbi bazën e rregullave ndërkombëtare. Për më tepër, jemi të bindur se bashkësia ndërkombëtare, bazuar në praktikën dhe rregullat ndërkombëtare, duhet të aplikojë institucionin e a.q. të revokimit të njohjes së mëparshme, përkatësisht institucionin e çnjohjes (ital. *il disconoscimento*). Me fjalë të tjera, bashkësia ndërkombëtare, duke u bazuar në mendimin e Komisionit Badinter, duhet të konstatojë se në raport me rrethanat e krijuara dhe realitetin socio-historik, njohja e akorduar për Jugosllavinë nuk ka efekt të mëtejmë, sepse shteti, për të cilën ka qenë i drejtuar akti i njohjes më datën 28 qershor 1919, ka pushuar së ekzistuari si subjekt ndërkombëtar[47]. Në praktikën e së drejtës ndërkombëtare, rast tipik i revokimit të njohjes së mëparshme ka qenë Deklarata e Departamentit të Shtetit Amerikan e datës 4 janar 1934 në raport me Armeninë, deklaratë sipas së cilës njohja e mëparshme e Armenisë "nuk ka efekt të mëtejmë qëkur Republika e Armenisë ka pushuar së ekzistuari si shtet i pavarur". Pasojat e një akti të tillë të bashkësisë ndërkombëtare, i cili një ditë do të pasojë patjetër, do të ishin si vijon: institucionet dhe organet e mbetura të ish-federatës jugosllave do të trajtoheshin si jolegjitime në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare, ndërsa armata jugosllave do të cilësohej si armatë jo e rregullt e popujt dhe territoret që do të gjendeshin nën kontrollin e saj si "një okupim i prolonguar" sipas analogjisë me rastet tjera në të drejtën ndërkombëtare dhe pasojave tjera që tërheq me vete okupimi i tillë (p.sh., rasti i Gjermanisë dhe Japonisë pas Luftës së Dytë Botërore, i Kamboxhias, Saharasë Perëndimore, Afganistanit, territoreve të okupuara nga Izraeli etj. etj.).[48] Më tutje, rezistenca kundër organeve dhe institucioneve të ish-federatës jugosllave do ta fitonte legjitimitetin e plotë juridiko-ndërkombëtar sikur në rastet e cekura. Së fundi, pasuria e ish-shtetit jugosllav, e cila gjendet jashtë, do të bllokohej gjerë në zgjidhjen definitive të trashëgimisë juridiko-ndërkombëtare të ish-federatës jugosllave.

---

[47] Shih më shumë për institucionin e "çnjohjes" në të drejtën ndërkombëtare ("*il disconoscimento*") në Giuseppe Sperduti, punimi i cituar, fq. 130. e tutje. Në këtë vend, autori ka dhënë edhe rastet tjera nga praktika ndërkombëtare.

[48] Shih më shumë për nocionin e okupimit të prolonguar ose të "okupimit ilegal" në Adam Roberts, "Prolonged Military Occupation", *American Journal of International Law* vol. 84, no. 1 (January 1990) fq. 44-103. Autori i shpjegon kushtet, rastet dhe mënyrat e konstituimit të okupimit të prolonguar në praktikën ndërkombëtare.

2. Instrumentalizimi juridiko-ndërkombëtar i subjektivitetit të Kosovës

Përgjithësisht. Shqyrtimeve tona lidhur me këtë çështje i paraprijnë disa sqarime mbi subjektivitetin e entiteteve shtetërore në përgjithësi në mënyrë që më lehtë ta gjejmë dhe sqarojmë pozitën e Kosovës si subjekt i ri në realitetin ndërkombëtar.

2.1.

Afirmimi i faktit socio-historik mbi ekzistimin e një subjekti të ri ndërkombëtar kryhet përmes aftësisë së tij për komunikim ndërkombëtar, përkatësisht aftësisë së respektimit të së drejtës ndërkombëtare nga ana e këtij subjektit të ri. Ky kusht për subjektivitetin juridik-ndërkombëtar të shtetit, i cili e ka zëvendësuar atë antik të përkatësisë së qytetërimit të krishterë[49], së pari është përmendur në *Rezolutën e Institutit për të Drejtën Ndërkombëtare* të datës 24 prill 1936 edhe pse më herët, sipas një memorandumi të Departamentit të Shtetit të ShBA-së të datës 28 mars 1913, ky ka qenë një prej elementeve kryesore mbi të cilën është bazuar politika e njohjes së shteteve të reja nga ShBA-ja[50].

Në vijim sa më sipër, pyetja që shtrohet ka të bëjë me atë nëse krijimi i subjektivitetit juridik-ndërkombëtar të Kosovës është i njëjtë me atë të republikave të tjera të ish-Jugosllavisë ose për Kosovën duhet të vlejnë rregulla të tjera të reja. Krijimi i subjektivitetit juridiko-ndërkombëtar të ish-njësive federale të Jugosllavisë duhet të shikohet kundrejt subjektit, akoma ekzistues formalisht, të quajtur Jugosllavi në planin ndërkombëtar. Në aspektin juridik, e drejta ndërkombëtare nuk e ka kushtëzuar shpërbërjen e këtij shteti. Kjo sepse procesi i krijimit të subjekteve të reja në territorin e ish-Jugosllavisë është një proces socio-historik dhe realitet i dhënë për të cilën, *mutatis mutandis*, vlen tërë ajo që vlen për rastet tjera të krijimit të shteteve të reja. Shqiptarët në procesin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, më tepër janë afirmuar si subjekt i së drejtës ndërkombëtare se sa Republika e Kosovës si shtet në lindje e sipër (*in statu nascendi*) dhe në procesin e afirmimit të saj ndërkombëtar. Këtë rrugë e kanë pasur edhe disa popuj të tjerë të Evropës, ndërsa doktrina, si p.sh., ajo italiane e shekullit të kaluar, e ka arsyetuar nocionin e kombit si subjekt i së drejtës ndërkombëtare më parë se nocionin sht-

[49] Giuseppe Sperduti, punimi i cituar, fq. 125.
[50] *Hackworth's Digest of International Law* vol. I (Washington, 1940) fq. 175-176.

et[51]. Kjo nuk ka qenë kështu në doktrinën ish-jugosllave[52], e cila padrejtësisht konstatonte se kombet nuk mund të viheshin drejtpërsëdrejti në marrëdhënie ndërkombëtare. Kjo u provua si një gabim i madh, sepse me rënien e komunizmit në Evropë kombet kanë marrë një rëndësi gjithnjë e më të madhe për arsye të moszgjidhjes së çështjes nacionale nëpër vendet ish-komuniste evropiane. Një gabim të tillë doktrinar e dëshmojnë edhe një sërë e dispozitave të së drejtës ndërkombëtare të cilat flasin drejtpërdrejti për kombet: i tillë është rasti me të drejtën për vetëvendosje të kombeve të përmbajtur në Kartën e OKB-së, dispozitat e caktuara të Pakteve mbi të Drejtat e Njeriut e deri te Deklarata e Parisit për Evropën e re (1990).

Nga kjo del se emërtimi "subjektivitet juridiko-ndërkombëtar" është një nocion tekniko-juridik i destinimit (përkatësisë) të normave juridiko-ndërkombëtare[53], ndërkohë që subjektiviteti në fjalë nënkupton posedimin nga ana e një subjekti (organizmi) shtetëror të një kualiteti juridik abstrakt i cili e bën të aftë për të qenë titullar i të drejtave dhe detyrimeve, si dhe pjesëmarrës i situatave konkrete juridike në suazat e rendit të dhënë juridiko-ndërkombëtar. Ky kualitet abstrakt juridik del nga logjika se krijimi i shteteve të reja është fakt historik dhe se shtetet e reja janë të obliguara nga rregullat paraekzistuese të së drejtës ndërkombëtare gjersa të mos kenë pranuar rregullat specifike të sjelljes.[54] Në këtë kontekst duhet shikuar dhe kuptuar kërkesën zyrtare të Qeverisë dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dërguar Lordit Carrington më 20 dhjetor 1991[55]. Në Kërkesë, mes të tjerash, në pikën B është shprehur gatishmëria e Republikës së Kosovës për respektimin e së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht për pranimin e dokumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare nënshkruese e të cilave ka qenë RSFJ, duke filluar nga Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut (1948) e gjer tek Karta e Parisit për Evropën e Re (1990). Kjo dëshmon për aftësinë e Republikës së Kosovës për komunikim ndërkombëtar, e cila, përveç asaj që u cek, manifestohet edhe në aktivitetin diplomatik. Kërkesës në fjalë të Qeverisë dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës mbase ka qenë dashur t'i shtohet

---

[51] Pasquale Stanislao Mancini, *Della Nazionalita come Fondamento del Diritto delle Genti* (Universita di Torino: 1851).

[52] Dr. Milan Bartoš, vep. e cit. fq. 451. Si dhe autorët tjerë.

[53] Gaetano Arangio Ruiz, punimi i cituar, fq. 136.

[54] Shih recensionin e Anthony D'Amatos të librit *Rethinking the Sources of International Law* të autorit G.J.H. van Hoof Deventer (Kluwer Law: The Hague, 1983), botuar në *American Journal of International Law* vol. 78, no. 4 (1984) fq. 937.

[55] Për tekstin integral, shih në gazetën ditore *Bujku* nr. 206 (Prishtinë, 24 dhjetor 1991) fq. 1.

edhe një pikë e veçantë me të cilën do të notifikohej pranimi edhe i obligimeve tjera kontraktuese të ish-RSFJ-së si pasojë e suksedimit (trashëgimit) juridiko-ndërkombëtar të një pjese të caktuar të territorit të saj që quhet Kosovë.

2.2.

Me instrumentalizim juridiko-ndërkombëtar të subjektivitetit të një entiteti shtetëror, pra edhe të Republikës së Kosovës, nënkuptojmë sanksionimin e situatës së caktuar juridiko-politike të një entiteti shtetëror me anën e marrëveshjes multilaterale dhe prej të cilit sanksionim dalin të drejta dhe detyra të caktuara të karakterit juridiko-ndërkombëtar për palët (subjektet e marrëveshjes). Nga ky përkufizim kësisoj dalin disa veçori të cilat nocionin e entitetit shtetëror sovran, sovranitetin shtetëror dhe konceptet e vjetra mbi subjektivitetin juridiko-ndërkombëtarë të shtetit, në kushtet e reja të rirreshtimit evropian, i bëjnë të paqëndrueshme. Ato veçori, në raport me Kosovën si entitet shtetëror sovran *vis-à-vis* instrumentalizimit të subjektivitetit të saj në kuptimin që ne flasim këtu, mund të përmblidhen me sa vijon:

a. se elementet e subjektive të subjektivitetit juridiko-ndërkombëtar të entiteteve shtetërore, përkatësisht aftësia për komunikim ndërkombëtar dhe respektim të së drejtës ndërkombëtare[56] janë me vlerë të njëjtë me të ashtuquajturat elemente objektive (populli, territori dhe pushteti sovran i subjektit)[57]. Kjo do të thotë se pozita e tanishme juridiko politike e Kosovës, e përcaktuar me Kushtetutën e Kaçanikut, dhe e Kosovës si një fakt sociohistorik duhet të afirmohen edhe më tej në elementin e saj subjektiv të nocionit shtet në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare;

b. se instrumentalizimi juridiko-ndërkombëtar i subjektivitetit të Republikës së Kosovës, *pro futuro*, do të ishte garanci për të penguar ekspansionizmin ekonomik (dhe tjetër) të territoreve dhe popujve të tjerë ekonomikisht (dhe në aspekte të tjera) më të fortë kundruall Kosovës dhe viseve

[56] Në nenin 4 para. 1 të Kartës së OKB-së thuhet se "anëtarësia në Kombet e Bashkuara është e hapur për të gjitha shtetet paqedashëse të cilat pranojnë obligimet e përcaktuara në këtë Kartë, kurse sipas vlerësimit të organizatës janë të afta dhe kanë vullnet për t'i zbatuar obligimet e cekura".

[57] Doktrina e së drejtës ndërkombëtare në ish-vendet socialiste ka qenë e limituar në trajtimin e subjektivitetit juridiko-ndërkombëtar të shteteve dhe kryesisht ka qenë e përqendruar në elementet objektive të nocionit të shtetit në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare, kurse për ato subjektive ka konsideruar se janë elemente të cilat shpien në pengimin e luftës për vetëvendosje të popujve edhe pse *de facto* ka qenë e kundërta. I tillë ka qenë rasti edhe me doktrinën e ish-Jugosllavisë (p.sh. Bartosh, Andrassy, Jankoviq, Avramov-Kreqa etj. etj.).

tjera shqiptare. Ky konkludim i yni, përveç së kaluarës, bazohet edhe në atë se integrimi evropian dhe proceset e filluara në superstrukturën socio-politike të ish-vendeve komuniste bazohen kryesisht në interesat ekonomike, përkatësisht në luftën për tregje të reja, ndërsa elementet e tjera (ideologjike, fetare, etnike etj.) nuk janë dominantë kryesore të këtyre proceseve[58];

c. se instrumentalizimi në fjalë është protektorat i institucioneve ndërkombëtare me regjim të caktuar specifik dhe jo protektorat ndërkombëtar i vetëm i një shteti ndaj Kosovës (ose status special siç po e përflasin disa qarqe politike e publicistike në Kosovë dhe më gjerë). Në të vërtetë, protektorati dhe statusi special janë nocione mjaftë të gjëra të cilat ndër ne nuk elaborohen gjerësisht, ose edhe kur elaborohen, rëndom kuptohen e përfliten në kontekstin negativ dhe merren si alibi për ta sulmuar ndonjërin prej subjekteve politike shqiptare. Protektorati i institucioneve ndërkombëtare, në kuptimin që ne këtu e përdorim, nuk është protektorat klasik ndërkombëtar ku një shtet e humb ose e zvogëlon subjektivitetin e vet juridiko-ndërkombëtar (p.sh., rasti i Andorrës, San-Marinos, Monakos, Lihtenshtajnit, Tunizisë etj.) e as protektorat i institucioneve ndërkombëtare (p.sh., i OKB-së ndaj territoreve dhe popujve nën mandat ose përkujdesje ndërkombëtare në kuptim të neneve 73-91 të Kartës së OKB-së). Protektorati i institucioneve ndërkombëtare në kuptimin tonë dallohet nga ai i paraparë në nenet 73-91 të Kartës së OKB-së veçanërisht nga arsyeja se kombi shqiptar i cili jeton në Republikën e Kosovës është i aftë për të jetësuar atë, d.m.th. Republikën, mirëpo i treti, Republika e Serbisë, po e pengon një gjë të tillë;

d. se protektorati i institucioneve ndërkombëtare si mënyrë për instrumentalizimin e subjektivitetit juridiko-ndërkombëtar të Kosovës do ta krijonte statusin ndërkombëtar për Kosovën sipas parimit "*uti possidetis* 1974" çfarë ka normë ndërkombëtare në rastet të tjera (p.sh., "parimi *uti possidetis* 1810" me rastin e pavarësimit nga Spanja të shteteve të Amerikës Jugore etj.). Ky subjektivitet i instrumentalizuar kësisoj, ku sovraniteti i Republikës së Kosovës do të kufizohej në favor të bashkësisë ndërkombëtare dhe do të krijohej një regjim specifik sipas modelit zvicerano-austriak, nuk do të prejudikonte çështjen e bashkimit të Ko-

[58] Më shumë lidhur me këtë, krahaso librin *Razumjevanje Kapitalizma* ("Understanding Capitalism") të autorëve Samuel Bowels dhe Richard Edwards (Informator: Zagreb 1991) (përkth.).

sovës me Shqipërinë, përveç (eventualisht) për një kohë të caktuar. E cekëm rastin e Austrisë pikërisht nga arsyeja se, shikuar në retrospektivën historike, janë gati shkaqe identike të cilat e kanë sjellë Republikën e Austrisë gjer tek instrumentalizimi juridiko-ndërkombëtar i subjektivitetit të saj; por kuptohet, natyra e neutralitet të përhershëm është e ndryshme prej situatës që e diskutojmë këtu lidhur me Kosovën;

e. se ai instrumentalizim do të bëhej me marrëveshje multilaterale ndërkombëtare, subjekte të së cilës do të ishin KSBE-ja në kuptimin e nenit 52 të Kartës së OKB-së, Republika e Kosovës dhe ajo e Serbisë, me qëllim të përcaktimit të bazave për rregullimin e obligimeve ndërkombëtare reciproke si pasojë e suksedimit (trashëgimit) të ish-RSFJ-së dhe statusit kolonial të Kosovës në të, dhe kuptohet, Republika e Shqipërisë si palë e fundit. Me aktin e brendshëm juridiko-politik, përkatësisht me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, do të bëhej implementimi i dispozitave të marrëveshjes së cekur multilaterale siç është rasti me vendet e tjera me status të garantuar nga bashkësia ndërkombëtare (p.sh., rasti i Zvicrës, Austrisë etj.). Gjithashtu, me aktin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës do të bëhej implementimi edhe i obligimeve tjera ndërkombëtare të cilat (eventualisht) dalin nga marrëveshja e cekur ndërkombëtare, si p.sh., në lidhje me demilitarizimin e territorit të Kosovës ose e pjesëve të caktuara të saj, apo kufizimet e ndryshme në lidhje me forcat e armatosura nacionale, hyrjen në ndonjë aleancë ushtarako-politike, pastaj dispozitat në lidhje me anëtarësimin në organizatat e ndryshme ndërkombëtare, etj. etj.; dhe së fundi,

f. se në mesin e të drejtave dhe detyrimeve të sanksionuara si në më sipër nën pikën *d* kishte me qenë edhe detyra e bashkësisë ndërkombëtare që t'i bartë disa prej institucioneve ndërkombëtare në territorin e Republikës së Kosovës.

Kapitulli II

MBYLLJA E PROCESIT TË VETËVENDOSJES DHE TË TRASHËGIMIT NË KUADËR TË ISH-JUGOSLLAVISË: SPECIFIKAT E TIJ PËR KOSOVËN

Sfondi historik: Ky kapitull ka tri punime të cilat në tërësi riprodukohen këtu. Punimi i parë, që asnjëherë nuk është botuar në gjuhën shqipe, flet për vetëvendosjen e Kosovës në dritën e lidhjes së Marrëveshjes për Union mes Serbisë dhe Malit të Zi në Beograd në mars 2002. Shkrimi për herë të parë është botuar anglisht në ShBA[59].

Qëllimi i autorit ka qenë të përndritësojë qarqet akademike ndërkombëtare rreth qasjes së Marrëveshjes për Union ndaj çështjes së Kosovës. Marrëveshja synonte të sanksiononte po atë filozofi që kishte nisur me mendimet e Komisionit Badinter (1991-1993) dhe që ishte përsëritur e reflektuar në mënyrë besnike në të gjitha dokumentet e mëvonshme të prodhuara në kontekstin e zgjidhjes së problemeve të dala nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë. Këto mendime dhe dokumente ndërkombëtare kishin trajtuar Kosovën si një çështje minoriteti që duhej zgjidhur në kuadër të respektimit të integritetit dhe sovranitetit territorial të ish-republikave jugosllave. Meqë, sipas Kushtetutës së ish-RSFJ-së të vitit 1974, Kosova kishte qenë pjesë e Republikës së Serbisë, nënkuptohej se edhe zgjidhja e çështjes së Kosovës duhej kërkuar në vijim të respektimit të integritetit dhe sovranitetit territorial të Republikës së Serbisë, si njëra nga ish-republikat.

Pas shpërbërjes së plotë të ish-Jugosllavisë më 1992 dhe kapitullimit ushtarak të RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi) më 1999 para trupave të NATO-s, të cilat kishin sulmuar për 78 ditë rresht forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe, në Kosovë u instalua një administratë ndërkombëtare. Kjo administratë, që akoma formalisht ngelet në fuqi në Kosovë, u ndërtua në bazë të Rezolutës 1244 të KS të OKB-së, dhe njihet me emrin UNMIK (*United Nations Mission in Kosovo*). UNMIK-u, i vendosur pas 10 qershorit të vitit 1999, nuk kishte pasur asnjë mandat tjetër sa i përket statusit të Kosovës pos të

[59] "Self-Determination under the Terms of the 2002 Union Agreement between Serbia and Montenegro: Tracing the Origins of Kosovo Self-Determination", *Chicago-Kent Law Review*, Vol. 80 No. 1 (2005).

lehtësojë zgjidhjen e tij përmes krijimit të institucioneve të vetëqeverisjes vendore, por gjithnjë në kuadër të respektit për sovranitetin formal dhe integritetin territorial të RFJ-së. Në ndërkohë që zgjidhjes së statusit të Kosovës nuk po i shihej filli, Mali i Zi nisi reagimet e veta legjitime për shkëputje nga RFJ, shtetit të ri federal të krijuar nga diktatori serb Sllobodan Millosheviq (Slobodan Milošević) në prill 1992, me shpresë se bashkësia ndërkombëtare do t'ia njihte këtij entiteti shtetëror të drejtën ekskluzive për të qenë trashëgimtar dhe kontinuitet i vetëm i ish-Jugosllavisë. Mali i Zi duhej ndalur së pakut deri të afrohej zgjidhja e statusit të Kosovës. Por meqë kjo nuk shihej në horizont askund, Podgorica çdo ditë e më shumë bënte presion për t'u shkëputur nga RFJ, duke mos pranuar më që të identifikohej me krimet, gjenocidin dhe poshtërsitë e tjera të kryera nga Millosheviqi, që nga viti 1986 e deri kur ra nga pushteti më 2000. Qartë shihej se shkëputja e Malit të Zi, pa ndonjë procedurë paraprake legale dhe pa ndonjë marrëveshje reciproke me Serbinë, do të krijonte reagime të ashpra për shkëputje, pavarësim dhe sovranizim të menjëhershëm të Kosovës. Për t'u evituar ky skenar, shpresohej në qarqet ndërkombëtare të kohës, duhej arritur një marrëveshje me ndërmjetësim ndërkombëtare mes dy republikave të fundit të sllavëve të jugut, Serbisë dhe Malit të Zi, të cilat kishin ngelur të bashkuara pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë më 1992. Kjo marrëveshje u arrit në mars 2002 në Beograd, me ndërmjetësimin e njeriut që kishte dhënë urdhrin për të nisur bombardimet kundër caqeve serbe më 24 mars 1999. Çfarë paradoksi! Javier Solana (Havier Solana), "ministri i jashtëm" i Evropës, ish-Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s në kohën e bombardimeve, tani në Beograd po ndërmjetësonte krijimin e një entiteti të ri shtetëror. I satirizuar si "Solania", por i njohur zyrtarisht si Unioni Serbi-Mal i Zi, ky entitet është objekt diskutimi në seksionin e parë të këtij kapitulli.

Shkrimi i dytë është botuar shqip, si këtu, në revistën *E drejta*, nr. 1/2012 (fq. 7-53), të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës[60]. Siç sqarohet në fillim të shkrimit, ai është botuar si projekt për herë të parë në ShBA dhe në Hungari, në dy revista prestigjioze akademike mbi të drejtën ndërkombëtare. Punimin e ka mundësuar studimi im i gjatë, një semestër, në Universitetin "Northwestern" të Çikagos, në kuadër të Programit "Fulbright" (2005-2006).

Si koncept, shkrimi nuk dallon nga shkrimet që kemi sjellë në kapitullin pararendës. Në fakt, ky punim paraqet vazhdimësi të angazhimit tonë për një

[60] Enver Hasani: "Specifikat e trashëgimit të ish-Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të", *E drejta*, nr. 1 (2012) fq. 7-53.

diskurs profesional në Kosovë dhe jashtë saj lidhur me aspektet ndërkombëtare të trashëgimit (suksedimit) të ish-Jugosllavisë dhe pasojat e tij për Kosovën dhe shqiptarët në ish-Jugosllavi. Në ndërkohë që shkrimet e kapitullit të parë janë klasifikuar sipas qasjes klasike mbi trashëgimin, ku ndiqet rruga e dy konventave mbi suksedimin, të viteve 1978 dhe 1983, ky shkrim ndjek një rrugë tjetër dhe më gjithëpërfshirëse.

Sipas trajtimeve standarde të së drejtës mbi trashëgimin e shteteve, bazuar në konventat e Vjenës, ekzistojnë dy sfera të trashëgimit: trashëgimi i shteteve ndaj traktateve (marrëveshjeve) ndërkombëtare, ku hyjnë edhe marrëveshjet për kufijtë shtetërorë, dhe trashëgimi i shteteve në sferën e pasurisë shtetërore (të tundshme dhe të patundshme), arkivave dhe borxhit të jashtëm. Kjo domethënë se nuk kemi ndjekur trajtimin e suksedimit të ish-Jugosllavisë sipas materies së rregulluar me konventat e Vjenës: njëra quhet Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin ndaj Traktateve Ndërkombëtare e vitit 1978 (në tekstin e mëtejmë: KV I), kurse tjetra Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin e Pronës, Arkivave dhe Borxhit të Jashtëm e vitit 1983 (më tej shkurt: KV II).

Trajtimi ynë këtu ndjek një rrugë tjetër sepse i jemi përmbajtur materies specifike, siç është trajtuar në kontekstin jugosllav sipas Marrëveshjes mbi Trashëgimin e ish-Jugosllavisë të vitit 2001, e lidhur në Vjenë mes ish-republikave jugosllave, por edhe siç ka qenë problematika e trashëgimit (suksedimit) ish-jugosllav në praktikë që në periudhën 1991-2001. Kjo nënkupton se domosdo në këtë kontest është dashur t'i rikthehemi sërish temave nga kapitulli i kaluar, të cilat i kishim prekur që më 1991, e të cilat kishin të bënin me sa vijon: kontinuitetin shtetëror të ish-Jugosllavisë me Mbretërinë e Serbisë, tezë që serbët, deri me rënien e diktatorit Millosheviq, e kishin ndjekur me fanatizëm; pastaj përgjigjen në pyetjen se kush mund të ishin subjektet e trashëgimit dhe nën cilat kushte, cilët kufij administrativë bëheshin ndërkombëtarë; pronat, asetet financiare dhe borxhi i jashtëm i ish-Jugosllavisë, të drejtat e fituara dhe prona private, si dhe çështje tjera si këto.

Në fund të shkrimit kemi trajtuar trashëgimin specifik të Kosovës, si një ndër shtete e dala nga ish-Jugosllavia. Specificiteti në rend të parë shihet në faktin se Kosova e trashëgon Serbinë dhe jo ish-Jugosllavinë, sepse u bë shtete pas mbylljes së trashëgimit (suksedimit) të ish-Jugosllavisë më 2001. Kjo i referohet të gjitha aspekteve të trashëgimit të cilat ishin rregulluar me Marrëveshjen e Vjenës të vitit 2001, të lidhur mes trashëgimtarëve të ish-Jugosllavisë (Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Sllovenia). Marrëveshja e Vjenës e vitit 2001 në këtë punim cilësohet si MT.

MT ka dy pjesë të ndara, të cilat, megjithatë, përbëjnë një tërësi unike. Pjesa e parë përbëhet prej pjesës kryesore, "Marrëveshjes mbi Çështjet e Trashëgimit", e cila paraqet "ombrellën" ose kuadrin e MT, kurse e dyta përbëhet prej anekseve (shtatë sosh). MT, në pjesën e vet kryesore, adreson çështjet kyçe të trashëgimit të ish-Jugosllavisë, ato më kontestueset që nga fillimi i procesit më 1992, të cilat kanë të bëjnë me: problemin e statusit juridik të republikave jugosllave kundrejt ish-Jugosllavisë, vendin dhe rolin e Konventës së Vjenës të vitit 1983, rolin dhe vendin e parimit të drejtësisë (*equity*), nivelin dhe natyrën e detyrimeve të ndërsjella të shteteve trashëgimtare dhe, fare në fund, çështjet e bashkëpunimit institucional në mes të subjekteve të barabartë të trashëgimit të ish-Jugosllavisë.

Pjesa e dytë, anekset e MT, mbulojnë këto segmente të trashëgimit si dhe të drejtat e detyrat që dalin nga to: Aneksi A pronën e tundshme dhe të patundshme të ish-Jugosllavisë; Aneksi B pronën e përfaqësive diplomatike e konsullore të ish-Jugosllavisë; Aneksi C asetet dhe detyrimet financiare të ish-Jugosllavisë; Aneksi D arkivat e ish-Jugosllavisë; Aneksi E pensionet e ish-shtetasve të Jugosllavisë; aneksi F interesat, të drejtat dhe detyrimet e tjera që nuk përfshihen me anekset e mëparshëm dhe që mund të dalin më vonë në syprinë; dhe, në fund, Aneksi G pronën private dhe të drejtat e fituara të personave privatë, fizikë dhe juridikë, në kohën e ish-Jugosllavisë.

Sikundër mund të vërehet, MT nuk përmban të gjitha njësitë e trashëgimit dhe të drejtat e detyrimet që dalin nga trashëgimi ndaj tyre. E kemi fjalën në rend të parë për trashëgimin ndaj çështjes së shtetësisë dhe anëtarësisë në organizatat ndërkombëtare. Po ashtu, as KV I e as KV II nuk rregullojnë këto dy çështje. Meqë MT nuk flet për këto dy njësi, ngaqë nuk ka pasur probleme serioze rreth trashëgimit të tyre mes ish-republikave jugosllave, as ne në këtë shkrim nuk jemi ndalur në to. U mor vesh, për Kosovën kjo është një çështje e re; pra, Kosova duhet të kërkojë anëtarësimin nëpër organizata ndërkombëtare kundër vullnetit serb, gjë që nuk ka qenë rasti me ish-republikat jugosllave.

Punimi që riprodhohet këtu në këtë kapitull në mënyrë të natyrshme paraqet mbylljen e diskutimeve tona akademike rreth çështjeve kryesore të trashëgimit të shteteve, më vështrim të veçantë të atyre që lidhen me ish-Jugosllavinë dhe vendin e Kosovës në tërë atë proces, tanimë të mbyllur. Nga ky shkrim shihet qartë se sa shumë është neglizhuar ndër ne problematika e trashëgimit të shteteve, e dhënies në përgjigjen se kush mund të trashëgojë, si mund të trashëgojë dhe çfarë mund të trashëgojë. Kjo çështje akoma ngelet e

hapur, por tani vetëm kundrejt shtetit serb, i cili ka trashëguar në emër të Kosovës më 2001.

Shkrimi i tretë dhe i fundit i këtij kapitulli është botuar pas luftës së fundit në Kosovë (shkurt 1998-qershor 1999) në revistën *E Drejta*, nr. 1-4/2000, fq. 181-195, të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës[61]. Asnjëherë nuk është botuar gjetiu më parë. Ky punim, në fakt, paraqet një ese të përpunuar, të cilën autori e kishte paraqitur në fund të vitit 1998 si pjesë e programit të studimeve të rregullta të doktoratës në Universitetin Bilkent të Ankarasë, Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Përveç provimeve të shumta që duheshin dhënë, katër për çdo semestër, në tri vitet e studimit, autori i këtyre rreshtave kishte prezantuar punime të ndryshme, ndër to edhe këtë që riprodhohet këtu. Ky punim, pa asnjë dyshim, se ka mundur të riprodhohet edhe në kapitujt e tjerë, jo vetëm të kësaj monografie, por edhe të monografisë tjetër omonime, por që trajton temat e zgjedhura nga e drejta kushtetuese. Pse?

Dy janë arsyet pse këtu në këtë kapitull riprodhohet shkrimi në fjalë, të cilin përndryshe e pata punuar me ndihmën e pakursyer të njërit prej mentorëve të mi gjatë tërë studimeve të doktoratës, përfshirë këtu edhe disertacionin tim, prof. dr. Scott Pegg (Skot Peg). Shkrimi si i tillë ka qenë pjesë e kërkesave të kursit të detyrueshëm në kuadër të programit të doktoratës që mbarova më 2001 në Universitetin Bilkent të Ankarasë, kursit "Debate të zgjedhura nga Teoria e Marrëdhënieve Ndërkombëtare" (semestri dimëror 1998-1999). Prof. Pegg ka qenë bashkëpunëtor i ngushtë dhe doktorant i profesorit të njohur dhe me renome ndërkombëtare Kalevi Holsti.

Arsyeja e parë ka të bëjë me faktin se libri i Kenneth Waltz (Keneth Uallc) paraqet pikën kthyese në debatet teorike në planin ndërkombëtar lidhur me natyrën e shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Teoretizimi të cilin Waltz ia bën shtetit dhe rolit të tij në marrëdhëniet ndërkombëtare sot e kësaj dite ngelet i debatueshëm dhe pikë referimi për çdo diskutim të shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare, rolit dhe natyrës së tij. Ne kemi marrë si shkas autorin në fjalë për të diskutuar rolin dhe natyrën e shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare, por në esencë ne flasim më shumë për shtetin në përgjithësi dhe rolin e natyrën e tij në marrëdhëniet ndërkombëtare. Pra, këtu flasim për shtetin jo vetëm nga aspekti uallcian neorelaist, kuptimi i të cilit sot e kësaj dite ofron përgjigje në shumë pyetje lidhur me luftën dhe paqen,

[61] Enver Hasani, "Kritikë konceptit shtet në një vepër të Keneth Uallc (Kenneth Waltz)". *E drejta/Law* nr. 1-4 (2000).

lidhur me akterët realë dhe fiktivë në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe çështjet të tjera të cilat lidhen me fenomenet kryesore që sot dominojnë agjendën ndërkombëtare. Flasim, me fjalë të tjera, edhe për shtetin nga këndvështrimi i autorëve të tjerë jorealistë të marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo, sepse shteti, si çdo fenomen tjetër, nuk mund të shpjegohet vetëm me një teori, sado e saktë dhe gjithëpërfshirëse që të jetë ajo. Këtë e bëjmë me qëllim që t'i tregojmë lexuesit shqip se shteti në marrëdhëniet ndërkombëtare ka shumë dimensione që nuk janë realiste dhe, megjithatë, kanë relevancë praktike.

Arsyeja e dytë që riprodukojmë këtu këtë shkrim lidhet me dy shkrimet tjera që janë pjesë e këtij kapitulli, por edhe me punimet e tjera që prekin segmente të ndryshme juridiko-ndërkombëtare dhe juridiko-kushtetuese të shtetit si fenomen shoqëror. Më këtë shkrim synojmë t'i tregojmë lexuesit shqip se aspekti juridik i shtetit në të drejtën e brendshme kushtetuese dhe në atë ndërkombëtare dallojnë diametralisht nga kuptimi shtet që ekziston në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në teorinë e tyre. Në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, kuptimi i shtetit ndryshon. Ka disa arsye pse kjo është kështu. Ndër to, më kryesorja është se, në marrëdhëniet ndërkombëtare, shtet quhet edhe një entitet si "Republika Srpska", e cila u krijua me dhunë dhe gjenocid kundër popujve tjerë joserbë, apo Rodezia e Jugut e Republika Turke e Qipros Veriore, Tajvani, Osetia e Jugut e kështu me radhë. Pse? Sepse këto entitete prodhojnë lajme, prodhojnë ngjarje, përkatësisht janë pjesë e vendimmarrjes ndërkombëtare dhe, si të tilla, kanë efekte në planin ndërkombëtar dhe në sjelljet e shteteve ndërkombëtarisht të njohura. Profesori i profesorit tim, pra Kalevi Holsti, këto fenomene kuazi-shtet në marrëdhëniet ndërkombëtare i ka trajtuar në një vepër të tij madhore ku ka ardhur deri në përfundimin se pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, shtetet e panjohura dhe entitetet tjera që janë krijuar si pasojë e kontrollit efektiv të territoreve dhe popujve të caktuar kanë sjellje tërësisht të njëjta me shtetet e tjera në marrëdhëniet ndërkombëtare[62]. Në të njëjtën kohë, këto entitete kuazi-

[62] Kalevi J. Holsti, *The State, War, and the State of War* (Cambridge UP: Cambridge, 1996); Ky libër bazohet në një studim të tij të mëparshëm, të thellë, të kryer gjatë kohës së Luftës së Ftohtë, dhe përfshin periudhën që nga Paqja e Vestfalisë deri në ditët e fundit të rënies së komunizmit. Cf. Kalevi J. Holsti, *Peace and War: Armed Conflicts and International Order 1648-1989* (Cambridge UP: Cambridge, 1991). Në këto dy studime, Kalevi J. Holsti bën krahasimin e viteve para vitit 1989 dhe atyre pas rënies së komunizmit në vitin 1990. Në rastin e dytë, sipas autorit Kelevi J. Holsti, ka ardhur deri të shkatërrimi i konceptit vestfalian të shtetit dhe kanë hyrë në skenë aktorë të rinj, apo shtetet *de facto*, së bashku me akterët e tjerë, si p.sh., organizata terroriste dhe akterët e tjerë që iu ngjasojnë shteteve, të cilët, me

shtetërore kanë prodhuar edhe fenomenin e a.q. "shtete të dobëta" ose "shtete të dështuara", të cilat nganjëherë kanë qenë pjesë e bashkësisë ndërkombëtare, si shtete formalisht të barabarta me anëtarët e tjerë, por nganjëherë kanë qenë edhe si entitete që kanë penguar zhvillimin dhe rritjen normale të shteteve të dala nga transicioni komunist[63]. Në fakt, situata e dytë tejkalon transicionin komunist pas vitit 1990 dhe lirisht sot mund t'i referohet edhe shteteve të dala nga e a.q. pranverë arabe, e cila nisi në dhjetorin e vitit 2010 në Tunizi.

sjelljet e tyre, kanë kontribuar në krijimin e të a.q. "shtete të dështuara" (*failed states*) dhe të shteteve të dobëta (*weak states*) në marrëdhëniet bashkëkohore ndërkombëtare.

[63] Fenomeni "shtete të dështuara" ose "shtete të dobëta" zakonisht diskutohet në kontekstin e debatit për sigurinë ndërkombëtare. Pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, ky debat kryesisht është lidhur me rolin e akterëve joshtetërorë në prodhimin e pasigurisë ndërkombëtare. Shih më shumë në Barry Buzan, *People, States and Fear* (Harvester Wheatsheaf: UK, 1991); Stefano Ruzza and Anja P. Jakobi, *Non-State Challenges in a Re-Ordered World: The Jackals of Westphalia* (Routledge: New Yok, 2016).

I. Vetëvendosja sipas kushteve të Marrëveshjes për Bashkim të vitit 2002 ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi: Gjurmëve të origjinës së vetëvendosjes së Kosovës

Hyrje

Unioni Serbi-Mali i Zi (më tej shkurt: "USMZ") në përgjithësi vlerësohet si mjet për parandalimin e ndarjes së mëtutjeshme të republikave përbërëse të ish-Jugosllavisë, që përfshin edhe parandalimin e pavarësisë së Kosovë në të ardhmen. Marrëveshja e muajit mars të vitit 2002[64] është nënshkruar jo vetëm për të parandaluar ndarjen e Malit të Zi, por njëherësh edhe për të kundërshtuar të drejtën e Kosovës për pavarësi. Sipas kushteve të përfshira në marrëveshje, nëse Mali i Zi largohet nga USMZ[65], sovraniteti mbi Kosovën i kthehet Serbisë. Pavarësia për Kosovën nuk parashihet as në kuadër të USMZ-së e as pas shpërbërjes së USMZ-së.

Edhe pse e ardhmja e USMZ-së është vetë e pasigurt, struktura e USMZ-së reflekton pozitën evropiane përkitazi me vetëvendosjen e Kosovës. USMZ-së nuk është vetëm një model për pozitën politike dhe ligjore të Kosovës në të ardhmen; së paku në mendjet e shumë liderëve të rëndësishëm të UE-së, ajo është një reflektim i dobishëm i kufizimeve politike të jashtme që me gjasë do të kufizojnë opsionet e tjera për Kosovën, kufizime që janë zbatuar në vazhdimësi duke u bazuar në parimet e Komisionit Badinter, në Marrëveshjen e Dejtonit, në negociatat e Rambujesë dhe së fundi, në Marrëveshjen për Union.

---

[64] Marrëveshja mbi Parimet mes Serbisë dhe Malit të Zi në kuadër të Unionit të Shteteve (2002) (në tekstin e mëtejmë: "Marrëveshja për Union"). Marrëveshja për Unionin është nënshkruar në Beograd më datën 14 mars 2002, nën mbikëqyrjen e Javier Solanës, Përfaqësuesi i Lartë i Unionit Evropian ("UE") për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë. Shpeshherë kjo marrëveshje cilësohet edhe si "Marrëveshja Solana".

[65] Dispozitat që duhen rishikuar parashikonin si vijon:

"Pas mbarimit të një kohe prej tre viteve, shtetet anëtare do të jenë të autorizuara që të nisin procedurat për ndryshim të statusit, përkatësisht për tërheqje nga Unioni. Nëse Mali i Zi tërhiqet nga Unioni atëherë dokumentet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me RFJ-në, Rezoluta e KS të OKB-së 1244 në veçanti, do t'i përkasin Serbisë, përkatësisht do të kenë të bëjnë në tërësi vetëm me Serbinë si trashëgimtare".

Dispozitat e Marrëveshjes për Union janë dëshmi e faktit se qëndrimi i Perëndimit përkitazi me vetëvendosjen e Kosovës ka qenë shumë konsekuent që nga viti 1991. Për të dëshmuar këtë konsekuencë, ky artikull gjurmon qëndrimin euro-atlantik mbi vetëvendosjen që nga opinioni i parë i Komisionit Badinter për ish-Jugosllavinë, në nëntor të vitit 1991, deri në Marrëveshjen për Union të vitit 2002.

Në këtë artikull argumentojmë se janë disa të meta fillestare në zbatimin e procesit të Marrëveshjes për Union dhe se këto probleme në zbatim kërcënojnë suksesin final të USMZ-së. Marrëveshja për Union ka gjasa të mira të mbijetojë nëse administrata ndërkombëtare qartazi ndjek rrugën dhe agjendën e UE-së në politikën e jashtme. Kjo, megjithatë, nuk është ajo që po ndodh tani.

Aktualisht, janë dy agjenda në Kosovë, njëra e ndjekur nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (më tej shkurt: "UNMIK")[66] , dhe tjetra e ndjekur nga shqiptarët e Kosovës dhe të tjerët (kryesisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës), për të cilët prioritet është siguria në Kosovë.

Asnjëra nuk është e rreshtuar në pajtim me agjendën e UE-së.

Në aspektin e përgjithshëm, agjenda e UE-së nuk është e ndërlidhur me sigurinë në veçanti, por me paqen, që definohet në aspektin e mbushjes me pushtet më shumë "të butë" se sa "të fortë" të boshllëkut të pushtetit që mbeti me të përfunduar Lufta e Ftohtë, ngjashëm me mënyrën e përshkruar nga Robert Kagan në analizën e tij të famshme të marrëdhënieve transatlantike[67]. Për dallim nga pritjet e disa liderëve evropianë, kriza e Kosovës nuk ia doli të përtërijë asnjë nga mekanizmat mbrojtës të Evropës, të cilët u formuan pas rënies së Murit të Berlinit[68].

Sfida kryesore ndaj realizimit të qëllimeve të UE-së në procesin e zbatimit të Marrëveshjes për Union ishte kohezioni i bashkimit të ri. Thënë më

---

[66] UNMIK paraqet administratën e përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Cf. përgjithësisht për këtë në Henry H. Perritt, Jr., "Introduction", në *Chicago Kent Law Review* vol 3, no. 80 (2005).

[67] Cf. me shumë në Robert Kagan, *Of Paradise and Power: America and Europe in the New World Order* (Vintage: USA, 2003); Shih poashtu edhe Zbigniew Brzezinski, *The Choice: Global Domination or Global Leadership* (Basic Books: New York, 2004) fq. 7-40. Për efektet speciale dhe konkrete të kësaj politike në Kosovë, sukseset dhe dështimet e saj, shih më shumë në Orla McBreen, "The Diplomatic Involvement of the EU in the Kosovo Crisis", në Dieter Mahncke (ed.), *Old Frontiers — New Frontiers: The Challenge of Kosovo and Its Implications for the European Union* (Peter Lang: Bern, 2001).

[68] Shih Manuel Szapiro, "Will the Kosovo Crisis Rejuvenate CFSP and European Defence?", në Dieter Mahncke (ed.), vep. cit., fq. 203.

thjesht, Marrëveshja dështon që të adresojë çështjet dhe brengat e njëjta të cilat përfundimisht edhe çuan deri tek shkatërrimi i dhunshëm dhe tragjik i Jugosllavisë, në veçanti, forcat përçarëse të nacionalizimit dhe pozita jo e volitshme e shqiptarëve në rajon karshi të tjerëve. UE-së, si faktori kryesor në procesin e hartimit të Marrëveshjes për Union, i mungojnë mekanizmat e duhur për të ndërtuar kohezionin shoqëror dhe politik brenda USMZ-së. Për më shumë, qasjes evropiane i mungon përkrahja popullore në mesin e shumicës shqiptare të Kosovës. Ka shumë të ngjarë që Marrëveshja për Union do të bëhet shkaktar i dhunës etnike dhe politike për një kohë të gjatë, pavarësisht nga niveli dhe intensiteti i punës së zellshme në terren nga personeli për politikë të jashtme i UE-së.

1. Opinionet e Komisionit Badinter

a. Më gjerësisht për Komisionin Badinter

Komisioni Badinter është një organ që është formuar në kuadër të Konferencës së Hagës për Jugosllavinë, në vitin 1991[69]. Ish-Bashkësia Evropiane ("BE", tani e njohur si "UE") udhëhoqi me Konferencën e Hagës dhe e themeloi Komisionin e Badinterit. Komisioni u emërtua sipas avokatit dhe gjyqtarit francez, Robert Badinter. Asnjë diskutim për vetëvendosjen e Jugosllavisë, format e saj dhe përmbajtjen e saj, nuk është i kompletuar pa e kuptuar punën e Komisionit. Komisioni i Badinterit e qartësoi dokumentin e a.q. *Kriteret për Pranimin e Shteteve të Reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik* (më tej shkurt: "Kriteret për Njohje").[70] Para së gjithash, Komisioni ofroi një kornizë për BE-në dhe komunitetin e gjerë ndërkombët-

[69] Cf. "Conference on Yugoslavia Arbitration Commission. Opinions on Questions Arising from the Dissolution of Yugoslavia" January 11 & July 4, 1992, *International Legal Materials* ("ILM") vol. 31, fq. 1488 (në tekstin e mëtejmë: "Mendimet e Komisionit Badinter"). Këto mendime të botuar në ILM si më sipër kanë një shënim hyrës të Maurizio Ragazzi, i cili shpjegon historikun e Komisionit Badinter.

[70] "European Community: Declaration on Yugoslavia on the Guidelines on the Recognition of New States in Eastern Europe and the Soviet Union", *International Legal Materials* vol. 31, fq. 1485 (në tekstin e mëtejmë: Deklarata e Bashkimit Evropian për Njohjen dhe Kriteret). Kriteret janë lëshuar më 16 dhjetor 1991 në formë të një deklarate që ka pasur për synim ndikimin e procesit të shpërbërjes se federatave komuniste (RSFJ, BRSS dhe Çekosllovakia).

ar, për të zgjidhur çështjet e sovranitetit dhe të vetëvendosjes në Jugosllavi[71]. Sidoqoftë, puna e Komisionit ka rezultuar me interpretime të kundërta dhe në disa raste edhe kontroverse, në mesin e akademikëve[72].

Duke ofruar këtë kornizë, Komisioni i Badinterit e trajtoi vetëvendosjen "e jashtme" krejtësisht më ndryshe nga vetëvendosja "e brendshme". Ky dallim është ndjekur nga pjesa më e madhe e përpjekjeve ndërkombëtare për të konsideruar Kosovën në kuadër të kontekstit të shpërbërjes së Jugosllavisë. Vetëvendosja e jashtme fokusohet në të drejtën e një populli për t'u shkëputur, siç është rasti në Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Maqedoni. Vetëvendosja e brendshme fokusohet në të drejtën e një populli për të pasur të drejta të caktuara individuale dhe kolektive, që respektohen brenda një shteti ekzistues[73]. Në planin ndërkombëtar, Kosova në vazhdimësi dhe në masën më të madhe është cilësuar si entitet me të drejtën për vetëvendosje të brendshme, përderisa popujt slloven, kroat, boshnjak dhe maqedonas janë trajtuar si popuj më të drejtën për vetëvendosje të jashtme.

Në mesin e vendimeve më kryesore, Komisioni konkludoi se:

1. Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë ("RSFJ") më nuk i plotësonte kriteret që e përcaktojnë një shtet[74];

2. Minoriteti serb në Bosnjë kishte të drejtë që të kërkonte respektimin e kombësisë së vet, por nuk kishte të drejtë të ndryshonte kufijtë e Bosnjës[75].

---

[71] Shih poashtu Thomas D. Grant, *The Recognition of States: Law and Practice in Debate and Evolution* (Praeger: Westport, Conn., 1999) fq. 83-121, 149-213; Steve Terrett, *The Dissolution of Yugoslavia and the Badinter Arbitration Commission: A Contextual Study of Peacemaking Efforts in the Post-Cold War World* (Ashgate: Dartmouth, 2000) fq. 69-119, 254-309; James Gow, "Serbian Nationalism and the Hissssing Ssssnake in the International Order: Whose Sovereignty? Which Nation?", *Slavonic and East European Review* vol. 72, no. 3 (July 1994) fq. 456, 461-62.

[72] Pretendimi i Komisionit Badinter për legjitimitet ndërkombëtar ka qenë më i dobët se ai i komisioneve të tjera në Afrikë që kishin të bënin me statusin e shteteve të reja atje. As ish-Jugosllavia e as republikat përbërëse të saj nuk ishin anëtare të Bashkimit Evropian, i cili vetë kishte krijuar Komisionin Badinter. Pas dekolonizimit në Afrikë gjatë viteve '60 të shekullit të kaluar, përkundrazi, shtetet në konflikt (Nigeria dhe Zaire/Kongo) ishin shtete anëtare me të drejta të plota të OUA, e cila ka debatuar për statusin e tyre.

[73] Shih Stephen Alvstad, "The Quebec Secession Issue, With an Emphasis on the 'Cultural' Side of the Equation", *Temple International and Comparative Law Journal* vol. 18, no. 89 (Spring 2004) fq. 99, fusnota 90 (ku sqarohet dallimi në mes të vetëvendosjes së brendshme dhe vetëvendosjes së jashtme).

[74] Komisioni Badinter, Mendimi nr. 1.

[75] Komisioni Badinter, mendimet nr. 2 dhe 3.

3. Ish-kufijtë e brendshëm që përcaktuan republikat në kuadër të Jugosllavisë, tashmë ishin bërë kufij të jashtëm të shteteve të reja, dhe se këta kufij nuk mund të ndryshohen pa pëlqimin e shteteve të reja[76]; dhe

4. Sllovenia[77], Maqedonia[78], Kroacia[79], dhe Republika Federative e Jugosllavisë ("RFJ"), e përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi , por jo edhe Bosnja[80], kishin të drejtë të pranohen si shtete.

Sidoqoftë, Komisioni nuk e përmendi fare situatën në Kosovë apo Deklaratën për Pavarësi të shpallur nga shqiptarët e Kosovës në vitin 1991. Vendimi i Komisionit përkitazi me paprekshmërinë e kufijve të brendshëm dhe refuzimi i kërkesës së minoritetit serb të Bosnjës për ndarje janë interpretuar përgjithësisht si refuzim i nënkuptueshëm për aspiratat e shqiptarëve të Kosovës që të ndahen na Serbia dhe të riorganizohen si një shtet i veçantë.

Me disa përjashtime[81], shkrimet akademike në pjesën më të madhe kanë hedhur poshtë deklarimet e Komisionit të Badinterit. Megjithatë, ky ku-

---

[76] Komisioni Badinter, Mendimi nr. 3. Kjo paraqet zbatim praktik të parimit *uti possidetis*, i definuar si doktrinë sipas së cilës kufijtë administrativë kolonialë kthehen në kufij ndërkombëtar në momentin kur ndarja apo nënndarja administrative koloniale e fiton pavarësinë e saj.

[77] Komisioni Badinter, Mendimi nr. 7.

[78] Komisioni Badinter, Mendimi nr. 6.

[79] Komisioni Badinter, Mendimi nr. 6.

[80] Komisioni Badinter, Mendimi nr. 6.

[81] Shih në Brad R. Roth, *Governmental Illegitimacy in International Law* (Oxford UP: Oxford, 1999) fq. 22-26; Ove E. Bring, "Correspondents' Agora: U.N. Membership of the Former Yugoslavia", *American Journal of International Law* vol. 87, no. 2 (April 1993) fq. 240-251; Antonio Cassese, "Self-Determination of Peoples and the Recent Break-Up of USSR and Yugoslavia", në Ronald St. John MacDonald (ed.), *Essays in Honour of Wang Tieya* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1994) fq. 131; 142-43; Vladimir Djuro Degan, "L'arbitrage juridique ignore : la jurisprudence de la Commission Badinter", në Marie-Françoise Allain et al. (eds.), *L'ex-Yougoslavie en Europe : de la faillite des démocraties au processus de paix* (L'Harmattan: Paris, 1997); Vladimir-Djuro Degan, "Correspondents' Agora: U.N. Membership of the Former Yugoslavia", *American Journal of International Law* vol. 87, no. 2 (April 1993) fq. 240-251; Vladimir-Djuro Degan, "Jugoslavija u raspadu: Misljenje arbitražne komisije br. 1 od 7 prosinca 1991", *Politička Misao* vol. XXVIII, nr. 4 (1991); Vladimir-Djuro Degan, "Samoodredenje naroda i teritorijalna cjelovitost država u uvjetima raspada Jugoslavije", *Naša Zakonitost* vol. 46, no. 4 (1992); George Karipsiadis, "State Succession in the Balkans: Its Impact Upon International Boundaries", në *Southeast European Yearbook* (1994); M. Kelly Malone, "Correspondents' Agora: U.N. Membership of the Former Yugoslavia", *American Journal of International Law* vol. 87, no. 2 (April 1993) fq. 240-251; Konstantin Obradović, "Problemi vezani za sukcesiju SFRJ", në Milan Šahović (ed), *Medjunarodno pravo i jugoslovenska kriza: zbornik radova* (Službeni list SRJ: Beograd, 1996) fq. 275-315; Alain Pellet, "L'activité de la Commission d'arbitrage de la Conférence européenne pour la paix en Yougoslavie", *Annuaire français de droit international* vol. 38 no. 1 (1992) fq.

ndërshtim nuk ka pasur të bëjë me vlefshmërinë e punës së Komisionit si të tillë[82], por më shumë është përqendruar në meritat e punës nga aspekti politik. Disa akademikë pohojnë se puna e Badinterit ishte joligjore, duke i paraqitur kështu të gjitha përpjekjet e Komisionit si thjesht politike[83]. Disa shkojnë edhe më larg, duke e akuzuar Komisionin si bashkëfajtor të drejtpërdrejtë dhe shkaktar të vetë tragjedisë dhe të shpërbërjes së Jugosllavisë[84]. Megjithatë, të tjerët vlerësojnë se Komisioni e zbatoi gabimisht dhe e keqinterpretoi kriterin e njohur ndërkombëtar për të qenë shtet dhe për vetëvendosje sipas së drejtës ndërkombëtare[85].

220-238; Alain Pellet, "The Opinions of the Badinter Committee: A Second Breath for the Self-Determination of Peoples", *European Journal of International Law* vol. 3, no. 1 (1992); Milan Šahović, "Raspad SFRJ i stvaranje novih država", në Milan Šahović (ed.), vep. cit., fq. 14-47.

[82] Përveç faktit që ish-Jugosllavia nuk ka qenë anëtare e Bashkimit Evropian, të gjithë akterët e dramës jugosllave kanë pranuar si legjitim punën e Komisionit Badinter. As Serbia nuk e ka mohuar legjitimitetin e Komisionit deri në momentin kur ky doli me mendimin e parë më 29 nëntor 1991. Qartë shihet se Serbia fillimisht e ka pranuar legjitimitetin e Komisionit sepse ka besuar se ai do t'i zbatojë në mënyrë dogmatike kriteret e qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare. Një zbatim i tillë dogmatik, kanë besuar serbët, do t'ia njihte ish-Jugosllavisë integritetin territorial pa asnjë rezervë, në një kohë që shteti jugosllav tanimë po kontrollohej në tërësi nga diktatori serb Sllobodan Millosheviq.

[83] Shih, ta zëmë, në John Williams, *Legitimacy in International Relations and the Rise and Fall of Yugoslavia* (Palgrave Macmillan UK: Basingstoke, 1998) fq. 130-31; 138, 140-41 (1998); Payam Akhavan, "Self-Determination and the Disintegration of Yugoslavia: What Lessons for the International Community?", në Donald Clark and Robert Williamson (eds.), *Self-Determination: International Perspectives* (Plagrave Macmillan UK: Basingstoke, 1996) fq. 227, 227-28, 233-35, 240-42; Martyn Rady, "Self-Determination and the Dissolution of Yugoslavia", *Ethnic and Racial Studies* vol. 19, no. 2 (1996) fq. 379, 382-84.

[84] Reneo Lukić and Allen Lynch, *Europe from the Balkans to the Urals: The Disintegration of Yugoslavia and the Soviet Union* (Stockholm International Peace Research Institute: Stockholm, 1996) fq. 275-281; Said Mahmoudi, "Recogntion of States: The Case of Former Yugoslav Republics", në Ove Bring and Said Mahmoudi (eds.), *Current International Law Issues: Nordic Perspectives Essays in Honor of Jerzy Sztucki* (Kluwer Law International: The Hague, 1994) fq. 135, 135-159; Raju G.C. Thomas, "Nations, States, and Secession: Lessons from the Former Yugoslavia", *Mediterranean Quarterly* vol. 5, no. 4 (Fall 1994) fq. 40, 40-65; Peter Radan, "The Badinter Arbitration Commission and the Partition of Yugoslavia", *Nationalitites Papers* vol. 25, no. 3 (1997) fq. 537-557.

[85] Këta autorë thonë se Badinteri ka pasur mundësi që ta deklarojë Bosnjë-Hercegovinën si shtet në shpërbërje e sipër që nga janari i vitit 1992, në mënyrë të njëjtë siç kishte bërë me ish-Jugosllavinë me mendimin e vet të parë disa muaj më herët, në nëntor të vitit 1991. Me fjalë të tjera, këta autorë pohojnë se Bosnjë-Hercegovina ka pasur mungesë të kontrollit efektiv të territorit dhe popullsisë në kohën kur Badinteri ka deklaruar se Bosnjë-Hercegovina është shtet (me kusht që të mbante edhe një referendum për pavarësinë). Shih më

b. Motivimi politik

Grupi i parë i kritikëve të Komisionit të Badinterit përqendrohet në kontekstin politik përbrenda të cilit Komisioni veproi. Me të shpërthyer të luftimeve, qëllimi i BE-së ishte rendi dhe stabiliteti.

BE vendosi që të përmbajë konfliktin dhe shfrytëzoi një kombinim të parimeve tradicionale dhe të ideve të reja me qëllim që të gjejë një zgjidhje politike për krizën jugosllave.

Shumë çështje në agjendën evropiane u ndërlidhën me zhvillimet e politikës ndaj Jugosllavisë, duke përfshirë edhe rolin e ardhshëm të BE-së në politikën e jashtme në rajon; marrëdhëniet ndërmjet fuqive kryesore të BE-së (veçanërisht Francës dhe Gjermanisë); si dhe marrëdhëniet ndërmjet BE-së, NATO-së dhe Unionin Evropian Perëndimor ("UEP").

Me orvatjet për të udhëhequr përpjekjet ndërkombëtare për menaxhimin e krizës në Jugosllavi, BE po futej në ujëra të paeksploruara më herët. Roli i mëhershëm diplomatik i saj përqendrohej kryesisht në marrëdhëniet tregtare[86]. Roli i BE-së në çështjet më "klasike" të politikës së jashtme ishte i kufizuar në diskutimin dhe koordinimin e pozitave përbrenda procesit të bashkëpunimit politik evropian.

Me të përfunduar Lufta e Ftohtë, arsyeja kryesore për përfshirjen e ShBA-së në çështjet e sigurisë evropiane më nuk ekzistonte, gjë që sugjeronte se udhëheqësit e ShBA-së do të ishin më pak vendimmarrës dhe se qeveria e këtij vendi do të synonte që të zvogëlojë rolin e saj.

Përkrahësit e Sigurisë dhe të Politikës së Jashtme të Përbashkët ("SPJP-ja e BE-së") vërejtën një zbrazëtirë që duhej mbushur[87]. U bënë propozimet për ringjalljen e UEP-së, si krah mbrojtës i rolit të ri për siguri të BE-së[88]. Fakti që ish-Jugosllavia nuk ishte anëtare e BE-së nuk çonte shumë peshë përballë sfidave të reja me të cilat BE-ja po ballafaqohej në atë kohë.

---

shumë në Robert M. Hayden, "Bosnia's Internal War and the International Criminal Tribunal", *The Fletcher Forum of World Affairs* vol. 45, no. 22 (Winter/Spring 1998) fq. 45, 50-51.

[86] Shih në përgjithësi për këtë në Mario Zucconi, "The West and the Balkan Conflict", në Stefano Bianchini and Robert Craig Nation (eds.), *The Yugoslav Conflict and Its Implications for International Relations* (The Modern Library: New York, 1998).

[87] Shih në Harold James, *Europe Reborn: A History, 1914-2000* (Routledge: London, 2003) fq. 386-446.

[88] Shih Saadia Touval, *Mediation in the Yugoslav Wars: The Critical Years, 1990-95* (Palgrave Macmillan UK: Basingstoke, 2002) fq. 45, 94; Georges-Marie Chenu, "Les limites des interventions européennes", në Marie-Françoise Allain et al. (eds.), *L'ex-Yougoslavie en Europe : de la faillite des démocraties au processus de paix***,** fq. 59.

c. Qasjet inovative

Puna e Komisionit të Badinterit, siç u tha më sipër, në esencë ishte një kombinim i qasjeve tradicionale dhe inventive. Në këtë kontekst, autorët që e vlerësojnë punën e këtij organi si të motivuar politikisht përpiqen të mohojnë kompetencën e punës së Komisionit. Megjithatë, të qenët inventiv dhe të gjykosh me motive politike janë dy gjëra që dallojnë mes vete.

Komisioni ishte inventiv në mënyrën se si u orvat që të arrijë qëllimet që synonte, rendin dhe stabilitetin. Për të arritur këto qëllime, Komisioni shfrytëzoi si pikë referimi vetëm kufijtë e mëhershëm administrativë të republikave jugosllave. Komisioni ndoqi shembullin e precedentëve të vendosur në Amerikën Latine, në Afrikë dhe në Azi[89]. Kjo do të thotë se Komisioni nuk vendosi një precedent të vetin, por vetëm zbatoi një rregull të vjetër në një kontekst të ri, dhe këtë e bëri në mënyrë inventive e jo sipas vlerësimeve politike.

Inovacioni përbëhej nga specifikimi i natyrës së shteteve të reja që do të dilnin nga ish-Jugosllavia dhe përgjigjja në pyetjen nëse shtetet e reja do të jenë diktatura siç ishte paraardhësi i tyre.

---

[89] Komisioni theksoi në një pjesë përkatëse si vijon:

"Komisioni është i pikëpamjes se në momentin kur procesi i shpërbërjes së RSFJ-së çon në krijimin e një ose më shumë shteteve të pavarura, atëherë çështja e kufijve, në veçanti të atyre republikanë të zënë në gjë në pyetjen që iu është parashtruar, duhet të zgjidhet në pajtim me këto parime:

"Së pari, kufijtë e jashtëm duhet të respektohen në pajtim me parimet e vëna në Kartën e OKB-së, në Deklaratën e Parimeve të së Drejtës Ndërkombëtare lidhur me Marrëdhëniet Fqinjësore dhe Bashkëpunimin mes Shteteve në pajtim me Kartën e OKB-së (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 2625 (XXV)) dhe në Aktin Final të Helsinkit, parime që po ashtu gjenden të mishëruara në nenin 11 të Konventës së Vjenës të 23 gushtit 1978 mbi Trashëgimin e Shteteve në Marrëveshjet Ndërkombëtare.

"Së dyti, kufijtë mes Kroacisë dhe Serbisë, si dhe mes Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë, por edhe mes shteteve të tjera në fqinjësi nuk mund të ndryshohen pos me marrëveshje të arritur me vullnet të lirë të palëve.

"Së treti, përveç rasteve të pajtimit tjetërfare, kufijtë e mëparshëm administrativë bëhen kufij të mbrojtur nga e drejta ndërkombëtare. Ky konstatim buron nga parimi i respektit për *status quo*-në territoriale dhe, në veçanti, nga parimi *uti possidetis*. Ky parim, fillimisht i zbatuar në zgjidhjen e çështjeve koloniale në Amerikë dhe Afrikë, sot njihet si një parim i përgjithshëm, siç e ka thënë Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë më 22 dhjetor 1986 në rastin mes Burkia-Fasos dhe Republikës së Malit ("Frontier Dispute" [1986] *ICJ Reports* 554 në fq. 565). Për më tepër, *uti possidetis* zbatohet ndaj republikave edhe për faktin se paragrafët dy dhe katër të nenit 5 të Kushtetutës së RSFJ-së në mënyrë shprehimore thotë se 'territoret e republikave dhe kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa pëlqimin e tyre'."

Komisioni Badinter, Mendimi nr. 3.

Kjo çështje u zgjidh nga Komisioni duke vendosur kushte të reja për të qenë shtet të proveniencës liberale — sundimi i ligjit, demokracia dhe respektimi i të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve[90]. Legjitimiteti i vendimeve të Komisionit të Badinterit tani e tutje do të duhej gjykuar nëpërmjet thjerrëzave të reja: qëllimi i rendit dhe stabilitetit u ndërlidh nga Komisioni me idetë liberale për sundim të ligjit, demokraci, ekonominë e tregut të lirë dhe, së fundi, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve.

Por, nëse Bosnja ende nuk ishte kualifikuar për shtetësi për shkak se pikëpamjet e shumicës së saj serbe nuk u vlerësuan sa duhet[91] dhe nëse Kroacia u pranua vetëm me kushtin që të ndryshojë Kushtetutën për të ofruar mbrojtje më të fortë për minoritetet[92], përse nënshtrimi në prapavijë i minoritetit shqiptar të Jugosllavisë praktikisht po injorohej?[93]

Shpirti inventiv i Komisionit të Badinterit nuk shkoi aq larg, por e qartësoi edhe më shumë kriterin për të qenë shtet në të drejtën ndërkombëtare. Bazuar në nevojën e shfaqur, Komisioni e mori si të mirëqenë kriterin ndërkombëtar pasi që filluan luftërat jugosllave për trashëgimi. Në përputhje me rrethanat, Komisioni minimizoi edhe parimin e kontrollit efektiv qeveritar mbi një territor dhe popullsi të caktuar, si parakusht për shtetësi të pranuar ndërkombëtarisht. Por, ky ishte një qëndrim i logjikshëm sepse sikur ta pranonte si të vlefshëm këtë kriter klasik, BE-së do t'i duhej të mbante anën e agresorit, pra, të Millosheviqit.

Pranimi i kufijve administrativë të dikurshëm si kufij të shteteve të reja nuk ishte diçka e re. Qasja e njëjtë, që rezultoi me atë që disa e karakterizojnë si "njohje e parakohshme", u shfaq në Afrikë gjatë procesit të dekolonizimit dhe për qëllim kishte mbajtjen e kolonive nën kontrollin e ish-fuqive koloniale dhe të elitave të tyre të preferuara[94].

---

[90] Mendimet përmbajnë dispozita të qarta dhe autoritative lidhur me kushtet e të qenurit shtet, të cilat i referohen respektit për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, sundimit të ligjit, dhe demokracisë. Shih Komisioni Badinter, Mendimi nr. 4 (Bosnjë-Hercegovina); Mendimi nr. 5 (Kroacia); Mendimi nr. 6 (Maqedonia); Mendimi nr. 7 (Sllovenia).

[91] Shih Komisioni Badinter, Mendimi nr. 4 (i cili konkludon se vullneti i popullit të Bosnjë-Hercegovinës për t'u bërë i pavarur nuk është shprehur në tërësi).

[92] Komisioni Badinter, Mendimi nr. 5 (i cili kushtëzon njohjen e Kroacisë me ndryshimin e kushtetutës së vet).

[93] Komisioni Badinter, Mendimi nr. 10 (i cili konkludon se RFJ (Serbia dhe Mali i Zi) paraqiste një shtet të ri, duke mos përmendur fare trajtimin e brendshëm të minoriteteve dhe kushtet e tjera që lidhen me qeverisjen moderne liberale).

[94] Për një shtjellim të gjerë të përvojës afrikane, shih në Enver Hasani, "*Uti Possidetis Juris*: From Rome to Kosovo", *The Fletcher Forum of World Affairs* vol. 27 (Summer/Fall 2003) fq. 85, 88-89.

Komisioni mori një qëndrim të ri në rastin e Jugosllavisë, duke e ndërlidhur zbatimin e këtyre kritereve tradicionale me vlerat liberale, një lidhje që qartazi mungoi në procesin e dekolonizimit të Afrikës.

Komisioni zbatoi "Kriteret për Njohje", të cilat theksonin se, gjatë marrjes së vendimit për të njohur shtetet e reja, BE dhe shtetet e tjera të bashkësisë ndërkombëtare duhet të marrin parasysh "realitetet politike në secilin rast"[95]. Ky formulim reflektonte besnikërisht realitetet politike në terren që ekzistonin në atë kohë kur filloi procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë.

Me fjalë të tjera, në kohën kur "Kriteret për Njohje" u publikuan nga BE, disa pjesë të ish-Jugosllavisë më nuk ndodheshin nën kontrollin efektiv të qeverisë federative me seli në Beograd. Në të vërtetë, nga fundi i vitit 1991, përveç Serbisë, Malit të Zi, Kosovës dhe Vojvodinës, pjesa tjetër e Jugosllavisë ishte pak a shumë nën kontrollin e autoriteteve të reja[96].

Përderisa bashkësia ndërkombëtare nuk mund të mohonte faktin se disa pjesë të Kroacisë dhe Bosnjë-Hercegovinës ishin nën kontrollin e Serbisë, kryeqytetet e këtyre republikave nuk ishin nën këtë kontroll serb. Është një praktikë e pranuar ndërkombëtarisht, e cila doli nga periudha e procesit të dekolonizimit, që asnjë njohje nuk duhet dhënë autoriteteve të cilat nuk e kanë nën kontroll kryeqytetin, edhe nëse mund të kenë nën kontroll pjesë të tjera të vendit.

Sikur Komisioni i Badinterit të zbatonte rregullën e vjetër të efikasitetit total qeveritar ndaj një popullsie dhe mbi një territor[97], do të duhej të përkrahte serbët, pasi që ata kontrollonin pjesë të mëdha të territoreve në Kroaci

---

[95] "Deklarata e Bashkimit Evropian" dhe "Kriteret për Njohje".

[96] Sa i përket Kosovës, aplikimi i saj për njohje ndërkombëtare nuk mori asnjë përgjigje në janar të vitit 1992, kur Komisioni Badinter i shpalli mendimet e veta për këtë çështje. Aplikimi i Kosovës, vlen të theksohet këtu, ka qenë parashtruar me kohë dhe në mënyrën e kërkuar nga "Kriteret". Në qarqet akademike, mungesa e kontrollit efektiv ndaj territorit dhe popullsisë së Kosovës është theksuar si shkak kryesor për mosnjohje të Kosovës si shtete sovran dhe i pavarur nga ana e Komisionit Badinter. Komisioni, siç dihet, ka folur në emër dhe me porosi të Bashkimit Evropian dhe bashkësisë ndërkombëtare. Shih më shumë në A.V. Lowe and Colin Warbrick, "Recognition of States", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 41, no. 2 (April 1992) fq. 478-482.

[97] Kriteret tradicionale për të qenë shtet janë: (1) territori; (2) popullsia; (3) autoriteti politik i organizuar apo qeveria; dhe (4) aftësia për të hyrë në marrëdhënie me jashtë. Këtë pak a shumë e ka thënë edhe Komisioni Badinter në Mendimin nr. 1. Nëse një qeveri kontrollon kryeqendrën, por jo periferinë e saj, atëherë dështon në plotësimin e kriterit të tretë. Për më tepër, një grup kryengritës që kontrollon shumicën e territorit të shtetit mund të jetë më afër plotësimit të kriterit të fundit se sa qeveria qendrore e cila kontrollon vetëm kryeqendrën.

dhe në Bosnjë. E një përkrahje e tillë do të ishte miratim i heshtur i politikës së spastrimit etnik[98].

Komisioni i Badinterit ishte inventiv në atë se i përvetësoi demokratizimin dhe respektin për të drejtat e njeriut si kritere për njohjen e shteteve të reja. Përndryshe, ai nuk bëri asgjë më shumë përveç se e shtjelloi më hollësisht anën praktike të vetëvendosjes.

Komisioni filloi punën mes shpërbërjes së Jugosllavisë dhe u mor me çështjet si trashëgimia, pavarësia, referendumet, të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, si dhe ish-kufijtë administrativë të republikave. Komisioni u detyrua të merret edhe me zbatimin e vetëvendosjes dhe me forcën e saj destabilizuese në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ndonëse vendimet e Komisionit kishin të bëjnë vetëm me shpërbërjen e Jugosllavisë, autoriteti i Komisionit tejkalonte kontekstin jugosllav, jo për shkak të fuqisë detyruese ligjore të vendimeve të saj, por për shkak të kredibilitetit moral të BE-së, si dhe të kompetencës dhe të profesionalizmit të vetë Komisionit Badinter.

2. Modeli i Dejtonit për Bosnjë-Hercegovinën dhe ndikimi i tij në statusin përfundimtar të Kosovës: Trajtimi i Kosovës në një paralele me "Republikën Serbe", në mos më keq

Marrëveshja e Dejtonit e vitit 1995[99] i dha fund luftës ndërmjet kroatëve, serbëve dhe forcave myslimane ("boshnjake") në Bosnjë-Hercegovinë.

Bosnjë-Hercegovina u nda nga Jugosllavia në vitin 1992, dhe në të njëjtën kohë, zonat serbe të Bosnjës shpallën pavarësinë e tyre. Luftimet shpërthyen pothuaj menjëherë mes myslimanëve, forcave jo të rregullta serbe, Armatës Popullore Jugosllave (më tej shkurt: "APJ") dhe forcave jo të rregullta kroate.

Serbët filluan rrethimin e Sarajevës dhe të qendrave të tjera me popullatë myslimane, dhe nisën një fushatë intensive të spastrimit etnik, duke dëbuar

---

[98] Kontrolli serb i territorit është sforcuar përmes përzënies me dhunë të popullsive joserbe, një praktikë kjo që u njoh me emrin "pastrimi etnik".

[99] Marrëveshja e Përgjithshme Kuadër për Paqen në Bosnjë-Hercegovinë, 14 dhjetor 1995, *International Legal Materials* vol. 35, fq. 75 (më tej shkurt : "Marrëveshja e Dejtonit"), anglisht: General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina, December 14, 1995, *International Legal Materials* vol. 35, fq. 75 ("Dayton Accords"). Këshilli i Sigurimit të OKB-së ka përqafuar Marrëveshjen e Dejtonit si dokument të vetin me Rezolutën Nr. 1031, miratuar në mbledhjen e vet 3607 (1995). Cf. U.N. Doc. S/RES/1031 (1995). Duke vepruar në bazë të Kapitullit të VII të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit "mirëpret dhe përkrah Marrëveshjen e Dejtonit dhe fton palët që me mirëbesim t'i plotësojnë zotimet e marra me atë marrëveshje".

myslimanët nga shtëpitë e tyre në territorin e okupuar nga forcat serbe[100]. Deri në korrik të vitit 1992, konflikti dhe spastrimi etnik kishte shpërthyer po ashtu edhe ndërmjet forcave të rregullta të Bosnjë-Hercegovinës dhe forcave jo të rregullta të kroatëve të Bosnjës, të cilët synonin që të aneksonin pjesë të Bosnjë-Hercegovinës dhe t'ia bashkëngjitnin Kroacisë[101]. Në nëntor të vitit 1995, lufta e Bosnjë-Hercegovinës përfundoi me negociatat e Marrëveshjes së Dejtonit[102].

Marrëveshja e Dejtonit u kritikua ashpër për shkak se, duke e pranuar "Republikën Serbe" si një entitet në kuadër të shtetit relativisht të brishtë të Bosnjë-Hercegovinës, heshtazi u pranuan edhe rezultatet e spastrimit etnik të boshnjakëve dhe kroatëve nga territori i "Republikës Serbe"[103].

Spastrimi etnik nga serbët ishte pjesë e një strategjie gjithëpërfshirëse për të forcuar pretendimet e serbëve ndaj territorit të tyre politik — ndoshta si pjesë të një Serbie të Madhe, apo ndoshta si shtete të pavarura të krijuara nga territori i shkëputur nga Bosnjë-Hercegovina dhe Kroacia. Krijimi dhe transformimi i entiteteve serbe në Bosnjë-Hercegovinë ishte një proces i koordinuar, i cili përfshinte jo vetëm territorin e kësaj republike, por edhe pjesë të mëdha të territorit të Kroacisë fqinje. Fillimisht, formimi i këtyre entiteteve serbe u ndërlidh me ndryshimet e reja kushtetuese që po bëheshin në Bosnjë-Hercegovinë gjatë vitit 1990[104].

Këto ndryshime u ndërmorën me qëllim të rajonizimit të republikës, me qëllim që të bëhej një shtet modern, evropian dhe pro reformave[105]. Procesi i rajonizimit në Bosnjë-Hercegovinë ishte parashikuar që të bazohej në kritere ekonomike dhe shoqërore, duke e rritur efektivitetin e tërë shtetit të Bosnjë-

---

[100] Shih më shumë në Roger Cohen, *Hearts Grown Brutal: Sagas of Sarajevo* (Random House: New York, 1998).

[101] Shih në përgjithësi për këtë në Michael A. Sells, *The Bridge Betrayed: Religion and Genocide in Bosnia* (Univ. of California Press: Los Angeles, 1996) (në të cilin libër autori nxjerr rrënimin e urës në Mostar si simbol të shkatërrimit të Jugosllavisë dhe konfliktit në Bosnjë-Hercegovinë).

[102] Shih Richard Holbrooke, *To End a War* (Random House: New York, 1998).

[103] Shih, ta zëmë, Timothy William Waters, "The Naked Land: The Dayton Accords, Property Disputes, and Bosnia's Real Constitution", *Harvard International Law Journal* vol. 40, no. 2 (Spring 1999) fq. 517, 583-584 (ku autori kritikon Marrëveshjen e Dejtonit si një instrument i cili ratifikon juridikisht "ndarjet ushtarake dhe politike të krijuara me dhunë dhe përmes një fushate të spastrimit etnik").

[104] Shih, Komisioni Badinter, Mendimi nr. 4 (ku diskutohet reforma kushtetuese në Bosnjë-Hercegovinë).

[105] Kasim Begić, *Bosna i Hercegovina od Vanceove misije do Daytonskog sporazuma: 1991-1996* (Bosanska Knjiga: Sarajevo, 1997) fq. 46-59.

Hercegovinës[106]. Megjithatë, shumë kohë para se të fillonte lufta, po bëhej gjithnjë e më e qartë se serbët nuk kishin për qëllim të bazonin konceptin e tyre të rajonizimit në kritere ekonomike dhe shoqërore, duke u mbështetur vetëm në parimin e përkatësisë etnike[107].

Këmbëngulja serbe në parimin e përkatësisë etnike përkonte në tërësi me manipulimet dhe keqinterpretimet e tyre të përgjithshme përkitazi me trendët ekzistuese ekonomike në disa pjesë të Bosnjë-Hercegovinës, të banuara nga serbët, pavarësisht nga të dhënat[108]. Kjo strategji kishte për qëllim që të shpërfaqte diskriminimin e pretenduar ekonomik të serbëve dhe zhvillimin e prapambetur ekonomik të tyre në këtë republikë. Strategjia përfshinte jo vetëm zonat ku serbët ishin në shumicë[109], por gjithashtu edhe zonat e tjera ku ata jetonin në bashkësi me të tjerët, në numër shumë më të vogël[110].

Demonstrimi i parë i kësaj strategjie, që synonte copëtimin e shtetit të Bosnjë-Hercegovinës, mori formën e një shoqate të emërtuar "Komuniteti i Komunave të *Bosanska Krajina*-s", që përbëhej nga nëntë deri në 30 komuna të Bosnjë-Hercegovinës[111]. Ky entitet u formua me një marrëveshje të pretenduar ndërmjet komunave, e quajtur *Marrëveshja për themelimin e Asociacionit të Komunave* (serbisht, *Dogovor o udruživanju u Zajednicu Općina*)[112].Ky asociacion kishte një individualitet ligjor dhe të ndarë nga organet dhe strukturat shtetërore të Bosnjë-Hercegovinës. Kjo nënkuptonte se kishte të drejtën të ushtronte të gjitha kompetencat që ishin nën juridiksionin e Republikës së Bosnjë-Hercegovinës. Më 16 dhjetor 1991, ky rajon "autonom" u transformua në "Rajoni Autonom Serb" (në serbisht *Srpska Autonomna Ob-*

---

[106] Shih, ta zëmë, preambullën e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale (Rome 1984), e cila flet për vlerat e njëjta që duhen promovuar përmes qeverisjeve lokale dhe decentralizimit të pushteteve. European Charter of Local Self-Government (October 15, 1985), në *European Treaty Series* no. 122. Për komente, shih në Guy Hollis and Karin Plokker, *Towards Democratic Decentralisation: Transforming Regional and Local Government in the New Europe* (Tacis: England, 1995).

[107] Shih Timothy William Waters, "The Naked Land: The Dayton Accords, Property Disputes, and Bosnia's Real Constitution", fq. 525.

[108] Kasim Begić, *Bosna i Hercegovina od Vanceove misije do Daytonskog sporazuma: 1991-1996*, fq. 55-79.

[109] U patën propozuar disa versione të këtij dokumenti, ashtu që numri i saktë i komunave ngelet i panjohur deri më sot. Ibid. fq. 57.

[110] Ibid.

[111] Ibid.

[112] Ibid. fq. 58.

last)[113]. Shpallja e rajonit të parë autonom serb u pasua nga veprime të njëjta në pjesë të tjera të Bosnjë-Hercegovinës. Këto veprime mbuluan gati 80 për qind të territorit të Bosnjë-Hercegovinës[114]. Entitetet e reja ushtruan juridiksionin e tyre jo vetëm mbi organet e Bosnjë-Hercegovinës, por po ashtu edhe mbi çështjet që kishin të bëjnë me mbrojtjen dhe me aspekte të tjera përkitazi me RSFJ-në.

Në të njëjtën kohë, derisa territoret autonome serbe po shfaqeshin, autoritetet serbe formuan "Kuvendin e popullit serb në Bosnjë-Hercegovinë"[115]. Kuvendi u themelua më 24 tetor të vitit 1991. Ai nxori një vendim që thoshte se serbët kishin vendosur të jetojnë në shtetin e përbashkët të Jugosllavisë, bashkë me Serbinë, Malin e Zi dhe entitetet e tjera të vetëkrijuara serbe në Kroaci. Sipas vendimit të Kuvendit, vullneti i serbëve do të demonstrohej më 9 dhe 10 nëntor 1991. Për të arsyetuar këto veprime, liderët serbë haptazi iu referuan motivit etnik në vend të shkaqeve ekonomike apo shoqërore. Ai u quajt një "plebishit", ndonëse qëllimi i vetëm i tij ishte copëtimi i shtetit të Bosnjë-Hercegovinës. Plebishiti vërtetë u mbajt në datat e sipërpërmendura, duke e bërë edhe më të qartë idenë e Serbisë së Madhe. Në mënyrë të veçantë, serbët i shtypën listat e tyre të votimit me ngjyrë të kaltër, duke i lënë listat me ngjyrë të verdhë për joserbët[116]. Ky dallim në ngjyrë u shoqërua gjithashtu edhe me pyetje të ndryshme. Joserbët u desh të përgjigjen në pyetjen nëse Bosnjë-Hercegovina duhet të mbetet republikë e barabartë, përderisa serbët u desh të përgjigjen në pyetjen e kundërt, pra, nëse ata duhet të mbeten në kuadër të Bosnjë-Hercegovinës[117].

Pas "plebishitit" të nëntorit të vitit 1991, hapi i ardhshëm i Serbisë ishte që të përfitojë sa më shumë nga rezultatet e plebishitit të mbajtur, si brenda po ashtu edhe jashtë vendit. Në rrafshin ndërkombëtar, serbët tentuan të përfaqësojnë veten në Konferencën e BE-së për Jugosllavinë, e cila po mbahej

---

[113] Si krijimi, ashtu edhe transformimi i tyre në regjione autonome, fillimisht qe arsyetuar me koncepte ekonomike dhe sociale, në ndërkohë që shihet hapur se kriteri etnik përbënte forcën kryesore shtytëse. Kjo u bë e qartë me kalimin e kohës, në veçanti pas zbulimit të një plani serb që synonte shpërbërjen totale të Bosnjë-Hercegovinës përgjatë vijave etnike. Ky plan u hartua në shtator të vitit 1991 në emër të "shkencës" dhe "profesionit", por që qartë ofronte zgjidhjen etnike si parim bazë për regjionalizimin e Bosnjë-Hercegovinës. Faktorët ekonomikë dhe socialë qenë manipuluar dhe keqinterpretuar me qëllim që t'i shërbenin parimit etnik të ndarjes së Bosnjë-Hercegovinës. Ibid. fq. 58-60.

[114] Ibid. fq. 59.

[115] Ibid. fq. 60.

[116] Ibid. fq. 61.

[117] Ibid. fq. 61.

në Hagë, si palë e ndarë në raport me organet e tjera ligjore të Bosnjë-Hercegovinës. Brenda vendit, udhëheqësit serbë shfrytëzuan rezultatet e "plebishitit" për të avancuar shpalljen përfundimtare të "Republikës së Popullit Serb të Bosnjës-Hercegovinës", më 9 janar 1992. Ky transformim i entiteteve të dikurshme autonome në një republikë të vetme u bë me shpresën se ajo do të pranohet ndërkombëtarisht si njësi federative në kuadër të RSFJ-së, federatës jugosllave që ende ekzistonte, dhe në rast se kjo dështon, të njihet si shtet i pavarur dhe sovran[118].

Strategjia dështoi. Në opinionin e dhënë në janar të vitit 1992, Komisioni i Badinterit për ish-Jugosllavinë ishte në favor të njohjes së Sllovenisë dhe të Maqedonisë[119]. Ndërsa për Bosnjën dhe Kroacinë, Komisioni vendosi disa kushte që këto dy republika jugosllave duhej t'i përmbushnin, para se t'u pranohej e drejta e njohjes ndërkombëtare. Komisioni kërkoi mbajtjen e një referendumi në Bosnjë-Hercegovinë dhe që të drejtat e minoriteteve në Kroaci të respektoheshin[120]. Liderët serbë shfrytëzuan kushtet e vendosura si

---

[118] Kjo "republikë" bëri njohjen e së njëjtës që ekzistonte në Kroaci. Ibid. fq. 63-64. Kjo tregon se serbët kanë besuar se vetëm entitetet e tipit republikë mund të fitonin njohjen ndërkombëtare. Një pikëpamje e tillë mbështetej në mendimin e nëntorit 1991 të Komisionit Badinter, në mendimin e parë të tij.

[119] Shih Komisioni Badinter, mendimet nr. 6 dhe 7. Për komentet akademike, shih në Steve Terrett, *The Dissolution of Yugoslavia and the Badinter Arbitration Commission: A Contextual Study of Peacemaking Efforts in the Post-Cold War World.*

[120] Në rastin e Kroacisë, Komisioni Badinter konsideroi se:

"i. Ligji Kushtetutës i 4 dhjetorit 1991 nuk i përfshinë në tërësi dispozitat e draft-marrëveshjes së 4 nëntorit 1991, në veçanti ato që kanë të bëjnë me Kapitullin II, neni 2(c), me titull "statusi special";

"ii. autoritet e Republikës së Kroacisë duhet për këtë arsye të bëjnë plotësimin e Ligjit Kushtetues ashtu që ai t'i përmbajë dispozitat e sipërcekura; dhe

"iii. me këtë rezervë, Republika e Kroacisë i ka plotësuar kushtet e domosdoshme për njohje nga ana e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian në pajtim me Deklaratën për Jugosllavinë dhe Kriteret për Njohje të Shteteve të Reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik të datës 16 dhjetor 1991".

Komisioni Badinter, Mendimi nr. 5.

Në rastin e Maqedonisë, Komisioni Badinter konstatoi se:

"Republika e Maqedonisë ka plotësuar testin e Kritereve për Njohje të Shteteve të Reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik dhe në Deklaratën për Jugosllavinë të datës 16 dhjetor 1991;

"Republika e Maqedonisë, për më tepër, ka hequr dorë nga të gjitha kërkesat për territor në deklaratat e saj të detyrueshme sipas të drejtës ndërkombëtare, kështu që emri 'Maqedonia' nuk paraqet asnjë kërkesë territoriale ndaj asnjë shteti tjetër; dhe

"Republika e Maqedonisë ka marrë detyrime formale në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, sipas të cilit detyrim dhe në pajtim me nenin 49 të Kushtetutës së saj, asnjë propagan-

pretekst për të bojkotuar referendumin, i cili u mbajt më 29 shkurt dhe 1 mars të vitit 1992. Pas kësaj, udhëheqësit serbë kërcënuan hapur se do të shpallnin pavarësinë e tyre nëse Bosnjë-Hercegovina do të njihej si shtet i pavarur dhe sovran. Me këto veprime, serbët tentuan që të justifikojnë paraprakisht spastrimin etnik të të gjithë joserbëve nga entitetet e tyre. Interpretimi se kush është shtet sipas së drejtës ndërkombëtare nga serbët ishte arbitrar dhe tërësisht i gabuar. Ata besonin se vetëm entitetet e llojit të republikës do të njiheshin ndërkombëtarisht, pavarësisht nga mënyra në të cilën ato ishin krijuar[121].

Në përputhje me këtë mënyrë të menduarit, serbët shpallën "republikën e pavarur" të tyre, pas njohjes ndërkombëtare të Bosnjë-Hercegovinës më 6 dhe 7 prill 1992[122]. Megjithatë, këtë herë serbët e Bosnjë-Hercegovinës hoqën dorë nga ideja e mbetjes në Jugosllavinë që po shpërbëhej rrufeshëm. Vetëm disa muaj pas shpalljes së kësaj "republike të pavarur", serbët arritën që spastrojnë etnikisht gati 70 për qind të territorit të Bosnjë-Hercegovinës, duke siguruar kështu bazën territoriale për "shtetin" e tyre të ri[123]. Me shpresën që të fitojnë njohjen ndërkombëtare falë politikës së tyre të *fait accompli* ("faktit të kryer"), serbët e braktisën idenë e vjetër të jugosllavizmit dhe në vend të kësaj u përqendruan në projektin e Serbisë së Madhe, që mbështetej tërësisht në politikën e spastrimit etnik të joserbëve[124].

Reagimet fillestare nga bashkësia ndërkombëtare, përfshirë BE-në, ishin thuaja tërësisht në favor të pranimit të kërkesës serbe për të qenë shtet sipas së drejtës ndërkombëtare[125]. Kjo u konsiderua si përkrahje e hapur për ndarjen e Bosnjë-Hercegovinës në dy apo tri shtete, të ndara në vija etnike. Sllobodan Millosheviqi në përgjithësi dyshohej për këmbënguljen në realizimin e qëllimit të tij për formimin e Serbisë së Madhe, porse tani vëmendja

---

dë armiqësore kundër ndonjë shteti tjetër nuk do të kryhet nga ana e saj; kjo buron nga deklarata e ministrit të jashtëm maqedon dërguar Komisionit Badinter më datën 11 janar 1992, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për qartësim të amendamentit kushtetues nr. II të datës 6 janar 1992".

Komisioni Badinter, Mendimi nr. 6.

[121] Shih, Kasim Begić, *Bosna i Hercegovina od Vanceove misije do Daytonskog sporazuma: 1991-1996*, fq. 31-44; Steve Terrett, *The Dissolution of Yugoslavia and the Badinter Arbitration Commission: A Contextual Study of Peacemaking Efforts in the Post-Cold War World*, fq. 254-308.

[122] Joze Pirievec, *Le guerre jugosllave, 1991-1999* (Einaudi: Torino, 2001) fq. 145-146.

[123] Ibid. fq. 153-55.

[124] James Gow, *The Serbian Project and Its Adversaries: A Strategy of War Crimes* (Hurst: London, 2003) fq. 118-144.

[125] Ibid. fq. 145-223 dhe 263-309.

ishte zhvendosur në pretendimet e serbëve të Bosnjë-Hercegovinës për pavarësi. Vetëm Marrëveshja e Dejtonit e vitit 1995, e miratuar nën udhëheqjen e ShBA-së, ia doli të mposhtë këtë parim etnik[126]. Planet e tjera për paqe, siç ishin: plani i Cutilieros (Kutiljero), plani Vance-Owen (Vens-Ouen) dhe plani Owen-Stoltenberg u hartuan në përputhje me parimin etnik[127].

Kjo megjithatë nuk do të thotë se BE e parashikoi parimin etnik si kriter bazë për vetëvendosjen e brendshme apo të jashtme, në territorin e ish-Jugosllavisë. Për dallim, në dokumentet e saj, BE u mbështet në parimin e territorialitetit, duke marrë si pikë referimi republikat jugosllave[128]. Për të qenë më e sigurt BE-ja e plotësoi qasjen e saj ndaj parimit tradicional të territorialitetit, duke shpallur këto kritere të reja: sundim të ligjit, demokraci dhe respektim i të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve[129]. Por, në praktikë, pasi që u shfaqën problemet për zbatimin e këtyre kushteve, parimi territorialo-etnik megjithatë dominoi, duke rezultuar në tolerimin e politikës serbe të spastrimit etnik.

Në mënyrë logjike, parimet themelore të Marrëveshjes së Dejtonit në bazë të së cilave edhe u trajtua "Republika Serbe" në kuadër të Bosnjë-Hercegovinës, sikur paralajmëruan përkrahjen ndërkombëtare për autonominë, apo gjysmë-pavarësinë e Kosovës, në kuadër të Serbisë. Kjo për faktin se, në të vërtetë, Kosova në dukje kishte një pretendim më të fuqishëm për njohje ndërkombëtare sesa "Republika Serbe". "Republika Serbe" ishte përfituese e politikës së spastrimit etnik dhe të gjenocidit kundër një populli të tërë, përderisa Kosova kishte një bazë territoriale të qartë dhe një popullatë etnike dominuese, e cila edhe vetë ishte viktimë e politikës serbe të spastrimit etnik.

Kjo logjikë si më sipër, megjithatë, nuk u zbatua në praktikë. Përpjekjet për të spastruar etnikisht Kosovën nga popullata e saj joserbe u parandaluan nga aksioni ushtarak i NATO-s, që u ndërmor nga muaji mars deri në qershor të vitit 1999. Kosova ligjërisht mbetet pjesë e USMZ-së, që e bën të dy-

---

[126] Marrëveshja e Dejtonit, e cekur si më sipër.

[127] Për një diskutim të detajuar të katër propozimeve për paqe në Bosnjë-Hercegovinë, në veçanti të atyre gjatë viteve 1992-1995 që bazohen në kritere etnike (në fakt, të gjitha propozimet e tjera përveç Marrëveshjes së Dejtonit), shih më shumë në Kasim Begić, *Bosna i Hercegovina od Vanceove misije do Daytonskog sporazuma: 1991-1996*, fq. 100-197; Aleksandar Pavković, *The Fragmentation of Yugoslavia: Nationalism and War in the Balkans* (Palgrave Macmillan UK: Basingstoke, 2000) fq. 155-193; Wolfgang Petrisch, *Bosna i Hercegovina od Daytona do Evrope* (Svjetlost: Sarajevo, 2000).

[128] Shih te "Deklarata e Bashkimit Evropian" dhe "Kriteret për Njohje".

[129] Ibid. Për komente akademike, shih te Thomas D. Grant, *The Recognition of States: Law and Practice in Debate and Evolution*, fq. 149-198.

shimtë pretendimin se projekti i Serbisë së Madhe është mposhtur në Kosovë. Mund të ndodh që regjimi në Beograd ka qenë i suksesshëm në ruajtjen e sovranitetit të tij mbi territore të mëdha të pabanuara nga shumica serbe, duke mos i lënë kështu zgjidhje tjetër bashkësisë ndërkombëtare veç se të marrë rolin e kujdestarit të projektit të Serbisë së Madhe, realizimi brutal dhe i dhunshëm i të cilit me gjasë është shtyrë deri në ndonjë ditë tjetër kur baraspesha ndërkombëtare e forcave të ndryshojë në favor të Serbisë. Me qëllim që të zvogëlohen gjasat e kësaj perspektive shqetësuese, pjesa në vijim trajton aktivitetet për vetëvendosje të shqiptarëve të Kosovës, si para konfliktit të vitit 1998 në Kosovë, ashtu edhe pas intervenimit ushtarak të NATO-s. Përballë zhvillimeve të trajtuara në pjesën në vijim, Marrëveshja e Dejtonit paraqet një precedent të fuqishëm për një marrëveshje të sanksionuar ndërkombëtarisht, e cila u garanton shqiptarëve të Kosovës së paku autonominë e njëjtë me atë që e gëzojnë serbët në "Republikën Serbe".

3. Marrëveshja e Rambujesë dhe modeli i saj i vetëvendosjes: Krahasimi i modelit të Rambujesë me atë të Dejtonit

Marrëveshja e Rambujesë ishte rezultat i përpjekjes së pasuksesshme të Grupit të Kontaktit për ish-Jugosllavi për të ndërmjetësuar zgjidhjen e një konflikti gjithnjë e më të dhunshëm ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (më tej shkurt: "UÇK") dhe forcave serbe në Kosovë në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999[130]. Refuzimi i Serbisë që të pajtohet me këtë marrëveshje përshpejtoi fushatën e bombardimeve të NATO-s. Për më shumë, përmendja e Marrëveshjes së Rambujesë në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si model i pjesshëm për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës, i jep Marrëveshjes së Rambujesë zbatueshmëri të vazhdueshme[131].

---

[130] Grupi i Kontaktit paraqet një grupim joformal të këtyre vendeve: ShBA-së, Francën, Gjermaninë, Italinë dhe Rusinë. Rusia u fut në këtë grupim të vendeve perëndimore si përgjigje ndaj krizës në Bosnjë-Hercegovinë. Më vonë, Bashkimi Evropian u bashkua me këtë grupim për të koordinuar politikat e Kosovës me ato të UNMIK-ut. Bisedimet në Rambuje ndodhën nga 6 deri më 23 shkurt 1999. Këto bisedime zyrtarisht u mbyllën me nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë në Paris më datën 19 mars 1999.

[131] Shih *Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo* (February 23, 1999), U.N. Doc. S/1999/648 (June 7, 1999). Rezoluta 1244 e KS të OKB-së e datës 10 qershor 1999 përmban në vetvete edhe Marrëveshjen e Rambujesë dhe reflekton, në aspektin teleologjik (qëllimor), të njëjtin synim për sa i përket zgjidhjes së statusit të ardhshëm të Kosovës.

Pas Marrëveshjes së Dejtonit të vitit 1995, njëri nga liderët më me ndikim të opozitës në Serbi, Dragoljub Miçunoviq, u tha mediave se Serbia ndihej e relaksuar për shkak se bashkësia ndërkombëtare i pranoi kufijtë e saj si kufij ndërkombëtarë dhe se territori i Kosovës ishte përfshirë brenda atyre kufijve[132]. I njëjti opinion dominoi edhe në qarqet e regjimit serb dhe që atëherë është ritheksuar shpesh në publik[133]. Kur përputhja ndërmjet këtij qëndrimi dhe qëndrimit të bashkësisë ndërkombëtare, se kufijtë e pranuar ndërkombëtarisht nuk mund të ndryshohen, krahasohen me kërkesën e shqiptarëve të Kosovës për pavarësi, zbulojnë dy gjëra thelbësore përkitazi me veprimet e NATO-së kundër RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi) në mars-qershor të vitit 1999 dhe pasojat e tyre të mundshme për të ardhmen e Kosovës.

Çështja e parë ka të bëjë me vetë bashkësinë ndërkombëtare, përderisa çështja e dytë ka të bëjë me Kosovën dhe mundësitë e saj që të bëhet shtet i pavarur.

Qëndrimi i lartpërmendur në qarqet serbe nuk flet për asgjë tjetër përveç se për një orientim të caktuar politik që dominon pjesën më të madhe të shoqërisë serbe. Ky orientim si pikë referimi e ka shtetin, e jo popullatën apo individët e rëndomtë. Përkitazi me çështjen e kufijve dhe të vetëvendosjes në përgjithësi, mentaliteti serb përkon me qasjen e bashkësisë ndërkombëtare pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Por, kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se vetë bashkësia ndërkombëtare e ka krijuar këtë orientim politik të serbëve. Orientimi aktual brenda Serbisë buron më shumë nga vetë natyra e nacionalizmit serb. Megjithatë, qëndrimi i bashkësisë ndërkombëtare mbi paprekshmërinë e kufijve të dikurshëm administrativë vetëm sa i ka betonuar mitet serbe në lidhje me Kosovën dhe të drejtën e supozuar të serbëve për sundim

---

[132] Megjithatë, pesë vite më vonë Dragoljub Miçunoviq (Mičunović) nuk dukej i sigurt lidhur me këtë çështje. Duke kritikuar planet për shkëputje të kësaj republike në qershor 2001 (afati i fundit për mbajtjen e referendumit për pavarësi të kësaj republike), ai tha se shkëputja e Malit të Zi nga RFJ (Serbia dhe Mali i Zi) e bën shumë me gjasa shkëputjen e Kosovës, duke vënë në këtë mënyrë në rrezik ekzistencën e RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi). Shih për këtë në: *Radio Slobodna Evropa* (1 prill 2001) (radio "Evropa e Lirë", programi në gjuhët e sllavëve të jugut).

[133] Lidhur me të a.q. Marrëveshje e Kumanovës, e cila ka mundësuar hyrjen në Kosovë në qershor të vitit 1999 të trupave të NATO-s, si dhe nxjerrjen e Rezolutës 1244 të KS të OKB-së më 10 qershor 1999, shefi i shtabit të ushtrisë jugosllave (serbo-malazeze) Nebojsha Pavkoviq (Nebojša Pavković), i tha medies në Beograd se ata, pra serbët, mbanin "tapitë" e Kosovës sepse dy dokumentet e sipërcekura njohin (pranojnë) dhe garantojnë integritetin dhe sovranitetin e RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi). Shih *Radio Slobodna Evropa* (17 dhjetor 1999) (radio "Evropa e Lirë", programi në gjuhët e sllavëve të jugut).

të padiskutueshëm me popullatën shumicë të Kosovës[134]. Pse i ishte dhënë regjimit në Beograd ky zotim për paprekshmërinë e kufijve të Serbisë? A ishte çështje e parimit ligjor apo thjesht çështje e realpolitikës ajo që mori parasysh faktorët e tjerë gjeopolitikë dhe gjeostrategjikë, e posaçërisht një dëshirë ndërkombëtare për të shmangur inkurajimin e lëvizjeve separatiste në Irlandën e Veriut, Tibet, Çeçeni, Kuebek, Bosnjë-Hercegovinë dhe Maqedoni? Do të përpiqemi t'u japin një përgjigje këtyre pyetjeve në paragrafët vijues.

Kur të diskutohet çështja e intervenimit të NATO-s kundër RFJ-së (Serb dhe Mali i Zi) shfaqen dy dilema. Së pari shfaqet dilema e realpolitikës, e bazuar në interesat gjeopolitike dhe gjeostrategjike, që do të thotë se paprekshmëria e ish-kufijve republikanë nuk ishte qëllim në vete, por më shumë një efekt anësor i brengosjes së NATO-s për paqen dhe sigurinë në Ballkan (dhe gjetiu në territoret e anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara). Pastaj shfaqet dilema e mbështetur në interesin humanitar, për shkak se shqetësimet rreth situatës humanitare ishin një qëllim i shprehur publikisht nga zyrtarët e NATO-s, si para e po ashtu edhe pas intervenimit kundër RFJ-së[135]. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në atë

---

[134] Për pikëpamje të ngjashme, shih Greg Campbell, *The Road to Kosovo: A Balkan Diary* (Westview Press: Oxford, 1999); Tim Judah, *Kosovo: War and Revenge* (Yale UP: Yale, 2000); Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History* (New York UP: New York, 1998); Julie A. Mertus, *Kosovo: How Myths and Truths Started a War* (Univ. of California Press: Los Angeles, 1999); Shlomo Avineri, "The Future of Kosovo", *East European Constitutional Review* vol. 8, no. 3 (Summer 1999) fq. 79; Warren Zimmermann, "The Demons of Kosovo", *National Interest* issue 52 (Spring 1998) fq. 5-6; Aleksa Djilas, "Imagining Kosovo: A Biased New Account Fans Western Confusion", *Foreign Affairs* (September-October 1998) fq. 124 (recension libri).

[135] Ky qëllim është bërë i qartë në deklaratën speciale të Këshillit të NATO-s të datës 8 dhjetor 1998, ku thuhet si vijon: "NATO ka pasur për qëllim që të kontribuojë në përpjekjet ndërkombëtare për të ndaluar krizën humanitare në Kosovë, për të ndaluar dhunën atje, si dhe për të siguruar një zgjidhje permanente të çështjes së Kosovës". QIK, *Informatori ditor* nr. 2264B (8 dhjetor 1998). Në anën tjetër, studiuesit nuk janë të bashkuar rreth motiveve reale të veprimeve të NATO-s në Kosovë dhe rreth asaj se si duhen interpretuar në të ardhmen këto veprime. Autorët më me ndikim, siç janë Thomas Frank dhe Antonio Cassese, kanë favorizuar konsideratat humanitare. Shih: Thomas M. Franck, "Lessons of Kosovo", *American Journal of International Law* vol. 93, no. 4 (1999); Antonio Cassese, "*Ex iniuriaius oritur*: Are We Moving Towards International Legitimation of Forcible Humanitarian Countermeasures in the World Community?", *European Journal of International Law* vol. 10, no. 1 (1999); Richard A. Falk, "Kosovo, World Order, and the Future of International Law", *American Journal of International Law* vol. 93, no. 4 (October 1999); Louis Henkin, "Kosovo and the Law of 'Humanitarian Intervention'", idem.; Ruth Wedgwood, "NATO's Campaign in Yugoslavia", idem.

kohë, Javier Solana, përmendi shqetësimet rreth situatës humanitare vetëm një ditë para se sulmet ajrore të fillonin më 24 mars 1999[136]. Në fakt, në arsy-

---

Autorët tjerë kanë përkrahur veprimet ushtarake të NATO-s kundër RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi), por me disa rezerva. Këta kanë argumentuar se rasti i Kosovës nuk duhet të shërbejë si precedent në të ardhmen, por të merret si një përjashtim që buron si rezultat e rrethanave regjionale. Kosova, thonë këta autorë, i takon Evropës kur cenimet masive të të drejtave të njeriut nuk mund të tolerohen. Shih më shumë në W. Michael Reisman, "Kosovo's Antinomies", *American Journal of International Law* vol. 93, no. 4 (October 1999). Në fakt, shumica e autorëve mbajnë qëndrimin se rrethana që Kosova gjendet në Evropë ka luajtur një rol të madh në vendimmarrjen e NATO-s për ta sulmuar RFJ (Serbi dhe Mali i Zi).

Grupi i fundit i autorëve, të zënë në gojë si më poshtë, nuk përkrahin veprimet e NATO-s kundër RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi), duke theksuar si pengesë sovranitetin dhe parimin e mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve sovrane dhe të pavarura. Shih më shumë në Jonathan Chamey, "Anticipatory Humanitarian Intervention in Kosovo", *American Journal of International Law* vol. 93, no. 4 (October 1999); Christine M. Chinkin, "Kosovo: A 'Good' or 'Bad' War?", po aty; Mary Ellen O'Connell, "The U.N., NATO, and International Law After Kosovo", *Human Rights Quarterly* vol. 22, no. 1 (February 2000); Bruno Simma, "NATO, the U.N. and the Use of Force: Legal Aspects", *European Journal of International Law* vol. 10, no. 1 (1999). Sa i përket vetë NATO-s, zyrtarët e saj e kanë bërë disa herë të qartë se vendimi për të sulmuar RFJ-në (Serbi dhe Mali i Zi) nuk ka vënë asnjë precedent për vendimet e saj në të ardhmen, përkundër frikës së rusëve dhe disa tjerëve në Evropën lindore që shpresojnë se kjo mund ta frikësojë zgjerimin rus në Evropë. Shih Paul Goble, "Another Precedent From Kosovo?", *RFE/RL Newsline* (November 9, 2000).

[136] Shih kumtesën për shtyp të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s: Press Statement by Dr. Javier Solana, Secretary General of NATO (23 mars 1999).

Kur filloi sulmi ajror, NATO më shpesh nisën të flasim për konsiderata humanitare si bazë e sulmeve kundër RFJ (Serbia dhe Mali i Zi). Shih Bill Clinton, *Ne luftën, ju paqen: mesazhe, artikuj, konferenca shtypi, intervista dhe fjalime për Kosovën*, Lutfi Dervishi, përkth. (Tiranë, 2000). Në kuptim të suksesit apo dështimit të fushatës së NATO-s kundër RFJ-së (Serbi dhe Mali i Zi), me rëndësi është të kuptohen synimet e mëhershme të NATO-s. Këto synime kanë ndryshuar gjatë fushatës ajrore. Kështu, ta zëmë, në fillim administrata amerikane e Presidentit Clinton qarkulloi tri qëllime të cilat synoheshin: (1) "demonstrimi i seriozitetit të NATO-s për ta kundërshtuar agresionin"; (2) frikësimi i Millosheviqit për të vazhduar dhe ngritur sulmet kundër Kosovës; dhe (3) dëmtimi i aftësisë së Serbisë për të bërë luftë në të ardhmen". R.W. Apple, Jr., "A Fresh Set of U.S Goals", *New York Times* (25 March 1999); shih poashtu Barton Gellman, "Allies Facing the Limits of Air Power", *Washington Post* (28 March 1999). Të njëjtat synime janë shprehur në deklaratat e zyrtarëve të lartë gjatë tërë fushatës ajrore të NATO-s. Këto deklarata kërkonin që Sllobodan Millosheviqi të ndalonte represionin në Kosovë, të tërhiqte trupat nga Kosova, të pajtohet për vendosjen e një pranie ndërkombëtare ushtarake në Kosovë, kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur nëpër shtëpitë e tyre, të shpreh gatishmërinë e qartë për të punuar në kuadrin politik përgjatë vijave të skicuara në Rambuje. Shih: NATO Secretary General Javier Solana, Press Conference after the Extraordinary Meeting of the North Atlantic Council at Foreign Ministers Level (April 12, 1999); Press Release, NATO, Statement on Kosovo Issued by the

etimin e dhënë për përdorimin e sulmeve ajrore kundër RFJ-së, zyrtarët e NATO-s pothuajse iu referuan vetëm shqetësimeve rreth situatës humanitare. Siç do të shohim në vijim, kjo megjithatë nuk ndodhi gjatë fazave të hershme të konfliktit në Kosovë, në shkurt-mars 1998. Sidoqoftë, pavarësisht nga roli i shqetësimeve të shfrytëzuara në arsyetimin e fushatës së bombardimeve, më shumë përkitazi me situatën humanitare sesa atë politike, rezultati përfundimtar i sulmeve ajrore të NATO-s ishte ruajtja e integritetit territorial të RFJ-së dhe, si rrjedhojë, imponimi i vetëvendosjes së brendshme në vend të pavarësisë për Kosovën në aspektin afatgjatë. Kjo përkrahet qartazi me dy dispozita të Rezolutës 1244 të KB-ve, të cilat konfirmojnë sovranitetin e Serbisë dhe rekomandojnë një status final për Kosovën që siguron autonominë[137].

Referimi në shqetësimet për situatën humanitare nuk mund të shpjegojë në tërësi fushatën ajrore të NATO-s kundër RFJ-së. Ky argument buron nga ngjarjet para dhe pas fushatës ajrore, që përfshijnë periudhën nga janari deri në qershor të vitit 1999. Përderisa NATO publikisht e shfaqi aprovimin dhe përkushtimin e saj ndaj Rezolutës 1244, çështja e situatës humanitare në këtë dokument të OKB-së nuk u parapriu çështjeve si kufijtë dhe, para së gjithash, ruajtja e paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar, si dhe zgjidhja e statusit përfundimtar të Kosovës. Në të vërtetë, Rezoluta 1244 është aktualisht baza e vetme ligjore në të cilën gjejnë mbështetje si prezenca ushtarake e po ashtu edhe ajo civile e administratës ndërkombëtare në Kosovë[138]. Për më shumë, kur Grupi i Kontaktit e lëshoi një deklaratë më 19 janar 1999, duke shprehur pajtimin që të ftojë në Rambuje (Rambouillet, qytet në jugperëndim të kryeqytetit francez, Paris) përfaqësuesit e qeverisë së RFJ-së, të qeverisë së Serbisë, si dhe përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës, krizën humanitare në Kosovë ia atribuoi çështjeve politike dhe sugjeroi që zgjidhjet politike, për situatën e ndërlidhur me paqen, stabilitetin dhe integritetin territorial të RFJ-së, si dhe të shteteve të saj fqinje, ishin zgjidhja e vetme e qëndrueshme edhe për krizën në Kosovë[139]. Kjo deklaratë u përkrah plotësisht nga NATO më 30

Heads of State and Government Participating in the Meeting of the North Atlantic Council in Washington, D.C. on 23rd and 24th April 1999 (April 23, 1999).

[137] Shih, Rezoluta 1244 e KS të OKB-së e datës 10 qershor 1999, e diskutuar më sipër.

[138] Ibid.

[139] Shih QIK, *Kosovo Daily Report No. 1677* (Prishtina, January 29, 1999); "Big Powers Demand Deal on Kosovo Within Weeks", *HRI* (January 29, 1999). "Contact Group Sets Deadline", *RFE/RL Newsline* (February 15, 1999).

janar 1999[140]. Si në deklaratën e NATO-s e po ashtu edhe në miratimin e kësaj deklarate nga OKB, të gjitha rezolutat e mëparshme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së përkitazi me këtë çështje ishin marrë parasysh në tërësi, duke përforcuar kështu përkushtimin e bashkësisë ndërkombëtare ndaj integritetit territorial të RFJ-së dhe ndaj ruajtjes së stabilitetit dhe të paqes në rajon[141].

Ky qëndrim i bashkësisë ndërkombëtare e karakterizoi tërë procesin negociator të Rambujesë. Të ashtuquajturat "parime të panegociueshme", që u vunë në tavolinë për nënshkrim, si parakusht për çdo diskutim të mëtutjeshëm rreth Marrëveshjes së Rambujesë, e theksuan paprekshmërinë e kufijve të RFJ-së, duke lënë të kuptohet se çdo zgjidhje duhej të gjendej në kuadër të sovranitetit dhe të integritetit territorial të RFJ-së[142]. Në aspektin e vetëvendosjes, kjo do të thoshte se Kosova dhe popullata e saj shumicë do të duhej të mbeteshin të kënaqura me të drejtën e brendshme për vetëvendosje. Kjo nuk ishte diçka e re për shqiptarët e Kosovës, por ata nuk deshën dhe ende nuk duan të besojnë se e drejta e tyre për vetëvendosje është e kufizuar në vetëvendosjen e brendshme. Më herët, bashkësia ndërkombëtare e emërtoi të drejtën për vetëvendosje të brendshme si, "autonomi substanciale për Kosovën"[143]. Megjithatë, përveç disa krahasimeve të zbehta me autonomitë e tjera

---

[140] Shih "NATO Statement on Kosovo", *HRI* (January 31, 1999).

[141] Shih, Rezoluta e KS të OKB-së 1160. U.N. SCOR, 53d Sess., 3868th mtg., U.N. Doc. S/RES/1160 (1998); S.C. Res. 1203, U.N. SCOR, 53d Sess., 3937th mtg., U.N. Doc. S/RES/1203 (1998).

[142] Shih, Marrëveshja e Rambujesë, e diskutuar më sipër.

[143] Në të kaluarën kanë qarkulluar modele të ndryshme për autonominë e Kosovës. Disa janë propozuar nga bashkësia ndërkombëtare e tjerat nga vetë palët. Shih, Dimimos Triantaphyllou, "Kosovo Today: Is There No Way Out of the Deadlock?", *European Security* vol. 5 (1996) fq. 291-92; Zoran Lutovac, "Options for Solution of the Problem of Kosovo", *Review of International Affairs* vol. 48 (15 May 1997) fq. 10-12.

Modeli i parë konsistonte në dhënien e një lloj autonomie për Kosovën, ngjashëm me atë që kishte gëzuar vendi sipas Kushtetutës së vitit 1974. Cf. Zoran Lutovac, "Options for Solution of the Problem of Kosovo", fq. 10-12. Një propozim i tillë është përsëritur kryesisht nga qarqet ndërkombëtare. Si i tillë qe bërë publik edhe nga Grupi Special për Kosovën, i cili operonte në kuadër të Grupit Punues për Pakicat Etnike dhe Nacionale në kuadër të Konferencës për ish-Jugosllavinë. Ky opsion ka ngelur në qarkullim deri kur filloi konflikti në Kosovë në shkurt të vitit 1998. Modeli, i draftuar nga kryesuesi i Grupit Special për Kosovën si më sipër, ambasadori gjerman Gerht Ahrens, parashihte një autonomi për Kosovën duke u bazuar në Kushtetutën e vitit 1974 dhe përvojat e Tirolit të Jugut, Spanjës, ishujve Oland, Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë (i ashtuquajturi "Plani Z4", për autonominë e serbëve në Kroaci, të cilin ata e refuzuan). Shih më shumë në Hugh Poulton, "The Rest of the Balkans", në Hugh Miall (ed), *Minority Rights in Europe* (Pinter Publishers: UK, 1994) fq. 71-72.

ekzistuese, asnjë dokument specifik në të cilin do të tregohej përmbajtja e plotë e autonomisë substanciale për Kosovën nuk u përpilua, së paku jo deri në Marrëveshjen e Rambujesë. Marrëveshja e Rambujesë e specifikoi përmbajtjen e autonomisë substanciale për Kosovën edhe pse për një periudhë të përkohshme trivjeçare[144]. Ky dokument ofroi mundësinë e një vetëqeverisje demokratike, si dhe të paqes dhe të sigurisë për secilin që jetonte në Kosovë. Vetëqeverisja demokratike përfshinte të gjitha çështjet me rëndësi për përditshmërinë e popullit në Kosovë, si arsimi, shëndetësia dhe zhvillimi ekonomik. Kosova do të kishte një president, një kuvend, gjykatat e saj, qeverisje të fortë lokale, si dhe institucione shtetërore për komunitete, me autoritetin e duhur për të mbrojtur identitetin e secilit komunitet[145]. Siguria ishte lënë të garantohej nga trupat ndërkombëtare, të shpërndarë gjithandej territorit të Kosovës[146]. Policia lokale, me përfaqësues nga të gjitha komunitetet në Kosovë, do të mundësonte zbatimin e zakonshëm të ligjit[147]. Forcat federative dhe republikane të sigurisë do të duhej të largoheshin nga Kosova, përveç një pranie të kufizuar për mbrojtjen e kufirit[148]. Çështja e fundit kishte të bëjë me zgjidhjen përfundimtare për Kosovën: një takim i nivelit ndërkombëtar do të thirrej pas tri vitesh, për të themeluar një mekanizëm që do të mundësonte zgjidhjen përfundimtare. Vullneti i popullit ishte cilësuar si një faktor me rëndësi që duhej marrë parasysh në këtë takim ndërkombëtar[149].

Modeli i dytë kishte të bënte me federalizimin e RFJ (Serbi dhe Mali i Zi). Një gjë e tillë nënkuptonte plotësimin ose federalizimin e ri të RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi), duke bërë Kosovën si republikë të tretë federale. Kjo ka qenë në fakt ajo që shqiptarët e Kosovës kishin kërkuar në demonstratat e vitit 1981. Që nga shpërbërja e Jugosllavisë, megjithatë, ky opsion konsiderohej si i vjetruar. Nga pala serbe ky opsion qe përkrahur nga ana e të a.q. Lëvizja e Rezistencës Serbe në Kosovë, Momçillo Trajkoviq (Momčilo Trajković). Shih më shumë në Carl Bildt, "Kosovo Should Have the Same Status as Montenegro", në QIK, *Daily Report* 1736 (Prishtina, 3 June 1997). Momqillo Trajkoviq ka kërkuar për Kosovën në disa raste statusin e një republike të tretë brenda RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi). Në një rast, Trajkoviq ka kërcënuar se nëse shqiptarët nuk e pranojnë një gjë të tillë, atëherë duhet me forcë t'u imponohet projekti i federalizimit. Shih QIK, *Daily Report* 1945 (Prishtina, January 1997).

[144] Marrëveshja e Rambujesë po ashtu ka përmbajtur të ashtuquajturat parime të panegociueshme, ku integriteti dhe sovraniteti territorial i RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi) merr një epërsi të qartë.

[145] Marrëveshja e Rambujesë, kapitulli 1 (nenet II-VII).

[146] Marrëveshja e Rambujesë, kapitulli 7 (nenet I-XVI.

[147] Marrëveshja e Rambujesë, kapitulli 2 (neni II).

[148] Marrëveshja e Rambujesë, kapitulli 7 (nenet III-V).

[149] Marrëveshja Rambujesë, kapitulli 8 (neni I, paragrafi 3). Në këtë vend, Marrëveshja thotë:

"Tre vite pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, një takim ndërkombëtar do të mbahet me qëllim të përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës, bazuar në vullnetin e popullit,

Përkundër garancisë që ishte dhënë për sovranitetin dhe integritetin territorial të RFJ-së, autoritetet në Beograd refuzuan të nënshkruajnë dokumentin. Regjimi i Sllobodan Millosheviqit, në vend se të negociojë kushtet për paqe të Rambujesë, vazhdoi fushatën e tij ushtarake në mbarë Kosovën, duke dëbuar mijëra shqiptarë nga shtëpitë e tyre[150]. Deri në përfundim të Konferencës së Rambujesë, situata humanitare në Kosovë po bëhej një kërcënim real ndaj stabilitetit dhe paqes rajonale, me qindra e mijëra refugjatë që vërshuan drejt Shqipërisë dhe Maqedonisë. NATO nuk pati zgjidhje tjetër veçse të veprojë në përputhje me deklaratën e vet, të miratuar më 30 janar 1999[151]. Sidoqoftë, deri në kohën kur sulmet ajrore filluan, më 24 mars 1999, gjuha e liderëve të NATO-s ndryshoi. Tani theksi ishte vënë në shqetësimet për situatën humanitare, në vend të brengosjes përkitazi me stabilitetin dhe paqen rajonale[152]. Kjo, megjithatë, nuk ishte edhe gjuha e Rezolutës 1244. Kategorizimi i çështjeve sipas rëndësisë së tyre në Rezolutën 1244 dallon nga kategorizimi i bërë në Marrëveshjen e Rambujesë. Në Rezolutë, si edhe në rezolutat e mëparshme përkitazi me krizën në Kosovë, mbizotëruan ruajtja e sigurisë dhe e paqes rajonale, si dhe e sovranitetit dhe integritetit territorial të RFJ-së. Vetëm atëherë, çështjet humanitare (kthimi i refugjatëve dhe i personave të zhvendosur), zgjidhja përfundimtare e statusit të Kosovës dhe zbatimi i regjimit të përkohshëm të vetëqeverisjes luajtën një rol[153]. Në realitet,

---

mendimet e autoriteteve relevante, vlerësimit të përpjekjeve të secilës palë në implementimin e Marrëveshjes, si dhe në bazë të Aktit Final të Helsinkit, dhe me qëllim të vlerësimit gjithëpërfshirës të zbatimit të Marrëveshjes dhe shqyrtimit të propozimeve për masat shtesë".

[150] Justin Brown, "Uncomfortable Peace in Kosovo", *Christian Science Monitor* (14 October 1998) fq. 1.

[151] Norman Kempster, "Warring Sides in Kosovo Get Ultimatum", *Los Angeles Times* (30 January 1999) fq. 1.

[152] Në fakt, përveç integritetit territorial të RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi), stabilitetit dhe sigurisë regjionale, si dhe situatës humanitare në Kosovë, ka ekzistuar vetëm një rast kur NATO në mënyrë shprehimore iu është referuar qëllimit politik në rast të një intervenimi nga ana e saj në Kosovë. Sekretari i atëhershëm i NATO-s, Javier Solana, më 22 janar 1999, tha se qëllimi politik organizatës që ai drejtonte ishte restaurimi i statusit autonom të Kosovës të cilin Kosova e kishte gëzuar sipas Kushtetutës së Jugosllavisë të vitit 1974. Kjo nënkuptonte se ndërhyrja eventuale ushtarake e NATO-s do të kishte si pasojë, nëse jo të drejtpërdrejtë, atëherë të tërthortë, imponimin e statusit të autonomisë (ose të vetëvendosjes së brendshme) për Kosovën, autonomi që Kosova ka gëzuar gjatë kohës së Titos. Shih më shumë në QIK, *Daily Report* 2308B (Prishtina, January 22, 1999).

[153] Dy ndërmjetësues ndërkombëtar, një në emër të Bashkimit Evropian, Martti Ahtisaari, dhe tjetri në emër të Federatës Ruse, Viktor Çernomirdin (Chernomyrdin), kanë zbuluar se diktatori serb Sllobodan Millosheviq kishte pranuar kushtet e NATO-s për dorëzim kur ka

shikuar nga perspektiva e vetëvendosjes kosovare, kjo do të thoshte se sulmet ajrore të NATO-së rezultuan me ruajtjen e stabilitetit dhe të paqes rajonale, të sovranitetit dhe të integritetit territorial të RFJ-së, me mbrojtjen e popullatës shqiptare të Kosovës dhe së fundi, me përgatitjet fillestare për zgjidhjen politike të çështjes së Kosovës, duke miratuar "autonominë substanciale" për rajonin[154]. Në të vërtetë, qeverisja në formë të "autonomisë substanciale" u është ofruar shqiptarëve të Kosovës kohë pas kohe qysh nga viti 1989. Do të ishte gabim përqendrimi vetëm në arsyetimin humanitar, në llogari të një agjende politike më të gjerë.

Rezoluta 1244 i rikujton dhe plotësisht i përkrah rezolutat e mëparshme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së lidhur me krizën në Kosovë. Rezolutat e mëhershme, si dhe Rezoluta 1244, bëjnë thirrje për ruajtjen e integritetit territorial të RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi) dhe integritetin e shteteve të saj fqinje. Rezoluta 1244 e kodifikoi edhe më tej formulën e G8-s për zgjidhjen politike

---

marrë sigurimet se misioni ndërkombëtar në Kosovë do të jetë mision i OKB-së dhe se bashkësia ndërkombëtare nën mikëqyrjen e OKB-së do t'ia garantonte integritetin dhe sovranitetin territorial të RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi) mbi Kosovën. Shih, letra e datës 28 korrik 1998 nga *Charge d'Affaires AI* i RFJ-së pranë OKB-së, Vlladisllav Jovanoviq (Vladislav Jovanović), dërguar kryetarit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (Annex 2-4, U.N. SCOR, 54th Sess,, Doc. S/1999/828/1999). Për komentet e dy ndërmjetësuesve të këtij aspekti, shih më shumë në Viktor Černomirdin, "Nismo izdali Srbiju" (intervistë), *NIN* (Beograd, 14 oktobar 1999) fq. 49; Martti Ahtisaari, "Nuk e kam kërcënuar Millosheviçin", *Kosova Sot* (Prishtinë, 26 korrik 2000) fq. 8.

[154] Përveç prononcimeve të NATO-s lidhur me çështjet politike, siç janë ato lidhur me statusin e autonomisë së Kosovës sipas Kushtetutë së vitit 1974, të cilin e ka gazuar gjatë kohës së Titos, disa zyrtarë perëndimorë kanë bërë prononcime, në fazat e mëhershme të konfliktit në Kosovë, për zotimin e qeverive perëndimore ndaj integritetit dhe sovranitetit territorial të RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi). Kështu, në një vizitë të tij në Prishtinë në marsin e hershëm të vitit 1998, emisari special për Kosovën i ShBA-së, Robert Gelbard, disi jo fort në mënyrë të mençur shpalosi opsionet për paqen në Kosovë që konsistonte në ruajtjen pakusht nga ana e amerikanëve dhe vendeve të tjera perëndimore të integritetit të RFJ-së. Kjo, në anën tjetër, ia linte Sllobodan Millosheviqit duart e lira për të dëbuar gati tërë popullin shqiptar të Kosovës, për të vrarë civilët e pafajshëm dhe për të zbatuar politikën e "tokës së djegur". Për një kritikë të këtij pozicionimi të vendeve perëndimore, shih në James Brady, "History Proves Again Balkan's Bite is Worse Than its Bark", *Advertising Age* (July 13, 1998) fq. 25; Justin Brown, "Living in Cross Hairs of NATO", *Christian Science Monitor* (October 7, 1998) fq. 11; Janusz Bugajski, "Act Now in Kosovo, or Regret it Later", *Christian Science Monitor* (March 11, 1998) fq. 19; Mark Dennis, "Kosovo: Locked and Loaded", *Newsweek* (October 19, 1998) fq. 50; Michael Hirsh, "The Balkans: Holbrooke's Nervy Game of Chicken", *Newsweek* (October 26, 1998) fq. 50-51; Jonathan S. Landay, "NATO's Drums Beat Louder Over Kosovo", *Christian Science Monitor* (September 25, 1998) fq. 1, 7; Ronald Steel, "Hijacked", *New Republic* (July 13, 1998) fq. 10.

të konfliktit në Kosovë, të miratuar më 6 maj 1999[155]. Formula është pak a shumë e njëjtë me atë të shprehur në Rezolutën 1244, e cila rikonfirmon thirrjen e bërë në rezolutat e mëparshme për autonominë substanciale dhe për një vetadministrim kuptimplotë për Kosovën.

Në mesin e përgjegjësive të prezencës civile ndërkombëtare në Kosovë është edhe detyra që të mundësojë një proces politik i cili do të përcaktojë statusin e ardhshëm të Kosovës, duke marrë parasysh Marrëveshjen e Rambujesë. Rezultati përfundimtar i kësaj, së paku në aspektin formal, do të jetë se politika e Serbisë së Madhe nuk është mposhtur në Kosovë, së paku jo përderisa bashkësia ndërkombëtare do ta trajtojë me konsideratë këtë politikë e cila është pjesë integrale e politikës së RFJ-së që dominohet nga serbët.

Përsëri, në këtë aspekt formal, ekziston një ngjashmëri e habitshme ndërmjet pozitës së Kosovës dhe të "Republikës Serbe" në Bosnjë-Hercegovinë[156]. Që të dyja gëzojnë të drejtën në autonomi, por jo edhe në pavarësi.

---

[155] Shih, letrën e datës 6 maj 1999 e përfaqësuesit të përhershëm gjerman pranë OKB-së, Dieter Kastrup, drejtuar kryetarit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Annex, U.N. SCOR, 54th Sess., U.N. Doc. S/1999/516 (1999).

[156] Disa argumentojnë se Rezoluta 1244 dhe UNMIK-u kanë për synim fuqizimin e Kosovës, mirëpo në të njëjtën kohë kanë prodhuar problemin e sovranitetit. Kjo, megjithatë, nuk është e vërtetë aspak. Kosova nuk është nën qeverisjen ndërkombëtare, por nën administrim ndërkombëtar. Sipas praktikës ndërkombëtare dhe teorisë së saj, ekziston një dallim i madh mes këtyre dy koncepteve. Në rastin e Kosovës, UNMIK-u dhe Rezoluta 1244 pa asnjë dyshim që synojnë ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të USMZ-së, përfshirë Kosovën në të. Megjithatë, e paqartë është se si kjo do të arrihet. Fillimisht, UNMIK-u ndoqi misionin e njëfarë kujdestari të sovranitetit të USMZ-së në Kosovë, por shumë shpejt u pa se kjo nuk shkon: UNMIK-u ose duhet të shndërrohet në një "dorë ndihmëse" e Kosovës, siç ka bërë administrata ndërkombëtare në Bosnjë-Hercegovinë, ose në një sistem "këshillimi dhe ndihme" në të njëjtën kohë, sikur ka qenë rasti me Timorin Lindor. Duhet të lejohet që vendorët të marrin më shumë përgjegjësi për qeverisjen e vendit të tyre, kurse vullneti i popullit duhet të respektohet dhe të reflektohet në vendimmarrjen e përditshme dhe në atë lidhur me ardhmërinë e Kosovës. Më shumë për këto gjëra, shih në Patrick T. Egan, "The Kosovo Intervention and Collective Self-Defence", *International Peacekeeping* vol. 8, no. 3 (2001); Espen Barth Eide, "The Internal Security Challenge in Kosovo", *International Spectator* vol. 35, no. 1 (January-March 2000) fq. 49; Enrico Milano, "Security Council Action in the Balkans: Reviewing the Legality of Kosovo's Territorial Status", *European Journal of International Law* vol. 14, no. 5 (2003); Daniel N. Nelson, "Kosovo Futures, Western Dilemmas", *International Spectator* vol. 37, no. 2 (April-June 2002) fq. 11-12; Ralph Wilde, "From Danzig to East Timor and Beyond. The Role of International Territorial Administration", *American Journal of International Law* vol. 95, no. 3 (2001); Susan L. Woodward, "Kosovo and the Region: Consequences of the Waiting Game", *International Spectator* vol. 35, no. 1 (January-March 2000) fq. 35.

4. Marrëveshja për Union përfshin modelin për vetëvendosje të Rezolutës 1244 dhe të Rambujesë

Përkundër faktit që Rezoluta 1244 përpiqet të ruajë integritetin territorial dhe stabilitetin ndërkombëtar me të gjitha mjetet e mundshme, ajo ende i referohet në vazhdimësi natyrës së përkohshme të misionit ndërkombëtar në Kosovë. Ky karakter i përkohshëm i UNMIK-ut sugjeron nevojën për zgjidhjen e mëtutjeshme të statusit përfundimtar të vendit. Në shikim të parë, për dikë që nuk është i njohur me sfondin politik dhe atë ligjor, mund t'i duket sikur statusi përfundimtar i Kosovës dhe i "Republikës Serbe" ende nuk është zgjidhur. Kjo edhe mund të jetë e vërtetë shikuar nga perspektiva shqiptare. Shqiptarët e Kosovës vazhdojnë të besojnë se Rezoluta 1244 dhe Marrëveshja e Rambujesë, e diskutuar në vijim, nuk e përjashtojnë çështjen e pavarësisë. Në të vërtetë, shqiptarët e Kosovës e ndërlidhin çështjen e statusit përfundimtar për Kosovën me pavarësi të plotë.

Siç e vërejtëm edhe gjatë shtjellimit të bërë më herët, ky nuk është skenari që do të ngjajë më së shumti. Rezoluta 1244 dhe Marrëveshja për Union përjashtojnë më së shumti vetëm një formë të vetëvendosjes, e kjo është sovraniteti dhe pavarësia e plotë e Kosovës. Dikush mund të thotë se, në kuptimin rigoroz ligjor, Marrëveshja për Union nuk është ligjërisht e obligueshme për shkak se ajo nuk i plotëson kushtet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, që kërkojnë regjistrimin e dokumentit me qëllim që të shndërrohet në marrëveshje të vlefshme ndërkombëtare. Megjithatë, gati të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me ish-Jugosllavinë, përfshirë Marrëveshjen e Dejtonit, kanë qenë me legjitimitet të dyshimtë nëse shikohen nga prizmi klasik i së drejtës ndërkombëtare. Ajo çfarë ka rëndësi është se perëndimi, si autor i të gjitha dokumenteve themelore për ish-Jugosllavinë, ka luajtur "rol kryesor në përcaktimin e të kaluarës, të tashmes dhe, siç po duket tani, edhe të ardhmes së rajonit"[157].

Marrëveshja e Rambujesë u përforcua me Marrëveshjen për Union. Kjo marrëveshje ka pak nene, porse kuptimi i saj dhe mesazhi që ajo përçon janë shumë me rëndësi dhe gjithëpërfshirëse. Marrëveshja për Union përfaqëson një lloj udhërrëfyesi për stabilizimin e situatës së përgjithshme në USMZ. Nga ky aspekt, dispozitat e saj mund të veçohen në dy kategori. Kategoria e parë ka të bëjë me marrëdhënien ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi. Kategoria e dytë e dispozitave, që është shumë më e shkurtër, ka të bëjë me marrëdh-

[157] Charles Ingrao, "Understanding Ethnic Conflict in Central Europe: An Historical Perspective", *Nationalities Papers* vol. 27, no. 2 (1999) fq. 291.

ënien ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, në njërën anë, dhe marrëdhënien ndërmjet të dyjave së bashku dhe bashkësisë ndërkombëtare në anën tjetër. Vetëm dispozitat e fundit janë me interes në këtë rast për shkak se dispozitat që kanë të bëjnë me marrëdhënien ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi janë të natyrës kushtetuese dhe janë kryesisht të dedikuara për përdorim të brendshëm. Në fakt, deri më tani që të dyja kategoritë janë zbatuar në tërësi, duke përfshirë edhe zgjedhjen e të gjitha organeve të parashikuara për aktivizimin e unionit të ri ndërmjet Serbisë dhe të Malit të Zi.

Pjesa e dytë e Marrëveshjes për Union thotë se:

> Pas kalimit të periudhës trevjeçare, shtetet anëtare do të kenë të drejtë të iniciojnë procedurat për ndryshimin e statusit shtetëror, përkatësisht, për tërheqje nga bashkimi shtetëror. Nëse Mali i Zi tërhiqet nga bashkimi shtetëror, dokumentet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me RFJ-në, e në veçanti Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB-ve, do të ndërlidhen dhe do të zbatohen plotësisht mbi Serbinë, si trashëgimtare e saj.

Kjo dispozitë e Marrëveshjes për Union mungonte në draftin përfundimtar të Marrëveshjes së Rambujesë, për shkak të kundërshtimit të ashpër nga shqiptarët e Kosovës. Kurse aktualisht, sipas Marrëveshjes për Union, nëse Mali i Zi ndahet nga USMZ, Serbia edhe një herë do të ketë të drejtën e sovranitetit të plotë mbi Kosovën. Veç kësaj, kjo do të thotë se, bashkësia ndërkombëtare do të miratojë një pretendim të tillë të sovranitetit serb për shkak se është në përputhje me perceptimin e përgjithshëm të formave të brendshme të vetëvendosjes.

Problemet kryesore me Marrëveshjen për Union, si model për Kosovën, janë se, së pari, ajo është më shumë simbolike sesa përmbajtjesore dhe, së dyti, ajo është rezultat i një përgjigje politike pragmatike *ad hoc* (e çastit) ndaj kërcënimit të Malit të Zi për ndarje, gjë që nuk reflekton ndonjë strukturë të menduar me kujdes e cila do të mund të promovonte qëndrueshmërinë e USMS. Marrëveshjes për Union i mungojnë mekanizmat kredibilë për zbatim. Në krahasim me Marrëveshjen e Dejtonit, kjo marrëveshje nuk zotëron me instrumentet që do të inkurajonin dhe do të ndihmonin ndërtimin e një kohezioni shoqëror dhe politik përbrenda USZM-së së re. Kjo do të thotë se Marrëveshja për Union është e bazuar në zvarritjen (shtyrjen) e krizave për ndonjë ditë tjetër, ashtu siç edhe UNMIK-u ka vepruar deri me tani duke e trajtuar çështjen e statusit përfundimtar të Kosovës si një punë që mund të presë pa kufi.

Përfundim

Filozofia e Marrëveshjes për Union është ajo çfarë na bën të frikësohemi nga propozimet për rirregullimin e brendshëm territorial të Kosovës, qoftë në formë të kantoneve, decentralizimit apo ndryshe. Mënyra e vetme për të prodhuar paqe dhe stabilitet në Kosovë si tërësi është duke investuar në ristrukturimin e përgjithshëm shoqëror dhe kulturor të shoqërisë kosovare, nëpërmjet përpjekjeve që ndryshojnë mendjen dhe sjelljen e kosovarëve të zakonshëm. Format e vetëvendosjes, të zbatueshme qysh nga viti 1991, mund dhe duhet të jenë pikë referimi për të filluar punën në një projekt të ri vetëdijesimi, nga i cili do të përfitojnë të gjithë.

II. Specifikat e trashëgimit të ish-Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të

Hyrje

Ky shkrim synon shtjellimin e pasojave në kurriz të Kosovës, të cilat dalin si pasojë e mbylljes së procesit të trashëgimit të ish-Jugosllavisë, mbyllje që ka ndodhur me nënshkrimin e marrëveshjes mbi trashëgimin mes pesë ish-republikave jugosllave, të krijuara si shtete sovrane dhe të pavarura pas shkatërrimit të ish-Jugosllavisë[158]. Në diskursin politik e publik kosovar kjo

[158] Titulli i Marrëveshjes në origjinal është: *Agreement on Succession Issues and Annexes A to G*, nënshkruar më 29 qershor 2001 mes Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Sllovenisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë ("Unioni Serbi dhe Mali i Zi", i cili formalisht ka përfshirë dhe Kosovën në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të datës 10 qershor 1999) (në tekstin e mëtejmë: MT ose "Marrëveshja"). Dokumenti, i shoqëruar me komentet e Negociatorit Special për Çështjet e Trashëgimit të ish-Jugosllavisë prej vitit 1996 deri në lidhjen e MT, Sir Arthur Watts është ribotuar si tekst i plotë në *International Legal Materials* vol. 41 (2002) fq. 1-37. Marrëveshja ka hyrë në fuqi më 2 qershor 2004, sipas dispozitave të nenin 12(1) mbi hyrjen e saj në fuqi dhe është ratifikuar nga pesë shtete trashëgimtare dhe atë: Bosnjë-Hercegovina, 15 maj 2002; Kroacia, 3 maj 2004; Unioni Serbi dhe Mali i Zi, 10 tetor 2002; Sllovenia, 21 gusht 2002; ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, 6 mars 2002. Këto të dhëna janë siguruar përmes një interviste me anë të internetit të cilën autori i këtyre rreshtave e ka kryer me z. Andrej Rode, përgjegjës për marrëdhënie me publikun pranë ministrisë së punëve të jashtme të Republikës së Sllovenisë, zhvilluar më datën 9 dhjetor 2005. Sipas z. Rode, deri më tani janë zhvilluar një sërë aktivitetesh në vijim të zbatimit të MT, siç janë takimet e rregullta të përfaqësuese të shteteve palë në mekanizmat

çështje ende trajtohet si e hapur[159]. Shtjellimet në këtë shkrim merren me sqarimin e natyrës së MT dhe të pasojave të saj për të drejtat e detyrat e Kos-

e saj, kryesisht për çështjet financiare nga Aneksi C i MT dhe ato të pronave të përfaqësive diplomatike e konsullore nga Aneksi B i MT. Sipas bashkëbiseduesit, ndonjë mosmarrëveshje serioze mes palëve në Marrëveshje deri më tani nuk ka pasur.

[159] Autori i këtyre rreshtave, pas mbarimit të luftës së fundit në Kosovë, disa herë është detyruar të prononcohet me kërkesë të medias vendëse për të njëjtën çështje, ka provuar fare qartë të vë në dukje kotësinë e qasjes kosovare ndaj këtij problemi, hera e fundit duke qenë prononcimi rreth problemit të kufijve me Maqedoninë, i krijuar në bazë të Marrëveshjes së vitit 2001 mes Maqedonisë e Republikës Federative të Jugosllavisë (tash Unioni Serbi-Mali i Zi; më tej shkurt: RFJ/USMZ). Megjithatë, ky autor nuk ka pasur mundësi të bëjë ndonjë hulumtim të thellë rreth kësaj problematike dhe prononcimet e mësipërme kanë qenë të bazuara kryesisht në MT, e cila ka qenë e arritshme për publikun. Shkuarja në Universitetin "Northwestern" të Çikagos, ShBA, në Institutin për Studime Ndërkombëtare dhe Komparative, në semestrin dimëror 2005, në kuadër të programit "Fulbright", për mbajtjen e një cikli të ligjëratave në këtë institut dhe në disa universitete të tjera amerikane, ka bërë të mundur hulumtimin e thellë të materialit rreth trashëgimit të ish-Jugosllavisë, për çka autori është mirënjohës si ndaj programit "Fulbright", ashtu dhe ndaj të gjithë atyre që ndihmuan në mbledhjen e materialit për këtë shkrim. Detyrim të veçantë falënderimi autori ndien ndaj drejtorit të Institutit, dr. Andrew Wachtel, si dhe prof. William Slomanson nga "Thomas Jefferson School of Law" të San-Diegos së Kalifornisë. Idenë për një strukturë të tillë të punimit, ndërkaq, autori e ka huazuar nga autori Carsten Stahn, i cili me punimin e tij mjaft të detajuar "The Agreement on Succession Issues of the Former Socialist Federal Republic of Yugoslavia", publikuar në *American Journal of International Law* vol. 96, no. 2 (April 2002) fq. 379-397, ka ndikuar esencialisht në autorin për marrjen edhe më tutje me rezultatet aktuale doktrinare në lëmin e trashëgimit shtetëror në rastet e shpërbërjes së shteteve.

Versioni i parë i këtij shkrimi është botuar në *Thomas Jefferson Law Journal* vol. 29, no. 1 (Fall 2006), me titull "The Evolution of Succession Process in Former Yougosllavia", fq. 111-150, i cili më pastaj është riprodukuar me leje në Hungari në *Miskolc Journal of International Law* vol. 4, no. 2 (2007) fq. 12-37, me të njëjtin titull. Ky version në gjuhën shqipe paraqet një ndryshim esencial të punimit fillestar sa më sipër për faktin se trajton çështjen e trashëgimit të ish-Jugosllavisë në dritën e "Planit Ahtisaari për Kosovën" të datës 2 shkurt 2007 dhe krijimit të Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur më 17 shkurt 2008, i njohur nga 91 shtete deri më tani (korrik 2012), ndër to nga shtetet më të fuqishme të botës së sotme, nga shtetet të cilat sot interpretojnë ligjin ndërkombëtar.

Termi "Plani Ahtisaari" i cili përdoret në këtë shkrim i referohet dokumentit titulli i plotë i të cilit është "Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës" (datë 2 shkurt 2007). Ky dokument u lejua nga Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ai ishte menduar për ta zëvendësuar Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të datës 10 qershor 1999 mbi bazën e së cilës ishte themeluar misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë i njohur si UNMIK. Vetëm shqiptarët, jo serbët e Kosovës, e pranuan vlefshmërinë e këtij dokumenti dhe në bazë të tij u shpall Kosova shtet sovran dhe i pavarur më datën 17 shkurt 2008. Pala serbe e refuzoi atë. Ky dokument u emërtua sipas ish-presidentit finlandez Martti Ahtisaari, i cili i udhëhoqi bisedimet paqësore që synonin përfundimin e statusit politik të Kosovës, i cili atëbotë ishte akoma i pazgjidhur dhe që duhej të zgjidhej meqë ishte kërkesë shprehimore e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit. Cf. më tepër për këtë në Ray

ovës kundrejt trashëgimit të ish-Jugosllavisë. Në fakt, në këtë shkrim ne sqarojmë për lexuesin shqip se Kosova si shtet sovran dhe i pavarur nga data 17 shkurt 2008 trashëgon Republikën e Serbisë, jo ish-Jugosllavinë siç ka qenë rasti me MT ku vetëm ish-republikat jugosllave kanë pasur një të drejtë të tillë.

Arritja e MT ka mbyllur njëherë e mirë problemin e trashëgimit të ish-Jugosllavisë mes ish-republikave jugosllave (me përjashtim të Kosovës e cila nuk ka pasur statusin e republikës federale jugosllave), i cili ka qenë i hapur që nga viti 1992. E themi që nga vitit 1992 për arsye se si proces ka mundur të hapet vetëm atëherë kur janë krijuar shtetet e reja dhe shteti i vjetër jugosllav është zhdukur nga faqja e dheut. Konstatimi ndërkombëtar se ish-Jugosllavia ka marrë fund si shtet sovran dhe i pavarur, i shqiptuar në verë të vitit 1992 nga Komisioni Badinter, ka shtruar nevojën që edhe çështja e trashëgimit të të drejtave dhe detyrimeve të atij shteti të nisë e të zbatohet më me shpejtësi se deri atëherë. U bënë shkrime të shumta akademike e politike rreth kësaj çështjeje, aq sa citimi i tyre me këtë rast nuk do të ishte i mundur.

Në mënyrë zyrtare, ky problem ka filluar të trajtohet për herë të parë në kuadër të Grupit Punues për Çështjet e Trashëgimit, i cili ka funksionuar brenda Konferencës për ish-Jugosllavinë (Gjenevë dhe Londër respektivisht: 1992-1995). Sipas dispozitave të Marrëveshjes mbi Paqen e Dejtonit (nëntor 1995), Grupi për Çështjet e Trashëgimit ka mbetur i vetmi grup që ka vazhduar punën në kushtet e reja të krijuara pas lidhjes së marrëveshjes në fjalë dhe, mbi bazën e një vendimi të njërit prej organeve të themeluara në Dejton, Këshillit për Implementim të Paqes, kompetenca për trajtimin e çështjeve të trashëgimisë së ish-Jugosllavisë ka kaluar në duart e Përfaqësuesit të Lartë për Bosnjë-Hercegovinë[160]. Qëndrimi serb në kuadër të punës së këtij grupi për vite me radhë ka penguar punën e tij dhe arritjen e një marrëveshjeje të përgjithshme, ashtu siç kërkon e drejta ndërkombëtare në rastet e trashëgimit të shteteve[161]. Ky qëndrim serb ka konsideruar RFJ/USMZ-në si trashëgimtarin e vetëm juridiko-ndërkombëtar të ish-Jugosllavisë. Sikundër do të shihet në vijim, serbët kanë besuar se me këtë fitojnë të drejtën e ndarj-

---

Murphy, *UN Peacekeeping in Lebanon, Somalia and Kosovo* (Cambridge UP: Cambridge, 2007); Mauro Mazza, *L'ordinamento costituzionale del Kosovo* (Jovene Editore: Napoli, 2008).

[160] Konkluzionet e Këshillit për Implementimin e Paqes (*Peace Implementation Council*), të dala nga takimi i Londrës, mbajtur më 8 dhjetor 1995.

[161] E drejta ndërkombëtare e trashëgimit të shteteve njeh si parësor parimin e marrëveshjes mes subjekteve që trashëgojnë.

es sipas dëshirës së tyre të aseteve të ish-Jugosllavisë[162]. Sipas politikës zyrtare serbe, ish-Jugosllavia nuk qe shpërbërë më 1992. Atëherë, sipas kësaj politike, ka ndodhur vetëm shkëputja e pjesëve të saj, ku RFJ/USMZ kishte arritur ta ruajë identitetin e ish-Jugosllavisë (dhe kontinuitetin me të) sepse, sipas serbëve, republikat tjera janë shkëputur pa dëshirë dhe, si të tilla, nuk kanë të drejtën e trashëgimit të barabartë të pasurisë, të drejtave dhe detyrimeve të atij shteti.

Ky punim ndahet në disa pjesë dhe ndjek strukturën e MT, në po atë mënyrë që ka bërë autori tjetër, punimi i të cilit ka shërbyer si udhërrëfyes mjaft i dobishëm në hartimin e këtij shkrimi[163]. Pjesa e parë flet për shqyrtimet e përgjithshme rreth trashëgimit, për të kaluar në pjesën e dytë te kuadri ligjor i MT. Kjo bëhet me qëllim që lexuesi të jetë në gjendje për t'i ndjekur specifikat e trashëgimit të ish-Jugosllavisë kundrejt praktikave tjera në të drejtën ndërkombëtare, të tashme dhe nga historia. Pjesa e tretë flet për problemet konkrete që kanë lindur rreth ndarjes së pronës shtetërore të ish-Jugosllavisë, që ne e kemi quajtur hedhja poshtë e kërkesës së RFJ/USMZ për trashëgimtar të vetëm (kontinuitet) të ish-Jugosllavisë. Pjesa e katërt paraqet kuadrin e bashkëpunimit institucional në MT. Ndërkohë që në pjesën e pestë është shtjelluar çështja e pronës së tundshme e të patundshme, ku bëjnë pjesë edhe përfaqësitë diplomatike dhe konsullore. Në mënyrë të natyrshme, pjesa e gjashtë e këtij shkrimi plotëson mozaikun e trashëgimit si proces dhe flet për trashëgimin e të drejtave dhe detyrimeve financiare. Sado që arkivat janë pronësi shtetërore, ndarja e tyre kryhet sipas rregullave të tjera nga ato që kanë të bëjnë me pronësinë, gjë që ka bërë të jetë pjesë e ndarë edhe në MT, rrugë që edhe ne e kemi ndjekur në këtë shkrim në pjesën e shtatë të tij[164].

---

[162] Për komentet e këtij qëndrimi, shih më shumë në Vladmir-Djuro Degan, "Disagreements over the Definition of State Property in the Process of State Succession to the Former Yugoslavia", në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1999) fq. 33-60.

[163] Për tekstin e MT, shih fusnotën 100 *supra*, kurse për autorin në fjalë fusnotën 101 *supra*.

[164] Në planin ndërkombëtar ekzistojnë dy konventa që rregullojnë çështjet e trashëgimit të shteteve: njëra quhet Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin ndaj Traktateve Ndërkombëtare e vitit 1978 (në tekstin e mëtejmë: KV I), kurse tjetra Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin ndaj Pronës, Arkivave dhe Borxhit të Jashtëm e vitit 1983 (më tej shkurt: KV II). (*Vienna Convention on Succession of States in Respect of Treaties*, August 23, 1978, U.N. Doc. A/CONF. 80/31 (1978)) dhe (*Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts*, April 8, 1983, U.N. Doc. A/CONF. 117/14 (1983)).

Sado që besohet që këto dy dokumente të rëndësishme ndërkombëtare, përkundër të metave, reflektojnë të drejtën zakonore ndërkombëtare në lëmin e trashëgimit të shteteve, statusi i tyre aktual është mjaft i dobët: Etiopia, Iraku, Sllovakia dhe ish-Jugosllavia kanë

Kjo nuk është kështu kur flitet për pronën private dhe të drejtat e fituara, të cilat sqarohen në pjesën e tetë të këtij shkrimi. Pjesa e fundit rezervohet për mendimet tona përfundimtare.

Çështja e Kosovës ka qenë tërësisht e përjashtuar nga ky proces, për arsye të mosqenies së saj shtet sovran dhe i pavarur. Asnjë dispozitë e MT nuk i referohet Kosovës. Shkrimi synon që të tregojë jo vetëm përjashtimin e Kosovës nga ky proces, tanimë të mbyllur sipas kushteve të parapara në MT, por edhe mundësitë juridike e politike të cilat janë përdorur dhe hapur në Planin Ahtisaari për një rikthim të këtij procesi në dobi të Kosovës *vis-à-vis* Serbisë gjatë bisedave të dyta teknike për Kosovën[165].

Rifutja e Kosovës në këtë proces përmes Planit Ahtisaari paraqet teknikë të re juridike, në tërësi *sui generis*, e cila si e tillë i përmbahet në tërësi të drejtës ndërkombëtare mbi trashëgimin e shteteve, por sërish mbetet akt i njëanshëm juridik ndërkombëtar pa pasur natyrën e një marrëveshjeje të vlefshme ndërkombëtare. Për këtë arsye, në këtë shkrim flasim për Kosovën brenda tekstit pas trajtimit të aspekteve të veçanta të trashëgimit dhe atë çdoherë pas shtjellimeve mbi ish-republikat jugosllave dhe vendin që ato kanë pasur dhe kanë në MT (sepse ato dhe vetëm ato, pra ish-republikat jug-

---

ratifikuar KV I, kurse Republika Dominikane, Egjipti, Estonia, Maroku, Sejshellet, Tunisia dhe Ukraina kanë hyrë në të, në ndërkohë që Bosnjë-Hercegovina, Kroacia dhe Sllovakia e kanë trashëguar të njëjtën. Asnjë shtet deri më 31 dhjetor 2005 nuk ka ratifikuar KV II, kurse vetëm Kroacia, Estonia, Gjeorgjia dhe Ukraina kanë hyrë në të. Multilateral Treaties Deposited with the Secretary-General: Status as on December 31, 2005, U.N. Doc. ST/LEG/SER/E 19 (2005).

[165] Bisedat e para teknike patën filluar nga pranvera e vitit 2004 dhe kanë zgjatur deri në vjeshtën e vitit 2005 dhe janë udhëhequr nga autori i këtyre rreshtave, me format afërsisht të njëjtë me këto që janë në vijim e sipër dhe që filluan në vjeshtën e vitit 2011, me një dallim që implementimi i tyre këtë herë thuhet se garantohet nga Unioni Evropian. Në fakt, këto bisedime janë duke u kryer nën patronatin e Unionit Evropian. Ato të parat në esencë patën nisur menjëherë pas samitit të UE-së në mesin e vitit 2003, përkatësisht në Vjenë më 14 tetor 2003. Në këtë takim qenë formuar katër grupe punuese (personat e zhdukur, kthimet, energjetika, dhe transporti e komunikacioni), të cilat gjatë tërë dialogut janë udhëhequr nga ky autor, deri në mbylljen e tyre joformale si pasojë e nisjes së dialogut mbi zgjidhjen përfundimtare të statusit të politik të Kosovës. Kjo ka filluar më 23 mars 2005 kur Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi A. Anann emëroi Kai Eiden, diplomat i njohur norvegjez, si të dërguar të tij të posaçëm për të bërë një hulumtim gjithëpërfshirës mbi gjendjen në Kosovë dhe hapat e mëtejmë. Sipas raportit të prezantuar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së në tetor të vitit 2005, pati filluar edhe dialogu politik i mirëfilltë mbi zgjidhjen e statusit final të Kosovës, i cili është udhëhequr nga z. Ahtisaari dhe që ka rezultuar me planin e sipërcekur gjithëpërfshirës të vitit 2007, mbi bazën e të cilit Kosova ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008.

osllave, kanë qenë dhe janë autore të MT).[166] Sado që MT në aspektin formal nuk mund të zbatohet dhe të vlejë ndaj Kosovës, fryma dhe esenca e saj kanë gjetur zbatim, siç do të shihet, në disa segmente të trashëgimit të Kosovës karshi Serbisë (shtetësia, asetet dhe detyrimet financiare, traktatet për kufij etj.).

1. Koncepti i trashëgimit të shteteve dhe parimet bazë të tij

Trashëgimi i shteteve në të drejtën ndërkombëtare përfshin tërësinë e rregullave dhe parimeve të cilat zbatohen ndaj pasojave legale të ndërrimit të sovraniteteve territoriale[167], të drejtave dhe detyrimeve të shtetit pararendës. Ato të drejta dhe detyrime kanë të bëjnë me traktatet ndërkombëtare, shtetësinë, pronën shtetërore dhe borxhin e jashtëm, arkivat dhe të drejtat e fituara të personave privatë (fizikë dhe juridikë). Si i tillë, trashëgimi i shteteve paraqet lëmin që ka më së shumti vakum juridik dhe fare nuk është kodifikuar deri më sot[168]. Edhe ajo pak përvojë e shteteve e grumbulluar deri në fillim të procesit të dekolonizimit nuk arriti të transformohet në rregulla të qarta të së drejtës mbi trashëgiminë e shteteve në të drejtën ndërkombëtare. KV I dhe KV II nuk bënë asgjë veçse sanksionuan trashëgiminë e shteteve në kontekstin kolonial. Jashtë atij konteksti, rregullat e tyre mbeten të zbatueshme vetëm në nivel parimesh. Kjo gjendje u krijua si pasojë e faktit se KV I dhe KV II privilegjuan deri në fund ish-vendet koloniale, duke ua njohur atyre doktrinën e "pjatës së pastër" (*clean slate doctrine*). Nga të gjitha segmentet e trashëgimit të shteteve, ish-vendet koloniale trashëguan vetëm rregullat dhe

---

[166] Aneksi VI (Borxhi Ndërkombëtar) dhe VII (Prona dhe Arkivi) në veçanti janë të dizajnuara për zgjidhjen e segmenteve kyçe të trashëgimit mes Kosovës dhe Serbisë, siç do të vërehet në vijim të këtij shkrimi.

[167] Cf. Librin monumental të Daniel P. O'Connel, *State Succession in Municipal and International Law* vol. I (Cambridge UP: Cambridge 1967) fq. 3.

[168] Komisioni për të Drejtën Ndërkombëtare ka filluar punën në kodifikimin e kësaj lëmie më 1963, por pas një dekade ka konstatuar se një gjë e tillë është e vështirë, nëse jo e pamundur në tërësi, sepse kodifikimi në fjalë "ka të bëjë me një fushë ku nuk ekziston një doktrinë e përgjithshme kurse praktika e shteteve dhe zakoni ndërkombëtar ende nuk kanë prodhuar precedentë me bazë të qëndrueshme". Sir Francis Vallat, "First Report on Succession of States in Respect of Treaties", *The Yearbook of the International Law Commission* vol. II (1974) fq. 22. Për komentet dhe historikun e kodifikimit të trashëgimit të shteteve, shih në Detlev F. Vagts, "State Succession: The Codifiers' View", *Virginia Journal of International Law* vol. 33, no. 2 (Winter 1993) fq. 275-297, në fq. 279-280 dhe 294-297.

parimet mbi regjimet kufitare, si dhe anëtarësimet në organizatat e caktuara ndërkombëtare, të cilat qenë krijuar nga ish-metropolet e tyre.

Vendet ish-koloniale, pas fitimit të pavarësisë së tyre, u mbështeten në doktrinën e "pjatës së pastër", mbi bazën e së cilës patën mundësinë e refuzimit të shumicës së të drejtave dhe detyrimeve të shtetit pararendës, ish-metropoleve të tyre, në veçanti kur qe fjala për borxhet e jashtme shtetërore dhe të drejtat e fituara të personave privatë (fizikë dhe juridikë). KV I dhe KV II si dhe praktika e shteteve e bazuar në to mohoi në tërësi doktrinën e trashëgimit universal, të rrënjosur thellë në të drejtën ndërkombëtare tradicionale. E kundërt me doktrinën e "pjatës së pastër", kjo doktrinë thekson se çdo ndryshim në sovranitetin territorial ka për pasojë aktivizimin e rregullave dhe parimeve historike mbi trashëgiminë e shteteve.

Sikundër vërehet, rregullat dhe parimet mbi trashëgiminë e shteteve adresojnë pasojat legale të ndryshimeve në sovranitetin territorial të shteteve[169]. Kjo do të thotë se ndryshimet në regjimin politik dhe ndryshimet që janë bërë në mënyrë kundërligjore, jo legale, nuk aktivizojnë zbatimin e rregullave dhe parimeve mbi trashëgimin e shteteve[170]. Nisur nga fakti se trashëgimia merret me pasojat legale të ndërrimit të sovraniteteve, pa marrë parasysh sa substanciale janë ato ndërrime sovranitetesh territoriale, atëherë del se nuk ka rëndësi nëse shteti pararendës e ruan identitetin dhe kontinuitetin e tij juridik — ndërkombëtar pas ndërrimeve të tilla në sovranitetin territorial. Krejt çfarë mund të ndodhë është se shteti i goditur me ndërrimet në sovranitetin e tij territorial mund të ketë humbur anëtarësimin në disa traktate ndërkombëtare, disa shtetas të tij mund të jenë bërë shtetas të sovra-

---

[169] KV I dhe KV II flasin për trashëgiminë si për "zëvendësim të një shteti me tjetrin për përgjegjësitë ndërkombëtare të territorit" (neni 2.1. b i KV I dhe II). KV I dhe KV II nuk flasin fare për pasojat legale të ndryshimit të tillë në përgjegjësitë ndërkombëtare të shteteve, gjë e cila paraqet vetë esencën e trashëgimit të shteteve. Një mungesë e tillë mbetet të sqarohet nga doktrina dhe praktika e shteteve për secilin rast veç e veç. Për komente, Cf. Eli Nathan, "The Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts", në Yoram Dinstein (ed.), *International Law in Time of Perplexity* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1989) fq. 489-518, në fq. 498-499.

[170] Komisioni për të Drejtën Ndërkombëtare po ashtu thekson se ndryshimet në sovranitetin territorial duhet të jenë bërë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Cf. *The Yearbook of the International Law Commission* vol. II, part 2 (1981) fq. 23; Surya P. Sharma, *Territorial Acquision, Disputes and International Law* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1997) fq. 2-51; 48-160, si dhe Kapitulli IV. Për qëndrim të kundërt, Cf. Carsten Thomas Ebenroth & Matthew James Kemner, "The Enduring Political Nature of Questions of State Succession and Seccession and the Quest for Objective Standards", *University of Pennsylvania Journal of International Economic Law*, vol. 17, no. 3 (Fall 1996) fq. 753-819, në fq. 759-763.

niteteve të tjera, borxhet e tij dhe detyrimet mund të kenë kaluar tek të tjerët dhe, së fundi, të drejtat private të fituara më herët sipas ligjit të tij mund të jenë futur nën ligjin e sovranitetit të ri. E megjithatë, ai shtet e ruan identitetin dhe kontinuitetin e vet shtetëror juridiko-ndërkombëtar sepse çështja e identitetit dhe e kontinuitetit shtetëror është çështje e ndarë nga trashëgimi. Nëse shteti e ka humbur identitetin dhe kontinuitetin e vet shtetëror, kjo gjë përcaktohet nga bashkësia ndërkombëtare në kohën dhe hapësirën e dhënë. Një përcaktim i tillë është punë marrëveshjeje dhe konvencioni mes anëtarëve të bashkësisë ndërkombëtare dhe nuk varet nga sasia e territorit të humbur e as forma e transformimit të tij shtetëror juridiko-ndërkombëtar. Mund të ketë shpërbërje të tërësishme të shtetit, e megjithatë, për qëllimet e së drejtës ndërkombëtare, sërish të konsiderohet se është ruajtur identiteti dhe kontinuiteti i shtetit pararendës të shpërbërë[171]. Kështu ndodhi me Austrinë, e cila u quajt shtet i njëjtë vazhdimësi e ish-Austro-Hungarisë, me Turqinë kundrejt Perandorisë Osmane, me Federatën e Rusisë kur është në pyetje ish-BRSS.

KV I dhe KV II nuk paraqesin, sikundër u tha, zgjidhje legjislative të cilat mund të zbatohen në rastet e tjera jashtë kontekstit kolonial me ndonjë siguri të madhe. Dispozitat e tyre më shumë janë në nivel parimesh, të cilat si të tilla janë konfirmuar nga praktika e shteteve nga koha e kaluar. Ndër këto parime, ai i zgjidhjes me marrëveshje të problemeve të trashëgimisë zënë një vend të rëndësishëm. Se kjo është kështu u pa qartë kur filluan të adresohen pasojat legale të shpërbërjes së ish-federatave komuniste — Jugosllavisë, BRSS-së dhe Çekosllovakisë. Ky parim u konfirmua që nga vendimet e BE-së në kuadër të Konferencës së Paqes për Jugosllavinë (1991-1992), të cilat kanë vlejtur për tri ish-federatat në fjalë[172], prononcimet e Komisionit Badinter[173],

---

[171] Për këtë dallim, shih gjerësisht në Krystina Marek, *Identity and Continuity of States in International Law* (Geneve: Library E. Droz, 1954) fq. 2-4, 14, 68-76, 241-258; Stevan Djordjević, *O kontinuitetu država s posebnim osvrtom na medjunarodno-pravni kontinuitet Kraljevine Jugoslavije i FNRJ* (Beograd: Naučna Knjiga, 1967) fq. 13-36. Për rastet e ish-federatave komuniste, shih në Rein Mullerson, "The Continuity and Succession of States by Reference to Former USSR and Yugoslavia". *International and Comparative Law Quartelry* vol. 42, part 3 (July 1993) fq. 473-493; Matthew C.R. Craven, "The Problem of State Succesion and Identity in Under International Law", *European Journal of International Law* vol. 9, no. 1 (1998) fq. 142-163; Hanna Bokor-Szego, "Questions of State Identity and State Succession in Eastern and Central Europe", në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1999) fq. 95-107.

[172] "Zotimi për zgjidhjen me marrëveshje, përfshirë këtu edhe procedurën e arbitrazhit kur kjo quhet e nevojshme, të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me trashëgimin dhe mosmarrëveshjet regjionale". Paragrafi i pestë i *Declaration on the Guidelines on the Recognition of*

vendimet e Konferencës së Paqes për ish-Jugosllavinë të vitit 1992-1995[174] dhe, së fundi, vendimet e KS të OKB[175]. Ky parim zë vend të dukshëm edhe në MT e cila ka reflektuar frymën e tij[176], dhe, *mutatis mutandis*, edhe në dispozitat e Planit Ahtisaari.[177]

Parim tjetër i cili ka gjetur zbatim të gjerë me rastin e trajtimit të pasojave legale të trashëgimit të shteteve është parimi i drejtësisë (*equity*). Zbatimi i këtij parimi paraqet një *condiction sine qua non* në procesin e trashëgimit të shteteve dhe si i tillë ka qenë i pranuar dhe i zbatuar edhe në proceset e trashëgimit në të kaluarën, sado që zbatimi i tij përfshinë fusha të tjera përveç trashëgimit të shteteve[178]. Duke pasur një natyrë mjaft kontekstuale, të

New States in Eastern Europe and in the Soviet Union, miratuar në mbledhjen e jashtëzakonshme ministrore të Konferencës për Paqen në Jugosllavi, Bruksel 16 dhjetor 1991. *International Legal Materials* vol. 31 (1992) fq. 1486-1487.

[173] "Shtetet trashëgimtare të ish-Jugosllavisë detyrohen për zgjidhjen me marrëveshje të të gjitha aspekteve të trashëgimit". Paragrafi i katërt i "Conference for Peace in Yugoslavia. Arbitration Commission. Opinion No. 9", (Paris, 4 korrik 1992), *International Legal Materials* vol. 31 (1992).

[174] Deklarata mbi Parimet, miratuar më 26 gusht 1992 nga Konferenca Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (e njohur si "Konferenca e Londrës": 1992-1995), ka përkrahur parimin sipas të cilit të gjitha çështjet e trashëgimit të ish-Jugosllavisë duhet të zgjidhen me konsensus ose përmes arbitrazhit. Cf. "International Conference on the Former Yugoslavia. Statement of Principles (LC/C2/FINAL)", Parimi (ix), *International Legal Materials* vol. 31 (1992) fq. 1533-1534.

[175] Pika 6 e Rezolutës 1022 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, miratuar në mbledhjen e 3595 të Këshillit të Sigurimit, datë 22 nëntor 1995. UN Doc. S/RES/1022 (1995).

[176] Kështu, në paragrafin e parafundit të Preambulës së MT thuhet, *inter alia,* se pesë shtetet e dala nga ish-Jugosllavia (Bosnjë-Hercegovina, Republika e Kroacisë, Republika e Maqedonisë, Republika e Sllovenisë, dhe Republika Federative e Jugosllavisë), duke qenë të gjitha shtete sovrane dhe të barabarta në procesin e trashëgimit të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, "kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në zgjidhjen e çështjeve të hapura të trashëgimit në pajtim më të drejtën ndërkombëtare", kurse në nenin 9 të MT koncepti i bazës juridike të procesit të trashëgimit të ish-Jugosllavisë zgjerohet më shumë dhe përfshinë, përveç parimit të vullnetit të mirë, *bona fide*, edhe parimet e së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare si dhe ato që dalin nga Karta e Kombeve të Bashkuara, sado që vetë Karta nuk flet për trashëgimin e shteteve.

[177] Plani Ahtisaari*, inter alia*, në mesin e parimeve bazë për zgjidhjen e çështjeve të trashëgimit mes Kosovës dhe Serbisë parasheh parimin e zgjidhjes me marrëveshje të çështjes së borxheve, parimin e kompensimit të Serbisë në rast se ajo paguan borxhin në emër të Kosovës pa marrëveshje, pra nëse Serbia njëanshëm paguan borxhin e Kosovës ajo duhet të kompensohet nga ne, dhe, së fundi, parimin e arbitrimit të çdo mosmarrëveshje mes palëve, Kosovës dhe Serbisë. Cf. Ankesi VI i Planit Ahtisaari ("borxhi ndërkombëtar").

[178] *Equity* gjen zbatim të gjerë në të drejtën ndërkombëtare në përgjithësi për arsye të natyrës së tij juridike, përkatësisht për shkak se e drejta ndërkombëtare paraqet një sistem juridik jo të plotë, jo të sistemuar dhe jo aq të zbatueshëm në praktikë, për dallim nga sistemet e

vështirë për zbatim praktik, zbatimi i parimit *equity*, sikundër shprehet një autor, do të thotë "gjetje e të vërtetës"[179]. Nevojat e oportunitetit politik, më shumë se normat e ngurta juridike që kërkojnë zbatim të disiplinuar, kanë qenë prapa zgjidhjeve të problemeve të trashëgimit, si në rastet nga e kaluara, ashtu dhe kur është fjala me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë dhe dy federatave të tjera komuniste, ish-BRSS-së dhe Çekosllovakisë. Para se të flasim për këto tri raste, vlen të theksohet se me të vërtetë mundësia për zbatim të tij në mënyrë mjaft të lirë e reflekton vetë esencën e pasigurt të materies së trashëgimit të shteteve dhe pamundësinë e rregullimit të saj të detajuar me norma pozitive ndërkombëtare[180].

Parimi i drejtësisë (*equity*) në KV II shprehet në dispozitat e neneve 37(1) dhe 40(2), të cilat kërkojnë që të ekzistojë një ekuilibër mes aseteve të ndara dhe borxhit që merret përsipër me rastin e trashëgimit, formulim që te Komisioni Badinter paraqitet si kërkesë që "shpërndarja e tërësishme të jetë e drejtë"[181]. Komisioni Badinter ka shkuar më tutje në këtë drejtim, duke ofruar rregulla procedurale për të arritur deri te kjo "shpërndarje e drejtë e përgjithshme". Shpërbërja e dhunshme e ish-Jugosllavisë dhe degjenerimi i procesit politik, megjithatë, kanë pamundësuar zbatimin e prononcimeve sa më

---

brendshme juridike, gjë që lenë vend për zbrazëtira juridike dhe mundësi për zgjidhje të çështjeve ndërkombëtare duke u mbështetur në parime të përgjithshme juridike. Për një elaborim të detajuar të parimit *equity* në të drejtën ndërkombëtare, cf. Vladimir-Djuro Degan, *L'équité et le droit international* (Martinus Nijhoff, La Haye, 1970); Vladimir-Djuro Degan, "Equity in Matters of State Succession", në Ronald St. John Macdonald (ed.), *Essays in Honour of Wang Tieya* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1994) fq. 201-210; Christopher R. Rossi, *Equity and International Law: A Legal Realist Approach to International Decision Making*, Serie de Monografias del Bid (Transnational Publishers: Irvington, N.Y., 1993); Stefan Oeter, "State Succession and the Struggle Over Equity: Some Observations on the Laws of State Succession with Respect to State Property and Debts in Cases of Separation and Dissolution of States", *German Yearbook of International Law* (1995) fq. 73-102.

[179] W. Jenks, cituar në Eli Nathan, "The Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts", në Yoram Dinstein (ed.), *International Law in Time of Perplexity*, fq. 498.

[180] Cf. Eli Nathan, "The Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts", fq. 496-498.

[181] Për më tepër, Badinteri ka parashikuar edhe rregullat procedurale për të arritur deri te kjo "shpërndarje e drejtë e përgjithshme", duke vënë në dukje detyrimin e bashkëpunimit me mirëbesim mes subjekteve të trashëgimisë, si dhe masat ndëshkuese për ata që nuk i përmbahen këtij detyrimi. Cf. Mendimi nr. 13, datë 16 korrik 1993, paragrafi i dytë, *International Legal Materials* vol. 32 (1993) fq. 1591-1592, në fq. 1592.

sipër të Komisionit Badinter[182]. Procedurat e ofruara të trashëgimit dhe garancive të tjera për vënien në jetë të rregullës *equity* është dashur të presin një kohë bukur të gjatë para se të arrinin rezultatin e një rregulle të "së drejtës së përgjithshme". Kjo ka ndodhur vetëm me arritjen e MT ku zbatimi i rregullës *equity* ka nënkuptuar marrjen parasysh edhe të qëndrueshmërisë ekonomike të shteteve trashëgimtare, sado që në fillim një rrethanë e tillë ka qenë e paqartë për Komisionin Badinter. Kjo marrje parasysh e qëndrueshmërisë ekonomike të shteteve trashëgimtare reflektohet në MT si kur është fjala për ndarjen e pronës së patundshme, asaj të tundshme, por edhe me rastin e ndarjes së aseteve dhe borxhit të jashtëm[183]. MT, njëjtë si KV II, nuk përmban dispozita mbi kundërmasat dhe garancive të tjera në dobi të trashëgimtarëve dhe kreditorëve për shkak se MT bazohet në premisën se palët do të sillen dhe bashkëpunojnë me mirëbesim, *bona fide,* rrethanë që ka munguar në kohën e marrjes së vendimit të fundit të Komisionit Badinter rreth trashëgimit[184].

---

[182] Robert Badinter, "L'Europe du droit", *European Journal of International Law* vol. 4, no. 1 (1993) fq. 15-23, në fq. 23.

[183] Neni 5(2) i Aneksit C dhe Anekset A dhe C të MT. Krahasimi i dispozitave të këtyre dy anekseve dhe i "çelësit" të përdorur për ndarjen e aseteve dhe detyrimeve nga ana e Fondit Monetar Ndërkombëtar (në tekstin e mëtejmë: FMN) dhe Bankës Botërore (në tekstin e mëtejmë: BB), tregon qartë për marrjen parasysh të qëndrueshmërisë ekonomike më rastin e trashëgimit të ish-Jugosllavisë nga ana e shteteve të reja trashëgimtare. Cf. Mojmir Mrak, "Apportionment and Succession of External Debts: The Case of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia", në *Research Reports* No. 259 (August 1999), botim i The Vienna Institute for International Economic Studies, fq. 5-20; Josip Metelko, *Sukcesija država s posebnim osvrtom na raspad bivše SFRJ* (Pravni Fakultet: Zagreb, 1999) fq. 267-288; Ibrahim F.I. Shihata, "Matters of State Succession in the World Bank's Practice", në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1999) fq. 75-93; Mojmir Mrak, "Succession to the Former Yugoslavia's External Debt: The Case of Slovenia", në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States*, fq. 159-170.

[184] Komisioni Badinter në fillim e pati bërë të qartë zbatueshmërinë e këtij parimi, mirëpo vetëm më vonë i është kthyer në mënyrë konkrete mundësisë për ofrimin e garancive dhe të rregullave të tjera procedurale me rastin e zbatimit praktik të tij. Cf. "Conference for Peace in Yugoslavia. Arbitration Commission. Opinion No. 9", *International Legal Materials* vol. 31 (1992) fq. 1523-1525; "International Conference on Former Yugoslavia. Arbitration Commission. Opinion No. 12", *International Legal Materials* vol. 32 (1993) fq. 1589-1591. Për komentet, shih në Hubert Beemelmans, "State Succession in International Law: Remarks on Recent Theory and State Praxis", *Boston University International Law Journal* vol. 15, no. 1 (Spring 1997) fq. 71-123, në fq. 115-118; Marco Martins, "An Alternative Approach to the International Law of State Succession: Lex Naturae and the Dissolution of Yugolsavia". *Syracuse Law Review* vol. 44, no. 3 (1993) fq. 1019-1058, në fq. 1049-58.

Në rastin e trashëgimit të dy ish-federatave të tjera komuniste, BRSS-së dhe Çekosllovakisë, gjërat kanë shkuar më ndryshe për faktin se shpërbërja e tyre nuk ka qenë e shoqëruar me dhunë, konflikt të armatosur dhe kaos. Derisa për çekosllovakët rregulla *equity* ka nënkuptuar zbatimin me marrëveshje të raportit të ndarjes "dy me një"[185], në kontekstin e ish-BRSS-së një gjë e tillë ka konsistuar në marrjen e tërësishme të borxheve të ish-BRSS-së, por edhe të pasurisë së saj, nga ana e Federatës së Rusisë[186]. Në dy rastet, ndër-

---

Kjo qasje disi e shkapërderdhur lidhet me faktin se trashëgimi i ish-Jugosllavisë ka qenë pjesë e një procesi që është shoqëruar me dhunë, luftë të armatosur dhe kaos të përgjithshëm. Kjo ka pasur për pasojë që secila palë të sheh në rregullën *equity* shansin e saj për përfitim në kurriz të tjerëve, ashtu që vetëm ndërhyrja e faktorit ndërkombëtar, në rend të parë ndërhyrja e botës financiare ndërkombëtare, ka ndikuar në atë që Badinteri të jetë më konkret në mendimet e tij të fundit rreth procedurës dhe masave të tjera për vënien në jetë të rregullës *equity*. Cf. Mojmir Mrak, "Succession to the Former Yugoslavia's External Debt", fq. 159-169; Ana Stanić, "Financial Aspects of State Succession: The Case of Yugoslavia", *European Journal of International Law* vol. 12, no. 4 (2001) fq. 751-779, në fq. 754-755; Paul Williams & Jennifer Harris, "State Succession to Debts and Assets: The Modern Law and Policy", *Harvard International Law Journal* vol. 42, no. 2 (Summer 2001) fq. 355-417, në fq. 383-400.

Për dallim nga Komisioni Badinter, MT nuk përmban dispozita mbi kundërmasat dhe garancitë e tjera në dobi të trashëgimtarëve dhe kreditorëve për shkak se MT bazohet në premisën se palët do të sillen dhe bashkëpunojnë me mirëbesim, *bona fide*.

[185] Në rastin e Çekosllovakisë, zbatimi i së drejtës ndërkombëtare dhe i vetë parimit *equity* ka qenë më i qartë, gjë që ka pasur për pasojë edhe pranimin nga vendet kreditore dhe nga bashkësia ndërkombëtare më lehtë të marrëveshjes së brendshme mes dy vendeve, Çekisë dhe Sllovakisë. Çka është edhe më me rëndësi, kjo marrëveshje e brendshme mes tyre ka pasur karakterin e ligjit kushtetues mbi ndarjen e pasurisë, i miratuar nga Parlamenti Federal i Çekosllovakisë më 13 nëntor 1992, si "Ligji kushtetues mbi ndarjen e pasurisë së Çekosllovakisë mes Çekisë dhe Sllovakisë". Në këtë ligj, dhe në marrëveshjet që janë arritur më pastaj deri në mbylljen e këtij procesi në fillim të vitit 1993, tri parime kanë përbërë esencën e rregullës *equity* ashtu siç është zbatuar në këtë rast: parimi i numrit të popullsisë, i efektshmërisë dhe ai i relevancës. Zbatimi i këtyre tri parimeve në esencë ka ngjasuar mjaft me zbatimin e rregullës klasike mbi ndarjen, sipas të cilës duhet pasur parasysh raportin mes pasurisë së trashëguar dhe borxhit që merret përsipër. *Equity* në këtë rast ka shërbyer si udhërrëfyes dhe si rregull korrektuese e zbatimit të së drejtës ndërkombëtare, gjë që ka mundësuar që raporti "dy me një" të zbatohet pa ndonjë vështirësi të madhe mes dy shteteve të reja trashëgimtare. Cf. Paul Williams & Jannifer Harris, "State Succession to Debts and Assets: The Modern Law and Policy", fq. 400-407; Hubert Beemelmans, "State Successionin International Law: Remarks on Recent Theory and State Praxis", fq. 111-113.

[186] Ky opsion është quajtur *zero option agreement* ("marrëveshja pa mundësi zgjidhjeje" apo "marrëveshja pa mundësi për të zgjidhur") dhe ka dalë si rezultat i përpjekjeve të dështuara, në tri faza, për zgjidhjen e çështjes së aseteve dhe borxhit të ish-BRSS-së dhe trashëgimtarëve të tij. Në fazën e parë, shtetet trashëgimtare patën arritur një memorandum mirëkuptimi mes tyre, Moskë 28 tetor 1991, ku qe pranuar përgjegjësia e përbashkët dhe e ndarë e secilit

hyrja e jashtme ka konsistuar në respektimin e marrëveshjes së arritur mes aktorëve vendës, gjë që ka munguar në rastin e ish-Jugosllavisë për një kohë të gjatë deri me arritjen e MT.

E tërë kjo që u tha më sipër vlen edhe për parimin e fundit, po aq të rëndësishëm, parimin *rebus sic stantibus*, i cili shërben si instrument mjaft i dobishëm për interpretimin e dispozitave ekzistuese të KV I dhe II mbi trashëgimin e shteteve, si dhe i dispozitave të tjera të së drejtës ndërkombëtare që janë të zbatueshme ndaj trashëgimit të shteteve[187]. Megjithatë, MT nuk ka dispozita për respektimin e këtij parimi ngaqë të drejtat dhe detyrimet e trashëgimtarëve të ish-Jugosllavisë që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare nuk kanë qenë objekt kontestimi reciprok dhe një çështje problematike. Kjo është arsyeja pse as ne nuk shtjellojmë më tepër cilësitë karakteristike të këtij parimi të rëndësishëm.

---

për tërë borxhin e jashtëm të ish-BRSS-së (*joint and several liability*), kurse Banka për Aktivitete të Jashtme Ekonomike u autorizua që të administrojë këtë borxh sovjetik. Kjo rezultoi në shtyrjen e pagesës së borxheve nga ana e kreditorëve të jashtëm të ish-BRSS-së për tërë vitin 1992. Në fazën e dytë, 15 vendet trashëgimtare të ish-BRSS-së arritën një marrëveshje, Marrëveshjen e Minskut të datës 4 dhjetor 1991, për ndarjen në përqindje të borxhit dhe të pasurisë së ish-Bashkimit Sovjetik, duke përdorur formulimet e ngjashme me ato të MT. Në Marrëveshjen e Minskut, mes të tjerash, theksohet se palët janë të vetëdijshme "për faktin se garantimi dhe pagesa e borxhit të jashtëm sovjetik paraqet parakusht për hyrje në tregun botëror" dhe pranojnë marrjen parasysh "të parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe rregullave të Konventës së Vjenës të vitit 1983". Ky dokument ka shërbyer si bazë e formulimit tërësisht të ngjashëm të Deklaratës së Alma-Atas mbi formimin e Komonuelthit të Shteteve të Pavarura, datë 21 dhjetor 1991. Këto dy dokumente, megjithatë, nuk hasën në mirëkuptim të të gjitha vendeve trashëgimtare, ashtu që në fazën e fundit, Federata e Rusisë filloi një fushatë të lidhjes së marrëveshjeve bilaterale me kreditorët e jashtëm, duke marrë përsipër pagesën e tërë borxhit të jashtëm sovjetik, por edhe të pasurisë së atij shteti, sipas parimit *zero option agreements*. Për tekstin e Memorandumit të Mirëkuptimit, Deklaratën e Minskut dhe Marrëveshjen e Alma-Atas, shih në *International Legal Materials* vol. XXXI, no. 1 (January 1992) fq. 138-154; Për komentet e tyre, shih në Lech Antonowitcz, "The Disintegration of the USSR from the Point of View of International Law", *Polish Yearbook of International Law* vol. 19 (1991-1992) fq. 7-16; Hubert Beemelmans, "State Succession in International Law: Remarks on Recent Theory and State Praxis", fq. 110-111; Paul Williams & Jannifer Harris, "State Succession to Debts and Assets: The Modern Law and Policy", fq. 366-383; Rein Mullerson, "The Continuity and Succession of States by Reference to the Former USSR and Yugoslavia", fq. 473-493, në fq. 475-480.

[187] Guido Acquaviva, "The Dissolution of Yugoslavia and the Fate of Its Financial Obligations", *Denver Journal of International Law and Policy* vol. 30, no. 2 (Spring 2002) fq. 173-216, në fq. 185-194 dhe 206, 211-215.

2. Struktura e MT: pjesa kryesore dhe anekset

MT ka dy pjesë të ndara, të cilat megjithatë përbëjnë një tërësi unike. Pjesa e parë përbëhet prej pjesës kryesore, "Marrëveshja mbi çështjet e trashëgimit", e cila paraqet "ombrellën" ose kuadrin e MT, kurse e dyta përbëhet prej anekseve (shtatë sosh). MT, në pjesën e vet kryesore adreson çështjet kyçe të trashëgimit të ish-Jugosllavisë, ato më kontestueset që nga fillimi i procesit më 1992, të cilat kanë të bëjnë me: problemin e statusit juridik të republikave jugosllave kundrejt ish-Jugosllavisë, vendin dhe rolin e KV II, rolin dhe vendin e parimit të drejtësisë (*equity*), nivelin dhe natyrën e detyrimeve të ndërsjella të shteteve trashëgimtare dhe, fare në fund, çështjet e bashkëpunimit institucional mes subjekteve të barabarta të trashëgimit të ish-Jugosllavisë.

Pjesa e dytë, anekset e MT, mbulojnë këto segmente të trashëgimit si dhe të drejtat e detyrat që dalin nga to: Aneksi "A" pronën e tundshme dhe të patundshme të ish-Jugosllavisë; Aneksi "B" pronën e përfaqësive diplomatike e konsullore të ish-Jugosllavisë; Aneksi "C" asetet dhe detyrimet financiare të ish-Jugosllavisë; Aneksi "D" arkivat e ish-Jugosllavisë; Aneksi "E" pensionet e ish-shtetasve të Jugosllavisë; Ankesi "F" interesat, të drejtat dhe detyrimet tjera që nuk përfshihen me anekset e mëparshëm dhe që mund të dalin më vonë në syprinë; dhe, në fund, Aneksi "G" pronën private dhe të drejtat e fituara të personave privatë (fizikë dhe juridikë) në kohën e ish-Jugosllavisë.

Sikundër mund të vërehet, MT nuk përmban të gjitha njësitë e trashëgimit dhe të drejtat e detyrimet që dalin nga trashëgimi ndaj tyre. E kemi fjalën në rend të parë për trashëgimin ndaj çështjes së shtetësisë dhe anëtarësisë në organizatat ndërkombëtare. Po ashtu, as KV I dhe KV II nuk rregullojnë këto dy çështje. Meqë MT nuk flet për këto dy njësi, ngaqë nuk ka pasur probleme serioze rreth trashëgimit të tyre, as ne në këtë shkrim nuk jemi ndalur në to[188].

[188] Kjo gjendje është pasojë e faktit se lëmia e shtetësisë është kompetencë mjaft ekskluzive e shteteve, me disa kufizime për sa i përket detyrimit të shteteve për uljen e numrit të personave pa shtetësi. Shteti i vendit përcakton kushtet e tjera, përveç vendbanimit (domicilit) për fitim të shtetësisë së re, çka do të thotë se në të drejtën ndërkombëtare nuk njihet fitimi automatik i shtetësisë. Rregulla tradicionale ka qenë që vendbanimi (domicili) të jetë pikë referimi për fitim të shtetësisë së re në rastet e trashëgimit dhe si i tillë ka figuruar në marrëveshjet e paqes të lidhura pas dy luftërave botërore. Në rastin e ish-Jugosllavisë, vendbanimi (domicili) sikur ka mbetur ende pikë referimi por i kombinuar me kërkesën për shtetësinë dytësore të ish-republikës jugosllave. Kjo do të thotë se në të drejtën ndërkombëtare nuk ka fitim automatik të shtetësisë. Një gjë e tillë është reflektuar jo vetëm në ligjet mbi shtetësinë të ish-republikave jugosllave, të nxjerra pas vitit 1991, por edhe në dokumentet e propozuara mbi trashëgimin në këtë lëmi nga ana e Grupit Punues për Trashëgim të Konferencës për

3. Hedhja poshtë e kërkesës së RFJ-së për trashëgimtar të vetëm (kontinuitet) të ish-Jugosllavisë

Ka qenë prononcimi i parë i Komisionit Badinter, më 29 nëntor 1991,[189] ai i cili ka hapur rrugën për zgjidhjen përfundimtare të statusit juridik ndërkombëtar të ish-Jugosllavisë[190]. Në këtë prononcim, Komisioni pati theksuar, *inter alia*, se "Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë gjendet në procesin e shpërbërjes". Ky prononcim, me gjithë kundërshtimin e hapur serb[191],

---

ish-Jugosllavinë gjatë periudhës 1993-1996. Cf. Todor Djunov, "Succession of States in Respect of Citizenship: The Case of Former SFRY", *Development and Cooperation* vol. XII, no. 23 (December 1996) fq. 149-166.

Kosova nuk bën përjashtim aspak nga qasja sa më sipër e ish-republikave jugosllave. Kjo qasje është reflektuar në Ligjin Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës i datës 20 shkurt 2008. Cf. në veçanti Kapitullin II (nent 5-15) dhe Kapitullin V (nenet 28-29).

[189] "Conference on Yugoslavia. Arbitration Commission. Opinion No. 1", *International Legal Materials* vol. 31 (1992) fq. 1494-1497. Në opinionin tjetër, datë 4 korrik 1992, Badinter konstatoi se procesi i filluar në nëntor të vitit 1991 ka arritur fundin ashtu që, mes të tjerash, "RSFJ më nuk ekziston". "Conference on Yugoslavia. Arbitration Commission. Opinion No. 1", *International Legal Materials* vol. 31 (1992) fq. 1521-1523. Për komentet shih: Vladimir-Djuro Degan, "Yugoslavia in Dissolution: Opinion No. 1 of the Arbitration Commission of 7 December, 1991", *Croatian Political Science Review* vol. I, no. 1 (Zagreb, 1992) fq. 20-32; Alain Pellet, "The Opinions of the Badinter Committee: A Second Breath for the Self-Determination of Peoples", *European Journal of International Law* vol. 3, no. 1 (1992) fq. 178-182; Roland Rich, "Recognition of States: The Collapse of Yugoslavia and the Soviet Union". *European Journal of International Law* vol. 4, no. 1 (1993) fq. 36-65; Danilo Türk, "Recognition of States: A Comment", *European Journal of International Law* vol. 4, no. 1 (1993) fq. 66-72; Marc Weller, "The International Response to the Dissolution of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia". *American Journal of International Law* vol. 86, no. 3 (July 1992) fq. 569-607; Vladislav Jovanović, "The Status of the Federal Republic of Yugoslavia in the United Nations", *Fortham International Law Journal* vol 21, no. 5 (June 1998) fq. 1719-1736; Për qëndrim neutral ndaj punës së Komisionit Badinter, Cf. Michael C. Wood, "Participation of Former Yugoslav States in the United Nations and in multilateral Treaties", *Max Planck Yearbook of United Nations Law* vol. I (1997) fq. 231-257.

[190] Për laikët kanë ekzistuar tri shtete jugosllave, njëra e quajtur "Mbretëria e Jugosllavisë" (me rastin e themelimit e quajtur si "Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene"), tjetra Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë" dhe, së fundi, "Republika Federative e Jugosllavisë", e krijuar nga Millosheviq më 1992, e cila pas rrëzimit të tij nga pushteti e ndërroi emrin në "Unioni Serbi-Mal i Zi" (USMZ). Ndërrimi i emrit, në kohën sa ka qenë Millosheviq në pushtet, nuk ka qenë i mundur, sepse ruajtja e atij emri, sipas Millosheviqit, ka qenë simbolikë dhe identitet i njëjtësisë, përkatësisht i kontinuitetit shtetëror juridik-ndërkombëtar me ish-Jugosllavinë. Në pikëpamje shkencore dhe nga vetë praktika e së drejtës ndërkombëtare, ndërkaq, ka pasur vetëm një shtet jugosllav: ai që krijua pas Luftës së Parë Botërore dhe që u rrënua më 1992. Për këtë do të flitet akoma më shumë në vijim.

[191] Cf. "Position of SFR Yugoslavia on the Question of Internal Borders of Yugoslavia" (Belgrade, December 30, 1991), rishtypur në *Review of International Affairs* vol. XLIII (Belgrade,

ka gjetur përkrahje të parezervë në forumet ndërkombëtare, në rend të parë në Këshillin e Sigurimit dhe Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara[192], e më pastaj edhe në organizmat e tjerë ndërkombëtarë[193]. Për më tepër, edhe vendimet e gjykatave nacionale kur janë ndeshur më një çështje të tillë kanë pasur parasysh prononcimet e sipër cekura të Komisionit dhe vendimet autoritative të forumeve ndërkombëtare[194]. Pasojat praktike të këtyre qëndrimeve kanë qenë se RFJ mund të jetë vetëm njëri ndër trashëgimtarët e barabartë të ish-Jugosllavisë, pa pasur një trashëgimtar të vetëm të identitetit dhe kontinuitetit të saj shtetëror juridik-ndërkombëtar. Këtë fakt e ka sanksionuar MT në pjesën hyrëse të saj ku theksohet se, *inter alia*, pesë republikat jugosllave (Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Sllovenia dhe RFJ janë titullarë të barabartë në procesin e ndarjes së pasurisë, marrjen e detyrimeve si dhe në çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me trashëgimin e ish-Jugosllavisë[195].

February 5, 1992) fq. 23. Për komentet zyrtare serbe, cf. Vladislav Jovanović, "The Status of the Federal Republic of Yugoslavia in the United Nations", fq. 1719-1736; Për qëndrim neutral ndaj kësaj çështje, cf. Michael C. Wood, "Participation of Former Yugoslav States in the United Nations and in Multilateral Treaties", fq. 231-257. Për komentet tjera rreth refuzimit serb dhe historikun e këtij refuzimi, cf. Josip Metelko, *Sukcesija država s posebnim osvrtom na raspad bivše SFRJ*, fq. 262-289.

[192] Rezolutat 752, datë 15 maj 1992 dhe 757, datë 30 maj 1992, miratuar në takimet 3075 dhe 3082 respektivisht të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Për qëndrimet e njëjta të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Cf. Rezoluta nr. 47/1 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, datë 22 shtator. Tekstet në orgjinal te autori, ofruar nga Ministria e Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

[193] Vlen të theksohet se Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) ka qenë organizata e parë ndërkombëtare e cila ka deklaruar se RSFJ është shpërbërë si shtet. Cf. EBRD, Rezoluta e Bordit të Guvernatorëve nr. 30 mbi Anëtarësimin e Vendeve të cilat më parë kanë qenë pjesë e Jugosllavisë, 9 tetor 1992. Pas kësaj vijnë prononcimet e FMN, datë 14 dhjetor 1992, dhe BB, datë 25 shkurt 1993. Cf. IMF Press Release, 15 December 1992 dhe WB Press Release No. 93/543, 26 February 1993. Për komentet akademike, cf. Paul R. Williams, "State Succession and the International Financial Institutions: Political Criteria v. Protection of Outstanding Financial Obligations", *The International and Comparative Law Quarterly* vol. 43, no. 4 (October 1994) fq. 776-808 në fq. 779-782, 794-804; Ibrahim F.I. Shihata, "Matters of States Succession in the World Bank's Practice", fq. 75-93, në fq. 81-85.

[194] Gjykata Supreme e Austrisë në rastin "Republic of Croatia et al. v Girocredit Bank A.G. Der Sparkassen", 17 dhjetor 1996, *International Legal Materials* vol. 36 (1997) fq. 1522-1530. Në këtë vendim të Gjykatës Supreme të Austrisë gjenden elaborimet më të detajuara dhe me bazë të thellë shkencore në lidhje me kontinuitetin shtetëror të ish-Jugosllavisë, si dhe kundërshtimet e argumentuara dhe shkencore të pozicioneve serbe rreth kontinuitetit shtetëror jugosllav.

[195] Ka fare pak rëndësi rrethana që në MT nuk përdoret terminologjia standarde që është përdorur ndaj ish-Jugosllavisë, pra se fjala ka qenë për shpërbërje. Tani në MT figuron fjala

Kërkesa serbe për kontinuitet me ish-Jugosllavinë është e vjetër dhe ka ekzistuar në diskursin politik zyrtar dhe akademik serb që nga vitet e para të krijimit të atij shteti më 1918. Pas vitit 1918, serbët me këmbëngulje kanë insistuar se shteti i ri, Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene (i riemërtuar si "Mbretëria e Jugosllavisë" pas viti 1929) paraqet shtet të njëjtë dhe kontinuitet të Mbretërisë Serbe të para vitit 1918[196]. Aktivizimi i kërkesës së njëjtë pas vitit 1991 është vetëm vazhdim i këtij diskursi, në ndërkohë që në periudhën komuniste ka pasur një ngrirje të kësaj problematike[197]. Në literaturën serbe me të drejtë është vërejtur se kjo kërkesë serbe ka paraqitur thelbin e projektit mbi Serbinë e Madhe, të mbështjellë me petkun e ligjit ndërkombëtar[198].

Sllobodan Milosheviq këtë kërkesë e ka çuar përpara, por pa sukses. Në fillim ai ka ngelur vetëm në nivel të prononcimeve dhe këmbënguljes së zakonshme, duke shpresuar se një insistim i tillë do t'i sjellë më shumë të drejta në procesin e trashëgimit të ish-Jugosllavisë[199]. Më vonë ka ndërmarrë dhe

---

"prishje" (*break up*) në vend të saj. Cf. Preambula e MT, paragrafi i dytë. Pra, deri atëherë, serbët kanë insistuar që nuk flitet për shpërbërje (*dissolution*) apo për prishje (*break up*) por për shkëputje (*secession*) të pjesëve të caktuara të ish-Jugosllavisë ku RFJ (Serbia dhe Mali i Zi), e krijuar nga Millosheviqi më 1992, paraqet shtetin e njëjtë (dhe vetë vazhdimësinë) me ish-Jugosllavinë.

[196] Për qëndrimin serb, zyrtar dhe akademik, shih: Krystina Marek, *Identity and Continuity of States in International Law,* fq. 237-262; Mark Almond, *Europe's Backyard War: The War in the Balkans* (Heinemann: London, 1994) fq. 116-117; Slobodan Jovanović, *Ustavno pravo Kraljevine Srba, Hrvata i Slovenaca* (GZ "Makarije": Zemun, Beograd, 1924) fq. 12-21; Stevan Djordjević, *O kontinuitetu država s posebnim osvrtom na medjunarodno-pravni kontinuitet Kraljevine Jugoslavije i FNRJ,* fq. 162-163. Për kundërshtimet kroate e sllovene, qëndrimet negative të të cilëve, njëjtë si pas vitit 1991, qenë përkrahur nga bashkësia ndërkombëtare, cf. O Robarz, "Da li je naša Kraljevina nova ili stara država", *Arhiv za pravne i društvene nauke* knjiga XXIII (Beograd: 1933) fq. 241-261.

[197] Stevan Djordjević, *O kontinuitetu država s posebnim osvrtom na medjunarodno-pravni kontinuitet Kraljevine Jugoslavije i FNRJ*, fq. 97-114.

[198] Cf. Milan Bartoš, "Krystyna Marek: Identity and Continuity of States in Public International Law (Geneve 1954)", *Jugoslovenska revija za medjunarodno pravo* vol. I, nr. 1 (Beograd: 1954) fq. 290-293, në fq. 292. Millan Bartosh ka qenë jurist i njohur serb i viteve '60 dhe '70 të shekullit të kaluar. Për arsyetim të njëjtë nga autori tjetër serb, cf. Stevan Djordjević, *O kontinuitetu država s posebnim osvrtom na medjunarodno-pravni kontinuitet Kraljevine Jugoslavije i FNRJ*, fq. 97-114.

[199] Në të drejtën ndërkombëtare nuk ekziston një rregull e cila privilegjon shtetet trashëgimtare gjatë ndarjes së pronës shtetërore, pa marrë parasysh nëse ato shtete janë vazhdim i shtetit pararendës. Cf. Vladimir-Djuro Degan, "Disagreements over the Definition of State Property in the Process of State Succession to the Former Yugoslavia", në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States,* fq. 33-60; Rein Mullerson, "The Continuity and Succession of States by Reference to the Former USSR and Yugoslavia", fq. 473-493; Hanna Bokor-Szego,

hapa praktikë, sado që deri në fund janë treguar pa rezultat dhe naivë. Në këtë kontekst, ai ka lidhur marrëveshje[200] dhe ka bërë deklarata[201] me republikat e tjera jugosllave pas arritjes së Marrëveshjes së Dejtonit (nëntor 1995), duke shpresuar se ato do t'i mjaftojnë për të bindur bashkësinë ndërkombëtare në kërkesën e tij për njohje të kontinuitetit (vazhdimësisë) me ish-Jugosllavinë. Në të gjitha këto dokumente të bëra me republikat e tjera ish--jugosllave, figuron klauzola sipas së cilës bëhet njohja e kontinuitetit shtetëror të RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi) me ish-Mbretërinë Serbe, në njërën anë, dhe e kontinuitetit shtetëror të Maqedonisë, Kroacisë dhe Bosnjë-Hercegovinës respektivisht me format shtetërore të këtyre vendeve në të kaluarën sa ka ekzistuar ish-Jugosllavia dhe para saj kur është në pyetje Kroacia (dhe format e saj parashtetërore nga e kaluara). U mor vesh, këto përpjekje serbe ranë në ujë dhe dështuan sepse askush nga bashkësia ndërkombëtare nuk njohu kontinuitetin e RFJ-së me ish-Jugosllavinë[202]. Tani, shtrohet pyetja, pse serbët nën Sllobodan Millosheviqin insistuan aq shumë në kontinuitet shtetëror me ish-Jugosllavinë? Studiuesit të cilët janë marrë me trashëgimin e ish-Jugosllavisë me të drejtë kanë vërejtur se insistimi i tillë serb shpjegohet me iluzionet rreth ndarjes së borxhit te jashtëm dhe aseteve te ish-Jugosllavisë. Millosheviqi ka besuar, krejt në mënyrë naive, se nëse arrin që RFJ të konsiderohet kontinuitet (trashëgimtar i vetëm) i ish-Jugosllavisë, sipas definicionit, republikat e tjera do të quheshin secesioniste dhe nuk do t'u takonte asnjë aset, kurse borxhi i jashtëm ish-jugosllav do të ndahej sipas dëshirës dhe rregullave të cilat vetë serbët do t'i diktonin si shtet vazhdues i ish-Jugosllavisë. Kjo, sikundër u tha, nuk ka qenë e suksesshme dhe MT ka mbyllur këtë çështje njëherë e mirë, problematikë të cilën e trajtojmë në vijim të këtyre rreshtave.

"Questions of State Identity and State Succession in Eastern Europe and Central Europe", fq. 95-107.

[200] *The Agreement on Normalization of Relations and Promotion of Cooperation between Macedonia and the Federal Republic of Yugoslavia*, 8 prill 1996, teksti integral botuar në *Flaka e Vëllazërimit* (Shkup, 9 prill 1996); dhe *The Agreement on Normalization of Relations between the Federal Republic of Yugoslavia and Croatia*, 23 gusht 1996, teksti integral i botuar në *Review of International Affairs* vol. XLVII, no. 1048 (Beograd 1996). Për komentet e tyre, cf. Saskia Hille, "Mutual Recognition of Croatia and Serbia (+Montenegro)", *European Journal of International Law* vol. 6, no. 4 (1995) fq. 598-612.

[201] *Joint Statement* (Paris, 3 tetor 1996). Për komentet, cf. Charles Truchart, "Bosnia-Yugoslavia to Swap Embassies", *Washington Post Foreign Service* (4 October 1996).

[202] Për argumentim të ngjashëm, cf. Mirjam Skrk, "Recognition of States and Its (Non-) Implications on State Succession: The Case of Successor States to the Former Yugoslavia", në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States*, fq. 1-31, në fq. 23-30.

4. Kuadri për bashkëpunim institucional në MT

Puna rreth trashëgimit të ish-Jugosllavisë nën drejtimin e Arthur Wattsit qe ndërprerë në prag të luftës në Kosovë[203], për të vazhduar menjëherë pas rrëzimit të Millosheviqit nga pushteti në tetor të vitit 2000. Para arritjes së MT janë mbajtur dy takime në mes të palëve, një në Bruksel (dhjetor 2000) dhe tjetra në Lubjanë (shkurt 2001)[204]. Megjithatë, më herët nuk ka pasur ndonjë rrjet bashkëpunimi institucional, i cili u krijua vetëm me arritjen e MT. Tani ekzistojnë jo vetëm institucionet permanente për bashkëpunim gjatë fazës së implementimit të MT, por edhe mekanizma të tjerë për zgjidhjen e kontesteve lidhur me vetë zbatimin dhe interpretimin e MT.

Institucioni kryesor sipas MT është Komitetit i Përbashkët i Përhershëm (*Joint Standing Committee*; në tekstin e mëtejmë: KPP), të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e lartë të secilit shtet trashëgimtar[205]. Detyrë e KPP është mbikëqyrja e zbatimit efektiv të MT. Përveç kësaj, KPP shërben edhe si vend ku zgjidhen mosmarrëveshjet në mes të palëve[206]. Vendimet e tij nuk janë të detyrueshme për palët, dhe kjo paraqet një të metë të madhe të këtij organi[207]. Në njëfarë mënyre, KPP paraqitet si një lloj bashkëpronari nisur nga fakti se

---

[203] Mbledhja e fundit për çështjet e trashëgimit të ish-Jugosllavisë nën kryesinë e Arthur Wattsit është mbajtur më 6 dhe 7 nëntor 1997. Cf. *B92 Open Serbia* (Beograd, 6-7 nëntor 1997); *Odraz B92 Vesti* (Beograd, 11 nëntor 1997). Për komentet rreth ndërprerjes dhe vazhdimit të bisedimeve për trashëgimin e ish-Jugosllavisë, Cf. Ana Stanić, "Financial Aspects of State Succession: The Case of Yugoslavia", fq. 753; Sir Arthur Watts, "Introductory Note to the Agreement on Succession Issues Between the Five Successor States of the Former State of Yugoslavia", *International Legal Materials* vol. 41 (2002) fq. 1-2, në fq. 2.

Kosova nuk ka mundur të jetë palë trashëgimtare sepse nuk ka qenë shtet sovran dhe i pavarur. Siç e thamë më herët, trashëgimi i shteteve vjen në shprehje vetëm atëherë kur ndodhë zëvendësimi i një sovraniteti shtetëror me tjetrin, gjë që në Kosovë ka ndodhur vetëm më datën 17 shkurt 2008 e tutje. Më 10 qershor 1999 ka ndodhur vetëm suspendimi (pezullimi) i sovranitetit të Beogradit mbi Kosovën dhe ndalimi i Republikës së Kosovës që të ushtrojë çfarëdo juridiksioni nëpër territorin e Kosovës. Këtë pozicion tejet të saktë nga pikëpamja e të drejtës ndërkombëtare e ka konfirmuar Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (më tej shkurt: GjND) me mendimin e saj këshillëdhënës të datës 22 korrik 2010. Cf. "Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo". International Court of Justice, Advisory Opinion, 22 July 2010, në veçanti paragrafët 52-56; 74-84; 96-109; dhe 114-121.

[204] Ana Stanić, "Financial Aspects of State Succession: The Case of Yugoslavia", fq. 778.

[205] Cf. neni 4 i MT.

[206] Ibid., neni 5(2)(b).

[207] KPP mund të bëjë vetëm "rekomandime për qeveritë e shteteve trashëgimtare". Ibid. Neni 5(2).

të drejtat dhe detyrat e shteteve trashëgimtare janë e mirë e përbashkët e tyre të cilat qeverisen nga shtetet trashëgimtare nën drejtimin e KPP[208].

Me qëllim të mbikëqyrjes së implementimit të pjesëve të caktuara të MT, të cilat janë dëshmuar si më kontestueset gjatë viteve të mëhershme, është paraparë themelimi i disa mekanizmave të tjerë, të cilët kanë të bëjnë me shpërndarjen e sendeve të tundshme dhe të patundshme, ndarjen e pasurisë së përfaqësive diplomatike dhe konsullore, si dhe të aseteve dhe borxheve. Karakteristikë e këtyre komiteteve është se puna e tyre fillon ende pa hyrë në fuqi MT për shkak të rolit të madh që kanë në zgjidhjen e problemeve të hapura të trashëgimit të ish-Jugosllavisë e të cilat janë provuar si të vështira për zgjidhje në mes të palëve që nga dita e parë[209]. Në vijim të kësaj, shtetet trashëgimtare të ish-Jugosllavisë krijuan Komitetin e Përbashkët mbi Trashëgimin e Sendeve të Tundshme dhe të Patundshme (*Joint Committee on Succession to Movable and Immovable Property*; në tekstin e mëtejmë KPTSTP). Ky mekanizëm ka për qëllim që të përkujdeset për "zbatimin e drejtë të dispozitave […] të cilat zbatohen ndaj sendeve të prekshme të tundshme dhe të patundshme (përveç pasurisë ushtarake), si dhe zgjidhjen e problemeve që mund të lindin gjatë procesit të zbatimit të tyre"[210]. Përveç tij, MT parasheh themelimin edhe të komiteteve të tjera të përbashkëta. Këto komitete kanë për qëllim përcaktimin e vlerës së aseteve dhe të borxheve të pasurisë së përfaqësive diplomatike e konsullore të ish-Jugosllavisë, si shpërndarjen e aseteve dhe borxheve sipas çelësit të përcaktuar në MT[211].

---

[208] Këto të drejta dhe detyrime përfshijnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet të cilat i kanë takuar ish-Jugosllavisë dhe që nuk janë të përmendura në MT (përfshirë, pa u kufizuar në, të drejtat e patentave, vulës, të drejtat e autorit, honoraret, si dhe kërkesat e detyrimet tjera të ish-Jugosllavisë). Cf. ibid. Për sa i përket detyrimeve të ish-Jugosllavisë, Cf. neni 1, Aneksi F i MT. Neni 2 i Aneksit F të MT përcakton se "të gjitha kërkesat kundër RSFJ, të cilat nuk përfshihen me këtë marrëveshje duhet të shqyrtohen nga KPP, i themeluar në bazë të nenit 4 të MT.

[209] Ibid., Ankesi A, neni 5(2) ("Komiteti i Përbashkët do të fillojë punën brenda tre muajve nga dita e nënshkrimit të kësaj marrëveshje"); Aneksi B, neni 6 ("Komiteti i Përbashkët do të fillojë punën përkohësisht brenda tre muajve nga dita e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje"); Aneksi C, neni 6 ("Secili shtet trashëgimtar do të caktojë një përfaqësues të Bankës Qendrore, ose ndonjë përfaqësues tjetër, me qëllim të formimit të një komiteti i cili do të takohet brenda tridhjetë ditëve nga nënshkrimi i Marrëveshjes, me qëllim të përcaktimit të modaliteteve për shpërndarjen fillestare të identifikuar në nenin 5 të këtij aneksi"). Cf. po ashtu edhe nenin 12(2) të MT, i cili thekson se këto dispozita "do të jenë përkohësisht të zbatueshme pas datës së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, në pajtim me kushtet e përcaktuara këtu".

[210] Ibid., Aneksi A, neni 5(10).

[211] Ibid., Aneksi B (neni 5) dhe Aneksi C (neni 6).

Dallimet që lindin në lidhje me interpretimin ose implementimin e MT i nënshtrohen, në rend të parë, zgjidhjes "mbi bazën e diskutimeve në mes të shteteve të interesuara"[212]. Vetëm në rast se diskutimi i tillë nuk sjell rezultate, palët mund t'i drejtohen një personi të pavarur sipas zgjedhjes së tyre, të cilit i japin të drejtën për marrjen e vendimit të detyrueshëm[213]. Palët, në mënyrë alternative, mund ta dërgojnë çështjen në KPP, i cili ka të drejtën e marrjes së vendimit këshillues (jo të detyrueshëm për palët). Në raste të caktuara, sipas nismës së cilësdo palë, mosmarrëveshjet që dalin lidhur me interpretimin e MT mund t'i dërgohen për vendosje të detyrueshme një eksperti të vetëm, i cili caktohet me marrëveshje mes palëve apo, në mungesë të marrëveshjes, ai mund të caktohet nga kryetari i Gjykatës së Pajtimit dhe Arbitrazhit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë[214]. Kjo dispozitë synon që të pengojë ngecjet dhe bllokimet e mundshme të procesit të zgjidhjes së trashëgimisë së ish-Jugosllavisë. OSBE është zgjedhur nga palët për një rol të tillë sepse kjo organizatë regjionale ka pasur një involvim të madh në krizën dhe tragjedinë ish-jugosllave ashtu që palët e kanë parë atë si një aktor neutral në gjykimin edhe të çështjeve të tilla, siç është trashëgimi ndërkombëtar i ish-Jugosllavisë[215]. Për dallim nga KV II, MT nuk përmend fare mundësinë e involvimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Kjo nuk do të thotë se MT ka përjashtuar në tërësi mundësinë e involvimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në këtë proces, gjë që shihet nga formulimi sipas të cilit "kushtet nga neni 5 nuk i prekin të drejtat dhe detyrimet e palëve të cilat dalin nga dispozitat në fuqi për sa i përket zgjidhjes së mosmarrëveshjeve". Ofrimi i zgjidhjeve origjinale në lëminë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në MT, një e detyrueshme kurse tjetra jo, paraqet risinë dhe precedentin më të rëndësishëm të trashëgimit jugosllav, i cili mund të hyjë në punë në rastet e ardhshme të trashëgimit të shteteve.

---

[212] Neni 5(3) i MT.

[213] Neni 5(2) i MT flet për "vendosjen e shpejtë dhe me efekt detyrues të çështjes e cila duhet të respektohet nga palët dhe, sipas rastit, vendimi mund përcaktojë edhe afatet për veprimet që duhet të ndërmerren".

[214] Idem., neni 5(3).

[215] Në fakt, vetë ideja e formimit të kësaj gjykate të OSBE-së ka lindur nga Robert Badinter, kryetari i Komisionit të Arbitrazhit për ish-Jugosllavinë. Cf. Robert Badinter, "L' Europe du droit", fq. 15-23.

5. Prona e tundshme, prona e patundshme dhe prona e përfaqësive diplomatike e konsullore

Lidhur me ndarjen e patundshmërive të ish-Jugosllavisë, MT ka dispozita të cilat janë krejtësisht të ndryshme nga standardet ndërkombëtare të përcaktuara në KV II. Këto dispozita të reja dhe origjinale janë parashikuar për këto kategori: definimin e pronës së patundshme shtetërore; përcaktimin e momentit të trashëgimit të kësaj prone; kompensimin eventual për kalimin e pronës së tillë te trashëgimtarët; dhe, së fundi, dispozitat që caktojnë ligjin i cili zbatohet për definimin e pronës së patundshme të ish-Jugosllavisë.

Si moment të trashëgimit, MT ka përcaktuar në marrëveshje momentin e "deklarimit të pavarësisë" ashtu siç e kanë dëshiruar vetë palët e jo si thotë KV II[216]. Kjo do të thotë, sipas MT, se "prona e patundshme e RSFJ-së, e cila ka qenë në territorin e RSFJ-së, do të kalojë në shtetet trashëgimtare në territorin e të cilave ajo pronë gjendet"[217], kurse të drejtat pronësore "konsiderohet se kanë lindur që nga data e shpalljes së pavarësisë së shteteve të reja"[218].

KV II parashikon se prona e patundshme u takon atyre shteteve në territorin e të cilave gjendet prona e tillë dhe parashikon mundësinë e kompensimit në rast se një kalim i tillë i patundshmërisë prodhon efekte të padrejta për trashëgimtarët e ndryshëm. Kompensimi i tillë është kërkuar nga të gjitha ish-republikat jugosllave, përveç serbëve, të cilët kanë mbajtur në posedim pronën e tillë në pjesën më të madhe. E njëjta ka ndodhur edhe me ish-republikat sovjetike, si dhe me Çekinë dhe Sllovakinë[219], por pa sukses. MT nuk përjashton një mundësi të tillë por vetëm në rast të pajtimit të plotë për kompensim në mes të pesë ish-republikave jugosllave dhe atë pasi të jetë rekomanduar me konsensus nga trupat përkatës të themeluar sipas MT[220]. Në praktikë, kjo do të thotë se vështirë që mund të vijë deri te një kompensim i tillë konsensual.

Përveç kësaj risie, palët kanë futur edhe një qasje tjetër për identifikimin e pronës së ish-Jugosllavisë, e cila dallon nga modaliteti i KV II. Derisa KV II

---

[216] KV II pranon si moment të trashëgimit "datën kur shteti trashëgimtar ka zëvendësuar shtetin pararendës në përgjegjësitë e tij për marrëdhëniet ndërkombëtare të territorit". Cf. neni 2(d) i KV II.

[217] Neni 2(1), Aneksi A.

[218] Neni 7, Aneksi A.

[219] Cf. Paul Williams & Jennifer Harris, "State Succession to Debts and Assets: The Modern Law and Policy", fq. 366-383 dhe 400-407; Hubert Beemelmans, "State Succession in International Law: Remarks on Recent Theory and State Praxis", fq. 110-113.

[220] Cf. neni 5 dhe neni 8 (Aneksi A) i MT.

thotë se "ligji i brendshëm" përcakton se çka ka qenë pronë e shtetit pararendës[221], MT e bënë të kundërtën e kësaj. MT thotë se shteti trashëgues, pra jo shteti pararendës, "në territorin e të cilit gjendet pasuria e patundshme […] e përcakton vetë […] nëse prona e tillë ka qenë pasuri shtetërore e RSFJ-së në pajtim me të drejtën ndërkombëtare"[222]. Në ndërkohë që si pronë e RSFJ-së "konsiderohet tërë prona e tundshme dhe e patundshme e federatës së definuar si Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë"[223]. Kjo ka një kundërthënie logjike në shikim të parë, por del e kuptueshme nëse merret parasysh fakti se serbët gjatë tërë kohës kanë kundërshtuar zbatimin e pronoñcimeve të Badinterit dhe të KV I dhe II në çështjet e ndarjes së pronës, duke pasur në posedim të tyre shumicën e pronës së ish-Jugosllavisë. Ndarja e pronës së tundshme të ish-Jugosllavisë sërish është bërë në një mënyrë të ndryshme nga ajo që përcakton KV II[224]. Në KV II ndiqet parimi funksional, sipas të cilit prona e tundshme i takon shtetit aktiviteti i të cilit lidhet me pronën e tillë të tundshme që trashëgohet[225]. MT, ndërkaq, ka vepruar ndryshe duke e pranuar qasjen territoriale edhe ndaj pronës së tundshme. Kjo është bërë për arsye të faktit se serbët kanë mbajtur në posedim pjesën më të madhe të asaj prone. Qeveria e Serbisë ka përdorur këtë pronë për ndjekjen e qëllimeve të saja ushtarake. MT, me një fjalë, i është nënshtruar politikës *fait accompli* të Serbisë, duke përjashtuar nga trashëgimi pasurinë e tundshme ushtarake të ish-Armatës Jugosllave[226], kurse dëmet e luftës u për-

[221] Kjo do të thotë se në përcaktimin e asaj se çka paraqet pronë shtetërore të trashëgueshme duhet bazuar në definimet e asaj prone sipas ligjeve në fuqi të shtetit pararendës në momentin e trashëgimit. Cf. neni 8 i KV II.

[222] Neni 6, Aneksi A.

[223] Neni 1(1), Aneksi A i MT.

[224] Edhe në rastin e pronës së tundshme vlejnë rregullat e mësipërme për identifikimin e saj, pra atë e bënë shteti trashëgimtar në territorin e të cilit gjendet prona e tillë duke u mbështetur në të drejtën ndërkombëtare, jo në ligjin e brendshëm të shtetit pararendës siç thotë KV II. Cf. neni 6 i Aneksit A të MT.

[225] Cf nenet 14(b), 15(d), 17(b), 18(c) të KV II.

[226] Prona ushtarake përbëhej prej 75 për qind të pasurisë së ish-Jugosllavisë. Cf. Vladimir-Djuro Degan, "Dissagreements over the Definition of State Property in the Process of State Succession to Former Yugoslavia", fq. 50; Ana Stanić, "Financial Aspects of State Succession: The Case of Yugoslavia", fq. 755. Prona e ish-ushtrisë jugosllave përjashtohet nga trashëgimi. Ndarja e pronës së ish-ushtrisë jugosllave mund të bëhet vetëm nëse ekzistojnë marrëveshje të veçanta në mes të shteteve trashëgimtare për një ndarje të tillë. Cf. neni 4(2) i Aneksit A të MT.

jashtuan nga procesi i trashëgimit të ish-Jugosllavisë, ashtu siç pati propozuar më herët vetë Komisioni Badinter[227].

Sipas nenit 3(1) të Aneksit A të MT, "pasuria e tundshme shtetërore e RSFJ e cila është gjetur brenda territorit të RSFJ-së kalon në shtetin trashëgimtar në territorin e të cilit ajo pronë ka qenë e vendosur në ditën e shpalljes së pavarësisë". Paragrafi në vijim i nenit të njëjtë përjashton nga kjo kategori pronën me rëndësi kulturore e historike për popujt e ish-Jugosllavisë. Kjo dispozitë është vënë, nisur nga fakti se luftërat në ish-Jugosllavi kanë shkatërruar në masë të konsiderueshme pasurinë kulturore e historike të popujve jugosllavë. Ky përjashtim nuk shtrihet vetëm ndaj pronës së tundshme me rëndësi historike e kulturore që ka qenë e vendosur brenda territorit të ish-Jugosllavisë në ditën e pavarësimit të shteteve trashëgimtare, por edhe në atë pronë të tundshme e cila, sipas nenit 4(5) të Aneksit B, ka qenë e mbajtur jashtë vendit si pjesë e përfaqësive diplomatike e konsullore. Kjo dispozitë është një risi e madhe krahasuar me KV II e cila një mbrojtje të tillë u ofron vetëm materialeve arkivore, pra jo dhe pronës shtetërore të tundshme të pararendësit[228].

MT praktikisht ka ndjekur prononcimin e Komisionit Badinter mbi ndarjen e dëmeve të luftës nga trashëgimi i shtetit ish-jugosllav. MT nuk flet fare për dëmet e luftës, mirëpo formulimi i dispozitës së nenit 3(3) i Aneksit A adreson mundësinë e kthimit të pronës së tundshme e cila është marrë pa autorizim nga shtetet trashëgimtare, nëse ajo pronë ka qenë e vendosur në territorin e tyre në ditën e shpalljes së pavarësisë. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë shteti trashëgimtar që ka marrë pronën e tillë pa të drejtë detyrohet të bëjë kompensim të tërësishëm për pronën e tillë të marrë, u mor vesh përveç pronës ushtarake[229]. Nga kjo shihet qartë se kthimi ka përparësi ndaj kompensimit të këtij lloji të pronës shtetërore të ish-Jugosllavisë.

Në ndarjen e pronës së përfaqësive diplomatike dhe konsullore, e cila përbëhet vetëm prej një për qind të tërë pasurisë[230], trashëgimtarët e ish-Jugosllavisë kanë qenë më afër respektimit të dispozitave të KV II dhe të

---

[227] "International Conference on Former Yugoslavia. Arbitration Commission. Opinion No. 13", *International Legal Materials* vol. 32 (1993) fq. 1591-1592.

[228] Cf. neni 30(3) i KV II.

[229] Në të vërtetë, prona e ish-ushtrisë jugosllave që ka shërbyer për qëllime civile ka një tretman të njëjtë me pronën e tundshme nga neni 3(1) i Aneksit A të MT, pra, kalon në shtetin trashëgimtar në territorin e të cilit ka qenë ditën e shpalljes së pavarësisë.

[230] Cf. Vladimir-Djuro Degan, "Dissagreements over the Definition of State Property inthe Process of State Succession to Former Yugoslavia", fq. 50.

praktikës ndërkombëtare[231]. Me qëllim të arritjes së një ndarjeje të drejtë (*equity*), MT ka paraparë tri mënyra. Sipas mënyrës së parë, MT parashikon ndarjen sipas përzgjedhjes së vetë shteteve trashëgimtare të përfaqësive diplomatike e konsullore të ish-Jugosllavisë (neni 1 i Aneksit B). Mirëpo, kjo përzgjedhje është e natyrës së përkohshme dhe e pjesshme sepse MT në nenin e dytë flet për mënyrën e dytë të ndarjes, e cila duhet të respektojë përqindjet e caktuara kur të ketë përfunduar në tërësi ndarja e pronës së tillë (neni 3 i Aneksit B). Ato përqindje ndryshojnë nga përqindjet e zbatuara nga FMN dhe synojnë të jenë më të favorshme për Bosnjë-Hercegovinën dhe Maqedoninë (neni 2, para. 2 i Aneksit B), ashtu që tani duken për sa vijon: Bosnjë-Hercegovina 15 për qind; Kroaci 23,5 për qind; Maqedonia 8 për qind; Sllovenia 14 për qind; dhe RFJ 39,5 për qind. Këtë përqindje e përfshijnë edhe pronat e përfaqësive diplomatike e konsullore nga neni 1 i Aneksit B ku palët kanë bërë këtë përzgjedhje: Bosnjë-Hercegovina ka marrë ambasadën e ish-Jugosllavisë në Londër; Kroacia ka marrë ambasadën e ish-Jugosllavisë në Paris; Maqedonia ka marrë konsullatën e përgjithshme të ish-Jugosllavisë në Paris; Sllovenia ka marrë ambasadën e ish-Jugosllavisë në Uashington; dhe RFJ ka marrë rezidencën e ish-Jugosllavisë në Paris.

Në fund, si mënyrë të tretë, MT ka parashikuar se prona e luajtshme i takon shtetit trashëgimtar që ka marrë përfaqësinë diplomatike sipas dy mënyrave të sipërcekura, me përjashtim të pronës e cila paraqet rëndësi kulturore ose historike për ndonjërin prej shteteve trashëgimtare (neni 4, paragrafi 5 i Aneksit B). Kjo do të thotë se prona tjetër ndahet në mënyrë proporcionale duke synuar arritjen e përqindjeve si më sipër. Kjo mund të arrihet ose me marrëveshje në mes të vetë pesë trashëgimtarëve ose duke parashikuar procedura të veçanta në mes tyre për ndarjen e tillë, gjithnjë duke pasur parasysh përqindjet e mësipërme. Në nenin 4(1-5) MT parashikon se në kuadër të

---

[231] "Prona e patundshme shtetërore e shtetit pararendës e cila gjendet jashtë vendit u jepet shteteve trashëgimtare në proporcion të drejtë". Neni 18(1)(b) i KV II. Për komentet, Cf. P.K. Menon, *The Succession of States in Respect to Treaties, State Property, Archives and Debts* (The Edwin Mellen Press: Lewiston, N.Y., 1991) fq. 111. Insistimi serb në kontinuitetin shtetëror me ish-Jugosllavinë më së miri është reflektuar në sjelljet e serbëve karshi pronës së përfaqësive diplomatike dhe konsullore të atij shteti. RFJ (Serbia dhe Mali i Zi) tërë kohën është sjellë sikur ato të ishin pronat e saj, kurse të tjerët, secesionistët, sipas praktikës ndërkombëtare, zakonisht nuk kanë gëzuar të drejtën e trashëgimit të pronës së përfaqësive diplomatike e konsullore të shtetit pararendës i cili ka vazhduar të jetojë edhe pas shkëputjes së një pjesë të territorit të tij. Cf. Malcolm Shaw, *International Law* (Cambridge UP: Cambridge, 1995) fq. 613-614. Për dyshimet rreth këtij qëndrimi, Cf. Ana Stanić, "Financial Aspects of State Succession: The Case of Yugoslavia", fq. 769, fusnota nr. 91.

regjionit ku janë të vendosura pronat e tilla diplomatike e konsullore shtetet trashëgimtare kanë proporcionet e tyre në pronat e tilla deri sa të arrihet përqindja e parashikuar nga neni 3 i Aneksit B.

Në fund fare, vlen të theksohet se MT ka paraparë sjelljen me nikoqirllëk dhe me mirëbesim të palëve në duar te të cilës gjendet prona e tillë, deri në momentin e kalimit të saj në trashëgimtarin të cilit i takon sipas kritereve dhe mënyrave si më sipër, si dhe kompensimin në dobi të palës së dëmtuar në rast se në ndërkohë ka ndodhur humbja ose dëmtimi i pronës së tillë[232].

6. Asetet dhe detyrimet financiare

Asetet dhe detyrimet financiare janë pjesa më e parregulluar me KV II, kurse praktika e bazuar në to deri më 1991 ka qenë kryesisht në kontekstin kolonial[233]. Si KV II, ashtu dhe praktika shtetërore e kësaj kohe kanë mangësi në definimin e borxhit shtetëror dhe në parimin sipas të cilit duhen ndarë asetet dhe borxhet e shtetit pararendës. Në pikëpamje të borxhit, KV II pranon si borxh shtetëror vetëm nëse kreditori është "shtet, organizatë ndërkombëtare ose subjekt i së drejtës ndërkombëtare", kurse për mënyrë të ndarjes ofron "ekuilibrin në mes të borxhit që merret dhe aseteve që trashëgohen"[234]. Sikundër mund të vërehet, këtu merret parasysh vetëm interesi i vendeve trashëgimtare të cilat marrin përsipër borxhin (personi i debitorit), jo interesi i atyre të cilëve u duhet paguar borxhi (personi i kreditorit)[235]. Interesat e

---

[232] Cf. neni 7 i Aneksit B të MT.

[233] Mampuya Tashiabo, *Émergence des États nouveaux et droit international* (Presses universitaire du Zaire: Kinshasa, 1984) fq. 155-189; Annie Gruber, *Le Droit international et la succession d'États* (Faculte de Droit — Paris V: Paris 1986) fq. 13-22; Guido Acquaviva, "The Dissolution of Yugoslavia and the Fate of Its Financial Obligations", fq. 178-184; Paul Williams & Jennifer Harris, "State Succession to Debts and Assets: The Modern Law and Policy", fq. 355-417, në fq. 356-366; Pierre Michel Eisemann, "Rapport du directeur d'études de la section de langue française du Centre", në Pierre-Michel Eisemann et Martti Koskenniemi (eds.), *La succession d'États : la codification à l'epreuve des faits / State Succession : Codification Tested Against the Facts* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2000) fq. 3-64 në fq. 10-20, 47-62; Martti Koskenniemi, "Report of the Director of the Studies of the English-Speaking Section of the Centre", në Eisemann & Koskenniemi (eds), *La succession d'États*, fq. 65-132 në fq. 65-69, 90-96.

[234] Neni 41 i KV II.

[235] Cf. Stefan Oeter, "State Succession and the Struggle Over Equity: Some Observations on the Laws of State Succession with Respect to State Property and Debts in Cases of Separation and Dissolution of States", fq. 83-84; August Reinisch, *State Responsibility for Debts: Interna-*

kreditorëve privatë të cilët nuk janë "subjekte të së drejtës ndërkombëtare" do të ishin dëmtuar rëndë nëse do të ishte ndjekur kjo praktikë. Për të evituar zbatimin praktik të këtij definicioni dhe të kësaj praktike të mëparshme, organizatat ndërkombëtare qeveritare[236], por edhe vendet kreditore ("Klubi i Parisit") dhe kreditorët komercial ("Klubi i Londrës") kanë ndërhyrë fuqishëm në procesin e ndarjes së aseteve dhe të borxhit të jashtëm, si në ish-Jugosllavi ashtu dhe në rastet e ish-BRSS-së dhe Çekosllovakisë[237]. Kjo ndërhyrje ka qenë interes jo vetëm i faktorëve të sipërcekur ndërkombëtarë, por edhe i vendeve trashëgimtare për shkak të nevojës së tyre për integrim në tregun e kapitalit ndërkombëtar dhe zhvillimit të tyre ekonomik, një gjendje kjo e ndryshme nga koha e trashëgimit kolonial. Në këtë pikëpamje duhen shikuar hapat e Sllovenisë dhe të ish-republikave të tjera jugosllave, përjashtim RFJ/USMZ, të cilat në periudhën prej 1993 deri më 1996 kanë bërë marrëveshje dypalëshe me vendet e "Klubit të Parisit" dhe kreditorët e "Klubit të Londrës" për pagesën e pjesës së borxhit të tyre sipas proporcioneve të FMN-së[238], duke ia lënë RFJ/USMZ pjesën e borxhit të saj të paalokuar dhe asetet

---

tional Law Aspects of External Debt and Debt Restructuring (Bohlau: Vienna 1995) fq. 4-6 dhe 23.

[236] Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka për Zhvillim e Afrikës, Banka Ndëramerikane për Zhvillim, si dhe Banka për Zgjidhjet Ndërkombëtare. Nga këto organizma, Banka për Zgjidhjet Ndërkombëtare ka status të veçantë sepse marrëveshja e saj me trashëgimtarët e ish-Jugosllavisë paraqet aneks të MT. Cf. Shtojcën e MT, "BIS Assets", të datës 10 prill 2001.

[237] Për historikun e këtij involvimi shih në Mojmir Mrak, "Apportionment and Succession of External Debts: The Case of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia", fq. 11-20.

[238] Proporcionet e FMN kanë qenë për sa vijon: Bosnjë-Hercegovina 13,20 për qind, Kroacia: 28,49 për qind, Maqedonia: 5,40 për qind; Sllovenia: 16,39 për qind; dhe RFJ: 36,52 për qind. Çelësin e FMN-së e kanë pranuar edhe institucionet tjera qeveritare, ndërkombëtare dhe komerciale, përfshirë dhe Bankën Botërore, kurse vetë MT në mënyrë shprehimore thotë, në nenin 3 të Aneksit C, se "ndarjet e tilla të bëra më herët janë definitive dhe nuk mund të rihapen dhe të diskutohen nga asnjëri prej vendeve trashëgimtare në kontekstin e trashëgimit". Për komentet akademike, Cf. Paul R. Williams, "State Succession and the International Financial Institutions: Political Criteria v. Protection of Outstanding Financial Obligations", *The International and Comparative Law Quarter*ly vol. 43, no. 4 (October 1994) fq. 776-808, në fq. 779 (fusnota 14), 793-795; Ibrahim F. Shihata, "Matters of State Succession in the World Bank's Practice", fq. 75 dhe 87; Mojmir Mrak, "Succession to the Former Yugoslavia's External Debt: The Case of Slovenia", fq. 159-170; Mojmir Mrak, "Apportionment and Succession of External Debts: The Case of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia", fq. 165-170; Ana Stanić, "Financial Aspects of State Succession: The Case of Yugoslavia", fq. 758-763.

që i takojnë sipas përqindjes së njëjtë sikur trashëgimtarëve të tjerë[239]. MT pranon çelësin e institucioneve financiare ndërkombëtare si kriter për ndarjen e aseteve dhe borxhit të jashtëm të ish-RSFJ-së, duke lënë të paprekur marrëveshjet individuale të cilat trashëgimtarët e ish-Jugosllavisë i kanë lidhur gjatë periudhës 1993-1996 me vendet kreditore, bankat komerciale dhe organizatat e tjera ndërkombëtare financiare. Vetëm në këtë mënyrë ka mundur të arrihet deri te realizimi i parimit të drejtësisë në kontekstin e ish-Jugosllavisë, jo duke zbatuar KV II dhe praktikën e kontekstit kolonial. Ndërhyrja e institucioneve financiare ndërkombëtare ka qenë vendimtare në arritjen e marrëveshjes mes palëve trashëgimtare si në ish-Jugosllavi ashtu dhe në ish-BRSS dhe Çekosllovaki, sepse ka përcaktuar qartë kriteret e ndarjes së drejtë dhe ka imponuar disiplinë në këtë proces. Në rastin e ish-Jugosllavisë, kjo reflektohet fare qartë në Aneksin A (me dy shtojcat e tij) të MT.

MT ka pranuar në parim çelësin e FMN me rastin e ndarjes së aseteve të ish-Jugosllavisë. Kjo nuk do të thotë se palët në tërësi kanë zbatuar çelësin e përcaktuar nga FMN, i cili qe bazuar në disa faktorë, siç janë kontributi i ish-republikave jugosllave në prodhimin e përgjithshëm shoqëror, në eksportin e ish-Jugosllavisë, si dhe fuqia e tyre ekonomike karshi njëra-tjetrës[240].

---

[239] Shenjat e para se do të ndiqet një rrugë e tillë e ndarë për zgjidhjen e problemeve të aseteve dhe të borxheve financiare të ish-Jugosllavisë i ka dhënë Komisioni Badinter, i cili pati thënë, mes të tjerash, se mosbindja ndaj zgjidhjes me marrëveshje të problemeve të trashëgimit nga ana e ndonjërit prej shteteve trashëgimtare nuk është pengesë që tjerët të fillojnë një proces të tillë me ato vendet trashëgimtare që janë kooperative në këtë proces. Cf. "International Conference on the Former Yugoslavia. Abritration Commission. Opinion No. 12", *International Legal Materials* vol. 32 (1993) fq. 1589-1591. Kjo qasje e Komisionit dhe praktika e ndjekur nga vendet trashëgimtare të ish-Jugosllavisë ka shërbyer si një lloj mjeti për presion ndaj RFJ/USMZ, e cila më në fund është detyruar të pranojë tërë atë që është arritur në baza bilaterale në mes të vendeve trashëgimtare të ish-Jugosllavisë me institucionet financiare ndërkombëtare, kreditorët privatë dhe vendet kreditore. Për analizën e detajuar të historikut të marrëveshjeve bilaterale si dhe presionin ndërkombëtar ndaj vendeve trashëgimtare të ish-Jugosllavisë, Cf. Paul R. Williams, "State Succession and the International Financial Institutions: Political Criteria v. Protection of Outstanding Financial Obligations", fq. 793-804.

[240] Cf. fusnota nr. 125 *infra.* Një zbatim të shumë faktorëve e kanë aplikuar edhe vendet e ish-Bashkimit Sovjetik, kurse praktika e ish-Çekosllovakisë e ndarjes së aseteve dhe borxheve financiare bazohet vetëm në një faktor: madhësia e popullsisë së vendeve trashëgimtare. Për rastet e ish-BRSS-së dhe Çekosllovakisë, cf. Paul Williams & Jennifer Harris, "State Succession to Debts and Assets: The Modern Law and Policy", fq. 372, 383, 402-403, dhe 406; Hubert Beemelmans, "State Succession in International Law: Remarks on Recent Theory and State Praxis", 110-113.

Modifikimet e çelësit të ndjekur nga FMN janë sanksionuar në nenin 5(2) të MT[241]. Ato tani duken kështu: Bosnjë-Hercegovina 15,5 për qind; Kroacia 23 për qind; Maqedonia 7,5 për qind; Sllovenia 16 për qind; dhe RFJ/USMZ 38 për qind. Kjo ndarje vlen në veçanti për këto asete: për 27 për qind të kapitalit të ish-Bankës së RSFJ-së për Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar[242]; për shumën neto të kërkesave të Bankës Nacionale të ish-RSFJ-së ndaj vendeve të tjera[243]; për asetet e huaja financiare, siç janë paratë e gatshme, ari dhe metalet tjera të çmueshme; llogaritë e depozituara dhe sigurimet e drejtpërdrejta ose bashkërisht me bankat e huaja të mbajtura nga ish-RSFJ ose Banka Nacionale e ish-RSFJ-së [244]; dhe, në fund, për asetet financiare të jashtme aktualisht të panjohura për palët[245].

Mënyra si është bërë ndarja e borxhit të jashtëm të ish-Jugosllavisë paraqet risi në disa drejtime. Në rend të parë, vlen të theksohet se palët në MT kanë pranuar çelësin e FMN-së edhe për ndarjen e borxheve[246]. Në rend të dytë, ndarja e borxhit të jashtëm në MT nuk ndjek rrugën e KV II sipas së cilës duhet të ketë një ekuilibër në mes të aseteve që trashëgohen dhe borxhit që merret përsipër nga trashëgimtari. Zbatimi i kësaj formule është provuar në kontekstin e ish-BRSS-së dhe Çekosllovakisë[247] por pa sukses. Kreditorët e jashtëm nuk kanë pranuar një gjë të tillë dhe kanë insistuar në përgjegjësinë e ndarë dhe të përbashkët (*joint and several liability*). Mënjanimi i kësaj klauzole është bërë i mundur vetëm kur kreditorët e jashtëm kanë vërejtur se vendet trashëgimtare të ish-federatave socialiste janë serioze në marrjen përsipër të borxhit të tyre të paalokuar (borxhin federal)[248]. Ky ka qenë një proc-

---

[241] Për çelësin e përdorur nga FMN, cf. fusnota nr. 180 *supra.*

[242] Aneksi C, neni 4(a) i MT.

[243] Aneksi C, neni 4(b) i MT.

[244] Aneksi C, neni 5(1) i MT.

[245] Aneksi C, neni 5(3) i MT.

[246] Neni 3, para. 1-3 i Aneksit C të MT.

[247] Cf. fusnota nr. 26 *infra.*

[248] Për rastin e ish-Jugosllavisë, cf. neni 2 para. 1-2 i Aneksit C të MT. Për komentet rreth përgjegjësisë së ndarë dhe të përbashkët (*joint and several liability*), si dhe për marrjen përsipër të borxhit të paalokuar në tri rastet e ish-federatave komuniste, shih më shumë në: Stefan Oeter, "State Succession and Struggle Over Equity: Some Observations on the Law of State Succession With Respect to State Property and Debts in Cases of Separation and Dissolution of States", fq. 76-83; Andrea Gioia, "State Succession and International Financial Institutions", botuar në Pierre Michel Eismann & Martti Koskenniemi (eds.), *La succession d'États : la codification à l'epreuve des faits / State Succession: Codification Tested Against the Facts*, fq.327-383 në fq 355-383; Mojmir Mrak, "Apportionment and Succession of External Debts: The Case of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia", fq. 12-20; Vladimir-Djuro

es i vështirë, i komplikuar dhe i gjatë. Ky borxh, në praktikën standarde të së drejtës ndërkombëtare nuk përfshin as borxhin lokal (të kontraktuar nga autoritetet regjionale, ish-republikat dhe krahinat autonome) e as borxhin e lokalizuar (të kontraktuar nga ish-federatat komuniste në dobi të autoriteteve regjionale, ish-republikave dhe krahinave autonome)[249]. Këto dy lloje të borxhit kalojnë në mënyrë automatike në barrë të shteteve të reja trashëgimtare sipas rregullës së "përfituesit të fundit", pra, kush ka qenë përfitues nga borxhi i tillë[250].

Kjo mënyrë e ndarjes së borxhit të paalokuar të ish-Jugosllavisë ka nënkuptuar se ndarja e kryer borxhit të paalokuar të ish-Jugosllavisë, sipas çelësit të FMN-së, si dhe veprimet e kryera dypalëshe mes FMN-së, Bankës Botërore, vendeve të "Klubit të Parisit", si dhe bankave komerciale të "Klubit të Londrës", paraqesin një zgjidhje të përhershme dhe të mbyllur. Këtë e thotë në mënyrë shprehimore MT në neni 3 paragrafi 3, Aneksi C, kurse në paragrafin e dytë të po këtij neni theksohet se palët nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim ligjor kundër njëri-tjetrit ose të hapin ndonjë procedurë karshi njëri-tjetrit për kërkesat që kanë të bëjnë me kërkesat financiare të cilat lidhen me detyrimet ndaj "Klubit të Parisit" ose "Klubit të Londrës". Kjo është

Degan, "State Succession, Especially in Respect of State Property and Debts", *The Finnish Yearbook of International Law* vol. 4 (1993) fq. 130-193, në fq. 143-146; Hubert Beemelmans, "State Succession in International Law: Remarks on Recent Theory and State Praxis", fq. 110-118; Paul Williams & Jennifer Harris, "State Succession to Debts and Assets: The Modern Law and Policy", fq. 368-383, 396-407.

[249] Borxhi i jashtëm publik në të drejtën ndërkombëtare ndahet në borxhin nacional, borxhin lokal dhe në borxhin e lokalizuar. Borxhi nacional është borxhi për të cilin përgjigjet në mënyrë ekskluzive shteti. Në rastin e ish-federatave socialiste, ai quhet borxh federal. Cf. Stefan Oeter, "State Succession and the Struggle over Equity: Some Observations on the Laws of State Succession with Respect to State Property and Debts in Cases of Separation and Dissolution of States", fq. 87. Ndarjen si kjo e ka bërë për herë të parë Asociacioni për të Drejtën Ndërkombëtare më 1970. Cf. International Law Association, *Report of the Fifty-Fourth Conference held at the Hague,* 23rd-20th August, 1970 (London: 1971) fq. 108; shih po ashtu Mohammed Bedjaoui, *Ninth Report on Succession of States in Respect of Matters Other Than Treaties* (Doc. A/CN.4/301 and Add. 1 of 13 and 20 April 1977, para. 2, 3, 6, 14, 16, 18-19, 22-24, 29, 32-33, 40, 63 dhe 118; 1418th Meeting of 13 May 1977, para. 38); dhe Mohammed Bedjaoui, *Thirteenth Report on Succession Of States in Respect of Matters Other Than Treaties* (Doc. A/CN.4/345/Add. 1 of 29 May 1977), para. 127, 129, 132, and 157; Përveç kësaj ndarje, borxhet nganjëherë ndahen edhe në borxhe të a.q. *odioze* (borxhet e marra për qëllim të zhvillimit të operacioneve luftarake dhe për shuarjen e kryengritjes), të cilat nuk mund të jenë objekt trashëgimi, dhe borxhet e ndërmarrjeve publike, trashëgimi i të cilave është mjaft i diskutueshëm në praktikën e shteteve. Cf. P.K. Menon, The *Succession of States in Respect to Treaties, State Property, Archives, and Debts*, fq. 157-170.

[250] Neni 2(b) i Aneksit C të MT.

bërë për të siguruar vendet e "Klubit të Parisit" dhe kreditorët komercialë të "Klubit të Londrës" se mosmarrëveshjet eventuale në mes të palëve nuk do të reflektohen në asnjë mënyrë në marrëveshjet e arritura bilaterale në mes të kreditorëve të sipërcekur dhe ish-republikave jugosllave. Mungesa e kësaj klauzole sigurisht që do ta kishte vënë në lëvizje rikthimin e sistemit të "përgjegjësisë se ndarë dhe të përbashkët" (*joint and several liability*) të ish-republikave jugosllave.

Kosova nuk përbën përjashtim nga kjo qasje, pra nga qasja e zbatuar ndaj ish-Jugosllavisë për sa i takon aseteve dhe detyrimeve financiare. Nuk pranohet si mënyrë ndarje ndjekja e "ekuilibrit në mes të borxhit që merret dhe aseteve që trashëgohen" nga neni 41 i KV II e as zbatimi i parimit të "përgjegjësisë së ndarë dhe të përbashkët" (*joint and several liability*) për arsye se Kosova është e fundit si shtet sovran dhe i pavarur që del nga territori ish-jugosllav më 17 shkurt 2008. Kjo domethënë se karshi Kosovës qëndron një proces i mbyllur i trashëgimit shtetëror të ish-Jugosllavisë i bazuar në MT, kurse Kosova si shtet nuk mund të trashëgojë më ish-Jugosllavinë por vetëm Republikën e Serbisë. Kjo më tutje nënkupton se formalisht nuk mund të zbatohet MT, por që në esencë, sa i takon aseteve dhe detyrimeve financiare, por edhe kufijve dhe disa segmenteve të tjera, në tërësi është ndjekur rruga dhe fryma e njëjtë me atë të ndjekur me rastin e zbatimit të MT.

Se gjendja është si më sipër, shihet qartë nga qarkullimi i dokumentacionit tejet sekret të FMN-së dhe Bankës Botërore, që ngërthen edhe detyrimet ndaj "Klubit të Parisit" dhe "Klubit të Londrës"[251]. Në këtë dokumentacion me saktësi përcaktohet shuma e borxhit aktual të paalokuar të Kosovës, i cili kap shumë afro 689 milionë euro[252].

---

[251] Borxhi i alokuar i Kosovës nuk është kontestues. Kosova në mënyrë automatike ka trashëguar borxhin e tillë si "përfitues i fundit" dhe kryesisht ka të bëjë me dy-tri kredi të marra nga Banka Botërore në mesin e viteve 1970. Këtu e kam fjalën për borxhin regjional të cilin Kosova vetë sipas Kushtetutës së vitit 1974 ka pasur të drejtë ta kontraktojë. Mirëpo, në sasinë e borxhit të lokalizuar, të cilin ish-federata jugosllave e ka kontraktuar në emër të Kosovës, hyjnë edhe shumë kontraktime tjera të kryera për ose në emër të Kosovës me qëllim të zhvillimit të bujqësisë dhe promovimit të ndryshimeve strukturore në ekonominë e atëhershme të Kosovës. Tekstet e këtyre marrëveshjeve duhet të gjenden në arkivat e Beogradit dhe të ish-republikave jugosllave (kopjet e tyre), sepse ato kanë shërbyer si bazë për përcaktimin e borxhit (automatikisht) të alokuar të Serbisë të marrë në emër të (territorit të) Kosovës sipas dispozitave të MT.

[252] Cf. Establishment of the Kosovo Debt Menagement Support Program (KDMSP), dated June 9, 2008, Confidential: R 2008-0135, IDA/R 2008-0218, June 12, 2008.

7. Arkivat

Në ndarjen e arkivave të ish-Jugosllavisë më së shumti është respektuar KV II. Kjo nuk do të thotë se MT nuk ka futur zgjidhje të reja në këtë drejtim[253]. Ato kanë të bëjnë me zbatimin e parimit territorial, funksional (organik)[254], si dhe me parimin e integritetit të koleksionit arkivor me rastin e ndarjes së tij[255].

KV II niset nga parimi se dokumentet dhe materiali arkivor i "çfarëdo lloji dhe date" që është i nevojshëm për funksionimin normal të administratës në territorin e trashëguar përfshihet në trashëgim[256]. Kjo ka të bëjë si me arkivat administrative ashtu dhe me ato që nuk kanë natyrë të tillë por që janë të rëndësishme nga pikëpamja historike e kulturore. Arkivat politike nuk trashëgohen[257]. KV II, sikundër vërehet, nuk flet për njësitë të cilat përbëjnë dokumentet dhe materialin tjetër arkivor[258]. Këtë paqartësi e ka evituar MT, e cila në nenin në nenin 1(a) të Aneksit D i konsideron si arkiv:

> të gjitha dokumentet, të çfarëdo lloji e date, të vendosura kudo, të cilat janë prodhuar ose pranuar nga RSFJ [...] në vijim të ushtrimit të funksioneve të saj si shtet dhe të cilat, më 30 qershor 1991, i kanë takuar

---

[253] Arkivat shtetërore të ish-Jugosllavisë kanë qenë objekt diskutimi në mes të shteteve trashëgimtare që nga viti 1992, por pa ndonjë rezultat të prekshëm. Problemet kanë lindur qysh në fillim dhe kanë pasur të bëjnë me definimin e termit "arkiv shtetëror". Cf. Vladimir-Djuro Degan, "State Succession, Especially in Respect of State Property and Debts", fq. 130-193, në fq. 149. Për historikun e këtyre bisedimeve dhe ofertat e ndërmjetësuesve ndërkombëtarë, sikundër dhe për qëndrimet e kundërta të palëve vendore, shih më shumë në Marija Oblak-Carni & Born Bohte, "Succession to the Archives of the Former SFR Yugoslavia", në Mojmir Mrak, *Succession of States*, fq. 171-185, në fq. 178-185.

[254] Termin "lidhje organike" të arkivave me territorin e ka përdorur për herë të parë P.K. Menon. Cf. P.K. Menon, *The Succession of States in Respect to Treaties, State Property, Archives and Debts*, 136.

[255] Për komentet e parimeve të territorialitetit, funksionalitetit dhe të integritetit arkivor, cf. P.K. Menon, *The Succession of States in Respect to Treaties, State Property, Archives and Debts,* fq. 119-149.

[256] Neni 31(1)(a) i KV II. Në nenin 3 të Aneksit D të MT, në vijim të zbatimit të parimit territorial, thuhet se: "ajo pjesë e arkivave shtetërore të RSFJ-së (që ka natyrë administrative, aktuale ose që paraqet shënime arkivore) e cila është e domosdoshme për funksionimin normal të administratës së territorit të njërës prej shteteve trashëgimtare, në pajtim me parimin e përkatësisë funksionale, kalon në ato shtete, pa marrë parasysh vendndodhjen e tyre momentale".

[257] Cf. P.K. Menon, *The Succession of States in Respect to Treaties, State Property, Archives and Debts*, fq. 142-144.

[258] Kjo mangësi është kritikuar nga doktrina. Cf. P.K. Menon, *The Succession of States in Respect to Treaties, State Property, Archives and Debts*, fq. 123.

> RSFJ-së sipas ligjit në fuqi dhe që janë ruajtur si arkiv qoftë nga vetë ajo ose nën kontrollin e saj , pa marrë parasysh qëllimin e tyre.

Kurse në po atë nen, nën pikën (b), flet për dokumentet që përbëjnë materialin arkivor i cili është objekt trashëgimi mes pesë shteteve të reja. Kjo nuk do të thotë se ka mundur të përpilohet një listë shteruese e gjithë dokumenteve dhe materialit arkivor që trashëgohet. Ky formulim lë hapësirë për mosmarrje të përgjegjësisë për arkivat që trashëgohen për një periudhë disamuajshe (qershor 1991–korrik 1992) për shkak se mungon shteti pararendës i cili është zhdukur pikërisht në këtë periudhë.

KV II lidhur me parimin organik jep formulimin sipas të cilit "lidhja e drejtpërdrejtë e arkivave të shtetit pararendës me territorin e shtetit trashëgimtar" paraqet kusht të mjaftueshëm për trashëgimin e tyre, pa dhënë ndonjë kriter për të gjykuar se cila është kjo lidhje direkte. MT në këtë drejtim është më specifike dhe përmban, përveç formulimit mbi "lidhjen e drejtpërdrejtë të territorit me arkivin që trashëgohet" edhe formulimin që lidhet me faktin se ato janë prodhuar si të tilla nga shteti trashëgimtar ose janë marrë në emër të tij në të kaluarën[259].

Sipas parimit të integritetit arkivor, trashëgimtarët me rastin e ndarjes së arkivave shtetërore duhet të kenë kujdes që të mos e dëmtojnë tërësinë e të dhënave dhe informacionin arkivor si tërësi. Në MT kjo shprehet me kujdesin që duhet pasur në mënyrë që "sa më shumë që të jetë e mundur të respektohet integriteti i grupeve të arkivave të RSFJ-së pa marrë parasysh se ku do të ruhen grupet e tilla të arkivave". Zbatimit të këtij parimi i shërben edhe neni 6 i Aneksit D i cili parashikon mundësinë e lënies në "trashëgim të përbashkët" të arkivave shtetërore të ish-Jugosllavisë, përveç atyre nga neni 3 dhe 4, të cilat nuk mund të ndahen në mënyre të drejtë (*equitable*) në mes të shteteve trashëgimtare të ish-Jugosllavisë. Me qëllim të lehtësimit të këtij procesi parashikohet formulimi i listës së veçantë nga ana e shteteve trashëgimtare për arkivat të cilat mbesin "trashëgimi e përbashkët"[260]. Funksion të njëjtë të ruajtjes së integritetit arkivor, përveç arkivave që mbesin "trashëgimi e përbashkët", ka edhe neni 5 i Aneksit D të MT. Ky nen parashikon se palët mund të merren vesh se cila nga to do ta mbajë origjinalin, kurse të tjerëve t'i bëjnë kopjet në rastet kur "arkivat u takojnë një ose më shumë shteteve

[259] Neni 4(a)(ii) i Aneksit D të MT.
[260] Cf. Neni 6(b) i Aneksit D të MT.

trashëgimtare"[261]. Vlen të theksohet, megjithatë, se parimi i integritetit arkivor, ose i ruajtjes së koleksionit arkivor siç e thonë disa autorë, nuk guxon të shkojë në dëm të nevojave të realizimit të dy parimeve të sipërcekura[262].

Sa i përket Kosovës, në çështjet e arkivave nuk ka pasur ndonjë lëvizje konkrete në praktikë. Në Planin Ahtisaari nuk ka dispozita mbi këtë çështje. I vetmi hap që është ndërmarrë në këtë drejtim ka të bëjë me "Konkluzionet e Brukselit", të arritura në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë më datën 2 shtator 2001[263]. Në këtë dokument parashihet që të bëhet dorëzimi i kopjeve të regjistrave kadastralë palës kosovare. Dorëzimi i kopjeve në fjalë në këtë rast bëhet për të dhënë mesazh të qartë në publik se origjinali do të mbetet në duart serbe e kjo do të thotë se Serbia i konsideron ato origjinale si pjesë organike të "territorit serb" në Kosovë dhe se vetëm ajo si shtet ka të drejtën ekskluzive të ruajtjes së integritetit arkivor të regjistrave të tillë kadastralë.

8. Prona private dhe të drejtat e fituara

Tërësia e rregullave dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e fituara ka për qëllim kufizimin e arbitraritetit shtetëror me rastin e ndërrimit të sovraniteteve territoriale. Si të tilla, ato nuk janë kufizime të sovranitetit, por kanë për qëllim mbrojtjen e marrëdhënieve private të individëve dhe personave të tjerë juridikë dhe privatë me rastin e ndërrimit në sovranitetin territorial[264]. Zbatimi i këtyre normave dhe parimeve me rastin e trashëgimit, pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, ka dëshmuar fuqishëm se ato

---

[261] Për mënyrën e bartjes së shpenzimeve të transporti dhe të fotokopjimit të materialit arkivor, Cf. zgjidhjen standarde në nenin 7 të Ankesit D të MT.

[262] Cf. Eli Nathan, "The Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts", fq. 504.

[263] Cf. Agreed Conclusions of 2 September 2011 (Cadastral Records). Përveç këtyre, në Bruksel, më 2 korrik 2011, është arritur edhe nënshkrimi i një dokumenti tjetër, në formë konkluzioni me të cilin rregullohet çështja e librave të regjistrave civilë të cilat Serbia i ka marrë me vete pas mbarimit të luftës më 10 qershor 1999. Edhe këtu është zbatuar parimi i njëjtë, pra Kosova merr kopjet e certifikuara, kurse origjinali mbetet në Serbi. Cf. Agreed Conclusions of 2 September 2011 (Civil Registry Books).

[264] August Reinisch, *State Responsibility for Debts: International Law Aspects of External Debt and Debt Restructuring*, fq. 86, 88-89; Georges Kaeckenbeeck, *The Protection of Vested Rights in International Law* (Oxford UP: Oxford, 1936) fq. 8.

paraqesin një pjesë të së drejtës ndërkombëtare zakonore[265]. Një dëshmi të tillë paraqet edhe historiku i këtyre rregullave dhe parimeve në të kaluarën, me përjashtim të periudhës së dekolonizimit kur sovranitetet e reja territoriale, të bazuar në doktrinën e njohur të "pjatës së pastër", seriozisht cenuan rregullat dhe parimet mbi të drejtat e fituara[266]. Në kohën para dekolonizimit, të drejtat e fituara kanë gjetur përkrahjen si të gjykatave nacionale[267], ashtu dhe të atyre ndërkombëtare[268], por edhe kanë qenë objekt i rregullimit normativ shumëpalësh[269] dhe dypalësh[270]. Edhe në rastet kur janë cenuar ato, kjo

---

[265] Cf. Carsten Stahn, "The Agreement on Succcession Issues of the Former Socialist Federal Republic of Yougoslavia", fq. 395.

[266] Kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur dokumente ndërkombëtare të kohës të cilat kanë synuar zbutjen e kësaj ndërhyrjeje brutale të sovraniteteve të reja territoriale, por që zbatimi ka qenë fare i papërfillshëm. Për praktikën e shteteve në këtë periudhë, cf. "ILC Report on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts", *The Yearbook of the International Law Commission* vol. II, part 2 (1981) fq. 79-80; Për komentet doktrinare që arsyetojnë politikat e nacionalizimit, cf. Yao Kunalè Eklo, *Le principe de droits acquis : la nationalisation et les "nouveaux États"* në serinë *Cahiers libres de l'Institut national de la recherche scientifique* vol. 1 (Institut national de la recherche scientifique: Lomé, Togo, 1974) fq. 7-11, 15-25; Hanna Bokor-Szego, *New States and International Law* (Akademiai Kaido: Budapest, 1970) fq. 52-72. Për komentet që mbrojnë të drejtat e fituara, përfshirë edhe normat mbi të drejtat e njeriut si ndërhyrëse në procesin e mbrojtjes të së drejtave të fituara, shih më shumë në: Thomas Ebenroth & Matthew James Kemner, "The Enduring Political Nature of Questions of State Succession and Succession and the Quest for Objective Standards", *University of Pennsylvania Journal of International Economic Law* vol. 17, no. 3 (Fall 1996) fq. 753-819; Pierre-Michel Eisemann, "Rapport du Directeur d'études de la section de langue française du Centre", fq. 60-61; 106-108; Sandrine Maljean-Dubois, "La rôle de l'équité dans le droit de la succession d'États", botuar në Eisemann & Koskenniemi (eds.), *La succession d'États*, fq. 137-184, në fq. 151; Isabelle Poupart, "Succession aux traite et droit de l'home: vers la reconnaissance d'une protection ininterrompue des individus", në Eisemann & Koskenniemi (eds.), vep. cit., fq. 465-490, në fq. 467-468, 475; Maria Isabel Torras Cazorla, "Rights of Private Persons on State Succession: An Approach to the Most Recent Cases", në Eisemann & Koskenniemi (eds.), vep. cit., fq. 663-717, në fq. 663, 667-679 dhe 686-712.

[267] Parimi sipas të cilit të drejtat private të fituara sipas ligjeve të vjetra duhet të ruhet është pranuar mjaft në praktikë. Në rastin *United States v Percheman* (1819), kryetari i gjykatës Marshall pati dhënë në mënyrë elokuente esencën e këtij parimi: "zakoni modern i kombeve, i cili është bërë ligj, do të cenohej, kuptimi i drejtësisë dhe i të drejtës së njohur nga bota e civilizuar do të ofendoheshin, sikur prona të konfiskohej, kurse të drejtat private të anuloheshin". Cf. *United States v Percheman*, 32 U.S. 51 (1833). Për komentet akademike, shih në Sir Hersch Lauterpacht, *The Development of International Law by the International Court* (Stevens & Sons: London, 1958) fq. 319-320.

[268] Cf. "Colons allemands au Pologne", CPJI serie B, no. 6 (1923) fq. 36.

[269] Neni 35 i Aktit Final të Berlinit mbi Kongon. "The General Act of the Berlin Congo Conference (1845)", ribotuar në Arthur Berriedale Keith, *The Belgian Congo and the Berlin Act* (Clarendon Press: Oxford, 1919). Për komentet, cf. Daniel de Leon, "The Conference at Ber-

ka ndodhur kundrejt një "kompensimi të drejtë dhe të menjëhershëm" të palës së dëmtuar[271].

Të drejtat e fituara përfshijnë "çdo të drejtë, materiale dhe jo materiale, e cila u takon subjekteve private të së drejtës, fizike dhe juridike, sipas të ligjit të brendshëm, vlera e së cilës mund të konvertohet në para"[272]. Ato kanë lindur në kontekstin e mbrojtjes së koncesioneve të huaja kundër nacionalizimit nga ana e sovranitetit të ri territorial dhe kanë qenë në lidhshmëri të ngushtë me të ashtuquajturën mbrojtjen diplomatike. Në fakt, rastet e para të gjykatave bëjnë fjalë për këtë lloj mbrojtjeje të të drejtave të fituara[273].

Në rastin e shpërbërjes së tri ish-federatave komuniste këto të drejta janë respektuar në mënyrën më të duhur dhe nuk ka pasur asnjë hezitim nga ana e sovraniteteve të reja territoriale për sa i përket respektimit të tyre në praktikë. Kjo shpjegohet me mungesën e konfliktit ideologjik rreth formave të pronës dhe orientimit të tërë botës ish-komuniste kah ekonomia e lirë dhe respektimi i pronës private dhe konkurrencës së lirë. Për më tepër respektimi i tyre është ndërlidhur me konceptet universale mbi të drejtat e njeriut, te cilat janë inkorporuar nëpër legjislacionet nacionale të ish-vendeve kom-

---

lin on the West-African Question", *Political Science Quarterly* vol. 1, no. 1 (March 1886) fq. 103-139.

[270] Këtu mendohet në doktrinën Drago-Porter, të mishëruar në "Konventën e Hagës të vitit 1907 mbi Kufizimin e Përdorimit të Forcës për Nxjerrjen e Borxheve Kontraktuale". Për komentet, cf. Georg Winfield Scott, "Hague Convention Restricting the Use of Force to Recover on Contract Claims", *American Journal of International* Law vol. 2, no. 1 (January 1908) fq. 78-94; August Reinisch, *State Responsibility for Debts: International Law Aspects of External Debt and Debt Restructuring*, fq. 13-14.

[271] Eli Nathan, "The Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts", fq. 513; J.E.S. Fawcett, "Some Foreign Effects of Nationalization of Property", *British Yearbook of International Law* vol. 27 (1950) fq. 355-375; N.R. Doman, "Post War Nationalization of Foreign Property in Europe", *Colombia Law Review* vol. 48, no. 8 (December 1948) fq. 1125-1161; Patric Daillier & Alain Pellet, *Droit international public* (L.G.D.J.: Paris, 1994) fq. 518.

[272] Daniel P. O'Connell, *International Law*, 2nd ed. (Stevens: London, 1979) fq. 763.

[273] Cf. August Reinisch, *State Responsibility for Debts: International Law Aspects of External Debt and Debt Restructuring*, fq. 12-17. Të drejtat e fituara përfshijnë edhe kërkesat e pastra financiare, ndryshe nga që është menduar deri vonë, dhe si të tilla mbrohen nga e drejta zakonore ndërkombëtare sikur të drejtat e tjera që kanë natyrë materiale. Koncesionet, përkatësisht mbrojtja e tyre si të drejta të pastra financiare të personave privatë (fizikë dhe juridikë) kanë lindur konceptin e mbrojtjes diplomatike në kontekstin e të drejtave të fituara. Cf. Daniel P. O'Connell, "Economic Concessions in the Law of States Succession", *British Yearbook of International Law* vol. 27 (1950) fq. 93-124.

uniste[274]. Dispozitat e MT reflektojnë këtë frymë universale dhe përmbajnë dispozita konkrete kundër diskriminimit dhe për kompensim material në rastet kur nuk mund të bëhet rikthimi në gjendjen e mëparshme i të drejtave të fituara.

Përveç të drejtave të fituara të natyrës administrative, siç janë pensionet[275] dhe të drejtat tjera që mund të lindin në të ardhmen[276], Aneksi G i MT flet për "të drejtat e fituara dhe pronën private" (nenet 1-8). Këto të drejta në MT ndahen në të drejtat materiale (neni 2: "të drejtat mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme") dhe në ato që nuk janë materiale (neni 3: "të drejtat mbi pronësinë intelektuale, përfshirë patentat, shenjën e dallimit, të drejtat e autorit, honoraret dhe të ngjashme"). Parimi i mosdiskriminimit figuron fuqishëm në nenin 2, pika (a), ku thuhet për sa vijon:

> të drejtat ndaj pronës së tundshme dhe të patundshme të vendosura në shtetin trashëgimtar dhe të cilat u kanë takuar personave fizikë ose juridikë të RSFJ-së më 31 dhjetor 1990, gëzojnë mbrojtje dhe u kthehen titullarëve sipas standardeve dhe normave të së drejtës ndërkombëtare, pa marrë parasysh nacionalitetin, shtetësinë, vendbanimin ose vendndodhjen e tyre. Kjo përfshinë personat të cilët pas datës 31 dhjetor 1990 kanë fituar shtetësinë, vendbanimin ose vendndodhjen në shtetin tjetër përveç shtetit trashëgimtar.

Dispozitë të ngjashme mbrojtëse përmban edhe neni 6 i Aneksit G të MT mbi mbrojtjen e së drejtës banesore, pa prekur këtu në garancitë shtesë

---

[274] Cf. Carsten Stahn, "The Agreement on Succcession Issues of the Former Socialist Federal Republic of Yougoslavia", fq 396; Martti Koskenniemi, "Report of the Director of Studies of the English-Speaking Section of the Centre", fq. 106-112; Maria Isabel Torres Cazorla, "Rights of Private Persons on State Succession: An Approach to the Most Recent Cases", fq. 671-677 dhe 714-717.

[275] Ankesi E i MT ka të bëjë me pensionet dhe ka tri nene. Neni i parë rregullon të drejtën e gëzimit pa asnjë diskriminim të pensioneve, të cilat janë gëzuar nga shfrytëzuesit e tyre gjatë kohës së ish-Jugosllavisë, por që janë paguar nga ish-republikat jugosllave. Neni 2 flet për pensionet federale, të personave ushtarakë dhe atyre civilë. Neni i fundit parashikon lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe në mes të shteteve trashëgimtare me qëllim të bartjes së fondeve për realizimin e pagesave për pensionet nga nenet 1 dhe 2.

[276] Në nenin 2 të Aneksit F të MT parashikohet mundësia e daljes së kërkesave të reja kundër ish-Jugosllavisë. Në rast se lindin kërkesa të tilla të reja, qofshin të natyrës së të drejtave të fituara të personave privatë, fizikë dhe juridikë, ose të natyrës tjetër publike ose shtetërore, atëherë ato shqyrtohen nga KPP, i themeluar në pajtim me nenin 4 të MT. Për këtë qëllim, palët kanë detyrë ta informojnë njëra tjetrën në rast të ekzistimit të kërkesave të tilla (neni 2, fjalia e fundit).

ekzistuese të shteteve nacionale lidhur me mosdiskriminimin[277]. Kjo do të thotë se çdo kontratë e lidhur nën shtrëngim konsiderohet si e pavlefshme[278]. Dispozitat mbi pavlefshmërinë e kontratave të tilla synojnë t'i evitojnë, sa të jetë e mundur, veprimet joligjore kundër të drejtave të fituara, ngjashëm siç ka bërë Marrëveshja e Dejtonit më 1995[279]. Në frymën e ndalimit të diskriminimit është edhe formulimi i nenit 7, i cili synon që personave privatë (fizikë dhe juridikë) t'ua lehtësojë qasjen pa asnjë diskriminim në gjykatat vendore të shteteve trashëgimtare në rast se do të kenë nevojë për realizimin e të drejtave të fituara sipas ligjit të vjetër.

Rregulla mbi kompensimin parashikohet për rastet kur nuk mund të realizohen të drejtat mbi sendet e patundshme dhe të tundshme të përshkruara si më sipër. Në një rast të tillë sigurohet se personat, fizikë dhe juridikë, të cilët nuk mund t'i realizojnë të drejtat e tyre "e gëzojnë të drejtën e kompensimit në pajtim me të drejtën civile dhe ndërkombëtare".

Për fund, vlen të thuhet se dispozitat e Aneksit G të MT ofrojnë zgjidhje në nivel parimi, mjaft të përgjithësuara. Për këtë arsye në nenin 4 të Aneksit G shprehimisht parashikohet detyrimi i palëve "për të lidhur marrëveshje dypalëshe dhe për të njoftuar gjykatat e autoritetet tjera kompetente" me qëllim që të mundësohet "zbatimi efektiv i parimeve të këtij aneksi" në pajtim me "parimet e përgjithshme të drejtësisë dhe ashtu siç e kërkon nevoja".

Çështja e pronës private dhe e të drejtave të fituara në Kosovë duhet të jetë më problematikja. Kjo është e tillë, siç u pa më sipër, edhe në rastet e vendeve që kanë të lidhur një marrëveshje ndërkombëtare. Mbrojtja e këtyre të drejtave varet kryekëput nga raporti i forcave në mes të palëve. Në rastet e trashëgimit të tyre gjatë dhe pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, sovranitetet e reja territoriale nuk kanë qenë në pozitë për të zbatuar logjikën e "pjatës së

---

[277] Cf. neni 8 i Aneksit G.

[278] Neni 2(b), Aneksi G i MT.

[279] Në nenin 1(1) të Aneksit 7 të Marrëveshjes së Dejtonit parashihet kthimi i pronës së marrë pa të drejtë, ose kompensimi nëse nuk ka mundësi të bëhet një kthim i tillë, dhe i referohet kohës së armiqësive të filluara pas vitit 1991. Cf. "General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina" (December 14, 1995), *International Legal Materials* vol. 35 (1996) fq. 89-169, në fq. 137. Vlen të theksohet se, në praktikë, megjithatë nuk ka pasur ndonjë zbatim të suksesshëm të kësaj dispozite, sikundër as të dispozitave të tjera mbi të drejtat themelore të njeriut. Procesi i zbatimit të të drejtave të njeriut në Bosnjë-Hercegovinë pas arritjes së Marrëveshjes së Dejtonit më 1995 ka ecur mjaft ngadalë dhe më shumë vështirësi. Shih më shumë në Christopher Harland, "Making Effective the Use of Human Rights and Freedoms in Bosnia-Herzegovina", në Jasna Bakšić-Muftić & Liljana Mijović (eds.), *Citanka ljudskih prava* (Centar za ljudska prava Univ. u Sarajevu: Sarajevo, 2001) fq. 259-280.

pastër", përkatësisht të mohojnë në mënyrë përfundimtare të drejtat pronësore dhe të drejtat tjera të fituara, sipas ligjeve të shtetit pararendës. Në këtë drejtim, Kosova ka pak gjasa të realizojë ndonjërën nga këto të drejta të qytetarëve të vet, në veçanti lidhur me pensionet. Ka tepër pak gjasa që Serbia ndonjëherë të pranojë lidhjen e një marrëveshjeje dypalëshe me Kosovën lidhur me këto çështje. Mundësia e vetme është që bashkësia ndërkombëtare në mënyre të njëanshme të bëjë bartjen e një shume paushalle të borxhit të jashtëm të Kosovës, si formë kompensimi, në barrë të Serbisë. Ky lehtësim financiar karshi Kosovës më pas do të shërbente si bazë për kompensim të të drejtave pronësore dhe të drejtave të tjera të qytetarëve të Kosovës. Edhe ky opsion, megjithatë, ka pak gjasë të realizohet nisur nga fakti se asnjëherë nuk është biseduar seriozisht me Serbinë për caktimin e arbitrit ndërkombëtar ashtu siç thuhet në nenin 3.1 dhe 3.2 të Aneksit VI të Planit Ahtisaari[280]. Pra, Kosova duhet të insistojë në zbatimin deri në fund të Planit Ahtisaari. Kjo, megjithatë, në asnjë mënyrë nuk nënkupton që autori i këtyre rreshtave mbron tezen krejt naive dhe joprofesionale të qarqeve të caktuara në Kosovë që besojnë akoma se kuptimi i dispozitave sa më sipër të Planit Ahtisaari për caktimin e këtij arbitri do të thotë se ka vend akoma që Kosova të bëjë rinegocimin me ish-republikat jugosllave të borxhit të jashtëm dhe të çështjeve të tjera që lidhen me asetet dhe pasurinë e ish-Jugosllavisë. Kosova nuk ka asnjë mundësi që t'i diskutojë këto punë me ish-republikat jugosllave, përveç se me Serbinë të cilën e trashëgon. Trashëgimi i ish-Jugosllavisë është punë e kryer dhe çdo përpjekje publike për ushqim të një iluzioni të tillë nuk është veçse një iluzion naiv[281].

---

[280] Aneksi VI, Neni 3.1 i Planit Ahtisaari: "Nëse, brenda një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Kosova dhe Republika e Serbisë nuk janë pajtuar për barazimin dhe alokimin e borxheve, pas konsultimit me palët, Grupi Drejtues Ndërkombëtar, do të emërojë një arbitër ndërkombëtar për ndarjen e borxhit ndërkombëtar të Republikës së Serbisë mes Republikës së Serbisë dhe Kosovës, në atë pjesë të borxhit ndërkombëtar për të cilin nuk është arritur ujdi nga palët, në marrëveshje me kreditorët relevantë."

Aneksi VI, Neni 3.2 i Planit Ahtisaari: "Caktimi i borxhit nga arbitri do të jetë i parevokueshëm dhe do të vendosë se cilat borxhe do t'i transferohen Kosovës".

[281] Në kohën e shkrimit të këtyre rreshtave, u publikua një raport në gusht 2012 nga *Forumi 2015*, i cili vepron në kuadër të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), në të cilin raport thuhet se Kosova duhet t'i rregullojë raportet e trashëgimit të pasurisë dhe çështjet tjera me ish-republikat jugosllave pasi që kjo çështje, sipas këtij raporti, ka mbetur e hapur akoma me Planin Ahtisaari. Ky raport, ishte shkruar si analizë për përmbylljen e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës sipas Planit Ahtisaari, gjë e cila ndodhi më 12 shtator 2012. Pra, sipas këtyre ekspertëve, del sikur Kosova akoma ka shans për të diskutuar me ish-republikat jugosllave restaurimin e pronës publike, borxhin e jashtëm dhe çështjet tjera të

Mënyrë tjetër për zgjidhjen e këtij problemi është që të bëhet imponimi Serbisë për kompensim të këtyre të drejtave si pjesë e dëmit të luftës të shkaktuar nga shteti serb në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Edhe ky opsion mund të realizohet vetëm nëse kreditorët e jashtëm të Serbisë dhe të Kosovës e imponojnë në mënyrë të njëanshme një gjë të tillë. Kjo, po ashtu duhet thënë këtu me këtë rast, ka fare pak gjasa për të ndodhur sepse deri më tani bashkësia ndërkombëtare nuk ka pranuar fare që dëmet e luftës të diskutohen apo që të merren parasysh si ndonjë prej bazave të kompensimeve reciproke për dëmet e shkaktuara në luftërat e ish-Jugosllavisë. Në fakt, ky ka qenë pozicion fillestar i Komisionit Badinter dhe nuk ka pasur asnjë shmangie nga ky parim, pra nga parimi që dëmet e luftës nuk mund të jenë objekt diskutimi dhe as të shërbejnë si bazë për kompensim të ndërsjellë të ish-republikave jugosllave. Këtë mosshmangie e ka respektuar edhe MT, siç u diskutua më herët në këtë punim.

Përfundim

Procesi i trashëgimit të ish-Jugosllavisë, i filluar më 1991, është mbyllur me sukses mes shteteve sovrane më 2001 me lidhjen e MT. MT ka ndjekur rrugën e prononcimeve të Komisionit Badinter duke dëshmuar fuqishëm se trashëgimi i shteteve është proces mjaft kontekstual dhe se rregullat juridike, kryesisht, luajnë rol në nivel parimesh të përgjithshme.

Me fjalë të tjera, nga sa më sipër, sërish u vërtetua se parimi i bashkëpunimit, i marrëveshjes mes palëve dhe ai *rebus sic stantibus* janë kyç në zgjidhjen e çështjeve që dalin nga trashëgimi i shteteve. Përkundër kritikave të argumentuara e racionale[282], miratimit të prononcimeve të tij *en bloc*[283], por edhe

---

trashëgimit të ish-Jugosllavisë dhe se arbitri i paraparë me Planin Ahtisaari ka për mandat edhe trajtimin e trashëgimit të ish-Jugosllavisë, përkatësisht zgjidhjen e çështjeve të trashëgimit të borxhit për kohën 1989-1999 dhe segmenteve tjera që lidhen me këtë. Kjo fare nuk ka asnjë bazë logjike, lëre më profesionale. Cf. Forum 2015, *Mëngjesi një ditë pas: jeta pa mbikëqyrje* (KFOS: Prishtinë, gusht 2012). Për komente, cf. më shumë në artikullin "Forumi 2015: Veriu do të jetë çështje tensionesh e problemesh" të autorit Besnik Krasniqi, botuar në të përditshmen *Koha Ditore* (Prishtinë, e mërkurë, 5 shtator 2012) fq. 2.

[282] Michla Pomerance, "The Badinter Commision: The Use and Misuse of the International Court of Justice's Jurisprudence", *Michigan Journal of International Law* vol. 20, no. 1 (Fall 1998) fq. 31-58; Matthew C.R. Craven, "The European Community Arbitration Commission on Yugoslavia", *British Yearbook of International Law* vol. 66 (1995) fq. 333-413.

[283] Alain Pellet, "The Opinions of the Badinter Committee: A Second Breath for the Self-Determination of Peoples", fq. 178-181; Alain Pellet, "Note sur la Conference Europenne

akuzave ndaj tij për konspiracion gjatë prononcimeve[284], puna e Komisionit Badinter në përgjithësi mund të thuhet se ka qenë me vend dhe i ka dhënë kahje modelimit të krizës ish-jugosllave, si në formë e përmbajtje, ashtu dhe në aspektin politik e juridik.

Kjo nuk do të thotë se trashëgimi i ish-Jugosllavisë nuk ka sjellë rezultate të reja dhe precedentë të cilët mund të përdoren në të ardhmen. Risitë kryesore mund të përmblidhen për sa vijon: për herë të parë u tregua se trashëgimi universal, jo ai i "pjatës së pastër" (*clean slate doctrine*), duhet të jetë rregull zakonore ndërkombëtare, pra, se shtetet, në parim, trashëgojnë të gjitha llojet e të drejtave dhe detyrimeve në rastet kur ndodhin ndërrimet në sovranitetin territorial te pararendësit. Këtu nuk përjashtohet as lëmia e pronës private dhe të drejtave të fituara. Risi tjetër, që lidhet më këtë, është se roli i bashkësisë ndërkombëtare, në rend të parë i kreditorëve të jashtëm u dëshmua si krucial në përcaktimin e modaliteteve të trashëgimit të pronës, aseteve dhe detyrimeve të shtetit pararendës, diçka që më parë nuk ka pasur mundësi të imagjinohet. Në veçanti ndërhyrja dhe ndihma e institucioneve ekonomike ndërkombëtare, BB dhe FMN, por edhe i vendeve kreditore dhe i bankave komerciale, u tregua si e domosdoshme në zgjidhjen e problemeve të trashëgimit të shteteve.

Kosova nuk u përfshi nga tërë ky proces. Fare me të drejtë sepse nuk ishte shtet sovran e i pavarur, që është parakusht për të trashëguar dikë në të drejtën ndërkombëtare. Përderisa për çështjet sovrane, siç janë shtetësia, borxhi i jashtëm, traktatet ndërkombëtare (në veçanti ato që lidhen me regjimin ndërkombëtar të kufijve të Kosovës) dhe anëtarësimin nëpër disa organizata ndërkombëtare[285], Kosova nuk mund të thuhet se u përjashtua në tërësi pas

---

pour la Paix en Yougoslavie", në *Annuaire Française de Droit International* vol. XXXVIII (1992) fq. 223-238; Vladimir-Djuro Degan, "Samoopredeljenje naroda i territorijalna celovitost država u uvjetima raspada Jugoslavije", *Naša Zakonitost* vol. 46, no. 4 (Zagreb, 1992) fq. 543-569; Vladimir-Djuro Degan, "L'arbitrage juridique ignore : la jurisprudence de la Commission Badinter", botuar në Marie François Allain et al. (eds.), *L'ex-Yougoslavie en Europe: de la fallite des democraties au processus de paix* (L'Harmattan: Paris, 1997) fq. 31-43.

[284] Gregory H. Fox, "Self-Determination in the Post-Cold War Era: A New Internal Focus?", *Michigan Journal of International Law* vol. 16, no. 3 (Spring 1995) fq. 733-781 në fq. 750.

[285] Kuvendi i Kosovës ka ratifikuar traktatin për anëtarësimin e Kosovës në FMN dhe në grupimin e organizatave të BB më datën 24 korrik 2009, me vendimin 03-V-159. Sa i përket organizatave tjera, Kosova mund të thuhet se ka bërë një progres të vogël vetëm sa i përket qasjes në organizata të ndryshme regjionale, por jo edhe anëtarësimit. Kjo është bërë me lidhjen e Marrëveshjes për bashkëpunim rajonal në mes të Qeverisë së Serbisë dhe Qeverisë së Kosovës në shkurt të vitit 2012. Në këtë marrëveshje u përcaktua se Kosova do të përdorë

fitimit të pavarësisë më 17 shkurt 2008, në njësitë e tjera të trashëgimit mund të bëhet precedent dhe të përmirësohen padrejtësitë e bëra ndaj Kosovës. Këtu e kemi fjalën në rend të parë për pronën shtetërore dhe asetet e ish-Jugosllavisë, të cilat RFJ (Serbi-Mali i Zi)/USMZ i ka trashëguar pa të drejtë në emër të Kosovës, duke bërë kështu pasurim të pabazë ligjore në kurriz të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Kosova ka kontribuar esencialisht në rritjen e pronës dhe të aseteve të ish-Jugosllavisë, pikërisht, gjykuar sipas kritereve të miratuara nga BB dhe FMN dhe palët në MT (pjesëmarrja në buxhetin federal jugosllav, në prodhimin shoqëror jugosllav, në eksportin jugosllav, numri i popullsisë, i njëjtë nëse jo më i madh se i disa shteteve trashëgimtare të ish-Jugosllavisë, territori i njëjtë, nëse jo më i madh se i disa shteteve trashëgimtare të ish-Jugosllavisë dhe, në fund fare, fuqia ekonomike e Kosovës, aferisht e njëjtë me atë të disa prej vendeve trashëgimtare të ish-Jugosllavisë). E njëjta gjë vlen edhe për arkivat shtetërore të ish-Jugosllavisë: Kosovës duhet t'i kthehen arkivat sipas parimit funksional, organik dhe integral, siç ka ndodhur me shtetet tjera. Kthimi i statujave, i objekteve të ngjashme dhe dokumenteve të tjera të cilat serbët i kanë tërhequr nga Kosova pas humbjes së luftës më 1999 nuk paraqet trashëgim, por rikthim i gjërave të rëndësisë kulturore për një regjion të caktuar, të marra nga ai si pasojë e konfliktit të brendshëm. Për pasojë, kjo do të thotë se edhe kthimi i tyre bëhet sipas ligjit të brendshëm dhe jo ndërkombëtar. Për të ndërruar këtë, kosovarët përmes institucioneve të tyre duhet të kërkojnë që këto gjëra të futen në bisedat teknike për zgjidhjen e problemit të veriut të Kosovës që pritet të zhvillohen gjatë këtij viti, pra gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012. Ato që filluan në vjeshtë 2004 dhe që zgjatën përgjatë vitit 2005, si dhe ato të vitit që e lamë pas, nuk dhanë ndonjë rezultat të prekshëm.

Ajo që u sanksionua me Planin Ahtisaari për sa i takon trashëgimit të shteteve paraqet dokumentin më kompetent nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare. Për Kosovën, ai paraqet dokumentin më të favorshëm. Por, siç dihet, ai u refuzua nga serbët dhe mbeti vetëm në letër kur është fjala për

---

vetëm emrin e saj, pa cilësuar formën aktuale shtetërore të një shteti sovran dhe të pavarur. Kjo qasje në këtë marrëveshje u kritikua shumë sepse, siç u tha, Kosovës ia humb identitetin e saj aktual shtetëror. Në Marrëveshje thuhet se ky lloj emërtimi vetëm si "Kosovë" nuk prejudikon statusin e saj e as pozitën dhe është në harmoni me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me Deklarimin e pavarësisë" (cf. paragrafi 3 i Marrëveshjes). Sado që kjo marrëveshje është arritur, Kosova nuk ka pasur ndonjë dobi të prekshme për sa i takon bashkëpunimit dhe aktiviteteve të tjera rajonale.

trashëgimin e të drejtave dhe detyrimeve të subjektit pararendës, pra për sa i përket trashëgimit të Serbisë nga ana e Kosovës. Për t'u bërë kjo, pra trashëgimi i Serbisë, kosovarët më parë duhet ta braktisin diskursin naiv mbi "Kosovën si element konstituiv i federatës jugosllave". Ajo federatë dhe ai shtet janë shpërbërë dhe pasuria e saj ka kaluar tashmë në trashëgimtarët e rinj. Serbia ka trashëguar në emër të Kosovës dhe MT është fakt i pandryshueshëm. Kosova ka punë me Serbinë, jo me trashëgimtarët tjerë të ish-Jugosllavisë. Pasurinë e Kosovës e ka marrë Serbia dhe ajo duhet ta kthejë atë. Kjo bëhet jo duke vajtuar për diçka që ka shkuar, për "Kosovën si element konstituiv i federatës jugosllave", por duke kërkuar gjatë bisedave në vijim për veriun e Kosovës që pasuria e Kosovës të kthehet siç është marrë.

Shkenca juridike ndërkombëtare mund të luajë këtu një rol, mjaft pozitiv e konstruktiv, duke gjetur modalitete të reja të ritrashëgimit të pjesëve të caktuara të të drejtave dhe detyrimeve të shtetit pararendës, i cili kundrejt Kosovës është RFJ/USMZ, pra, jo ish-Jugosllavia. Kjo nënkupton edhe atë, se regjimet kufitare të Kosovës, të cilat janë krijuar pas vitit 1991, siç është rasti me Marrëveshjen për kufij mes RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi) dhe Republikës së Maqedonisë[286], mbesin në fuqi dhe nuk mund të ndryshohen. Ngjashëm do të ndodhë edhe me kufirin me Malin e Zi, me të cilin shumë shpejt duhet të lidhet marrëveshja e delimitimit dhe demarkacionit si me Maqedoninë.

Thënë shkurt: duhet të krijohet një precedent i ri, një lloj trashëgimi *sui generis*, ashtu që edhe ndaj Kosovës të krijohen mundësitë për zbatim të parimeve të njëjta të trashëgimit, të proklamuara nga Komisioni Badinter një dekadë më herët[287]. Po nuk u bë kjo, vështirë mund të thuhet se Kosova dhe qytetarët e saj kanë fituar diçka pas tërë atyre vuajtjeve e persekutimeve deri në shkallë gjenocidi. Kjo zgjidhje *sui generis* duhet të insistojë në një involv-

---

[286] *Treaty between the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Macedonia Concerning the Delineation and Description of the State Border*, nënshkruar më 23 shkurt 2001 (ratifikuar më 9 maj 2001), kurse ka hyrë në fuqi më 16 qershor 2001. *Službeni list SRJ* 16.1, aneks "Medjunarodni ugovori" (Beograd, 2001). Kosova më pastaj, pas fitimit të pavarësisë, ka nënshkruar një marrëveshje tjetër për demarkacion sepse çdo marrëveshje për kufi ka dy faza, delimitimin dhe demarkacionin. Kuvendi i Kosovës me vendimin e vet nr. 03-V-203 të datës 17 tetor 2009 ka bërë ratifikimin e *Marrëveshjes për demarkacionin fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.* Për historikun e kësaj Marrëveshje, cf. studimin elokuent dhe të gjatë të dr. Jove Dimitrija Talevski, *The Borders of the Republic of Macedonia, with Supplements* (Kiro Dandaro: Bitola, 1998), në veçanti faqet 141-188 dhe 331-343.

[287] Për qëndrim të ngjashëm, cf. Guido Acquaviva, "The Dissolution of Yugoslavia and the Fate of its Financial Obligations", fq. 213-214.

im më të paktë të faktorit ndërkombëtar në qeverisjen e Kosovës, në një integrim më të madh evropian e ndërkombëtar të Kosovës, si dhe në krijimin e mundësive që Kosova të jetë trashëgimtare e menjëhershme e atyre dimensioneve të trashëgimit të ish-Jugosllavisë të cilat nuk prekin interesat e shteteve të treta, por vetëm ato të Republikës së Serbisë, entitetit që ka folur e trashëguar në emër të Kosovës pas vitit 1992 deri me lidhjen e MT më 2001.

Qasja e kosovarëve në dialogun e viteve para arritjes së Planit Ahtisaari, por edhe pas tij që u zhvillua në vitin 2011, ka qenë naive për një arsye të thjeshtë: asnjëri nga ata që patën mandat politik për dialogim nuk qenë të vetëdijshëm për ekzistimin e MT dhe faktit se trashëgimi i ish-Jugosllavisë pati qenë i mbyllur në atë kohë. Këtë rrethanë, autori i këtyre rreshtave e pat vërejtur meqë ka udhëhequr dialogun e parë teknik me serbët para arritjes së Planit Ahtisaari që u zhvillua në Vjenë gjatë viteve 2004-2005, dhe që u pasua pastaj me dialog politik nga nëntori i vitit 2005 e tutje. Çdo tentim i këtij autori për të futur në përdorim diskursin dhe forcën e parimeve e normave të së drejtës ndërkombëtare mbi trashëgimin e shteteve, përfshirë këtu edhe precedentin e krijuar me MT, shurdhohej nga zërat e akademikëve e kuazi-intelektualëve të edukuar në frymën e diskursit "shkencor" të vitit 1974 dhe iluzionet për "Kosovën si element konstitutiv i federatës jugosllave".

III. Kritikë konceptit shtet në një vepër të Kenneth Waltzit

Hyrje

Shteti si një formë e organizimit të shoqërisë ka qenë dhe është objekt studimi i shumë fushave. Ai studiohet nga ana e tij sociale, politike, ekonomike, ushtarake, filozofike etj. Në të gjitha aspektet e tij, fenomeni shtet paraqet një strukturë mjaft të ndërlikuar. Së këndejmi, edhe interesimi aq i madh në teori dhe praktikë për studimin e këtij fenomeni. Këtu, në këtë shkrim, fenomeni në fjalë diskutohet vetëm në një aspekt dhe vetëm nga një autor: nga aspekti i marrëdhënieve ndërkombëtare, ashtu si është konceptuar në veprën e njërit nga autorët modernë më me ndikim në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, Kenneth Waltz (Keneth Uallc)[288].

[288] Kenneth N. Waltz, *Man, the State and War* (Columbia UP: New York, 1954, 1959).

Shkrimi në vijim paraqet versionin e përpunuar të një eseje të mbrojtur në dhjetorin e vitit 1998 pranë Departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Universitetit Bilkent të Ankarasë nën mbikëqyrjen e profesorit të lëndës "*Debatet Aktuale në Teorinë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare*", prof. dr. Scott Pegg (Skot Peg). Pa ndihmën e tij, sigurisht që shkrimi nuk do të kishte formën që ka sot. Ndihma gjatë përpëlitjeve fillestare për shkrimin e esesë në fjalë ka qenë vendimtare: dr. Pegg ka dhënë një kontribut të madh në përcaktimin e kahjeve të kritikës sonë të konceptit shtet, ashtu siç është parashtruar te autori Kenneth Waltz, në dallimin e këtij koncepti nga konceptet në lëmenjtë e tjerë që studiojnë fenomenin shtet, si dhe në përcaktimin e qartë të arsyeve që e kanë shtyrë autorin në thjeshtësimin e skajshëm të këtij koncepti. Nga kjo kritikë mund të shihet qartë se koncepti shtet dallon shumë nga ai që mësohet në lëmin juridik, meqë fjala është për definimin e tij në raport me shtetet e tjera, anëtare të bashkësisë ndërkombëtare. Ky lloj definimi është shumë i vjetër dhe daton që nga lashtësia. Ai gjendet edhe në veprat e autorëve klasikë të së drejtës ndërkombëtare, si te Hugo Groci, Francisco de Vitoria etj. Definimi i tillë ka prekur dhe prek çështjet më vitale të luftës dhe paqes apo meditimet lidhur me mundësinë e zhdukjes ose, së paku, reduktimit të fenomenit që quhet luftë.

Nga analiza e librit *Njeriu, shteti dhe lufta: Një qasje teorike*, lexuesi nuk mund e të mos e vërejë mënyrën e ndjekur nga autori me rastin e përfoljes së autorëve të tjerë të marrëdhënieve ndërkombëtare (Augustini i Shenjtë, Makiaveli, Spinoza, Kant, Niebuhr, Morgenthau etj.). Është vështirë të vërehet nëse autori i parashtron pikëpamjet e veta apo ato të autorëve si më sipër. Kjo rrugë është ndjekur përgjatë tërë kapitujve e deri në pjesën ku nxirren konkluzionet për secilin autor tjetër të marrëdhënieve ndërkombëtare. Vetëm në pjesën e fundit të librit vërehet se fjala është për idetë origjinale të autorit.

Kritika që bëhet këtu ndjek vijën që vetë K. Waltz e ka zgjedhur gjatë shtjellimeve të veta. Ajo zgjedhje ka të bëjë me tri imazhet (perspektivat) kryesore të cilat sot dominojnë marrëdhëniet ndërkombëtare dhe teorinë e saj. Në vijim pason parashtrimi i pikëpamjeve shkencore mbi të cilat bazohet kritika e veprës, sipas kësaj renditjeje:

- Kritikë imazhit të parë: konflikti ndërkombëtar dhe sjellja njerëzore;
- Kritikë imazhit të dytë: konflikti ndërkombëtar dhe struktura e brendshme e shteteve; dhe
- Kritikë imazhit të tretë: konflikti ndërkombëtar dhe anarkia ndërkombëtare.

Duke e bërë këtë, ne orientohemi për kritikë ndaj vetë kritikës së konceptit uallcian mbi shtetin, përkatësisht mbështetemi në supozimet e imazhit të dytë për dallim nga dy të tjerat. Si me çdo përpjekje intelektuale, edhe me këtë rast ekziston një shpjegim, ekziston një arsye se për se ne e kemi zgjedhur imazhin e tretë si më të qëlluar në kundërvënien tonë ndaj konceptit shtet të K. Waltzit. Observimet tona kryesore teorike lidhur me veprën e sipërcituar të autorit, sado që paraqesin pjesë përbërëse të literaturës aktuale mbi teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, kushtëzohen nga zhvillimet dramatike të kryera pas unifikimit të kombit gjerman dhe prishjes së komunizmit e mbarimit të Luftës së Ftohtë. Këto ngjarje kanë ndryshuar dhe sfiduar esencialisht dhe tërësisht konceptin shtet të parashtruar dhe kultivuar nga K. Waltz dhe autorët e tjerë të së ashtuquajturës proveniencë realiste në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare.

E kemi konsideruar si të pamundur kritikën e konceptit shtet të një autori me kaq ndikim në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare pa u futur paraprakisht edhe në shqyrtimet e imazheve të tjera të marrëdhënieve ndërkombëtare, të cilat u zunë ngoje më sipër. Kjo nga shkaku se ato janë të ndërvarura. Dhe, këtë rrugë e kemi quajtur si të vetmen dhe logjike në rrugëtimin tonë kah sqarimi i konceptit shtet në marrëdhëniet ndërkombëtare, teorinë dhe praktikën e tyre.

1. Kritikë imazhit të parë: Konflikti ndërkombëtar dhe sjellja njerëzore

Në këtë pjesë autori parashtron në detaje pikëpamjet e të tjerëve lidhur me natyrën njerëzore dhe rolin që ajo luan në lindjen dhe zhdukjen e shteteve dhe në vetë fenomenin e luftës (Spinoza, Augustini i Shenjtë, Morgenthau etj.). Ai vëren me të drejtë, në këtë kontekst, dy rrymat kryesore në kuadrin e shkollës realiste: "pesimizmin" dhe "optimizmin". Ky dallim bazohet në dilemën nëse natyra luftënxitëse njerëzore mund të ndryshohet dhe të orientohet kah paqja. Nga grupi i "pesimistëve", autori zgjedh Hans Morgenthaun, i cili pohon se shteti dhe natyra luftënxitëse e njeriut kushtëzohen nga ambienti ndërkombëtar që është konkurrent dhe në të njëjtën kohë anarkik (mosekzistimi i një "qeverie botërore", sipas shembullit të organizimit shtetëror të shteteve ekzistuese dhe sovrane)[289]. Në qëndrimet e Morgenthaut, autori, megjithatë, ka gjetur disa pikëpamje deterministe dhe normative, pra disa

[289] Ibid. fq. 35.

pikëpamje që lidhen me vlerësime të caktuara subjektive[290]. Pasi hedh poshtë idetë e Margenthaut mbi çështjet normative (subjektive) lidhur me "interesin nacional", pra, vlerësimet subjektive që nuk derivohen nga natyra e ambientit ndërkombëtar, si kushtëzues i sjelljes së shteteve dhe individëve që përfaqësojnë ato[291], K. Waltz në mënyrë autoritative ia liron vetes rrugën për fokusim të mëtejmë në kushtet ekzistuese të politikës, marrëdhënieve dhe përgjithësisht të ambientit ndërkombëtar, si baza të konceptit të tij mbi shtetin. Sipas tij, veprimet dhe mendimet e udhëheqësve shtetërorë, në sensin e parimeve legale dhe morale udhërrëfyese, janë tërësisht irrelevante. Me fjalë të tjera, kur gjykohet koncepti shtet sipas Waltzit, nga ai koncept përjashtohen çdo konsideratë morale e juridike, të cilat eventualisht do të mund të merreshin parasysh në vlerësimin e sjelljeve dhe të veprimeve të udhëheqësve të ndryshëm shtetërorë. Koncepti shtet në marrëdhëniet dhe politikën ndërkombëtare, sipas autorit, i përjashton këto konsiderata normative (subjektive) në tërësi[292].

Ne konsiderojmë, ndërkaq, se veprimet dhe sjelljet e udhëheqësve shtetërorë, parimet legale dhe konsideratat morale, përfshirë këtu edhe ngjarjet e vogla që ndodhin gjatë një periudhe të gjatë kohore, kanë pasur ndikim të konsiderueshëm në sjelljet e shteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare. Duhen marrë parasysh ngjarjet komplekse dhe, në disa aspekte, unikate e të cilat janë pasuar nga një gërshetim i tepërt i ndodhive të tjera. Rrënimi i Perandorisë Romake, Lufta Civile Amerikane, Revolucioni Francez, Lufta e Parë Botërore, Holokausti dhe bashkimi i kombit gjerman janë shembujt tipikë të këtyre ngjarjeve. Këto ngjarje duket sikur kanë qenë rezultat i ndikimeve komplekse të shumë forcave dhe personaliteteve, lidhja e të cilave në një moment të dhënë kohor ka prodhuar rezultatet historike si më sipër. Nuk mund të fajësohet Perandori Kaligula për prostitucionin romak, Jakobinët për gijotinën, Jugu i Amerikës për mizoritë njerëzore, Ludendorff për Luftën e Parë Botërore, vetëm Hitleri për kampet e shfarosjes së hebrenjve, sikur që as Helmut Kohl nuk i mban të gjitha meritat, në esencë të padiskutueshme, lidhur me bashkimin e kombit gjerman. Me një fjalë, çmojmë se ngjarjet apo disa nga pjesët e ngjarjeve, të shkaktuara ndaras, kanë prodhuar efektet e caktuara dhe kanë konvergjuar me njëra-tjetrën në një vend dhe kohë të dhënë, interaksioni i të cilave bashkërisht ka prodhuar ngjarjet që në sot i

[290] Ibid. fq. 37.
[291] Ibid. fq. 37-38.
[292] Ibid. fq. 38-41.

njohim dhe studiojmë. Mjaft shpesh vështirë është të besohet se këto ngjarje e rrethana kanë qenë produkte të pashmangshme të forcave historike në një shkallë të gjerë. Për më tepër, disa duket sikur kanë ndodhur në një masë të madhe si pasojë e tipareve individuale të karaktereve dhe institucioneve të caktuara. Në fakt, nga perspektiva e teorisë së marrëdhënieve ndërkombëtare duket sikur fati "shumë herë ka lozur një rol të caktuar: faktorët jashtë caqeve të teorisë kanë ofruar shpjegimin e lidhjeve kyçe në zinxhirin e ngjarjeve të dhëna"[293].

Pa u larguar nga kjo që u tha, mund të zhvillohen argumente të tjera për të provuar se Waltz nuk e ka drejt kur mohon faktorët njerëzorë dhe rolin që ata luajnë në formësimin e veprimeve shtetërore në marrëdhëniet dhe politikën ndërkombëtare. Në ngjarjet që kanë pasuar Luftën e Parë Botërore, krizën e raketave në Kubë (1962), unifikimin e kombit gjerman (1989), sa për të numëruar vetëm disa prej tyre, mund të gjendet lehtë argumenti se tiparet individuale të personaliteteve kryesore të involvuara në këto ngjarje kanë luajtur një rol të rëndësishëm, nëse jo vendimtar. Kjo është e vërtetë edhe për sa i takon personalitetit të Adolf Hitlerit dhe rolit që ai ka luajtur në formësimin e ngjarjeve të kohës së tij. Sjellja e John Kennedyt (Xhon Kenedi) gjatë dhe pas krizës së raketave në Kubë duket sheshazi se ka qenë e drejtuar me vetëdije në shmangien e përsëritjes së katastrofës së vitit 1914. Në të vërtetë, ai vetë i referohej bukur shpesh procesit të vendimmarrjes që kishte çuar në Luftën e Parë Botërore, për të treguar një mësim të hidhur nga e kaluara e njerëzimit, ashtu sikur që edhe vetë Hitleri i referohej humbjes së Napoleonit në Rusi. Ky i fundit, megjithatë, nuk e kishte lexuar mësimin e historisë si duhet, ndërkohë që J. Kennedy, pasi e kishte lexuar librin e Barbara Tuchmanit (Barbara Takmën) *The Guns of August* ("Të shtënat e gushtit"), kishte pohuar vendosmërisht se:

> nuk do ta ndiqte kursin i cili do t'i mundësonte ndokujt shkrimin e një libri të ngjashëm me atë të Luftës së Parë Botërore dhe që do të quhej *Raketat e Tetorit*. Nëse dikush është këtu pari për të shkruar një libër të ngjashëm, atëherë do të kuptojë se pas gjithë kësaj që ndodhi ne bëmë çdo përpjekje për t'i dhënë paqes shansin dhe armikut tonë hapësirën për manovrim në drejtim të paqes dhe prosperitetit.[294]

---

[293] Gary King, Robert O. Keohane & Sidney Verba, *Designing Socian Inquiry* (Princeton UP: Princeton 1994) fq. 10.

[294] Cituar në Paul R. Vioti & Mark V. Kauppi, *International Relations Theory: Realism, Pluralism, Globalism* (Macmilian Publishing, 1993) fq. 330-31.

Në një tentim për ta mbyllur këtë pjesë të shkrimit, ne do të mund të konkludonim se pikëpamja e ashtuquajtur "modeli racional i veprimit të shteteve", i përqafuar nga Waltz dhe realistët e tjerë, është jo e saktë. Kjo pikëpamje, siç u parashtrua më sipër në mënyrë të tërthortë, presupozon se shtetet si aktorë kryesorë të marrëdhënieve ndërkombëtare ndërmarrin veprime në një ambient anarkik dhe çdo sjellje e tyre i nënshtrohet një kalkulimi paraprak të fitimeve dhe humbjeve respektive dhe, në këtë kontekst, askush nuk kujdeset për sigurinë e shteteve, veçse ata vetë. Kjo gjendje kësisoj shkakton ndjenjën e vetëgjyqësisë dhe armatimin si mjet sigurie, i cili në fund shpie në luftë në mes të shteteve me qëllim sigurimin e ekzistencës fizike vetjake, si kërkesë dhe synim elementar i çdo shteti. Mirëpo, sikundër u vërejt më sipër, procesi organizativ dhe sjelljet e udhëheqësve shtetërorë të ndryshëm, që ndryshe quhen edhe imazhe (perspektiva) pluraliste të marrëdhënieve ndërkombëtare, nxisin pyetje serioze për sa i përket qëndrueshmërisë së konceptit të Waltzit mbi mbështetjen vetëm në konceptin e "modelit racional" të veprimit të shteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky model nuk mund të shpjegojë as politikën e jashtme të një shteti, e aq më pak vetë sjelljet e tij, meqë ngushton shumë horizontin shtrirës të fenomenit shtet dhe të sjelljes së tij kundrejt aktorëve të tjerë të marrëdhënieve ndërkombëtare (shteteve dhe jo shteteve).

2. Kritikë imazhit të dytë: Konflikti ndërkombëtar dhe struktura e brendshme e shteteve

Esenca e imazhit të dytë, të cilin Waltz e kritikon, ka të bëjë me strukturën e brendshme të shteteve dhe efektin që kjo strukturë e ushtron në vetë sjelljet e shteteve[295]. Ky është imazhi të cilit Waltz i kushton më së shumti kujdes në veprën e tij, sado që e kritikon po aq sa dhe imazhin e parë të përfolur më sipër. Për më tepër, ai nuk e konsideron këtë aspekt të shteteve si të një rëndësie të veçantë për kuptimin e sjelljes së tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare. Autori pranon, ndërkaq, se "shtetet e dobëta çojnë në luftë"[296] dhe se "dallimet në sjelljet e shteteve derivohen nga kushtetutat e ndryshme dhe kontekstet e dhëna në të cilat gjenden shtetet"[297]. Waltz, megjithatë, nuk është i sigurt nëse të gjitha shtetet apo "vetëm disa forma të shteteve janë më

[295] K. Waltz, *Man, the State and War*, kapitujt IV dhe V, fq. 80-158.
[296] Ibid. fq. 122.
[297] Ibid. fusnota 46, fq. 183.

shumë të prira kah paqja sesa të tjerat"[298]. Kjo nuk do të thotë se ai injoron rëndësinë e kuadrit brenda të cilit shtetet veprojnë. Në imazhin e tij të tretë, siç do të shihet më vonë, ai e bën të qartë faktin sipas së cilit kushtet e anarkisë në marrëdhëniet ndërkombëtare janë tipari kryesor që duhet pasur parasysh me rastin e gjykimit të natyrës së shteteve në teorinë dhe praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Para se të kalojmë në imazhin e fundit, le të shohim diçka më shumë për vetë esencën e imazhit të dytë, pra për shtetin dhe natyrën e tij të brendshme.

Ky imazh i marrëdhënieve ndërkombëtare buron nga formësimi i mendimit liberal, me fillim nga doktrina *laissez-faire* e deri te revizionizmi liberal. Nga pikëpamja eksterne, ai fillon me mbështetjen në përmirësimet e strukturës së brendshme të shteteve të veçanta e deri te nevoja për një organizim në mes të shteteve sovrane. Për sa i përket vetë shtetit, prezumimet kryesore të këtij imazhi janë se në një botë të mbushur me demokraci nuk mund të ketë veçse paqe të përhershme, meqë qeveritë autokratike janë të vetmet të interesuara për luftë. Ky imazh kritikohet nga Waltz vetëm për sa i takon çështjes së luftës dhe paqes, apo barazimit të tyre, duke iu referuar luftërave revolucionare franceze të shekullit XVIII, dy luftërave botërore, për të konkluduar se pa përcaktimin e "rëndësisë që ka ambienti ndërkombëtar" nuk mund të jepet përgjigjja e duhur lidhur me natyrën paqedashëse apo luftënxitëse të shteteve[299]. Autori pranon se struktura e brendshme e shteteve nuk duhet të lihet anash, nëse dëshirojmë ta kuptojmë natyrën e shteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare, sado që e ngushton dukshëm rrugën për argumentim, duke e kthyer diskutimin në relacionin luftë-paqe kundrejt ambientit ndërkombëtar ekzistues. Në këtë aspekt ai i sheh shtetet si një dhe të njëjta, pra pa asnjë dallim. Kategoria e "njëjtësisë" buron nga fakti se shtetet kanë sjellje të njëjta në kushtet e anarkisë. Madhësia e shteteve, struktura e brendshme politike, pra lloji i qeverisë e të ngjashme, çojnë shumë pak peshë në gjykimin e nocionit shtet në marrëdhëniet ndërkombëtarë[300]. Me fjalë të tjera, të gjitha shtetet, sipas kësaj pikëpamje, synojnë sigurimin e ekzistencës fizike (kërkesa minimale) apo hegjemoninë mbi të tjerët (kërkesa maksimale), varësisht nga aftësitë e tyre. Si kërkesë e ndërmjetme është ajo që shtetet të lihen të qeta nga ambienti që i rrethon.

---

[298] Ibid. fq. 230.

[299] Ibid. fq. 123.

[300] Ky qëndrim është parashtruar nga Kenneth Waltz edhe në shkrimet tjera. Cf. Kenneth Waltz, "Anarchic Orders and Balances of Power", botuar në *Neorealism and Its Critics* nën edicionin e Robert O. Keohane (Columbia UP: New York, 1986) fq. 98-130.

Ky konstatim i Waltzit bëhet me qëllim, siç e thotë vetë ai, të ndërtimit të një teorie të marrëdhënieve ndërkombëtare, prandaj edhe koncepti i shtetit është i stërthjeshtësuar. Kjo kategori kësisoj edhe mund të jetë e dobishme për ndërtim teorie, por natyra tejet abstrakte e shtetit si më sipër e bën atë të pakuptimtë dhe pa ndonjë dobi praktike në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo nga shkaku se jo vetëm që shtetet dallojnë nga njëri-tjetri nga ana funksionale, pra sipas distribuimit të aftësive nëpër shtetet e dhëna të bashkësisë ndërkombëtare, por dhe sipas "çfarëdo qoftë standardi — territori, etniciteti, prodhimi i përgjithshëm nacional, zotësia ushtarake, aftësia qeverisëse — shtetet moderne dallojnë mes vete"[301].

Pika tjetër e kritikës sonë të zhvilluar këtu ka të bëjë me natyrën paqedashëse apo luftënxitëse të shteteve të dhëna, fakt të cilin Waltz e mohon gjatë tërë veprës së tij. Duke e bërë këtë, ne fokusohemi vetëm në strukturën e brendshme të shteteve dhe lëmë anash, për një moment, kuadrin brenda të cilit shtetet veprojnë (ambienti ndërkombëtar). Natyrisht që kuadri i veprimit të shteteve diskutohet këtu, më vonë, kur flitet për kritikën e imazhit të tretë.

Se struktura e brendshme e shteteve luan një rol të rëndësishëm në çështjet e paqes dhe të luftës, askund nuk mund të shihet më qartë se në Ballkan, Azi dhe Afrikë. Shtetet e Ballkanit, të themeluara kryesisht pas viteve 1820-4, 1878, 1912 dhe 1991-92, qenë krijuar si shtete-satelitë për fuqitë e mëdha. E njëjta gjë vlen për Afrikën postkoloniale dhe shtetet e Azisë. Në kohën e pavarësimit të tyre kolonial ekzistonin bindjet mjaft të përhapura, sidomos në mesin e intelektualëve, se Afrika e Azia po "ballkanizoheshin", me kuptim që në dy rastet shtetet nuk qenë krijuar për t'u bërë të qëndrueshme dhe me demokraci të tipit liberal (perëndimor), por për t'u shërbyer qëllimeve politike (shtetet ballkanike) ose ekonomike (shtetet e Afrikës dhe Azisë) të fuqive të kohës. Duke qenë ky rast, ato kanë qenë vazhdimisht burim jostabiliteti dhe lufte, të zhvilluara kryesisht brenda vetë këtyre shteteve. Këto lloj luftërash, të shkaktuara si pasojë e mungesës së institucioneve demokratike, me të drejtë janë quajtur si "luftëra të llojit të tretë" apo si luftëra brenda shteteve dhe për krijim të "shteteve të reja, si dhe lidhur me statusin e popujve të caktuar brenda këtyre shteteve. Këto i kanë ndryshuar rregullat e zhvillimit të luftës, të neutralitetit dhe vetë të drejtën ndërkombëtare humanitare,

[301] Ferguson Yale & Richard Mansbach, "Between Celebration and Despair: Constructive Suggestions for Future International Theory", *Inernational Studies Quarterly* vol. 35 (1991) fq. 363-386, fq. 381.

duke e fshirë vijën e dallimit tradicional në mes popullsisë, ushtrisë dhe qeverisë. Ato më shumë ngjajnë në luftërat mesjetare sesa në ato klasike siç përshkruhen nga Clausewitz (Klauzevic) në veprën e tij monumentale *Mbi luftën* dhe që janë zhvilluar që nga Paqja e Vestfalisë (1642) e tutje[302].

Nga kjo pasqyrë e shkurtër mund të shihet se struktura e brendshme e shteteve, forma e qeverisjes së tyre dhe mungesa e institucioneve stabile qëndrojnë si shkaqe permanente të konfliktit jo vetëm brenda tyre, por dhe kundrejt botës së jashtme. Mund të jetë e saktë bindja e përgjithshme se struktura ndërkombëtare ka qenë vendimtare në krijimin e këtyre shteteve, por gjithashtu është e sigurt se siguria dhe jostabiliteti i tyre nuk kushtëzohen nga faktorët e jashtëm të anarkisë ndërkombëtare. Ato shtete vetvetiu kanë qenë dhe janë burim pasigurie dhe jostabiliteti në një kohë kur sistemi ndërkombëtar, me rregullat dhe institucionet e tij për barazinë sovrane të shteteve, vetëm sa ka paraqitur dhe paraqet çdo ditë e më shumë gëzofin mbrojtës për dobësitë inherente të këtyre shteteve. Nëse do të gjykonim me logjikën e K. Waltzit dhe të realistëve të tjerë këto shtete kaherë do të ishin zhdukur nga faqja e dheut dhe nga lista e anëtarëve të tjerë të bashkësisë ndërkombëtare anarkike.

3. Kritikë imazhit të tretë: Konflikti ndërkombëtar dhe anarkia ndërkombëtare

Me shumë shtete sovrane dhe pa një sistem i cili do t'i zbatonte rregullat midis tyre, me shtetet ekzistuese që kanë të drejtën e gjykimit të padrejtësive eventuale dhe ambicieve sipas tekeve dhe dëshirës vetjake, konflikti dhe lufta domosdo se ndodhin. Për të arritur një rezultat të favorshëm nga konflikti ose lufta eventuale, shtetet detyrohen të mbështeten në mjetet e veta, efikasiteti relativ i të cilave paraqet brengën konstante për çdo shtet sovran. Kjo shkurtimisht është esenca e imazhit të tretë. Fokusi në këtë rast përqendrohet në kuadrin e veprimit të shteteve, ashtu që prezumimet e imazhit të parë dhe të dytë bëhen të panevojshme dhe të padobishme. Ky imazh bazohet në filozofinë e Rousseausë (Ruso), sado që në një formë më të modifikuar[303].

---

[302] Shih më shumë për këtë në Martin van Creveld, *The Transformation of War* (The Free Press: New York 1991) fq. 35-37; 48-49; 193-223; Kalevi Holsti, *The State, War, and the State of War* (Cambrdige UP: Cambridge 1996) fq. 13-40.
[303] K. Waltz, *Man, the State and War*, fq. 159-238.

Rousseau e shihte rregullimin federativ si një forcë të mjaftueshme për zbatimin e ligjeve dhe si zgjidhje të qëlluar për problemet e realpolitikës në planin ndërkombëtar, përkatësisht argumentonte se në federatë shtetet e Evropës eventualisht do të ishin në gjendje të balancoheshin reciprokisht, ashtu që dominimi mbi njëri-tjetrin ose i një grupi shtetesh kundrejt tjerëve do të pengohej dhe bëhej i pamundur. Për t'i shërbyer këtij qëllimi, federata gjithnjë mban për vete një forcë të domosdoshme. K. Waltz pranon se kjo ide e Rousseausë është bindëse, por e quan si të parealizueshme tërësisht[304]. Vija e tij e argumentimit shkon më tepër kah trajtimi i çështjes brenda imazhit të tretë. Kështu, sipas Waltzit, ekziston një mundësi konstante e luftës në një botë ku janë më shumë se dy shtete, ku secili prej tyre kërkon promovimin e interesave të veta dhe ku nuk ka asnjë agjenci mbi të cilën mund të mbështeteshin për rastet e mbrojtjes së tyre nga të tjerët. Një kuptim si duhet i imazhit të tretë për sa i takon luftës në mes të shteteve, sipas Waltzit, e bën të qartë faktin se ndodhja e saj mund të evitohet vetëm nëse interesat minimale të shteteve për ruajtjen e vetvetes bëhen interesa maksimale për të gjitha shtetet, ashtu që secili mund të mbështetet në tërësi në këtë lloj definimi të bërë bashkërisht për sa u takon interesave shtetërore. Gjendja e anarkisë në marrëdhëniet ndërkombëtare, megjithatë, e bën utopik çdo imazh tjetër të marrëdhënieve ndërkombëtare[305]. Këto ide të Waltzit bazohen në dy veçoritë e përgjithshme, por kontradiktore, siç i quan vetë ai, të marrëdhënieve ndërkombëtare : tarifat dhe raporti i forcave (realpolitika). Këto dy koncepte ofrojnë bazë-n mbi të cilën ai bazohet kur e shpjegon rolin sqarues të imazhit të tretë të marrëdhënieve ndërkombëtare[306]. Konsiderojmë se konkluzionet e tilla të nxjerra nga Waltz dhe Rousseau lidhur me kuadrin e veprimit të shteteve nuk janë të mjaftueshme dhe të sakta për arsyet që pasojnë në vijim. Gjërat nuk janë aq të thjeshta sa mund të duken.

Bashkësia e sotme ndërkombëtare është hibride dhe, pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, kohezive. Ajo nuk është aq e thjeshtë, si mendon Waltz dhe autorët e tjerë realistë të marrëdhënieve ndërkombëtare. Ajo është hibride, pjesërisht nga shkaku se buron nga një shoqëri, homogjene ndërkombëtare që është zhvilluar në Evropën moderne, por që më vonë është shtrirë në gjithë planetin gjatë ditëve të kulmimit imperial të Evropës dhe, në pjesën tjetër, nga shkaku se ajo reflekton kulturat e ndryshme të rrënjosura në një

[304] Ibid. fq. 186.
[305] Ibid. fq. 186, 227.
[306] Ibid. fq. 187-223.

sistem që ka një nivel të lartë interaksioni në mes këtyre kulturave. Pika e fundit e kësaj i referohet, krejt në kundërshtim me mendimet e Waltzit, njohjes reciproke të shteteve si entitete sovrane dhe formalisht (legalisht) të barabarta, pa marrë parasysh dallimet kulturore dhe të tjera në mes tyre. Njohja reciproke e shteteve, si sovrane dhe të barabarta, mundëson interaksionet në mes kulturave dhe civilizimeve të ndryshme. Koncepti i raportit të forcave (realpolitika), së këndejmi, nuk është forca e vetme lëvizëse e anarkisë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në fakt, vetë koncepti në fjalë është vënë në dyshim, meqë theksi duhet vënë jo në kuadrin e veprimit të shteteve, pra, në regjimin ndërkombëtar. Theksi duhet të vihet më tepër në strukturën e brendshme të shteteve. Nëse ka ndonjë rol që bashkësia ndërkombëtare e luan kundrejt shteteve atëherë ai është pozitiv dhe stabilizues, ngaqë falë kësaj natyre hibride dhe këtij parimi të njohjes reciproke dhe të barazisë të shteteve sovrane, shtetet e dobëta dhe jo të qëndrueshme akoma ekzistojnë si entitete të kësaj bashkësie ndërkombëtare. Po të mos ishte kështu, ky lloj shtetesh do të ishte zhdukur kaherë nga faqja e dheut[307]. Kjo është kështu veçanërisht pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, por edhe më herët. Shembuj të fundit të këtij lloji të shteteve janë IRJ e Maqedonisë, Shqipëria dhe, në një masë të caktuar, e aq. RFJ (Serbi dhe Mali i Zi). Në të kaluarën, të tilla raste kanë qenë Biafra (Nigeri), Rodezia (Zimbabveja e sotme), Republika e Turqve Qipriotë etj.

Ky tip hibrid i bashkësisë ndërkombëtare është, sipas vetë definicionit, një fenomen postkolonial. Me mbarimin e këtij procesi, numri i shteteve është rritur jashtëzakonisht shumë, por struktura e brendshme e këtyre shteteve postkoloniale ka mbetur e dobët dhe ka shkaktuar përçarje e probleme serioze brenda tyre. Parimi i sipërcekur i barazisë sovrane të shteteve dhe garancitë e bashkësisë ndërkombëtare lidhur me paprekshmërinë e kufijve shtetërorë (parimi i a.q. *uti possidetis*) kanë kontribuar dhe më shumë në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e strukturave të brendshme dhe institucioneve të tyre, të cilat në të shumtën e rasteve kanë reflektuar regjimet dhe shtetet autokratike që shtypin me dhunë vullnetin e shtetasve të vet[308].

---

[307] Cf. Barry Buzan, "From International System to International Society: Structural Realism and Regime Theory Meet the English School", *International Organization* vol. 47, no. 3 (Summer 1993) fq. 327-352; Scott Pegg, "*De Facto* States in the International System", botuar në Institute of International Relations of the University of British Columbia, Working Paper No. 21 (February 1998) fq. 1-3.

[308] Për një analizë të shkëlqyeshme të parimit *uti possidetis* dhe dobësitë e tij inherente, shih më shumë në Steven Ratner, "Drawing a Better Line: *Uti Possidetis* and the Borders of New States", *American Journal oflnternational Law* vol. 90, no. 4 (1996) fq. 590-625.

Duke marrë parasysh përzierjet e ndryshme kulturore nga e kaluara e tyre, shtetet post-koloniale kanë kontribuar dukshëm në kohezionin e shoqërisë ndërkombëtare, meqë ato morën si detyrë respektimin e zotimeve të njëjta dhe obligimeve në kontakte me anëtarë të tjerë të bashkësisë ndërkombëtare. Kohezioni i tërësishëm i kësaj shoqërie ndërkombëtare është rritur esencialisht me aktin e shpërbërjes së ish-Bashkimit Sovjetik, i cili deri më 1990 kishte sfiduar dukshëm. perëndimorët për sa u takon të gjitha normave të sjelljes, rregullave dhe institucioneve të tyre, përveç atyre që i referoheshin sovranitetit dhe armatimit nuklear. Lufta e Gjirit më 1991 ilustron pikën nisëse të këtij koheziviteti të mëtejshëm të shoqërisë së sotme ndërkombëtare, kurse kriza në Kosovë paraqet edhe një sfidë më shumë. Kurrë më shumë nuk është provuar në historinë njerëzore pikëpamja e iluministëve se sjellja deviante është produkt i institucioneve dhe proceseve defektive që mund të ndryshojnë vetëm me ndryshimin e sistemit si tërësi, në rastin tonë me ndryshimet në strukturën e brendshme të shteteve, e cila edhe është burim i sjelljes si më sipër. E njëjta vlen edhe për natyrën njerëzore, për dallim nga pikëpamja e teorisë së realizmit klasik. Pra, mendojmë se natyra e njeriut mund të modifikohet dhe ndryshohet, sepse nuk udhëhiqet nga dëshira e pashërueshme për pushtet, siç mendohet në teorinë e realizmit klasik.

Nga perspektiva e teorisë së marrëdhënieve ndërkombëtare, duhet të jetë korrekt mendimi për ndjekjen e dy rrugëve lidhur me çështjen e përshkruar si më lart. Njëra rrugë konsiston në zhvillimin e mëtejmë të realizmit parimor, por duke theksuar idetë liberale në të[309], kurse tjetra rrugë koncentrohet në nevojën e pasjes së një teorie mbi shtetin në marrëdhëniet ndërkombëtare. Nuk mendojmë e as që argumentojmë këtu se teoria e shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare (pikëpamja e dytë) është diçka *sui generis* apo e pakonceptueshme. Një gjë të tillë, përkundrazi, e quajmë si diçka reale, pra, besojmë se mund të zhvillohet një teori e re për shtetin në marrëdhëniet ndërkombëtare e që do t'i reflektonte sfidat e kohës së pas-Luftës së Ftohtë. Që të bëhet teoria mbi shtetin për sa më sipër, atëherë në te duhet të përfshihen patjetër premisat kryesore të nënshkruesve të Deklaratës së ShBA-së mbi Pavarësinë, e përpiluar para më se dy shekujsh. Premisa e parë e Deklaratës është se shtetet duhet t'i nxjerrin autorizimet e tyre për qeverisje nga ata me të cilët qeverisin, kurse premisa e dytë fokusohet në respektin që shtetet duh-

[309] Charles W. Kegly, Jr., "The Neorealist Moment in International Studies? Realist Myths and the New International Realities", *International Studies Quarterly* vol. 37 (1993) fq. 133-146.

et ta tregojnë ndaj vetë njerëzimit[310]. Vetëm ato shtete që i plotësojnë premisat e cekura e kanë vendin e merituar në familjen e kombeve. Studiuesit e marrëdhënieve ndërkombëtare, në këtë kontekst, të cilët duan të mbështeten në abstraksione me qëllim zhvillimin e teorisë së re mbi shtetin, megjithatë, nuk guxojnë t'i harrojnë këto dy premisa, sepse do t'u mungonin mjetet esenciale për gjykimin e fenomeneve në marrëdhëniet ndërkombëtare. Është ky gabimi që Kenneth Waltz e bën në veprën e vet për shtetin në marrëdhëniet ndërkombëtare, e cila është objekt i kritikës sonë në këtë shkrim. Pra, ai nuk merr parasysh, gjatë ndërtimit të teorisë mbi shtetin, premisat për sa më sipër.

Kjo pikëpamje liberale për konceptin shtet në marrëdhëniet ndërkombëtare, e neglizhuar nga Kenneth Waltz dhe studiuesit e tjerë të proveniencës realiste, është më e përshtatshme për shpjegimin e aspekteve të tjera të çështjes që diskutohet këtu. Në mesin e këtyre aspekteve, ai i bashkëpunimit në mes. të shteteve është i një rëndësie të veçantë. Pikërisht këtu ka dështuar koncepti realist mbi shtetin në marrëdhëniet ndërkombëtare, pra, në rastet kur duhet sqaruar raporti i shtetit ndaj premisave të tjera të realizmit (anarkia ndërkombëtare, fitimet relative të shteteve etj.) si dhe roli i institucioneve dhe rregullave ndërkombëtare në sjelljen dhe veprimet e shteteve. Në këtë respekt, mendimi liberal ka qenë më largpamës dhe më i guximshëm sesa ai realist.

Mendimi liberal, përfshirë këtu edhe neoliberalizmin, ka pohuar se pranon pikën kyçe të realizmit, sipas së cilit anarkia ndërkombëtare pengon bashkëpunimin në mes të shteteve. Mirëpo, liberalët argumentojnë se institucionet dhe rregullat ndërkombëtare i lehtësojnë efektet penguese të anarkisë ndërkombëtare, me supozim se ekziston një vullnet i mirë i shteteve dhe një interes i përbashkët për bashkëpunim. Me fjalë të tjera, për dallim nga Kenneth Waltz dhe realistët e tjerë, liberalët pohojnë se institucionet ndërkombëtare dhe rregullat e bëjnë bashkëpunimin më atraktiv dhe e promovojnë atë. Ringjallja e Unionit Evropian (më parë Bashkësia Evropiane) dhe e institucioneve të tjera regjionale janë dëshmi e kësaj[311]. Në anën tjetër, është e vërtetë se teoritë liberale dhe të tjerat që janë të orientuara kah vlerat normative, por të proveniencës liberale., nuk kanë ndonjë bazë solide empirike, fakt që pra-

[310] Shih poashtu edhe Tomas Frank, "The Emerging Right to Democratic Governance", *American Journal of International Law* vol. 86, no. 1 (1992) fq. 46-91, fq. 46.

[311] Joseph Grieco, "Anarchy and the Limits of Cooperation: A Realist Critique of Newest Liberal Institutionalism", *International Organization* vol. 42, no. 3 (Summer 1988) fq. 485-507.

nohet nga vetë studiuesit e këtij mendimi. Ky nuk është rasti, ndërkaq, me studiuesit e realizmit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Të parët pohojnë se kanë krijuar teorinë për shtetin, pa u bazuar shumë në faktet empirike. Ky fakt, megjithatë, nuk e dobëson rëndësinë e pikëpamjeve liberale dhe neoliberale në shpjegimin e strukturës së shoqërisë ndërkombëtare dhe sjelljen e shteteve në këtë kuadër.

Përfundim

Kritika e konceptit shtet të autorit Kenneth Waltz nënkupton një ndërmarrje të gjerë intelektuale, e cila drejtohet ndaj të gjitha premisave bazë dhe parimeve të realizmit, si teori e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ky nuk ka qenë, ndërkaq, qëllimi ynë. E tërë ajo që kemi dashur dhe duam të arrijmë përmes kësaj kritike ka të bëjë me rivlerësimin e konceptit shtet si aktor racional dhe unitar, ashtu si kuptohet ky në teorinë realiste, koncept që vihet në dritën e ngjarjeve pas mbarimit të Luftës së Ftohtë. Ndryshe, kritika jonë nuk do të kishte kuptim. Në shkrimin tonë, shteti si kuptim nuk diskutohet në sensin e tij legal, socio-politik ose tjetër. Ne flasim vetëm për kuptimin e tij si aktor në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kuadrin e tij të veprimit, qoftë ai shtet unitar ose i përbërë. Ky, në fakt, është kuptimi primar i shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Natyrisht që kemi pasur parasysh edhe aspektet e tjera të nocionit shtet (anën e tij legale, socio-politike, ekonomike dhe tjetër), me qëllim zhvillimin e kritikës ndaj konceptit shtet të autorit Kenneth Waltz. Rruga jonë e argumentimit ka shkuar kryesisht nëpër atë të ndjekur nga vetë autori, pra, është bazuar në tri imazhet (pikëpamjet) tradicionale mbi marrëdhëniet ndërkombëtare: individi, shteti dhe bashkësia ndërkombëtare. Thënia e Aristotelit se politika është një gjë e pambërthyeshme, askund nuk duket më e saktë se në rastin e definimit të konceptit shtet në marrëdhëniet ndërkombëtare. Përkundër gjithë kësaj, nuk u dekurajuam kur ndërmorëm shkrimin e kësaj kritike. Ndihma e prof. dr. Skot Peg (Scott Pegg), ligjërues i lëndës "Debatet aktuale në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare" në Universitetin Bilkent të Ankarasë, në përpilimin e tezave fillestare të kritikës sonë ka qenë e një rëndësie të madhe. Pa të, vështirë që ky shkrim do ta kishte marrë formën dhe përmbajtjen që sot e ka. U mor vesh, tërë përgjegjësia bie mbi mua dhe askënd tjetër.

Vijat e kritikës sonë ndaj Kenneth Waltzit shkojnë kah çështjet si vijon: ngjashmëria dhe ndryshimi; struktura e brendshme e shteteve; natyra e shtet-

eve (demokratike dhe jodemokratike); dhe, së fundi, roli që rregullat dhe institucionet e regjimit ndërkombëtar luajnë në ardhmërinë e shteteve.

Për sa i përket nivelit të parë të analizës, Kenneth Waltz sigurisht që pozicionohet kah rryma pesimiste e studiuesve, përkatësisht me ata studiues që konsiderojnë se shtetarët individualë nuk luajnë asnjë rol në formësimin final të veprimeve të shteteve. Natyra njerëzore, sipas tyre, është definitivisht e pandryshueshme.

Edhe pse autori i takon së njëjtës perspektivë realiste si Hans Morgenthau, ai përfundimisht e largon nga kritika e vet tërë anën normative dhe morale të konceptit shtet. Shtetet janë aktorë racionalë. Sjellja dhe veprimet e shteteve janë të përllogaritura mbi bazën e përfitimeve eventuale që dalin nga sjelljet dhe veprimet e tyre. Konsideratat normative dhe morale nuk luajnë asnjë rol në këtë kontekst. Këto premisa e bëjnë autorin Kenneth Waltz përkrahësin kryesor të tezës sipas së cilës shteti është një aktor racional, pa asnjë modifikim. Konsiderojmë, ndërkaq, se ky qëndrim është i stërthjeshtësuar. Ngjarjet nga e kaluara dhe ato të vonshmet tregojnë se lëvizjet kryesore socio-politike kanë qenë rezultat i hapave të vegjël dhe gradual, por edhe rezultat i njëkohshëm i aktiviteteve dhe veprimeve individuale të personalitete-ve të dhëna. Të marrim si shembull Luftën e Dytë Botërore, Holokaustin dhe krizën e raketave në Kubë (1962), pa harruar këtu rolin që Napoleoni ka luajtur në historinë evropiane. Të gjitha këto raste, bashkë me të tjerat që këtu nuk zihen në gojë, provojnë se roli i individëve gjatë momenteve të caktuara historike ka qenë vërtet i madh dhe se sjelljet e tyre nuk janë kushtëzuar nga natyra, kryesisht anarkike, e sistemit ndërkombëtar të kohës. Me logjikën e përllogaritjeve të fitimeve shtetërore (shteti si aktor racional) nuk mund të shpjegohen as Revolucioni në Francë (1789), Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore, Holokausti, unifikimi i Gjermanisë etj. Në rastet si këto, procesi i vendimmarrjes dhe vetitë personale të shtetasve të kohës kanë luajtur rolin parësor më shumë se vetë ambienti dhe sistemi ndërkombëtar i kohës. Në vijim të kësaj duhen parë sjelljet e Serbisë dhe Irakut pas mbarimit të Luftës së Ftohtë.

Në imazhin e dytë që ka të bëjë me konfliktet ndërkombëtare dhe strukturën e brendshme të shteteve, autori diskuton "problemet e luftës dhe të paqes". Këtij imazhi i kushtohet vëmendje më e madhe nga autori, sado që ai e kritikon këtë po aq sa edhe pararendësin e tij. Ai nuk është i sigurt nëse të gjitha shtetet janë të prira për luftë apo vetëm disa lloje shtetesh, ndërkohë që mendon se shtetet jodemokratike janë të prira për luftë dhe se aspektet kushtetuese dhe situacionale të tyre kanë një ndikim në çështjet e luftës dhe të

paqes. Ky argument, në anën tjetër, bie ndesh me shtjellimet e tij kryesore, ku pohon se vetëm ambienti ndërkombëtar determinon të kuptuarit tonë të shtetit dhe të marrëdhënieve të tij ndaj çështjeve të luftës dhe paqes.

Imazhi i dytë ka lindur nga idetë liberale për organizimin shtetëror, ashtu si ne e njohim sot e kësaj dite. Esenca e imazhit në fjalë është se struktura e brendshme dhe organizimi i shteteve kanë ndikim në sjelljet dhe veprimet e tyre. Shtetet me një regjim të brendshëm demokratik, shikuar historikisht, nuk kanë qenë të orientuara kah lufta, edhe pse në sistemin ndërkombëtar anarkik (teza e realizmit klasik) ato do të duhej ta ndiqnin logjikën e përllogaritjes së fitimeve. Shtetet autokratike, në të kundërtën e kësaj, janë të orientuara kah lufta, si rrjedhojë e problemeve të tyre të brendshme dhe të vetë strukturës. Për t'i mbajtur shtetasit e vet nën sundim, këto shtete duhet të kërkojnë arsye dhe shkaqe jashtë kufijve të tyre shtetërorë. Edhe këtu nuk qëndron shembulli i Kenneth Waltz lidhur me luftërat revolucionare të Francës dhe Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore.

Struktura e brendshme jodemokratike e shteteve të dhëna ka pasur një ndikim në shoqërinë ndërkombëtare në sensin se ato kanë paraqitur dhe paraqesin burim të vazhdueshëm jostabiliteti ndërkombëtar. Sistemi ndërkombëtar si i tillë nuk ka qenë e as nuk është burim dhe shkak i pasigurisë së këtyre shteteve, por vetë struktura e brendshme dhe e dobët shtetërore e tyre. Për më tepër, struktura e sistemit ndërkombëtar ka paraqitur dhe paraqet një mjet në dobi të mbijetesës së këtyre shteteve, gjë e cila manifestohet përmes rregullave (normave) ndërkombëtare mbi barazinë formale (legale/sovrane) të shteteve. Rasti më tipik i kësaj janë disa nga shtetet e Ballkanit dhe të Afrikës/Azisë pas dekolonizimit. Si pasojë e strukturës së tyre të dobët të brendshme, kanë ndodhur dhe ndodhin luftëra brenda tyre. Ky lloj luftërash janë quajtur nga studiues të ndryshëm si "luftëra të llojit të tretë", me kuptim se nuk zhvillohen në mes të shteteve, por brenda tyre. Qëllimi dhe shkaku i këtyre luftërave është i ndryshëm nga rastet klasike, të cilat janë zhvilluar që nga Paqja e Vestfalisë, përkatësisht se këto janë luftëra që lidhen me statusin e popujve që jetojnë brenda shteteve dhe lidhur me krijimin e shteteve të reja nga shtetet ekzistuese.

Në shoqërinë ndërkombëtare ekziston një anarki, ashtu që shtetet duhet të kujdesen për vetveten, nëse duan të mbijetojnë dhe të mos zhduken nga faqja e dheut. Vetëgjyqësia, si sistem në marrëdhëniet ndërkombëtare, do të jetë tipari kryesor i shoqërisë ndërkombëtare për aq kohë sa nuk do të ketë një qeveri botërore ose ndonjë autoritet tjetër superior, i cili vullnetin e vet do t'ua imponontе shteteve ekzistuese (logjika e anarkisë në marrëdhëniet

ndërkombëtare sipas teorisë realiste). Argumenti i Rousseausë, sipas së cilit federata do të kishte pushtet dhe forcë të mjaftueshme për administrimin e marrëdhënieve në mes të anëtarëve të saj, duket tërësisht i pabazë për Kenneth Waltzin. Situata e vetëgjyqësisë dhe lufta, si pasojë e saj, për autorin Waltz duken si të gjykuara për ekzistencë për aq kohë sa filozofia e konkurrencës në mes të shteteve të mbizotërojë. Dhe, kjo nuk mund të jetë fare e vërtetë. Një argument i tillë është tepër i thjeshtë që të reflektojë tërë ndërlikueshmërinë e marrëdhënieve të sotme ndërkombëtare, qoftë edhe për hir të ndërtimit të një teorie apo, thjesht, për hir të zhvillimit të mëtejmë të paradigmave të caktuara.

Shoqëria e sotme ndërkombëtare nuk udhëhiqet nga koncepti klasik i bilancit të forcave. Natyra e saj hibride lejon akomodim interesash të ndryshme të shteteve, që në të kaluarën çmohej si gjë e pamundur. Njohja reciproke e "shteteve, më parë se bilanci i forcave, paraqet esencën e parimit mbi bazën e të cilit duhen gjykuar qëndrimet dhe veprimet e shumicës së shteteve në bashkësinë e sotme ndërkombëtare. Ky tipar i sistemit të sotëm ndërkombëtar, sado që evropian në esencë, ofron edhe një mburojë më shumë për shtetet e vogla dhe të dobëta. Këto të fundit, gjykuar sipas kritereve të autorit mbi shtetin dhe bilancin e forcave, do të ishin shpërbërë kaherë. Falë rregullave, normave dhe institucioneve të cilat garantojnë barazinë formale (legale/sovrane) të shteteve, shtetet si më sipër akoma mbijetojnë. Në vijim të kësaj, ajo që qëndron lidhur me shtet e dobëta është se struktura e tyre e brendshme ka qenë dhe mbetet burim i problemeve dhe i konflikteve ndërkombëtare.

Sistemi ndërkombëtar, sado hibrid në natyrën e tij, sërish ruan një kohezivitet të vetin minimal. Kjo do të thotë se të gjitha shtetet, pa marrë parasysh nivelin e zhvillimit, emancipimin kulturor e politik, zotohen për respektimin dhe vënien në jetë të rregullave, normave dhe të institucioneve të definuar si "dobi e përbashkët e njerëzimit". Edhe pse i sfiduar gjatë Luftës së Ftohtë, kohezivitetit pas mbarimit të saj ka filluar të rritet, për të kulmuar në pikën dominante gjatë Luftës së Gjirit (1991). Konfliktet etnike në ish-Jugosllavi dhe, së fundi, në Kosovë, paraqesin sërish një sfidë ndaj konceptit të kohezivitetit, si u përshkrua më lart. Këto sfida, megjithatë, nuk burojnë nga sistemi ndërkombëtar, por nga vetë struktura e brendshme e entiteteve përbërëse të tij, pra, nga struktura e brendshme e shteteve. Ky fakt shtron nevojën e përmirësimit të strukturës së brendshme, e jo të asaj ndërkombëtare, të entiteteve përbërëse të sistemit ndërkombëtar. Kjo pikë referimi ka të bëjë me nivelin e parë të analizës së marrëdhënieve ndërkombëtare, pra me nivelin që merret me individin. Mungesa e institucioneve demokratike dhe e

traditës nëpër këto shtete, të dala kryesisht nga procesi i dekolonizimit dhe pas tij, përforcon idenë se kuadri i veprimit të shteteve, pra sistemi ndërkombëtar, nuk është njësi e qëlluar për analizë dhe, rrjedhimisht, nuk mund ta shpjegojë krizën aktuale në shoqërinë ndërkombëtare.

Çfarë duhet bërë?! Janë tri vërejtje që duhet pasur parasysh, nëse vërtet synohet korrektimi i pikëpamjeve të autorit. Kjo është kështu veçanërisht sa i përket aspektit të bashkëpunimit në mes të shteteve. Në fakt, Kenneth Waltz dhe të gjithë realistët e tjerë argumentojnë se bashkëpunimi në kushtet e anarkisë ndërkombëtare është shumë i vështirë dhe ndodh vetëm përjashtimisht dhe në raste të jashtëzakonshme, por gjithherë nën hijen e konkurrencës brutale në mes të shteteve. Ne argumentojmë këtu, përkundrazi, se bashkëpunimi ndërshtetëror nuk është i vështirë, në veçanti, kur shikohet nga perspektiva e rregullave, normave dhe institucioneve ndërkombëtare. Unioni Evropian (më herët Bashkësia Evropiane) është shembull tipik. Kjo dëshmon se shteti në marrëdhëniet ndërkombëtare kuptohet më mirë dhe, mbi bazën e kësaj, teoria mbi shtetin ndërtohet më lehtë nëse merren parasysh idetë liberale (dhe neoliberale) mbi shtetin në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Në këtë, kontekst, pika e dytë e argumentimit do t'i referohej një konceptualizimi tjetër të nocionit shtet e me qëllim të ndërtimit të teorisë solide për shtetin në marrëdhëniet ndërkombëtare. Bazuar në këtë, teoria e re mbi shtetin. në marrëdhëniet ndërkombëtare duhet të përfshijë si aspektet e brendshme, ashtu dhe ato ndërkombëtare të konceptit shtet. Në të parat hyn struktura demokratike e shtetit, përkatësisht koncepti i "qeverisjes demokratike", kurse në të dytat kundërvënia e shtetit dhe sjelljeve e veprimeve të tij ndaj botës që e rrethon. Sikur mund të vërehet, përparësi i jepet strukturës së brendshme të shteteve ngaqë kjo paraqet dhe reflekton realitetin e sotëm të marrëdhënieve ndërkombëtare, perspektivat dhe sfidat e tyre.

Thënë shkurt, në këtë shkrim provuam të argumentojmë në mënyrë konkluzive se koncepti i Kenneth Waltzit për shtetin në marrëdhëniet ndërkombëtare nuk është i qëlluar dhe ka të meta serioze si i tillë. Edhe pse ka qenë një detyrë e vështirë, tentimi ynë ka shkuar në drejtim të vënies së disa vërejtjeve thelbësore që bien ndesh me konceptin e autorit lidhur me shtetin në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Vërejtjet tona dhe argumentet koncentrohen në drejtimet për sa vijon:

- çështjet e ngjashmërisë dhe dallimeve në mes të shteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare;

- faktin se struktura e brendshme dhe dinamika e shteteve të dobëta, pra, jo sistemi ndërkombëtar, janë burim lufte dhe jostabiliteti ndërkombëtar;
- në vijim të kësaj, argumenti i luftës dhe paqes, e që lidhet me konceptet "regjim demokratik" dhe "jodemokratik", paraqet një nga kuptimet mbi të cilat mbështetet autori, sado që kuadri ndërkombëtar për veprim shtetëror është pika kryesore e referimit të tij për kuptimin e nocionit shtet në marrëdhëniet ndërkombëtare;
- së fundi, shtetet e dobëta dhe jo të sigurta ruhen dhe mbijetojnë falë normave, rregullave dhe institucioneve ndërkombëtare (barazia formale/sovrane e shteteve). Këto norma, rregulla dhe institucione jo vetëm që i ruajnë shtetet ekzistuese, por edhe ofrojnë dhe lehtësojnë bashkëpunimin në mes tyre.

Kapitulli III

UTI POSSIDETIS JURIS DHE ÇËSHTJA E CAKTIMIT TË KUFIJVE TË KOSOVËS

Sfondi historik: Punimi i parë, me titull "*Uti Possidetis Juris*: Nga Roma në Kosovë", u botua në ShBA si pjesë e një debati ndërkombëtar mbi brishtësinë e së drejtës ndërkombëtare dhe pamundësinë e saj për të zgjidhur konfliktet dhe mosmarrëveshjet e ndryshme ndërmjet shteteve dhe akterëve të tjerë të së drejtës ndërkombëtare[312].

Kur më 2003, në fillim të atij viti, më kërkuan të shkruaja diçka për revistën e njohur akademike, *The Fletcher Forum of World Affairs,* menjëherë më doli në mendje çështja e kufijve të Kosovës dhe konteksti i tyre juridiko-ndërkombëtar. Kjo për faktin se parimi *uti possidetis*, ashtu siç ishte zbatuar në ish-Jugosllavi, e linte Kosovën jashtë lojës dhe potencialisht legalizonte njëherë e përgjithmonë mbetjen e Kosovës nën sovranitetin formal të RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi), përkatësisht nën sovranitetin serb në rast të largimit të Malit të Zi nga RFJ, këtij shteti të krijuar nga diktatori serb Sllobodan Millosheviq më 1992 pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë.

Situata e fundit si më sipër ndodhi tri vjet më vonë, në qershor të vitit 2006, kur Mali i Zi u nda nga RFJ. Shkrimi si më sipër, i cili riprodukohet këtu, ka qenë pledoaje e autorit të këtyre rreshtave për një korrigjim ndërkombëtar të qasjes ndaj Kosovës sa i përket zbatimit të parimit *uti possidetis*. Ai korrigjim do të konsistonte në zbatimin e parimit *uti possidetis* 1974 edhe ndaj Kosovës dhe jo ashtu siç e kishte thënë Komisioni Badinter në mendimin e vet nr. 3 të datës 11 janar 1992[313]. Kjo për faktin e thjeshtë se Kosova, ani

---

[312] Enver Hasani, "*Uti Possidetis Juris*: From Rome to Kosovo", *Fletcher Forum of World Affairs* vol. 27, issue 2 (Summer/Fall 2003). Vëllimi i revistës *Fletcher Forum of World Affairs* i qe kushtuar lëmisë të së drejtës ndërkombëtare dhe vështirësive që kjo degë e së drejtës po haste në realizimin e misionit të saj — arritjes së paqes në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo shihet nga vet titulli i këtij vëllimi, "International Law under Fire" (E drejta ndërkombëtare nën zjarr), ku të gjitha shkrimet flisnin për aspekte të ndryshe të paqes në planin ndërkombëtar dhe për rolin e së drejtës ndërkombëtare në arritjen e saj.

[313] "Ky parim [*uti possidetis juris* — vërejtja jona, E.H.] zbatohet me po aq lehtësi ndaj republikave sepse paragrafi i dytë dhe i katër i nenit 5 të Kushtetutës së RSFJ-së theksojnë se ter-

se nuk ishte një republikë federale, kishte një identitet të qartë territorial që nga viti 1974, identitet të cilin ua garantonte Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974 si republikave ashtu edhe ish-krahinave autonome[314].

Mendimi nr. 3 si më sipër ishte dhënë nga Komisoni Badinter si përgjigje në shqetësimet dhe dilemat serbe, të cilat buronin nga politikat e saj hegjemoniste që synonin krijimin e Serbisë së madhe dhe ndryshimin e kufijve administrativë të ish-republikave federale jugosllave dhe të kufijve administrativë të Kosovës, kufij që, siç u pa, garantoheshin në po të njëjtën mënyrë si ata republikanë nga Kushtetuta e RSFJ e vitit 1974. Dilemat dhe shqetësimet hegjemoniste serbe, Republika e Serbisë i kishte shprehur me shkrim dhe ia kishte paraqitur Lordit Carrington, i cili atëbotë ishte kryetar i Konferencës për Jugosllavinë, më datën 20 nëntor 1991. Kjo dilemë dhe ky shqetësim serb shprehej në formë të pyetjes për sa vijon: "a mund të konsiderohen si kufij ndërkombëtar kufijtë e brendshëm mes Kroacisë dhe Serbisë dhe mes Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë?"

Pas analizës së materialeve dhe argumenteve të ofruara nga të gjitha palët — që domethënë nga Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Sllovenia, Serbia, kryesia e cunguar e RSFJ-së dhe së fundi, edhe nga i a.q. "kuvend i popullit serb të Bosnjë-Hercegovinës"[315] — Komisioni Badinter dha mendimin e vet nr. 3 si më sipër. Në të thuhej:

---

ritoret e republikave dhe kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa pëlqimin e vetë republikave".

[314] Neni 5 [Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë] i Kushtetutës së RSFJ të vitit 1974:

"Territori i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë është unik dhe përbëhet nga territori i republikave socialiste.

"Territori i republikës nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e republikës, kurse territori i krahinës autonome — pa pëlqimin e krahinës autonome.

"Kufiri i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë nuk mund të ndryshohet pa pëlqimin e të gjitha republikave dhe krahinave autonome.

"Kufiri mes republikave mund të ndryshohet vetëm në bazë të pëlqimit të tyre, e kur flitet për kufijtë e krahinave autonome, as pa pëlqimin e krahinave autonome."

[315] Asnjëherë gjatë ekzistimit të ish-Jugosllavisë (1918-1992) populli serb i Bosnjë-Hercegovinës nuk kishte pasur identitet territorial të veçantë dhe të pavarur. Ky "identitet" u krijua me dhunë dhe me gjenocid kundër popujve dhe kulturave jo serbe në Bosnjë-Hercegovinë. Ky kuvend serb i formuar në vigjilje të luftës dhe gjenocidit serb në Bosnjë-Hercegovinë, kishte për qëllim realizimin e të drejtës eksterne për vetëvendosje, duke shpresuar se krijimi i tij dhe i një republike serbe ne Bosnjë-Hercegovinë do të tolerohej dhe pranohej nga bashkësia ndërkombëtare. Kjo nuk ndodhi, megjithatë, sepse tërë bashkësia ndërkombëtare në fillim të krizës në ish-Jugosllavi pa në formimin e këtyre kuvendeve serbe politikën hegjemoniste serbë që synonte ndryshimin me dhunë të kufijve administrativ të republikave dhe krahinave ish-Jugosllave.

> 1. Në mendimin e tij nr. 1 të datës 29 nëntor 1991, i cili është publikuar më 7 dhjetor, Komisioni ka deklaruar se "Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë është në proces të shpërbërjes". Duke pasur parasysh se Republika e Kroacisë dhe ajo e Bosnjë-Hercegovinës, *inter alia*, kanë kërkuar njohje ndërkombëtare, Komisioni është i mendimit që përgjigja në pyetjen e shtruar [nga Serbia përmes Lordit Carrington — vërejtja jonë, E.H] duhet të jepet domosdoshmërisht në kontekst të situatës në ndryshim e sipër dhe si pasojë duhet të mbështetet në parimet dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare publike.
> 2. Komisioni është i mendimit që, rrjedhimisht, kur procesi në RSFJ çon drejt krijimit të një ose më shumë shteteve të pavarura, çështja e kufijve, posaçërisht të atyre republikave të përmendura në pyetjen e shtruar si më sipër [nga ana e Serbisë — vërejtja jonë, E.H.], duhet të zgjidhet në përputhje me parimet e mëposhtme.

E para, të gjithë kufijtë e jashtëm duhet të respektohen në përputhje me parimin e përmendur në Kartën e Kombeve të Bashkuara, në Deklaratën mbi Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare në lidhje me Marrëdhëniet Miqësore dhe Bashkëpunimin mes Shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara (Rezoluta 2625 (XXV) e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara) dhe në Aktin Final të Helsinkit, si dhe me parimin që gjendet në nenin 11 të Konventës së Vjenës të datës 23 gusht 1978 mbi Trashëgimin e Shteteve në Traktatet Ndërkombëtare.

E dyta, kufijtë mes Kroacisë dhe Serbisë, mes Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë, dhe mes shteteve tjera të pavarura na afërsi (fqinjësi), nuk mund të zëvendësohen përveçse me marrëveshje të arritur lirshëm mes palëve.

E treta, përveç nëse palët pajtohen ndryshe, kufijtë e mëparshëm administrativë bëhen kufij të mbrojtur nga e drejta ndërkombëtare (kufij ndërkombëtarë). Ky përfundim rrjedh nga parimi i respektimit të *status quo*-së territoriale dhe, në veçanti, nga parimi *uti possidetis*. Megjithëse, fillimisht, *uti possidetis* është aplikuar për dhënien fund të çështjeve të dekolonizimit në Amerikë dhe Afrikë, sot njihet si një parim i përgjithshëm, siç edhe thuhet në Mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të datës 22 dhjetor 1986 në rastin mes Burkina-Fasos e Republikës së Malit (*Frontier Dispute*, 1986, ICJ Report, fq. 554-556):

> Ky parim nuk është një normë e veçantë, e cila i përket vetëm një sistemi specifik të së drejtës ndërkombëtare. Ai është një parim i përgjithshëm, i cili logjikisht është i lidhur me fenomenin e fitimit të pavarësisë, kurdo që ajo ndodh. Qëllimi i tij i dukshëm është që të pengojë rreziki-

> min e pavarësisë dhe stabilitetit të shteteve të reja nga luftërat vëllavrasëse [...].

Ky parim zbatohet me po aq lehtësi ndaj republikave sepse paragrafi i dytë dhe i katërt i nenit 5 të Kushtetutës së RSFJ-së theksojnë se territoret e republikave dhe kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa pëlqimin e vetë republikave.

E katërta, sipas parimit të mirënjohur të së drejtës ndërkombëtare ndryshimi me forcë i kufijve ekzistues ose kufijve nuk mund të prodhojnë asnjë efekt legal. Ky parim mbështetet, për shembull, në Deklaratën mbi Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare në lidhje me Marrëdhëniet Miqësore dhe Bashkëpunimin mes Shteteve në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara (Rezolutën 2625 (XXV) të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara) dhe Aktin Final të Helsinkit. Ky parim është pranuar nga Konferenca e Hagës më 7 shtator 1991 dhe është futur në Projekt-Konventën e 4 nëntorit 1991, e hartuar nga Konferenca për Jugosllavinë.

Kur ndodhi ndarja e Malit të Zi nga USMZ në qershor të vitit 2006, atëherë Serbia trashëgoi të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shtetit pararendës që i takonin territorit të ish-KSA të Kosovës. RFJ (Serbi dhe Mali i Zi), e krijuar më 1992 dhe e transformuar sipas një marrëveshje të lidhur në Beograd më 14 mars të vitit 2002 në USMZ, ishte njëri prej pesë shteteve trashëgimtare të ish-Jugosllavisë[316]. Procesi i trashëgimit të ish-Jugosllavisë u mbyll më 2001 me lidhjen e Marrëveshje së Vjenës për Trashëgimin e ish-Jugosllavisë, e cila është diskutuar në kapitullin II të këtij libri si një ndër temat e veçanta. Trashëgimi i Serbisë ndaj territorit të Kosovës bazohej në Marrëveshjen për Union, e lidhur në Beograd më 14 mars 2002, mes Serbisë dhe Malit të Zi. Kjo marrëveshje, e cila diskutohen në punimin e parë në vijim, kishte dispozita të veçanta të cilat i njihnin një të drejtë të tillë Republikës së Serbisë. Këto dispozita ishin formuluar ashtu që në mënyrë të qartë Serbisë i njihnin të drejta preferenciale ndaj Kosovës në rast të shpërbërjes së unionit të ri shtetëror serbo-malazez.

Me pavarësimin e Kosovës më 17 shkurt 2008 nisi zbatimi i parimit *uti possidetis juris*, sipas zbatimit automatik të këtij parimi në të drejtën ndërkombëtare, i cili konsiston në transformimin e kufijve të fundit administrativë në kufij ndërkombëtarë. Kjo nënkupton se kufijtë e fundit të Kosovës, të cilët

---

[316] Nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë në pranverën e vitit 1992 ishin krijuar këto pesë shtetet të reja trashëgimtare: Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, RFJ (Serbi dhe Mali i Zi) dhe Sllovenia.

në thelb ishin ata që kishin qenë më 1974, bëheshin kufij të rinj ndërkombëtarë të shtetit të Kosovës. Vija kufitare e Kosovës së 17 shkurtit 2008, jo domosdo ishte e njëjtë me vijën kufitare që kishte ekzistuar në shkurt të vitit 1974, kur ishte miratuar Kushtetuta e ish-KSA të Kosovës e po atij viti. Se kjo është kështu u pa qartë kur filloi caktimi i kufijve të Kosovës me fqinjët e saj: Maqedoninë dhe Malin e Zi. Në ndërkohë që më Maqedoninë kishte një marrëveshje për delimitim, sipas së cilës kufijtë e RFJ-së (Serbi e Mal i Zi) caktoheshin mbi bazën e gjendjes së fundit kadastrale dhe kritereve të tjera shtesë nga e drejta ndërkombëtare klasike (pozita gjeografike, interesi ekonomik i vendeve dhe i qytetarëve të afektuar më caktimin e kufirit etj.), me Malin e Zi nuk pati asnjë marrëveshje paraprake ashtu që caktimi i kufijve të Kosovës me Malin e Zi doli të jetë jo identifikim i vijës kufitare të vitit sipas rregullës *uti possidetis juris*, por caktim i një kufiri të ri shtetëror të Kosovës. Me Maqedoninë gjërat ishin më të qarta sepse flitej për trashëgim nga ana e Kosovës së Marrëveshjes së vitit 2001, e cila ishte lidhur mes Maqedonisë dhe RFJ-së. Këtu Kosova nuk kishte shumë zgjidhje: kufiri i caktuar dhe i ndryshuar më 2001 në mënyrë automatike trashëgohej nga shteti i ri i Kosovës sipas rregullave mbi trashëgimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për kufijtë të cilat janë absolute dhe nuk mund të ndryshohen nga palët në mënyrë të njëanshme[317]. E njëjta gjë vlen edhe me marrëveshjen për kufijtë me Shqipërinë, e njohur si Protokolli i Firencës i vitit 1926, me të cilën janë caktuar kufijtë e

[317] Këtë rrethanë Kosova e kishte bërë të qartë në mënyrë të njëanshme me momentin e pranimit të Planit Ahtisaari (2007) si dokumentin bazik mbi bazën e të cilit u shpall pavarësia e vendit më 17 shkurt 2008. Në nenin e tretë [Kufiri] të Aneksit të VIII-të [Sektori i Sigurisë në Kosovë] të Planit Ahtisaari, qartë flitet për ndryshim të trashëgimit klasik të kufijve të vitit 1974 të Kosovës, të ndryshuar me marrëveshjen e sipërcekur të vitit 2001 të lidhur mes RFJ (Serbi dhe Mali i Zi) dhe Maqedonisë). Ky nen në pikën 3.2 thotë si vijon:

"Territori i Kosovës nga vija kufitare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ashtu siç kanë qenë këto vija kufitare më 31 dhjetor 1988, përveç ndryshimit të vijës kufitare nga marrëveshja e demarkacionit mes Republikës Federative të Jugosllavisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë më 23 shkurt 2001".

Se fjala është për zbatim të së drejtës klasike ndërkombëtare mbi trashëgimin në marrëveshje ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me kufijtë, qartë shihet edhe nga një deklaratë e kryesuesit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të datës 7 mars 2007, të cilën në fusnotën nr. 7 me nenin e tretë si më sipër e citon Plani Ahtisaari. Kryesuesi i Këshillit të Sigurimit me atë rast pat thënë, ndër tjera, se: "Këshilli i Sigurimit bën thirrje për nevojën e respektimit të sovranitetit dhe integritetit territorial të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në këtë kontekst thekson se marrëveshja mbi demarkacionin e kufirit, e nënshkruar në Shkup më 23 shkurt 2001 [...] duhet të respektohet nga të gjithë".

sotëm të Shqipërisë, ku pjesa kah Kosova dikur ka qenë nën sovranitetin e ish-Jugosllavisë.

Nga sa më sipër, problemet që lindën në caktimin e kufijve me Malin e Zi, fqinjin tonë perëndimor, gjenezën e kanë pikërisht në shpërputhjen mes parimit *uti possidetis* siç ka ekzistuar më 1974 dhe *uti possidetis* siç është caktuar me interpretimin krejtësisht gabim dhe jotransparent të një komisioni qeveritar, i cili u kryesua nga z. Murat Meha dhe që punoi nga viti 2012 e deri më 25 gusht 2015, kur u nënshkrua Marrëveshja për Demarkacionin me Malin e Zi. Autori i këtyre rreshtave u njoftua me këto gabime vetëm në pranverën e hershme të vitit 2016, në ndërkohë që po përgatiste botimin e dy monografive, një për të drejtën kushtetuese dhe tjetra për të drejtën ndërkombëtare. Në kuadër të monografisë së fundit, të cilën tani e ka në dorë lexuesi, autori dëshironte që të ribotonte pikëpamjet e tij për kufijtë, të cilat i kishte shprehur qysh gjatë kohës së studimeve të doktoratës (1998-2001), por edhe më herët që nga koha e shkrimeve të para për trashëgimin e ish-Jugosllavisë, të cilët së bashku riprodukohen në këtë monografi.

Duke bërë përgatitjen për botimin e shkrimeve për kufij dhe trashëgim të shteteve në të drejtën ndërkombëtare, në pranverën e hershme 2016, ky autor kishte kërkuar ndihmën e disa kolegëve për të gjetur kopjen e marrëveshjes për demarkacion me Malin e Zi, të nënshkruar në Vjenë më 25 gusht 2015. Kjo çështje tanimë ishte bërë një agjendë e njohur për publikun, si pasojë e reagimit të partive opozitare në Kosovë, por që diskursi rreth marrëveshjes ishte kryesisht mekanik, teknik, dhe bazohej në argumentime të natyrës hartografike në kuptimin e gjerë të kësaj fjalë. Si i tillë, reagimi profesional kufizohej në disa profesorë universitarë nga lëmenjtë e gjeografisë dhe gjeodezisë, pa ndonjë argument nga lëmi i së drejtës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Debati asnjëherë nuk arriti të ketë një ton juridiko-ndërkombëtar, çfarë do të duhej të ishte rasti.[318] Kanë qenë kryesisht gjeografët dhe gjeodetët ata që i bënë publike gabimet e mëdha të Komisionit të udhëhequr nga z. Murat Meha dhe i dhanë tonin debatit për këtë çështje.

---

[318] Libri i prof. Zejnullah Grudës doli vonë , njëjtë sikur edhe ky libër që e ka lexuesi në dorë, d.m.th., pasi që është mbyllur debati rreth gabimeve të shkaktuara në demarkacionin me Malin e Zi. Cf. Zejnullah Gruda, *Kufijtë në dëm të shqiptarëve (Demarkacioni i vijës kufitare Kosovë-Mali i Zi në kontekstin historik, ish-jugosllav dhe të së drejtës ndërkombëtare*) (Koha: Prishtinë, qershor 2016). Shpresojmë se edhe ky libër, krahas librit të prof. Zejnullah Gruda, do paraqesë një kontribut modest në problematikën e caktimit të kufijve të Kosovës në të ardhmen si dhe do të evidentojë për gjeneratat që vijnë gabimet e bëra gjatë vënies së kufirit me Malin e Zi.

Për këtë qëllim, autori i këtyre rreshtave në koordinim më kolegët nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, profesorët Zejnullah Gruda, Hajredin Kuçi, Iliriana Islami, Remzije Istrefi etj., si dhe me dekanin prof. Haxhi Gashi, mori iniciativën për organizimin e një debati profesional-shkencor lidhur me çështjen e kufijve në të drejtën ndërkombëtare. Kjo edhe ndodhi, më datën 25 prill 2015, kur në Fakultetin Juridik u mblodhën profesorët më eminentë të Kosovës, jo vetëm juristët por edhe nga lëmenjtë e tjerë, për të rrahur problematikën e demarkacionit, si njëri ndër aspektet relativisht teknike në fazën e caktimit shtetëror të kufijve në të drejtën ndërkombëtare. Ky ka qenë momenti kur ky autor është njoftuar me profesorët e nderuar Shpejtim Bulliqi, Florim Isufi dhe Përparim Ahmeti. Që nga ky moment kemi punuar së bashku në mënyrë intensive, secili nga këndi i vet i profesionit, deri në kurorëzimin e punës sonë të përbashkët me datën 3 gusht 2016, kur në Kuvend të Kosovës u mbajt debati i vonuar publik, profesional dhe shkencor lidhur me caktimin (e gabuar) të kufijve me Malin e Zi. Siç e thotë populli, "më mirë vonë se kurrë"! Efektet pozitive të këtij debati publik u vërejtën që atë ditë dhe pas saj sepse tanimë qartë duket se kufijtë dhe çështjet tjera serioze të interesit nacional nuk mund të vendosen pa pjesëmarrjen e segmenteve kompetente të profesionit dhe shkencës.

I. *UTI POSSIDETIS JURIS*: NGA ROMA NË KOSOVË

Hyrje

Ky punim analizon parimin *uti possidetis juris*, një koncept i së drejtës ndërkombëtare që i definon kufijtë e shteteve të reja sovrane, duke u bazuar në kufijtë e tyre të mëparshëm administrativë. Ai vazhdon duke gjurmuar rrënjët historike të konceptit dhe duke analizuar zbatimin e tij në ditët e sotme, ndonëse në rastin e Kosovës jo i pranuar në politikën dhe të drejtën ndërkombëtare. Me origjinë nga e drejta romake, *uti possidetis juris* përfshinte pronësinë mbi gjërat dhe ishte i natyrës së përkohshme. Vetëm më vonë, gjatë kohës së mesjetës, u bë normë e marrëdhënieve ndërkombëtare, së pari në Amerikën Latine dhe pastaj në Afrikë dhe në Azi.

Jashtë kontekstit kolonial, parimi *uti possidetis juris* është zbatuar në shpërbërjen e federatave komuniste të Jugosllavisë, të Çekosllovakisë dhe të Bashkimit Sovjetik.

Në fokus të kësaj analize është rasti i Jugosllavisë, që i solli një tragjedi tërë territorit të Ballkanit.

Kjo nuk do të thotë se shpërbërja e Bashkimit Sovjetik dhe ajo që ndodhi më pas nuk prodhuan tragjedi: zhvillimet aktuale në Çeçeni dëshmojnë të kundërtën. Kosova ka përjetuar një përfshirje të pashembullt nga ana bashkësisë ndërkombëtare me qëllim të zgjidhjes së statusit të saj. Megjithatë, kjo bashkësi deri më sot ka insistuar në zbatimin e vazhdueshëm të parimit *uti possidetis juris*, i cili u tregua si shkatërrues sepse nënkuptonte që Kosova përfshihej nën sovranitetin e RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi).

1. Zhvillimi historik

Historikisht, parimi *uti possidetis juris* është zhvilluar në dy forma: *uti possidetis juris* dhe *uti possidetis de facto*[319]. Parimi i parë është shfrytëzuar në kohët moderne, përderisa ai i fundit i takon së kaluarës, origjina e të cilit mund të gjurmohet deri në kohën e mesjetës. Në atë kohë, ndarja e territoreve bëhej në mënyrë të ngjashme me ndarjen e pronës private. Për shembull, Papa Aleksandri VI ishte i njohur për lëshimin e tapive të tij, të cilat e emëronin pronarin e një territori të caktuar[320].

E drejta romake, e cila e bëri të njohur parimin *uti possidetis* në të drejtën ndërkombëtare, e mendonte ndryshe atë. Dekretet pretoriane të Republikës së Romës, që definonin pronën private, bënë një dallim ndërmjet posedimit dhe pronësisë. Në rastet kur posedimi i një gjësendi ishte bërë në mirëbesim — pra, jo me përdorimin e forcës apo në mënyra të tjera mashtruese — gjyqtarët romakë zbatonin normën e famshme *uti possidetis, ita possidetis* ("pasi që posedoni, ju mund të posedoni"). Megjithatë, ky rregull nuk zbatohej në çështjet e pronësisë — për çështje të tilla vendosej në gjykatë[321].

---

[319] Steven Ratner, "Drawing a Better Line: *Uti Possidetis* and the Borders of New States", *American Journal of International Law* vol. 90, no. 4 (October 1996) fq. 594-595.

[320] Jesse S. Reves, "International Boundaries", *American Journal of International Law* vol. 38, no. 4 (October 1944) fq. 539-541; dhe Frederich von der Heydte, "Discovery, Symbolic Annexation and Virtual Effectiveness in International Law", *American Journal of International Law* vol. 29, no. 3 (July 1935) fq. 452.

[321] Për të Drejtën Romake, shih në W. Michael Reisman, "Protecting Indigenous Rights in International Adjudication", *American Journal of International Law* vol. 89, no. 2 (April

Evoluimi gradual i *uti possidetis* nga e drejta private në sferën ndërkombëtare, si dhe transformimi i tij në një normë me zbatim më të gjerë, ka vazhduar në dy drejtime. I pari reflekton implikimet praktike të zbatimit të *uti possidetis*, transformimi i tij nga një rregull që kishte të bëjë me pretendimet mbi pronën private, në një normë që i përket sovranitetit shtetëror apo territorial. Tjetri ka të bëjë me transformimin e "posedimit", si një gjendje e përkohshme dhe faktike në të drejtën private, në një status të përhershëm ligjor të të drejtave sovrane mbi territorin e një shteti. Një transformim i tillë nuk duhet të befasojë, duke pasur parasysh se *uti possidetis* u shfaq në një kohë kur shfrytëzimi i forcës së pakufizuar nga shtetet në konfliktet për territore nuk konsiderohej joligjor apo jolegjitim[322] — një pikëpamje që zgjati deri në kohën e Luftës së Dytë Botërore.

Uti possidetis juris, siç njihet edhe sot, bazohet në dy ide: në vetëvendosjen dhe në mospërzierjen në punët e brendshme të shteteve të tjera. Që të dyja rrjedhin nga Amerika Latine, në fillim të shekullit XIX. Zbatimi i parë zyrtar i *uti possidetis* në Amerikën Latine reflekton natyrën e çështjeve evropiane në njërën anë, si dhe marrëdhëniet ndërmjet Evropës dhe Amerikës Latine pas luftërave të Napoleonit mes viteve 1796-1815 në anën tjetër. Evropa ka ndërhyrë vazhdimisht në Amerikën Latine në kërkim të *terra nullius* (tokë e askujt), që më vonë u bë pronësi e saj koloniale[323]. Pas pavarësisë së Amerikës Latine, që u arrit mes viteve 1810 dhe 1824, evropianët tentuan që të trans-

---

1995) fq. 352, fusnotat 8 dhe 9. Në këtë studim, autori jep një pasqyrë të teorisë së themeluar nga Monroe, e cila konfirmon se *uti possidetis* është bartur nga ana e juristëve mesjetarë në marrëdhëniet mes shteteve nga lëmia e së drejtës private e së drejtës romake.

[322] Frantz Despagnet, *Cours de Droit International* (Librarie de la Société du Recuiel Sirey: Paris, 1910) fq. 117-132, 575, 579-584; Thomas Joseph Lawrence, *Les principes de droit international* (Imprimerie de la Université: Oxford, 1920), 766; Thomas Baty, "Can an Anarchy be a State?", *American Journal of International Law* vol. 28, no. 3 (July 1934) fq. 444, 446, 454; Karl Strupp, "Les règles générales du droit de la paix", *Recueil de Cours de l'Academie de Droit International* vol. 47 Tome I (1934) fq. 473-474; dhe Hersch Lauterpacht (ed.), *Oppenheim's International Law* vol. II, 7th ed. (Longman: London, 1952) fq. 598-599.

[323] Teoria e proklamuar nga Emerich de Vattel ka klasifikuar tri epoka të *terra nullius*-it, të cilat i korrespondojnë analizës sonë të *uti possidetis*-it. Këto epoka mund të përmblidhen shkurt në: konceptin e së drejtës romake nga shekulli XVI, kur *terra nullius* kishte të bënte me të gjitha territoret joromake; pikëpamja e shekujve XVII dhe XVIII që konsideronin si *terra nullius* çdo tokë jokristiane; dhe, së fundi, pretendimet e shekullit XIX sipas të cilave territoret që nuk i takonin një "kombi të civilizuar" konsideroheshin si *terra nullius*. Cf. Joshua Castellino, "Territoriality and Identity in International Law: The Struggle for Self-Determination in the Western Sahara", *Millennium: Journal of International Studies* vol. 28, no. 2 (1999) fq. 547. Rasti i Amerikës Latine i përket kategorisë së parë të *terra nullius*, kurse kolonitë tjera bien në kategorinë e "territoreve që nuk iu takojnë shteteve të civilizuara".

ferojnë politikën e balancës së forcave nga Evropa në Amerikën Latine. Si rrjedhojë, dhe me qëllim për të shmangur ndërhyrjet e shpeshta evropiane, shtetet e Amerikës Latine (përveç Brazilit, deri së fundi) pranuan parimin *uti possidetis juris* për të udhëhequr me marrëdhëniet e tyre.

Vlen për të ritheksuar se caktimi i kufijve territorialë i sovraniteteve të reja është bazuar në *uti possidetis juris* dhe jo në *uti possidetis de facto*. Kjo nënkuptonte që kufijtë shtetërorë të shteteve të reja të pavarura përkonin me ishkufijtë kolonialë, duke mos lënë *terra nullius* (tokë të askujt) në atë pjesë të botës. Një dekadë më vonë, parimi i *uti possidetis* është fuqizuar me Doktrinën Monroe të vitit 1823, që kërkonte mosndërhyrjen në çështjet e brendshme të kontinentit amerikan[324]. Në të njëjtën kohë, përderisa pranimi i *uti possidetis juris* nga shtetet e Amerikës Latine kishte për qëllim të parandalonte konfliktet e mëtutjeshme rreth kufijve, ai nuk ndaloi as ndërhyrjen evropiane e as mosmarrëveshjet territoriale[325]. *Uti possidetis*, si dhe koncepti i mosndërhyrjes në çështjet e brendshme të shteteve sovrane, u shndërruan në parime të mirëvendosura dhe me zbatim të përgjithshëm vetëm pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, gjatë procesit të dekolonizimit.

Në periudhën ndërmjet viteve 1815 dhe 1945, rregullat mbi sovranitetin territorial në Evropë bazoheshin në kritere të tjera. Kongresi i Vjenës i vitit 1815 ka përcaktuar një filozofi dhe praktikë të ashtuquajtur "sferat e inter-

---

[324] Norman Rich, *Great Power Diplomacy: 1814-1914* (McGraw-Hill: New York, 1992) fq. 28-44; 167-184; dhe 347-364.

[325] Kontesti i fundit territorial, i zgjidhur më 1992, ka qenë mes Salvadorit dhe Hondurasit, me Nikaraguan si palë ndërhyrëse. Për një pasqyrë të historikut të kontesteve për kufij në Amerikën Latine që nga shekulli XIX, shih më shumë në Alejandro Álvarez, "Latin America and International Law", *American Journal of International Law* vol. 3, no. 2 (April 1909) fq. 269-353; James Brown Scott, "The Swiss Decision in the Boundary Dispute Between Colombia and Venezuela", *American Journal of International Law* vol. 16, no. 3 (July 1922) fq. 428-431; Chandler P. Anderson, "The Costa Rica-Panama Boundary Dispute", *American Journal of International Law* vol. 15, no. 2 (April 1921) fq. 236-240; Lester Hood Woolsey, "Boundary Disputes in Latin America", *American Journal of International Law* vol. 25, no. 2 (April 1931) fq. 324-333; F.C. Fisher, "The Arbitration of the Guatemalan-Honduras Boundary Dispute", *American Journal of International Law* vol. 27, no. 3 (July 1933) fq. 403-427; Lester Hood Woolsey, "The Ecuador-Peru Boundary Controversy", *American Journal of International Law* vol. 31, no. 1 (January 1937) fq. 97-100; Josef L. Kunz, "Guatemala vs. Great Britain: In Re Belice", *American Journal of International Law* vol. 40, no. 2 (April 1946) fq. 383-390; C.G. Fenwick, "The Honduras-Nicaragua Boundary Dispute", *American Journal of International Law* vol. 51, no. 4 (October 1957) fq. 761-765; Georg Maier, "The Boundary Dispute between Ecuador and Peru", *American Journal of International Law* vol. 63, no. 1 (January 1969) fq. 28-46; dhe Gideon Rottem, "Land, Island and Maritime Frontier Dispute", *American Journal of International Law* vol. 87, no. 4 (October 1993) fq. 618-626.

esit". Në Ballkan, për shembull, kjo nënkuptoi që asnjë konsideratë nuk iu dha përbërjes etnike të territoreve që do të ndaheshin, përveç gjeopolitikës. Asnjë konsideratë, përveç përdorimit të forcës brutale, nuk i është dhënë kufijve të mëhershëm administrativë të Perandorisë Osmane dhe të Perandorisë Austro-Hungareze. Pas Luftërave Ballkanike të viteve 1912-1913, politikat territoriale evropiane në rajonin e Ballkanit synonin të ruanin sigurinë dhe stabilitetin, pa marrë parasysh që kjo bëhej në kurriz të shteteve të prekura nga rivendosja territoriale[326].

Me të përfunduar Lufta e Dytë Botërore dhe pas procesit të dekolonizimit në Afrikë, liderët afrikanë po ashtu insistuan në ruajtjen e kufijve të mëhershëm administrativë të kolonive[327]. Megjithatë, rasti i Afrikës është thellë i rrënjosur në historinë që ka të bëjë me Konferencën Berlin-Kongo (1884-1885), e cila gabimisht është interpretuar si takim që e ndau Afrikën[328]. Në të vërtetë, Afrika është ndarë shumë më herët. Akti Final i Konferencës së Berlinit mbi Kongon, i nënshkruar më 26 shkurt 1885, thjesht ndaloi tregtinë me skllevër dhe mundësoi lëvizjen e lirë të mallrave dhe të njerëzve brenda territoreve nën sovranitetin e fuqive koloniale (Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë, Portugalisë dhe Belgjikës)[329]. Të drejtat sovrane të këtyre fuqive mbi territoret përkatëse nuk bazoheshin në kontrollin efektiv administrativ, siç ishte rasti në Evropë, por në përputhje me gjerësitë dhe gjatësitë gjeografike, duke filluar nga brigjet e Afrikës. Në fakt, neni 35 i Aktit të Final fliste për krijimin e një vije bazë të kontrollit vetëm përgjatë brigjeve të kontinentit[330].

Akti Final po ashtu thoshte se, çdo shtet që do të merrte në posedim një pjesë të tokës afrikane duhej të njoftonte fuqitë e tjera koloniale, me qëllim për të shmangur konfliktet eventuale për territore. Edhe atëherë, fuqive koloniale nuk u lejohej që të vendosnin ndonjë administratë efektive në këto to-

---

[326] Arthur W. Spencer, "The Balkan Question—Key to a Permanent Peace", *The American Political Science Review* vol. 8, no. 4 (November 1914) fq. 563, 569-570, 575, 577, 580-581; Jesse S. Reves, "International Boundaries", fq. 545; dhe Michael Roux, *Les albanais en Yougoslavie : minorité nationales, territoire et développent* (Fondation de la Maison des science de l'home: Paris, 1992) fq. 175-185, 187-191.

[327] Shih edhe Rupert Emmerson, *From Empire to Nation* (Harvard UP: Harvard, 1960) kapitujt VI dhe XVI.

[328] Më shumë për këtë, shih në Daniel de Leon, "The Conference at Berlin on the West-African Question", *Political Science Quarterly* vol. 1, no. 1 (March 1886) fq. 103-139.

[329] Norman Rich, *Great Power Diplomacy: 1814-1914*, fq. 237-242.

[330] The General Act of the Berlin-Congo Conference. Për komentet, shih në Arthur Berriedale Keith, *The Belgian Congo and the Berlin Act* (Clarendon Press: Oxford, 1919) fq. 314-315.

ka. E tëra që ato mund të bënin ishte që të vendosnin një kontroll minimal efektiv, të rregullonin çështjen e lëvizjes së lirë të mallrave dhe të njerëzve, dhe të kontrollonin tregtinë me skllevër. Çdo zgjerim i sundimit evropian në tokën afrikane konsiderohej si një punë e kushtueshme dhe e vështirë.

Ndarja e Afrikës sipas "sferave të interesit" të evropianëve kishte edhe një tjetër ndikim përballë popullatës vendase. Për të rregulluar marrëdhëniet me vendasit, kolonialistët vendosën protektorate të ndryshme, zona "tampon" dhe neutrale, si dhe pushtete feudale. Ata asnjëherë nuk tentuan që të vendosin ndonjë formë të sundimit modern politik në tokat që ata kontrollonin.

Me rënien e sundimit kolonial, pjesa më e madhe e kufijve abstraktë që shtriheshin përgjatë gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike që ndanin "sferat e ndikimit" kolonialist, u shndërruan në kufij ndërkombëtarë duke u mbështetur në parimin *uti possidetis juris*[331]. E përkundër faktit që 40 për qind e kufijve afrikanë janë vija të drejta që ndajnë dhjetëra grupe të ndryshme etnike[332], ato janë dëshmuar të jenë stabile dhe të qëndrueshme në të shumtën e rasteve[333]. Liderët afrikanë shpesh kanë theksuar se kufijtë e tyre janë artificialë dhe të imponuar arbitrarisht nga fuqitë e huaja. Megjithatë, që nga pavarësia, këta liderë janë pajtuar me faktin se kufijtë e sotëm janë zgjidhja e vetme e qëndrueshme për kontinentin. Një vit pas themelimit më 1964, Organizata e Unitetit Afrikan vuri theksin në faktin se kufijtë e Afrikës reflektojnë një "realitet të prekshëm", përderisa udhëheqësit e saj shprehën përkushtimin për të respektuar kufijtë që ekzistuan në kohën e pavarësimit (*uti possidetis juris*).

Ato shtete afrikane që shprehën pretendimet territoriale në baza të ndryshme nga *uti possidetis juris*, si p.sh. të drejtat etnike apo historike, kanë ndryshuar gradualisht qëndrimin e tyre. Rastet e Marokut dhe të Somalisë janë shembujt më të spikatur[334]. Sipas shembullit të njëjtë, grupet etnike që

---

[331] Friedrich Kratochwil, "Of Systems, Boundaries, and Territoriality: An Inquiry into the Formation of the State System", *World Politics* vol. 39, no. 1 (October 1986) fq. 36-41.

[332] "Ne, fuqitë koloniale, angazhohemi [...] për tërheqjen e vijave në harta aty ku kurrë këmba e njeriut të bardhë nuk ka shkelur; ne po i japim njëri-tjetrit malet, lumenjtë dhe liqenet. Ne kemi qenë të penguar vetëm nga një fakt; asnjëherë nuk kemi ditur se ku gjenden këto male, lumenjtë dhe liqene." Fjalimi i Lordit Salisbury, kryeministër britanik i fundit të shekullit XIX, i cituar në Joshua Castellino, "Territoriality and Identity in International Law: The Struggle for Self-Determination in the Western Sahara", fq. 529.

[333] Jeffrey Herbst, "The Creation and Maintenance of National Boundaries in Africa", *International Organization* vol. 43, no. 4 (Autumn 1989) fq. 674.

[334] Ravi L. Kapil, "On the Conflict Potential of Inherited Boundaries in Africa", *World Politics* vol. 18, no. 4 (January 1966) fq. 633-634; dhe Patricia Berko Wild, "The Organisation of

tentuan të ndahen nga shteti amë u ballafaquan me kundërshtim të ashpër nga bashkësia ndërkombëtare, si p.sh., në rastin e Katangës (Zaire/Kongo) dhe të Biafrës (Nigeri). Në anën tjetër, fuqitë koloniale që u përpoqën të pengojnë me dhunë pavarësimin e kolonive të tyre të dikurshme — siç është rasti me Algjerinë apo Guine-Bisaon — rrezikuan të qortohen për të ashtuquajturën "njohje e parakohshme e shteteve të reja dhe të lëvizjeve që luftojnë për çlirim kombëtar", një koncept i krijuar kryesisht për të ndihmuar procesin e pavarësimit të ish-kolonive[335].

Për një ish-koloni afrikane që kërkonte njohje ndërkombëtare, mjaftonte të kishte një qeveri që kontrollonte vetëm kryeqytetin e saj. Në esencë, njohja e parakohshme nga shtetet e tjera buronte nga e njëjta praktikë dhe filozofi e Konferencës Berlin-Kongo. Me fjalë të tjera, OUA dhe udhëheqësit e saj përqafuan të njëjtën filozofi dhe praktikë me atë të kolonizuesve të tyre: rregullat e OUA ishin hartuar me qëllim për të ruajtur kufijtë e jashtëm dhe marrëdhëniet ndërmjet shteteve të reja sovrane të Afrikës. Në aspektin e brendshëm, ishte e mjaftueshme që një vend të kishte kontroll minimal dhe simbolik administrativ, të përqendruar kryesisht rreth kryeqytetit të vet[336]. Një koloni afrikane konsiderohej e pavarur pasi që kishte dalë nga sundimi i huaj dhe që ishte e aftë të zhvillojë marrëdhëniet e saj të jashtme me autoritet të plotë, përkundër problemeve të brendshme[337].

Në një mënyrë, e drejta ndërkombëtare e viteve 1880, që mëtonte të zbusë dhe të rregullojë grindjet territoriale, shërbeu si model për të drejtën e viteve 1960 dhe 1970, pasi që lëvizjet antikoloniale fituan legjitimitetin ndërkombëtar. Rasti i vetëvendosjes së tyre bazohej më shumë në pretendimet territoriale sesa ato etnike, që edhe mundësoi transicionin më të lehtë nga kolonializmi në pavarësi. Me siguri që do të ishte shumë më vështirë, nëse jo e pamundur, për të definuar ato "entitete etnike" që do të gëzonin të drejtën e ve-

---

African Unity and the Algeria-Morocco Border Conflict: A Study of New Machinery for Peacekeeping and for the Peaceful Settlement of Disputes Among African States", *International Organization* vol. 20, no. 1 (Winter 1996) fq. 19-20; 27, 29-36.

[335] Heather Wilson, *International Law and the Use of Force by National Liberation Movements* (Clarendon Press: Oxford, 1988) fq. 119-120, fusnota 101.

[336] Jeffrey Herbst, "The Creation and Maintenance of National Boundaries in Africa", fq. 687-689.

[337] Ali A. Mazrui, "The United Nations and Some African Political Attitudes", *International Organization* vol. 18, no. 3 (Summer 1964) fq. 499. Ky autor në mënyrë eufemike ka cilësuar procesin e fitimit të pavarësisë në kontekstin afrikan si transicion "nga sundimi i jashtëm në marrëdhënie me jashtë".

tëvendosjes, si p.sh., të drejtën për pavarësi[338]. Koncepti afrikan i vetëvendosjes, sikurse ai në Amerikën Latine, është bazuar në territor e jo në etni. Si rrjedhojë, asnjëri nga dijetarët[339] apo vetë shtetet[340] nuk kanë pranuar pretendimet për vetëvendosje të shfaqura nga grupet e ndryshme vendase në këto rajone. Andaj, parimi *uti possidetis* "ka ofruar një aureolë të ligjshmërisë historike për konfiskimin e tokave të popujve vendas"[341].

Azia ndryshon në këtë aspekt, falë historisë tjetër të kolonizimit dhe të ruajtjes së traditave shtetërore. Në Azi, sistemi i kufijve të vendosur nga fuqitë koloniale (Britani e Madhe dhe Francë) sfidoi sistemin perëndimor në shumicën e rasteve, duke lënë strukturat e shtetit parakolonial të paprekura. Si rrjedhojë, pas pavarësimit këto vende trashëguan kufij shtetërorë të sovraniteteve ekzistuese dhe me traditë të gjatë shtetërore. Prandaj, zbatimi i vetëvendosjes vazhdoi përmes rivendosjes së plotë të formave parakoloniale të organizimit shtetëror. Kjo ishte e dukshme veçanërisht në pjesën e Azisë juglindore[342].

2. Arsyeja prapa *uti possidetis juris*

Studiuesit kanë bërë përpjekje të mëdha për të definuar shkaqet e vërteta të shfaqjes dhe të pranimit të parimit *uti possidetis juris*. Këto shkaqe mund

---

[338] Rupert Emerson, "Pan-Africanism", *International Organization* vol. 16, no. 2 (Spring 1962) fq. 276-283.

[339] "Jo vetëm që nuk ekzistojnë territore *nullius* në kontinentin amerikan, por, si pasojë e kësaj, asnjë vlerë nuk iu njihet posedimeve të disa territoreve nga ana e fiseve aborigjine që nga kohërat e lashta, fise që nuk njohin sovranitetin e vendit nën sovranitetin e të cilit jetojnë. Dy pasoja me rëndësi burojnë nga ky konstatim. Në rend të parë, okupimi i atyre viseve nga fiset aborigjene është punë e së drejtës publike të brendshme të secilit vend, e jo vetëm çështje e të drejtës ndërkombëtare. Së dyti, qeveritë kanë, në disa raste, një përgjegjësi ndërkombëtare për veprimet e fiseve aborigjine të cilat jetojnë brenda sovranitetit të tyre territorial, pa marr parasysh që ato fise nuk e njohin sovranitetin e shtetit." Cf. Alejandro Álvarez, "Latin America and International Law", fq. 342-343, fusnota 95.

[340] Në vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, kufijtë ndjekin vijën *uti possidetis juris*, përkatësisht ndarjet administrative koloniale ose besnikëritë (lojalitetet) që i përkasin epokës parakoloniale. Kjo qasje është vërtetuar në rastet e Saharës Perëndimore (1975), *Salvador v. Honduras* (Nikaragua si ndërhyrës gjyqësor) (1992) dhe së fundi, në kontestin territorial mes Libisë dhe Çadit (1994). Për më shumë, shih në W. Michael Reisman, "Protecting Indigenous Rights in International Adjudication", fq. 354-357.

[341] Malcolm Shaw, "The Heritage of States: The Principle of *Uti Possidetis* Today", *British Yearbook of International Law* vol. 67 (1996) fq. 98.

[342] Cf. Robert L. Solomon, "Boundary Concepts and Practices in Southeast Asia", *World Politics* vol. 23, no. 1 (October 1970) fq. 1-23.

të grupohen në dy kategori: të jashtme dhe të brendshme. Për shembull, gjatë diskutimit rreth arsyes pse vendet e Amerikës Latine kanë refuzuar idenë e konfederatës së bazuar në kufijtë e dikurshëm administrativë kolonialë (*uti possidetis juris*), Alejandro Álvarez veçon mungesën e plotë të komunikimit ndërmjet këtyre vendeve; shpirtin e pavarësisë; konfliktet rreth kufijve; luftërat civile, si pasojë e ambicieve personale të liderëve revolucionarë; mungesën e përvojës politike; dhe në fund, mungesën e traditave të përbashkëta[343].

Duke nënvizuar disa nga shkaqet e jashtme që do të shpjegonin pranimin e *uti possidetis juris*, Álvarez flet për idenë e konfederatës në kontekstin e rezistencës ndaj ndërhyrjeve evropiane. Parimi *uti possidetis* shërbeu jo vetëm për të parandaluar konfliktet rreth kufijve, por po ashtu për të eliminuar vetë pretekstin e ndërhyrjeve të evropianëve në kërkim të *tokave të askujt*. Në fakt, autoritetet spanjolle imponuan politikat e tyre të përvijimit të kufijve në rajon duke mos e marrë fare parasysh topografinë lokale[344]. Megjithatë, një tjetër autor, dështimin e vendeve të Amerikës Latine për të formuar një lloj konfederate ua atribuon personaliteteve të liderëve vendas, të cilët fituan pushtetin pas pavarësisë. Këta liderë, thotë Steven Ratner, zbatuan rregullën *uti possidetis* për hir të interesave të tyre dhe për përfitime individuale[345].

Kufijtë afrikanë u vendosën po ashtu duke injoruar çdo njohuri të mëhershme përkitazi me topografinë e terrenit apo dëshirat e popullatës vendase. Siç u tha më sipër, kufijtë afrikanë u përcaktuan në bazën e gjatësisë dhe gjerësisë gjeografikë përkatëse. Kjo trashëgimi ndihmon që të shpjegohet arsyeja se pse dekolonizimi afrikan prodhoi shtete dhe sisteme politike të dobëta, por që po ashtu ndaloi pretendimet separatiste të grupeve të ndryshme etnike. Këto janë shkaqet themelore të jashtme për pranimin e *uti possidetis juris* në Afrikë[346].

Për të shpjeguar origjinën e *uti possidetis juris*, analistët gjithashtu tërheqin vërejtjen në personalitetet e liderëve afrikanë dhe në zhvillimet e brendshme në ish-kolonitë[347]. Megjithatë, ky sqarim është i dobët. Përderisa karakteristikat personale të elitave afrikane me siguri që kanë luajtur rolin e tyre,

---

[343] Alejandro Álvarez, "Latin America and International Law", fq. 288.
[344] Ibid. fq. 290-291; 320-321; 342-343.
[345] Steven Ratner, "Drawing a Better Line: *Uti Possidetis* and the Borders of New States", fq. 592.
[346] Ravi L. Kapil, "On the Conflict Potential of Inherited Boundaries in Africa", fq. 656-673; dhe Jeffrey Herbst, "The Creation and Maintenance of National Boundaries in Africa", fq. 690-691.
[347] Jeffrey Herbst, "The Creation and Maintenance of National Boundaries in Africa", fq. 676-678.

përbërja sociale e shoqërive afrikane, strukturat e dobëta shtetërore dhe shumëllojshmëria etnike, si dhe rregullat ndërkombëtare mbi shtetësinë legjitime dhe sovranitetin e barabartë të popujve kolonialë dhe të territoreve të tyre, shpjegojnë më mirë pranimin e *uti possidetis juris*. Çdo zgjidhje tjetër do të ishte e dëmshme për stabilitetin rajonal dhe atë ndërkombëtar, dhe do të mund të çonte në luftëra vëllavrasëse.

Këto arsye shpjegojnë vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) përkitazi me mosmarrëveshjen kufitare ndërmjet Burkina-Fasos dhe Republikës së Malit (1986)[348]. Në këtë rast, GjND theksoi se *uti possidetis juris* shërben për të "ngrirë" të drejtën e pronësisë mbi një territor në kohën e pavarësisë, duke prodhuar në realitet një "fotografi të territorit"[349]. GjND e definoi *uti possidetis juris* si një parim i cili transformon kufijtë e mëhershëm administrativë, të krijuar gjatë kohës së kolonizimit, në kufij ndërkombëtarë. Si i tillë, ky parim është logjikisht i ndërlidhur me procesin e dekolonizimit kudo që ndodh[350], duke e mbrojtur pavarësinë dhe duke e ruajtur stabilitetin

---

[348] *Burkina Faso v. Republic of Mali*, ICJ Reports (1986) fq. 565: "Më 14 tetor 1983, Burkina-Faso (atëherë e njohur si Volta e Sipërme) dhe Mali njoftuan Gjykatën për lidhjen në mes tyre të një marrëveshje speciale me të cilën dërgonin në Dhomën e Gjykatës çështjen e delimitimit të një pjese të territorit tokësor mes këtyre dy shteteve [...]. Pas incidenteve të rënda mes forcave të armatosura të dy vendeve në fund të vitit 1985, dy palët ia parashtruan Dhomës në mënyrë paralele kërkesat për vënien e masave të përkohshme të mbrojtjes [...]. Në Aktgjykimin e datës 22 dhjetor 1986, Dhoma e Gjykatës filloi përcaktimin e burimit të të drejtave të pretenduara nga ana e palëve. Dhoma vërejti se, në atë rast, parimi i cili duhej zbatuar ishte parimi i paprekshmërisë së kufijve të trashëguar nga koha koloniale dhe *parimi uti possidetis juris*, i cili i njeh peshën dhe rëndësinë më të madhe titullit juridik kundrejt posedimit efektiv si bazë për përcaktimin e sovranitetit, qëllimi kryesor i të cilit është sigurimi i respektit për kufijtë territorialë të cilët kanë ekzistuar në kohën (momentin) e fitimit të pavarësisë. Dhoma specifikoi që, në rastet kur kufijtë e tillë nuk janë më shumë se delimitim mes ndarjeve të ndryshme administrative apo kolonive të cilat i takojnë të njëjtit sovranitet, atëherë zbatimi i parimit *uti possidetis juris* rezulton (ka për pasojë) transformimin e tyre në kufij ndërkombëtare, siç ka ndodhur në rastin konkret. Në të njëjtën mënyrë, Dhoma theksoi se do të ketë parasysh parimin *equity infra legem*, përkatësisht atë formë të *equity*, e cila paraqet metodën e interpretimit të ligjit e cila metodë edhe vetë bazohet në ligj. Palët po ashtu kanë mbështetur pohimet e tyre në lloje të ndryshme të provave për t'i mbështetur argumentet e parashtruara, përfshirë këtu tekstet e ndryshme franceze të natyrës legjislative, dokumentet administrative/rregullative, hartat dhe *colonial effectivités*, përkatësisht sjelljet e autoriteteve administrative si dëshmi e ushtrimit efektiv të juridiksionit territorial mbi regjionin kontestues gjatë kohës koloniale. Pas shqyrtimit të llojeve të ndryshme të provave, Dhoma definoi ecjen e vijës së kufirit (kursin) në pjesën e regjionit kontestues mes palëve [...]."

[349] *ICJ Reports* (1986) fq. 568.

[350] Ibid. fq. 566.

e shteteve të reja afrikane[351]. Natyrisht, kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur asnjë devijim nga zbatimi rigoroz i parimit *uti possidetis juris* gjatë procesit të dekolonizimit në Afrikë[352]. Sidoqoftë, në të shumtën e rasteve, kufijtë e mëparshëm administrativë kolonialë janë pranuar si kufij ndërkombëtarë.

3. Ish-federatat komuniste dhe Kosova

Jashtë kontekstit kolonial, zbatimi i *uti possidetis juris* ka ndodhur vetëm një herë: kur ish-federatat komuniste të Bashkimit Sovjetik, të Çekosllovakisë dhe të Jugosllavisë, u shpërbënë me të përfunduar Lufta e Ftohtë. Përderisa Çekosllovakia u nda paqësisht dhe Bashkimi Sovjetik ishte i aftë që të shmangë përleshjet e brendshme dhe të dhunshme në pjesën më të madhe, rasti i Jugosllavisë e shpërfaqi absurditetin e zbatimit mekanik të parimit *uti possidetis juris.* Përgjigja ligjore ndërkombëtare ndaj shpërbërjes së Jugosllavisë ishte pashmangshmërisht e ndërlidhur me avokatin francez Robert Badinter, i cili udhëhoqi me Komisionin e Badinterit — një grup juristësh i themeluar nga Bashkimi Evropian më 1991, me qëllim për të ndërmjetësuar mosmarrëveshjet dhe për të vendosur kriteret për njohje[353]. Komisioni e mbështeti vendimin e tij përkitazi me Jugosllavinë në hipotezat themelore të politikës dhe të drejtës ndërkombëtare. Kjo i karakterizoi shtetet sovrane si entitete, të cilat, ndërmjet të tjerash, i përmbushin kriteret themelore për shtetësi ndërkombëtare, si p.sh., me pasë territorin dhe popullatën e vet, si dhe një qeveri e cila ka nën kontroll territorin e saj dhe popullatën. Në vendimin

---

[351] Ibid. fq. 566.

[352] Kështu, Togoja Britanike u bashkua me Ganën. Njëjtë ndodhi me Kamerunin Britanik, i cili u bashkua me Nigerinë. Somalia Britanike dhe Somalia Italiane u shkrinë në një shtet, kurse Ruandë-Urundi belg u nda në dy shtete.

[353] Më shumë për këtë shih në Alain Pellet, "The Opinions of the Badinter Committee: A Second Breath for Self-Determination of Peoples", *European Journal of International Law* vol. 3, no. 1 (1992) fq. 178-181; Alain Pellet, "Note sur la Conference Europeenne pour la Paix en Yougoslavie", *Annuaire Francais de Droit International* XXXVIII (1992) fq. 223-238; Vladimir-Djuro Degan, "Samoopredeljenje naroda i territorijalna celovitost država u uvjetima raspada Jugoslavije", *Naša Zakonitost* vol. 46, no. 4 (Zagreb, April 1992) fq. 543-569; Antonio Cassese, "Self-Determination of Peoples and the Recent Break-Up of USSR and Yugoslavia", botuar në Ronald St. John MacDonald (ed.), *Essays in Honor of Wang Tieya* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1994) fq. 131-144; Vladimir-Djuro Degan, "L'Arbitrage Juridique Ignore: La Jurisprudence de la Commission Badinter", botuar në Marie Francois Allain et al. (eds.), *L'Ex Yougoslavie en Europe : de la faillite des démocraties au processus de paix* (L'Harmattan: Paris, 1997) fq. 31-43; dhe Thomas D. Grant, *The Recognition of States: Law and Practice in Debate and Evolution* (Praeger: Westport, Conn., 1999) fq. 149-213.

e vet, Komisioni kryesisht u mbështet në pjesën më të madhe në përvojën afrikane, si dhe veçanërisht në vendimin e GjND-së në rastin e Burkina-Fasos kundër Republikës së Malit, duke zgjeruar në realitet precedentin afrikan dhe standardet të cilat i kishte vënë në një ambient dukshëm më të ndryshëm politik dhe shoqëror.

Në opinionin e dhënë, Komisioni i Badinterit deklaroi se, "çfarëdo qofshin rrethanat, përveç në rastet kur shtetet përkatëse pajtohen ndryshe, e drejta për vetëvendosje nuk duhet të përfshijë edhe ndryshimin e kufijve ekzistues në kohën e pavarësimit (*uti possidetis juris*)". Në pajtim me këtë, Komisioni në vazhdim theksoi se, "përveç kur arrihet marrëveshja përndryshe, kufijtë e dikurshëm republikanë [kufijtë e brendshëm ndërmjet Serbisë dhe Kroacisë, si dhe mes Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës] bëhen kufij ndërkombëtarë të mbrojtur nga e drejta ndërkombëtare"[354]. Ky qëndrim reflektoi nocionin e respektimit të gjendjes ekzistuese territoriale ("fotografinë territoriale" në rastin e Burkina-Fasos kundër Republikës së Malit) dhe vetë parimin *uti possidetis*, i cili — sipas Komisionit — duhej të parandalonte konfliktet territoriale që po shfaqeshin ndërmjet shteteve të reja të pavarura që dolën nga ish-Jugosllavia[355].

Gjatë hartimit të qëndrimeve, Komisioni pretendoi se konfliktet për territore mund të parandalohen vetëm nëpërmjet njohjes së ish-kufijve administrativë si kufij ndërkombëtarë, të cilët pastaj do të mbroheshin nga neni 2(4) i Kartës së Kombeve të Bashkuara[356]. Ky pretendim reflektoi qëllimet politike të liderëve evropianë, të cilët, pas shpalljes së pavarësisë nga Sllovenia dhe Kroacia në qershor 1991, insistonin që vetëm republikat federative të Jugosllavisë të gëzonin të drejtën e vetëvendosjes. Për ngjashmëri, i njëjti qëndrim u aplikua edhe në rastin e Bashkimit Sovjetik dhe të Çekosllovakisë, e që u aprovua me deklaratën e miratuar nga Komuniteti Evropian (tani Bashkimi Evropian) më 16 dhjetor 1991, duke vendosur një seri të udhërrëfyesve që përcaktonin kushtet që duhej përmbushur para se shtetet e reja të pranoheshin si të pavarura. Ish-republikat sovjetike e pranuan këtë zyrtarisht në

---

[354] Komisioni Badinter, Mendimi nr. 2 (11 janar 1992).

[355] Steven Ratner, "Drawing a Better Line: *Uti Possidetis* and the Borders of New States", fq. 614, fusnota 192.

[356] Karta e OKB-së, neni 2(4): "Të gjitha vendet anëtare në marrëdhëniet e tyre ndërkombetare do të përmbahen nga përdorimi i forcës ose kërcënimi me forcë kundër integritetit territorial dhe pavarësisë politike të cilitdo shtet, apo nga ndonjë mënyrë tjetër e cila është e papajtueshme me qëllimet e Kombeve të Bashkuara".

vitin 1993, duke deklaruar se *uti possidetis juris* do të jetë një zgjidhje e pranueshme për mosmarrëveshjet territoriale ndërmjet tyre[357].

Me insistimin në zbatimin e *uti possidetis juris* në rastin e ish-Jugosllavisë, vendimmarrësit evropianë kushtëzuan standardet e vendosura në rastin e Afrikës duke shtuar kritere të tjera korrigjuese. Lista e parakushteve për njohje ndërkombëtare tani ishte zgjatur për të përfshirë kërkesat për sundim të ligjit, demokraci, si dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Në të njëjtën kohë, asnjë mekanizëm real për zbatimin e këtyre direktivave nuk ekzistonte në praktikë — sanksionet ekonomike u dëshmuan të padobishme, përderisa intervenimi ushtarak në atë kohë konsiderohej i pamundur. Vetëm atëherë kur u bë e qartë se serbët e Kroacisë dhe të Bosnjë-Hercegovinës mbështetën interpretimin "e gabuar" të vetëvendosjes, bashkësia ndërkombëtare intervenoi ushtarakisht për të mbrojtur sovranitetin territorial të Bosnjë-Hercegovinës. Në të njëjtën kohë, Kroacia u lejua që të shkatërrojë Republikën e Krajinës Serbe (Republika Srpska Krajina), një entitet serb që u themelua në kuadër të kufijve sovranë të Kroacisë, pas ndarjes së saj nga federata. Intervenimi i fuqive perëndimore në Bosnjë-Hercegovinë erdhi vonë po ashtu, pas një akti të kryer dhe gjenocidit kundër myslimanëve boshnjakë.

Pranimi i parimit të *uti possidetis juris* nga bashkësia ndërkombëtare në rastin e Jugosllavisë, reflektoi "bilancin e fuqive" të politikës dhe dëshirën për të balancuar forcat përbrenda republikave shumëkombëshe që ekzistonin në kohën e pavarësisë. Me fjalë të tjera, entitetet që nuk i kishin veçoritë e republikës federative u desh të luftonin shumë për të prezantuar veten si kandidatë të vlefshëm për pavarësi të plotë. Duke pasur parasysh këtë, vendimmarrësit kishin refuzuar pretendimet për sovranitet të shfaqura nga entitetet serbe në Kroaci (Republika Serbe e Krajinës) dhe në Bosnjë-Hercegovinë (Republika Serbe). E kur përsëri erdhi koha për të zbatuar me forcë dhe për të imponuar respektin për kriteret korrigjuese të *uti possidetis juris* (demo-

[357] Neni 3 i Kartës së Komonuelthit të Shteteve të Pavarura (22 qershor 1993) afirmon "pacenueshmërinë e kufijve shtetërorë, njohjen e kufijve ekzistues dhe refuzimin e fitimeve territoriale të kryera në mënyrë të jashtëligjshme". Marrëveshja e Alma-Atas mbi krijimin e Komonuelthit të Shteteve të Pavarura (dhjetor 1991) përmban dispozita të ngjashme. Më shumë për këtë, cf. Sergei A. Voitovich, "The Commonwealth of Independent States: An Emerging Institutional Model", *European Journal of International Law* vol. 4, no. 3 (1993) fq. 418-430. Për tekstin e plotë të Kartës, cf. Sergei A. Voitovich, "Annex: Decision of the Council of Heads of State of the Commonwealth of Independent States", po aty.

kracia, sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve), Kosova u shtua në listën e entiteteve "ilegale".

Bashkësia ndërkombëtare shfrytëzoi standardin *uti possidetis juris* për të refuzuar pretendimet e Kosovës për pavarësi. Duke pasur parasysh këtë, gjatë bisedimeve paqësore për Kosovën në Rambuje, në shkurt të vitit 1999, duke vepruar në cilësinë e këshilltarit ligjor të delegacionit të shqiptarëve të Kosovës, autori ua kishte tërhequr vërejtjen udhëheqësve të delegacionit përkitazi me dispozitat e Marrëveshjes së Rambujesë të cilat e vënin Kosovën brenda juridiksionit të Serbisë. Fatkeqësisht, negociatorët i kushtuan më shumë vëmendje dispozitave të Marrëveshjes që kishin të bëjnë me zgjedhjen e gjyqtarëve, formimin e parlamentit, zgjedhjen e presidentit të ardhshëm etj.[358]

Marrëveshja për Paqe e Rambujesë u fuqizua me Marrëveshjen mbi Parimet e Marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi në kuadër të Unionit të Shteteve, ose Marrëveshja për Unionin Serbi-Mali Zi (USM), e nënshkruar në Beograd më 14 mars 2002, nën mbikëqyrjen e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, z. Javier Solana. Marrëveshja USM, në paragrafin 3, dispozita për rishqyrtim, ndër të tjera thotë se:

> pas kalimit të periudhës trevjeçare, shtetet anëtare do të gëzojnë të drejtën e inicimit të procedurave për ndryshimin e statusit të shtetit, përkatësisht tërheqjen nga bashkimi i shteteve. Nëse Mali i Zi tërhiqet nga bashkimi i shteteve, dokumentet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Republikën Federative të Jugosllavisë, e në veçanti Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, do të ndërlidhen me dhe do të zbatohen mbi Serbinë, si trashëgimtare e saj.

Përfshirja e kësaj dispozite në Marrëveshjen USM, e cila mungonte në draftin final të Marrëveshjes së Rambujesë, si rezultat i kundërshtimit të ashpër të shqiptarëve të Kosovës, do të thotë se nëse dhe pasi që Mali i Zi të ndahet nga Unioni SM, Serbia edhe një herë do të gëzojë të drejtën e sovranitetit formal dhe të plotë mbi Kosovën.

---

[358] Pas lirimit të Kosovës nga regjimi serb i Beogradit, administrata e re ndërkombëtare e instaluar në Kosovë nisi me krijimin e strukturave vendore të vetëqeverisjes. Gjatë këtij procesi, politikanët lokalë më shumë u fokusuan në çështje sekondare se në ato kruciale për të ardhmen e vendit. Kështu, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e udhëhequr nga dr. Ibrahim Rugova, insistonte që Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen në Kosovë, e shpallur më 21 maj 2001 nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Hans Hækkerup, të themelonte institucionin e Presidentit të Kosovës. Këto dispozita paraprakisht ishin fshirë nga Marrëveshja e Rambujesë. Cf. kapitullin 9, seksionin 2 të Kornizës Kushtetuese.

Në vend të përfundimit: a do të ndryshojnë kalkulimet e palëve?

Kosova nuk është më ndryshe nga pjesët e tjera të botës dhe me siguri që nuk ndryshon as nga shtetet afrikane të cilat kërkuan pavarësinë nga sunduesit e tyre kolonialë. Në të vërtetë, bashkësia ndërkombëtare ka insistuar dhe është bazuar po në këtë ngjashmëri ligjore kur intervenoi ushtarakisht në Jugosllavi, por që pastaj e kufizoi pretendimin e Kosovës për vetëvendosje. Vendimmarrësit evropianë arsyetuan qëndrimin e tyre nga aspekti i *uti possidetis juris*, sipas të cilit, territori i shteteve të reja sovrane përcaktohet duke u bazuar në kufijtë e vjetër kolonialë. Pasi që Kosova nuk ishte republikë federative në kuadër të Jugosllavisë, por më shumë një entitet në kuadër të Serbisë, nuk gëzonte të drejtën për të pretenduar sovranitetin.

Ajo çfarë politikanët evropianë dështuan të identifikojnë në rastin e Kosovës ishte fakti se *uti possidetis juris* kishte evoluar përgjatë historisë dhe tani ai përfshin kritere të tjera shtesë si, sundimi i ligjit, demokracia, respektimi i të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve. Natyrisht, në realitet nuk ka ndonjë mekanizëm për zbatim që do të siguronte qëndrueshmërinë e këtyre parimeve dhe si rrjedhojë popujt e botës qëndruan anash gjatë fazës fillestare të gjenocidit të kryer nga forcat serbe në Kosovë.

Një paradoks i ri u shfaq pas intervenimit të NATO-s: në statusin e saj final, Kosova u barazua me ato entitete të cilat provokuan konfliktin.

Parimi *uti possidetis juris* shërbeu si bazë për Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e cila përcakton Marrëveshjen për Paqe të Rambujesë si platformë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës[359]. Padyshim, ajo çfarë frymëzoi kalkulimet e fuqive evropiane në hartimin e këtyre dokumenteve ishte më shumë rrjedhojë e interesave të tyre politike sesa interesi i vërtetë i popullit të Kosovës. Sa gjatë do të jenë të aftë që të ruajnë stabilitetin në Kosovë do të varet nëse kalkulimet e tyre të momentit do të mbesin të justifikueshme.

---

[359] Në preambulën e Rezolutës 1244 të KS të OKB-së, e cila paraqet kuadrin ligjor për operimin e administratës aktuale ndërkombëtare në Kosovë dhe që vepron krahas administratës vendore të themeluar rishtazi, thotë ndër të tjera se KS "afirmon zotimin e të gjitha vendeve anëtare për respektim të sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe shteteve të tjera në rajon". Rezoluta në paragrafin 11 i referohet Marrëveshjes së Rambujesë si bazë për vetëqeverisjen në Kosovë dhe si një mjet për lehtësimin e procesit politik që ka për qëllim zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Cf. Rezoluta 1244 e KS të OKB-së. S/RES/1244 (1999).

Në përfundim të këtij punimi do të shfrytëzoja një mendim të shprehur nga Jeffrey Herbst përkitazi me Afrikën, i cili reflekton qartazi thelbin e çështjes *uti possidetis* në rastin e Jugosllavisë:

Kufijtë në Afrikë shpeshherë karakterizohen si artificialë dhe arbitrarë, duke u bazuar në faktin se ata nuk përputhen me atë se çfarë popujt mendojnë se janë kufij të arsyeshëm demografikë, etnografikë dhe topografikë. Megjithatë, kufijtë janë gjithmonë artificialë për shkak se shtetet nuk janë krijesa natyrale. Prandaj, është me rëndësi që kufijtë të gjykohen si "krijesa politike", bazuar në dobinë e atyre që i krijuan ato. Duke u mbështetur në këtë kriter, kufijtë aktualë të Afrikës nuk janë arbitrarë. Sistemi i kufijve i zhvilluar në vitin 1885 paraqiste një reagim të arsyeshëm nga kolonialistët, për shkak se u shërbeu kërkesave të tyre politike. Pjesa dërrmuese e kufijve kanë mbetur praktikisht të paprekur që nga ajo kohë sepse ky sistem në pjesën më të madhe vazhdon t'i shërbejë kërkesave politike të kolonialistëve dhe të liderëve aktualë afrikanë. Mundësia është që në të ardhmen, elitat afrikane të konsiderojnë ruajtjen e kufijve ekzistues si më të kushtueshme se alternativat e tjera, ndonëse së pari një pjesë e madhe e kalkulimeve politike duhet të ndryshojë. Deri atëherë, kufijtë "racionalë" të Afrikës do të ruhen ashtu siç janë.[360]

A do të ndryshojnë kalkulimet politike përkitazi me territoret e ish-Jugosllavisë në të ardhmen e afërt? Është e vështirë të parashikohet. Për momentin duket e vështirë, duke gjykuar përsëri sipas përvojës afrikane. Dallimi i vetëm mund të jetë se në Ballkan problemet e kufijve janë shfaqur shumë më vonë dhe po zgjasin qe shumë kohë.

[360] Jeffrey Herbst, "The Creation and Maintenance of National Boundaries in Africa", fq. 692.

II. Caktimi i kufijve të Kosovës është kryesisht çështje e së drejtës ndërkombëtare

Hyrje

Ky punim, i paraqitur në seminarin e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, më 25 prill 2016, organizuar nergut për çështjen e kufijve në të drejtën ndërkombëtare, përbëhet nga tri pjesë dhe qëllim parësor ka që publikut kosovar t'i ofrojë një qasje tjetër akademike, qasje që bazohet në të drejtën ndërkombëtare. Në fakt, vetë çështja e kufijve është një çështje tërësisht e ligjit ndërkombëtar, kurse aspektet gjeografike, relievore, gjeometrike e gjeofizike përbëjnë vetëm anën teknike të caktimit të kufijve sipas së drejtës ndërkombëtare.

Pjesa e parë trajton konceptet kyçe në procesin e caktimit të kufijve në të drejtën ndërkombëtare. Këtu mëtojmë të sqarojmë se asnjë kufi nuk mund të caktohet pa pasur një delimitim paraprak, pra se demarkacioni asnjëherë nuk mund të jetë pika nisëse në procesin e caktimit të kufijve sipas së drejtës ndërkombëtare. Shkurt, do të sqarojmë se çka nënkuptohet me delimitim dhe do ta kontekstualizojmë këtë koncept në kontekstin e problemit të lindur me Malin e Zi. Në të dytën pjesë, natyrshëm vazhdohet me diskutimin mbi parimin *uti possidetis juris* nga aspekti komparativ dhe në kontekstin me Malin e Zi, duke e ndarë parimin/rregullën e efektivitetit në të gjitha trajtat e manifestimit si një problematikë mosnjohja e së cilës nga pala kosovare ka paraqitur pengesë serioze për të kuptuar se ku është gabuar gjatë bisedave të viteve 2012-2015 për arritjen e *Marrëveshjes për Demarkacion me Malin e Zi*, e cila u nënshkrua më 25 gusht 2015 në Vjenë (më tej shkurt: Marrëveshja e 25 gushtit 2015). Pjesa e tretë dhe e fundit flet për keqinterpretimin që *Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror*, prirë nga profesori Murat Meha (më tej shkurt: Komisioni Meha) i ka bërë Planit Ahtisaari, këtij dokumenti vërtet me rëndësi kolosale për historinë bashkëkohore të Kosovës. Mbi bazën e këtij interpretimi tejet të keq, abstrakt dhe pa asnjë pikë referimi, ka ardhur deri te përdorimi në mënyrë të verbër i kadastrave të vjetra të Kosovës, duke ua njohur atyre vlerën e kriterit absolut, të vetëm dhe përjashtues me rastin e demarkimit me Malin e Zi. Me këtë akt, Komisioni

Meha ka injoruar rolin dhe fuqinë provuese dhe interpretuese të hartave topografike ekzistuese, sikundër dhe rolin dhe fuqinë e kritereve të tjera standarde të së drejtës ndërkombëtare lidhur me caktimin e kufijve shtetërorë terrestrialë.

Në diskursin kosovar deri më sot, i zhvilluar rreth demarkacionit me Malin e Zi, bazuar në Marrëveshjen e 25 gushtit 2015 ka dominuar vetëm aspekti gjeografik, hartografik, gjeometrik, gjeofizik etj. i problemit të kufirit me Malin e Zi. Kjo ka qenë kështu, jo pa të drejtë, nisur nga fakti se Kosova, tërësisht në mënyrë të gabuar, e ka marrë si të mirëqenë ekzistimin e një delimitacioni mes dy vendeve, duke u bazuar në gjendjen e fundit kadastrale të Kosovës pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008. Kjo qasje e kosovarëve ka qenë gabim, sepse gjendja kadastrale për herë të parë në territorin e ish-Jugosllavisë po shërben si një pikë e vetme referimi për delimitim të kufirit, ekskluzive dhe përjashtuese ndaj kritereve të tjera të së drejtës ndërkombëtare klasike. Delimitimi përbën një akt sovran relativ në të drejtën ndërkombëtare publike. Ky relativitet ka të bëjë me faktin se janë shtetet ato që vetë duhet të ulen në mënyrë sovrane dhe të caktojnë parimet kyçe të vijave të përgjithshme ndarëse kufitare mes sovraniteteve shtetërore, e më pastaj të niset me demarkacionin. Jo vetëm kaq!

Edhe në ndarjet (delimitimet) e brendshme administrativo-territoriale ka ekzistuar një parim mbi bazën e të cilit ka ndodhur një gjë e tillë, pra përkufizimi i brendshëm. Në vendet ish-komuniste, ky parim është bazuar në krijimin e entiteteve administrativo-territoriale të cilat synojnë shprishjen e kompaktësisë etnike të territoreve të popujve të padëshiruar. Në ish-BRSS[361], ku ka buruar kjo praktikë sipas porosisë së Stalinit, ta zëmë, të padëshiruar janë cilësuar popujt jorusë, në veçanti popujt myslimanë në Transkaukaz, kurse në kontekstin ish-jugosllav kanë qenë shqiptarët, populli mysliman i Bosnjë-Hercegovinës, si dhe hungarezët e Vojvodinës[362]. Megjithatë, pas rënies së

[361] Për origjinën teorike dhe zbatimin në praktikë të saj, shih më shumë në punimin elokuent të Michael V. Kryukov, "Self-Determination from Marx to Mao", *Ethnic and Racial Studies* vol. 19, no. 2 (1996; SHih poashtu edhe George Thomson, *From Marx to Mao Tse-Tung: A Study in Revolutionary Dialectics* (Garden City Press: UK, 1971), në veçanti kapitulli IV ("The National Question").

[362] Për parimet e ndarjes (delimitimit) administrativo-territoriale në kuadër të ish Jugosllavisë, shih më shumë në Dušan Josipović, *Principi političko-territorialne podele u Jugoslaviji* (RAD: Beograd, 1963) (vetëm në alfabetin cirilik). Për vënien e tyre në jetë në hapësirën ish-Jugosllave si tërësi, si dhe për rastin e Kosvës, cf. Miodrag Zečević & Bogdan Lekić, *Granice i unutrašnja territorijalna podela Jugoslavije* (Gradjevinka knjiga: Beograd, 1991). Për rastin e Kroacisë në drejtim të Vojvodinës, por edhe për rastet e tjera në ish-Jugosllavi, cf. Marina

komunizmit në pjesën dërrmuese, vendet që u pavarësuan nga shpërbërjet e federatave komuniste (BRSS, Çekosllovakia dhe Jugosllavia) i pranuan ndarjet administrative territoriale të kryera gjatë kohës së komunizmit si vija ndarëse mes shteteve[363].

Kufijtë e Kosovës aktualisht janë të pacaktuar me Republikën e Serbisë. Me Malin e Zi ka ngecur puna, si pasojë e keqkuptimeve dhe mosnjohjes nga pala kosovare e delimitimit në kuadër të ish-Jugosllavisë, i cili ka ekzistuar që nga viti 1946[364]. Në drejtim të Malit të Zi, gjykuar sipas dokumentacionit të kësaj kohe, nuk ka pasur asnjë ndryshim. Ndryshimet e vetme janë bërë kah territori ynë me Maqedoninë dhe Republikën e Serbisë. Me këtë të fundit ka pasur disa herë ndryshime territoriale[365], kurse me Maqedoninë ndryshimet e fundit janë bërë më 2001, kur është lidhur një marrëveshje për caktim të kufirit mes RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi) dhe Maqedonisë, pjesa kah Kosova[366]. Këtë marrëveshje Kosova e ka trashëguar sipas dispozitave mbi trashëgimin e shteteve në materien e kufijve, trashëgim i cili nuk mund të kontestohet

---

Stambuk-Skalić, "Hrvatska istočna granica u u dokumentima 1945-1947", *Fontes: izvori za hrvatsku povjest* vol. 1, no. 1 (Zagreb, novembar 1995) fq. 153-329. Vetëm për rastin e Kosovës, shih përmbledhjen e dokumenteve juridike dhe katrografike tek Jusuf Osmani dhe Ramë Manaj, *Ndarja administrative-territoriale e Kosovës 1944-2010* (AShAK: Prishtinë, 2014).

[363] Për shtjellim të shkëlqyer të kësaj problematike, cf. Jure Vidmar, "Confining New International Borders in the Practice of Post-1990 State Creations", *Zeitschrift für ausländisches öfentliches Recht und Völkerrecht / Heidelberg Journal of International Law* vol. 70, no. 2 (2010) fq. 319-356.

[364] Cf. Miodrag Zečević & Bogdan Lekić, *Granice i unutrašnja territorijalna podela Jugoslavije*, fq. 26-38; Marina Stambuk-Skalić, "Hrvatska istočna granica u u dokumentima 1945-1947", fq. 291-296. Ky komision ndryshe njihet edhe si Komisioni Gjillas, sipas emrit të kryesuesit të tij, malazezit Millovan Gjillas (Milovan Djilas), i cili ka qenë nënkryetar i Jugosllavisë komuniste pas Luftës së Dytë Botërore.

[365] Lidhur me çdo detaj të ndryshimeve territoriale të Kosovës me Serbinë që nga viti 1946 e deri më shkatërrimin e ish-Jugosllavisë, shih më shumë në Jusuf Osmani dhe Ramë Manaj, *Ndarja administrative-territoriale e Kosovës 1944-2010*, fq. 19-53.

[366] Fjala është për Marrëveshjen për përcaktimin dhe përshkrimin e kufirit shtetëror të datës 23 shkurt 2001, ratifikuar më 9 maj 2001, kurse ka hyrë në fuqi më 16 qershor 2001. Cf. *Službeni list SRJ* 16.1, aneks "Medjunarodni ugovori" (Beograd, 2001). Kosova më pastaj, pas fitimit të pavarësisë, ka nënshkruar një marrëveshje tjetër për demarkacion sepse çdo marrëveshje për kufi ka dy faza, delimitimin dhe demarkacionin. Kuvendi i Kosovës me vendimin e vet nr. 03-V-203 të datës 17 tetor 2009 ka bërë ratifikimin e Marrëveshjes për Demarkacionin Fizik të Kufirit Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë. Për historikun e Marrëveshjes së 23 shkurtit 2001 për delimitim, shih më shumë në studimin elokuent dhe të gjatë të dr. Jove Dimitrija Talevski, *The Borders of the Republic of Macedonia, With Supplements* (Kiro Dandaro: Bitola, 1998), në veçanti faqet 141-188 dhe 331-343.

ndërkombëtarisht. Rregullat për trashëgim të kufijve shtetërorë ndërkombëtarisht të njohur janë rregullat më stabile dhe më të respektuara në të drejtën ndërkombëtare. Se fjala ka qenë për ndryshim të kufirit kah Maqedonia, flet edhe vetë neni 3.2 i Aneksit VIII [Sektori i Sigurisë në Kosovë] të Planit Ahtisaari, i cili në mënyrë specifike i referohet kufijve të Kosovës duke thënë:

> Territori i Kosovës do të definohet nga vija kufitare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës brenda Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ashtu siç kanë qenë këto vija kufitare më 31 dhjetor 1988, përveç ndryshimit të vijës kufitare nga marrëveshja e demarkacionit mes Republikës Federative të Jugosllavisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë më 23 shkurt 2001.

Dispozita si më sipër, sikundër vërehet, ngërthen definimin e kufirit të Kosovës se pavarur dhe sovrane (parimi/rregulla *uti possidetis juris* 1974) dhe përbën tekstin të cilin Komisioni Meha e ka keqinterpretuar. Keqinterpretimi në veçanti ka të bëjë me mënyrën e zbatimit të parimit/rregullës *uti possidetis juris* 1974 në kontekstin e caktimit të kufijve të Kosovës në drejtim të Malit të Zi, por jo të kufijve të rinj, por të atyre ekzistues. Veprimi i caktimit të kufijve ekzistues, në të vërtetë, paraqet identifikim të kufirit ekzistues të Kosovës me Malin e Zi, ashtu siç është definuar në nenin 3.2. i Aneksit VIII [Sektori i Sigurisë në Kosovë] të Planit Ahtisaari.

Çështja e përcaktimit të saktë të kufirit mes dy vendeve ka lindur në momentin e fitimit të pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Nga ky moment ka qenë i domosdoshëm përcaktimi i kufijve të një shteti sovran me një shtet tjetër sovran, Malin e Zi, me qëllim të lokalizimit të saktë të vendndodhjes së vijës kufitare që Mali i Zi e ka trashëguar në drejtim të Kosovës sipas parimit *uti possidetis juris* në ditën e 6 qershorit 2006, kur ky vend u bë shtet sovran dhe i pavarur. Kufiri tjetër i Malit të Zi, ai me Shqipërinë, nuk ka qenë dhe nuk është kontestues, siç nuk është kontestues as për Kosovën, meqë fjala është për kufij shtetërorë ndërkombëtarisht të njohur që nga mbarimi i Luftës së Parë Botërore. Çdo ndryshim i sovranitetit territorial, sado i vogël dhe i përkohshëm që mund të jetë, aktivizon rregullat mbi trashëgimin e shteteve në materien e kufijve shtetërorë. Kjo vlen edhe në rastet e shteteve të a.q. efemere, pra të atyre krijesave shtetërore që në planin ndërkombëtar kanë bërë jetë të shkurtër (p.sh., Unionin Arab mes Sirisë dhe Egjiptit, Federata e Malit mes Senegalit dhe Sudanit, të gjitha këto gjatë viteve '50 dhe '60 të shekullit të kaluar, apo shtetet e tjera efemere në Amerikën Latine pas dekolonizimit të

tyre më 1810 dhe 1821 respektivisht etj.)[367]. I tillë, pra i natyrës efemere, ka qenë dhe ngelet edhe USMZ, i themeluar 14 mars 2002 në bazë të Marrëveshjes së Beogradit[368]. Kjo nënkupton se në çështjen e caktimit të kufirit mes Kosovës dhe Malit të Zi ka rëndësi të madhe të njihet (identifikohet) se cili ka qenë delimitacioni i kufirit mes Serbisë dhe Malit të Zi në kohën kur Kosova ka qenë formalisht pjesë e Republikës së Serbisë (mars 1989–qershor 2006) për të parë nëse ka pasur ndryshim të vijës kufitare mes dy vendeve në pjesën kah kufiri Kosovë–Mali i Zi, e më pastaj të shikohet gjendja e kufirit në kohën para vitit 1989 (1946-1989). Lidhur me dilemën e parë, me një siguri të madhe mund të pohohet se me sa duket nuk ka pasur ndonjë ndryshim në këtë periudhë, pra gjatë periudhës prej marsit të vitit 1989 deri në qershor të vitit 2006 kur Mali i Zi ka fituar pavarësinë. Megjithatë, kjo nuk mjafton të thuhet sepse si rrethanë e tillë ka qenë dashur të konstatohet nga vetë Komisioni Meha. Kjo për faktin se gjendja para vitit 1974 ka relevancë vetëm për sa i përket mënyrës së delimitimit të dy vendeve sipas gjendjes *uti possidetis* 1974, kurse pas saj ka rëndësi për të përcjellë ndryshimet eventuale të bëra nga Mali i Zi dhe Serbia përgjatë kohës kur Kosova nuk ka qenë shtet sovran dhe i pavarur, pra para datës 17 shkurt 2008.

1. Pa delimitim nuk ka demarkacion: trajtimi i koncepteve kyçe në procesin e caktimit të kufijve terrestrialë mes shteteve

Nuk kemi ndërmend këtu të flasim në detaje për atë së çka quhet kufi në të drejtën ndërkombëtare, meqë edhe një laik duhet ta dijë se ato janë vija ndarëse nën dhe mbi një territor që ndajnë sovranitetet e dy ose më shumë vendeve. Ky është kufiri ndërkombëtar. Kufiri administrativ, në të njëjtën mënyrë, ndan njësitë e caktuara administrative në drejtim të thellësisë së territorit (tokësor dhe ujor) dhe pafundësisë së hapësirës ajrore. Qëllimi i këtij seksioni është krejtësisht tjetër, dhe lidhet me dy çështje. E para, nuk flitet këtu për caktimin e kufijve në det apo oqean, por në tokë. Dhe e dyta, këtu

---

[367] Për këto, si dhe për kontinuitetit dhe trashëgimin e shteteve efemere, përfshirë këtu materien e kufijve shtetërorë, në punimin e shkëlqyer të Habib Gherari, "Quelque observations sur les États ephemere", *Annuaire français de droit international* vol. 40, no. 1 (année 1994) fq. 419-432.

[368] Marrëveshja mbi Parimet mes Serbisë dhe Malit të Zi në kuadër të Unionit të Shteteve (2002) (në tekstin e mëtejmë: "Marrëveshja për Union"). Marrëveshja për Unionin është nënshkruar në Beograd më datën 14 mars 2002, nën mbikëqyrjen e Javier Solanës, Përfaqësuesi i Lartë i Unionit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë.

duam të theksojmë fuqishëm se nuk ka demarkacion pa delimitim[369]. Demarkacioni është i dobishëm, por jo i domosdoshëm ligjërisht, e ka thënë juristi i njohur i së drejtës ndërkombëtare Paul de La Pradelle qysh më 1928, në disertacionin e tij të doktoratës[370]. Akoma ky pohim rezonon mesazh të njëjtë për ata që sot mendojnë se demarkacioni ka qenë dhe është fillimi dhe fundi në procesin e caktimit të kufijve të Kosovës. Këtë konstatim gjithmonë domethënës nuk e ka pasur dhe nuk e ka të qartë Komisioni Meha, i cili përmes punës së tij trevjeçare (2012-2015), në fakt, caktoi kufijtë e rinj — apo, meqenëse akoma nuk ka ndodhur ratifikimi i draft-marrëveshjes për demarkacion me Malin e Zi, më mirë të themi se Komisioni Meha ka propozuar që të caktohen kufij të rinj me këtë vend fqinj. Para se të sqarojmë këtë paqartësi të Komisionit Meha, të flasim pak për delimitimin dhe kuptimin e tij në kontekstin aktual të mosmarrëveshjes për kufij me Malin e Zi.

Delimitimi, apo përkufizimi i kufirit, nuk paraqet asgjë tjetër pos një definim të tij. Këtë e ka thënë GjND në rastin e njohur Burkina-Faso–Republika e Malit (1986). Në këtë rast fundamental, GjND theksoi, *inter alia*, si vijon[371]:

> Dy palët kanë argumentuar gjerësisht se kontesti aktual duhet të klasifikohet sipas dallimit të cilin e bëjnë shkrimtarët e drejtësisë mes "kontesteve kufitare" ose "kontesteve lidhur me delimitimin" (*frontier disputes* ose *delimitation disputes*) dhe "kontesteve që kanë të bëjnë me atribuimin e territorit" (*disputes as to attribution of territory*). Sipas këtij dallimi, kontesti i parë ka të bëjë me veprimet e delimitimit që prekin atë që cilësohet si "pjesë e tokës e cila nuk është autonome në pikëpamje gjeografike", kurse objekt i kontestit të dytë ka të bëjë me atribuimin e sovranitetit mbi një entitet gjeografik marrë si tërësi. Dy palët, me sa duket, në fund pranojnë se kontesti aktual i takon kontesteve për delimitim, sado që nuk arrijnë të pajtohen lidhur me përfundimet që duhen nxjerrë nga një pranim i tillë. Në fakt, në shumicën e rasteve të kontesteve të tilla, megjithatë, dallimi si më sipër nuk është një dallim lidhur me llojin e kontestit *per se* aq sa lidhur me nivelin e veprimeve që duhen ndërmarrë me rastin e zgjidhjes së kontestit [qoftë të llojit të parë ose të llojit të dytë — vërejtja jonë, E.H.]. Efekti i çdo delimitimi, pa marrë parasysh

---

[369] Delimitimi zakonisht bëhet me marrëveshje mes palëve apo me marrëveshje paqësore pas mbarimit të luftës. Por, ai mund të bëhet edhe me vendim gjyqësor apo me vendim arbitrazhi, si dhe me vendim të ndonjë organi tjetër kompetent.

[370] Paul de La Pradelle, *La frontière : étude de droit international* (Les Editions internationales: Paris, 1928) fq. 143

[371] "Frontier Dispute, Judgment (Burkina Faso/Republic of Mali) of 22 December 1986", *ICJ Reports* (1986) fq. 653-564, 582 dhe 632-633.

sa i vogël mund të jetë territori kontestues mbi të cilin përshkon vija kufitare, paraqet një ndarje të pjesëve të tokës të cilat gjenden në cilëndo anë të vijës së tillë përshkuese. Në rastin konkret, duhet vënë në dukje se Marrëveshja Speciale në nenin I flet jo vetëm për tërheqjen e vijës kufitare [pra, për demarkacion — vërejtja jonë, E.H.], por për një "hapësirë" kontestuese e cila definohet si një "rrip" i territorit që përfshinë "rajonin" e Belit. Për më tepër, efekti i cilitdo vendim gjyqësor, qoftë lidhur me kontestin për atribuim të territorit apo lidhur me kontestin për delimitim, paraqitet si i domosdoshëm për të caktuar një kufi. Nuk është pa rëndësi rrethana që disa konventa kodifikuese përdorin shprehjet si "marrëveshja që përcakton një kufi" apo "kufiri i përcaktuar nga një marrëveshje" për të përfshirë si marrëveshjet për delimitim ashtu dhe marrëveshjet që bartin apo atribuojnë një territor në një vend tjetër (cf. Konventa e Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve, neni 62; Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin e Shteteve ndaj Traktateve, neni 11). Në dy rastet palët kanë bërë një sqarim lidhur me situatën e dhënë legale me efekt deklarativ që nga data kur Gjykata do ta mbështesë titullin juridik [në favor të ndonjërës prej palëve — vërejtja jonë, E.H.]. Ky sqarim në vetvete përbën një element të ri; ky element është futur sepse palët kanë dashur të shohin një gjë të tillë meqë sipas tyre ai përbën esencën e vendimit gjyqësor. Sikur mos të kishte ekzistuar një kontest apo pasiguri mes palëve, palët nuk do ta dëshironin një gjë të tillë. Për pasojë, në rastin konkret nuk janë natyra dhe cilësimi i kontestit aktual përcaktues të natyrës, caqeve, detyrës dhe funksioneve të Dhomës, por vetë Statuti i Gjykatës dhe dispozitat e Marrëveshjes Speciale.

Në rastin konkret, Dhoma në arsyetimin e saj kufizohet në shpalljen e një parimi. Qoftë në delimitimet e kufijve apo në konfliktet territoriale ndërkombëtare, hartat paraqesin thjesht vetëm një informacion i cili ndryshon nga rasti në rast; vetëpërvete, dhe për shkak se ekzistojnë si të tilla, hartat nuk mund të paraqesin titull juridik, përkatësisht ato nuk mund të paraqesin një dokument që nga e drejta ndërkombëtare furnizohet me një forcë të brendshme juridike me qëllim të themelimit të të drejtave territoriale mbi një territor të caktuar. Natyrisht, në disa raste hartat mund të marrin forcë të tillë juridike. Por, në rastet e tilla, forca juridike nuk buron vetëm nga forca e tyre e brendshme (përmbajtja e hartës): në raste te tilla, thënë shkurt, hartat futen në kategorinë e shprehjeve fizike të vullnetit të shtetit apo të shteteve të caktuara. Ky është rasti, ta zëmë, atëherë kur hartat janë aneks i një teksti zyrtar dhe përbëjnë pjesë integrale të tekstit të tillë. Përveç këtij rasti qartë të definuar, hartat kanë vlerë të jashtme provuese të një besueshmërie të ndryshme dhe, si të tilla, mund të përdoren krahas provave të tjera të natyrës rrethanore për qëllimet e krijimit apo rikrijimit të fakteve reale (të vërteta).

Sërish duhet të theksohet se detyra e Dhomës në rastin konkret është që të tregojë vijën e kufirit të trashëguar nga dy shtetet prej kolonizuesve me rastin e fitimit të pavarësisë së tyre. Për arsyet e cekura më sipër, kjo detyrë konsiston në gjetjen dhe definimin e vijave të cilat kanë përbërë kufijtë administrativë të kolonisë së Voltës së Epërme [sot Burkina-Faso — vërejtja jonë, E.H.] më datën 31 dhjetor 1932. Sigurisht që palët kanë pasur mundësi dhe të drejtë që të ndryshojnë kufirin që ka ekzistuar më datën kritike [pra, në datën e fitimit të pavarësisë së dy shteteve — vërejtja jonë, E.H.] përmes një marrëveshje të mëvonshme. Sikur autoritete kompetente të dy palëve të kishin përkrahur marrëveshjen e 15 janarit 1965, atëherë nuk do të kishte qenë e domosdoshme për qëllimet e rastit konkret që të vërtetohet nëse marrëveshja e tillë ka pasur karakter deklarativ apo ndryshues në raport me kufijtë e vitit 1932. Kjo gjë nuk ka ndodhur, prandaj edhe Dhoma nuk ka pasur autorizim (mandat) nga palët për të zëvendësuar vullnetin e vet me atë të palëve lidhur me kufirin e përshtatshëm. Dhoma nuk duhet ta heqë nga mendja asnjërin prej funksioneve të Gjykatës, i cili konsiston në zgjidhjen e kontesteve të paraqitura nga ana e palëve në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, por as faktin se nga Dhoma palët përmes Marrëveshjes Speciale nuk kanë kërkuar që t'u jepen udhëzime lidhur me përcaktimin e kufirit të tyre të përbashkët, por kanë kërkuar që vetë Dhoma ta tërheqë dhe saktësojë vijën kufitare. Siç është shpjeguar, Dhoma mund të përdorë *equity infra legem*, sepse të dyja palët e kanë pranuar si të aplikueshëm në rastin konkret (shih: paragrafi 27 si më sipër). Në këtë aspekt, koncepti udhëheqës është thjesht se "*equity* si koncept juridik rrjedh drejtpërsëdrejti nga ideja e drejtësisë" ("Continental Shelf (Tunisia/Libyan Arab Jamahiriya)", *ICJ Reports* 1982, fq. 60, paragrafi 71). Dhoma do të donte të theksonte më shumë se përdorimi i konceptit *equity* në modifikimin e një kufiri të etabluar nuk do të ishte i arsyeshëm. Në veçanti, në kontekstin afrikan, të metat e dukshme të shumë kufijve të trashëguar nga kolonializmi në aspektin etnik, gjeografik apo administrativ nuk mund të mbështesin pohimet që flasin për domosdoshmërinë dhe arsyeshmërinë e ndryshimit të tyre bazuar në parimin *equity*. Këta kufij, pa marrë parasysh sa të pakënaqshëm mund të jenë, posedojnë autoritetin e *uti possidetis*, dhe si të tillë janë në pajtim të plotë me të drejtën bashkëkohore ndërkombëtare. Përveç rasteve të vendimeve të nxjerra *ex aequo et bono* me pëlqimin e vetë palëve, "kjo nuk është thjesht një çështje e gjetjes së një zgjidhjeje të drejtë, por një zgjidhjeje të drejtë që rrjedh nga e drejta e aplikueshme" ("Fisheries Jurisdiction", *ICJ Reports* 1974, fq. 33, para. 78). Dhoma duhet të marrë parasysh, me qëllim të gjetjes së një zgjidhje si kjo, jo marrëveshjen e 15 janarit 1965, por rrethanat nën të cilat një marrëveshje e tillë është arritur.

I cituam gjerësisht këto pjesë nga aktgjykimi në këtë rast për të parë tërë stabilitetin që kanë kriteret e së drejtës ndërkombëtare lidhur me delimitimin, si dhe për të parë dallimin e madh mes delimitimit dhe demarkacionit. Përveç në kontekstin ish-jugosllav, për të cilin do të flitet më vonë, kjo është parë edhe në një rast tjetër të vendosur nga GjND. Në këtë rast sërish palë ka qenë Burkina-Fasoja: fjalën e kemi për rastin mes Burkina-Fasos dhe Nigerit[372]. Më 16 prill 2013, kur është vendosur meritorisht ky rast, GjND ka përcaktuar kursin e kufirit mes dy vendeve, të cilat më pastaj, në maj të vitit 2015, kanë shkëmbyer ndërmjet veti 18 qytete në vijim të vënies në jetë të aktgjykimit të GjND lidhur me këtë rast[373]. Kontesti rreth kufirit mes këtyre dy shteteve, të cilat kanë qenë pjesë e Afrikës Franceze të Perëndimit deri me pavarësimin e tyre më 1960, ka nisur që nga viti 1927, kur një dekret (*arrêté*) qe miratuar nga Guvernatori i Përgjithshëm i Afrikës Francezë Perëndimore, me qëllim të caktimit të kufijve të kolonive të Voltës së Epërme dhe Nigerit.

Me marrëveshjet e 23 qershorit 1964 dhe 28 marsit 1987, qeveritë e dy vendeve janë pajtuar për ta bërë demarkimin e kufirit të tyre të përbashkët duke krijuar një komision të përbashkët teknik. Marrëveshja e vitit 1987 ka paraparë që dekreti i vitit 1927 (*arrêté*), i plotësuar më 5 tetor 1927, do të jetë i zbatueshëm për delimitim të kufirit mes dy vendeve. Në rast se dekreti i vitit 1927 (*arrêté*), i plotësuar më 5 tetor 1927, nuk mjafton për delimitim, atëherë, sipas Marrëveshjes së vitit 1987, kursi i kufirit do të jetë ai që paraqitet në seritë e hartave topografike 1:200,000 të prodhuara më 1960 nga Instituti Gjeografik Kombëtar (Institut géographique national, IGN)[374].

GjND në këtë rast vendosi që dekreti i vitit 1927 (*arrêté*), i plotësuar më 5 tetor 1927, paraqet një instrument relevant që duhet marrë parasysh me rastin e delimitimit mes dy vendeve. Por, sipas saj, aty ku ai nuk ka qartësi, duhet të zbatohen hartat topografike të përmasave si më sipër të botuara në vitin 1960 nga IGN. Përveç kësaj, Gjykata në këtë vendim ka marrë parasysh edhe interesat e popullsisë nomade, e cila afektohet me delimitimin e ri të përcaktuar nga vetë Gjykata. Për këtë arsye, nga palët është kërkuar që ta kenë parasysh këtë rrethanë me rastin e demarkimit të kufirit të tyre në të ardhmen.

---

[372] "Frontier Dispute, Judgment (Burkina Faso/Niger) of 16 April 2013", *ICJ Reports* (2013).
[373] Për zbatimin e Aktgjykimit të datës 16 prill 2013, shih raportimet: "Burkina Faso and Niger exchange 18 towns to settle border dispute", *The Guardian* (8 May 2015).
[374] "Frontier Dispute, Judgment (Burkina Faso/Niger) of 16 April 2013", *ICJ Reports* (2013): "I. Historical and Factual Background", fq. 58-66; "III. The Course of the Section of the Frontier Remaining in Dispute", fq. 73-93.

Sikundër shihet, në këtë rast dhe në rastet e tjera të vendimmarrjes në lëmin e caktimit të kufijve mes shteteve, vendimi i GjND-së e zëvendëson marrëveshjen për delimitim mes palëve. Vendimi mund të jetë edhe i ndonjë organi tjetër *ad hoc*, ta zëmë i ndonjë ndërmjetësuesi, i ndonjë arbitrazhi apo i ndonjë trupi tjetër të cilit palët ia kanë besuar zgjidhjen e kontestit të tyre për kufij. Rëndësi ka që çdoherë duhet të ekzistojë një marrëveshje, një vendim gjykate apo arbitrazhi (*ad hoc* ose permanent) ose vendim i ndonjë trupi tjetër për të cilin palët paraprakisht janë pajtuar se do ta zgjidhë kontestin.

Këtë dallim si më sipër mes delimitimit dhe demarkacionit, në doktrinë askush më mirë se Oppenheim (Openhajm) nuk e ka shprehur[375]:

> Praktika e përgjithshme për kufijtë në tokë është që me marrëveshje apo vendim të një organi të përshkruhet kufiri me fjalë, përkatësisht praktika është që të delimitohet kufiri; më pastaj vjen caktimi i komisioneve, zakonisht të përbashkëta, të cilat delimitimin e kryer duhet ta zbatojnë në praktikë në terren dhe nëse është e nevojshme ta shënjojnë me shtylla kufitare ose shenja të tjera të të ngjashme, pra ta demarkojnë kufirin e delimituar.

Thënë shkurt, delimitimi, ose definimi i kufirit në tokë, sepse në det kjo çështje kur shtrohet ekziston një qasje tjetër, paraqet definimin e vendndodhjes (identifikimit) së kufirit dhe të procedurave që duhen ndjekur me qëllim që ky definim (identifikim) të bartet në terren. Një ndër konsideratat që duhen marrë parasysh me rastin e bartjes në terren të këtij definimi (identifikimi) ka të bëjë me marrjen shumë parasysh të jetës në terren. Bartja në terren e kufirit të definuar (identifikuar) quhet demarkacion. Në këto dy faza të caktimit të kufijve ekzistojnë profilet e profesioneve të caktuara që marrin pjesë në to. Në fazën e delimitimit, apo të definimit të kufirit, marrin pjesë kryesisht diplomatët, juristët, këshilltarët politikë, ekonomistët, të cilët cilësohen si arkitektët e kufirit, kurse në fazën e demarkacionit marrin pjesë gjeografët, gjeodetët, hartografët, inxhinierët e kompjuteristikës, të cilët cilësohen si inxhinierët e kufirit.

Detyra parësore e demarkacionit është që të transferojë në terren, sa më saktë që të jetë e mundur, vijën e kufirit ashtu siç është definuar (identifikuar) në dokumentin e delimitimit. Delimitimi ofron, në anën tjetër, definimin (identifikimin) e vijave ndarëse mes sovraniteteve të vendeve fqinje përmes përshkrimit verbal dhe grafik të vendndodhjes së kufirit, nganjëherë duke

---

[375] Sir Robert Jennings and Sir Arthur Watts (eds.), *Oppenheim's International Law.* vol. I (Introduction and Part 1), 9th ed. (Longoman: London, 1992) fq. 20.

qenë i shoqëruar me ndonjë hartë ose skicë. Ky definim verbal i përmbajtur në një marrëveshje apo në ndonjë vendim gjyqësor, arbitrazhi apo vendim të ndonjë organi tjetër duhet të transferohet në terren, përmes procesit të quajtur demarkacion. Misioni i demarkacionit, siç mund të vërehet, nuk është aspak politik. Funksionet e tij janë krejt teknologjike dhe vendimmarrja në demarkacion kufizohet në transferimin e definimeve (identifikimeve) verbale, grafike dhe digjitale të arritura mes palëve më herët në sipërfaqen e terrenit të caktuar me vijat delimituese.

2. Parimi/rregulla *uti possidetis juris* në kontekstin krahasues dhe ish-jugosllav

Shprehja *uti possidetis juris* tanimë ka marrë qytetarinë jo vetëm në diskursin juridik, por edhe në atë laik dhe të përditshëm. Në kontekstin kosovar, kjo shprehje filloi të bëhet publike kur nisi shpërbërja e ish-Jugosllavisë pas mbarimit të Luftës së Ftohtë. Kjo, megjithatë, aspak nuk domethënë se është e qartë brendia e tij dhe pasojat që dalin nga zbatimi i tij në kontekstin e caktimit të kufijve të Kosovës me fqinjët.

Në shumicën e kontesteve kufitare, e që janë me qindra sosh, të cilat janë shqyrtuar dhe janë vendosur nga gjykata e arbitrazhe ndërkombëtare që nga fillimi i dekolonizimit të Amerikës Latine (1810-1821) e deri të shpërbërja e ish-federatave komuniste të Bashkimit Sovjetik, Çekosllovakisë dhe Jugosllavisë (1991-1992), kanë ekzistuar dy faza si më sipër në përcaktimin e kufijve të shteteve të reja të krijuara me rastin e shpërbërjes së tyre: delimitimi dhe demarkacioni. Deri me shpërbërjen e federatave komuniste më 1991-1992, pas pavarësimit, shtetet ndërmjet veti zakonisht kanë përcaktuar delimitimin me marrëveshje ndërkombëtare bilaterale e më pastaj kanë lidhur marrëveshje bilaterale për demarkacion. Jo rrallë, siç u pa më herët, procesi i delimitimit është kryer përmes marrëveshjeve të paqes, një vendimi gjyqësor, të arbitrazhit apo të ndonjë organi tjetër ndërkombëtar të cilit palët ia kanë besuar një proces të tillë. Pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, megjithatë, u ndoq një rrugë tjetër me rastin e përcaktimit të kufijve të shteteve të reja të dala nga kjo shpërbërje. Ish-Jugosllavia nuk përbën një përjashtim. Këto vende, u fokusuan kryesisht në lidhjen vetëm të marrëveshjeve individuale bilaterale për demarkacionin. E kemi fjalën për shtete që u krijuan nga shpërbërja e ish-federatave komuniste dhe të cilat, në shumicën e rasteve, anashkaluan lidhjen e marrëveshjeve bilaterale për delimitim. Kjo ka ndodhur kështu

sepse shpërbërja e ish-federatave komuniste u shkaktua si pasojë e veprimit krejt legjitim të forcave nga brenda, *ab intra*. Si përcaktues se cilat kishin qenë vijat delimituese në kohën e jetesës së përbashkët nën kulmin komunist u mor kryesisht përvoja e dekolonizimit në Afrikë, e njohur si parimi/rregulla *uti possidetis juris*, përkatësisht marrja e vijave administrative të ish-provincave koloniale si pikë nisëse me rastin e caktimit të kufijve të rinj shtetërorë.

Për dallim nga rastet e dekolonizimit në Amerikën Latine një shekull më herët, në rastin e Afrikës dhe të ish-federatave komuniste, *uti possidetis juris* u barazua me parimin e paprekshmërisë së kufijve të mëparshëm administrativë, të cilët i kishin pasur shtetet e reja në momentin e fitimit të pavarësisë. Jugosllavia nuk bën përjashtim nga ky përcaktim: një komision ndërkombëtar, i njohur si Komisioni Badinter, gjatë viteve 1991-1993 ka dhënë disa mendime juridike që kanë përdorur shprehimisht precedentin e sipërcekur të GjND-së lidhur me rastin Burkina-Faso–Republika e Malit. Mbi bazën e këtij parimi, pra mbi bazën e *uti possidetis juris*, sipas Komisionit Badinter, vetëm kufijtë republikanë u konsideruan si kufij të mbrojtur nga ligji ndërkombëtar me rastin e pavarësimit të ish-republikave jugosllave, tani shtete sovrane dhe të pavarura (Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Serbia, Sllovenia, Maqedonia, dhe Mali i Zi). Kjo ka vlejtur edhe për ish-BRSS dhe Çekosllovakinë. Një praktikë e tillë ka pasur për pasojë që, marrëveshjet për delimitim, të cilat duheshin lidhur në kushte normale ndërmjet shteteve të reja që dolën nga shpërbërja e ish-federatave komuniste, u zëvendësuan me gjendjen e fundit kadastrale të ish-republikave federale të ish-federatave komuniste në momentin e fitimit të pavarësisë së tyre.

Sipas ligjit ndërkombëtar, momenti i fitimit të pavarësisë cilësohet si "moment kritik" për qëllimet e zbatimit të rregullës (normës) *uti possidetis juris*. Ka edhe momente të tjera, megjithatë, të cilat cilësohen si "momente kritike" sipas së drejtës ndërkombëtare dhe që, zakonisht, i referohen momentit të lidhjes së një marrëveshje ndërkombëtare për delimitim, apo momentit të nxjerrjes së një verdikti gjyqësor apo arbitror me të cilin caktohet kufiri i ri shtetëror i një shteti të ri, përkundër apo krahas respektimit të rregullës *uti possidetis juris*[376].

[376] Si "moment kritik", i njohur ndryshe edhe si "efekti kohor i *uti possidetis juris*", në të shumtën e rasteve merret momenti i ndërmarrjes së aktit të shpalljes së pavarësisë. Përveç këtij momenti, ekzistojnë edhe momente të tjera të ndërmarrjes së akteve të caktuara që kanë të njëjtin efekt, siç janë momenti i nxjerrjes dhe hyrjes në fuqi të vendimit gjyqësor ose arbitror, me të cilin caktohen kufijtë, momenti i lidhjes dhe hyrjes në fuqi të marrëveshjes së

Për secilën ish-republikë të pavarësuar nga shpërbërja e ish-federatave komuniste dihet saktësisht momenti kohor i fitimit të pavarësisë. Ky moment ka rëndësi dhe cilësohet "moment kritik" për faktin se një moment i tillë ka rëndësi për caqet dhe për mënyrën e trashëgimit të shteteve në të gjitha marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit pararendës. Si marrëdhënie në të cilat trashëgohet shteti pararendës janë: trashëgimi i shtetit pararendës në marrëdhëniet kontraktuese rreth kufijve dhe shtetësisë, borxhit të jashtëm, pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, aseteve, arkivave dhe gjërave të ngjashme me këto. Kur flitet për trashëgimin e shtetit pararendës në çështjen e kufijve, si parim/rregull e cila ndiqet është *uti possidetis juris*. Ky parim/rregull shërben si përcaktues i caqeve të vlefshmërisë së titullit juridik mbi bazën e të cilit më pastaj ravijëzohen vijat gjeometrike e lakimet gjeodezike në terren. Pa sqarimin se cili është caku i vënies në jetë të titullit juridik nuk mund të ketë ravijëzim në terren të vijave gjeometrike e lakimeve gjeodezike. Titull juridik, ndërkombëtarisht i vlefshëm, paraqet çdo realizim i së drejtës për vetëvendosje të një populli apo të një territori, p.sh., rasti i Saharës Perëndimore, i cili nuk kontestohet nga *jus cogens* të së drejtës ndërkombëtare. Për Kosovën, ky titull derivohet nga realizimi i "shkëputjes shëruese" (*remedial secession*) të cilën Kosova e ka ekzekutuar më 17 shkurt 2008 kur ka shpallur njëanshëm aktin e pavarësimit nga Republika e Serbisë[377].

Dikur titull juridik ka qenë paja që një monark i ka dhënë një tjetri në formë territoresh të caktuara. Më vonë, marrëveshjet ndërkombëtare të paqes janë instaluar si titull kryesor juridik. Me lindjen e kombeve dhe të nacionalizmit si ideologji mbi kombin, parimi i vetëvendosjes ka shërbyer si titull juridik për fitim të territorit. Mënyrat e tjera, si shtimi, cedimi (bartja), e kështu me radhë, kanë qenë dhe ngelin tituj juridikë validë klasikë dhe nuk dalin nga përdorimi asnjëherë. Mirëpo, si të tilla nuk përcaktojnë caqet e zbatimit të vetëvendosjes si titull juridik. Ne këtu flasim për parimin/rregull-

---

paqes me të cilën caktohen kufijtë dhe zgjidhen kontestimet territoriale, momenti i nxjerrjes së një deklarate apo ndonjë vendimi tjetër që cakton mënyrat e delimitimit dhe shënjimit të kufijve mes shteteve të dhëna, dhe kështu me radhë. Cf. Georges Abi-Saab, "Le principe de l'uti possidetis : son rôle et ses limites dans la contentieux territorial international", në Marcelo G. Kohen (ed.), *Promoting Justice, Human Rights and Conflict Resolution Through International Law: Liber Amicorum Lucius Caflisch* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2007) fq. 663-671.

[377] Cf. Jure Vidmar, "International Legal Responses to Kosovo's Declaration of Independence", *Vanderbilt Journal of Transnational Law* vol. 42, no. 3 (2009) fq. 814-818. Krahaso në veçanti literaturën që ky autor e përdor në fusnotat e tij, si dhe praktikën gjyqësore për rastin e ishujve Oland të Finlandës dhe të Kuebekut në Kanada.

ën *uti possidetis juris* edhe në një aspekt tjetër, përkatësisht si për një mjet që përcakton caqet e vënies në jetë të titullit juridik të fituar në mënyrë valide sipas së drejtës ndërkombëtare. Kjo ka nisur ta ketë këtë kuptim, siç u tha, vetëm pas rastit të Burkina-Fasos kundër Malit (1986).

Në këtë shkrim flasim për *uti possidetis juris* si përcaktues i vënies në jetë të titullit juridik të fituar në mënyrë të ligjshme sipas së drejtës ndërkombëtare (p.sh., përmes ushtrimit të së drejtës për vetëvendosje të jashtme, apo përmes njohjes së titullit juridik me një vendim gjyqësor apo me ndonjë akt tjetër juridik të vlefshëm në të drejtën ndërkombëtare), si dhe për mënyrën e përcaktimit të kufijve të rinj shtetërorë nga hiçi. Në të dy rastet nënkuptohet se kufijtë e një shteti të ri caktohen sipas *uti possidetis juris* vetëm nga momenti i fitimit të pavarësisë. Ky moment kohor, pra momenti i fitimit të pavarësisë, ka disa forma zbatimi kur bëhet fjalë për caqet dhe për mënyrën e zbatimit të parimit/rregullës *uti possidetis juris*, përfshirë këtu edhe rastet kur si mjet për delimitim shërben një verdikt gjyqësor, arbitror apo diçka tjetër që zëvendëson marrëveshjen ndërmjet palëve. Këto dy aspekte manifestohen në katër format e zbatimit të parimit/rregullës *uti possidetis juris*, si titull juridik, me rastin e fitimit të pavarësisë dhe pas. Këto forma aktualisht paraqesin standard të zbatueshëm ndërkombëtar. Si të tilla janë etabluar jo vetëm me vendimin e sipërcekur të GjND-së në rastin Burkina-Faso–Republika e Malit, por edhe me vendime e akte të tjera të vlefshme sipas së drejtës ndërkombëtare. Format në fjalë konsistojnë për sa vijon[378]:

a. Aty ku nuk ka pasur, gjatë periudhës para pavarësimit, një delimitim të qartë mes ndarjeve administrative, atëherë nuk ngel tjetër kriter veçse vlerësimi i cilësisë së kontrollit efektiv nga banorët në terren të pjesëve administrative të territorit. Ka dy cilësi të *effectivité*-së: posedimi me mirëbesim dhe ai me keqbesim. Në vendimin e GjND-së, në rastin Burkina-Faso kundër Republikës së Malit, kjo gjendje është cilësuar si kontroll efektiv që nuk përputhet me titullin juridik të kuptuar si *uti possidetis juris*. Në rastin e Brazilit, të cilin e citon GjND-ja në zgjidhjen e kontestit kufitar Salvador–Honduras (1992), po ashtu është zbatuar parimi i efektivitetit, i kuptuar si *uti possidetis de facto*, sepse në pikëpamje juridike është konsideruar që asnjëherë nuk ka pasur një traktat në fuqi ndërmjet Portugalisë dhe Spanjës lidhur me Brazilin

[378] Për komentet akademike të këtyre formave, cf. Georges Abi-Saab, "Le principe de l'uti possidetis : son rôle et ses limites dans la contentieux territorial international", fq. 657-671.

para fitimit të pavarësisë së këtij të fundit[379]. Me këtë rast, kontrolli paqësor i sektorit kufitar kontestues me mirëbesim dhe me pajtim të heshtur të palëve lidhur me këtë kontroll paqësor me mirëbesim kanë qenë faktorët korrektues në caktimin e kufijve të shteteve të reja si më sipër.

b. Aty ku delimitimi (identifikimi) është kryer gjatë kohës para fitimit të pavarësisë, mirëpo aktet juridiko-administrative të kohës së tillë janë të dykuptimta apo nuk janë të sakta, kurse nuk ka pasur një demarkacion të pranuar nga dy palët para fitimit të pavarësisë, atëherë kjo situatë korrespondon me atë që GjND-ja, në rastin Burkina-Faso–Mali (1986), e ka cilësuar si proces i akomodimit joformal ndërmjet palëve[380]. Kjo ka të bëjë me veprimet e popullsisë lokale në të dy anët e kufirit, të cilat nëpërmjet administratave të tyre ose vetë ndërmarrin veprimet e rektifikimit të gabimeve, qartësojnë dykuptimësitë, me qëllim që kufiri i ri të përputhet si duhet me cilësitë topografike të terrenit ose me nevojat e popullsisë lokale si në kohën para fitimit të pavarësisë.

c. Aty ku faktet në terren nuk përputhen me titullin juridik *uti possidetis juris*, apo ku territori është administruar efektivisht nga një vend tjetër nga ai që ka titullin juridik *uti possidetis juris*, atëherë, sipas GjND-së në rastin Burkina-Faso–Mali (1986), përparësi duhet t'i jepet vendit që ka titullin juridik *uti possidetis juris*[381].

ç. Aty ku, së fundi, nuk ekziston një vijë *uti possidetis juris* si titull juridik në momentin e fitimit të pavarësisë, por më vonë, pas fitimit të pavarësisë, ka pasur një pajtim të heshtur të palëve rreth vijës së re kufitare, kjo e fundit imponohet si titull i ri juridik.

Këto standarde që u përmendën këtu, të vëna nga GjND më 1986, janë riprodukuar pak a shumë në të gjitha kontestet kufitare të mëvonshme dhe paraqesin një kristalizim gradual të një praktike qindravjeçare të gjykatave e arbitrazheve ndërkombëtare në lëmin e caktimit të kursit të vijave kufitare.

---

[379] Cf. më shumë për këtë në Marcello Gustavo Kohen, "L'uti possidetis revisité: L'arrêt du 11 septembre 1992 dans l'affaire El Salvador / Honduras", *Revue générale de droit international public* Tome 97, no. 4 (1993) fq. 939-973.

[380] Cf. Georges Abi-Saab, "Le principe de l'uti possidetis : son rôle et ses limites dans la contentieux territorial international", fq. 660.

[381] Ibid. fq. 660.

Këtu, në veçanti, kemi parasysh rastet: Salvador–Honduras (1992)[382]; Kamerun–Nigeri (2002)[383]; Indonezi–Malajzi (2002)[384]; Benin–Niger (2005)[385] etj.

Sa i përket kufijve në ish-Jugosllavi, vetëm tri raste të kontesteve kufitare kanë lindur që atëherë në territorin e ish-Jugosllavisë: Mal i Zi–Kroaci (lidhur me ishullin Prevllaka), Kroaci–Slloveni (kryesisht lidhur me gjirin Piran, por edhe me sektorët e tjerë të kufirit të tyre të gjatë mbi 650 kilometra), Mal i Zi–Bosnjë-Hercegovinë (lidhur me sektorin rreth fshatit e lumit Sutorino); dhe, së fundi, lidhur me korridorin Bërçko (ndërmjet Republika Sërpska dhe Federatës së Bosnjë-Hercegovinës). Kontesti lidhur me korridorin Bërçko është kontest kufitar i brendshëm, por që ka relevancë në rastin e Kosovës, sepse edhe në këtë rast janë zbatuar norma e parime të së drejtës ndërkombëtare. Të gjitha kontestet kufitare, si më sipër, në territorin e ish-Jugosllavisë, akoma janë të hapura.

Në parim, në rastet e ish-Jugosllavisë ka vlejtur mendimi i Komisionit Badinter. Megjithatë, ka pasur devijime nga ky precedent te rasti i kontestit kufitar Kroaci–Slloveni, sepse është konsideruar se zbatimi i mendimit të Badinterit po e dëmtonte palën kroate. Për këtë arsye, në korrik të vitit 2001, Kroacia e Sllovenia patën nënshkruar një marrëveshje për kufijtë, duke i ikur zbatimit të rregullës *uti possidetis juris*, pra duke mos pranuar vijat administrative të vitit 1974 në disa pjesë të kufirit ndërmjet tyre dhe duke i korrigjuar ato në bazë te kritereve të tjera ekonomike, të konfiguracionit të terrenit, të interesave të banorëve dhe të konsideratave të tjera kontekstuale. Meqë palët nuk kanë arritur ta demarkojnë kufirin ndërmjet tyre sipas marrëveshjes së vitit 2001, atëherë, më 2009, palët kanë lidhur edhe një marrëveshje për arbitrazh për demarkacionin e vijës kufitare ndërmjet tyre, por ajo ende nuk është ratifikuar, kurse Bashkimi Evropian në mënyrë të vazhdueshme po insiston në zbatimin e kësaj marrëveshje për arbitrazh, si mënyrë e vetme për demarkacion ndërmjet dy vendeve në sektorin kontestues.

Devijime nga zbatimi *ad literam* i mendimeve të Komisionit Badinter ka pasur edhe në pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë, gjë e cila është reflektuar me

---

[382] "Case Concerning Land, Island and Maritime Frontier Dispute (El Salvador/Honduras: Nicaragua Intervening). Judgement of 11 September 1992", *ICJ Reports* (1992).

[383] "Case Concerning the Land and Maritime Boundary between Cameroon and Nigeria (Cameroon v. Nigeria: Equatorial Guinea Intervening). Judgment of 10 October 2002", *ICJ Reports* (2002).

[384] "Case Concerning Sovereignty Over Pulau Ligitan and Pulau Sipadan (Indonesia/Malaysia). Judgement of 16 September 2002", *ICJ Reports* (2002).

[385] "Frontier Dispute (Benin/Niger). Judgment of 12 July 2005", *ICJ Reports* (2005).

faktin e lidhjes së marrëveshjeve të reja për delimitim dhe me vetë përmbajtjen e tyre. Ka pasur dy raste të lidhjes së marrëveshjeve të reja për delimitim (identifikim) të kufirit në territorin ish-jugosllav. Njëra nga to është marrëveshja për delimitim e lidhur ndërmjet Republikës Federative të Jugosllavisë (Serbi-Mali Zi) dhe Maqedonisë, në shkurt të vitit 2001[386]. Këtë marrëveshje e ka trashëguar Kosova, pas fitimit të pavarësisë më 17 shkurt 2008, sipas normave të së drejtës ndërkombëtare mbi trashëgimin e shteteve në lëmin e marrëveshjeve ndërkombëtare[387]. Arsyeja pse është lidhur kjo marrëveshje duhet të jetë krejt politike e pragmatike: serbët dhe maqedonasit e kanë pasur të qartë, pas hyrjes së NATO-s në Kosovë, se Kosova pashmangshëm po ecën drejt pavarësisë dhe kanë dashur që sa më shumë t'ia ngushtojnë territorin e trashëguar sipas Kushtetutës së vitit 1974, përkatësisht sipas *uti possidetis juris* 1974, siç ka vlejtur për të gjitha njësitë federale.

---

[386] Marrëveshja e parë e këtij lloji në territorin ish-Jugosllavisë është ajo e lidhur mes Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë më datën 30 korrik 1999. Kjo marrëveshje, në fakt, paraqet marrëveshjen për delimitim mes dy vendeve, sepse përmes saj bëhet definimi i kufirit dhe i kritereve për identifikimin e tij në mënyrë që më pastaj të mundësohet demarkacioni i kufirit. Kjo gjë parashihet shprehimisht në nenin 2 të Marrëveshjes, ku është thënë se kufiri "definohet mbi bazën e situatës së kufirit që ka ekzistuar në momentin e shpërbërjes së Jugosllavisë më 1991 dhe njohjes reciproke ndërkombëtare mes Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë më 1992". Në po këtë nen, pra në nenin 2 të Marrëveshjes, janë listuar kriteret mbi bazën e të cilave do të bëhet identifikimi i kufirit ekzistues mes dy vendeve. Kriteret janë ato "ashtu siç identifikohen në hartën topografike të përmasave 1:25,000 dhe në terren në bazë të kufirit mes komunave kadastrale kufitare, në bazë të kufirit mes vendbanimeve fqinje sipas regjistrimit të vitit 1991, dhe në bazë të vijës ndarëse e cila ka ndarë ushtrimin e autoritetit publik në Republikën Socialiste të Kroacisë dhe në Republikën Socialiste të Bosnjë-Hercegovinës". Për komente mbi këtë marrëveshje, cf. më shumë në Mladen Klemenčić, "The Border Agreement Between Croatia and Bosnia-Herzegovina: The First but not the Last", në *IBRU Boundary and Security Buletin: Articles Section* (Winter 1999-2000) fq. 96-101.

[387] Përveç kësaj, Kosova ka trashëguar edhe Protokollin e Firencës të vitit 1926 kur është fjala për kufijtë e saj me Republikën e Shqipërisë. Në mënyrë të njëjtë, edhe ish-republikat jugosllave që u pavarësuan nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë kanë trashëguar marrëveshjet ndërkombëtare për kufijtë e jashtëm, të cilat kanë qenë të vlefshme për territorin e ish-Jugosllavisë: Serbia, Sllovenia, Kroacia, Maqedonia dhe Mali i Zi, të gjitha kanë trashëguar respektivisht marrëveshjet si vijon: Marrëveshjen e Trianonin të datës 4 qershor 1920 për kufijtë mes Serbisë dhe Hungarisë; Marrëveshjen e Sen-Zhermenit e datës 10 shtator 1919 për kufijtë e Austrisë më Kroacinë; Marrëveshja e Njejit mbi Senë e datës 27 nëntor 1919 për kufijtë e Maqedonisë me Bullgarinë dhe Greqinë; dhe, në fund, Protokollin e Firencës të nënshkruar në korrik të vitit 1926 (kur është fjala për Kosovën dhe Malin e Zi dhe kufirin e tyre me Shqipërinë). Të gjitha këto marrëveshje janë lidhur pas Luftës së Parë Botërore, në kuadër të sistemit të a.q. të Versajës mbi sigurinë kolektive.

Ani se rasti i fitimit të pavarësisë së Kosovës është *sui generis* në shumë aspekte, përfshirë këtu edhe përcaktimin e kufijve të saj, megjithatë nuk mund të mohohet fakti se rregulla *uti possidetis juris* 1974 vlen edhe për Kosovën në mënyrë tërësisht identike si në rastin e të gjitha shteteve të dala nga ish-Jugosllavia. Problemi kryesor, megjithatë, qëndron në përcaktimin e saktë të caqeve dhe të vëllimit territorial të zbatimit të *uti possidetis juris* 1974 në rastin e Kosovës. Interpretimi i gabuar i caqeve dhe i vëllimit të zbatimit të *uti possidetis juris* 1974 përbën esencën e gabimeve të bëra gjatë procesit të caktimit të kufirit me Malin e Zi, gabim që nuk ka rezultuar në demarkim të një kufiri ekzistues por në caktim të një kufiri të ri mes dy vendeve.

3. Gabimet me Malin e Zi si pasojë e keqinterpretimit të bazës juridike ndërkombëtare e vendore për kufijtë

Uti possidetis juris, që do të thotë trashëgimi i kufijve administrativë të cilët i ka pasur një vend në momentin e fitimit të pavarësisë dhe transformimi i tyre në kufij ndërkombëtarë në momentin e fitimit të pavarësisë, aktualisht gjen një zbatim universal. Kjo është thënë shumë qartë në kontestin e sipërcekur kufitar të vitit 1986 të gjykuar nga GjND-ja. Në rastin Burkina-Faso–Republika e Malit (1986), GjND-ja ka thënë se ky parim ndërkombëtar zbatohet menjëherë, pa marrë parasysh nëse kemi të bëjmë me ish-kolonitë apo me shtetet sovrane ekzistuese nga të cilat një ose disa pjesë administrative shkëputen dhe fitojnë pavarësinë. Edhe me rastin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë si pikë referimi për delimitim ka qenë *uti possidetis juris* 1974. Kjo sepse ekziston supozimi se jeta e përbashkët në një shtet nuk e vë në pikëpyetje natyrën supozuese të zbatimit të *uti possidetis* 1974. Kjo asnjëherë, megjithatë, nuk ka nënkuptuar se kadastra është e barasvlefshme me *uti possidetis juris* 1974, nisur nga fakti se ekzistojnë edhe kritere të tjera me rëndësi, të cilat si tërësi shërbejnë për ta përkthyer dhe lexuar përmbajtjen e parimit/rregullës *uti possidetis juris* në secilin kontekst që mund zbatohet. Ndër këto kritere me rëndësi hyn edhe kadastra, mirëpo assesi si një kriter i vetëm dhe përjashtues ndaj kritereve të tjera. Kjo do të shihet qartë në vijim të shtjellimeve tona.

Meqë Kosova u pavarësua e fundit nga ish-Jugosllavia, supozimi i zbatimit të parimit/rregullës *uti possidetis juris* 1974 ka qëndruar në këmbë fragjile. Supozimi në fjalë, si i rrëzueshëm në çdo rast, në rastin e Kosovës ka vlejtur edhe më shumë, sepse shtetet sovrane rreth Kosovës, ish-republikat jugo-

sllave, e kanë marrë si të mirëqenë faktin se kadastrat që ata i posedojnë konfirmojnë kufijtë e tyre ndërkombëtarë që nga dita e pavarësimit të tyre. Një supozim i tillë i tyre në të njëjtën kohë nuk ka marrë parasysh fare gjendjen kadastrale në Kosovë në momentin e fitimit të pavarësisë së tyre dhe deri më sot. Se kjo është kështu, shihet qartë nga marrëveshja e sipërcekur e vitit 2001 mes Maqedonisë dhe RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi), të cilën e ka trashëguar Kosova sipas rregullave mbi trashëgimin e shteteve në lëminë e traktateve ndërkombëtare[388]. Marrëveshja, në nenin 3 të saj, stipulon zgjidhje të njëjtë për delimitim (identifikim) të kufirit mes dy vendeve në drejtim të Kosovës, ani se ka një qasje pak më ndryshe nga draft-marrëveshja e Kosovës me Malin e Zi të datës 25 gusht 2015. Me fjalë të tjera, edhe në këtë marrëveshje, si kritere për delimitim (identifikim) të kufirit ekzistues administrativ mes dy vendeve kanë shërbyer hartat topografike, gjeografike dhe hartat e tjera, si dhe regjistrat kadastralë. Vendbanimet dhe gjendja e patundshmërive në fqinjësi të kufirit dhe të dhënat historike janë marrë parasysh. Në disa vende ku nuk ka pasur dokumentacion preciz, parimi i *status quo*-s së vijës kufitare në të kaluarën ka shërbyer si pikë referimi. Gjithashtu, parimet gjeografike për shtrirjen e kufijve ndërkombëtarë kanë gjetur zbatim në ato pjesë ku kushtet objektive kanë lejuar një gjë të tillë.

Mbi bazën e këtyre kritereve janë caktuar kufijtë mes Maqedonisë dhe RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi), por edhe mes Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë, si dhe mes ish-republikave të tjera jugosllave. Kadastra, siç shihet, ka qenë ndër kriteret kryesore në të gjitha rastet, por nuk ka qenë ekskluzive, dhe si e tillë ka arritur të lërë kontestuese mesatarisht 5 deri në 10 për qind të vijave kufitare ndërmjet ish-republikave jugosllave[389]. Hera e parë është në

---

[388] Kur bëhej delimitimi i kufirit të Kosovës me Maqedoninë nga ana e Serbisë, gjatë vitit 2001, autori i këtyre rreshtave u kishte thënë qartë liderëve të Kosovës, që atëherë ishin në KPA ("Këshilli i Përkohshëm Administrativ"), se duhej të ndërhynin te autoritetet ndërkombëtare në Kosovë, administrata e përkohshme ndërkombëtare e njohur si UNMIK, për të bërë një rezervë ashtu që Kosova të ruante të drejtën e rishikimit të mënyrës se si po zbatohej parimi *uti possidietis juris* nga RFJ (Serbia dhe Mali i Zi) dhe Maqedonia, mirëpo nuk kishte hasur në ndonjë ndjeshmëri të liderëve kosovarë ndaj kësaj çështje. Për të shprehur pikëpamjet e veta profesionale lidhur me këtë temë konkrete të kufirit me Maqedoninë, ky autor botoi një shkrim në qarqet akademike amerikane në revistën e njohur të Masaçusetsit për çështje juridiko-ndërkombëtare *The Fletcher Forum of World Affairs* vol. 27, issue 2 (Summer/Fall 2003) me titull: "*Uti Possidetis Juris:* From Rome to Kosovo". Kot, siç ka thënë Sokrati, sa për të çliruar shpirtin.

[389] Cf. Mile Milenkoski and Jove Talevski, "Delineation of the State Border Between the Republic of Macedonia and the Federal Republic of Yugoslavia", *IBRU Boundary and Security Bulletin: Articles Section* (Summer 2001) fq. 91-98.

Kosovë në kuadër të ish-Jugosllavisë që kadastra po synohet të përdoret ekskluzivisht vetëm si bazë për demarkacion (jo për delimitim, siç tregon rasti me Maqedoninë dhe ai mes Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë) përgjatë tërë kufirit të Kosovës me fqinjët. D.m.th., në rastin e Kosovës po synohet që të zbatohet kadastra si kriter i vetëm dhe përjashtues. Kjo po bëhet, siç thuhet nga Komisioni Meha, për faktin se Kushtetuta e vitit 1974 e ish-KSA të Kosovës, Marrëveshja Teknike Ushtarake e Kumanovës e 10 qershorit 1999 (më tej shkurt: MK) dhe Plani i Ahtisaarit i marsit 2007 e detyrojnë Kosovën për një gjë të tillë. Në asnjërin interpretim të dispozitave të këtyre dokumenteve juridiko-kushtetuese dhe juridiko-ndërkombëtare nuk del se kadastra duhet të jetë kriteri i vetëm dhe përjashtues për caktimin e kufijve të Kosovës.

Puna e Komisionit Meha, siç del nga ajo që dihet deri më sot, ka qenë punë teknike dhe jo aq shumë transparente, e kryer nga gjeografë e gjeodetë, si dhe nga persona me profesione të tjera teknike të cilët e kanë dominuar punën e tij, duke u bazuar në kadastrat e Kosovës të cilët, siç thuhet nga Komisioni, janë origjinale dhe të njëjta që nga viti 1973. Kontestimi që i bëhet me këtë shkrim kufirit të Kosovës me Malin e Zi, siç e ka përcaktuar Komisioni Meha, bazohet në fakte e në rrethana të së drejtës ndërkombëtare mbi caktimin e kufijve, siç u përshkrua më lart. Vetëm e drejta ndërkombëtare dhe normat e saj janë kompetente dhe pika bazë e referimit gjatë caktimit (delimitimit dhe demarkacionit) të kufijve. Hartografia nuk e ka këtë kompetencë dhe fuqi juridike, përveç rasteve kur hartat dhe shënimet e tjera gjeometrike përbëjnë pjesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare mbi caktimin (delimitimin dhe demarkacionin) e kufijve. Kështu është thënë në vendimin e GjND-së në rastin "Tempulli Preah Vehar" mes Kamboxhës dhe Tajlandës (1961)[390], por edhe në rastet e tjera pas tij, përfshirë këtu Marrëveshjen e Dejtonit të vitit 1995.

Kadastra është një lloj i hartografisë në sensin që në të skicohen gjendjet fizike të patundshmërive. Ajo nuk mund të shërbejë në mënyrë të pavarur si bazë për demarkacion, meqë nuk reflekton vullnetin e palëve. E tillë do paraqitej vetëm nëse do të kishte qenë pjesë përbërëse (aneks) i një marrëveshjeje të mëhershme mes palëve, në këtë rast mes Kosovës dhe Malit të Zi. Kështu ka thënë për hartografinë GjND në rastin e sipërcekur mes Tajlandës dhe Kamboxhës. Tanimë ky është një standard ndërkombëtar. Për më tepër, ky standard gjen mbështetje edhe në të drejtën e brendshme malazeze: në ligjin

[390] "Case Concerning Temple of Preah Vihear (Cambodia v. Thailand). Judgement of 26 May 1961", *ICJ Reports* (1961).

për vetëqeverisjen lokale flitet për mundësinë e mospërputhjes mes gjendjes kadastrale dhe gjendjeve të tjera fizike[391].

Pikë nisëse e Komisionit Meha, siç u pa, ka qenë (keq)interpretimi i tërësishëm i dispozitës së nenit 3.2 të Aneksit VIII [Sektori i Sigurisë në Kosovë] të Planit Ahtisaari, i cili u citua në fillim të këtij shkrimi, të MK-së dhe Kushtetutës së vitit 1974 të KSA të Kosovës. Në faqen 2 dhe 3 të raportit tmerrësisht të shkurtër dhe joserioz të Komisionit Meha (vetëm 14 faqe, me font *Times New Roman* 12-pikësh), flitet për këto dokumente si për parimet dhe bazën ligjore të punës së këtij komisioni[392]. Për më tepër, aty në raport flitet për Komisionin Badinter dhe për mendimet e tij, por të cilat askund nuk shtjellohen. Ka gjasë të madhe që Komisioni as idenë më të vogël nuk e ka pasur për kuptimin dhe rëndësinë e tyre në procesin e caktimit të kufijve në territorin ish-jugosllav. Nga dokumentacioni ligjor i shfrytëzuar si pikë ndarëse e kufirit administrativ mes dy vendeve, qartë shihet se ka shërbyer dokumentacioni i Kosovës së pas vitit 1999, më shumë se dokumentacioni para këtij viti.

Se kjo është kështu shihet qartë nga vetë emërtimi i Komisionit, si dhe nga baza ligjore për punën dhe veprimet e tij. Në hyrje të këtij raporti, prezantuar për publikun kosovar më 3 gusht 2016 për herë të parë, shihet qartë se Komisioni Meha ka probleme për ta qëlluar se çka është shënim i kufirit dhe çka është delimitim (identifikim) i tij. Në hyrje të Raportit, Komisioni Meha flet për "shënjimin e vijës kufitare", pra flet si për një vijë që ekziston diku dhe që dihet se ku është. Ajo mësa duket ekziston vetëm për Komisionin Meha, por jo edhe gjetiu. Si dihet nëse ekziston kjo rrethanë? Kjo rrethanë dihet, sipas Komisionit Meha, meqenëse qenka në Planin Ahtisaari, MK, Kushtetutën e vitit 1974 dhe, për çudi, te mendimet e vetë Komisioni Badint-

---

[391] Se mund të ketë, dhe në fakt çdoherë ka, mospërputhje mes vendbanimeve dhe zonave të tjera dhe gjendjes kadastrale e thotë edhe vetë ligji i Malit të Zi që normon organizimin territorial të Malit të Zi i vitit 2011, i cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e fillimit të procesit të demarkacionit me Malin e Zi në vitin 2012. E kemi fjalën për *Zakon br. 22/11-2/30 o teritorijalnoj organizaciji Crne Gore* të datës 2 nëntor 2011, i cili në paragrafin e fundit të nenit 8 të kapitullit II ["Organizimi territorial"] thotë për sa vijon:

"Nëse kufijtë e vetëqeverisjes lokale nuk përputhen me kufijtë e vendbanimeve, përkatësisht me hapësirat e komunave kadastrale, njësitë e vetëqeverisjes lokale këtë çështje mund ta zgjidhin me marrëveshje ose të njëjtën mund t'ia përcjellin për vendosje arbitrazhit".

[392] Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, Raport për takimin e organizuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 3 gusht 2016. Raporti nuk është nënshkruar nga prof. dr. Murat Meha, si kryetar i Komisionit. Ai mban vulën e Komisionit, numrin "70" dhe datën "3 gusht 2016".

er, të cilat asnjëherë asnjë anëtar i Komisionit nuk i ka parë e as lexuar. Se kjo është kështu shihet nga vetë arsyetimi i raportit të Komisionit Meha dhe qasja e tij në procesin e demarkimit me Malin e Zi. Kështu, ta zëmë, për "shënimin e vijës kufitare", Komisioni Meha flet si për një proces ligjor, teknik dhe politik. Ky proces, në fakt, është vetëm proces teknik dhe asnjëherë ligjor dhe politik. I cilësisë së fundit, procesi i caktimit të kufijve është vetëm gjatë delimitimit (identifikimit). Delimitimin, demarkacionin dhe shënjimin, tri fazat standarde në procesin e caktimit të kufijve mes shteteve, Komisioni Meha i ka shkrirë në një ashtu që tani ai flet për shënjimin e kufirit si për një proces ligjor, në ndërkohë që, në fakt, shënjimi është një proces tërësisht teknik. Komisioni Meha, përmes një procesi teknik, në thelb ka caktuar kufij të rinj të Kosovës, duke e injoruar faktin që për tërë territorin e ish-Jugosllavisë ka pasur një delimitim (identifikim) të kufijve të brendshëm administrativë të njësive federale. Ky delimitim (identifikim), siç u provua më herët, është kryer për herë të parë më 1946. Në ndërkohë që gjetiu ka pasur ndryshim të këtyre vijave të brendshme administrative, në kufirin e Kosovës me Malin e Zi asnjëherë nuk ka pasur ndryshim që nga viti 1946. Ndryshimet territoriale të Kosovës së sotme janë bërë vetëm në drejtim të kufirit me Serbinë, në shumicën prej sektorëve në drejtim të Luginës së Preshevës, por edhe në kufirin verior të Kosovës së sotme. U mor vesh, këto ndryshime me Serbinë kanë ndodhur, siç u theksua më herët, në kohën sa ka ekzistuar ish-Jugosllavia.

Plani Ahtisaari në nenin e tij 3 [Kufijtë] të Aneksit VIII [Siguria] flet për kufijtë e Kosovës në fund të vitit 1988, si bazë për delimitim (identifikim). Një dispozitë e tillë do të kishte kuptim valid vetëm sikur Plani Ahtisaari ta kishte si aneks të vetin një hartë topografike të përmasave 1:50000, e cila si e vetme tregon vijat kufitare delimituese (identifikuese). Plani Ahtisaari asnjëherë në publik nuk e ka pasur si aneks një hartë topografike si bazë ligjore për delimitim. Një aneks të tillë të hartës së përmasave 1:60000 e ka Marrëveshja e Dejtonit e vitit 1995. Ky është standardi ndërkombëtar sipas të cilit hartat kanë vlerë provuese vetëm nëse janë pjesë përbërëse e një marrëveshjeje ndërkombëtare. Në çdo rast tjetër, hartat kanë vetëm vlerë interpretuese. Komisioni Meha nuk i ka marrë fare parasysh hartat topografike të institucioneve relevante ish-jugosllave, siç ka qenë VGI, të cilat sipas ligjit të vitit 1988 kanë qenë kompetente për prodhimin e hartave topografike në nivel federal. Në dokumentacionin e Komisionit Meha fare nuk ka harta topografike të përmasave relevante dhe me baze ligjore si më sipër. Kjo është e papranueshme ligjërisht.

E njëjta vlen edhe për MK-në, e cila nuk ka asnjë relevancë për caktim të kufijve të Kosovës. Jashtë Rezolutës 1244 të KS të OKB-së, MK nuk ka fuqi juridike e cila do të mund të lidhej me çështjen e kufijve. Si e tillë, ajo vetëm ka përcaktuar tërheqjen e forcave ushtarake dhe policore të RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi) e assesi kufijtë e sovranitetit të ri shtetëror — Republikës së Kosovës. Me fjalë të tjera, MK paraqet një dokument juridik që ka pasur vlerë vetëm gjatë kohës së konfliktit të armatosur me RFJ-në dhe udhëhiqet nga dispozitat e së drejtës ndërkombëtare të luftës (e cila sot titullohet si "e drejta ndërkombëtare humanitare"): palë nënshkruese të MK-së janë komandantët ushtarakë. Kjo domethënë se ajo ka pasur vlerë kalimtare juridike vetëm për kohën sa ka zgjatur konflikti i armatosur në Kosovë, si konflikt ndërkombëtar i armatosur. Regjimin juridik të vlerës së MK-së e rregullojnë normat e së drejtës ndërkombëtare zakonore, pjesë e së cilës është e drejta ndërkombëtare humanitare. Kufijtë nuk rregullohen me marrëveshje teknико-ushtarake.

Për herë të parë, parimi/rregulla *uti possidetis* në kontekstin e ndryshimeve territoriale me ndihmën e forcës ushtarake është përdorur në Paqen e Vestfalisë (1648) me të cilën janë mbyllur luftërat 30-vjeçare në Evropë. Objekti dhe qëllimi i parimit/rregullës *uti possidetis* në rastet e fitimeve ushtarake të territorit nuk ka ndryshuar që nga Paqja e Vestfalisë: ngrirja e pozitave dhe e raportit të forcave ushtarake në terren me qëllim që t'i hapet rrugë arritjes së paqes mes palëve ndërluftuese. Për këtë arsye MK ka marrë forcën juridiko-ndërkombëtare të një dokumenti valid ndërkombëtar, por i cili nuk ka efekt juridik territorial, veçse së bashku dhe përmes Rezolutës 1244 të KS të OKB-së dhe, më vonë, përmes Planit Ahtisaari dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në kohë paqe, ai dokument ka shërbyer dhe shërben si bazë juridike për garantimin e ndalimit të operacioneve ushtarake serbe në afërsi të kufijve të Kosovës. Pasojat juridike lidhur me caktimin e kufirit nuk mund të prodhohen për Kosovën, në veçanti jo sa i përket delimitimit (përkufizimit) të territorit kosovar ndaj të tjerëve. Kjo sepse ushtria e KFOR-it nuk ka pasur detyrë që të lëvizë nëpër kufijtë e Kosovës, por zonave të afërta brenda territorit të Kosovës, me qëllim të pengimit të agresionit eventual serb ndaj Kosovës. Se kjo është kështu, pas prezantimit të këtij punimi në debatin e datës 3 gusht 2016 në Kuvendin e Kosovës, e tha ditë më vonë vetë gjenerali britanik Sir Michael David Jackson (Majkëll Dejvid Xhekson). Ky gjeneral

kishte qenë komandanti i parë i KFOR-it në Kosovë dhe njeriu që kishte nënshkruar MK-në[393].

Sipas Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve të vitit 1969, çdo marrëveshje duhet të ketë një objekt dhe një qëllim për t'u dalluar nga tekstet e tjera që nuk janë marrëveshje ndërkombëtare. Si objekt, MK ka pasur dhe ka rregullimin e marrëdhënieve ushtarake mes RFJ-së dhe NATO-s, kurse si qëllim ka pasur dhe ka largimin e forcave ushtarake dhe policore të RFJ-së nga territori i Kosovës. Fjala "territor i Kosovës" në këtë marrëveshje ka vetëm një kuptim: për ta dalluar atë nga territori i Serbisë dhe Malit të Zi (RFJ), që d.m.th. se forcat në fjalë është dashur të tërhiqen nga Kosova menjëherë. Në këtë kuptim, MK nuk mund të shërbejë as si provë indirekte lidhur me përkufizimin e saktë të territorit të Kosovës në kuadër te Rezolutës 1244, e lëre më si bazë juridiko-ndërkombëtare (apo pikë referimi) për demarkim të territorit të Kosovës (sovrane dhe e pavarur që nga 17 shkurti 2008). Këto janë dy çështje krejtësisht të ndara nga aspekti i së drejtës ndërkombëtare. Këtë e dinë të gjithë ata që kanë dije themelore nga e drejta ndërkombëtare publike.

Caktimi i kufijve shtetërorë në rend të parë është çështje e ligjit ndërkombëtar, pastaj e lëmive të tjera teknike. Hera e parë në jetën time që shoh t'i prijë një komisioni për caktim të ri të kufirit shtetëror një inxhinier! Kjo rrethanë lidhet me mandatin dhe me bazën ligjore të Komisionit Meha, i cili ekziston si komision administrativ për shënjim të kufirit, pra duke e marrë si të mirëqenë ekzistimin e një delimitimi të qartë të kufijve të Kosovës me fqinjët, gjë që nuk është rasti (përveç kufijve me Shqipërinë dhe me Maqedoninë, të cilët janë trashëguar, siç u tha, sipas rregullave të ligjit ndërkombëtar mbi trashëgimin e shteteve në lëminë e traktateve ndërkombëtare).

Për dallim nga rastet e tjera në ish-Jugosllavi, ku komisionet për caktim të kufirit kanë pasur mandat të kufizuar dhe janë përbërë kryesisht nga juristë, diplomatë e politologë, në rastin e Kosovës, komisioni ndërshtetëror është themeluar si komision permanent dhe me një natyrë teknike e me mandat formal për shënjim të kufijve ekzistues, duke e marrë si të mirëqenë se kufijtë e Kosovës janë të identifikuar ashtu që tani vetëm duhet të bëhet shënjimi i tyre në terren. Se kjo është kështu shihet qartë nga vetë emërtimi i bazës ligjore që ka formuar Komisionin Meha, si dhe nga vetë emërtimi i tij.

---

[393] "Jackson për Marrëveshjen e Kumanovës: Çështja e kufirit u diskutua vetëm për largimin e serbëve", *Gazeta Blic* (20 shtator 2016).

Neni 40 [Vija Kufitare] të *Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror*, datë 21 dhjetor 2001, flet për "përcaktimin dhe shënimin e vijës kufitare." Ky nen thotë: "Qeveria e Republikës së Kosovës, emëron anëtaret e komisionit shtetëror për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror, te vendosur në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare".

Neni 40 si më sipër ka shërbyer si bazë ligjore për nxjerrjen e *Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 17/2013 për punën e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror*, datë 7 gusht 2013. Neni 1 i Rregullores flet për qëllimet e Komisionit kurse neni 2 për detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit. As në nenin e parë e as në të dytin, sikundër dhe në asnjë dispozitë tjetër të saj, Komisioni nuk mandatohet për të caktuar kufij, por vetëm për të shënjuar kufijtë ekzistues të Kosovës, të cilët, siç e thotë Ligji në nenin 40 si më sipër, janë të vendosur me marrëveshje ndërkombëtare. Pra, neni 40 i Ligjit nuk flet për kufijtë e Kosovës sipas Planit Ahtisaari, MK-së, Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974, apo sipas vlerësimit të Komisionit Badinter.

Vetë baza ligjore e Komisionit, qëllimi i tij, detyrat dhe përgjegjësitë ligjore shumë qartë tregojnë se Komisioni gjatë punës së vet ka tejkaluar mandatin e tij sepse në asnjë rast Komisioni nuk ka mund të caktojë kufij të rinj të Kosovës në drejtim të Malit të Zi. Ai këtë e ka bërë. Mandati i Komisionit ka qenë dhe është i vlefshëm për t'u ekzekutuar vetëm në kufijtë e Kosovës kah Shqipëria dhe Maqedonia, të cilët janë të vendosur me marrëveshje respektive ndërkombëtare, kurse kufijtë e Kosovës me Malin e Zi dhe me Serbinë duhet të vendosen me marrëveshje ndërkombëtare sipas parimit *uti possidetis juris* 1974. Parimi *uti possidetis* 1974 në asnjë rast nuk nënkupton se mund të përmblidhet në një kriter të vetëm dhe përjashtues, siç është kadastra të cilin Komisioni Meha e ka marrë si kriter që është i barabartë me parimin/rregullën *uti possidetis juris* 1974. Kadastra askund në ish-Jugosllavi nuk figuron si kriter i vetëm dhe përjashtues dhe nuk listohet në fillim, por pas hartave topografike të përmasave të caktuara, dhe vetëm atëherë kur këto harta përputhen me hartat kadastrale, gjithnjë krahas dhe pa përjashtuar asnjëherë zbatimin e kriterit të konfiguracionit të terrenit, interesat e qytetarëve lokalë, si dhe kritere të tjera të ngjashme.

Këto kritere me këtë radhitje i gjejmë në të gjitha rregulloret e punës së komisioneve të përziera për kufij të formuara nga ish-republikat jugosllave pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Këto kritere janë zbatuar në ish-Jugosllavi dhe gjetiu nëpër botë në mënyrë kumulative dhe plotësuese me njëri-tjetrin,

jo në mënyrë përjashtuese dhe ekskluzive, siç ka bërë Komisioni Meha krejt arbitrarisht. Përveç praktikës në ish-Jugosllavi, krejt rastet e vendosura nga GjND në lëminë e caktimit të kufijve, si dhe ato të vendosura nga gjykatat e ndryshme të arbitrazhit e vërtetojnë këtë konstatim. Se kjo është kështu u pranua më 3 gusht 2016, në debatin publik, nga njëri prej anëtarëve të Komisionit Meha, juristi Besim Kajtazi. Autori i këtyre rreshtave i kërkoi Komisionit Meha t'i publikonte kriteret juridiko-ndërkombëtare që i ka zbatuar gjatë punës me malazezët. Besim Kajtazi, në përgjigjen e vet në emër të Komisionit Meha, lexoi nenin e dytë të Rregullores për Punën e Përbashkët të Komisionit të Kosovës dhe Malit të Zi, komision që ndërkombëtarisht cilësohet si "komisioni për kufij", gjë që është krejtësisht tjetër nga emërtimi i Komisionit Meha sipas ligjeve tona në fuqi. Ai nen, sipas gojës së vetë z. Kajtazi, përmend në rend të parë hartat topografike dhe konfiguracionin e terrenit si kritere të cilat është dashur të përdoren si bazë për caktimin e kufirit me Malin e Zi, pra si kritere që vetë Komisioni Meha i ka pranuar në fillim të punës me malazezët. Vetëm pas këtyre dy kritereve, nga vetë goja e të njëjtin anëtar të Komisionit Meha, u përmend kadastra si kriter që po ashtu është dashur të merret parasysh. Rregullorja është miratuar nga dy palët në takimin e datave 25 dhe 26 mars 2013, mbajtur në Podgoricë, mirëpo asnjëherë nuk është bërë publik për opinionin kosovar. Disa herë ky autor ka kërkuar nga organet qeveritare gjatë pranverës 2016 që ta bëjnë publik këtë dokument, por nuk ka arritur asgjë. I vetmi burim për ekzistimin e këtij dokumenti, i cili ka qenë teksti kryesor ligjor dhe baza kryesore ligjore në planin ndërkombëtar për punën trevjeçare të Komisionit Meha, ka qenë procesverbali i Qeverisë së Malit të Zi i prillit 2015[394].

Neni i sipërcituar i Rregullores, i cili përmban kriteret bazë për caktimin e kufijve, nuk është asgjë pos një formulim standard juridiko-ndërkombëtar që gjendet edhe në rregulloret e ngjashme të përpiluara nga ish-republikat jugosllave me rastin e caktimit të kufijve ndërmjet veti. Nga ai formulim, siç u pa nga rastet e rregulloreve të tilla të cituara më sipër që kanë të bëjnë me

[394] Ky procesverbal është nxjerrë në internet nga Qeveria e Malit të Zi, me sa duket, pa dijen e palës kosovare. Se kjo është kështu shihet nga fakti se pala jonë asnjëherë nuk ka folur në publik për këtë material dhe nuk e ka kontestuar. Për më tepër, e as që iu ka referuar ndonjëherë. Si për çudi, materiali në fjalë mban shenjën "*interno*", që d.m.th. për përdorim të brendshëm, ani se është bërë publik në internet që nga prilli i vitit 2015. Cf. Vlada Crne Gore, Ministarstvo unutrašnjih poslova, *Izveštaj o vodjenju pregovora na pripremama za zaključivanje Sporazuma o državnoj granici izmedju Crne Gore i Republike Kosovo* (Podgorica, april 2015).

punën e komisioneve të përbashkëta mes Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë si dhe mes RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi) dhe Maqedonisë për kufirin në drejtim të Kosovës, dalin dy gjëra me rëndësi. E para, ai dokument flet për kriteret bazë të cilat duhet përdorur me rastin e caktimit të kufijve ndërmjet shteteve, ku hartat topografike të përmasave të caktuara shërbejnë si pikë nisëse e çdo pune rreth caktimit të kufijve. Kriteri i hartave topografike, ani se i pari në listë, nuk është i vetmi dhe nuk është përjashtues, por përdoret krahas kritereve të tjera standarde të së drejtës ndërkombëtare, ku kadastra luan një rol të rëndësishëm. Së dyti, këto rregullore, si dhe formulimet e tyre për sa i takon zbatimit të kritereve standarde për caktimin e kufijve, i referohen një gjendjeje që për qëllim të vetëm ka caktimin e kufijve. Ky proces, çdoherë dhe kudo, përkatësisht në të gjitha rastet e caktimit të kufijve ndërmjet shteteve të reja sovrane dhe të pavarura, ka përfshirë dy faza.

Faza e parë ka të bëjë me delimitimin (identifikimin) e kufirit apo të kursit/drejtimit të lëvizjes së vijave të mëparshme administrative, kurse e dyta ka të bëjë me përdorimin e kritereve standardeve ndërkombëtare me qëllim që kufiri i ri i delimituar (identifikuar) si vijë që ndan dy sovranitete të reja shtetërore të vihet në terren dhe në harta të reja topografike të përmasave të caktuara, harta të cilat më pastaj, zakonisht, ngelin pjesë përbërëse e marrëveshjes së re ndërkombëtare për kufij. Këto harta të reja topografike, pra, janë rezultat i një pune të re të komisioneve të përbashkëta ndërshtetërore për caktim të kufijve, proces që duhet të kalojë nëpër këto dy faza, që nuk është bërë nga ana e Komisionit Meha, ani se e kanë pasur detyrim ligjor sipas së drejtës ndërkombëtare, gjë e cila ka qenë e sanksionuar edhe në vetë Rregulloren e Punës, e cekur si më sipër, e cila është miratuar në Podgoricë nga ana e dy komisioneve.

Baza juridike e Komisionit Meha, siç u pa nga Ligji nr. 04/L-072 dhe nga Rregullorja e Qeverisë nr. 17/2013, është në tërësi tjetërfare nga normat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare për caktimin e kufijve dhe nga praktika e ndjekur në tërë territorin e ish-Jugosllavisë dhe gjetiu nëpër botë. Sipas neneve që u përfolën më sipër, del qartë se Komisioni Meha në praktikë paraqet një komision administrativ të natyrës së përkohshme me mandat trevjeçar. Asnjë dispozitë e këtyre dy dokumenteve juridike nuk flet për caktim të kufijve, por për shënjimin dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistues të vendosur me marrëveshje ndërkombëtare të lidhura nga ana e Kosovës me fqinjët e saj. Atëherë shtrohet pyetja: pse Komisioni Meha i ka caktuar kuotat e reja dhe pse ka bërë përshkrimin e ri? Kufiri i Kosovës sipas parimit/rregullës *uti possidetis juris* 1974 nënkupton se Kosova ka pasur kufij ad-

ministrativë sipas kuotave të caktuara dhe ka pasur një përshkrim të atij kufiri që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. Se kjo është kështu qartë shihet nga hartat topografike dhe gjeografike të madhësive të caktuara që janë prodhuar me mijëra gjatë kohës së ish-Jugosllavisë. E njëjta situatë ka qenë edhe me ish-republikat e tjera jugosllave sepse ato harta (topografike dhe gjeografike) kanë pasur bazë të qartë kushtetuese dhe ligjore të kohës së tyre. Delimitimi (identifikimi) i kufirit administrativ të Kosovës me fqinjët në rend të parë nënkupton përdorimin e hartave topografike dhe të hartave e hartografisë tjetër me bazë kushtetuese dhe ligjore nga koha e ish-Jugosllavisë. Ndarja e parë administrative e Kosovës së sotme në drejtim të Malit të Zi ka ndodhur pas Luftës së Dytë Botërore nga i a.q. Komisioni Gjillas. Ky komision, i emërtuar sipas nënkryetarit komunist të ish-Jugosllavisë, malazezit Millovan Gjillas (Milovan Djilas), në vitin 1946 ka bërë delimitimin ndërmjet të gjitha ish-republikave jugosllave, përfshirë këtu Serbinë, pjesë e së cilës në atë kohë ka qenë edhe Kosova. Identiteti territorial i Kosovës së asaj kohe dallon me identitetin aktual vetëm sa i përket kufirit të Kosovës me Serbinë ku ka pasur disa ndryshime territoriale kah Lugina e Preshevës dhe në veri të Kosovës, të cilat u përmendën më herët në këtë punim. Me këtë, Komisioni ka tejkaluar mandatin e vet sepse ai mandat ka qenë krejt administrativo-teknik. Nuk ka qenë në mandatin e Komisionit injorimi i përkufizimit (delimitimit) verbal dhe gjeografik të kufirit të Kosovës me Malin e Zi, i cili, siç u tha, ka qenë i pandryshuar nga viti 1946 e deri më sot.

Sa i përket drejtimit të kufirit të Kosovës me Malin e Zi, sipas Komisionit Gjillas, nuk ka pasur asnjë ndryshim: në raportin e Komisionit Gjillas del se vetëm malet Vaganica kanë qenë kontestuese mes palëve pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Kjo nënkupton se hartat topografike dhe hartat e tjera të çdo kohe të prodhuara nga organet kompetente kushtetuese e ligjore ne ish-Jugosllavi ka qenë dashur të jenë baza fillestare e punës së Komisionit Meha. Vetëm më pastaj, sipas enumeracionit negativ, i cili nënkupton se ajo pjesë e territorit që nuk përmendet si kontestues në Komisionin Gjillas i takon Kosovës, Komisioni Meha është dashur të përdorë kriteret e tjera e jo të mbështetet ekskluzivisht në kadastra të stërvjetruara të banovinës Zeta të para-Luftës së Dytë Botërore. Në materialin e Komisionit Meha flitet për dokumentacionin të cilin Komisioni e ka trajtuar me rastin e përcaktimit të kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Në fakt, kështu titullohet i tërë dokumentit përfundimtar të Komisionit Meha dorëzuar Qeverisë së Kosovës për miratim. Sikundër vërehet, titulli i punës së prodhuar, "Dokumentacioni i trajtuar për përcaktimin e kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të

Zi", si dhe baza juridike e Komisionit, sipas Ligjit nr. 04/L-072 dhe Rregullores së Qeverisë nr. 17/2013, janë dy gjëra tërësisht të ndryshme. Përveç që janë neglizhuar kriteret standarde të së drejtës ndërkombëtare në çështjet e caktimit të kufijve, këtu ka pasur neglizhim total edhe të parimeve të tjera aq të rëndësishme të kësaj lëmie. Ndër to hyn edhe parimi *ekité* (ang. *equity*; fr. *équité*).

Sërish duhet ta përsërisim se, në pjesën dërrmuese të caktimit të kufijve të shteteve të reja pas fitimit të pavarësisë, të cilat janë gjykuar deri më sot nga gjykata e arbitrazhe ndërkombëtare, zbatimi i parimit/rregullës *uti possidetis juris* ka pësuar ndryshime dhe korrigjime dhe është zbatuar së bashku ose krahas me kriteret e tjera, siç janë: konfiguracioni i terrenit, interesat e popullsisë lokale, interesat ekonomike të zonës si tërësi, statusi i posedimit (me mirëbesim apo me keqbesim) në të kaluarën para caktimit definitiv të kufirit administrativ si kufi ndërkombëtar etj. Krahas këtyre, ekzistojnë edhe kritere shtesë në të drejtën ndërkombëtare mbi caktimin e kufijve. Këto kritere shtesë njihen si rregulla e ekitesë, e cila ka kuptimin e zbatimit të ligjit ndërkombëtar *me drejtësi dhe me ndershmëri.* Më konkretisht, kjo do të thotë se, sado që parimi/rregulla *uti possidetis juris* i jep njërës palë një të drejtë të caktuar, zbatimi i tij në praktikë duhet të korrigjohet dhe të ndryshojë përmes zbatimit të kritereve të tjera si më sipër, sepse çdo zbatim i ngurtë i *uti possidetis juris* do të shkaktonte padrejtësi të madhe për palën tjetër. Ndër shumë precedentë nga gjykatat dhe nga arbitrazhet ndërkombëtare të këtij lloji, rasti i vitit 1933 ndërmjet Guatemalës dhe Nikaraguas[395], gjykuar nga një arbitrazh ndërkombëtar, vlen të përmendet në mënyrë specifike, pa përjashtuar asnjëherë rastet e sipërcekura ku GjND-ja qartë ka bërë shmangie nga zbatimi rigjid i parimit/rregullës *uti possidetis juris,* duke e zbutur përmes zbatimit të parimit të ekitesë: zbatimi i parimit të *drejtësisë me ndershmëri.* Jo vetëm kaq! Gati pa përjashtim, marrëveshjet për caktim të kufijve kanë pasur klauzolat mbi zgjidhjen me arbitrazh të kontesteve kufitare, duke zbatuar *parimin e drejtësisë me ndershmëri* (parimi i ekitesë). Këto marrëveshje, të lidhura kryesisht ndërmjet vendeve të Amerikës Latine gjatë shekujve XIX dhe

[395] Konflikti i gjatë mes Guatemalës dhe Hondurasit përfundimisht është zgjedhur me një vendim arbitrazhi të datës 23 janar 1933 të nënshkruar në Uashington nga ana e anëtarëve të Tribunalit Special të Arbitrazhit, të emëruar mbi bazën e Marrëveshjes për Arbitrazh të nënshkruar nga ana e dy vendeve më 16 korrik 1930. Cf. më shumë për këtë në punimin e shkelqyer "The Guatemala-Honduras Boundary", *Geographical Review* vol. 23, no. 2 (1933) fq. 306-309; në rrjet: http://www.jstor.org/stable/209082 (shikuar së mbrami më 27 tetor 2016).

XX, kanë pasur emërtimet të ndryshme, siç janë: marrëveshjet e miqësisë, të aleancave dhe të fqinjësisë së mirë etj.

Përveç kritereve të tjera korrigjuese dhe zbutëse të parimit/rregullës tanimë të njohur si *uti possidetis juris*, ekziston edhe një tjetër kriter që është zbatuar në rastet e ndryshme. Ai quhet parimi/rregulla *effectivité.* Parimi i efektivitetit, apo i posedimit efektiv me mirëbesim (*bona fide*) të një pjese të territorit tokësor nga ana e njërës palë më shumë dhe më gjatë se pala tjetër, po ashtu nuk është marrë parasysh nga Komisioni Meha, i cili është mbështetur ekskluzivisht dhe në mënyrë përjashtuese vetëm në gjendjen kadastrale. Me këtë qasje, Komisioni Meha e ka barazuar *uti possidetis juris 1974* me gjendjen kadastrale të Kosovës në momentin e pavarësimit të saj më 17 shkurt 2008.

Si rast ekzemplar që vërteton rëndësinë e këtij precedenti, i cili konsiston në zbatimin e kriterit *effectivité* si kriter shtesë, është verdikti i vitit 2002 i Komisionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi delimitimin dhe demarkacionin ndërmjet Etiopisë dhe Eritresë[396]. Edhe rastet e tjera të cituara në këtë shkrim mbështeten në këtë kriter. Parimi i *effectivité* si më sipër është zbatuar për korrektim të parimit *uti possidetis juris*, si para fitimit të pavarësisë *de jure* të Eritresë më 1993, ashtu edhe pas këtij viti[397].

Këtë qasje të GjND-së dhe të arbitrazheve ndërkombëtare, me rastin e gjykimit dhe të vendosjes për çështjen e kontesteve kufitare, e gjejmë edhe në shumë raste të tjera që mund të citohen me bollëk.

Nga sa më sipër del se *titulli juridik*, i fituar nëpërmjet zbatimit të parimit/rregullës *uti possidetis juris*, nuk ka qenë çdo herë kriteri i vetëm përcaktues i kufijve ndërkombëtarë ndërmjet shteteve. Në fakt, rrallëherë ka qenë i tillë.

Në rastin e Kosovës, sipas interpretimit tërësisht të gabuar të Komisionit Meha të parimit/rregullës *uti possidetis juris*, *titulli juridik* caktohet sipas gjendjes së panjohur kadastrale, infrastrukturës së panjohur juridike të ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK), si dhe të infrastrukturës po ashtu të panjohur ligjore në nivel lokal në dy anët e kufirit Kosovë–Mal i

---

[396] Cf. Eritrea-Ethiopia Boundary Commission, "Decision Regarding Delimitation of the Border Between the State of Eritrea and the Federal Democratic Republic of Ethiopia of 13 April 2002", *Reports of International Arbitral Awards* vol XXV, fq. 83-195.

[397] Për rastin konkret, por edhe zbatimin e parimit/rregullës *effectivité* në rastet e tjera, cf. më shumë në Giovanni Distefano, "The Conceptualizaion (Construction) of Territrial Title in the Light of the International Court of Justice Case Law", *Leiden Journal of International Law* vol. 19, issue 4 (2006) fq. 1041-1075, në veçanti në fq. 1067-1075.

Zi. Këto tri lloje të dokumentacionit "juridik" kanë vetëm vlerë provuese të thyeshme, pra vlerë që mund të rrëzohet me prova e kritere të tjera. Kjo nënkupton se këto prova nuk janë përfundimtare, sepse të tilla nuk kanë qenë as në pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë. Fundja, të tilla nuk kanë qenë edhe në rastet kur si titull kanë qenë marrëveshjet ndërkombëtare për delimitim (identifikim), si në Amerikën Latine pas vitit 1821, ashtu dhe në Afrikë pas vitit 1955 kur ka filluar dekolonizimi i saj. Pra, nuk kanë qenë kurrë përfundimtare edhe në rastet kur në vend të kadastrave apo krahas tyre kanë ekzistuar edhe marrëveshje ndërkombëtare për caktimin e kufijve ndërmjet shteteve.

Me Maqedoninë, siç u tha më lart, Kosova ka rregulluar kufirin, sepse ka respektuar një detyrim ndërkombëtar, duke trashëguar si shtet i ri marrëveshjen e lidhur ndërmjet Republikës Federative të Jugosllavisë (Serbia e Mali i Zi) dhe Maqedonisë, në shkurt të vitit 2001. Ky trashëgim është konform nenit 11 të Konventës së Vjenës mbi Trashëgimin e Shteteve ndaj Traktateve Ndërkombëtare (1978).[398] Ky nen, në fakt, paraqet normë zakonore ndërkombëtare. E njëjta vlen në tërësi edhe për sa i takon kufirit të Kosovës me Republikën e Shqipërisë.

Në rastin e kufirit me Malin e Zi nuk mund të përdoret si kriter i vetëm *titulli juridik* që bazohet në gjendjen kadastrale, pra vetëm në *uti possidetis juris* bazuar në kadastër, në infrastrukturën ligjore të ish-KSAK, si dhe në infrastrukturën ligjore të nivelit lokal në dy anët e kufirit kontestues Kosovë–Mal i Zi. Kjo do të thotë se duhet të përdoren edhe kritere të tjera zbutëse që përbëjnë thelbin e rregullës ndërkombëtare të ekitesë, përkatësisht të zbatimit të rregullës së *drejtësisë me ndershmëri*, siç ka ndodhur në të katër anët e botës që nga vitit 1821 e deri më sot. Kjo mund të ndodhë vetëm nëpërmjet formimit të një arbitrazhi *ad hoc* për caktimin e kufirit tokësor Kosovë–Mal i Zi (më tej shkurt: "arbitrazhi *ad hoc*"). Kjo për faktin se Komisioni Meha ka futur Kosovën në një detyrim ndërkombëtar që thotë, sipas zakonit ndërkombëtar, se detyrimet e marra duhet të ekzekutohen *bona fide* (me mirëbesim). Kjo më tutje do të thotë se Kosova humb shumë nga imazhi i saj nëse nuk jep arsye të forta për të mohuar ratifikimin e draft-marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi të 25 gushtit 2015, të prodhuar nga Komisioni Meha. Duhet që me mirëbesim t'u sqarojmë miqve tanë ndërkombëtarë se ky

---

[398] Neni 11 [Regjimet Kufitare] i Konventës:

"Trashëgimi (suksedimi) i shteteve nuk prek:

"(a) kufirin e krijuar me marrëveshje; dhe

"(b) të drejtat dhe detyrimet e krijuara me marrëveshje, të cilat kanë të bëjnë me regjimin kufitar."

draft cenon rëndë dinjitetin shtetëror të Kosovës dhe interesat e saj nacionalë. Kjo bëhet vetëm duke ndjekur arsyetimin dhe argumentimin tërësisht profesional nga lëmi i caktimit të kufijve në drejtën ndërkombëtare.

Kosova e Mali i Zi duhet që, për këtë qëllim, me ndërmjetësimin e BE-së dhe të ShBA-së, të lidhin një marrëveshje speciale që do të përcaktonte numrin e arbitrave dhe ligjin e aplikueshëm për rastin konkret (më tej shkurt: "marrëveshja për arbitrazhin *ad hoc*"). E drejta që duhet të propozohet nga ana e kosovarëve si e aplikueshme për caktimin e kufirit me Malin e Zi duhet të jetë ajo e drejtë ndërkombëtare që është zbatuar në shumicën dërrmuese të rasteve deri më sot, përgjatë dy shekujve të kaluar — parimi/rregulla e ekitesë, përkatësisht zbatimi i *drejtësisë me ndershmëri* ndaj gjendjes aktuale kadastrale të Kosovës me Malin e Zi. Kjo duhet të ndodhë gjithnjë krahas zbatimit të kritereve standarde të së drejtës ndërkombëtare në lëminë e caktimit të kufijve ndërmjet shteteve. Njëjtë si në rastin e vendosur nga GjND në kontestin kufitar mes Burkina-Fasos e Nigerit më 2013, pala kosovare duhet ta bëjë të qartë se puna e Komisionit Meha ka qenë gabim dhe nuk mund të merret parasysh nga ana e arbitrave *ad hoc* në të ardhmen kur të vendoset çështja e kufirit mes dy vendeve[399]. Vendimi i arbitrazhit do të ishte i detyrueshëm për palët, kurse marrëveshja speciale për themelimin e arbitrazhit *ad hoc* do të duhej t'i nënshtrohej ratifikimit nga ana e parlamenteve të dy vendeve.

Nëse sot nuk bëhet formimi i arbitrazhit me Malin e Zi, së paku duhet që tani të bëhemi gati për Serbinë dhe të mos lejojmë zbatimin e këtij precedenti edhe me Serbinë, sepse aty ka një kufi mbi 300 kilometra të gjatë, që jo vetëm se është poroz, por gjendja kadastrale andej është thuajse joekzistuese. Kjo për faktin se serbët, jo kosovarët, kanë pasur kontroll efektiv të këtyre dokumenteve në origjinal. Ndërhyrjet e përditshme të xhandarmërisë serbe, në emër të sovranitetit serb, në fshatin Karaçevë të Kamenicës, në lindje të Kosovës, janë vetëm maja e ajsbergut e asaj që mund të vijë në të ardhmen: i tërë kufiri verilindor i Kosovës mund të pësojë ndryshime në dëm të Kosovës. Për të mos ndodhur kjo, duhet që puna e Komisionit Meha të vihet nën kontroll të atyre që flasin në emër të sovranit — Kuvendit të Kosovës. Kontrolli i punës nga organi përfaqësues, caktimi i një mandati të qartë, përfshirë këtu dhe resurset dhe kohën e kryerjes së mandatit të Komisionit Meha përbëjnë një

[399] Njëjtë ka ndodhur edhe me kërkesën e Nigerit, e cila është refuzuar nga GjND. Nigeri pati kërkuar të merret parasysh puna e mëparshme për demarkim, e kryer më 2009, e cila në tërësi ka qenë në favor të këtij vendi. Shih më shumë në "Frontier Dispute (Burkina Faso/Niger): Judgement of 16 April 2013", *ICJ Reports* (2013) paragrafët 35-38.

kusht të domosdoshëm për suksesin e demarkacionit të kufijve të Kosovës, jo vetëm me Malin e Zi, por edhe me fqinjin tonë verior në të ardhmen.

Përfundim

Caktimi i kufijve të shteteve të reja përbën një proces mjaft delikat dhe, jo rrallë, shoqërohet me probleme deri në konflikte të armatosura mes shteteve. Intensiteti i konflikteve për kufij varet nga faktorë të ndryshëm, siç janë faktorët gjeopolitikë, natyra e regjimeve shtetërore, natyra e kontestit, pra a është kontest për vijat kufitare apo për titullin juridik të madhësive të mëdha të territorit shtetëror, e kështu me radhë.

Në çdo caktim të kufijve mes shteteve ka tri faza: delimitimi i kufirit, apo definimi i tij me qëllim të identifikimit të pikave kryesore të drejtimit të lëvizjes së kufirit, demarkacioni, apo vënia në jetë e kufirit të delimituar dhe, faza e fundit, vënia e shenjave teknike në terren dhe mirëmbajtja e tyre.

Këto tri faza, sado që mund të duken teorike në thelb janë të një rëndësie të jashtëzakonshme. Kjo për faktin se përmbajtja e tyre ndryshon. Kjo u pa në mënyrë të veçantë gjatë procesit të caktimit të kufijve mes vendeve të dala nga shpërbërja e ish-federatave komuniste (BRSS, Çekosllovakia dhe Jugosllavia). Ata që nuk i njohën gjërat bazike të caktimit të kufijve, proces që në rend të parë është juridik dhe politike e vetëm më pastaj një proces teknik, bënë gabime të rënda sepse ngatërruan demarkacionin (shënjimin e kufirit) me delimitimin (definimin dhe identifikimin e kursit/drejtimit të përgjithshëm të lëvizjes së vijës kufitare). Të tillë janë edhe anëtarët e Komisionit Meha, të cilët në punën e tyre prodhuan një draft-marrëveshje, Marrëveshjen e 25 gushtit 2015, e cila në tërësi i kushtetohet demarkacionit, në ndërkohë që në përmbajtje paraqet dokument me të cilin synohet caktimi i kufijve të rinj të Kosovës. Pse ka ndodhur ky ngatërrim?

Kur u shpërbënë ish-federatat komuniste, shtete e reja dhe sovrane, që lindën nga ky proces i shpërbërjes, përdorën gjerësisht kadastrat si kritere të caktimit të kufijve të tyre. Kjo ndodhi si pasojë logjike e prezumimit (të rrëzueshëm) që shtete që kanë jetuar nën kulmin e një pushteti shtetëror të përbashkët, nuk duhet të kenë shumë probleme me posedimet e patundshmërive. Ky supozim, megjithatë, nuk ka qenë absolut ashtu që krahas (së bashku dhe në mënyrë kumulative) me kadastrat janë përdorur edhe hartat topografike dhe gjeografike të përpjesëtimeve të caktuara të prodhuara nga autoritetet kompetente sipas kushtetutës dhe ligjit në kohën sa kanë ekzistuar këto fe-

derata komuniste. Në të gjitha ish-federatat komuniste, përdorimi i kadastrave ka prodhuar probleme në procesin e caktimit të kufijve shtetërorë ashtu që mesatarisht rreth pesë për qind e sektorëve të vijave kufitare kanë ngelur të kontestuar mes palëve. Jugosllavia nuk paraqet përjashtim në këtë aspekt.

Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, më 1946, në tërë territorin e ish-Jugosllavisë ka ndodhur një përkufizim i territoreve mes ish-njësive federale të Jugosllavisë. Kosova në atë kohë dhe deri më 1974 ka qenë pjesë përbërëse e Republikës së Serbisë. Në fakt, në aspektin kushtetues dhe juridik, Kosova ka qenë e tillë edhe pas vitit 1974. Ajo çfarë duam të tregojmë këtu dhe që ka relevancë të madhe është se vetëm pas vitit 1974 Kosova ka fituar identitetin e qartë territorial, njëjtë si dhe ish-njësitë e tjera federale sepse territori i Kosovës nuk është përcaktuar sipas Kushtetutës së vitit 1974 të ish-RSFJ-së si territor i Republikës së Serbisë.

Kufiri i Kosovës në drejtim të Malit të Zi, siç shihet nga dokumentacioni dhe burimet e tjera të Komisionit Gjillas mbi delimitimin e vitit 1946, nuk ka pësuar asnjë ndryshim deri në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë. Shpërbërja e ish-Jugosllavisë më 1992 ka rëndësi të madhe sepse paraqet pikën kryesore të referimit në caktimin e kufijve të Kosovës me fqinjët sipas parimit *uti posidetis* 1974. Kjo është konfirmuar edhe me Planin Ahtisaari të marsit 2007. Në kuptimin e ngushtë të fjalës, zbatimit i parimit *uti possidetis* 1974 ndaj Kosovës paraqitet si problematik sepse "momenti kritik" në trashëgimin e shteteve në sferën e kufijve shtetërorë paraqitet momenti i deklarimit të pavarësisë. Përveç këtij momenti, si "momente kritike" mund të paraqitet edhe momentet e lidhjes së marrëveshjeve të paqes dhe hyrjes së tyre në fuqi, momenti i nxjerrjes së ndonjë vendimi gjyqësor apo arbitror, si dhe momentet e nxjerrjes së vendimeve të tjera që kanë relevancë për kufijtë me vullnetin e palëve. Në rastin e Kosovës, nuk ka "moment kritik" përveç momentit të shpalljes së pavarësisë, por jo të pavarësisë së Kosovës, po të vendeve fqinje, sepse ato të parat kanë trashëguar vijat kufitare në drejtim të Kosovës, e vetëm më pastaj Kosova. Mbi bazën e kësaj, Kosova ka trashëguar Marrëveshjen për kufij të lidhur me 2001 mes RFJ-së dhe Maqedonisë, si dhe regjimin kufitar të Kosovës me Shqipërinë të vendosur pas Luftës së Parë Botërore. Kjo nënkupton se Kosova do të kishte qenë e detyruar për të trashëguar secilin ndryshim eventual territorial të kryer para "momentit kritik" të shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008. Në drejtim të Malit të Zi, mësa duket, asnjëherë nuk ka pasur ndryshime të kursi/drejtimit të vijës kufitare të kryer me delimitimin e vitit 1946. Ky konstatim, megjithatë, mungon në raportin e Komisionit Meha.

Kjo mungesë, sado që mund të duket formale dhe e parëndësishme, ka shumë peshë, sepse me këtë tregohet që Komisioni Meha nuk ka qenë i vetëdijshëm për këtë rrethanë dhe, në vend se të identifikojë se cili ka qenë kursi/drejtimi i vijës kufitare me Malin e Zi, ai ka marrë si të mirëqenë se dokumentacioni kadastral mund të shërbejë si provë e pathyeshme e delimitimit të Kosovës me Malin e Zi. Mbështetja e tillë e Komisionit Meha vetëm në gjendjen kadastrale të ofruar kryesisht nga pala malazeze ka rezultuar në shkrirjen e delimitimit në fazën e demarkacionit dhe njëjtësimin e delimitimit me demarkacionit. Po të ishte nisur Komisioni Meha nga delimitimi i vitit 1946 dhe hartat topografike dhe gjeografike të prodhuara gjatë ish-Jugosllavisë atëherë gjendja do të kishte qenë në tërësi ndryshe, sepse vlera provuese e kadastrës do të ishte matur krahas me hartat topografike dhe hartat gjeografike, si dhe krahas dhe së bashku me kriteret standarde të së drejtës ndërkombëtare për caktimin e kufijve. Kriteret standarde, por edhe hartat e dokumentacioni tjetër hartografik kanë vlerë provuese të njëjtë, kurse dallimi në vlerën e tyre provuese ndryshon nën vartësi të rrethanave të secilit rast konkret. Këtë fakt nuk e ka pasur parasysh Komisioni Meha, sepse i ka dhënë vlerë absolute provuese kadastrës, duke injoruar në tërësi kriteret e tjera si më sipër. Angazhimi i këtyre kritereve me siguri se do të kishte sjellë një rezultat tjetër shumë më të favorshëm për Kosovën. Nëse çështja kalon në arbitrazh, gjë e cila më së miri do të ishte për Kosovën, krejt me siguri që do të ndodhë angazhimi i kritereve të tjera për caktimin e kufijve të Kosovës me Malin e Zi, në mënyrë shumë më të mirë dhe më ndryshe se që e ka bërë Komisioni Meha.

Kapitulli IV

MBI NOCIONIN SHTET, NACIONALIZMIN SERB DHE ASOCIACIONIN E KOMUNAVE, NGA PERSPEKTIVA KUSHTETUESE DHE NDËRKOMBËTARE

Sfondi historik: Gjatë studimeve të doktoratës (1998-2001), ndërsa punoja si asistent hulumtues, në departamentin e marrëdhënieve ndërkombëtare të Universitetit Bilkent të Ankarasë, na kërkohej të botonim së paku një punim me recension ndërkombëtar në lëmin e studimeve. Unë zgjodha revistën *Perceptions*, ku botova në vijim dy punime, të cilat riprodukohen në këtë libër. I pari u titullua "Refleksione mbi nacionalizmin serb dhe politikën e pastrimit etnik"[400], kurse i dyti "'Muri i Jashtëm' i sanksioneve dhe çështja e Kosovës"[401]. Dy shkrimet përbëjnë një tërësi organike sepse trajtojnë dy aspekte të krizës së Kosovës dhe rolin e serbëve dhe nacionalizmit të tyre në këtë krizë, si në të kaluarën ashtu dhe aktualisht. Megjithatë, shkrimi lidhur me të a.q. "mur i jashtëm i sanksioneve" jepet në kapitullin V të këtij libri, sepse lidhet më shumë më përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare në tërësi për të gjunjëzuar regjimin e diktatorit serb Sllobodan Millosheviq pas arritjes së Marrëveshjes së Dejtonit në nëntor 1995, më të cilin u ndal lufta dhe tragjedia në Bosnjë-Hercegovinë. Krahas kësaj, edhe themelimi i Gjykatës së Hagës për krimet e kryera në ish-Jugosllavi dhe shtrirja e juridiksionit të saj në Kosovë pasi nisi lufta në fillim të 1998-s, sikur e bëri më të pranueshëm riprodhimin dhe trajtimin e shkrimit për të a.q. "muri i jashtëm i sanksioneve" në kapitullin që flet për Gjykatën e Hagës dhe krimet e luftës. Në të njëjtën kohë, i natyrshëm del edhe riprodhimi i shkrimit mbi nacionalizmin serb dhe politikën e tyre të pastrimit etnik në kuadër të kapitullit IV. Ky shkrim flet për nocionin shtet në të drejtën ndërkombëtare dhe dallimin që ky nocion ka me shtetin në të drejtën e brendshme.

---

[400] Enver Hasani, "Reflections on Serbian Nationalism and the Policy of Ethnic Cleansing", *Perceptions* vol. IV, no. 4 (December 1999/February 2000). Versioni shqip, pak më i ndryshëm, i këtij shkrimi u botua në të përditshmen *Rilindja*, botimi i Tiranës, me vazhdime nga data 31 janar deri më 7 shkurt 1998.

[401] Enver Hasani, "The 'Outer Wall' of Sanctions and the Kosovo Issue", *Perceptions* vol. III, no. 3 (September/November 1998).

Në ndërkohë që shkrimi për shtetin sipas së drejtës ndërkombëtare dhe dallimin me të drejtën e brendshme prek çështjet bazike të konceptit shtet, punimi në vijim — lidhur me natyrën e nacionalizmit serb, politikën shekullore të pastrimit etnik dhe të shkatërrimit të kulturave joserbe — diskuton anën socio-politike dhe kulturore të shtetit siç e kanë kuptuar serbët përgjatë historisë.

Kur mbaroi Lufta e Ftohtë, në marrëdhëniet ndërkombëtare u shfaqën akterë që me herët nuk ishin parë. Në kohën sa zgjati Lufta e Ftohtë, akterët kryesor të marrëdhënieve ndërkombëtarë ngelën shtetet, në kuptimin e tyre klasik apo, siç thuhet në Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, në kuptimin vestfalian[402]. Me mbarimin e kësaj kohe, dhe rrënimin e komunizmit si sistem global që kishte sunduar gati dy të tretat e botës, vakumi i ngelur prapa u plotësua nga fenomene dhe akterë të paparë deri atëherë: lëvizjet e popujve të shtypur, e rrymave politike fetare; organizata paramilitare, të cilat në tërësi vepronin sikur shoqëritë e organizuara në shtet me forcë për të kryer krimet më monstruoze që bota i kishte parë herën e fundit vetëm gjatë Luftës së Dytë Botërore; luftërat civile të bazuara kryesisht në dallimet etnike brenda shteteve ekzistuese, dhe kështu me radhë. Në Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare u paraqitën lloj-lloj autorësh me lloj-lloj teorish, nga ata që theksonin se multilateralizmi në të cilin kishte hyrë bota pas bipolaritetit kërkonte riarmatimin e sërishëm të Gjermanisë dhe Japonisë për të ruajtur balancin e ri të forcave[403], e deri te të tjerët që, në tërë kaosin dhe konfliktet fetare, etnike dhe konfliktet e tjera që po ndodhnin pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, shihnin rikthimin e kulturës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Sipas këtyre autorëve të fundit, të cilët synonin të shpjegonin konfliktin ndërkombëtar, konflikti ravijëzohej *grosso modo* si një konflikt Lindje-Perëndim (në kuptimin kulturor)[404]. Ka pasur edhe autorë të tjerë të cilët thanë se me rëni-

---

[402] Për një analizë të shkëlqyer teorike të praktikës së Luftës së Ftohtë, cf. më shumë në John Lewis Gaddis, *The Cold War: A New History* (Penguin Books: London, 2006). Për mënyrën si filloi Lufta e Ftohtë dhe shkaqet e saj, cf. më shumë në Anne Appelbaum, *Iron Curtain: The Crushing of Eastern Europe, 1944-1956* (Anchor Books: New York, 2013).

[403] Cf. më shumë për fillet e kësaj ideje në John J. Mearsheimer, "Back to the Future. Instability in Europe After Cold War", *International Security* vol. 15, no. 1 (Summer 1990).

[404] Ideja për një konflikt civilizimesh për herë të parë u prezantua nga Samuel P. Huntington në verën e vitit 1993 në revistën prestigjioze amerikane *Foreign Affairs*. Shkrimi i tij, "The Clash of Civilizations?", provokoi një debat të jashtëzakonshëm dhe riktheu çështjen e harruar të ndikimit të kulturës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në fakt, i tërë edicioni i verës së vitit 1993 i *Foreign Affairs*-it iu kushtua argumenteve për dhe kundër ndikimit të kulturës në politikën ndërkombëtare. Ky debat akoma vazhdon. Cf. më shumë për këtë debat aktual

en e komunizmit ka fituar paqja e përhershme dhe Perëndimi më nuk do të ketë armiq, ashtu që, për pasojë, nuk do të ketë më me kë të luftojë në kohën që do të vijë[405].

Të gjithë këta autorë pashmangshëm se përdornin si pikë referimi dhe si shembull në teoritizimet e tyre rastin e ish-Jugosllavisë, konfliktin violent që kishte lënë gojëhapur çdokënd që kishte parë harmoninë e atij shteti gati për një shekull. Në veçanti pas Luftës së Dytë Botërore, ish-Jugosllavia sikur arriti të luante rolin e një shteti *buffer* mes Lindjes Komuniste dhe Perëndimit. E ashtuquajtura "Lëvizje e Mosinkuadrimit" dukej sikur po shërbente si forcë moderuese e konfliktit global mes dy superfuqive të kohës — ish-BRSS dhe ShBA-së — ani se të gjitha shtetet anëtare të saj kishin lojalitete të theksuara ndaj njërës prej këtyre dy superfuqive të kohës. Lufta në ish-Jugosllavi, e cila filloi më mbarimin e Luftës së Ftohtë, nuk u shpjegua me faktin se vakumi i lënë pas komunizmit nuk mund të plotësohej më përmes përrallave ideologjike të sistemit komunist: duhej një forcë e re për rilegjitimim të pushtetit. Kjo forcë, në vendet multietnike u gjet në ringjalljen e nacionalizmit ekstrem, kurse në vendet e tjera, ku stofi kulturor dominohej nga feja, kjo e fundit pjesërisht arriti të shërbejë si faktor legjitimues. Në kontekstin ish-jugosllav, feja shërbeu si instrument i nacionalizmave lokalë, në ndërkohë që nacionalizmi serb doli në syprinë si më agresivi ndër të gjithë.

Konflikti violent që po shpalosej në fillim të dekadës së fundit të shekullit XX në territorin ish-jugosllav u cilësua si luftë civile dhe si një çështje që duhej ta zgjidhnin vetë popujt e atij shteti tanimë të shpërbërë. Menjëherë u pa, megjithatë, se ky qëndrim ishte i gabuar, sepse projektimet e forcës nga ana e serbëve kishin tiparet e një politike klasike të zgjerimit territorial në dëm të të tjerëve. Përveç kësaj, serbët po kryenin gjenocid ndaj kulturave joserbe me qëllim të pastrimit të bazës territoriale për rivendosjen e serbëve dhe krijimin e Serbisë së Madhe si një ide që kishte lindur në vitin 1844 nga ideologët serbë të kohës. Disa të huaj, përfshirë dhe disa ideologë serbë, riaktivizuan termin "pastrim etnik" si një eufemizëm për gjenocid, me të cilin synonin që të zbusin pasojat juridike e historike të cilat sillte me vete gjenocidi të cilin serbët po e kryenin në fillim të dekadës së fundit të shekullit që e lamë pas. Bosnjë-Hercegovina, Kroacia dhe, së fundi, Kosova u bënë teatrot e

---

në Glen Fisher, *Mindsets: The Role of Culture and Perceptions in International Relations* (Nicholas Brealey America: London, 1997).

[405] Versioni i parë, fillestar, i kësaj ideje është publikuar në revistën *National Interest* (Summer 1989), për t'u bërë një libër me miliona lexues me të njëjtin titull tre vjet më vonë. Cf. Francis Fukuyama, *The End of History and the Last Man* (Avon Books: New York, 1992).

projektimit serb të gjenocideve të cilat Evropa nuk i kishte parë të përsëriten që nga Holokausti kundër hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në ndërkohë që në Kosovë po bëhej luftë e përgjakshme për mbijetesë të popullit shqiptar si shumicë historike në vend, më lindi ideja që të hulumtoja më thellë arsyet dhe shkaqet e këtij agresiviteti serb ndaj Kosovës. Në fakt, sado që format e manifestimit ishin më sistematike se gjetiu, pasi që Kosovën regjimi në Beograd e konsideronte si territor të vetin të brendshëm, fenomenologjia e krimit serb ngeli e njëjtë. Kjo buronte nga vetë natyra e nacionalizmit serb dhe nga qëllimet e projekteve nacionale serbe me fillim që nga projekti i parë nacional serb i vitit 1844. Të gjitha këto aspekte të nacionalizmit serb janë trajtuar në këtë punim që flet për këtë dhe për politikën e pastrimit etnik si qëllim përfundimtar, të cilin serbët e kishin ndjekur përgjatë më shumë se një shekulli në të kaluarën. Në fakt, ideja për të studiuar këtë temë më kishte lindur nga një libër mbi nacionalizmat evropianë të një autori francez, të cilin e citoj gjatë këtij shkrimi. Librin e kisha gjetur fare rastësisht në Gjenevë më 1992 sa isha me punë me diplomatë të Misionit të Shqipërisë në OKB. Ai libër fliste për faktin se termi "pastrim etnik" ishte produkt serb, të cilin për herë të parë e kishte përdorur babai i iluminizmit serb, Vuk Karaxhiq (Karadžić) (sic!). Lexuesi do ta gjejë shtjellimin e këtij fakti në vijim të shkrimit në këtë kapitull, pas trajtimit të nocionit shtet në të drejtën ndërkombëtare.

Seksioni i parë që flet për nocionin shtet në të drejtën ndërkombëtare është shkruar për qëllimet e brendshme të Qeverisë së Kosovës në mërgim, me të cilin kam punuar nga vitit 1992 deri në mbarim të Luftës në Kosovë, përkatësisht deri me mbarimin e Konferencës së Rambujesë (shkurt-mars 1999). Ky shkrim është botuar më herët në disa vazhdime edhe në *Rilindja javore* (botimi i Tiranës) nga data 18 gusht 1996 deri më 5 tetor 1996.

Seksioni i fundit i këtij kapitulli flet për përpjekjet e serbëve lokalë për të rikrijuar skenarin e Bosnjë-Hercegovinës, përmes synimit të tyre kokëfortë për të krijuar nja asociacion që do të mbronte vetëm interesat e serbëve, jo vetëm të atyre lokalë, por edhe interesat serbe që jetojnë në Ballkan. Përmes këtij organizimi, serbët synojnë që Kosovën ta paraqesin si një territor ku etnia serbe dhe identiteti i tyre mesjetar përbëjnë vulën dhe dëshminë e identitetit serb në Ballkan. Pra, serbët duan që me këtë luftë për të themeluar një asociacion që ka kompetenca territoriale të fitojnë një lloj legjitimiteti politik ndërkombëtar në luftën e tyre për restaurim të të drejtave që i kanë humbur si pasojë e luftërave të tyre agresive dhe, në të njëjtën kohë, të shprishin identitetin shtetëror të Republikës së Kosovës. Kjo e dyta synohet me bindjen se

çdo ditë e më shumë Kosova po humb mbështetjen e miqve të saj tradicionalë, ShBA-së dhe disa prej vendeve konservatore të Evropës, ashtu që në një të ardhme, sipas shpresave serbe, mund të ndodhë që edhe të zhbëhet fare shteti i Kosovës i shpallur më 17 shkurt 2008.

Ky shkrim këtu është botuar në vend[406] dhe në botën e jashtme[407], pa ndonjë ndryshim. Shkrimi më shumë trajton çështjet ndërkombëtare se ato kushtetuese. Edhe ato aspekte kushtetuese që trajtohen në këtë shkrim, në fakt, janë në tërësi çështje ndërkombëtare, por të cilat si të tilla nuk janë trajtuar as nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës në vendimin e saj për Asociacionin, të cilin e trajtojmë gjerësisht në vijim, por as nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Serbisë, e cila vazhdon akoma ta trajtojë çdo marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë si diçka që i takon të drejtës së brendshme (kushtetuese) serbe sepse Kosova akoma në Kushtetutën e Serbisë trajtohet si një provincë serbe. Ky shkrim prek këto dy aspekte dhe mëton të tregojë se si Gjykata e Kushtetuese e Kosovës, ashtu si ajo e Serbisë, ka bërë gabim në mënyrën sipas së cilës ka trajtuar natyrën juridiko-kushtetuese dhe juridiko-ndërkombëtare të marrëveshjeve të lidhura në mes të dy vendeve të arritura gjatë dialogut politik mes dy vendeve, i cili po zhvillohet në Bruksel që nga viti 2012 me ndërmjetësim të Unionit Evropian.

Trajtimi i këtij punimi këtu në këtë kuadër natyrshëm përshtatet me përmbajtjen dhe titullin e këtij kapitulli sepse përbën një aspekt tjetër të trajtimit të nacionalizmit serb dhe përpjekjeve të vazhdueshme të tij për të krijuar një bazë territoriale të ndarë nga e tërë bota dhe nga të gjitha kulturat joserbe me qëllim të realizimit të aspiratave hegjemoniste serbe.

---

[406] Enver Hasani, "Rasti i asociacionit serb në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës", *E drejta/Law* nr. 1-4 (2015).

[407] Enver Hasani, "The Case of the Serb Association before the Constitutional Court of Kosovo", në Andrzej Szmyt and Boguslaw Banaszak (eds.), *The Transformation of Law Systems in Central, Eastern and Southeastern Europe in 1989-2015* (Gdansk UP: Gdansk, 2016).

I. NOCIONI SHTET NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE

Hyrje

Në tekstet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, subjekteve të kësaj pjese të së drejtës iu kushtohet një vëmendje e veçantë. Konteksti themelor formal në kuadrin e të cilit ka lindur çështja e subjektivitetit ka të bëjë me zotësinë për të parashtruar kërkesa lidhur me cenimet e së drejtës ndërkombëtare, me zotësinë për të lidhur marrëveshje të vlefshme në planin ndërkombëtar dhe, së fundi, lidhur me shfrytëzimin e privilegjeve dhe të imuniteteve nga juridiksionet nacionale të shteteve.

Në definimet doktrinare të subjekteve të së drejtës, zakonisht, për subjektet thuhet se ato janë entitete të cilat kanë të drejta dhe detyrime ndërkombëtare dhe janë të afta për të mbrojtur të drejtat e tyre përmes parashtrimit të kërkesave në planin ndërkombëtar[408]. Shtetet kanë këto zotësi dhe imunitete. Shembujt e zhvillimit dhe të ekzistimit të shteteve në të drejtën zakonore ndërkombëtare kanë ofruar tregues vendimtarë lidhur me subjektivitetin e padiskutueshëm të shteteve kundrejt entiteteve të tjera. Ishte rasti i Selisë së Shenjtë (1870), si entitet *sui generis*, ai i cili, për herë të parë, zhdavariti konceptin se vetëm shtetet mund të jenë subjekte të së drejtës ndërkombëtare[409]. Përveç shteteve, edhe organizatat ndërkombëtare mund të kenë zotësi dhe të shfrytëzojnë privilegjet dhe imunitetet e caktuara në të drejtën ndërkombëtare, nëse plotësohen kushtet e caktuara.

Më vonë, në teorinë dhe praktikën ndërkombëtare u krijuan konceptet e reja mbi subjektet e së drejtës ndërkombëtare. U tha se, përveç atyre që i cekëm, mund të ekzistojnë edhe entitetet politike të caktuara e të cilat u ngjasojnë shteteve, siç është rasti me të a.q. territoret e ndërkombëtarizuara (p.sh., qytetet e lira të Dancigut, Krakovit, Triestes etj.). Pastaj, në teorinë dhe praktikën ndërkombëtare u pa se pushteti shtetëror mund të ushtrohet bashkërisht nga disa shtete, siç është rasti me të a.q. *kondominium*. Agjencive

---

[408] Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 4th ed. (Oxford UP: Oxford, 1990) fq. 58.

[409] Marek Stanislav Korovicz, *La souveraineté des États et l'avenir du droit international* (Pedone: Paris, 1945) fq. 136.

të shteteve dhe të organizatave të caktuara ndërkombëtare iu njoh subjektiviteti i caktuar ndërkombëtar, p.sh., rastet e Komisionit Evropian për Danubin dhe të Agjencisë Evropiane për Energjinë Nukleare, etj. etj. Gjithashtu, tipat e a.q. specialë të subjektivitetit ndërkombëtar u futën në kategorinë e koncepteve të reja të subjekteve ndërkombëtare, siç ishte rasti, ta zëmë, me *popujt dhe territoret joautonome në kuptim të Kreut XI të Kartës së OKB-së*, pastaj, *rasti i shteteve në lindje e sipër, i kryengritësve dhe palëve ndërluftuese, i individit për krimet kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare humanitare, i qeverive në ekzil* etj.

Subjektet si më sipër, megjithatë, janë produkt i shteteve, sepse shtetet mbesin akoma subjekti kryesor i së drejtës ndërkombëtare: Shtetet dhe vullneti i tyre janë përcaktuesit kryesor i vëllimit të të drejtave dhe të detyrimeve të subjekteve të tjera të së drejtës ndërkombëtare, i vetë natyrës së tyre juridike dhe i nivelit të aftësisë së këtyre subjekteve të së drejtës ndërkombëtare për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe për të realizuar obligimet e marra në planin ndërkombëtar[410]. Se kjo është kështu, mes të tjerash, shihet me së miri tek rasti i "territoreve të internacionalizuara". Në shumicën e rasteve, këto entitete kanë pasur prerogativat e një shteti, përkatësisht se organizimi i tyre i brendshëm i ka ngjasuar tërësisht shteteve, siç ishin, p.sh., rastet e Krakovit (1815-1846), Dancigut (1919-1939), Triestes (1945-1954) etj.[411]

Janë një numër i madh i faktorëve të cilët duhet shqyrtuar me kujdes para se të përcaktohet fakti nëse një entitet ka subjektivitet ndërkombëtar, dhe në rastin kur ai e posedon atë, atëherë duhet shikuar se çfarë të drejtash, detyrimesh dhe kompetencash vlejnë për rastin e tillë. Kjo nga shkaku se subjektiviteti ndërkombëtar përfshin ekzaminimin e një sërë konceptesh brenda së drejtës ndërkombëtare, siç janë ato të statusit, zotësisë, kompetencës, si dhe konceptet që kanë të bëjnë me vëllimin dhe natyrën e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara. Një ekzaminim i tillë presupozon njohjen e mirë të rregullave të së drejtës ndërkombëtare, sepse vetëm ajo përcakton natyrën e saktë dhe zotësinë e entiteteve me subjektivitet të caktuar ndërkombëtar[412]. Kjo assesi nuk do të thotë se rregullat (normat) e së drejtës ndërkombëtare vihen në veprim (aktivizohen) ndaj një entiteti vetëm për faktin se ai pretendon se ka subjektivitet juridik. Rregullat e së drejtës ndërkombëtare vihen në lëvizje

---

[410] Cf. Gerhard Von Glahn, *Law Among Nations: An Introduction to Public International Law*, 5th ed. (Macmillan: New York, 1986) fq. 55-80.

[411] Cf. Meir Ydit, *Internationalized Territories* (A.W. Sythoff: Leyden, 1961) fq. 22, 50, 71, 95-109, 185-231 dhe 231-273.

[412] Cf. Malcolm N. Shaw, *International Law* (Cambridge UP: Cambridge, 1995) fq. 135-137.

ndaj një entiteti vetëm në rastin kur ai entitet e vë veten në dukje dhe imponohet. Me fjalë të tjera, fakti nëse një entitet ka subjektivitet ndërkombëtar varet prej mënyrës se si ai funksionon në bashkësinë ndërkombëtare[413].

Kush janë shtete në të drejtën ndërkombëtare? A është i njëjtë ky nocion me atë që jemi mësuar ta dëgjojmë në jetën e përditshme? Pse republikat e serbëve të Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë, Çeçenia, Republika e turqve qipriotë, Biafra në Nigeri, Katanga në Kongo, Rodezia e Jugut (dikur), etj. etj. nuk konsiderohen dhe nuk janë konsideruar shtete në të drejtën ndërkombëtare? Apo, këto janë ose kanë qenë shtete, por të panjohura ndërkombëtarisht? Këto janë disa nga çështjet të cilave, në një mënyrë ose në një tjetër, kemi tentuar t'u përgjigjemi në këtë punim.

Duke qenë e pamundur praktikisht të trajtohen në një shkrim si ky i yni të gjitha subjektet e së drejtës ndërkombëtare, kemi vendosur të kufizohemi vetëm në shtetin dhe atë për shumë arsye. Subjektet e tjera i kemi lënë anash sepse, tek e fundit, nuk kanë ndonjë relevancë për momentin nëpër të cilin po kalon Kosova.

1. Nocioni shtet në të drejtën ndërkombëtare

Shteti si një fenomen historik, sociologjik dhe politik ka qenë objekt interesimi i së drejtës ndërkombëtare, si në planin doktrinar ashtu edhe në atë normativ. Ky interesim është shtuar veçanërisht pas formimit të komunitetit modern ndërkombëtar, për të cilin në literaturë thuhet se përkon me periudhën e viteve 1648-1856 (nga Paqja e Vestfalisë deri te Kongresi i Parisit), periudhë kjo që ka pasur për pasojë lindjen e shpejtë të shteteve të reja. Çështja kryesore, e cila është shtruar që atëherë, ka qenë dhe mbetet ajo e raportit mes së drejtës ndërkombëtare dhe qenies shtet (*statehood*), përkatësisht e raportit të së drejtës ndërkombëtare ndaj lindjes së shteteve të reja. Në këtë kontekst, në doktrinën ndërkombëtare të shekullit të kaluar u krijua e a.q. teori konstitutive, sipas së cilës shtetet krijohen me njohjen e tyre ndërkombëtare. Në anën tjetër, si refleks i kësaj, më vonë lindi e a.q. teoria deklarative, sipas së cilës lindja e shtetit është çështje faktike dhe nuk varet nga akti i njohjes.

Që nga kjo periudhë nuk kanë pushuar diskutimet në të drejtën ndërkombëtare në lidhje me dobishmërinë e këtyre dy teorive, përfshirë këtu edhe

---

[413] Cf. Christian N. Okeke, *Controversial Subjects of Contemporary International Law* (Rotterdam UP: Rotterdam, 1974) fq. 225.

përpjekjet e shkencëtarëve francezë për të kombinuar këto dy teori dhe për të tejkaluar këtë polemikë në doktrinë. Megjithatë, teoria deklarative ka mbetur si dominante në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare bashkëkohore.

Pa dashur të futemi në ndonjë analizë të thellë rreth asaj se cila prej këtyre teorive është e drejtë, duhet të theksojmë menjëherë se dallimet praktike mes këtyre dy teorive janë fare të vogla[414], gjë që është dëshmuar edhe me rastin e krijimit të shteteve të reja nga gjiri i ish-BRSS-së, RSFJ-së dhe Çekosllovakisë.

Mirëpo, gjërat nuk janë aq të thjeshta, ashtu siç pretendohet se janë, për arsye se, aktualisht, në të drejtën ndërkombëtare ekzistojnë disa kritere aplikative ose objektive të qenies shtetet (*statehood*) në të drejtën ndërkombëtare, plotësimi i të cilëve është parakusht i domosdoshëm për futjen e entiteteve te reja (shteteve) në kuadrin e "familjes së kombeve". Pra, shtetet ekzistuese të kësaj "familjeje", me rastin e vlerësimit të substratit të caktuar faktik, duhet të bëjnë vlerësimin e drejtë dhe të duhur të gjendjes së fakteve të tilla jetësore që cilësohen si "lindje e shtetit të ri". Sikur të mos ekzistonin këto kritere, atëherë vlerësimi arbitrar i qenurit shtet të entiteteve të reja nga ana e shteteve ekzistuese do të kishte për pasojë anarkinë në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe rikthimin në praktikë të pozicionit (teorisë) konstitutive[415]. Ekzistimi i këtyre kritereve aplikative ose objektive të qenies shtet (*statehood*) në të drejtën ndërkombëtare, të cilat janë të mishëruara në nenin e parë të Konventës së Montevideos mbi të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve të datës 26 dhjetor 1933, kanë paraqitur pikën nisëse për anëtarët ekzistues të bashkësisë ndërkombëtare me rastin e vlerësimit se kush mund të cilësohet si shtet në të drejtën ndërkombëtare. Vlen të thuhet se këto kritere aplikative ose objektive të qenies shtet janë plotësuar dhe ndryshuar si rezultat i zhvillimit gjithnjë e më dinamik i së drejtës ndërkombëtare, për çka do të flasim më shumë në vijim të punimit.

Me fjalë të tjera, ekzistimi dhe zbatimi i një sistemi të caktuar ligjor, i cili do t'i referohej të gjitha shteteve, presupozon pasjen e vlerave dhe sjelljeve të përbashkëta, sensin e bashkëjetesës ose, thënë ndryshe, ai sistem presupozon një bashkësi e cila quhet "komunitet" ose "familje e shteteve". Në kuadrin e kësaj familjeje, një entitet shtetëror mund të ekzistojë dhe të funksionojë si një sistem politik operativ, por pa qenë shtet në kuptimin legal të kësaj fjale.

---

[414] Cf. Barry Carter — Philip Trimble, *International Law: Cases and Materials* (Aspen: New York, 1995) fq. 162.

[415] Cf. Dionisio Anziloti, *Corso di Diritto Internazionale* I (CEDAM: Padova, 1964) fq. 136-137.

Transformimi në subjektin legal i cili quhet shtet bëhet vetëm përmes pranimit të entitetit të dhënë si anëtar i barabartë i bashkësisë së shteteve. Pranimi i entitetit të caktuar si anëtar i barabartë i bashkësisë së shteteve ka fuqi provuese mjaft të rëndësishme në sensin e asaj që entiteti i tillë i ka plotësuar kushtet për të qenë shtet. Përveç vlerës së tij provuese, pranimi në bashkësinë e shteteve i një entiteti të ri shtetëror shërben edhe për të konsoliduar statusin juridiko-ndërkombëtar dhe politik të një shteti në rastet kur ai është i dyshimtë dhe në pozita të lëkundura, siç ishte rasti me njohjen e Sllovenisë, Kroacisë, Maqedonisë dhe Bosnjë-Hercegovinës.

Në anën tjetër, mohimi i pranimit të një entiteti i cili i plotëson kushtet për të qenë shtet nuk i jep të drejtë shteteve të tjera që të sillen ndaj tij sikur ai të mos ishte shtet fare. Në këtë rast kemi të bëjmë me subjektivitetin ndërkombëtar të një entiteti të panjohur nga ana e bashkësisë ndërkombëtare[416]. Anasjelltas, shteti i panjohur nuk guxon të sillet jashtë rregullave të komunikimit të cilat vlejnë për anëtarët e tjerë të bashkësisë ndërkombëtare.

2. Kriteret për të qenë shtet në të drejtën ndërkombëtare

Deri më sot nuk ekziston një definicion i pranuar nga të gjithë për sa i përket qenies shtet (*statehood*) në të drejtën ndërkombëtare, çka nuk do të thotë se nuk ka pasur përpjekje serioze për një definim të këtij nocioni[417]. Aktualisht, mund të thuhet se ekzistojnë vetëm pasojat legale të cilat lindin nga fakti i ekzistimit të shteteve në të drejtën ndërkombëtare. Këto pasoja, paraqesin bazën e qenies shtet në të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe i referohen kompetencës ekskluzive të shteteve në planin e jashtëm dhe të brendshëm, përkatësisht asaj që nganjëherë quhet "shtet sovran", si dhe barazisë formale të shteteve pa marrë parasysh fuqinë e tyre reale.

Sovraniteti shtetëror ose kompetenca ekskluzive e shteteve në çështjet e tyre të brendshme dhe të jashtme paraqet gurthemelin e strukturës mbi të cilën bazohet dhe qëndron e drejta ndërkombëtare, si dhe bazën nisëse për vlerësimin e pozitës juridike të shtetit në të drejtën ndërkombëtare, të zotësisë së tij dhe të drejtave e detyrimeve. Të gjitha konceptet e tjera, si p.sh., ai i

---

[416] Cf. Christian N. Okeke, *Controversial Subjects of Contemporary International Law*, fq. 81-104.

[417] Fjala është për punimet e doktoratës: Kristina Marek, *Identity and Continuity of States in Public International Law* (DROZ: Geneva, 1954); James Crawford, *The Creation of States in International Law* (Oxford UP: Oxford, 1979).

vetëvendosjes, i shtetësisë etj., sillen rreth konceptit "shtet sovran"[418]. Çdo heqje dorë e shteteve nga këto atribute duhet të theksohet në mënyrë shprehimore dhe, në rast dyshimi, duhet gjykuar ne favor të lirisë së veprimit të shteteve si në çështjet e tyre të brendshme ashtu edhe në ato të jashtme.

Kriteret për të qenë shtet në të drejtën ndërkombëtare, pra kriteret dalluese të një entiteti shtetëror nga entitetet tjera që nuk janë të tilla, i ndajmë në tri grupe:

1. kriteret klasike të qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare;
2. kriteret e sugjeruara si rezultat i zhvillimit modern të së drejtës ndërkombëtare; dhe së fundi,
3. kriteret e qenies shtet për qëllimet e Lidhjes së Kombeve dhe të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Përveç këtyre kritereve, në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare, janë përmendur edhe disa tjera, si p.sh., përhershmëria e shtetit, dëshira dhe zotësia për të respektuar të drejtën ndërkombëtare, niveli i caktuar i civilizimit, njohja ndërkombëtare e shtetit dhe, së fundi, pasja e një rendi të caktuar kushtetues dhe ligjor.

2.1. Kriteret klasike të qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare

Formulimi më i njohur i kritereve bazë për të qenë shtet është ai i dhënë në nenin e parë të *Konventës së Montevideos mbi të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve*, datë *26 dhjetor 1933*. Aty, në atë nen, është thënë si vijon:

> Shteti si subjekt i së drejtës ndërkombëtare duhet të posedojë kualifikimet vijuese:
>
> a. popullsinë e përhershme;
> b. territorin e caktuar;
> c. qeverinë; dhe
> d. zotësinë për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera.

Si veçori kryesore e këtyre kritereve është se *bazohen në parimin e efektivitetit të pushtetit shtetëror* brendapërbrenda njësive të dhëna territoriale. Një fakt i tillë gjendet që nga kohërat e lashta, në shkrimet e autorëve të ndryshëm, si Ciceroni, Grotiusi, Vatteli etj.[419], mirëpo atëherë ka pasur një kuptim dhe përmbajtje tjetër nga ajo që ka sot.

---

[418] Cf. Christian N. Okeke, *Controversial Subjects of Contemporary International Law*, fq. 5 dhe 225.

[419] Cf. Frantz Despagnet, *Essai sur les protectorats* (Pedone: Paris, 1896) fq. 7-20.

Përveç Konventës së Montevideos ekziston edhe një dokument tjetër ndërkombëtar në të cilin theksohet pesha e efektivitetit, të pushtetit shtetëror si kusht për qenien shtet në të drejtën ndërkombëtare. Fjala është për nenin e parë të rezolutës së *Institut de droit international* me seli në Bruksel (prill 1936), e titulluar si "Rezoluta në lidhje me Njohjen e Shteteve dhe Qeverive të Reja". Në rezolutë thuhet si vijon:

> Njohja e shtetit të ri është akt i lirë përmes së cilit një shtet ose disa sosh njohin ekzistencën e shoqërisë së caktuar njerëzore, politikisht e organizuar, në një territor të caktuar, që është i pavarur nga çdo shtet tjetër ekzistues dhe i aftë për të respektuar obligimet e së drejtës ndërkombëtare.[420]

Lindja e shpejtë e shteteve të reja në periudhën e dekolonizimit nuk paraqiti ndonjë problem për sa i përket aplikimit të kritereve klasike të qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare e as të kritereve nën pikën *b* dhe *c* si më sipër, të cilat quhen ndryshe edhe si kritere modifikuese të kritereve klasike të qenies shtet. Në këtë kohë, shtetet lindnin brenda kufijve territorial të njësisë administrative koloniale ashtu siç ishin ata në momentin e njohjes dhe pavarësimit të kolonisë nga shteti metropol[421]. Njohja e këtyre shteteve bëhej në mënyrë mjaft formale. Vetëm në disa raste ka ndodhur të lindin probleme të diskutueshme të njohjes së shteteve të reja në këtë fazë të zhvillimit të së drejtës ndërkombëtare (rasti i Saharës Perëndimore dhe i kërkesave irredentiste të Guatemalës për mosnjohjen e shtetit të Belizës).

Zhvillimet e fundit në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik sikur krijuan përshtypjen se nuk do të ketë probleme në lidhje me lindjen e shteteve të reja. Ish-RD e Gjermanisë u absorbua nga RF e Gjermanisë, dhe nuk pati për pasojë ngritjen e çështjes së njohjes së qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare. Rastet e para të cilat ngjallën interesimin e bashkësisë ndërkombëtare për qenien shtet të entiteteve të reja ishte rasti i shteteve baltike: Lituanisë, Estonisë dhe Letonisë (1990-1991). Më pastaj, shpërbërja e ish-RSF të Jugosllavisë dhe ngjarjet që pasuan gjatë këtij procesi detyruan bashkësinë ndërkombëtare që të ndikojë "në proceset e shpërbërjes së ish-federatave socialiste (BRSS, Çekosllovaki dhe RSFJ). Në veçanti me rastin e ish-RSFJ-

---

[420] Cf. *American Journal of International Law* vol. 30 (1936), *Supplement*, fq. 185-87, në fq. 185.

[421] Cf. Jean-Marc Sorel et Rostane Mehdi, "L'uti possidetis entre la consécration juridique et la pratique : essai de réactualisation", *Annuaire Francais de Droit International* vol. 40 no. 1 (1994) fq. 11-14.

së, ku marrëdhëniet mes vetëvendosjes dhe qenies shtet si dhe mes njohjes dhe qenies shtet ishte mjaft vështirë për t'i dalluar dhe shthurur qetësisht. Për këtë arsye, në kontekstin ish-jugosllav, intervenimi i bashkësisë ndërkombëtare përmes caktimit normativ të disa kritereve bazë të njohjes së shteteve të reja të cilat ishin në lindje e sipër u provua si i dobishëm dhe i domosdoshëm.

Edhe pse në literaturën e së drejtës ndërkombëtare të këtyre viteve të fundit është pohuar se intervenimi i bashkësisë ndërkombëtare në rastet e cekura si më sipër paraqet një konglomerat të kushteve politike për njohjen e shteteve të reja[422], megjithatë një gjë e tillë nuk del nëse bëhet një analizë sado e cekët e teksteve kryesore, duke filluar që nga të a.q. *Kriteret Bazë për Njohjen e Shteteve të Reja të Krijuara në Evropën Lindore dhe ne BRSS* të datës 16 dhjetor 1991 (më tej shkurt: Kriteret për Njohje), Mendimet e Komisionit Badinter për ish-Jugosllavinë, si dhe nga Marrëveshja e Dejtonit. Kjo e fundit, së bashku me disa akte të tjera juridike të bashkësisë ndërkombëtare (rezolutat e ndryshme të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe të Këshillit të Sigurimit, pastaj rezolutat e ndryshme të OSBE-së dhe të Këshillit të Evropës etj.) paraqesin një zbërthim të mëtejshëm dhe të detajuar të Kritereve për Njohje dhe të Mendimeve të Badinterit dhe, në veçanti, të pjesës së Kritereve për Njohje ku është thënë shprehimisht se: "Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare afirmojnë gatishmërinë për të njohur shtetet e reja të krijuara, konform standardeve normale të praktikës ndërkombëtare dhe realiteteve të krijuara politike në secilin rast konkret".

Siç shihet, kjo pjesë e Kritereve për Njohje i referohet "shteteve të reja" dhe "standardeve normale të praktikës ndërkombëtare". Një formulim i këtillë ka për pasojë faktin se qenia shtet në kuptimin e saj klasik, ashtu siç përcaktohet nga Konventa e Montevideos dhe e drejta zakonore ndërkombëtare, është parakusht i domosdoshëm për njohjen ndërkombëtare. Megjithatë, gjatë procesit të shpërbërjes se ish-federatave socialiste (BRSS, RSFJ dhe Çekosllovakisë) kanë ekzistuar dallime mes shteteve ekzistuese lidhur me atë nëse entitetet e reja të cilat pretendonin të jenë shtete i plotësonin apo jo kriteret tradicionale për të qenë shtet në të drejtën ndërkombëtare. Nga shqyrtimet tona të këtyre Kritereve për Njohje do të shihet se aty janë sublimuar dhe gërshetuar jo vetëm kriteret klasike të qenies shtet por edhe kriteret tjera (të përmendura nën pikën *b* dhe *c* si më sipër).

---

[422] Cf. Stefan Talmon, "Recognition of Governments: An Analysis of the New British Policy and Practice", *The British Yearbook of International Law* 63 (1992) fq. 251.

Bazën legale nisëse të intervenimit të bashkësisë ndërkombëtare në zgjidhjen e krizës në ish-Jugosllavi e gjejmë në analizën e parashtruar në formë mendimesh juridike të Komisionit të Arbitrazhit (Komisioni Badinter) të themeluar në kuadrin e Konferencës Paqësore për ish-Jugosllavinë, ashtu që në fillim do të analizojmë mendimin e Komisionit Badinter, datë 29 nëntor 1991, mbi bazën e të cilit ka filluar pozicionimi i faktorëve ndërkombëtare ndaj krizës në ish-Jugosllavi.

Siç dihet, në fillim të vitit 1991, Bashkësia Evropiane pati vendosur thirrjen e një konference ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, e cila është quajt si Konferenca Paqësore e Hagës dhe e cila më vonë, më 1992, u zëvendësuar nga ajo e Londrës, me po të njëjtin emër. Dallimi mes këtyre dy konferencave ka qenë në natyrën juridike të tyre. Në rastin e parë, vendimet e Konferencës nuk janë konsideruar si të obligueshme, sepse puna e saj është konsideruar si "shërbim i mirë" i ofruar nga ana e Evropës. Në rastin e dytë, ndërkaq, duke marrë parasysh seriozitetin e konfliktit në ish-Jugosllavi, bashkësia ndërkombëtare arriti që të thërriste një konferencë vendimet e së cilës në mënyrë autoritative do të vlenin për të gjithë aktorët e krizës në ish-Jugosllavi. Me fjalë të tjera, Konferenca e Londrës arriti të imponontе fuqinë e detyrueshme për vendimet e veta, sado që puna e kësaj konference ka qenë e bazuar tërësisht në dokumentet dhe veprimet e kryera nga Konferenca e Hagës. Kjo edhe qe thënë në dokumentet bazë të Konferencës së Londrës, gjë që më vonë është konfirmuar edhe me faktin e ekzistimit të strukturës së njëjtë organizative me atë të Konferencës së Hagës. Në këtë strukturë, pa dyshim, bën pjesë edhe Komisioni i Badinterit, i cili ka relevancë të jashtëzakonshme për aspektet juridiko-politike dhe ndërkombëtare të krejt problemit ish-jugosllav.

Serbia, e bindur se ka të drejtë të pakufishme të nënshtrimit të të tjerëve në emër të subjektivitetit ndërkombëtar të ish-RSFJ-së — përkatësisht e bindur se Komisioni do të zbatojë kriteret klasike të qenies shtet në mënyrë të rreptë legaliste dhe pa ndonjë zbutje ose modifikim të tyre sipas standardeve të së drejtës ndërkombëtare pozitive — që nga fillimi i punës së Konferencës së Hagës u kërcënohej të tjerëve me rezultatet e punës së Komisionit Badinter. Këtë e dëshmon, ta zëmë, letra të cilën ish-ministri i punëve të jashtme të Serbisë i pati dërguar më 4 tetor 1991 kryetarit të Konferencës, Lordit Carrington, me të cilën kërkonte mendime profesionale nga Komisioni Badinter lidhur me tri pyetjet për sa vijon:

1. A ka të drejtën për vetëvendosje populli serb i Bosnjë-Hercegovinës dhe i Kroacisë, si një nga kombet konstitutive të Jugosllavisë;

2. A konsiderohet si akt juridikisht i vlefshëm në bazë të Kartës së OKB-së dhe dokumenteve të tjera ndërkombëtare shkëputja e Sllovenisë dhe e Kroacisë, të cilat këtë akt e kanë bërë në mënyrë të njëanshme dhe me dhunë;
3. A konsiderohen si kufij ndërkombëtarë vijat administrative kufitare mes Serbisë dhe Kroacisë dhe mes Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës.

Vetë formulimi i këtyre pyetjeve dhe përmbajtja e tyre flet për politikën hegjemoniste të Serbisë dhe për synimet e saja imediate. Këto synime shumë shpejt u shpalosën me tërë ashpërsinë e tyre në Kroaci dhe më pastaj në Bosnjë-Hercegovinë. Njëjtë vlen edhe për përgjigjen e Komisionit Badinter në këtë letër të cilën ia ka drejtuar Lordit Carrington, i cili po ashtu shpalosi krejt synimet dhe politikën ndërkombëtare në dy anët e Atlantikut sa i përket kritereve të qenies shtet në territorin e ish-Jugosllavisë, e cila atëbotë gjendej në procesin e shpërbërjes totale. Lordi Carrington, me letrën e vet të datës 20 tetor 1991 i ka përcjellë këto pyetje Komisionit të Arbitrazhit, duke kërkuar përgjigje vetëm për pyetjen e parë dhe të tretë, sepse pyetja e dytë e Serbisë është e përmbajtur në pyetjen që ai vetë, pra Lordi Carrington, ia bënte Komisionit dhe atë për sa vijon:

> Serbia konsideron se republikat të cilat kanë shpallur ose e kanë ndërmend ta shpallin pavarësinë janë shkëputur nga RSFJ, e cila, në anën tjetër, mund të vazhdojë ekzistimin e vet të mëtejshëm.
>
> Republikat e tjera, përkundrazi, konsiderojnë se nuk bëhet fjalë për shkëputje (secesion), por për shpërbërje të RSFJ-së, si rezultat i vullnetit të një numri të caktuar të republikave. Ato, pra republikat, konsiderojnë se gjashtë republikat duhet të konsiderohen si trashëgimtare të barabarta të RSFJ-së, ashtu që asnjëra prej tyre nuk mund të pretendojë të jetë vazhdimësi e saj.

Komisioni, ndërkaq, më 29 nëntor 1991 e dha mendimin e vet në pyetjen e Lordit Carrington dhe, në mënyrë implicite, edhe në pyetjen e dytë të Serbisë, të cilin po e japim në vijim. Ndërsa, për mendimet lidhur me pyetjen e parë dhe të tretë të Serbisë do të flasim më vonë.

Teksti i këtij mendimi të dhënë lidhur pyetjen e dytë të Serbisë është i shkruar në gati katër faqe dhe pa arsyetime të detajuara dhe pa u thirrur në ndonjë praktikë të mëhershme gjyqësore ose të arbitrazhit, gjë që nuk është veçori e gjyqësisë ndërkombëtare. Me këtë mendim janë hedhur poshtë si të pabaza në tërësi dy kërkesat e Serbisë, të cilat kishin të bënin me sa vijon:

a. pranimin e vazhdimësisë së ish-RSFJ-së; dhe

b. dënimin nga ana e bashkësisë ndërkombëtare të "shkëputjes së njëanshme dhe të dhunshme" të republikave të tjera të ish-RSFJ-së.

Sikur të ishin pranuar këto kërkesa të Serbisë, pra se ish-RSFJ vazhdonte të ekzistonte akoma dhe se tjerat republika ishin shkëputur nga RSFJ, atëherë Serbia do të kishte një arsyetim të fortë për agresionin dhe krimet e saj të kryera në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë. Me këtë do të vihej në pyetje edhe e drejta e ndarjes së pasurisë së përbashkët mes republikave të ish-RSFJ-së, sepse pikërisht në çështjet e suksedimit (trashëgimit) shihet dallimi në mes të shkëputjes (secesionit) dhe shpërbërjes totale të një shteti[423]. Se kjo është kështu shihet më së miri nga pozita aktuale e *Republikës së Kosovës*, e cila është përjashtuar nga trashëgimi (suksedimi) i ish-RSFJ-së duke iu falënderuar pikërisht këtij mendimi të Komisionit, i cili konstaton shpërbërjen e shtetit jugosllav por vetëvendosjen e jashtme (eksterne) ia njeh vetëm entiteteve të tipit republikë federale, diçka që Kosova nuk kishte qenë asnjëherë gjatë ekzistimit të ish-Jugosllavisë. Lidhur me vlefshmërinë juridike të këtij mendimi, autori i këtyre rreshtave ka polemizuar në punimin me titull "Vendimi i Arbitrazhit (s) është i drejtë", botuar në *Fjala*, Prishtinë, dhjetor 1991, të cilat polemika dhe mendime kryesisht përputhen me këto që shprehen këtu në vijim. Prandaj ka rëndësi që të riprodhohet në tërësi mendimi i Komisionit Badinter në pyetjet e Serbisë të bëra përmes Lordit Carringon.

Pyetjes së formuluar nga Lordi Carrington, Badinteri iu është përgjigjur si vijon:

1. Komisioni konsideron:

a) se, përgjigjja në pyetjen e parashtruar duhet të jetë e bazuar në kriteret e së drejtës ndërkombëtare të cilat shërbejnë për të përcaktuar kushtet nën të cilat një entitet duhet të konsiderohet si shtet; në këtë aspekt ekzistimi ose zhdukja e një shteti është çështje faktike, kurse efektet e njohjes nga ana e shteteve të tjera janë të një natyre thjeshtë deklarative;

b) se, shteti në përgjithësi definohet si bashkësi e cila përbëhet prej territorit dhe popullsisë, të cilat i nënshtrohen një pushteti të organizuar politik, fakt ky i cili e bën shtetin të jetë sovran;

c) se, me qëllim të zbatimit të këtyre kritereve, forma e organizimit politik dhe dispozitat kushtetuese janë fakte të thjeshta, edhe pse është e

[423] Cf. Patric Daillier et Alain Pellet, *Droit International Public*, 5-é ed. (L.G.D.J.: Paris, 1994) fq. 500-502.

> domosdoshme të merren në konsideratë me qëllim që të konstatohet niveli i ndikimit të pushtetit në popullsinë dhe territorin e caktuar.
>
> d) se, kur kemi të bëjmë me shtetin e tipit federal, i cili në gjirin e tij ngërthen bashkësitë me një shkallë të caktuar të autonomisë dhe të cilat marrin pjesë në ushtrimin e pushtetit politik në kuadrin e institucioneve të përbashkëta të Federatës, atëherë ekzistimi i shtetit federal nënkupton atë se në organet federative janë të përfaqësuara të gjitha pjesët e federatës dhe se në kuadrin e këtyre organeve federative ato [d.m.th., pjesët përbërëse të Federatës — vërejtja jonë, E.H.] ushtrojnë pushtetin efektiv.

Në këtë mënyrë, Komisioni ka refuzuar të lëshohet në vlerësimin e asaj se kush është fajtor dhe përgjegjës për shkeljen e dispozitave kushtetuese dhe ligjore të ish-federatës jugosllave, si dhe në vlerësimin e faktit nëse Kushtetuta e ish-RSFJ-së e vitit 1974, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, ishte akoma në fuqi. Kjo nuk është e tëra: në bazë të këtyre përcaktimeve të përgjithshme dhe parimore, Komisioni ka ardhur deri tek konkluzionet konkrete lidhur me gjendjen e atëhershme në ish-RSFJ-në si shtet. Këto konkluzione konkrete kanë qenë të gabuara dhe fatale për pozitën e Kosovës në planin ndërkombëtar. Në njërin prej këtyre konkluzioneve të Komisionit, thuhej si vijon:

> 2. Komisioni i Arbitrazhit konstaton se:
>
> a) edhe pse RSFJ deri më tani ka arritur ta ruajë subjektivitetin ndërkombëtar, në veçanti në raport me organizatat ndërkombëtare, republikat e saj kanë shprehur dëshirën e tyre për pavarësi.

Në vijim të tekstit si më sipër të këtij mendimi, Komisioni përmend referendumet për pavarësi të mbajtura në Slloveni, Kroaci dhe në Maqedoni, Shpallja e pavarësisë nga ana e këtyre republikave si dhe deklarata mbi sovranitetin e Bosnjë-Hercegovinës e 15 tetor 1991, vlerën. e së cilës e pat mohuar bashkësia serbe e kësaj republike. Deklarata mbi sovranitetin u pasua nga referendumi për pavarësi nga ish-RSFJ e Bosnjë-Hercegovinës, i cili u mbajt më 29 shkurt dhe 1 mars 1992. Komisioni, me këtë qasje, ua njohu të drejtën për vetëvendosje vetëm ish-republikave jugosllave dhe qytetarëve të tyre, por jo edhe krahinave autonome të ish-RSFJ-së, përkundër përpunimit parimor të kritereve për të qenë shtet në pikën 1, *a* deri *d*, të mendimit si më lart të Komisionit Badinter. Me fjalë tjera, e drejta për të likuiduar federatën jugosllave u takoi vetëm njësive federale të tipit republikë dhe jo edhe krahinave autonome.

Vlen të theksohet këtu se me rastin e njehjes së të drejtës për vetëvendosje, përkatësisht të së drejtës për krijimin e shteteve të reja brenda kufijve administrativ të republikave tjera të ish-RSFJ-së, duke iu njohur atyre, pra republikave, të drejtën e mbrojtjes ndërkombëtare të kufijve të tyre, siç u pa me lartë, Komisioni mori si referencë deklaratat mbi shpalljen e pavarësisë, referendumet e mbajtura në këto republika, si dhe faktin e plotësimit të kritereve për të qenë shtet në të drejtën ndërkombëtare. Në asnjë referencë të Komisionit Badinter nuk kemi hasur, me plot të drejtë, që të thirret në ndonjë vendim të të a.q. KAÇKJ (AVNOJ) apo të ndonjë organizmi tjetër të kohës së Luftës së Dytë Botërore ose pas saj, me përjashtim të Kushtetutës së fundit të ish-RSFJ- së të v.1974. Edhe kjo kushtetutë është vlerësuar nga ana e Komisionit, vetëm si një fakt i thjeshtë. Kjo për arsye të thjeshtë së Komisioni Badinter, ky organizëm specifik ndërkombëtar, as që ka pasur mundësi të vlerësojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e deklaratave mbi shpalljen e pavarësisë së republikave të ish-RSFJ-së.

Në vijim sa më sipër, qartë shihet se *pika nisëse e vlerësimeve të Komisionit ka qenë realiteti i ri i krijuar pas shpërbërjes së ish-RSFJ-së*, realitet ky i cili është përputhur tërësisht me kriteret për të qenë shtet në të drejtën ndërkombëtare. Vlen të përmendet se nga të gjitha punimet shkencore te publikuara në boten e jashtme deri me sot lidhur me aspektet juridiko-politike dhe ndërkombëtare të shpërbërjes se ish-RSFJ, autori i këtyre rreshtave ka hasur vetëm në një punim ku përmenden shkaqet për refuzim të njohjes ndërkombëtare të Republikës së Kosovës[424]. Në punim thuhet, *inter alia*, se:

> sipas asaj që raportohet, aplikimi i Kosovës, e cila ka votuar për pavarësi dhe e cila është skajshmërisht homogjene në pikëpamje etnike, u refuzua me procedurë të përshpejtuar nga ana e Bashkimit Evropian sepse nuk e ka plotësuar kushtin primar te qenies shtet — kontrollin efektiv mbi territorin e saj.

Ekziston edhe një punim tjetër, ai i kryetarit aktual te Gjykatës për Krimet e Luftës ne ish-Jugosllavi, z. Antonio Cassese (Kaseze), në të cilin flitet shkarazi për çështjen e Kosovës dhe atë në kuadrin e trajtimit të keq të afro dy milionë shqiptarëve nga ana e pushtetit serb[425].

---

[424] Fjala është për punimin e autorëve A.V. Lowe and Colin Warbrick, "Current Developments: Public International Law", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 41, part 2 (1992).

[425] Cf. Antonio Cassese, "Self-Determination of Peoples and the Recent Break-Up of USSR and Yugoslavia", në Ronald St. John Macdonald (ed.), *Essays in Honour of Wang Tieya* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1994) fq. 140.

Nisur nga kjo që u tha, nuk është vështirë të vërehet se përpjekjet e organeve shtetërore të Republikës së Kosovës duhen orientuar kah plotësimi i këtij kushti për të qenë shtet në të drejtën ndërkombëtare, pra, plotësimin e kushtit të ushtrimit të kontrollit (pushtetit) efektiv. Në të njëjtën kohë, për pasojë, konsiderojmë se edhe përpjekjet e shkencës juridike dhe të gjithë të tjerëve duhet që, me rastin e kërkimit të shkaqeve për mosnjohjen e Republikës së Kosovës nga ana e Komisionit Badinter dhe e bashkësisë ndërkombëtare, të fokusohen në analizimin e mendimeve të Komisionit Badinter, dhe jo në dokumentet e lëshuara apo në veprimet e ndërmarra gjatë Luftës së Dytë Botërore apo pas saj, siç janë vendimet e KAÇKJ/AVNOJ-it, të konferencave të Bunjajt dhe Prizerenit, respektivisht. Dokumentet e nxjerra nëpër këto forume komuniste nuk kanë pasur kurrë dhe as që do të kenë, pro futuro*, efekte juridiko ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe dokumentet e tjera mbi rrënimin e autonomisë së Kosovës me 1989. Fundi i fundit, logjikisht shikuar, pyetja mund të shtrohet: si do të duhej të dukej preambula (hyrja) e një kushtetute të Kosovës në të ardhmen nëse do të bazohej në dokumentet e sipërcekura të KAÇKJ/AVNOJ-it, apo të konferencave të Bunjajt e Prizerenit, respektivisht?! Në teori, sepse praktikisht ajo është pamundur, preambula (hyrja) e një kushtetute të tillë të Kosovës do të duhej të citonte pjesët e caktuara të mbledhjes së KAÇKJ/AVNOJ-it, të konferencës së Bunjajt dhe të asaj të Prizrenit dhe, së fundi, disa pjesë të Kushtetutës së ish-RSFJ-së të vitit 1974. Në këto dokumente dhe në Kushtetutën e fundit të ish-RSFJ-së të vitit 1974 gjenden, pa asnjë përjashtim, sintagmat për socializëm, vetëqeverisje, vëllazërim e bashkim, vullnet për jetën e përbashkët me Serbinë, interesat e larta të socializmit e të proletariatit, etj. etj.* Dokumentet e mësipërme, nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare janë një *res inter alios acta*, letra dhe çështje e brendshme e ish-Jugosllavisë, qoftë e asaj mbretërore ose e kësaj të fundit e cila është në procesin e zgjidhjes si krizë[426]. Dokumentet e tilla mund të marrin vlerën e tyre për referim vetëm pas fitimit të pavarësisë nga ana e Republikës së Kosovës dhe atë në rast se fqinjët e saj, pra të Kosovës, do t'ia vinin në dyshim kufijtë shtetërorë. Një rregull e tillë në të drejtën pozitive ndërkombëtare është konfirmuar edhe nga ana e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Aktgjykimin e datës 22 dhjetor 1986 lidhur me çështjen e kufijve mes Burkina-Fasos dhe Republikës së Malit[427].

---

[426] Cf. Enver Hasani, "Mbretëria e Serbëve-Kroatëve-Sllovenëve nuk është vazhdimësi juridike e Mbretërisë së Serbisë", *Fjala* nr. 23 (Prishtinë, qershor, 1991) fq. 10-11.

[427] Cf. International Court of Justice: *Burkina Faso v. Republic of Mali*, Akgjykimi i datës 22.12.1986, fq. 565-657, në fq. 568.

Në vijim sa më sipër, të vetmet dokumente dhe veprime që mund të kenë vlerë dhe rëndësi të duhur nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare janë ato të nxjerra dhe të kryera gjatë procesit të shpërbërjes së ish-RSFJ-së, siç janë Kushtetuta e Kaçanikut, Referendumi për Pavarësi të Kosovës, zgjedhjet e lira, si dhe realiteti i ri i krijuar pas shpërbërjes së ish-RSFJ-së. Kjo gjithnjë me supozim se arrijmë të ushtrojmë kontrollin (pushtetin) efektiv mbi territorin e Kosovës. Shikuar nga aspekti i thjeshtë politik, referimi i pandërprerë në Kushtetutën e ish-RSFJ-së të vitit 1974, do të thotë krijim i keqkuptimeve në opinionin e brendshëm dhe në atë të jashtëm, si politik ashtu dhe akademiko-shkencor. Një gjë e tillë, për rrjedhojë, ka për pasojë "sjelljen e ujkut në shtëpi", siç thotë populli. Kjo do të thotë, me fjalë të tjera, krijim i pikëpamjes, para atyre që do të jenë ndërmjetësues në zgjidhjen e çështjes së Kosovës në kohën që po vjen, se qytetarët e saj kanë nostalgji për të kaluarën ish-jugosllave.

Më tutje, në pikën 2, nën *b* dhe *c*, të Mendimit, Komisioni ka vazhduar shqyrtimin e vet për të theksuar se:

> b. përbërja dhe efektiviteti i organeve kryesore të federatës, siç janë: Kryesia, Këshilli, Dhoma e Republikave dhe e Krahinave, Këshilli Ekzekutiv Federativ, Gjykata Kushtetuese dhe Armata Federative më nuk i plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes dhe të përfaqësimit, kritere këto të qenësishme për shtetin federativ; dhe
> c. përdorimi i forcës ka pasur për rrjedhojë konfliktin e armatosur mes elementeve të ndryshëm të Federatës, vdekjen e mijëra njerëzve, si dhe shkatërrimet e konsiderueshme. Pushteti federativ dhe ai i republikave janë treguar të pazotë për të siguruar respektimin e një sërë marrëveshjeve mbi ndërprerjen e zjarrit, të lidhura nën mbikëqyrjen e Bashkimit Evropian dhe KSBE-së.

Komisioni me këtë rast i ka dhënë rëndësi parimit të efektivitetit, sepse flitet për krijimin e shteteve të reja jashtë kontekstit kolonial ku ky parim luan një rol të rëndësishëm. Organet e ish-RSFJ-së nuk ishin në gjendje të funksionojnë si duhet, kurse ajo që nga serbët mendohej se paraqet Federatën (me përfaqësuesit e Serbisë, Malit të Zi, Kosovës dhe Vojvodinës) nuk ishte e aftë që të sigurojë respektimin e marrëveshjeve dhe të obligimeve të tjera të marra në planin ndërkombëtar. Në këtë kontekst, sërish janë përmendur pushtetet e republikave, jo pushtetet e ish-krahinave autonome.

Nga e cekura si më lart, Komisioni ka nxjerrë konkluzionet përfundimtare, si vijon:

- se, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë është në procesin e shpërbërjes;
- se, republikat janë të detyruara që problemet, siç janë suksedimi i shteteve, të cilat mund të lindin nga ky proces t'i zgjidhin në bazë të parimeve dhe të rregullave të së drejtës ndërkombëtare, me kujdes të veçantë për të drejtat e njeriut, të drejtat e kombeve dhe të minoriteteve; dhe së fundi,
- se, ato republika të cilat dëshirojnë mund të punojnë së bashku në krijimin e bashkësisë së re me institucione demokratike sipas zgjedhjes së tyre.

Kjo pikë e fundit i ka pararendur ngjarjeve të mëpastajme në ish-BRSS. Atje, tri nga gjithsej dymbëdhjetë republikat, Federata Ruse, Ukraina dhe Bjellorusia, patën formuar një aleancë të re me seli në Minsk. Mirëpo, edhe sikur kjo të ndodhte në rastin e ish-republikave të RSFJ-së, nuk do të quhej si kontinuitet i saj, pra si kontinuitet i ish-RSFJ-së, diçka që do të ishte në kundërshtim me kërkesat e Serbisë.

Lidhur me obligimin e shteteve të reja për zgjidhjen e problemeve të cilat dalin nga shpërbërja e ish-RSFJ-së, Komisioni, me herët nën pikën 2.e, ka theksuar në mënyrë precize për sa vijon:

> se, në pajtim me definicionin e pranuar në të drejtën ndërkombëtare, shprehja "suksesioni i shteteve" nënkupton zëvendësimin e një shteti me një tjetër për sa i përket përgjegjësisë për marrëdhëniet ndërkombëtare të një territori të caktuar. Kjo ndodh çdoherë kur arrihet deri tek ndryshimet territoriale të shtetit. Fenomeni i suksedimit i nënshtrohet parimeve të së drejtës ndërkombëtare, të cilat janë të inspiruara nga Konventat e Vjenës të viteve 1978 dhe 1983. Në, pajtim me këto parime, rezultatet e suksedimit duhet të jenë të drejta, sepse shtetet janë të lira që vetë me marrëveshje t'i rregullojnë kushtet dhe marrëdhëniet e suksedimit. Përveç kësaj, normat e të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme, në veçanti ato të cilat kanë të bëjnë me të drejtat themelore të njeriut, të drejtat e kombeve dhe të minoriteteve janë të obligueshme për të gjitha palët e suksesionit.

a. Territori

Shtetet, sikundër u vërejt nga shqyrtimet e mësipërme, para së gjithash, janë entitete territoriale. Lidhur me këtë, në çështjen e ishullit Palmas (1928), Gjykata Permanente e Drejtësisë Ndërkombëtare pati deklaruar, mes të tjerash, se:

> Sovraniteti territorial përfshin të drejtën ekskluzive të një shteti për të ushtruar funksionet shtetërore brenda territorit të tij. Dhe, anasjelltas, e drejta për të qenë shtet është e varur, në rend të parë, nga ushtrimi i plotë i pushtetit shtetëror mbi një territor të caktuar.

Edhe pse shteti duhet të posedojë territorin e caktuar, prapëseprapë nuk ekziston një rregull i cili përcakton minimumin e hapësirës së territorit të një shteti. Kështu, sot ekzistojnë shtete mjaft të vogla, si p.sh., Monako dhe Nauru, të cilat kanë 1,5 dhe 21 kilometra katrorë respektivisht, si dhe shtete mjaft të mëdha, si p.sh., Kina, India, Federata Ruse, ShBA-ja etj.

Shteti i ri mund të ekzistojë përkundër kërkesave eventuale të drejtuara kundër territorit të tij, sikundër që edhe shtetet aktuale mund të vijojnë jetën e tyre pa marrë parasysh kërkesat kundër territorit që ato e zotërojnë, si p.sh., rasti i *Izraelit.* Në lidhje me këtë, në praktikë mund të lindin dy situata: *së pari,* mundet që kërkesa të jetë e drejtuar kundër tërë territorit të shtetit të ri; dhe, *së dyti,* ajo mund të jetë e drejtuar vetëm kundër kufijve të shtetit, si p.sh., *rasti i Shqipërisë pas shpalljes së pavarësisë më 1912.* Ka raste kur këto dy situata koincidojnë me njëra tjetrën, siç ishte, rasti i Izraelit më 1948. Në këtë rast qe thënë se Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së nr.181 (II), datë 29 nëntor 1947, në njëfarë mënyre e ka bartur territorin në shtetin e ri, ashtu që vetëm çështja e kufijve të shtetit izraelit mbetet për t'u zgjidhur. Edhe pikëpamja e kundërt qe mbrojtur. Në fund, Izraeli u pranua në OKB më 11 maj 1949.

Pra, kërkesat kundër tërë territorit ose ato të drejtuara kundër një pjese të territorit të shtetit të ri nuk e godasin qenien shtet në të drejtën ndërkombëtare. *Me fjalë të tjera, edhe grindjet më serioze territoriale ose lidhur me kufijtë nuk e vënë në dyshim ekzistencën e shtetit të ri e as ekzistencën e shteteve ekzistuese. Kushti i vetëm i cili kërkohet është se ai, pra shteti, duhet të përbëhet nga një territor i caktuar koheziv dhe të jetë i qeverisur nga ana e një qeverie efektive, formulë kjo që dëshmon faktin se territori është më tepër kriter përbërës i qeverisë dhe pavarësisë, se sa ndonjë kriter i ndarë më vete.*

b. Popullsia e përhershme

Nëse shtetet janë entitete territoriale, ato janë gjithashtu edhe tërësi e individëve. Pra, popullata e përhershme është kusht i domosdoshëm për të qenë shtet, përkundër asaj që, si edhe me rastin e territorit, nuk ekziston një kufi minimal i përcaktuar për këtë. Për shembull, më 1973 popullsia e Naurus është vlerësuar të ketë qenë 6.500 banorë, e San Marinos 20.000 banorë,

etj. etj. Nga shtetet që konsiderohen si të vogla dhe me popullsi të vogël, vetëm shteti i Vatikanit mund të sfidohet mbi këtë bazë, dhe kjo më tepër për arsye të natyrës profesionale dhe jo të përhershme të popullsisë së tij, sesa të numrit të vogël.

c. Qeveria

Kriteri kyç në kuadrin e kritereve për të qenë shtet është padyshim pasja e një qeverie efektive. Qeveria, apo "qeveria efektive", përbën bazën e një kriteri tjetër themelor, atij të pavarësisë. Sovraniteti territorial nuk është pronësia mbi territorin, porse e drejta e qeverisjes mbi një territor. Andaj, ekziston argumenti i fortë për ta konsideruar qeverinë si një kriter të vetëm dhe mjaft të rëndësishëm të qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare, sepse gjithë të tjerat varen prej tij.

Në lidhje me këtë mund të jepen disa sugjerime. *Së pari,* për të qenë shtet, entiteti i dhënë duhet të posedojë një qeveri ose një sistem të atillë qeverisjeje i cili ka nën kontroll të përgjithshëm territorin e vet, duke përjashtuar kështu të gjitha entitetet e tjera. *Së dyti*, e drejta ndërkombëtare nuk parashtron kushte të veçanta për sa i përket natyrës dhe gjerësisë së këtij kontrolli, përveç faktit, mësa duket, se ai, d.m.th., kontrolli, duhet të përmbajë një shkallë të caktuar të ruajtjes së rendit dhe të ligjit. Dhe, *së treti*, me rastin e aplikimit të një parimi të përgjithshëm në rastet specifike dhe konkrete, siç është rasti me parimin e pasjes së qeverisë, duhet pasur parasysh konsideratat për sa vijon: a kundërshtohet qenia shtet e një entiteti mbi bazën e një titulli (ose të drejte) të vlefshëm në të drejtën ndërkombëtare? Nëse është kështu, atëherë kërkesa për efektshmërinë e qeverisë zbatohet rreptësisht, si p.sh., rasti i shpërbërjes së ish-RSFJ-së dhe i lindjes së shteteve të reja nga gjiri i saj si pasojë e joefektivitetit të qeverisë së ish-RSFJ-së. Titullin (të drejtën) e vlefshëm të qeverisë qendrore deri në atë kohë e ka pasur vetëm ish-RSFJ. Në këtë kontekst, pyetja e radhës është: a ekziston pëlqimi i shtetit të mëparshëm dhënë një qeverie e cila pretendon për të qenë autoriteti i vetëm mbi popullatën dhe territorin e caktuar, pa e kontrolluar atë efektivisht, por vetëm duke ushtruar një shkallë të caktuar të kontrollit? Në këtë rast, kërkesa e pasjes së një "qeverie efektive" mund të konceptohet në mënyrë më liberale, siç ka qenë rasti, ta zëmë, me krijimin e shteteve të reja gjatë procesit të dekolonizimit përmes bartjes graduale të sovranitetit në kolonitë e dikurshme nga ana e metropoleve të tyre të dikurshme.

Vlen të thuhet, fare në fund të trajtimeve si më sipër, se në të drejtën ndërkombëtare bëhet dallimi në mes të krijimit të shtetit të ri, në njërën anë, dhe ekzistencës ose zhdukjes së një shteti aktual, në anën tjetër.

Nga sa u tha më sipër dhe nga praktika e krijimit të shteteve të reja, qartë shihet se në pjesën dërrmuese të rasteve kriteri i qeverisë efektive, si kusht për të qenë shtet, ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm. *Nga rastet e shumta të praktikës së krijimit të shteteve të reja, në kuadrin e kontekstit të sipërcekur, po përmendim vetëm rastet e ishujve Oland ne Finlandë (1917), të cilat ngelën nën sovranitetin finlandez, tentimin për secesion (shkëputje) më 1960 të Katangës në Republikën Demokratike të Kongos (dikur Zaireja), raste këto të cilat kanë gjetur zbatim të përgjithshëm dhe të serishëm në situatat e shpërbërjes së ish-federatave socialiste (BRSS, Çekosllovakia dhe RSFJ), por edhe në rastet e tjera, siç është rasti i Republikës se Turqve Qipriotë.* I zumë ngoje këto raste për të treguar se gjithherë pavarësia e shteteve ekzistuese mbrohet nga rregullat së drejtës ndërkombëtare kundër invadimit ilegal dhe agresionin, ashtu që shtetet ekzistuese edhe përkundër mungesës së një qeverie efektive, ta zëmë si pasojë e okupimit, mbesin shtete në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare. Me një fjalë, ndërhyrjet ilegale dhe agresionet kundër sovranitetit të shteteve nuk shkaktojnë zhdukjen e subjektivitetit të shtetit të invaduar apo kundër të cilit është kryer agresioni. E themi këtë me këtë rast vetëm sa për të treguar se parimi i efektshmërisë së qeverisë dhe ai i pavarësisë, në procesin e krijimit të shteteve të reja, në të drejtën dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare konsiderohen si formale vetëm në rastet kur shtetet e reja formohen si pasojë e bartjes (dhënies) së pushtetit, përkatësisht si pasojë e bartjes së titullit ndërkombëtar nga ana e sovranit të mëparshëm. Pra, kjo si më sipër vlen vetëm kur flitet për njohjen ndërkombëtare të së drejtës për vetëvendosje. Në të kundërtën, parimi i pasjes së një qeverie efektive zbatohet me tërë ashpërsinë e tij[428].

ç. Zotësia për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera

Zotësia për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera nuk është prerogative vetëm e shteteve. Nëse shikohet ngushtë, ky nuk është kriter për të qenë shtet, por pasojë e qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare. Vëllimi dhe format e manifestimit të zotësisë në fjalë varen nga statusi dhe situata e veçantë e shtetit të dhënë. Edhe pse më shumë kemi të bëjmë me pasojë, megji-

[428] Cf. Louis Henkin, R.C. Pugh, Oscar Schachter, and Hans Smit, *International Law: Cases and Materials* (West Publishing: St. Paul, Minn., 1993) fq. 249.

thatë, zotësia për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera është një kriter mjaft i dobishëm me rastin e vlerësimit se kush është shtet në të drejtën ndërkombëtare.

Në këtë kontekst, pra të dobishmërisë së tij si kriter, duhet thënë se ky paraqet një tërësi të përbërë prej dy kritereve: qeverisë dhe pavarësisë. Për qeverinë si kriter për të qenë shtet folëm më sipër, kurse tani do ta shqyrtojmë kriterin e pavarësisë si një lloj të nënsegmentit të zotësisë për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera. Kjo është kështu, na duket krejt e natyrshme, sepse zotësia për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera presupozon një qeverim të brendshëm pa të cilin obligimet e marra ndërkombëtare nga ana e një shteti nuk do të mund të zbatoheshin. Përveç kësaj, zotësia për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera presupozon edhe ekzistencën e një entiteti të ndarë nga të tjerët, me qëllim të kontaktimit me ta, entitet ky për obligimet ndërkombëtare të të cilit nuk përgjigjet askush tjetër përveç tij. Me fjalë të tjera, zotësia në fjalë nënkupton, praktikisht, ekzistimin e zotësisë politike, teknike dhe financiare për të hyrë në marrëdhënie me shtetet dhe entitetet e tjera[429].

d. Pavarësia

Pavarësia është kriteri qendror i qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare. Ajo mund të përmblidhet me fjalët e gjyqtarit Max Huber, të thëna në rastin e sipërcekur të ishullit Palmas:

> Sovraniteti në marrëdhëniet mes shteteve nënkupton pavarësinë. Kurse pavarësia kundrejt pjesës së caktuar të globit është e drejtë për të ushtruar, mbi atë pjesë të globit dhe duke përjashtuar çdo shtet tjetër, funksionet e shtetit. Zhvillimi i shteteve në shekujt e fundit dhe, si rrjedhojë, zhvillimi i së drejtës ndërkombëtare kanë krijuar parimin e kompetencës ekskluzive të shtetit në raport me territorin e tij. Ky parim nënkupton që kompetenca ekskluzive e shtetit është pika nisëse në zgjidhjen e shumicës së çështjeve të cilat i përkasin marrëdhënieve ndërkombëtare.

Edhe pse preokupimi ynë është me pavarësinë si element bazë për të qenë shtet në të drejtën ndërkombëtare, në kontekstin tjetër ajo mund të ketë edhe kuptim tjetër. Është me rëndësi që të bëhet dallimi mes pavarësisë si kusht bazë për të qenë shtet në të drejtën ndërkombëtare dhe pavarësisë si kusht

---

[429] Cf. Barry E. Carter — Philip R. Trimble, *International Law: Cases and Materials* (West Publishing: St. Paul, Minn., 1995) fq. 457.

për ekzistimin e mëtejmë të shtetit në të drejtën ndërkombëtare. Për rastin e dytë, vlen të thuhet gjithashtu se qenia shtet është plotësisht në përputhje me pavarësinë e pjesshme sepse pavarësia e jashtme nuk ka të bëjë aspak me faktin nëse shteti i dhënë ka sovranitet të brendshëm dhe se si është ai i shpërndarë brenda tij. Pra, është e qartë se shteti mund të ketë cilësinë e shtetit në të drejtën ndërkombëtare pa qenë, në fakt, i pavarur[430].

Dallimi i mësipërm në mes pavarësisë si kusht për të qenë shtet dhe pavarësisë si kusht për ekzistimin e mëtejmë të shtetit në të drejtën ndërkombëtare quhet si i rëndësishëm, në veçanti, *për rastet e situatave secesioniste nga shteti metropol dhe në rastet e ndërhyrjes së parimit të vetëvendosjes në krijimin e shteteve të reja, pa marrë parasysh nëse flitet për krijimin e shteteve të reja në kontekstin kolonial apo jashtë këtij konteksti.*

Në lidhje me pavarësinë, në praktikë mund të lindin dy situata të ndryshme. Mund të ndodhë që një entitet, edhe pse formalisht jo i pavarur, në fakt vepron me një liri të madhe si në çështjet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme (pavarësia reale). Së dyti, mund të ndodhë që një shtet, edhe pse formalisht i pavarur, në të vërtetë është nën drejtimin e një shteti tjetër në atë masë sa që pavarësia e tij formale është e pavlerë dhe e pakuptimtë (pavarësia formale).

2.2. Kriteret për të qenë shtet të sugjeruara si rezultat i zhvillimit modern të së drejtës ndërkombëtare

Sikundër u pa më herët, kriteret tradicionale të qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare janë të bazuara kryekëput në parimin e efektivitetit të pushtetit shtetëror mbi një territor të caktuar. Mirëpo, jo të gjitha situatat e pushtetit efektiv janë shtete në të drejtën ndërkombëtare. Nëse e drejta ndërkombëtare nuk i sfidon situatat e entiteteve me pushtet efektiv, por ilegale për nga origjina e titullit (së drejtës) të tyre, siç ndodhi me rastin e serbëve të *Kroacisë* dhe të *Bosnjë-Hercegovinës*, rastin e turqve në Qipron veriore etj., atëherë ajo, pra e drejta ndërkombëtare, rrezikon që edhe vetë të bëhet joefektive.

Edhe në praktikën ndërkombëtare më herët ka pasur entitete efektive të veçanta, për të cilat ka ekzistuar mendimi i një pjese dërmuese të bashkësisë ndërkombëtare se ato nuk janë shtete. Si raste për t'u përmendur, përveç ato që u zunë ngoje më sipër, kanë qenë edhe *Rodezia (Zimbabveja e sotme) dhe*

[430] Cf. Christian N. Okeke, *Controversial Subjects of Contemporary International Law*, fq. 29.

Formoza (Tajvani i sotshëm). Dhe, anasjelltas, ka pasur raste kur disa entitete, edhe pse joefektive, janë konsideruar përgjithësisht si shtete nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, si p.sh., rasti i *Guine-Bisaos* para njohjes së saj nga Portugalia, si dhe rastet e tjera të *entiteteve të aneksuara në mënyrë të kundërligjshme* në periudhën 1936-1940. Llojit të parë, ndërkaq, i përkasin aktualisht të gjitha republikat e serbëve të krijuara në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kroaci, Republika e Çeçenisë, Republika e Turqve Qipriotë etj., kurse llojit të dytë do t'i përkiste Republika e Bosnjë-Hercegovinës pas shpalljes së pavarësisë së saj e deri në arritjen e Marrëveshjes së Dejtonit, pastaj republikat baltike (Lituania, Letonia dhe Estonia). Nga kjo del se qenia shtet nuk mund të barazohet gjithnjë me efektshmërinë e një entiteti, përkatësisht me pushtetin që ai entitet e ushtron. Një gjë e tillë nuk përkrahet në praktikën moderne ndërkombëtare. Natyrisht, efektiviteti mbetet parimi dominues dhe i përgjithshëm, mirëpo, është krejt në pajtim me këtë që u tha deri tani këtu edhe kur pohojmë se duhet ekzistuar disa përjashtime specifike dhe të kufizuara e të cilat bazohen në disa parime të tjera gjithashtu fundamentale. Ato parime kanë të bëjnë me sa vijon:

a. normat *jus cogens* (të detyrueshme) në të drejtën ndërkombëtare;
b. vetëvendosjen në të drejtën ndërkombëtare; dhe së fundi,
c. mosnjohjen ndërkombëtare të entiteteve të caktuara.

a. Normat jus cogens *në të drejtën ndërkombëtare këtu*

Argumenti sipas të cilit e drejta ndërkombëtare nuk mund të rregullojë lindjen, funksionimin dhe kontrollimin e entiteteve efektive territoriale nuk është veçse një shprehje e pikëpamjes se e drejta ndërkombëtare nuk mund të normojë marrëdhëniet në politikën ndërkombëtare — pra, asgjë tjetër pos shprehje e pikëpamjes se e drejta ndërkombëtare nuk ka fuqi detyruese. Nëse, megjithatë, shikohet rezultati i së drejtës ndërkombëtare këtyre viteve të fundit (p.sh., intervenimi i NATO-s në emër të OKB-së, pastaj futja e sanksioneve ekonomike dhe e sanksioneve të tjera edhe ndaj serbëve të Bosnjë-Hercegovinës pa qenë shtet i njohur në të drejtën ndërkombëtare), atëherë pa asnjë dyshim shihet se e drejta ndërkombëtare mund të rregullojë lindjen, funksionimin dhe kontrollimin e entiteteve efektive territoriale. Si e tillë, e drejta ndërkombëtare gjendet në fazën e një zhvillimi të madh në drejtim të kohezivitetit të plotë si sistem normash të detyrueshme. Në këtë kontekst, një zhvillim i rëndësishëm kohëve të fundit ka qenë pranimi i nocionit të normave *jus cogens*, përkatësisht i normave të sjelljes relativisht të

obligueshme në planin ndërkombëtar. Këto norma rregullojnë të drejtat e njeriut (individuale dhe kolektive), të drejtat e kombeve dhe të drejtat e minoriteteve, por edhe mosnjohjen ndërkombëtare të një entiteti si një detyrim ndërkombëtar në ato raste kur njohja bie ndesh me normat *jus cogens*. Në këtë kategori bëjnë pjesë edhe vetëvendosja dhe të drejtat e tjera njerëzore (individuale dhe kolektive). Një konstatim si ky është dhënë edhe në mendimin e cekur më herët të Komisionit Badinter ku është shtjelluar dhe qartësuar se normat *jus cogens* paraqesin një parakusht thelbësor për funksionimin normal të bashkësisë ndërkombëtare. Si të tilla, normat *jus cogens* paraqesin kufizime ndaj lirisë së mundshme të veprimit të shteteve.

Në praktikën dhe teorinë e së drejtës ndërkombëtare janë bërë kategorizime të këtyre normave në tri lloje. *Të llojit të parë* janë rregullat të cilat i mbrojnë bazat e rendit ndërkombëtar, si p.sh., rregullat lidhur me krimin e gjenocidit; rregullat mbi ndalimin e përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare, përveç në rast të vetëmbrojtjes, etj. etj. *Të llojit të dytë* konsiderohen rregullat të cilat i referohen bashkëpunimit paqësor me qëllim të mbrojtjes së interesave të përgjithshme të njerëzimit, si p.sh., rregullat mbi lirinë e detit etj. *Të llojit të tretë* dhe të fundit quhen ato rregulla të cilat mbrojnë të drejtat themelore njerëzore dhe të drejtat e popullsisë civile në rastet e konflikteve të armatosura.

Normat *jus cogens* fillimisht janë zbatuar vetëm ndaj marrëdhënieve kontraktuese. Zbatimi i tyre ndaj çështjeve të statusit territorial është më i vështirë. Në këto raste, pra në rastet e statusit territorial, çështja e cila shtrohet për diskutim është nëse jolegaliteti është esencial për shuarjen apo ekzistimin e mëtejshëm të një entiteti, të cilin e drejta ndërkombëtare mund ta trajtojë me plot të drejtë si joshtet apo, anasjelltas, rasti kur një entitet, edhe pse joefektiv, e drejta ndërkombëtare mund ta trajtojë si shtet. Me fjalë të tjera, *jus cogens* në këto raste është i barabartë me një kriter për të qenë shtet, rëndësia e të cilit mund të gjykohet në dy drejtime. *Së pari,* një rregull i tillë në të drejtën ndërkombëtare shërben për të përcaktuar nëse jolegaliteti kundrejt saj është i një natyre të atillë sa që mund ta refuzojë pranimin e një shteti i cili është krijuar në kundërshtim me këtë rregull, siç ishin rastet të cilat i cekëm më herët, të serbëve, turqve qipriotë etj. Së dyti, jolegaliteti i një entiteti mund ta godasë edhe titullin (të drejtën) e përfaqësimit ndërkombëtar nga ana e një qeverie të një shteti të dhënë. Këtu vlen të thuhet se këto rregulla vlejnë jo vetëm për shtetet, por edhe për territoret e ndërkombëtarizuara, si entitete të cilat u ngjasojnë shteteve. Rast i tillë është, p.sh., rasti i Saharës Perëndimore, rasti i Rodezisë dikur, apo rasti i vendeve baltike etj.

b. Vetëvendosja në të drejtën ndërkombëtare

Vetëvendosja, në masën qe ajo vepron si e drejtë, paraqet një ndër kriteret e qenies shtet në të drejtën pozitive ndërkombëtare dhe, në këtë kuadër, paraqet një përjashtim nga koncepti tradicional sipas të cilit krijimi i shteteve është vetëm çështje faktike dhe jo edhe një çështje juridike e së drejtës ndërkombëtare.

Si çështje e diskutueshme në praktikën ndërkombëtare, vetëvendosja është ngritur për herë të parë në rastin e diskutimit të problemit të ishujve Oland, të cilat sot gjenden nën sovranitetin e Finlandës, ani se me shumicë kanë qenë të banuar me popullsi suedeze. Si çështje, rasti i ishujve Oland është ngritur në prag të mbajtjes së sesionit te parë të Lidhjes se Kombeve. Me këtë rast qe thënë se vetëvendosja nuk është normë e së drejtës ndërkombëtare dhe si e tillë nuk njihet as në Konventën e Lidhjes së Kombeve.

Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, vetëvendosja u trajtua në nivelin e një parimi legal, përkatësisht në nivelin e një të drejte, duke filluar nga Karta e OKB-së dhe dokumentet e tjera ndërkombëtare. Karta në mënyrë shprehimore thekson se "popujt" (*peoples*) janë të autorizuar për vetëvendosje. Kjo përzgjidhje e subjektit është përdorur edhe në Deklaratën mbi Kolonializmin nr. 1514 (XV) të vitit 1960, si dhe në pjesën dërmuese të akteve ndërkombëtare. Në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare, kjo mënyrë e përcaktimit të subjekteve që gëzojnë të drejtën për vetëvendosje iu është ekspozuar, me plot të drejtë, kritikave të shumta. Në pajtim me këtë, autori Ivor Jennings, në mes të tjerash, thekson se "në sipërfaqe kjo duket e arsyeshme: t'i lejojmë popujt të vetëvendosin, por, kjo, në esencë, është qesharake sepse popujt nuk mund te vetëvendosin derisa dikush tjetër mos të vendosë se kush janë popujt që kanë të drejtën e vetëvendosjes"[431].

Sikundër mund të vërehet, parimi i vetëvendosjes si parim legal, përkatësisht si një e drejtë ka edhe dimensionin e vet të theksuar politik, i cili vjen në shprehje çdoherë kur duhet përcaktuar caqet, përkatësisht subjektet e autorizuara për vetëvendosje. Gjithmonë një i treti, i cili quhet bashkësi ndërkombëtare, ka vendosur dhe vendos për atë se cilat janë caqet e zbatimit të këtij parimi në të drejtën ndërkombëtare.[432] Rrjedhimisht, praktika e veprimit të shteteve në këtë drejtim, përfshirë këtu edhe rastet e fundit të zbatimit

[431] Cf. Ivor Jennings, *The Approach to Self-Government* (Cambridge UP: Cambridge, 1956) fq. 56.
[432] Cf. Patric Daillier et Alain Pellet, *Droit International Public*, fq. 400-402, 490-503.

të këtij parimi në ish-BRSS, RSFJ dhe Çekosllovaki, shërben si treguesi kryesor për përcaktimin e caqeve të zbatimit të këtij parimi.

Sikundër u pa më lart, vetëvendosja si parim legal, përkatësisht si e drejtë është e rrënjosur, në njëfarë mënyre, në korpusin e normave ndërkombëtare lidhur me këtë çështje dhe atë në tri drejtime. Së pari, vetëvendosja paraqet një parim antikolonizues, që do të thotë se kjo e drejtë, në formën e përcaktimit te lirë të fatit politik, ekonomik dhe kulturor, zbatohet, para së gjithash, ndaj "territoreve joautonome" (*non-self-governing territories*) të cilat përmenden në krerët XI, XII dhe XIII të Kartës së OKB-së.

Problemi më i komplikuar lidhur me atë se kush ka të drejtën për vetëvendosje paraqitet tek kategoria e rasteve të cilat në të drejtën ndërkombëtare njihen si "territore të cilat formojnë hapësira të veçanta politiko-gjeografike, popujt e të cilave nuk marrin pjesë në qeverisjen ose administrimin e tyre, përkatësisht në vetëqeverisjen e regjionit ku këta popuj kanë një kompaktësi të theksuar". Në këto raste, në të drejtën ndërkombëtare flitet për situatat e a.q. "të mungesës së sovranitetit" (*lack of sovereignty*, *carence de souveraineté*)[433] ose, po ta përdorim terminologjinë e Komitetit te Reporterëve në rastin e ishujve Oland (1920), këtu flitet për territoret e administruara keq dhe jodrejt, përkatësisht për rastet e mohimit të së drejtës interne për vetëvendosje. Që këto raste të jenë të barazuara me ato të kolonive, përkatësisht me "territoret joautonome", në literaturë thuhet se nevojitet që të plotësohen disa kushte.

Si kusht i parë që duhet plotësuar në mënyrë që këto territore të barazohen me "territoret joautonome" është rrethana e ekzistimit të shkeljeve sistematike të të drejtave njerëzore dhe mohimi total i tyre, si dhe mungesa e theksuar e të drejtave demokratike për një pjesë të caktuar të popullsisë e cila, në rrethana normale, do të konsiderohej si minoritet. Kushti i dytë i referohet pasjes së një identiteti të qartë dhe të veçantë të kësaj popullate kundrejt popullit shumicë me të cilin jeton në një shtet. Si kusht i fundit është se kjo popullatë duhet të banojë në një territor të caktuar dhe kërkesa e saj për shkëputje (e drejta eksterne për vetëvendosje) nga shteti në të cilin jeton të jetë e përkrahur fuqimisht nga shumica e popullatës së tillë. Ka raste kur kërkohet që shkëputja të mos provokojë ndonjë konflikt të armatosur mes shteteve të vjetra dhe të reja.[434]

---

[433] Cf. Heather Wilson, *International Law and the Use of Force by National Liberation Movements* (Oxford UP: Oxford, 1998) fq. 82.

[434] Cf. Louis Henkin et al., *International Law: Cases and Materials* (West Publishing: St. Paul, Minn., 1993) fq. 305.

Si shembuj tipikë të njohjes së të drejtës për vetëvendosje si pasojë e "mungesës së sovranitetit", përkatësisht si pasojë e administrimit të keq dhe jo të drejtë të një territori të caktuar përmenden rasti i Bangladeshit (1970)[435]dhe ai i Saharës Perëndimore (1975). Ky i fundit akoma është i pazgjidhur. Megjithatë, praktika ndërkombëtare ka shënuar edhe raste të mohimit të së drejtës për vetëvendosje të popujve të territoreve të caktuara, përkundër plotësimit të kushteve të sipërcekura për të qenë popull me të drejtën për vetëvendosje eksterne. Të tilla kanë qenë rastet e tentimit për shkëputje të Katangës (Kongo) dhe Biafrës (Nigeri). Në këto dy raste, parimi i sovranitetit shtetëror dhe i integritetit territorial ka fituar përparësi kundrejt së drejtës për vetëvendosje.

Në këtë mënyrë, ne arritëm deri tek drejtimi i dytë i veprimit të së drejtës për vetëvendosje, ashtu siç koncipohet kjo e drejtë në kuadrin e korpusit të dokumenteve aktuale ndërkombëtare. Në këtë kuptim, e drejta për vetëvendosje ndalon okupimin e huaj të shteteve dhe mbron integritetin territorial dhe sovranitetin e tyre shtetëror, parim ky i njohur dhe i sanksionuar nga Karta e OKB-së. Kjo rregull kësisoj përfshin të drejtën e popullit të shtetit të caktuar që vetë të vendosë lirisht për formën e qeverisjes, përkatësisht për rregullimin e brendshëm politik të shtetit (e drejta interne për vetëvendosje). Nëse kemi të bëjmë me shtete shumëkombëshe të cilat kanë rregullim shtetëror të përbërë, zakonisht federativ, atëherë, me rastin e shpërbërjes së tyre, nuk paraqitet ndonjë problem i veçantë në përcaktimin (identifikimin) e titullarëve të së drejtës për vetëvendosje. Deri më tani, bazuar në praktiken ndërkombëtare, kjo e drejtë u ka takuar republikave të tipit federal, pa marrë parasysh se në disa kushtetuta, si p.sh., ajo e ish-RSFJ-së (1974), këtë të drejtë ua ka njohur vetëm kombeve pa marrë parasysh nëse kanë jetuar në një republikë apo në disa sosh. Do të ishte vështirë të imagjinohej përcaktimi se kujt i takon e drejta për vetëvendosje në rastet e shpërbërjes së shteteve me rregullim unitar.[436] Kjo, megjithatë, nuk nënkupton se përcaktues kryesor është rregullimi i brendshëm kushtetues i tipit federal në të cilin vetëm republikat federale gëzojnë të drejtën për vetëvendosje. Tek e fundit, historia e krijimit

---

[435] Cf. S.V. Man, "The 1971 War on the Indian Subcontinent and the International Law", *Indian Journal of International Law* vol. 12 (1972) fq. 12. Krahaso edhe me kumtesën tonë me titull "Sovraniteti dhe vetëvendosja", lexuar më 24 maj 1991, në simpoziumin shkencor më titull *Shqiptarët dhe Evropa, dje dhe sot*, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (mbajtur në Prishtinë, më 23-26 maj 1991); Enver Hasani, "Sovraniteti dhe vetëvendosja", *Fjala* nr. 24 (Prishtinë, 1990) fq. 3.

[436] Cf. Patric Daillier et Alain Pellet, *Droit International Public*, fq. 502.

dhe prishjes së shteteve tregon që, shikuar historikisht, kanë qenë federatat ato që më shumë se tipat e tjerë të shteteve të përbëra janë shpërbërë apo transformuar në një lloj tjetër me homogjen të rregullimit shtetëror.

Drejtimi i tretë dhe i fundit i zbatimit të së drejtës për vetëvendosje ka të bëjë me faktin se ajo zbatohet ndaj të gjitha situatave të tjera si një ndër mënyrat më të përshtatshme, përkatësisht si një kriter i dobishëm për zgjidhjen e konflikteve territoriale, siç janë, p.sh., rastet e organizimit të plebishiteve nën mbikëqyrjen ndërkombëtare. Këtu, megjithatë, flitet për ndryshimet territoriale të bëra me vullnetin e shteteve sovrane.

Në cilën kategori të vetëvendosjes bën pjesë rasti i pavarësimit të republikave të ish-Jugosllavisë? Në fillim fare, ne mund të konstatojmë se bashkësia ndërkombëtare ka shikuar shpërbërjen e ish-federatave socialiste (BRSS, RSFJ dhe Çekosllovakia) nga këndi i parimit të vetëvendosjes. Ky këndvështrim është përqafuar veçanërisht nga ana e Bashkimit Evropian dhe anëtarëve të tij. Kjo për faktin se që në takimin e datës 16 dhjetor 1991 të ministrave të jashtëm të Bashkimit Evropian u mor qëndrim ndaj shpërbërjes së ish-BRSS-së dhe RSFJ-së. Në këtë takim, të mbajtur në Bruksel, u vendosën disa "rregulla të lojës", Kriteret për Njohjen e Shteteve të Reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik, të cilat u zunë ngoje më herët. Teksti i Kritereve për Njohje fillonte me fjalët vijuese:

> Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare të tij konfirmojnë lidhshmërinë e tyre ndaj parimeve të Aktit të Helsinkit dhe të Kartës së Parisit, me një theks të veçantë ndaj parimit të vetëvendosjes.

Përmes këtyre fjalëve, Bashkimi Evropian synonte theksimin se shpërbërja graduale e ish-BRSS-së, RSFJ-së dhe Çekosllovakisë konsiderohej si një realizim i parimit të vetëvendosjes, përkatësisht si një proces historik që buron nga realizimi i konceptit sipas të cilit secili popull duhet që lirisht ta zgjedhë statusin e vet ndërkombëtar.

Vetëvendosja, sipas Kritereve për Njohje, doli në spikamë edhe në një aspekt tjetër, i cili ishte i panjohur deri në atë kohë. Në të vërtetë, në mesin e kushteve të ndryshme, të cilat duheshin plotësuar nga ana e shteteve të reja në lindje e sipër në mënyrë që ato të njiheshin si të tilla, Bashkimi Evropian parashtroi edhe kushtin e "respektimit të sundimit të ligjit, të demokracisë dhe të drejtave njerëzore", si dhe "dhënien e garancive për të drejtat e grupeve etnike, nacionale dhe të drejtave të minoriteteve brenda kuadrit të përcaktuar nga OSBE-ja". Me fjalë të tjera, njohja e shteteve të reja u bë e varur nga pasja e një qeverisjeje demokratike, përkatësisht nga respektimi i vetëve-

ndosjes së brendshme (interne). Ky qëndrim i Bashkimit Evropian thuhet se është fare i ri për faktin se, për herë të parë, përmes kushtëzimit të njohjes së shteteve të reja me respektin e tyre për demokraci, shtetet anëtare afirmuan lidhjen tejet të ngushtë e cila ekziston në mes të vetëvendosjes së jashtme (interne) dhe asaj të jashtme (eksterne, apo ndërkombëtare). E vërteta është se, megjithatë, kjo lidhje tanimë kishte qenë e njohur, në nivelin teorik, në Konventën e OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike, neni i parë, si dhe në dispozitat e tjera respektive të saj.

Përveç kësaj lidhjeje, Bashkimi Evropian vuri në spikamë edhe një lidhje tjetër: lidhjen mes vetëvendosjes dhe mbrojtjes së minoriteteve. Me këtë dokument u bë e qartë se vetëvendosja interne nuk mund të pranohej pa mbrojtjen e plotë të minoriteteve, ashtu siç nuk mund të përkrahej vetëvendosja eksterne nëse nuk realizohej segmenti intern i saj.

Mbi bazën e këtyre Kritereve për Njohje janë formuluar edhe mendimet nr. 2 dhe 3 të Komisionit të Arbitrazhit (Badinterit) të datës 11 janar 1992, në lidhje me atë se kush është titullar i të drejtës për vetëvendosje: republikat ose kombet.[437] Këto mendime paraqesin, në të njëjtën kohë, përgjigjen e Komisionit në pyetjen e parë dhe të tretë të parashtruar nga ana e Serbisë, të cilat u cekën më herët.

Në fillim të krizës së ish-Jugosllavisë, Serbia, e bindur se ka të drejtën e pakufishme të nënshtrimit të të tjerëve në emër të subjektivitetit ndërkombëtar të ish-RSFJ-së, përkatësisht e bindur se Komisioni do të zbatojë kriteret klasike të qenies shtet në mënyrë të rreptë legaliste dhe pa ndonjë zbutje ose modifikim të tyre sipas standardeve të së drejtës ndërkombëtare pozitive, që nga fillimi i punës së Konferencës së Hagës, u kërcënohej të tjerëve, *a priori*, me rezultatet e Komisionit Badinter. Një prej pyetjeve të Serbisë kishte të bënte me atë se kush janë titullarët e së drejtës për vetëvendosje në ish-RSFJ: *popujt ose republikat*. Duke u bazuar në mendimin e mëhershëm, Komisioni i Badinter konstatoi se "republikat kanë të drejtën e mbrojtjes ndërkombëtare të kufijve të jashtëm të tyre, bazuar në Kartën e OKB-së, Deklaratën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi parimet e së drejtës ndërkombëtare që kanë të bëjnë me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin në mes të shteteve (1970), si dhe me Aktin Final të Helsinkit (1991)[438]. Situata faktike e krijuar në ish-RSFJ, në ato momente kur po shkruhej mendimi/përgjigja në fjalë, ka pasur për pasojë, sipas Komisionit, "zbatimin e së drejtës ndërkomb-

[437] Cf. Mendimi Nr. 3, para. 1 dhe 2; Mendimi Nr. 2, 11 janar 1992.
[438] Cf. Mendimi Nr. 3, para. 2, 11 janar 1992.

ëtare"[439]. Me këtë, Komisioni ka mbrojtur territoret e republikave në bazë të parimit të ashtuquajtur *uti possidetis juris*, sipas modelit të zbatuar në procesin e dekolonizimit, me theks të veçantë në mosnjohjen e pasojave legale të përdorimit të forcës në procesin e krijimit të shteteve të reja.

Duke folur për llojin e dytë të titullarëve të së drejtës për vetëvendosje, Komisioni, përveç republikave, ka theksuar se "bazuar në praktikën aktuale, e drejta ndërkombëtare nuk i definon konsekuencat e sakta të së drejtës për vetëvendosje e as caqet e zbatimit të kësaj të drejte. Në anën tjetër, e drejta për vetëvendosje në asnjë mënyrë nuk nënkupton modifikimin e kufijve ashtu siç kanë qenë ata në momentin e fitimit të pavarësisë, përveç sipas marrëveshjes së përgjithshme"[440].

Në këtë kontekst, Komisioni konfirmoi se të gjithë anëtarët e minoritetit janë të autorizuar (pra, janë titullarë) që të përfitojnë nga të drejtat e minoriteteve dhe nga të drejtat njerëzore të përcaktuara nga konventat ndërkombëtare. E kuptuar në këtë mënyrë, e drejta për vetëvendosje përbën korpusin e të drejtave njerëzore, interpretim ky, sipas Komisionit, i konfirmuar edhe në nenet e para të Konventave për të Drejtat e Njeriut të vitit 1966. Rrjedhimisht, vazhdonte më tej Komisioni, "në bazë të marrëveshjeve mes republikave anëtarët e popullit serb në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kroaci mund të fitojnë njohjen e shtetësisë sipas dëshirës së tyre, me të gjitha të drejtat të cilat dalin nga ajo njohje *vis-à-vis* shteteve përkatëse". Krejt në fund, Komisioni konkludoi se serbët e Bosnjë-Hercegovinës dhe të Kroacisë kanë të drejtën e përfitimit nga të gjitha të drejtat të cilat iu takojnë dhe iu njihen minoriteteve dhe grupeve etnike duke u bazuar në të drejtën ndërkombëtare dhe në Projekt-Konventën e Lordit Carrington[441].

Nëse shikohen me kujdes esenca e këtyre përgjigjeve të Komisionit në lidhje me pyetjen e parë dhe të tretë të Serbisë, atëherë besojmë se është i qartë relacioni i titullarëve të së drejtës për vetëvendosje dhe i caqeve të zbatimit të tij në kontekstin e ish-RSFJ-së.

---

[439] Cf. Mendimi Nr. 3, para. 1, 11 janar 1992.

[440] Cf. Mendimi Nr. 2, 11 janar 1992.

[441] Në bazë të kësaj Konvente qe formuluar plani famoz "Z4" për autonominë e serbëve të Kroacisë, të cilin plan ata e refuzuan dhe pastaj filloi në gusht të vitit 1995 operacioni i famshëm kroat kundër serbëve lokalë, i njohur si "Stuhia" (*Oluja*).

c. Mosnjohja ndërkombëtare e një entiteti

Ekzistojnë dy baza për mosnjohjen ndërkombëtare si shtet të një entiteti: *mosnjohja ndërkombëtare si shtet për shkaqe politike dhe mosnjohja ndërkombëtare si shtet për shkaqe juridike.* Mosnjohja ndërkombëtare për shkaqe politike, e cila ka qenë fenomen mjaft i shpeshtë pas vitit 1945, nuk është objekt interesimi këtu. Ajo çka na intereson neve këtu ka të bëjë me mosnjohjen ndërkombëtare mbi baza juridike sepse, aktualisht, ajo paraqet fenomenin rreth të cilit kanë lindur dhe po lindin keqkuptimet gjatë procesit të zgjidhjes së krizës në ish-Jugosllavi[442].

Mosnjohja mbi baza juridike nuk është fenomen i ri. Veçanërisht në formë të mosnjohjes kolektive, ky fenomen ka fituar në spikamë që në vitin 1932. Në vitet e pas-Luftës së Dytë Botërore, ka qenë rasti i Rodezisë së Jugut ai i cili pati krijuar obligimin e shteteve për mosnjohjen ndërkombëtare të këtij entiteti, i cili bazohej në diskriminimin racor dhe shkeljen sistematike të të drejtave të njeriut, dhe pastaj rasti i Republikës së Turqve Qipriotë etj.

Në vitet e fundit, shpërbërja e ish-RSFJ-së sërish hapi problemet e njohjes së entiteteve dhe të situatave të caktuara faktike të cilat ishin si rezultat i luftës dhe i agresionit. Mosnjohjen ndërkombëtare si koncept, në rastin e krizës në ish-RSFJ, e gjejmë në formulimet e ndryshme të bashkësisë ndërkombëtare dhe të organeve të saj, sipas të cilave "*nuk do të ketë njohje ndërkombëtare të atyre entiteteve dhe situatave faktike të cilat janë rezultat i agresionit dhe i luftës*".

Problemet të cilat lindin në këto raste burojnë nga raporti mes karakterit objektiv të sovranitetit dhe plotësimit të kushteve konkrete të cilat kërkohen për të pasur të drejtën e ushtrimit të tij. Kontradikta themelore, pra, qëndron në natyrën dhe në rëndësinë e njohjes ndërkombëtare të shtetit, respektivisht në atë se kush ka të drejtën e formimit të shtetit[443]. Në rastin e krizës në ish-Jugosllavi, duket se disa popuj të saj e patën barazuar njohjen e shtetit me vetë krijimin e tij, gjë që nuk është e vërtetë. Njohja e shtetit, sigurisht që paraqet një akt mjaft me rëndësi, por jo edhe vendimtar, në procesin e krijimit të shteteve. Ajo, pra akti i njohjes, duhet të shikohet në kombinim me të drejtën (titullin), përkatësisht në kombinim me atë se kush është titullar i së drejtës për vetëvendosje. Nëse është saktësuar se kush është titullar i kësaj të drejte, atëherë parimi i efektivitetit mund të zbutet ose, anasjelltas, mund të

[442] Cf. Marc Weller, "The International Response to the Dissolution of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia", *American Journal of International Law* vol 86, no. 3 (1992) fq. 588.
[443] Cf. Patric Daillier et Alain Pellet, *Droit International Public*, fq. 339.

kërkohet që ai të zbatohet në praktikë me një rreptësi më të madhe. *Në këtë kontekst, duhen shikuar edhe formulimet e neneve respektive të Parimeve për Rregullimin Kushtetues të Bosnjë-Hercegovinës (1992), të Marrëveshjes së Gjenevës (8 shtator 1992)* dhe të Marrëveshjes së *Dejtonit (nëntor 1995)*, të dyja këto marrëveshje të arritura në lidhje me zgjidhjen e krizës në Bosnjë-Hercegovinë.

Në vijim sa më sipër, nuk janë vetëm këto dy marrëveshje që kanë peshë në diskutimin tonë lidhur me mosnjohjen në të drejtën ndërkombëtare dhe rëndësinë e saj praktike: të gjitha formulimet tjera ndërkombëtare të bëra në planin universal (OKB-ja) dhe regjional (OSBE dhe Këshilli i Evropës), përfshirë këtu edhe mendimet e Komisionit Badinter si një organ i bashkësisë ndërkombëtare me autorizime konkrete në zgjidhjen e krizës në ish-Jugosllavi, kanë ngërthyer qëndrimet e sipërcekura për *mosnjohjen ndërkombëtare të entiteteve të krijuara me dhunë dhe rezultati i agresionit nga jashtë*.

Lidhur me mosnjohjen mbi baza juridike duhet të bëhen dy dallime. Së pari, njohja ndërkombëtare e një situate jolegale nuk është domosdoshmërisht e ndaluar nga e drejta ndërkombëtare. Dhe, *së dyti*, mund të ndodhë që të refuzohet njohja e legalitetit ose e vlefshmërisë së një veprimi të caktuar, p-or, në anën tjetër, shtetet mund të jenë të detyruara t'i njohin, respektivisht pranojnë, disa prej pasojave të cilat burojnë nga një veprim i tillë jolegal ose i pavlefshëm. Kështu, me rastin e shpalljes së pavarësisë në mënyrë jolegale nga ana e të a.q. republikave serbe në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë, bashkësia ndërkombëtare ka qenë dhe akoma ngelet unike për mosnjohjen e tyre, përkundër faktit se pasojat e veprimeve të tilla të serbëve, veçanërisht në Bosnjë-Hercegovinë, u njohën pjesërisht nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, si p.sh., njohja e tyre si palë ndërluftuese dhe si palë e barabartë në procesin e rregullimit kushtetues të Bosnjë-Hercegovinës.

Nga e cekura si më lartë, mund të shihet se mosnjohja ndërkombëtare e entiteteve të caktuara është teknikë ose metodë se si duhet t'u qasemi situatave jolegale në të drejtën ndërkombëtare. Ajo gjithmonë ka lidhshmëri me çështjen e statusit territorial të shteteve, përkatësisht me atë se kush ka titullin e sovranit mbi një territor të caktuar. Kështu, nëse një entitet pretendon se është shtet, por nuk i plotëson kushtet e cekura më herët për qenien shtet në të drejtën ndërkombëtare, atëherë njohja e tij, edhe pse mund të krijojë efekte në baza bilaterale, konsiderohet si jolegale dhe e pavlefshme kundrejt sovranit të mëparshëm, si p.sh., rasti i turqve qipriotë. Dhe, rasti tjetër, kur kriteret për njohje ndërkombëtare kanë të bëjnë me legalitetin në të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, atëherë njohja ndërkombëtare është ilegale

dhe e pavlefshme kundrejt të gjithëve (*erga omens*), si p.sh., rastet e cekura të republikave serbe në Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë. Në këtë kontekst duhet shikuar edhe miratimin e operacionit ushtarak të kroatëve, operacioni i sipërcekur "Stuhia" i gushtit 1995 kundër entiteteve ilegale serbe, me qëllim të riintegrimit të tyre në shtetin kroat.

Në rastin e fundit, pra të ilegalitetit dhe të pavlefshmërisë *erga omnes*, njohja është e ndaluar nga e drejta ndërkombëtare sepse paraqet një aspekt të obligimit për respektimin e rregullave të së drejtës ndërkombëtare. Zakonisht, këto raste kanë të bëjnë me marrëdhëniet e qenies shtet dhe të statusit territorial të një entiteti. Në praktikë, lidhur me këto raste, është pranuar teza e mosnjohjes kolektive të entiteteve jolegale, e cila për herë të parë është iniciuar nga *Doktrina Stimson* dhe rezolutat respektive në lidhje me krizën e cekur të *Manxhurisë*. Më vonë ka gjetur zbatim edhe në rastet e *Rodezisë* dhe të *Namibisë*. Mosnjohja në këto raste ka qenë e ndaluar në bazë të statusit që e kanë pasur në atë kohë këto entitete. Rëndësia e obligimit kolektiv për mosnjohje, siç thekson edhe autori Hersch Lauterpacht (Hersh Lauterpaht), shkon përtej kësaj për faktin se ajo, pra mosnjohja ndërkombëtare, e fuqizon më tej pozitën e dhënë legale dhe pengon konsolidimin e situatave jo legale dhe të pavlefshme.[444]

2.3. Kriteret për të qenë shtet për qëllimet e Lidhjes së Kombeve dhe të Organizatës së Kombeve të Bashkuara

Këtu, në të vërtetë, nuk flitet për kritere në kuptimin e ngushtë të fjalës. Më tepër kemi të bëjmë me një përdorim disi më të zbutur të termit shtet, i cili haset në Konventën e Lidhjes së Kombeve dhe në Kartën e OKB-së. *Konteksti i përdorimit më të zbutur të termit shtet, në këto dokumente, i referohet pranimit në këto organizata të karakterit universal, çështjeve të sigurisë ndërkombëtare, pjesëmarrjes në punën e organeve ekzekutive të këtyre dy organizatave, dhe së fundi, termi shtet në kontekstin e cekur si më lartë i referohet pranimit në Gjykatën Ndërkombëtare.* Mirëpo, në të gjitha këto raste, nuk duhet menduar se ky përdorim kësisoj i termit shtet ka për pasojë mohimin e kritereve të qenies shtet të cilat u diskutuan më herët në këtë punim.

Praktika e Lidhjes së Kombeve në lidhje me çështjet e statusit dhe të anëtarësimit në të nuk ishte shumë e pasur, sepse ekzistonte synimi që kushtet për të qenë shtet të zbatoheshin në mënyrë mjaft të rreptë. Entiteteve, siç

[444] Cf. Hersch Lauterpacht, *Recognition in International Law* (Cambridge UP: Cambridge, 1947) fq. 412.

ishin *Armenia, Gjeorgjia* dhe *Ukraina,* të cilat ishin shkëputur nga *Perandoria Ruse*, iu qe refuzuar kërkesa për anëtarësim në Lidhje nën pretekstin e mungesës së stabilitetit, përkatësisht të permanencës së pushtetit efektiv shtetëror. Ndërsa, entiteteve të tjera, si p.sh., *Letonisë, Lituanisë dhe Estonisë* iu qe shtyrë kërkesa për pranim në Lidhje deri në momentin kur ato të tregonin permanencë të caktuar të pushtetit efektiv shtetëror. *Lihtenshtajni* qe refuzuar mbi bazën e vogëlsisë së tij, përkatësisht se ai, edhe pse ishte shtet, nuk konsiderohej si i aftë për të zbatuar obligimet të cilat dilnin nga Konventa e Lidhjes e Kombeve.

Sikurse Konventa e Lidhjes së Kombeve, ashtu edhe Karta e OKB-së, për të njëjtat arsye, e bënë dallimin mes anëtarëve themelues të saj dhe atyre që janë pranuar më pastaj, pra pas themelimit të OKB-së. Përveç kësaj, disa anëtarë themelues të OKB-së nuk qenë shtete në momentin e themelimit të saj, si p.sh.: India, statusi i së cilës kishte mbetur i pandryshuar që nga viti 1919; Filipinet, shtet që ishte pak a shumë në pozitë të njëjtë me Indinë; dhe së fundi, rasti i Bjellorusisë dhe Ukrainës, dy republikave sovjetike.

Për sa i takon *anëtarëve të rinj të OKB-së, në nenin 4 të Kartës* janë përcaktuar pesë kushte për t'u anëtarësuar në këtë organizatë. Entiteti i cili e paraqet kërkesën për anëtarësim duhet t'i plotësojë kushtet për sa vijon:

(1) duhet të jetë shtet;
(2) duhet të jetë paqedashës;
(3) duhet të pranojë obligimet e Kartës së OKB-së;
(4) duhet të jetë i aftë për t'i zbatuar këto obligime; dhe,
(5) duhet të ketë vullnet për zbatimin e obligimeve si më lartë.

Në praktikën e deritanishme ndërkombëtare të OKB-së, duket se termi shtet ka pasur të njëjtin kuptim si edhe në të drejtën e zakonore ndërkombëtare. Në Kartën e OKB-së, termi "shtet" përmendet 34 herë. Ky fakt nënkupton se fjala shtet në një dokument ndërkombëtar të këtij lloji, por edhe në llojet tjera të dokumenteve ndërkombëtare, në përgjithësi ka kuptimin e shtetit për qëllimet e së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare, ashtu siç e shqyrtuam më deri tani.

Se kjo është kështu shihet edhe nga dispozitat e tjera të Kartës së OKB-së të cilat i referohen zgjidhjes së konflikteve në mes të shteteve. Kështu, "*shtetet joanëtare të OKB-së do të ftohen për të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet para Këshillit të Sigurimit lidhur me konfliktet në të cilat ato janë palë*", thuhet në nenin 32 të Kartës së OKB-së. Kurse, gjithherë në këtë vijë, në nenin 35(2) të Kartës thuhet se "*shtetet joanëtare mund t'i prezantojnë para OKB-së konfliktet në të cilat ato janë palë*". Në zbatim të këtyre dispozitave,

më 1947, Këshilli i Sigurimit të OKB-së ka ftuar *Indinë* dhe *Hajdarabadin* për të marrë pjesë në debatet respektive, përkundër faktit që statusi i tyre pati qenë dubioz. Në debatin lidhur me ftesën e Indisë është thënë se një entitet mund të jetë shtet në kuptim të nenit 32 të Kartës së OKB-së, i cili i referohet shteteve me të vetmin qëllim që drejtësia të vihet në vend dhe që të dy palët të kenë mundësinë e paraqitjes së pikëpamjeve të tyre, përkundër faktit që nuk është tërësisht sovran.

Edhe dispozita e nenit 93(2) të Kartës, e cila i referohet pranimit në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë të shteteve joanëtare të OKB-së, nuk e mënjanon kuptimin standard të shteteve në të drejtën ndërkombëtare. Megjithatë, praktika e fundit pranë kësaj gjykate ka treguar një shmangie nga kjo rregull. Fjala është për aplikimin e bërë nga Bosnjë-Hercegovina kundër të a.q. RFJ (Serbia dhe Mali i Zi) lidhur me zbatimin e Konventës së Gjenocidit të vitit 1948[445]. Në këtë rast, një entiteti të panjohur ndërkombëtarisht, i cili nuk ishte anëtar i Konventës së Gjenocidit, pra të a.q. RFJ, iu njoh statusi i palës ndërgjyqëse. Në një punim tonin[446], këtë veprim të Gjykatës së Hagës e kemi arsyetuar me shkaqe humanitare dhe të oportunitetit politik.

Edhe praktika e shpërbërjes së ish-RSFJ-së, e cila ka ngritur çështjet e sigurisë ndërkombëtare dhe të pjesëmarrjes së palëve në konflikt pranë organit ekzekutiv të OKB-së, Këshillit të Sigurimit, dëshmon se kriteret legale të qenies shtet (popullsia, territori, qeveria efektive si dhe aftësia për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera) janë zbatuar me përpikëri. Në favor të kësaj flasin në veçanti mendimi nr. 10 i Komisionit të Arbitrazhit, i datës 4 korrik 1992, dhe rezolutat nr. 757 (1992) dhe 777 (1992) të KS të OKB-së.

Komisioni, në mendimin e sipërcekur, ka theksuar se vendimi i Serbisë dhe Malit të Zi (prill 1992) për të krijuar entitetin e quajtur Jugosllavi nuk quhet i vlefshëm. Në përkrahje të këtij mendimi, Komisioni citon edhe rezolutën nr. 757 (1992) të Këshillit të Sigurimit, sipas së cilës, "kërkesa e RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi) për kontinuitet legal me ish-RSFJ-në nuk pranohet në tërësi". Mirëpo, vazhdon më tej Komisioni, në po atë vend, ai entitet (Serbia dhe Mali i Zi) i plotëson të gjitha kriteret për të qenë një shtet tjetër i ri dhe i dallueshëm nga ish-RSFJ.

---

[445] Cf. International Court of Justice, "Application of the Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide: *Bosnia and Herzegovina v. Yugoslavia (Serbia and Montenegro)*", March 20, 1993.

[446] Cf. Enver Hasani, "Të gjitha Gjykatat e Hagës", *Rilindja Javore* (Tiranë, korrik-gusht 1995).

Për të vënë në jetë këtë mendim të Komisionit, Këshilli i Sigurimit të OKB-së, me rezolutën nr. 777, të datës 19 shtator 1992, i rekomandoi Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së që t'i kërkohet të a.q. RFJ (Serbi dhe Mali i Zi) të paraqesë kërkesën e re për pranim në OKB, ashtu siç është vepruar edhe me republikat tjera të ish-RSFJ-së. Mirëpo, përkundër kësaj, në teorinë e së drejtës ndërkombëtare u gjetën disa autorë, përveç atyre serbë[447], të cilët mbrojtën tezën se Serbia dhe Mali i Zi janë në të njëjtën kohë shtet suksesor (trashëgimtar) dhe vazhdimësi e ish-RSFJ-së, duke u thirrur me këtë rast në praktikën e ndarjes së Indisë dhe Pakistanit, gjë që absolutisht nuk përkon me realitetin.[448]

Përfundim

Si entitete të së drejtës ndërkombëtare të cilat posedojnë një subjektivitet të caktuar konsiderohen ato që kanë zotësinë për të qenë bartës të të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në planin ndërkombëtar. Shtetet janë entitetet kryesore të cilat në të drejtën ndërkombëtare kanë subjektivitet të plotë ndërkombëtar, pra, të cilat kanë të drejtën e parashtrimit të kërkesave në planin ndërkombëtar, të drejtën e lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe të drejtën e shfrytëzimit të privilegjeve dhe të imuniteteve të caktuara në të drejtën ndërkombëtare. Përveç shteteve, edhe organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë e shteteve kanë një subjektivitet të caktuar ndërkombëtar, pastaj, individi, popujt dhe territoret joautonome, shtetet në lindje e sipër, kryengritësit, palët ndërluftuese, qeveritë në ekzil, etj. etj. Në të gjitha këto raste, ekziston një numër i madh faktorësh dhe rrethanash të cilat duhet të merren parasysh me rastin e vlerësimit të llojeve dhe të vëllimit të të drejtave dhe detyrimeve të subjektit i cili merret në konsiderim. Dhe, *në të gjitha këto raste, e drejta ndërkombëtare është ajo e cila duhet njohur mirë me qëllim të përcaktimit të llojit dhe të vëllimit të të drejtave dhe detyrimeve të subjektit të dhënë.*

Nga të gjithë subjektet e së drejtës ndërkombëtare, territoret e ndërkombëtarizuara janë ato të cilat paraqesin probleme të mëdha kuptimore, përkatësisht probleme në sferën e përcaktimit të natyrës së tyre juridike. Për to

---

[447] Cf. Milenko Kreća, "A Few Remarks About the Continuity of FR Yugoslavia"; Ljubivoje Ačimović, "Continuity of International Legal Personality of Yugoslavia and Its Membership in the United Nations"; Konstandin Obradović, "Again on the Problem of Continuity: Is FR Yugoslavia 'Old' or 'New' State?", *Medjunarodni problemi* nr. 3 (Beograd, 1994) fq. 399-436.
[448] Cf. Yehuda Blumm, "UN Membership of the 'New' Yugoslavia", *American Journal of International Law* vol. 86, no. 4 (1992) fq. 830-833.

zakonisht thuhet se janë entitete të cilat iu ngjasojnë shteteve, por që nuk janë të tilla. Një ndërlikueshmëri e tillë buron, shikuar historikisht, nga vetë fakti i mënyrës dhe i shkaqeve të krijimit të tyre.

Që nga formimi i komunitetit modern ndërkombëtar (1648-1856), kur pasoi lindja e shpejtë e shteteve të reja, e deri në ditët e sotme, vazhdon përsiatja, në teori dhe në praktikë, mbi atë se kush mund të jetë shtet në të drejtën ndërkombëtare. Mbi bazën e kësaj u krijuan teoritë deklarative dhe konstitutive të qenies shtet (*statehood*). E para pohon se shteti lind jashtë kontekstit ligjor dhe se paraqet një çështje faktike dhe jo juridike, kurse teoria e dytë thotë se shteti lind vetëm në bazë të rregullave të caktuara që më herët dhe se shtetet e tjera vlerësojnë në mënyrë të lirë nëse janë plotësuar dhe respektuar këto rregulla. Në praktikë, dallimi mes këtyre dy teorive të qenies shtet është fare i vogël dhe i padukshëm, sepse në të drejtën pozitive ndërkombëtare ekzistojnë disa kritere të qenies shtet të cilat dukshëm e kanë ngushtuar hapësirën për veprim diskrecional të shteteve ekzistuese në bashkësinë ndërkombëtare. Kur njohja e shtetit është mbi baza jopolitike, pra kur flitet për plotësimin praktik të këtyre kritereve, atëherë roli i njohjes qëndron në mënjanimin e çfarëdo dyshimi për sa i përket statusit të një entiteti të dhënë, pra, njohja në këtë rast ka rolin e stabilizuesit të pozitës (eventuale) dubioze të një entiteti të caktuar (p.sh., *rasti i njohjes së Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjë-Hercegovinës dhe Maqedonisë, pas shkëputjes së tyre nga ish-RSFJ*).

Nëse merret parasysh fakti se e drejta ndërkombëtare pozitive paraqet një sistem të decentralizuar në pikëpamje organizative, por që është i kompletuar nga ana formale, atëherë del se disa çështje janë të rregulluara nga e drejta ndërkombëtare, si p.sh., shtetësia, ujërat territoriale, përdorimi i forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare etj. Edhe në çështjet e qenies shtet (*statehood*), siç u cek, e drejta ndërkombëtare pozitive ka qenë shumë e kujdesshme dhe i ka përcaktuar disa kritere të cilat duhen plotësuar për të qenë shtet një entitet i dhënë. Bazuar në këto kritere, bashkësia ndërkombëtare përfiton mjaft me rastin e dhënies së vlerësimit (individual ose kolektiv) të fakteve jetësore të cilat kanë për pasojë lindjen e një shteti të caktuar. Mbi bazën e kësaj, bashkësia ndërkombëtare, deri më sot, ka vendosur se cilat entitete quhen shtete e cilat jo. Kjo praktikë është ndjekur edhe me rastin e shpërbërjes së ish-RSFJ-së, BRSS-së dhe të Çekosllovakisë. Në të njëjtën kohë, ka raste kur disa entitete shtetërore, edhe pse janë efektive politikisht dhe të organizuara si shtete, nuk njihen si të tilla nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, si p.sh., Republika e Turqve Qipriotë, Çeçenia, republikat e serbëve të Bosnjë-Hercegovinës dhe të Kroacisë etj.

Edhe pse sot nuk ekziston një definicion i qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare, megjithatë ekzistojnë disa kritere për të qenë shtet në të drejtën ndërkombëtare. Ato kritere ndahen në tri grupe:

1. kriteret klasike të qenies shtet;
2. kriteret të cilat janë sugjeruar si rezultat i zhvillimit modern të së drejtës ndërkombëtare; dhe së fundi,
3. kriteret e qenies shtet për qëllimet e Lidhjes së Kombeve dhe të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në kriteret klasike të qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare bëjnë pjesë:

1. popullsia permanente;
2. territori;
3. qeveria; dhe së fundi,
4. zotësia për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera (neni i parë i Konventës së Montevideos mbi të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve, datë 26 dhjetor 1933).

Në kuadrin e këtyre kritereve, në esencë, marrëdhënia mes parimit të efektshmërisë së pushtetit shtetëror (qeverisë) dhe kritereve të tjera legale, si p.sh., parimit të vetëvendosjes, paraqet boshtin kyç në lindjen e shteteve të reja. Përveç kësaj, edhe konteksti në të cilin lindin shtetet e reja paraqet një rrethanë mjaft të rëndësishme. Kështu, nëse shteti i ri lind në kontekstin kolonial, atëherë parimi i efektshmërisë së pushtetit shtetëror (qeverisë) brenda kolonisë së caktuar, e cila aspiron për të qenë shtet, do të zbatohet me një rreptësi me të vogël. E njëjta gjë vlen edhe për rastet e krijimit të shteteve dhe të cilat barazohen me kontekstin kolonial (p.sh., rasti i shkëputjes së Bangladeshit nga Pakistani më 1970). Dhe anasjelltas, kur shteti i ri lind jashtë kontekstit kolonial, përkatësisht nga zhdukja ose zvogëlimi i shtetit ekzistues, atëherë parimi i efektshmërisë së pushtetit shtetëror (qeverisë) brenda entitetit i cili pretendon për të qenë shtet do të zbatohet me një rreptësi më të madhe.

Të gjitha këto konstatime dalin nga praktika e deritanishme ndërkombëtare në lidhje me krijimin dhe zhdukjen e shteteve, përfshirë këtu edhe praktikën e shpërbërjes së ish-RSFJ-së dhe të ish-federatave të tjera socialiste (BRSS dhe Çekosllovaki) dhe krijimin e shteteve të reja nga gjiri i tyre.

Platforma bazë për veprim praktik të mëtejshëm, në rastet e shpërbërjes së federatave të sipërcekura, ka qenë mendimi nr. 1, i datës 29 nëntor 1991, i Komisionit Badinter, si dhe vendimet e tjera të nxjerra më pastaj në vijim të

zgjidhjes së krizës në ish-RSFJ. Ky mendim, i cili ka sublimuar gjithë praktikën ndërkombëtare në këtë fushë, për Kosovën, ndërkaq, ka qenë fatal. Kjo është kështu për faktin se e ka përjashtuar Kosovën nga radha e entiteteve me të drejtë për vetëvendosje të jashtme (eksterne) përkundër konstatimit parimor të dhënë në pjesën e tij preambulare (pika 1.d) në të cilën është thënë se "kur bëhet fjalë për llojin e shtetit federal, i cili në gjirin e vet ngërthen bashkësitë me një shkallë të caktuar të autonomisë dhe që, si të tilla, marrin pjesë në ushtrimin e pushtetit politik në kuadrin e institucioneve të përbashkëta federale, atëherë edhe vetë ekzistimi i federatës si shtet nënkupton që në organet e saj janë të përfaqësuara pjesët e federatës dhe se në kuadrin e këtyre organeve federative pjesët e saj ushtrojnë pushtetin efektiv." Me pushtet politik efektiv, në këtë kontekst, nënkuptohet pushteti politik i cili ushtrohet ndaj një popullsie dhe një territori të dhënë, pa marrë parasysh madhësinë e tyre dhe faktin nëse territori është i përcaktuar saktësisht ose jo.

Analiza shkencore e mendimit të Komisionit Badinter, si dhe të dokumenteve të tjera vijuese, përbën bazën mbi të cilën duhet mbështetur me rastin e përcaktimit të shkaqeve reale të pozitës aktuale juridike-politike të Kosovës në planin ndërkombëtar. *Konsiderojmë se çdo këndvështrim tjetër, përkatësisht synimi i disave për të kërkuar shkaqet e mësipërme në dokumentet e ndryshme të nxjerra gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj, paraqet diletantizëm shkencor dhe aventurë politike. Të rëndësisë primare, në këtë drejtim, janë dy pika të cilave duhet t'u referohemi: së pari, dokumentet juridike-kushtetuese të miratuara nga organet legale të ish-KSA të Kosovës në vigjiljen e shpërbërjes së ish-RSFJ-së dhe ato të nxjerra menjëherë pas këtij procesi; dhe së dyti, këto dokumente e kanë vlerën e tyre të duhur në planin ndërkombëtar vetëm nëse i korrespondojnë realitetit të ri të cilin ata vet' synojnë ta sanksionojnë (rregullojnë, normojnë).*

Në kuadrin e kritereve klasike të qenies shtet, zotësia për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera paraqet një kriter mjaft të dobishëm për të vlerësuar se kush janë shtetet në të drejtën ndërkombëtare. Ky kriter përbëhet prej dy segmenteve: qeverisë, përkatësisht pushtetit efektiv, për të cilin u fol më sipër, dhe prej pavarësisë.

Kur flitet për pavarësinë si kriter për të qenë shtet në të drejtën ndërkombëtare, atëherë nuk duhet harruar se ajo në marrëdhëniet ndërkombëtare nënkupton parimin sipas të cilit kompetenca ekskluzive e shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare është pika nisëse për zgjidhjen e pjesës dërrmuese të çështjeve të cilat i përkasin marrëdhënieve ndërkombëtare. Siç mund të vërehet, pavarësia lidhet, në njëfarë mënyre, me parimin e efektivitetit. Në anën

tjetër, pavarësia, përveç si kriter për të qenë shtet, luan edhe rolin e kriterit mbrojtës të shteteve ekzistuese të bashkësisë ndërkombëtare. Ky dallim mes pavarësisë si kriter për të qenë shtet dhe pavarësisë si kusht për ekzistimin e mëtejshëm të shteteve në të drejtën ndërkombëtare është i rëndësishëm në veçanti në rastet e shkëputjes (secesionit) së kolonive nga shteti metropol, si dhe në rastet e ndërhyrjes së parimit të vetëvendosjes në procesin e krijimit të shteteve të reja, pra në rastet jashtë kontekstit kolonial.

Pavarësia, ndërkaq, mund të jetë formale dhe reale. Dallimi mes këtyre dy llojeve të pavarësisë varet prej rrethanave të rastit konkret dhe si i tillë duhet të vlerësohet prej rastit në rast.

Nëse kriteret tradicionale të qenies shtet në të drejtën ndërkombëtare janë të bazuara, kryesisht, në parimin e efektivitetit të pushtetit shtetëror (qeverisë) në një territor dhe ndaj një popullsie të caktuar, kjo nuk do të thotë se mungojnë kriteret e tjera të caktuara të cilat e zbusin dhe e korrigjojnë këtë parim. Përkundrazi, gjatë zhvillimit të së drejtës pozitive ndërkombëtare jo të gjitha situatat e pushtetit efektiv janë konsideruar si shtete. Me fjalë të tjera, e drejta pozitive ndërkombëtare ka ditur të sfidojë situatat e entiteteve me pushtet efektiv, por që kanë qenë ilegale nga pikëpamja e normave të saj, si p.sh., rasti i serbëve të Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, rastet e Manxhurisë dhe të entiteteve të krijuara gjatë Luftës së Dytë Botërore, pastaj, rasti i turqve qipriotë, etj. etj. Ka pasur raste kur disa entitete, në anën tjetër, edhe pse joefektive, janë konsideruar si shtete në të drejtën ndërkombëtare, si p.sh., rasti i Guine-Bisaos, para njohjes së saj nga Portugalia, si dhe shtetet baltike dhe shtetet e tjera të aneksuara gjatë Luftës së Dytë Botërore (1936-1945), pastaj, rasti i Bonjë-Hercegovinës pas shpërthimit të luftës atje më 1992, etj. etj.

Përveç ilegalitetit me rastin e krijimit të pushtetit efektiv (qeverisë), i cili manifestohet në cenimin e normave të detyrueshme (*jus cogens*) në të drejtën ndërkombëtare, ekzistojnë edhe dy parime të tjera të cilat e zbusin dhe e korrigjojnë parimin e efektivitetit në procesin e lindjes dhe të krijimit të shteteve të reja në të drejtën ndërkombëtare. Ato parime i referohen vetëvendosjes, si parim dhe si e drejtë, dhe mosnjohjes ndërkombëtare të një entiteti të caktuar. Të gjitha këto së bashku përbëjnë një tërësi unike dhe hyjnë në grupin e kritereve të sugjeruara si rezultat i zhvillimit modern të së drejtës pozitive ndërkombëtare. Në fakt, sikundër u vërejt më herët, mosnjohja ndërkombëtare e një entiteti efektiv bëhet për shkak të cenimit të normave *jus cogens* në të drejtën ndërkombëtare e veçanërisht në rastet kur këto norma kanë të bëjnë me vetëvendosjen si e drejtë kolektive njerëzore. Dhe anasjelltas, njohja

e parakohshme e një entiteti, d.m.th., njohja e një entiteti i cili nuk e ushtron pushtetin efektiv sipas kritereve tradicionale të qenies shtet, mund të bëhet vetëm nëse flitet për formimin e shteteve të reja në kontekstin kolonial dhe, jashtë këtij konteksti, në rastet kur bëhet fjalë për angazhimin e parimit të vetëvendosjes në procesin e lindjes dhe të krijimit të shteteve të reja. *Në të gjitha këto raste, bashkësia ndërkombëtare është ajo e cila përcakton se kush dhe kur ka cenuar normat* jus cogens *në të drejtën ndërkombëtare. Kështu, me rastin e ish-RSFJ-së dhe të ish-federatave të tjera socialiste, Komisioni Badinter ka vendosur mbi këtë çështje, në emër të bashkësisë ndërkombëtare, ashtu që edhe veprimet e mëvonshme të bashkësisë ndërkombëtare për mosnjohjen e republikave të serbëve të Bosnjës dhe të Kroacisë kanë qenë të bazuara mbi këtë si dhe mbi mendimet e tjera të mëvonshme të Komisionit të Arbitrazhit (Komisionit Badinter).*

Cilat janë konsekuencat që mund të nxirren nga e tërë kjo lidhur me qenien shtet të Republikës së Kosovës?

Zotimi i krerëve të rendit të ri botëror se do të respektohen dhe inkurajohen liria, barazia e të gjithëve, qarkullimi i lirë i mallrave, shërbimeve dhe i njerëzve, respekti për të drejtat e njeriut (individuale dhe kolektive), si dhe respekti për të drejtën ndërkombëtare duhet të bëhet realitet edhe për zgjidhjen e çështjes shqiptare në Ballkan, me Kosovën si çështje kryesore të saj. Respektimi i parimeve dhe i standardeve ndërkombëtare mbi të cilat është duke u bazuar zgjidhja e krizës në ish-RSFJ duhet të vlejë për të gjithë njësoj.

Në këtë kontekst, janë dy baza mbi të cilat duhet të mbështetet kërkesa jonë për pavarësi të plotë të Republikës së Kosovës. *Së pari*, bashkësia ndërkombëtare, me pranimin e së drejtës për vetëvendosje dhe legalizimin e "Republika Srpskas" të serbëve të Bosnjë-Hercegovinës, në vijim të zgjidhjes së krizës në ish-RSFJ, ka krijuar një precedent të ri me rastin e zgjedhjes së kritereve për zgjidhjen e kësaj krize, precedent që ka dhe duhet të ketë zbatim të përgjithshëm. Aty, pra me krijimin e republikës së serbëve të Bosnjë-Hercegovinës, bashkësia ndërkombëtare ka pranuar drejtpërsëdrejti legalizimin e një realiteti të ri, realitet ky i krijuar me luftë të armatosur dhe i shoqëruar me kryerjen e krimeve kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare.

Së dyti, mbi bazën e këtij precedenti të vet, i cili siç e thamë është bërë me luftë të armatosur dhe duke kryer krime kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare, bashkësia ndërkombëtare duhet të njohë një realitet tjetër të ri, realitet ky i krijuar në mënyrë paqësore, pa luftë të armatosur dhe pa kryerjen e krimeve kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare, i cili quhet Republika e Kosovës. Ky realitet bazohet jo në luftë të armatosur dhe në kri-

me kundër njerëzimit, por në vullnetin politik të popullit dhe të qytetarëve të Kosovës të shprehur në referendumin e vitit 1991 dhe në rregullimet e mëpastajshme kushtetuese të vitit 1992 (zgjedhjet e lira për Parlamentin dhe Kryetarin e Kosovës), të gjitha këto të bazuara në Kushtetutën e Kaçanikut të 7 shtatorit 1990. Nëse bashkësia ndërkombëtare mendon që këto duhet të konsiderohen si akte jo të vlefshme, duke na ofruar pozicionin e njëfarë lloj autonomie sipas modelit të vitit 1974, atëherë shtrohet pyetja e ekzistencës së mëtejshme të vlerave të rendit të ri botëror. Kjo do të nënkuptonte, definitivisht, se vetëm lufta dhe rezultatet e saj pranohen si të vlefshme dhe, përveç kësaj, kjo do të thotë se lufta është mjeti i vetëm dhe kryesor për zgjidhjen e konflikteve nacionale. Ndërsa, në botën e sotme supozohet të jenë rreth 200 çështje nacionale të pazgjidhura. Me siguri që në këtë supozim bënë pjesë edhe çështja shqiptare dhe Kosova si pjesë e saj.

Përkundër kësaj, mbesim optimistë se kësaj radhe ridefinimi i koncepteve dhe i vlerave në planin ndërkombëtar nuk do të bëhet në dëm të shqiptarëve sikur herëve të tjera, sepse ky ridefinim, i cili ka filluar me rrënimin e socializmit si sistem, do të duhej të ishte i bazuar mbi kritere më të besueshme se sa pararendësit e tij. Krijimi dhe vënia në jetë e mekanizmave të *Gjykatës së Hagës për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi dhe në Ruandë* janë shenjë e qartë se nuk do të lejohet që barbarët të kalojnë pa u ndëshkuar. Në mënyrë të njëjtë, mosnjohja kolektive nga ana e bashkësisë ndërkombëtare e të a.q. RFJ (Serbia dhe Mali i Zi) paraqet një shenjë tjetër optimiste, çka do të thotë se bashkësia ndërkombëtare nuk e pranon legalitetin dhe legjitimitetin ndërkombëtar të mënyrës së krijimit të këtij entiteti. Në veçanti, do të ishte gabim i madh nëse një njohje eventuale e të a.q. RFJ do të bëhej nga ana e Bashkimit Evropian, i cili është duke pretenduar integrimin në gjirin e vet të krejt kontinentit të vjetër në deceniet që po vijnë.

II. Refleksione mbi nacionalizmin serb dhe politikën e pastrimit etnik

Hyrje

A është pastrimi etnik, ky fenomen i vjetër me emër të ri, krijesë tipike ballkanike? Çka mund të thuhet për serbët? A janë ata të destinuar nga nat-

yra për t'i prirë largimit me dhunë të joserbëve nga tokat që ata i cilësojnë si kontestuese, fenomen ky që vetë serbët e emëruan "pastrim etnik" më shumë se para njëqind vjetësh?

Për të qenë të qartë që në fillim, sqarojmë këtu se fenomeni i pastrimit etnik të joserbëve në Ballkan dhe shkatërrimi i kulturës së tyre nuk mund të shpjegohet në mënyrë antropologjike, por vetëm përmes argumenteve sociopolitike: lindja dhe zhvillimi i nacionalizmit serb (një nacionalizëm i pastër egalitar popullist) dhe struktura sociale e shoqërisë serbe (kryesisht rurale) kanë gjeneruar forca sociale brutale që nga anti-feminizmi deri te pastrimi etnik. Ky fakt, mes të tjerëve, është shtjelluar nga Sabrina P. Ramet në punimin e saj "Nationalism and the 'Idiocy' of the Countryside: the Case of Serbia", publikuar në *Ethnic and Racial Studies* vol. 19, no. 1 (January 1996), fq. 76-87. Në pikat kryesore, ne kemi ndjekur logjikën e Sabrina P. Rametit, sepse ofron shpjegimin më të mirë të sjelljes serbe në kontekstin ballkanik.

Një argument kryesor që dështon të shpjegojë nacionalizmin serb është ai mbi të ashtuquajturin "mentalitet ballkanik". Ky mentalitet asnjëherë nuk ka ekzistuar në mesin e nacionaliteteve të tjera në Ballkan. Disa qarqe në Perëndim e kanë krijuar këtë nocion për të shmangur ballafaqimin me përgjegjësinë serbe për ndalimin e zgjerimit territorial të Serbisë në Ballkan. Pasojë e kësaj ka qenë bindja se luftërat ballkanike janë luftëra të karakterit fisnor ashtu që asgjë nuk mund të bëhet për të penguar popujt e Ballkanit nga vetëshkatërrimi. Regjimi aktual në Beograd ka promovuar konceptin e tillë sepse i shkon interesave të tij ekspansioniste. Mungesa e një mentaliteti unik ballkanik shpjegohet fare lehtë nëse shikohet jeta e përditshme dhe administrata e popujve të Ballkanit para shekullit XIX. Sistemi otoman *millet* nuk ka bërë dallime të tjera pos dallimit të myslimanëve nga të krishterët. Dallimet e bazuara në nacionalizëm dhe ideologjinë e tij kanë lindur vonë, njëjtët si në Evropë.[449]

Ne do të ekzaminojmë katër aspekte të fenomenit të pastrimit etnik me qëllim që të japim një pamje të qartë lidhur me dy anë të nacionalizmit serb dhe pasojat e tij për Ballkanin. Njëri anë ka të bëjë me nacionalizmin serb para krijimit të ish-Jugosllavisë më 1918, kurse tjetra i takon më shumë nacionalizmit shtetëror serb, i cili ka qenë qartë i dukshëm pas formimit të ish-Jugosllavisë deri me shkatërrimin e saj më 1992.

---

[449] Paschalis M. Kitromilides shpjegon këtë rrugë ballkanike të nacionalizmit dhe ideologjisë së tij një punim të tij të shkëlqyer. Cf. Paschalis M. Kitromilides, "'Balkan Mentality': History, Legend, Imagination", *Nations and Nationalism* vol. 2, no. 2 (1996) fq. 163-191.

1. Pasqyrë e shkurtër e fenomenit të pastrimit etnik përgjatë historisë

Fenomeni i pastrimit etnik mund të shikohet në dy mënyra. E para, ai përfshin të gjitha dëbimet me forcë të popujve me qëllim të dobësimit, shkatërrimit ose eliminimit të segmenteve të tyre të caktuara. E dyta, pastrimi etnik përfshin edhe disa veprime të tjera që drejtohen vetëm ndaj disa grupeve të caktuara nacionale dhe grupeve të tjera specifike. Forma e parë është e vjetër sa edhe vetë njerëzimi, kurse e dyta është e lidhur ngushtë me lindjen e lëvizjeve nacionaliste të shekullit XVII e tutje.

Zhvendosjet me dhunë të popujve brenda kufijve të shtetit janë shënuar që në shekullin VIII para erës sonë. Sunduesi asirian Tiglath-Pileser III (745-727 p.e.s.) me dhunë ka zhvendosur popullin autokton me qëllim të zëvendësimit të tij me popullsinë e tij. Babilonët, grekët e vjetër, romakët, të gjithë kanë zbatuar këtë praktikë por jo çdoherë me intensitet të njëjtë apo në shkallë të njëjtë. E përbashkët e tyre ka qenë fakti se qëllimi final ka qenë skllavërimi ekonomik i palës kundërshtare.[450]

Gjatë mesjetës, nisur nga fakti se feja ka qenë baza kryesore për identifikim individual dhe grupor, popujt e feve të tjera kanë qenë objekt dëbimi me dhunë, kryesisht myslimanët dhe hebrenjtë.[451] Në ndërkohë që feja akoma po shërbente si pikë referimi për zhvendosjen me dhunë të popullsive, Anglia u bë vendi i parë që bëri dëbimin me dhunë të bazuar në nacionalitet. Gjatë viteve 1640-1650, Anglia "pastroi" thuajse gjysmën e kombit irlandez nga tokat e tyre. Kjo praktikë më pastaj është ndjekur kundër fiseve autoktone në Amerikën e Veriut.[452]

Në fillim të shekullit XX, Ballkani u bë teatri i ri i Evropës për lojën obskure të pastrimit etnik. Një brutalitet i paparë u shfaq pas lindjes së lëvizjeve për pavarësi të popujve të krishterë të Ballkanit që jetonin në Perandorinë Otomane. Edhe pse vuajtjet e popujve jo të krishterë janë fshehur deri vonë, në literaturë është shënuar se pastrimi etnik i jokristianëve gjatë shekullit të fundit të jetës së Perandorisë Otomane ka tejkaluar dukshëm numrin e kris-

---

[450] Cf. Andrew Bell-Fialkoff, "A Brief History of Ethnic Cleansing", *Foreign Affairs* vol. 72, no. 3 (Summer 1993) fq. 111-12; Eric Kolodrer, "Population Transfer: the Effects of Settler infusion on a Host Population's Right to Self-Detemrination", *New York University Journal of International Law and Politics* vol. 27, no. 1 (Autumn 1994) fq. 163-65; Alfied de Zayas, "The Right to One's Homeland: Ethnic Cleansing and the International Criminal Tribunal for Former Yugoslavia", *Criminal Law Forum* vol. 6, no. 2 (1995) fq. 261-66.

[451] Andrew Bell-Fialkoff, op. cit., fq. 112.

[452] Ibid. fq. 112-13.

tianëve të larguar me dhunë nga ish-hapësirat e kësaj perandorie. Justin McCarthy, në një studim, ka prezantuar fakte të detajuara lidhur me këtë[453]. Studimi i McCarthyt, krahas librit *The Other Balkan Wars*, parathënien e të cilit e ka bërë diplomati i njohur amerikan George Kennan[454], paraqet një analizë të hollë dhe të detajuar të fenomenit tragjik ballkanik — pastrimit etnik.

Lufta e Dytë Botërore kulmoi në zhvendosjen me dhunë dhe shfarosjen e popujve, bazuar kryesisht në baza nacionale dhe të etnicitetit. Kjo qe pasojë imediate e ngritjes së nacionalizmit paranojak gjerman i mbështetur në "pastërtinë racore" dhe rrezikun e vetëkrijuar nga gjermanët mbi rrezikun që kësaj pastërtie i vinte nga populli hebre.

Zhvendosja e popujve, qoftë me dhunë apo përmes marrëveshjes, ka qenë braktisur dhe harruar për një kohë të gjatë në Evropën e pas-Luftës së Dytë Botërore. Lufta e Ftohtë sikur i "ngriu" kufijtë e Evropës dhe, për pasojë, fenomeni i pastrimit etnik i trajtuar si diçka që kishte ndodhur në të kaluarën e hidhur evropiane. Pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, sërish u hap një kapitull tragjik i Evropës. Në këtë kapitull tragjik dhe të mjerë, pastrimi etnik në ish-Jugosllavi dhe në territoret e Bashkimit Sovjetik u shpërfaq si dikur, si një politikë e mirë e paramenduar dhe vetë qëllimi i luftës si projektim force. Me fjalë të tjera, ndryshe nga si mendohej më herët, pastrimi etnik ishte një politikë që kishte për qëllim pastrimin e popujve tjerë dhe fitimin e territoreve të tyre, duke mos qenë rezultat i luftës, por vetë qëllim i saj primar. Në rastin e ish-Jugosllavisë nuk ka qenë dhe nuk është një anomali josociale e bazuar në urrejtjet e vjetra mes kombeve të Ballkanit, siç propagohej nga elita serbe, por një pasojë logjike e nacionalizmit serb dhe nacionalizmave të tjerë si përgjigje ndaj nacionalizmit serb, si dhe e kulturës së kultivuar në atë shtet për gjysmë shekulli.

---

[453] Cf. më shumë në Justin McCarthy, *Death and Exile: the Ethnic Cleansing of Ottoman Muslims:* 1821-1922 (Darwin Press: Univ. of Michigan, 1995).

[454] Cf. për këtë më shumë në Report of the International Commission for Inquiry into the Causes of the Balkan Wars, *The Other Balkan Wars* (Carnegie Endowment for International Peace: Washington DC, 1994).

2. Fenomeni i pastrimit etnik si bazë e projektit mbi Serbinë e Madhe

Analiza e praktikës së pastrimit etnik të kryer nga serbët fillon me projektin e tyre mbi Serbinë e Madhe. Ky projekt serb është i mishëruar thellë në programet serbe me fillim nga *Načertanije* ("Skica") e Ilija Garashaninit (Garašanin) e vitit 1844 e deri te Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë i vitit 1986, i njohur në origjinal si "Memorandum SANU". Fjala pastrim etnik, ndërkaq, për herë të parë është përdorur nga "babai i iluminizmit serb", Vuk Karaxhiq (Karadžić).[455]

Luftërat që serbët bënë në shekujt e fundit i kanë shërbyer këtij projekti mbi Serbinë e Madhe. Kur kanë qenë të suksesshëm, si më 1870 dhe, në veçanti, pas Luftërave Ballkanike (1912-13), projekti mbi Serbinë e Madhe ka shkaktuar vuajtje masive dhe zhvendosje të joserbëve dhe shkatërrim të kulturës së tyre. Regjimi ndërkombëtar gjatë këtyre shekujve ka luajtur një rol të veçantë në këtë sukses të politikës serbe të pastrimit etnik.

Liderët nacionalistë serbë kanë besuar në këto kohëra se lufta është mënyra kryesore për krijimin e vullnetit nacional. Për më tepër, fokusi i tyre ka qenë në territore ku serbët asnjëherë nuk kanë qenë popullsi shumicë. Okupimi i territoreve në të cilat serbët nuk përbënin shumicë ka qenë përcaktues i mënyrës që duheshin përdorur për të arritur këto qëllime, pra marrjen me dhunë të territoreve dhe shkatërrimin e kulturave joserbë. Kjo ngelet cilësi dominante e nacionalizmit serb edhe sot. Kryesit e politikës së pastrimit etnik, si mënyrë për fitimin e territoreve të huaja dhe për shkatërrimin e kulturave joserbe, nisur nga struktura e tyre sociale kryesisht rurale, shpjegojnë konsistencën dhe brutalitetin e pastrimit etnik serb. Nacionalizmi serb ka qenë dhe ngelet një nacionalizëm "popullor" (egalitar). Qasja egalitare serbe qe dobësuar dhe bërë pjesërisht aristokratike vetëm atëherë kur regjimi në Beograd synonte të dominonte Zagrebin dhe Lubjanën. Ky sinom serb, në anën tjetër, nxiste më shumë nacionalizmin ekzistues aristokratik në Kroaci dhe Slloveni.

Pse nacionalizmi serb ka qenë dhe ngelet egalitar për nga natyra e vet? Përgjigja në këtë pyetje gjendet në historinë e ngritjes dhe zhvillimit të vetë nacionalizmit serb. Kjo do të shihet nga shtjellimi ynë në vijim.

---

[455] Vuk Karaxhiqi më 1860 ka përdorur për herë të parë termin "pastrim etnik" për të përshkruar rimarrjen e Beogradit nga otomanët më 1805, vit ky në të cilin tërë joserbët dhe kultura e tyre u rrënuan. Cf. Patrick Cabanel, *Nation, Nationalites et Nationalisms en Europe: 1850-1920* (Editions Ophrys: Paris, 1996) fq. 213.

Pushtimi otoman i Serbisë në mesjetë ka pasur një efekt të barazimit sepse ka shkatërruar në tërësi klasën e pronarëve të tokave (aristokracinë e kohës). Kjo ka pasur këtë efekt edhe në vendet e tjera të pushtuara nga otomanët. Klasa e pronarëve të tokave ekzistuan vetëm në Bosnjë-Hercegovinë dhe pjesërisht në Maqedoni ku u konvertuan në myslimanë. Ndikimi i klasës në fjalë në krijimin e nacionalizmit serb ka qenë fare i vogël, siç ka qenë rasti me Bullgarinë dhe Greqinë. Kjo ka qenë pasojë e faktit se, në veçanti në rastin e sllavëve, pronarët e tokave shumë pak dallonin nga pronarët otomanë të tokave kur është fjala për statusin e tyre në shoqëri. Po ashtu, klasa tregtare nuk ka ekzistuar në Serbinë mesjetare, ashtu që edhe vetë zhvillimi modest i kësaj klase gjatë shekullit XIX ka pasur një ndikim fare të papërfillshëm në lindjen e nacionalizmin serb. Në të njëjtën kohë, urrejtja dhe përbuzja e kultivuar nga fshatari mesatar serb është drejtuar kundër kësaj klase të pronarëve otomanë të tokave, në të cilat fshatari serb ishte kategori e dorës së dytë. Në anën tjetër, kjo fshatarësi serbe arriti të ruajë institucionet e veta tradicionale dhe gjuhën serbe pikërisht duke iu falënderuar sistemi otoman *millet* — i cili, si një sistem administrativ i Perandorisë Otomane, ofronte bazën solide për ngritjen e nacionalizmit serb të një natyre egalitare. E njëjta vlen, pak a shumë, për ngritjen e nacionalizmit bullgar dhe atij grek, ani se ky i fundit ka pasur një natyrë burokratike.

Liderët dhe promovuesit e këtij lloj nacionalizmi brenda shoqërisë serbe kanë qenë priftërinjtë e fshatit dhe disa tregtarë të vegjël, të cilët jetonin jashtë Serbisë. Pakënaqësia dhe qëllimet e këtyre priftërinjve ishin të njëjta me ato të fshatarësisë (nga e cila vinin vetë priftërinjtë serbë). Në kontekstin serb, dioqeza synonte kontrollin mbi tokën në vend të pronarëve serbë, të cilët nuk ekzistonin. Intelektualët serbë, brenda dhe jashtë Serbisë, ofronin një kuadër të sofistikuar teorik për këtë nacionalizëm, kuadër që formulonte dhe kanalizonte përbërësit vendorë në formën e një nacionalizmi egalitar (populist), siç u përshkrua më herët. Në këto rrethana socio-ekonomike, ky ka qenë lloji i vetëm i nacionalizmit i cili ka pasur mundësi të lindë në shoqërinë serbe të kohës. As nacionalizmi borgjez, si në rastin e Çekisë (Bohemisë), as aristokratik, si në rastin e Polonisë dhe Hungarisë, por as burokratik, si në rastin e turqve dhe grekëve më vonë, nuk ka mund të lindë dhe të zhvillohet në rrethanat socio-ekonomike në Serbinë e asaj periudhe.[456]

[456] Peter Sugar, "Nationalism in Eastern Europe", në John Hutchinson and Anthony Smith (eds.), *Nationalism* (Oxford UP: Oxford, 1994) fq. 176-77.

Kjo strukturë sociale ka qenë mbështetja e programeve nacionale serbe, e cila shpjegon tërë brutalitetin e pastrimit etnik të kryer nga serbët përgjatë historisë së dy shekujve të kaluar. Gjatë Luftërave Ballkanike, si dhe gjatë konfliktit të fundit në ish-Jugosllavi (1991-1998), njësitë paramilitare të përbëra nga fshatarët serb të thjeshtë kanë qenë kryesit kryesorë të pastrimit etnik dhe shkatërruesit e kulturave joserbe në territoret e marra me luftë.[457] Hartuesit e programeve nacionale serbe kanë rrjedhur kryesisht nga kjo strukturë sociale e fshatit, një fakt që e bën demokratizimin e tërësishëm të shoqërisë serbe sot mjaft të vështirë, nëse jo edhe gati të pamundur. Përkundër ngjarjeve tragjike në Kosovë gjatë 78 ditëve të bombardimit të NATO-s (mars-qershor 1999) dhe dëmit të madh të shkaktuar ndaj bazës së pushtetit të liderit serb Sllobodan Millosheviq, opozita serbe akoma vazhdon të jetë e dobët dhe nuk duket se paraqet ndonjë sfide serioze ndaj regjimit në Beograd.

3. Roli vendimtar i nacionalizmit serb në shkatërrimin e ish-Jugosllavisë

Një analizë e rolit të nacionalizmit serb në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë pashmangësisht duhet të japë përgjigje në dy pyetje: e para, cili ka qenë roli i Serbisë në krijimin e Jugosllavisë dhe, e dyta, a ka qenë ish-Jugosllavia krijesë artificiale apo një krijesë shtetërore krejt normale siç janë krejt shtetet e tjera të bashkësisë ndërkombëtare?

Krijimi i Jugosllavisë më 1918 nuk ka qenë një akt artificial, por në tërësi në pajtim me vullnetin e sllavëve të jugut për të jetuar në një shtet dhe në interes të shteteve të mëdha të kohës (Francës, Britanisë së Madhe, dhe Shteteve të Bashkuara) për ta vënë atë shtet si një barrierë kundër depërtimit gjerman.

Dëshira për të jetuar në një shtet ka ekzistuar në mesin e sllavëve të jugut përgjatë tërë shekullit XIX. Kjo shihet qartë nga programet nacionale të nacionalistëve kroatë e sllovenë, por të cilat kanë qenë kundër idesë serbe për Serbinë e Madhe, sepse parashihnin barazinë e tre popujve, kroatëve, sllovenëve dhe serbëve. Ideja e krijimit të Jugosllavisë u intensifikua kah mesi i

[457] Cf. Ivan Veković, "Prilog razumevanju etničkih sukoba na Balkanu i Kavkazu", *Republika* no. 174 (Beograd, 1997). Shih poashtu Philip J. Cohen, *Serbia's Secret War: Propaganda and the Deceit of History* (Texas A&M UP: Texas, 1996). Në këtë libër, autori ofron një kronologji të arsyeve të cilat kanë çuar në suksesin e realizimit të projektit të Serbisë së Madhe përgjatë historisë.

Luftës së Parë Botërore përmes punës së Komitetit Jugosllav, me seli në Londër, dhe mbretit serb, në mërgim në ishullin grek të Korfuzit, mes të cilëve kishte kontakte intensive. Menjëherë pas Luftës, forcat italiane, ani se ishin në anën e Aleatëve, zbarkuan në brigjet dalmatine, ashtu që sllovenët dhe kroatët nuk patën zgjidhje tjetër pos të kërkojnë ndihmën e Armatës së Serbisë si ushtria e vetme e rregullt në mesin e sllavëve të jugut. Komiteti Jugosllav, i cili përfaqësonte sllavët e jugut si shtetas të Austro-Hungarisë, ishte i vetëdijshëm se kjo ishte një prelud për krijimin e një shteti tërësisht të dominuar nga serbët. Jo vetëm kaq, Komiteti Jugosllav e dinte se një shtet i tillë përfundimisht do t'i rrënonte ëndrrat e tyre për një shtet me strukturë federale. Simpatitë e fuqive të mëdha të kohës për projektin serb të Jugosllavisë, i cili në fakt ishte projekti për Serbinë e Madhe, buronin nga bindja e tyre se serbët kishin dhënë një kontribut të madh gjatë Luftës së Parë Botërore dhe kishin qenë viktima të Fuqive të Qendrës (Gjermania, Austro-Hungaria dhe aleatët e tyre).[458]

Një kontekst i tillë, nacional dhe ndërkombëtar, u ofronte serbëve një shans për ringjalljen *de facto* të perandorisë mesjetare të Car Dushanit, e cila do të dominohej në tërësi nga klasa e njëjtë politike që kishte sunduar Serbinë para Luftës së Parë Botërore. Ky fakt dhe ambienti i favorshëm ndërkombëtar, ku edhe presidenti i ShBA-së Woodrow Wilson besonte se Jugosllavia përfaqësonte një zgjidhje të madhe për sllavët e jugut, i dhanë serbëve një mundësi të papenguar për të vijuar politikën e tyre të pastrimit etnik kundër josllavëve që kishin jetuar me shekuj në territoret që tani po binin nën sovranitetin e shtetit të ri jugosllav. Për më tepër, politika e pastrimit etnik u zbatua edhe ndaj atyre që në pikëpamje kushtetuese ishin definuar si themelues të shtetit të ri jugosllav.[459] Kombi serb, i cili ushqente hapur bindjen se ishte kombi dominant në mesin e sllavëve të jugut, kurse Serbia qendra e tyre, përgjatë tërë ekzistencës së Jugosllavisë, u angazhua për ruajtjen e strukturave centraliste të qeverisjes së atij shteti. Pasojat e këtij mendimi dhe angazhimi

[458] Cf. Duško Sekulić, "The Creation and Dissolution of the Multinational State: The Case of Yugoslavia", *Nations and Nationalism* vol. 3, part 2 (July 1997) fq. 165-179; Aleksa Djilas, *The Contested Country: Yugoslavia and Communist Revolution 1919-1953* (Harvard UP: Cambridge, Mass., 1991) fq. 3-34; Aleksandar Pavković, *The Fragmentation of Yugoslavia: Nationalism in a Multinational State* (Macmillan: London, 1997) fq. 3-24; Mark Almond, *Europe's Backyard War: The War in the Balkans* (Heinemann: London, 1994) fq. 115-120.
[459] Cf. Rexhep Qosja, "The Albanian National Question in Serb Political Programmes during the Years 1937-1944", *International Journal of Albanian Studies,* vol. I, issue I (Fall 1997). Ky punim përshkruan faktorët ndërkombëtarë që kanë përcaktuar fatin e projekteve monstruoze për pastrimin etnik të shqiptarëve dhe boshnjakëve.

serb u panë gjatë Luftës së Dytë Botërore, të cilat sërish u përsëritën gjatë viteve 1991-1995 (dhe në Kosovë gjatë viteve 1998-1999). Në këtë kohë, pra në kohën pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, të gjitha vendet ish-komuniste po shkonin kah demokratizimi në ndërkohë që në shoqërinë serbe klasa politike po luftonte për të rifituar legjitimitetin e ri për mbetjen në pushtet. Klasa politike në Serbi kërkonte integrimin e serbëve të zakonshëm në projektin e Serbisë së Madhe, jo në projektin e evropianizimit të Serbisë — pra kërkonte, jo mbrojtjen e pronës private, por "tokat e shenjta të serbizmit". Memorandumi i AShAS i vitit 1986 e ka skicuar këtë projekt në mënyrë të detajuar. Slogani "të gjithë serbët në një shtet" përjashtonte çdo mundësi që serbët e zakonshëm të kishin një zgjidhje individuale: ata duhej t'i nënshtroheshin këtij slogani dhe këtij urdhri të dhënë nga AShAS.

Memorandumi i vitit 1986 shënon fillimin e këtij diskursi serb dhe përgatitjen emocionale të shoqërisë serbe për të kryer pastrimin etnik dhe rrënimin e kulturave joserbe. Ky ka qenë programi i parë nacional në territorin e ish-Jugosllavisë me të cilin standardizohej retorika nacionaliste me qëllim te eliminimit të të tjerëve dhe rrënimit të kulturave të tyre.

Memorandumi vuri në lëvizje një terminologji e cila reflektonte qëllimet e draftuesve të tij, si p.sh., "gjenocidi ndaj serbëve", "Holokausti ndaj serbëve", "tragjedia serbe e Kosovës", "martirizimi i serbëve", "toka e shenjtë serbë ku janë varrezat e tyre", "koalicioni antiserb" etj. Me këtë veprim, Akademia Serbe hapi kutinë e Pandorës, e cila në vitet në vijim do ta përgatisë terrenin për zhvendosjen me dhunë të joserbëve dhe për zgjerimin territorial të Serbisë në dëm të popujve të tjerë.[460]

Në fund, Memorandumi flet për "gatishmërinë për të qenë në shërbim të realizimit të detyrës së skicuar në të për hir të diktatit të historisë dhe gjeneratave që vijnë". Kjo tregon se Akademia ka trasuar rrugën për një politikë të caktuar, përkatësisht për politikën e zgjerimit territorial, me marrëveshje apo *manu militari*, siç e ka thënë vetë Dobrica Cosiq (Cosić), një ndër hartuesit e Memorandumit. Memorandumi, më këtë akt, i ka dhënë diskursit serb një argument shtesë në luftën e ardhshme për Serbinë e Madhe.[461] Nga ky moment, ajo çka ngeli ishte vetëm çështja e ridefinimit të identitetit të serbëve të

[460] Slavko Čuruvija and Iran Todorov, "The March to War: 1980-1990", në Jasmina Udovicki and James Ridgeway (eds.), *Yugoslavia's Ethnic Nightmare* (Lawrence Hill: New York, 1995) fq. 84-85.

[461] Shih më shumë për këtë në Philip J. Cohen, "The Complicity of Serbian Intellectuals in Genocide in the 1990s", në Thomas Cushman and Stjepan G. Meštrović (eds.), *This Time We Knew* (New York UP: New York, 1996) fq. 39·64.

zakonshëm me qëllim të arritjes së qëllimit të caktuar social.[462] Ky funksion social i serbëve të zakonshëm tanimë ishte përcaktuar — realizimi i pakusht i projektit të Serbisë së Madhe. Transformimi i identitetit kolektiv të serbëve gjatë realizimit të këtij funksioni ka qenë mjaft i shpejtë, siç ka qenë rasti edhe me fazat tjera të historisë moderne të serbëve. Struktura rurale dhe natyra egalitare e nacionalizmit serb e shpjegon një gjë të tillë. Memorandumi, megjithatë, nuk ka parashikuar një rrethanë që ndryshoi: ambienti ndërkombëtar pas mbarimit të Luftës së Ftohtë ndryshoi në mënyrë radikale në dëm të serbeve dhe projektit të tyre për Serbinë e Madhe. Bota ishte e njëjtë, ani se e ndryshme në përmbajtjen e vet: tanimë nuk e përkrahte Jugosllavinë siç kishte bërë gjatë tërë kohës së ekzistencës së saj, duke ua mundësuar serbëve sundimin mbi të tjerët dhe ndjekjen pa ndëshkim të politikës së pastrimit etnik të popujve joserbë dhe të kulturave të tyre.

4. Cilësitë kryesore të pastrimit etnik të kryer nga serbët gjatë luftërave të fundit në Jugosllavi

Siç mund të shihet nga emërtimi i këtij seksioni, këtu flasim vetëm për cilësitë e pastrimit etnik të kryer nga serbët në territorin e ish-Jugosllavisë në luftërat e fundit, dhe jo për cilësitë e tij të manifestuara gjatë luftërave të hershme. Për periudhën e mëhershme kemi folur kur përmendëm Raportin e Komisionit Ndërkombëtar të Hetimeve, i cili provon faktet lidhur me krimet e pastrimit etnik të kryera më herët nga ana e serbëve.

Jo rrallë mund të dëgjohet se të gjitha anët në luftë në Bosnjë-Hercegovinës dhe gjetiu në ish-Jugosllavi kanë kryer krime. E megjithatë, janë serbët ata që kanë kryer më shumë krime se të gjithë të tjerët dhe atë në mënyrë të planifikuar për arritjen me paramendim të një qëllimi të caktuar politik. Dëbimi me plan, i paramenduar, i joserbëve dhe shkatërrimi i kulturave të tyre paraqet cilësinë kryesore dhe bazike të krimeve masive të kryera nga serbët gjatë luftërave të fundit në ish-Jugosllavi. Se kjo është kështu mund të shihet fare lehtë nga përgatitjet serbe për luftë, përgatitje që kanë pasur dimensionin politik, ushtarak, propagandistik, ekonomik dhe diplomatik.[463]

---

[462] Për natyrën e ndryshueshmë të identitetit kolektiv dhe funskionin e tij social në vartësi të rrethanave, shih më shumë në Virginia Tilley, "The Terms of Debate: Untangling Language about Ethnicity and Ethnic Movements", *Ethnic and Racial Studies* vol. 20, no. 3 (July 1997) fq. 497-522.

[463] Për një analizë të detajuar dhe të provuar mirë të këtyre përgatitjeve serbe, shih më shumë në Slaven Letica, "The Genesis of the Current Balkan War", në Stjepan G. Meštrović (ed.),

Kjo përgatitje në të njëjtën kohë flet edhe për faktin se pastrimi etnik nuk ka qenë rezultat i luftës së nisur nga serbët, siç do të donin ta paraqisnin disa të huaj dhe vetë serbët, por vetë qëllimi i luftës. Se pastrimi etnik nuk është veçse një politikë e orkestruar nga Beogradi është provuar tanimë në mënyrë kompetente nga ish-Raporteri Special i OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Jugosllavi, Tadeusz Mazowiecki (Tadeush Mazovjecki), ish-kryeministër polak.[464]

Një cilësi tjetër, në vijim si më sipër, është se pastrimi etnik i joserbëve dhe shkatërrimi i kulturave të tyre ka qenë në funksion të realizimit të programit serb të zgjerimit territorial me qëllim të krijimit të Serbisë së Madhe. Në këtë kuptim, luftërat në Jugosllavi duhet të shikohen si luftëra tipike klauzeviciane të ndjekura nga Serbia në të gjitha rastet kur kanë dështuar përpjekjet politike për hegjemoni ndaj popujve joserbë. Kjo nënkupton se fjala është për rastet kur projekti politik serb për një federatë të centralizuar, përkatësisht për realizmin e projektit të Serbisë së Madhe, nuk ka mund të arrihet me mjete politike, atëherë serbët kanë ndjekur rrugët e dhunshme për realizimin e qëllimeve të tyre.

Cilësia e fundit e pastrimit etnik të kryer nga serbët ka qenë edhe koha mjaft e shkurtër brenda së cilës është realizuar. Dy kanë qenë faktorët përcaktues në të cilët është mbështetur shpresa serbe për zgjerim të shpejtë territorial: së pari, arsenali i madh ushtarak i koncentruar në duart e serbëve në prag të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe, së dyti, mungesa e fuqisë njerëzore serbe për përdorim efektiv të kësaj makinerie ushtarake. Këta dy faktorë kanë përcaktuar mënyrën e përdorimit të forcës ushtarake nga ana e serbëve me qëllim të arritjes se qëllimeve kryesore strategjike, përkatësisht me qëllim të krijimit të Serbisë së Madhe përmes pastrimit etnik të të gjithë joserbëve dhe të shkatërrimit të kulturës së tyre.

Përfundim

Pastrimi etnik si mënyrë e zhvendosjes me dhunë të një popullsie është paraqitur si fenomen modern vetëm atëherë kur nacionalizmi u bë ideja kryesore dhe forca shtytëse e ridefinimit socio-politik në Evropë pas shekullit

---

Genocide after Emotion: The Post-Emotional Balkan War (Routledge: New York, 1996) fq. 91-108.

[464] Alfied de Zayas, "The Right to One's Homeland: Ethnic Cleansing and the International Criminal Tribunal for Former Yugoslavia", fq. 295-296.

XVII. Nga fillimi i shekullit XX, Ballkani përjetoi mbi supet e tij shumicën e këtij lloji të krimit më obskur. Shtetet e reja ortodokse (Bullgaria, Greqia, Mali i Zi dhe Serbia) kanë qenë vendi i kryerjes së këtij krimi.

Projekti i Serbisë së Madhe, i skicuar nga Ilija Garashanin (1844) dhe i përfunduar me Memorandumin e AShAS të vitit 1986, ka përgatitur terrenin për kryerjen e krimit serb të pastrimit etnik. Ky krim është përgatitur dhe, në disa periudha kohore, ka qenë i suksesshëm ndaj atyre territoreve ku serbët nuk kanë qenë asnjëherë shumicë. Pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, megjithatë, projekti i Serbisë së Madhe u rrëzua, mirëpo akoma ngelet si pjesë e pandarë e shoqërisë serbe.

Cilësia e parë e pastrimit etnik të kryer nga serbët gjatë luftëtarëve të fundit në territorin ish-jugosllav, ngelet konstatimi ynë në këtë shkrim, konsiston në faktin se ai ka qenë i planifikuar dhe i menduar mirë para se të vihet në jetë. Memorandumi i vitit 1986 i AShAS shënon pikën vendimtare të kthesës në procesin e ridefinimit kolektiv të identitetit serb. Edhe këtë herë, ky ridefinim u bë konform strukturës sociale të shoqërisë serbe dhe elitës së saj, duke qenë kështu në funksion të realizimit të projektit të Serbisë së Madhe, siç ka ndodhur gjatë njëqind vjetëve të fundit të historisë serbe.

Cilësia e dytë e këtij krimi ka qenë se ai ka qenë i planifikuar si një fushatë afatshkurtër, fakt ky i përcaktuar nga dy faktorë. Së pari, serbët me forcë kanë shtënë në dorë armatimin e ish-Jugosllavisë, duke i drejtuar ato më pastaj kundër popujve joserbe dhe kulturave të tyre me qëllim të krijimit të Serbisë së Madhe. Së dyti, ushtarët serbë, forcat e rregullta dhe paramilitarët, kanë kryer krimin e pastrimit etnik me bindjen se popujt e robëruar nga ta dhe bashkësia ndërkombëtare do të rrinin duarkryq pa bërë asgjë. Këtu janë mashtruar keq sepse edhe popujt e robëruar, por edhe bashkësia ndërkombëtare krahas tyre, në mënyrë të koncentuar, i kanë dalë përballë projektit serb për Serbinë e Madhe, duke e rrëzuar për momentin. Projekti i Serbisë së Madhe, megjithatë, ngelet si pjesë e pandarë e kulturës së shoqërisë serbe edhe për një kohë të gjatë, gjë që është pasojë e strukturës sociale të shoqërisë serbe.

Së fundi, pastrimi etnik i kryer nga serbët paraqet një vazhdimësi të Memorandumit të vitit 1986, por me mjete të dhunshme. Kjo nënkupton se luftërat serbe në kuadër të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë janë luftëra tipike klauzeviciane. Nga ky fakt buron edhe konstatimi tjetër që thotë se pastrimi etnik është qëllimi i vetë luftërave serbe dhe jo pasojë e tyre.

Lëvizjet serbe në Kosovë në fillim të vitit 1998 provuan pikërisht këtë, pra se serbët synonin pastrimin etnik të shqiptarëve nga Kosova ashtu që fajin duhej kërkuar vetëm në regjimin e Beogradit. Bashkësia ndërkombëtare, në

veçanti NATO, këtë herë ishin të vendosur më shumë se në rastin e Bosnjë-Hercegovinës për të mësuar nga gabimet e kaluara. Nga rasti i Kosovës, serbët dhe shoqëria e tyre u deshën të ndeshen me një realitet tjetër sepse tanimë pasojat po i ndiente vetë Beogradi dhe Serbia. Tani vetë serbët duhej të adresonin rrënjët e iracionalitetit të tyre. Megjithatë, besojmë fuqishëm se përkundër gjithë kësaj shoqëria serbe nuk mund të bëj vetëm asgjë pa ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare për të tejkaluar kulturën politike dhe mentalitetin që ka prodhuar pastrimin etnik. Me një fjalë, perspektiva e demokratizimit të shoqërisë serbe mbetet e zbehtë pa mbështetjen dhe ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare.

III. Rasti i asociacionit serb në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës

Hyrje

Kur prof. B. Banaszak më dërgoi, më 16 mars 2016, një kërkesë për të shkruar një punim për nder të profesorit të dashur Arnold Rainer në një afat deri nga mesi i muajit prill, nuk kisha si të mendoja për diçka tjetër pos për një temë nga Ballkani, për rajonin, njerëzit dhe projektet hulumtuese të të cilit aq shumë i ka mbështetur prof. Rainer gjatë tërë karrierës së tij profesionale dhe akademike. Mendova se kjo temë do të ishte një shenjë simbolike e respektit të thellë që kam për prof. Aronld Rainer, i cili asnjëherë nuk e la Kosovën anash në debatet e në diskutimet akademike të juristëve evropianë, siç do të kishin dashur disa. Në fakt, ishte profesori Rainer ai që, në shtatorin e vitit 2009, më kishte ftuar që, në cilësinë e kryetarit të parë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, e formuar pak muaj më herët, të merrja pjesë në Kongresin XI mbi të Drejtën Komparative Kushtetuese dhe Forumin Kushtetues Evropian, që u mbajt në Regensburg të Gjermanisë në dhjetor të vitit 2009.

Marrëdhëniet Kosovë-Serbi, në kuptimin politik, përbëjnë nyjën e qetësisë në Ballkanin Perëndimor. Këto marrëdhënie janë pjesë e peizazhit të përgjithshëm ballkanik të marrëdhënieve serbo-shqiptare, marrëdhënie të cilat nuk kanë pasur një harmoni e qetësi për të shumtën e kohës. Këtu e kemi fjalën për periudhën nga fillimshek. XIX e deri më sot, pra për kohën nga fill-

imi i formimit të shteteve nacionale në Ballkan, kur ballkanasit luftuan për emancipim e për çlirim nga Perandoria Osmane. Ky punim, sigurisht, nuk ka për qëllim që të merret më çështjet e nacionalizmit në Ballkan, e as me marrëdhëniet e popujve të Ballkanit nga këndvështrimi historik. Qëllim dhe synim i këtij punimi është të sqarojë aspektet juridiko-kushtetuese të disa marrëveshjeve të lidhura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në vazhdën e stabilizimit të marrëdhënieve në mes të këtyre dy vendeve të trazuara të Ballkanit.

Aspektet juridiko-kushtetuese të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilat kanë dominuar skenën politike, publike e akademike gjatë këtyre tre vjetëve të fundit, që kur filloi dialogu me Serbinë në Bruksel, në vitin 2013, me ndihmën dhe me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, nuk kanë qenë edhe aq dominante. Aspektet politike kanë qenë dhe mbeten primare në marrëdhënien Kosovë-Serbi. Aspektet juridiko-kushtetuese kanë qenë kryesisht të lidhura për natyrën juridike-kushtetuese dhe me vendin e disa marrëveshjeve të lidhura ndërmjet dy vendeve. Nuk ka rëndësi që dialogu me Serbinë nuk doli të jetë krejt teknik, siç thuhej dhe siç ishte më 2005, kur autori i këtyre rreshtave kishte udhëhequr një dialog Kosovë-Serbi me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian e të ShBA-së, e kur asnjë marrëveshje nuk u arrit në Vjenë përveç marrëveshjes që të vazhdohet me bisedime edhe në të ardhmen. Këto aspekte krejt socio-politike, që vetëm më vonë do të reflektohen në dimensionin e tyre juridik-kushtetues, do të trajtohen në seksionin e parë të këtij punimi. Kjo sepse vetëm kështu mund të hapet rruga për të kuptuar seksionin e dytë në vijim, ku flitet për vendin dhe për fuqinë juridiko-kushtetuese të traktateve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm — kosovar.

Në diskursin kosovar, pas kontrollit kushtetues të *Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë*, të 19 prillit 2013, ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 qershor 2013 me Ligjin nr. 04/L-199 (në tekstin e mëtejmë: Marrëveshja e Parë), u pa qartë se ka një mosnjohje të skajshme të koncepteve bazike nga e drejta kushtetuese që lidhen me ratifikimin, me llojet dhe me funksionin e tij, me vendin dhe me fuqinë juridiko-kushtetuese të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në sistemin e brendshëm juridik-kushtetues kosovar, si dhe me statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare të paratifikuara në kuadër të këtij sistemi, përfshirë këtu edhe mundësitë eventuale të kontrollit të tyre kushtetues. Kjo mosnjohje, në veçanti, shihet në mesin e komunitetit juridik, por edhe më gjerë në publikun e gjerë kosovar. Kjo rrethanë u bë krejt e qartë pas nënshkrimit, më 25 gusht 2015 në Bruksel, të *Marrë-*

veshjes mbi Parimet e Përgjithshme Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe (në tekstin e mëtejmë: Marrëveshja e Dytë). Kjo marrëveshje nuk iu nënshtrua asnjë ratifikimi, por që, lidhur me të, Gjykata Kushtetuese u prononcua në një mënyrë krejtësisht të çuditshme me Aktgjykimin KO 130/15, të 23 dhjetorit 2015, i cili do të elaborohet në këtë shkrim gjerësisht në vijim.[465]

Këto dy çështje, pra çështja e vendit dhe e rolit të marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin juridik-kushtetues kosovar, si dhe kushtet e mënyrat për aplikim të kontrollit kushtetues ndaj tyre, do të jenë objekt i një trajtimi të veçantë në seksionet tre dhe katër të këtij punimi, duke bërë të qartë se ka një dallim substancial ndërmjet paragrafit 1, të nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës së Kosovës dhe paragrafit 2 të po këtij neni, diçka që ekziston pak a shumë thuajse në të gjitha kushtetutat e vendeve evropiane, si të ish-vendeve komuniste ashtu edhe të demokracive tradicionale të Kontinentit të vjetër. U mor vesh, formulimet e dispozitave dallojnë, por mesazhi ngel i njëjtë: ekzistojnë disa lloje të marrëveshjeve ndërkombëtare që i nënshtrohen ratifikimit të brendshëm nga ana e organit përfaqësues, por edhe disa të tjera që mund të ratifikohen edhe nga shefi i shtetit, nga Qeveria ose nga organi tjetër kushtetues i autorizuar për një gjë të tillë. Ratifikimi i këtyre të fundit quhet ratifikim ndërkombëtar, për dallim nga ratifikimi i brendshëm ose kushtetues që ka të bëjë me rastet kur akti i ratifikimit ndërmerret nga parlamenti. Dy llojet e ratifikimit do të diskutohen e do të trajtohen në këtë punim.

1. Rrethanat e krijimit të rastit

Marrëdhëniet Kosovë-Serbi, siç e thamë më sipër, nuk janë objekt trajtimi i këtij punimi, në veçanti jo në aspektin e historisë së tyre dhe të problemeve që janë krijuar përgjatë shekujve.[466] Sa për lexuesin jo mjaft të informuar,

---

[465] Aktgjykim në rastin nr. KO 130/15. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë — Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, me nenin 3.1 [Barazia para Ligjit], me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Prishtinë, 23 dhjetor 2015.

[466] Për këtë çështje, shih më shumë te libri i jashtëzakonshëm i Noel Malcolmit, *Kosovo. A Short History* (New York UP: New York, 1999). Në fakt, analiza jo vetëm historike, por edhe

megjithatë, besojmë që ka nevojë të thuhen disa fjalë shumë shpejt e shkurt lidhur me atë se si ka ardhur gjendja deri këtu, kur Gjykata Kushtetuese e Kosovës duhet të merret me aspektet kushtetuese të marrëdhënieve Kosovë-Serbi.

Kosova, në periudhën prej mbarimit të Luftës së Parë e deri në mbarim të Luftës së Ftohtë, ka qenë pjesë e asaj që njihet si ish-Jugosllavi. Ndërmjet dy luftërave botërore, Jugosllavia ka qenë me rregullim shtetëror monarkik, për t'u kthyer në një republikë komuniste pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Si e tillë, pra si republikë komuniste, ish-Jugosllavia ka ekzistuar deri në mbarim të Luftës së Ftohtë kur edhe qe shpërbërë. Nga rrënojat e saj u krijuan fillimisht pesë shtete sovrane dhe të pavarura, e më vonë, më 17 shkurt 2008, nga mbetjet e asaj që u krijua më 1992 si Republika Federale e Jugosllavisë (Serbi-Mali i Zi) u krijua edhe shteti i Malit të Zi dhe shteti i Kosovës, si dy shtete sovrane e të pavarura. Trashëgimia i ish-Jugosllavisë dhe mbyllja e procesit të shpërbërjes në planin ndërkombëtar kishin ndodhur *de facto* më 1992, kurse *de jure* vetëm më 2001, kur u lidh Marrëveshja mbi Trashëgiminë ndërmjet pesë shteteve të dala nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë.[467] Me pavarësimin e Malit të Zi, më 3 qershor 2006, trashëgimia ndërmjet këtij shteti dhe Serbisë ka ndodhur me automatizëm sipas një marrëveshjeje të lidhur nga to në Beograd, më 2002, duke ia ndërruar emrin nga "Republika Federale e Jugosllavisë" në "Unioni Serbi-Mali Zi". Sipas kësaj marrëveshjeje, largimi eventual i njërit prej anëtarëve nga Unioni nënkuptonte që secili duhet t'i zbatojë në mënyrë paqësore dhe me marrëveshje dispozitat e Marrëveshjes së Vjenës të vitit 2001 për trashëgiminë e ish-Jugosllavisë.

Kosova, pas 10 qershorit 1999, u fut nën administrim ndërkombëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) sipas Rezolutës 1244 të Këshill-

---

juridike-ndërkombëtare e statusit të Kosovës brenda ish-Jugosllavisë ngërthen një mprehtësi të veçantë të autorit që meriton edhe vëmendje të veçantë. Kjo bëhet në kapitullin e fundit që flet për Kosovën pas vdekjes së Titos, deri më 28 prill 1999, kur është dorëzuar për botim dorëshkrimi i librit.

[467] Marrëveshja është lidhur në Vjenë, më 29 qershor 2001, ndërmjet Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi-Mali i Zi), Sllovenisë dhe Maqedonisë. Për trajtim akademik të kësaj marrëveshjeje, Cf. më shumë: Enver Hasani, "The Evolution of Succession Process in Former Yugoslavia", botuar në *Tomas Jefferson Law Review* vol. 29, no. 1 (ShBA, 2006); ribotuar me leje te autorit edhe në *Miskolc Journal of International Law* vol. 4, no. 2 (Hungari, 2007). Për versionin e përditësuar të këtij punimi në gjuhën shqipe, Cf. Enver Hasani, "Specifikat e trashëgimit të ish-Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të", botuar në *E drejta/Law* nr. 1 (2012) (revistë për çështje juridike dhe shoqërore), Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës.

it të Sigurimit (KS). Kjo rezolutë e mandatonte KS-në që në Kosovë të instalonte një administratë ndërkombëtare me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve vendore për vetëqeverisje lokale, deri në zgjidhjen e statusit politik të Kosovës. Në aspektin formal, sipas kësaj rezolute, Kosova akoma trajtohej si pjesë formale e Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi-Mali i Zi), përkatësisht e Unionit Serbi-Mali Zi, ku sovraniteti i këtij shteti mbi Kosovën quhej si i suspenduar. Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli mëvetësinë pas një sërë negociatash të ndërmjetësuara nga ish-presidenti finlandez Martti Ahtisaari, i cili hartoi një projekt ndërkombëtar për pavarësinë e Kosovës.[468] Ky projekt, i njohur si Plani Ahtisaari, nuk u pranua nga pala serbe e as nga KS i OKB-së, i cili edhe kishte mandatuar misionin e presidentit Martti Ahtisaari me qëllim të zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës. Më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) deklaroi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk mund të kontestohej sepse nuk binte ndesh me asnjë pjesë të së drejtës pozitive ndërkombëtare.[469]

Sado që Plani Ahtisaari kishte parashikuar një mekanizëm shumë të detajuar e unik për kushtet kosovare për mbrojtjen e komuniteteve joshumicë, çështja e mbrojtjes dhe e promovimit të komuniteteve joshumicë në Kosovë, me kuptim këtu në rend të parë komunitetin serb, ngeli një problem akut. As ajo që u cilësua si decentralizim, i nisur para vitit 2008, por që më pastaj u vazhdua, nuk ka dhënë një përgjigje të kënaqshme në këtë aspekt, ashtu që

---

[468] Në prill të vitit 2007, Emisari Special i OKB-së, Martti Ahtisaari, ka parashtruar në KS të OKB-së *Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës* (Plani Ahtisaari). Plani Ahtisaari ka një tekst kryesor me 15 nene të cilat përcaktojnë parimet e përgjithshme, si dhe 12 anekse që elaborojnë këto parime. Plani Ahtisaari ka të bëjë në rend të parë me mbrojtjen e të drejtave, të identitetit dhe të kulturës së komuniteteve joshqiptare të Kosovës, duke përfshirë këtu themelimin e një kuadri për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike. Emisari Special Martti Ahtisaari propozoi që Kosova të bëhej e pavarur me kusht që të ketë një periudhë të mbikëqyrjes së kësaj pavarësie të Kosovës. Titulli i plotë i Planit Ahtisaari është *Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës*, 2 shkurt 2007.

[469] Ky mendim këshillëdhënës është kërkuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me insistimin e Qeverisë së Serbisë. GjND-ja, me këtë mendim këshillëdhënës, ka bërë të qartë në mënyrë elokuente se deklarimi i pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 ka ndodhur si rezultat i ushtrimit të *pouvoirs constituant* përmes përfaqësuesve të vet krejtësisht jashtë rendit juridik të krijuar nga UNMIK-u. Sipas GjND-së, kjo nënkuptonte se rendi i ri juridiko-kushtetues, i krijuar në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë, është një rend tërësisht i ri dhe i ndryshëm nga rendi pararendës. Për më tepër, ky rend as që mëtonte të ishte vijimësi e rendit paraprak që ka ekzistuar në Kosovë në çdo kohë deri më 17 shkurt 2008 kur u shpall pavarësia e Kosovës. Më shumë për këtë shih paragrafët 52-56, 74-84, 96-109 dhe 114-121, të mendimit këshillëdhënës të GjND-së të 22 korrikut 2010 lidhur me atë nëse deklarata e njëanshme e shpalljes së pavarësisë së Kosovës ishte në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

sërish u hap një dialog teknik që filloi gjatë vitit 2011 e që akoma zgjat deri në kohën e shkrimit të këtij punimi. Në kuadër të këtij dialogu teknik kanë lindur disa marrëveshje, prej të cilave, për qëllimet e këtij punimi, më të rëndësishme janë dy: Marrëveshja e Parë dhe Marrëveshja e Dytë.

Marrëveshja e Parë ka gjithsej 15 paragrafë, prej të cilëve paragrafët 1 deri në 6 flasin gjerësisht dhe në mënyrë konkrete për themelimin e një asociacioni të komunave me shumicë serbe. Ky asociacion, sipas tekstit të Marrëveshjes së Parë, themelohet nëpërmjet Statutit dhe modelohet mbi bazën e strukturës dhe formës së asociacionit ekzistues të komunave të Kosovës.

Marrëveshja e Dytë ka gjithsej 22 paragrafë dhe në tërësi shtjellon dispozitat e Marrëveshjes së Parë, por duke e cilësuar tani si një asociacion që mbron e që promovon interesat e serbëve lokalë, që ka një status juridiko-administrativ *on par* me personat juridikë nga e drejta publike në Kosovë me të gjitha pasojat që bart një status i tillë juridiko-kushtetues, që Qeverisë i jep tagrin e dekretimit të Statutit të Asociacionit, kurse Gjykatës Kushtetuese një "juridiksion shtesë" sa i përket kontrollit të kushtetutshmërisë së këtij statuti pasi të jetë draftuar nga komisioni menaxhues dhe pas vërtetimit me dekret qeveritar. Në shikim të parë, duket qartë se Marrëveshja e Dytë dukshëm del nga kuadri i përcaktuar i Marrëveshjes së Parë sepse krijon statuse, të drejta dhe detyrime të nivelit lokal, që mund të cenojnë rëndë parimet themelore të sistemit kushtetues kosovar. Për këtë kemi folur gjerësisht akoma para prononcimit të Gjykatës Kushtetuese me verdiktin e vet KO 130/95, të 23 dhjetorit 2015.[470]

Opozita kosovare, që nga momenti i bërjes publike në gusht të vitit 2015 të tekstit të Marrëveshjes së Dytë, ka filluar kundërshtimin e saj, përfshirë këtu edhe metodat jopolitike e violente. Fjalët çelës të opozitës kanë qenë nga fillimi se fare nuk duhet të ndodhë themelimi i Asociacionit të Komunave Serbe, ndërkohë që Qeveria deri në fund ka qenë e bindur se kjo duhet të ndodhë dhe se, në këtë drejtim, nuk ka pasur asnjë tejkalim të kompetencave të saj me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Dytë, më 25 gusht 2015. Situata jashtëzakonisht e tensionuar politike bëri që znj. Atifete Jahjaga, presidente e Kosovës, çështjen ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese, në vijim të vënies në jetë të kompetencave të saj kushtetuese si përfaqësues i unitetit ju-

[470] Shkrimi i parë publik që konstaton disa cenime të rënda kushtetuese të tekstit të Marrëveshjes së Dytë i ka bërë autori i këtyre rreshtave në një shkrim të gjatë të titulluar "Marrëveshja ia njeh pushtetin kushtetutbërës Asociacionit", botuar në të përditshmen kosovare *Zëri Ditor*, më 4 nëntor 2015 (fq. 10-11). Në këtë punim pak a shumë trajtohen gjërat e njëjta me ato të botuara në gazetën e sipërcituar *Zëri Ditor*.

ridik-kushtetues të popullit të Kosovës.[471] Kërkesa u dërgua më 31 tetor 2015 dhe me të kërkohej që Gjykata të përgjigjej në pyetjen si vijon:

> Duke marrë parasysh se Parimet e Asociacionit rregullojnë krijimin dhe funksionimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, a janë në përputhshmëri këto parime dhe elemente me frymën e Kushtetutës, neni 3, paragrafi 1 (natyra shumetnike), me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës?

Nga kërkesa qartë shihet se Presidentja nuk ka konsideruar që Kosova ka marrë ndonjë detyrim ndërkombëtar me nënshkrimin e Marrëveshjes së Dytë nga ana e Kryeministrit të Kosovës. Për më tepër, fare nuk merret se Marrëveshja e Dytë ka formën apo përmbajtjen e një detyrimi valid ndërkombëtar të shtetit të Kosovës. Kjo sjellje kështu ka kushtëzuar edhe sjelljen dhe përgjigjen e Gjykatës dhe buron si pasojë e situatës jashtëzakonisht të nderë që aktualisht mbretëron në Kosovë që nga vjeshta e vitit 2014. Megjithatë, kjo vetëm u tha sa për të treguar arsyet e një kërkese të tillë të bërë në panik, njëjët sikur edhe vetë verdikti i Gjykatës lidhur me këtë çështje, i dhënë po ashtu në panik. Kjo në asnjë mënyrë nuk amniston padijen profesionale respektive të aktorëve si më sipër, të cilët në çdo situatë e nën çdo presion duhet ta mbrojnë Kushtetutën e Kosovës, dispozitat e saj që janë esenciale për të ruajtur reputacionin e Kosovës ndërkombëtarisht, të atyre dispozitave që flasin për statusin juridiko-kushtetues të detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës të marra nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare. Parimi i proporcionalitetit me rastin e gjykimit dhe zgjidhjes së çështjeve që kanë implikime ndërkombëtare vjen i pari në këtë aspekt[472]. Kjo nënkupton se nuk ka logjikë dhe nuk shkon që Gjykata Kushtetuese të luajë rolin e një gjykate

---

[471] Neni 83 [Statusi i Presidentit] i Kushtetutës: "Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikë së Kosovës".

[472] Siç e ka thënë Hans Kelsen shumë kohë më heret, më 1929, nuk ekzistojnë pengesa juridike që të parashikohet kontrolli kushtetues represiv i marrëveshjeve ndërkombëtare. As në të drejtën kushtetuese nuk ka një pengesë të tillë. Por, sipas tij, ka pengesa të natyrës politike që shteti duhet mirë t'i peshojë kur vendos për një hap të tillë, gjithnjë me supozim që në tekstin kushtetues ekziston një dispozitë e tillë shprehimore që lejon kontrollin kushtetues represiv të marrëveshjeve ndërkombëtare. Cf. më shumë për Hans Kelsen, si dhe për zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe shtjellimet e tjera të tij në mes të dy luftërave botërore, në disertacionin e pabotuar të doktoratës të Olivera Vučić, *Austrijsko ustavno sudstvo: čuvar federacije i ustava* (mbrojtur më 1995 në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit) fq. 200-204.

ndërkombëtare dhe të amnistojë gabimet e padijen e politikës kosovare, të bëra në planin ndërkombëtar nëpërmjet shtjellimeve juridiko-kushtetuese që nuk kanë mbështetje në asnjë teori ose praktikë kushtetuese komparative. Ta shohim më nga afër këtë problematikë.

2. Vendi i marrëveshjeve ndërkombëtare në rendin e brendshëm

Në Evropë, për momentin, ekzistojnë tri lloje të sistemeve juridiko-kushtetuese që përcaktojnë vendin dhe rolin e traktateve ndërkombëtare në sistemin e brendshëm[473]. Në disa shtete, kushtetutat nacionale u japin një status special, në veçanti kur flitet për traktatet nga fusha e të drejtave të njeriut;[474] në disa të tjera, traktatet kanë statusin ndërmjet kushtetutës dhe ligjit;[475] dhe, së fundi, në disa vende evropiane, traktatet e të gjitha llojeve, me kushtetutë nacionale, gëzojnë statusin e ligjit të zakonshëm.[476] Këtu bën përjashtim Hol-

[473] Mbi statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare në të drejtën e brendshme në përgjithësi në aspektin komparativ, cf. më shumë Anne Peters, "Supremacy Lost: International Law Meets Domestic Constitutional Law", *Vienna Journal on International Constitutional Law* vol 3, issue 3 (September 2009) fq. 170-198.

[474] Kjo është kështu me shumicën e shteteve të ish-lindjes komuniste ku traktatet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut kanë status të privilegjuar në sistemin e tyre juridiko-kushtetues, duke qëndruar mbi ligjet e zakonshme, në disa raste edhe baras me vetë kushtetutat nacionale (p.sh., Shqipëria dhe Maqedonia). Ky trend i ndërkombëtarizimit ka filluar pas mbarimit të Luftës së Ftohtë. Cf. më shumë në materialet si vijon: Eric Stein, "International Law in Internal Law: Towards Internationalisation of Central — Eastern European Constitutions", *American Journal of International Law* vol. 88, no. 3 (July 1994) fq. 427-450; European Commission for Democracy Through Law (Vennice Commission), "The Relationship Between International and Domestic Law", *Science and Technique of Democracy* no. 5, CDL-STD (1995) 005 (Strasburg, 15 September 1993), në veçanti seksioni: *The Implementation of International Human Rights Agreements*.

[475] Ky është standardi i pranuar nga shumica e vendeve evropiane, pa llogaritur këtu traktatet mbi të drejtat e njeriut. Kjo do të thotë se, në shumicën e vendeve evropiane, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara nga parlamenti bëhen pjesë e sistemit të brendshëm pas publikimit të tyre në një gazetë zyrtare dhe mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke pasur kështu fuqinë mbi ligjin e zakonshëm që rri sipas fuqisë juridike menjëherë pas dispozitave kushtetuese. Cf. Thomas Burgenthal, "Modern Constitutions and Human Rights Treaties", *Columbia Journal of Transnational Law* vol. 36, Special Double Issue (1997) fq. 211-223; European Commission for Democracy Through Law (Vennice Commission), "The Relationship Between International and Domestic Law", në veçanti seksioni "The Elaboration of Model Clauses on the Relationship Between International and Domestic Law".

[476] Në Britaninë e Madhe dhe në vendet e tjera të modeluara sipas saj, nuk bëhet ndonjë dallim ndërmjet traktateve ndërkombëtare të përgjithshme dhe atyre mbi të drejtat e njeriut, sepse dy llojet e traktateve në fjalë kanë statusin e ligjit të zakonshëm britanik. Cf. më shumë

anda, e cila i jep një primat absolut të drejtës ndërkombëtare, pa marrë parasysh burimin e saj (traktat, zakon ndërkombëtar apo burim tjetër i të drejtës ndërkombëtare).

Kosova bën pjesë në kategorinë e shumicës së shteteve evropiane që traktatit ndërkombëtar ia njohin fuqinë mbi ligjin e zakonshëm dhe nën dispozitat kushtetuese, me përjashtim të traktateve mbi të drejtat e njeriut të cilat kanë fuqinë e normës kushtetuese si çdo normë tjetër kushtetuese.[477] Kjo zgjidhje e fundit ekziston edhe në rastin e Bosnjë-Hercegovinës, ani se atje detyrimi kushtetues është pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Dejtonit (1995), si marrëveshje ndërkombëtare e regjistruar në Sekretariatin e OKB-së.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 9 prill 2008, ka përcaktuar qartë një standard të marrëdhënies mes marrëveshjeve ndërkombëtare dhe ligjeve kosovare, duke ua njohur të parave statusin më të ulët se Kushtetuta e më të lartë se ligji i zakonshëm. Ky standard i

---

te Anthony Aust, *Modern Treaty Law in Practice* (Cambridge UP: Cambridge, 2000) fq. 151-154.

[477] Kjo shihet shumë qartë nga vetë formulimi i nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Ky nen përcakton, *inter alia*, se të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të cilat përmenden në këtë nen, garantohen me Kushtetutë dhe zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës. Në rast konflikti, thuhet më tej në këtë nen, ndërmjet dispozitave të ligjeve dhe të akteve të tjera të institucioneve publike kosovare dhe këtyre dokumenteve ndërkombëtare, atëherë përparësi kanë këto të fundit.

Dokumentet ndërkombëtare të cilat përmenden në nenin 22 të Kushtetutës, si më sipër, janë si vijon: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; dhe (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Sikundër shihet, nga kjo listë përjashtohen marrëveshjet apo dokumentet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat socio-ekonomike. Kjo për faktin se në një vend si Kosova, një listim i tillë do të shkaktonte pritje joreale dhe keqkuptime, të cilat do të mund të shërbenin si bazë për revolucione e përmbysje të tjera sociale në çdo kohë.

Në fund të kësaj, vlen të theksohet se, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, e tërë praktika gjyqësore dhe çdo praktikë tjetër e organeve publike në Kosovë duhet të mbështetet në interpretimet e GjEDNJ-së. Këtë, shprehimisht, e vë në dukje dispozita e nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, e cila thotë: "Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

vënë kësisoj nënkupton që çdo normë e cila bie ndesh me një normë ndërkombëtare kontraktuale shfuqizohet në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj të fundit.[478] Tani këtu shtrohet pyetja nëse një status të tillë juridiko-kushtetues e kanë vetëm marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Kosovës (ratifikimi i brendshëm),[479] në kuptim të nenit 18.1 të Kushtetutës,[480] apo çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare, pa marrë parasysh llojin e ratifikimit, siç përcaktohet në nenin 18.2 të Kushtetutës, i cili formulim nuk dallon në esencë për nga mesazhi që bart nga kushtetutat e vendeve të tjera evropia-

---

[478] Neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] i Kushtetutës:

"1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe kur zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji;

"2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës".

[479] Fjala "ratifikim" ka rrënjë latine dhe ka kuptimin e pëlqimit, të vërtetimit. Si e tillë, ajo përbëhet nga dy pjesë: e para, *ratus*, që domethënë i vlefshëm dhe, e dyta, *facere*, që domethënë për të bërë.

Ekzistojnë dy lloje të ratifikimit: *ratifikimi i brendshëm* dhe *ratifikimi ndërkombëtar*. Ratifikimi ndërkombëtar është një dokument formal-juridik më të cilin shteti jep pëlqimin në planin ndërkombëtar për t'u konsideruar i lidhur për një marrëveshje ndërkombëtare. Ratifikimi i brendshëm bëhet në shumicën e rasteve nga organi përfaqësues. Në kohët e vjetra, ratifikimin e brendshëm e ka bërë mbreti dhe ka pasur efekt retroaktiv ngaqë me aktin e tillë mbreti ka vërtetuar *post festum* veprimet e përfaqësuesit të tij. Më vonë, kjo prerogativë iu njoh parlamentit dhe që atëherë ka shërbyer si një mjet kontrolli ndaj veprimeve të ekzekutivit. Kjo ka qenë pjesë e luftës për parlamentarizëm.

Ndërkohë që ratifikimi i brendshëm është kategori që rregullohet më kushtetutë, ratifikimi ndërkombëtar normohet me nenin 14 [Consent to be Bound by A Treaty Expressed by Ratification, Acceptance or Approval] lidhur me nenin 2 [Use of Terms] të KVDT. Shih, për më tepër, te Frank Hoffmeister, "Consent to be bound by a treaty expressed by ratification, acceptance or approval", te Oliver Dörr, Kirsten Schmalenbach (eds.), *Vienna Connvention on the Law of Treaties: A Commentary* (Springer: Verlag, 2012) fq. 182-183; te Boris Krivokapić, *Enciklopedijski rečnik medjunarodnog prava i medjunarodnih odnosa* (JP Službeni Glasnik: Beograd, 2010) str. 903-904; te Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 6th ed. (Oxford UP: Oxford, 2003) fq. 582-583; te Vladimir Ibler, *Rječnik medjunarodnog javnog prava* (Informator: Zagreb, 1972) str. 55, 253 & 313.

[480] Neni 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës:

"1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:

(1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;

(2) të drejtat dhe liritë themelore;

(3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare; dhe

(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës".

ne?[481] Kjo për arsye se ka marrëveshje ndërkombëtare që lidhen në mënyrë të vlefshme sipas dispozitave të Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve, të vitit 1969 (në tekstin e mëtejmë: KVDT), përkatësisht sipas standardeve të së drejtës zakonore ndërkombëtare, por të cilat nuk i nënshtrohen ratifikimit të brendshëm. I tillë është rasti me Marrëveshjen e Dytë, e cila në pikëpamje të së drejtës ndërkombëtare zakonore ka statusin e marrëveshjes së lidhur në vazhdim të zbatimit të qëllimeve dhe të objektit të Marrëveshjes së Parë. Nga aspekti i të drejtës së brendshme, Marrëveshja e Dytë ka karakter të legjislacionit implementues që administron mënyrën e zbatimit dhe detajet e tjera që lidhen me vënien në jetë të Marrëveshjes së Parë. Lidhja e Marrëveshjes së Dytë në Bruksel, më 25 gusht 2015, sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare është e barabartë me ratifikimin ndërkombëtar.

Sqarimi i natyrës juridiko-ndërkombëtare dhe juridiko-kushtetuese të Marrëveshjes së Dytë ka rëndësi për dy arsye: *e para*, sepse ekziston një parim zakonor ndërkombëtar i cili quhet parimi *bona fide*, i cili nënkupton se *pacta sunt servanda* duhet të zbatohet me mirëbesim, pa marrë parasysh kufizimet e brendshme juridiko-kushtetuese të shteteve; dhe, *e dyta*, në rastet kur një marrëveshje ndërkombëtare ka kaluar ratifikimin e brendshëm nga parlamenti, kontrolli kushtetues i normave të saj paraqet një problem serioz sepse kushtetutat zakonisht përcaktojnë disa kufizime mjaft të qarta të kufijve të kontrollit kushtetues të cilat kufizime duhet t'i respektojnë gjykatat nacionale kushtetuese[482].

Dilema, përkitazi me fuqinë e traktateve ndërkombëtare të lidhura në mënyrë të duhur nga ana e autoriteteve kushtetuese vendore, kanë pasur edhe vendet e tjera ish-komuniste të Evropës. Kjo për arsye se lidhja e një traktati mund të ndodhë që koincidon me aktin e ratifikimit ndërkombëtar. Kjo këtu nuk ka ndonjë rëndësi sepse, fundja, çdo detyrim i marrë ndërkombëtar duhet të zbatohet me mirëbesim, *bona fide*, nëse shteti i caktuar men-

---

[481] Neni 18. 2 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës:

"2. Marrëveshjet ndërkombëtare, me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

"3. Presidenti i Republikës së Kosovës ose Kryeministri njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare".

[482] Mbi kufijtë e kontrollit kushtetues së marrëveshjeve ndërkombëtare, shih punimin e Maja Nastić, "Constituional Review of International Agreements: Comparative Law Perspective", botuar në *Facta Universitatis*, Series: *Law and Politics* vol. 13, no 1 (Niš, Serbia, 2015) fq. 59-72. Për vendet e demokracive perëndimore tradicionale dhe ish lindjen komuniste e më gjërë, shih studimin e detajuar Dinah Shelton (ed.), *International Law and Domestic Legal Systems: Incroporation, Transformation, and Persuasion* (Oxford UP: Oxford, 2011).

don të jetë një anëtar serioz i bashkësisë ndërkombëtare. Kosova nuk bën përjashtim në këtë drejtim, gjë e cila u pa gjatë dialogut me Serbinë pas lidhjes së disa marrëveshjeve ndërkombëtare, nga të cilat vetëm njëra iu nënshtrua ratifikimit nga Kuvendi i Kosovës, tanimë e cilësuar si Marrëveshja e Parë. Dilema kryesore që lindi ndër kosovarët ka pasur të bëjë me përcaktimin e statusit juridiko-kushtetues të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të cilat patën vetëm ratifikim ndërkombëtar të kryer nga njëri prej organeve kushtetuese kosovare që nuk ka nevojë për të pasur plotfuqi për ta futur shtetin në detyrim ndërkombëtar (kreu i shtetit, kryeministri apo ministri i jashtëm).[483] Këto marrëveshje nuk kanë pasur ratifikim të brendshëm nga Kuvendi i Kosovës dhe janë lidhur në vijim të implementimit të Marrëveshjes së Parë, të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës.[484] Me ratifikim ndërkombëtar, siç u theksua më herët, nënkuptohet ai veprim që rregullohet me dispozitat e KVDT-së dhe me të drejtën ndërkombëtare zakonore.

3. Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga parlamenti

Nisur nga kjo qasje lidhur me vendin dhe me rolin e marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin juridik u krijuan edhe juridiksionet përkatëse nacionale për kontrollin e tyre kushtetues. Në shumicën e vendeve ish-komuniste, marrëveshjet ndërkombëtare që kishin të bënin me çështjet e ndjeshme të sovranitetit shtetëror, të financave shtetërore, të të drejtave të njeriut, të terri-

---

[483] Sipas Kushtetutës së Kosovës, por edhe sipas kushtetutave të tjera dhe standardit zakonor ndërkombëtar, ratifikimi në fjalë mund të kryhet nga ana e shefit të Shtetit, shefit të Qeverisë dhe shefit të dikasterit të jashtëm (ministrit të Jashtëm). Këto tri organe nuk kanë nevojë për plotfuqi për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare. Cf. Neni 7.2(a) [Plotfuqitë] i KVDT.

[484] Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për Marrëveshjen e Dytë. Ka edhe marrëveshje në lëmenjtë e tjerë, të cilat janë lidhur në vazhdim të implementimit të Marrëveshjes së Parë. E tillë është, ta zëmë, "*Marrëveshja për Telekomunikacionin në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë*", aprovuar me Vendimin e Qeverisë nr. 03/148. Vetëm Marrëveshja e Dytë ka qenë deri më sot objekt vendimmarrjeje në Gjykatën Kushtetuese, me Aktgjykimin KO 130/15, të 23 dhjetorit 2015.

Marrëveshja për Telekomunikacionin nuk ka nevojë për ratifikim parlamentar meqë shërben si një akt juridik implementues i Marrëveshjes së Parë, e cila nga ana tjetër është ratifikuar me ligj të veçantë, me Ligjin nr. 04/L-199 të cekur më sipër. Si e tillë, Marrëveshja për Telekomunikacionin ka karakter implementues administrativ, siç kanë edhe Plani i Veprimit dhe të gjitha aktet e tjera të Qeverisë së Kosovës, të nxjerra në vijim të implementimit të detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës të marra në bazë të Marrëveshjes së parë, të Kushtetutës dhe të ligjeve të Kosovës.

torit etj., kërkohej t'i nënshtroheshin ratifikimit parlamentar dhe pëlqimit të ekzekutivit, veprime që kryheshin me draftimin e një ligji të veçantë.[485] Ligji, me të cilin ratifikohet një marrëveshje ndërkombëtare, sipas zgjidhjeve kushtetuese të shumicës dërrmuese të vendeve ish-komuniste të Evropës, por edhe më gjerë, nuk ka fare asnjë fuqi normative. Kjo do të thotë se ai ligj vetëm sa e fut në sistemin e brendshëm juridik-kushtetues një marrëveshje të lidhur ndërkombëtare, e cila, nëse ka norma të vetekzekutueshme,[486] mund të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo do të thotë se, në një rast të tillë, marrëveshja ndërkombëtare mund të krijojë të drejta e detyrime për palët të cilat mund të realizohen pranë gjykatave e organeve të tjera nacionale në mënyrë të njëjtë si çdo ligj apo normë tjetër e brendshme. Kështu është rasti edhe me Kosovën dhe me nenin 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës së cituar më lart. E njëjta vlen edhe për paragrafin e dytë në vijim të nenit të njëjtë, i cili flet për llojet e tjera të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat nuk kërkojnë ratifikim të organit përfaqësues, por vetëm lidhjen e tyre me veprimin adekuat të organeve kushtetuese të cilat, sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare, nuk kanë nevojë të kenë plotfuqi:

---

[485] Në fakt, edhe demokracitë e vjetra evropiane, si: Franca, Italia, Gjermania etj., kanë dispozita shprehimore kushtetuese që përcaktojnë saktë se marrëveshjet e caktuara të rëndësisë së veçantë shtetërore që prekin çështjet e sovranitetit territorial dhe shtetëror, financat, buxhetin apo ndonjë interes tjetër vital, ratifikohen me ligj nga ana e parlamentit nacional. Professor C. Economides, "The Relationship Between International and Domestic Law", *Science and Technique of Democracy* no. 6, CDL-STD 006 (Vennice Commission: Strasbourg, 1993).

Në vendet e sistemit anglosakson, në Britani të Madhe ta zëmë, nxjerrja e ligjit, i cili quhet *enabling act* (ligji autorizues), kërkohet jo për të futur në sistemin e brendshëm një normë të një marrëveshjeje ndërkombëtare por për të transformuar tërësisht një normë të tillë ndërkombëtare duke e kthyer atë në një normë të brendshme juridiko-kushtetuese. Ky ligj nxirret zakonisht kur një marrëveshje ndërkombëtare, pra një normë e përmbajtur në një marrëveshje ndërkombëtare, afekton të drejtat dhe përgjegjësitë private, rezulton në ngarkesën e fondeve publike, ose kërkon ndryshimin e një ligji vendor ose të drejtës së përgjithshme (*common law*) me qëllim që ajo marrëveshje të mund të zbatohet nga ana e gjykatave të vendit. Cf. Franck C. Newman and David Wiessbrodt, *International Human Rights: Law, Policy, and Process* (Anderson: Cincinati, Ohio, 1996) fq. 23; Thomas Buergenthal, "Modern Constitutions and Human Rights Treaties", *Columbia Journal of Transnational Law* vol. 36 (1997) fq. 211, në fq. 213-216; Anthony Aust, *Modern Treaty Law and Practice*, kapitulli 10 ("Treaties and Domestic Law") fq. 143-161; Ian Brownlie, *Principles of Public International Law* (Oxford UP: Oxford, 2003) fq. 44-45; David Weissbrodt and Connie de la Vega, *International Human Rights: An Introduction* (Univ. of Pennsylvania Press: Philadelphia, 2007) fq. 4-6.

[486] Shih më shumë për këtë në punimin e shkëlqyer të David Sloss "Non-Self-Executing Treaties: Exposing a Constitutional Fallacy", *U.C. Davis Law Review* vol. 36, no. 1 (November 2002) fq. 2-84.

shefi i shtetit, kryeministri, dhe, së fundi, ministri i jashtëm. Për marrëveshjet e lidhura në këtë mënyrë vetëm njoftohet organi përfaqësues, Kuvendi i Kosovës, për hir të zbatimit të parimit të transparencës së punës së organeve kushtetuese që janë të ngarkuara më punët e politikës së jashtme. Sa i përket forcës juridiko-kushtetuese, asnjë dallim nuk ka ndërmjet kategorisë së parë dhe të dytë, gjithnjë me kusht që janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Fuqia e tyre në praktikë varet nga natyra e normave që përmbajnë. Në rastet kur marrëveshjet e tilla kanë norma të vetekzekutueshme, zbatimi i tyre i drejtpërdrejtë nuk vihet në pikëpyetje. Në rastet kur ato nuk kanë një natyrë të tillë të vetekzekutueshme, atëherë kërkohet lidhja e një marrëveshjeje tjetër shtesë, apo nxjerrja e një legjislacioni tjetër vendor shtesë, i cili ka për qëllim implementimin e marrëveshjes së ratifikuar ndërkombëtare në kuptim të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës.[487] Zaten, vetë emërtimi i këtij neni të Kushtetutës së Kosovës e bën të qartë, pa asnjë ekuivok, se bëhet fjalë për dy llojet e ratifikimit që u përfolën më lart.

Marrëveshjet nga neni 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues nga ana e Gjykatës Kushtetuese, si pasojë e faktit se standardi i kontrollit kushtetues së marrëveshjeve të tilla është shumë i rreptë dhe nuk lejon gjykatat kushtetuese të ndërhyjnë në komunikimin ndërkombëtar të shteteve, të cilat, nëse do ta kishin një të drejtë të tillë, atëherë do ta luanin rolin e një gjykate ndërkombëtare kushtetuese. Këtë pozitë e ka mbrojtur edhe Gjykata Kushtetuese e Ko-

[487] Legjislacioni implementues mund të ketë formën e vendimit të Qeverisë, siç ishte rasti me Vendimin e Qeverisë për Marrëveshjen për Telekomunikacionin, e përmendur më lart. Ai legjislacion mund ta ketë formën e ligjit të kualifikuar, siç ishte rasti me Ligjin nr. 05/L-053 për Dhomat Speciale dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015. Në fund fare, ky legjislacion implementues mund të ketë natyrën e marrëveshjes shtesë në vazhdim të implementimit të një detyrimi primar origjinal ndërkombëtar, i cili nuk është marrëveshje ndërkombëtare por që ka lindur si pasojë e një vendimi të një organi ndërkombëtar, siç është rasti me Vendimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës që miraton Raportin dok. 12462, të 7 janarit 2011, lidhur me pretendimet për krimet e kryera ndërkufitare dhe ndërkombëtare gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij. Si legjislacion implementues që ka natyrën juridike të marrëveshjes ndërkombëtare që ka lindur si pasojë e implementimit të një detyrimi primar (origjinal) ndërkombëtar mund të theksohet Marrëveshja e Përkohshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës mbi Organizimin e Institucionit të Gjykatës Speciale të Kosovës i Zhvendosur në Holandë, e lidhur në Prishtinë, më 26 janar 2016. Kjo marrëveshje është ratifikuar me *Dekretin DMN-003-2016 të Presidentes së Republikës së Kosovës për Ratifikim të Marrëveshjes Ndërkombëtare*, i cili mban datën 3 shkurt 2016.

sovës në aktgjykimin e saj lidhur me kontrollin kushtetues së Marrëveshjes së Parë.[488] Me këtë aktgjykim, Gjykata ka bërë të qartë se, në vendet ku lejohet kontrolli kushtetues i marrëveshjeve ndërkombëtare, një gjë e tillë mund të bëhet vetëm para se ato të jenë ratifikuar nga ana e organit përfaqësues (ratifikimi i brendshëm). Pas ratifikimit, një gjë e tillë nuk mund të ndodhë sepse, siç ka konstatuar me të drejtë Gjykata Kushtetuese, një gjë e tillë do të pengonte seriozisht komunikimin ndërkombëtar ndërmjet shteteve. Në Evropë ekzistojnë shtete, të përmendura edhe në këtë aktgjykim të Gjykatës, të cilat njohin të drejtën e kontrollit preventiv të marrëveshjeve ndërkombëtare, si: Shqipëria, Bullgaria, Kroacia etj.[489] Në praktikën e vet gjyqësore, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë me *Vendimin nr. 15/2009*, të 15 prillit 2010, ka shpallur si antikushtetuese një marrëveshje të paratifikuar, të lidhur ndërmjet këtij vendi dhe Greqisë, e cila synonte caktimin e kufijve të tyre në det.[490]

Janë të rralla shtetet që lejojnë kontrollin kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare pas ratifikimit të tyre të brendshëm nga parlamenti. Polonia e Serbia janë ndër to.[491] Në vendet që kanë një zgjidhje të tillë kushtetuese, partnerët negociues së një marrëveshje ndërkombëtare duhet të njoftohen me kohë nga negociuesit e tillë për kufizimet e tyre kushtetuese. Kjo për faktin se barrierat kushtetuese nuk mund të jenë arsye valide për anulim të marrëveshjes së lidhur ndërkombëtare, përveç nëse nga rrethanat e rastit del se palët e kanë pasur të qartë një barrierë të tillë.[492] Shtetet, si Gjermania, për t'i ikur kësaj situate të pakëndshme, me Aktgjykimin e 29 qershorit 2009 lidhur me Traktatin e Lisbonës, ka ofruar zgjidhje subtile që në mënyrë të tërthortë

---

[488] Aktgjykim në Rastin nr. KO 95/13. Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-199 për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje (Nr. ref.: AGJ469/13, 9 shtator 2013).

[489] Cf. Paragrafët 48-69 të Aktgjykimit.

[490] Cf. më shumë për trajtimin elokuent të këtij rasti nga vetë raportuesi i çështjes, prof. Xhezair Zaganjori, *Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare* (Morava: Tiranë, 2011) fq. 39-52.

[491] Neni 167.2 [Statusi Gjykatës Kushtetuese] i Kushtetutës së Serbisë të vitit 2006 thotë shprehimisht se Gjykata Kushtetuese mund të vendosë lidhur me përputhshmërinë e marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare me Kushtetutën, kurse neni 118.1 [Tribunali Kushtetues] i Kushtetutës së Polonisë të vitit 1997 stipulon të drejtën e Tribunalit që të gjykojë përputhshmërinë e ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën.

[492] Në fakt, në nenin 46 [Dispozitat e të Drejtës së Brendshme Lidhur me Kompetencën për Lidhjen e Traktateve] të KVDT-së, shprehimisht theksohet se zgjidhjet e brendshme kushtetuese e ligjore nuk mund të shërbejnë si bazë juridike për moszbatim të detyrimeve të marra nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura në mënyrë të duhur.

kanë pranuar mundësinë praktike të kontrollit kushtetues së marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, por vetëm nëse organi përfaqësues ka vepruar *ultra vires*, qoftë me rastin e ratifikimit të brendshëm ose gjatë implementimit të marrëveshjes ndërkombëtare akoma të paratifikuar. Quhet se ekziston veprimi *ultra vires* i organit kushtetues, sipas verdiktit të Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, në rastet kur një marrëveshje e lidhur ndërkombëtare prek në dispozitat kryesore kushtetuese të neneve 1 dhe 20 lidhur me nenin 79 të Ligjit Bazik të Gjermanisë. Këto nene përbëjnë identitetin kushtetues gjerman.[493]

Nëse marrëveshja ndërkombëtare futet në sistemin e brendshëm juridik nëpërmjet një ligji për ratifikim të brendshëm, por dispozitat e saj nuk kanë natyrë vetekzekutuese, atëherë kjo do të thotë se ajo marrëveshje e ratifikuar nuk mund të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë sepse nuk krijon të drejta e detyrime për palët private dhe për palët e tjera. Një situatë e tillë kërkon nxjerrjen e një norme shtesë implementuese të marrëveshjes së ratifikuar me ligj. Kjo normë implementuese zakonisht ka karakter juridiko-kushtetues të një norme të brendshme (ligj, dekret, urdhër qeverie etj.). Në rastet kur kjo normë implementuese nuk ka natyrë juridike të brendshme, atëherë norma e dytë ndërkombëtare që implementon një detyrim ndërkombëtar origjinal ka natyrë juridike të normës suksesive në kuptim të nenit 30 [Zbatimi i Marrëveshjeve Sukcesive Lidhur me të Njëjtën Çështje] të KVDT-së, nen i cili në tërësi reflekton dhe sanksionon të drejtën ndërkombëtare zakonore. Si e tillë, kjo normë implementuese e natyrës suksesive në asnjë rast nuk mund të sabotojë objektin dhe qëllimin e detyrimit të parë të përmbajtur në marrëveshjen e parë të ratifikuar nga organi përfaqësues me pëlqim të organit ekzekutiv. Në këso rastesh, norma e dytë ndërkombëtare shërben si normë implementuese e normës së parë, e normës bazë, e cila përmbahet në marrëveshjen e lidhur ndërkombëtare që i është nënshtruar ratifikimit të brendshëm të organit përfaqësues, gjithnjë me pëlqimin e organit ekzekutiv. Në një raport të Komisionit të Venecias, duke iu referuar Maqedonisë, marrëveshjet ndërko-

[493] Në rastin gjerman bëhet fjalë për kontrollin kushtetues të cilin e bën Gjykata Federale e Gjermanisë kundrejt akteve *ultra vires* të organeve kushtetuese me qëllim të mbrojtjes së *identitetit kushtetues* të Gjermanisë karshi Bashkimit Evropian. Cf. Daniel Thym, "From Ultra Vires Control to Constitutional-Identity-Review: The Lisbon Judgement and German Constitutional Court", në Jose Maria Beneyto / Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos: Baden-Baden, 2011) fq. 45-62; Mattias Wendel, "Lisbon Before the Courts: Comparative Perspectives", në Beneyto/Pernice (eds.), vep. cit., fq. 65-106.

mbëtare që nuk ratifikohen nga parlamenti nuk do mend se janë pjesë përbërëse e rendit të brendshëm juridik dhe gjejnë zbatim të njëjtë si dhe ato të ratifikuarat, në vartësi të natyrës së normave që prodhojnë (të vetekzekutueshme ose jo). Me një fjalë, këto marrëveshje shpjegohen përmes teorisë moniste mbi marrëdhënien mes së drejtës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare, njëjtë si kur flitet për marrëveshjet e ratifikuara nga parlamenti.[494] Kjo për faktin se marrëveshjet e lidhura, të cilat përmbajnë norma të tilla, zakonisht administrojnë normat e marrëveshjes së ratifikuar me qëllim të saktësimit dhe të implementimit të tyre. Normat e përmbajtura në marrëveshjet administrative lindin si pasojë e ekzistimit të dy rrethanave: *e para*, dispozitat e normës së marrëveshjes së ratifikuar zakonisht nuk janë mjaftë precize dhe nuk i përcaktojnë qartë dhe si duhet të drejtat dhe detyrimet e palëve; dhe, *e dyta*, si pasojë e kësaj pasaktësie dhe paqartësie lind edhe nevoja për hapa shtesë për vënien në jetë të normave të ratifikuara nga parlamenti (gjithnjë me prezumimin se ekziston edhe pëlqimi i ekzekutivit).

Të një natyre të tillë janë edhe marrëveshjet e lidhura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në vijim të implementimit të Marrëveshjes së Parë. Marrëveshja e Dytë është më e rëndësishmja ndër to, për shkak të vetë përmbajtjes së saj si dhe për faktin se tanimë ekziston një prononcim i Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë përmbajtje. Ky prononcim, i cili më shumë ka shkaktuar huti se që ka sqaruar, e aq më pak të ketë zgjidhur, vendin dhe pozitën e marrëveshjeve ndërkombëtare të paratifikuara nga Kuvendi (me pëlqimin e Ekzekutivit) në sistemin juridik-kushtetues kosovar. Ky rast ka qenë një rast ideal për Gjykatën që të sqarojë përfundimisht natyrën e dispozitave të paragrafit 2, të nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, dispozita që, siç thamë më herët, aspak nuk dallojnë për nga mesazhi që bartin dispozitat e ngjashme të kushtetutave të vendeve të Evropës, si të atyre të vendeve ish-komuniste ashtu dhe të demokracive tradicionale evropiane. Në të gjitha rastet e tjera, marrëveshjet që nuk i nënshtrohen ratifikimit të brendshëm, cilësohen si marrëveshje administrative sepse administrojnë për qëllime të implementimit një normë tjetër ndërkombëtare që gjendet në një marrëveshje ndërkombëtare e cila është lidhur dhe është ratifikuar nga organi përfaqësues me pëlqim të ekzekutivit. Marrëveshja ndërkombëtare, kur ka

[494] Cf. Mr. Igor Spirovski, *The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws With International Treaties: New Trends in Constitutional Justice*, CDL-JU (2009) 036 (Vennice Commission, Strasbourg, 17 November 2009).

formën e shkruar, mund të gjendet në një instrument ratifikimi ose në disa sosh.

4. Kontrolli kushtetues i marrëveshjeve të paratifikuara ndërkombëtare

Siç mund të vërehet nga diskutimi i mësipërm, nuk ka në Kushtetutën e Kosovës qoftë dhe një dispozitë që flet për mundësinë e lejimit të kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare, pa marrë parasysh nëse janë ratifikuar ose jo nga Kuvendi, nga shefi i shtetit të Kosovës, apo nga vetë Qeveria. Në fakt, mundësinë e ratifikimit të llojeve të caktuara të marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e shefit të shtetit e lejon shprehimisht paragrafi 2 i nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. I njëjti nen, por edhe tërë Kushtetuta, ngelen të heshtur sa i përket ratifikimit të llojeve të caktuara të marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e Qeverisë. Kjo nënkupton se çdo ratifikim që kryhet nga Qeveria duhet të bëhet me autorizim të shefit të shtetit, me kusht që fjala nuk është për marrëveshjet nga neni 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës. Nga aspekti ndërkombëtar, ndërkaq, vlen të theksohet e të sqarohet se, edhe pa këtë autorizim të shefit të shtetit, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara ndërkombëtarisht nga Qeveria janë tërësisht valide dhe paqartësitë kushtetuese nga neni 18.2 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] i Kushtetutës nuk mund të shpërbejnë si bazë për mohimin e detyrimeve të marra ndërkombëtare. Atëherë, si ndodhi që Marrëveshja e Dytë u bë objekt kontrolli kushtetues në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës? Përgjigja në këtë pyetje gjendet në historikun e zgjerimit të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, që ka ndodhur me rastin e njohur si "Rasti Qeska", Aktgjykimi KO 80/10, i 7 tetorit 2010, kur Gjykata krejtësisht në mënyrë të gabuar interpretoi dispozitat e neneve 84.9 [Kompetencat e Presidentit][495] dhe 93.10 [Kompetencat e Qeverisë][496] të Kushtetutës, sikur gjoja ato lejojnë "ngritje të çështjeve kushtetuese" pa asnjë kufizim nga ana e Presidentit dhe Qeverisë.[497]

---

[495] Presidenti i Republikës së Kosovës: "(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese".

[496] Qeveria ka këto kompetenca: "(10) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese".

[497] Përveç rastit të parë, "Rastit Qeska", raste të tjera që deri më sot janë vendosur nga Gjykata mbi të njëjtin arsyetim dhe logjikë janë si vijon: *Aktgjykimi i 7 tetorit 2010 në rastin nr. KO 80/10* (Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Tij, dr. Fatmir Sej-

Ky ka qenë dhe ngel gabim, sepse dispozitat e sipërcekura të këtyre dy neneve kushtetuese flasin për "ngritjen e çështjeve kushtetuese" nga ana e këtyre dy organeve kushtetuese vetëm në kuadër të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese të përcaktuar qartë me nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Kosovës. Se një gjë e tillë ka qenë qëllim i hartuesve të Kushtetutës, qartë dëshmohet nga redaktimi i dispozitës tërësisht të ngjashme të nenit 135.4 [Raportimi i Avokatit të Popullit] të Kushtetutës.[498]

---

diu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska); *Aktgjykimi i 22 dhjetorit 2010 në rastin nr. KO 97/10* (Kërkesa e parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës); *Aktgjykimi i 20 shtatorit 2011 në rastin nr. KO 98/11* (Parashtrues: Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës); *Aktgjykimi i 20 shtatorit 2012 në rastin nr. KO 57/12* (Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/1-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës); *Aktvendimi i 11 shkurtit 2014 në rastin nr. KO 18/14* (Parashtrues: Vesna Mikić dhe 20 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kërkesë për "*interpretim të dispozitave të Kushtetutës* së *Kosovës lidhur* me *vendet* e *rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë*"); *Aktgjykimi i 1 korrikut 2014 në rastin nr. KO 103/14* (Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës, përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84 (14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës); *Aktgjykimi i 23 dhjetorit 2015 në rastin nr. KO 130/15* (Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar *"Asociacioni/Bashkësia i komunave* me *shumicë serbe në Kosovë — Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore"* me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

[498] Avokati Popullit: "(4) [...] ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute".

Pozicionet si në këtë punim, autori i këtyre rreshtave i ka mbrojtur që në dhjetor të vitit 2013 në librin koautorial ku komentohet për herë të parë Kushtetuta e Republikës së Kosovës, dorëshkrimi i të cilit në fakt qe dorëzuar për botim gjashtë muaj më herët. Cf. Enver Hasani — Ivan Čukalović, *Kushtetuta e Kosovës: Komentar* (GIZ, në emër të Ministrisë Gjermane Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik: Prishtinë, 2013) fq. 400-401, lidhur me fq. 665. Këtë e theksoj këtu për të dëshmuar se me kohë e kam pasur shumë të qartë se ky lloj aktivizmi gjyqësor, me kalimin e kohës, mund të bëhej barrë e padurueshme për gjyqësinë kushtetuese kosovare. Çdo ditë e më shumë do të shihet se kisha të drejtë ngaqë gjyqësia kushtetuese kosovare nuk ka as kapacitet profesional dhe intelektual, e as vullnet dhe sinqeritet kolegjial, për t'u ballafaquar me një juridiksion të tillë metafizik për çështje të papërcaktuara që nuk kanë asnjë funksion pos akomodimin dhe shpëtimin e lëkurës së politikanëve obskurantist të shtetit të Kosovës, shtet që akoma është në ndërtim e sipër.

Mënyra ekstensive e interpretimit të dispozitave mbi kompetencat e Presidentit dhe të Qeverisë, të cilin e ka bërë Gjykata, në esencë ka rezultuar në atë që kompetencat e këtyre dy organeve kushtetuese të jenë përcaktuese të vetë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Ky ngatërrim konceptual i juridiksionit me kompetencën,[499] më shumë se kaq, bëri që cila palë e autorizuar të jetë përcaktues i lejueshmërisë së ngritjes së çdo çështjeje kushtetuese në rastet kur ajo ngrihet *in concreto* nga Presidenti apo nga Qeveria e Kosovës. Këto dy organe kushtetuese kanë të drejtë që të jenë palë të autorizuara vetëm në çështjet e parashikuara nga neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës, si palë të privilegjuara që nuk kanë nevojë të provojnë ekzistimin e një interesi juridik për ngritjen e çështjeve në Gjykatën Kushtetuese. Ajo çfarë ka ndodhur është se këto dy organe kushtetuese mund të kërkojnë nxjerrjen e vendimeve interpretative dhe këshilluese për punën që bëjnë pa asnjë kufizim material nga neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës. Kjo nënkupton se është puna e tyre që bëjnë, jo ndonjë akt juridik më i ulët se Kushtetuta, që analizohet nëse bie ose nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën. Puna e bërë si pikë referimi mund të jetë edhe si punë në kuptimin hipotetik, pra punë që mund të bëhet nëse Gjykata nuk e cilëson më parë vetë si punë jokushtetuese, pa ndihmën e askujt dhe krejt në mënyrë arbitrare. Autorizimi për të nxjerrë vendime interpretative dhe këshillëdhënëse jashtë autorizimit shprehimor të tekstit material të Kushtetutës, është i njohur në praktikën e disa vendeve në Evropë, si: Bullgaria, Italia etj. Mirëpo, me kalimin e kohës, gradualisht, shtetet e tilla i kanë përcaktuar rregullat shtesë me qëllim të konstitucionalizimit të këtij aktiviteti ekstensiv të gjykatave të tyre kushtetuese.

---

[499] Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se gjetiu, në praktikën komparative të gjyqësisë kushtetuese, nuk ka pasur zgjerim të juridiksionit fillestar (origjinal) të gjykatave kushtetuese jashtë përcaktimeve të teksteve të kushtetutave nacionale. Përkundrazi, një gjë e tillë, e njohur si aktivizëm gjyqësor, ka ekzistuar dhe ekziston në të gjitha kontinentet e botës ku ka gjyqësi kushtetuese dhe ky zgjerim juridiksioni në disa raste ka marrë përmasa enorme shqetësuese ku gjykatat kanë luajtur rolin e gjykatave të faktit dhe arbitrit në çështjet nga më të thjeshta deri te ato që kanë pasur një natyrë të theksuar të pastër politike. Shih më shumë për këtë në studimin e jashtëzakonshëm ku jepet pasqyra komparative të kësaj çështje, Allan R. Brewer-Carias, *Constitutional Courts as Positive Legislators, A Comparative Law Study* (Cambridge UP, Cambridge, 2011). Në kapitullin 5 ["Gjykatat kushtetuese si ligjvënës në çështjet e kontrollit kushtetues] autori flet gjerësisht për praktikën komparative të gjyqësisë kushtetuese nga e cila praktikë shumë qartë shihet se gjykatat kanë krijuar juridiksion material plotësues për kontroll kushtetues në rastet që fare nuk kanë qenë të përcaktuara me juridiksionin e tyre origjinal. E njëjta gjë vlen edhe për zgjerimin e juridiksionit të tyre për sa i përket aspekteve procedurale të kontrollit kushtetues.

Duke përfituar nga kjo gjendje kushtetuese e krijuar nga vetë Gjykata Kushtetuese, Marrëveshja e Dytë përfundoi në Gjykatën Kushtetuese si "çështje kushtetuese", e ngritur nga presidentja e Republikës, znj. Atifete Jahjaga. Presidentja Jahjaga ka folur në kërkesën e saj në mënyrë krejt hipotetike për Marrëveshjen e Dytë, duke e cilësuar atë si diçka që akoma nuk është pjesë e sistemit juridik kosovar, meqë asnjëherë nuk është publikuar në Gazetë Zyrtare e as që ka filluar zbatimi i saj. Kjo, megjithatë, nuk e ka penguar Gjykatën Kushtetuese që të merret me dispozitat krejt konkrete të Marrëveshjes së Dytë, duke e konsideruar të njëjtën si një dokument ekzistues operativ brenda sistemit juridik-kushtetues kosovar. I tërë teksti i këtij aktgjykimit flet me terma këshillues, hipotetikë për të ardhmen, duke i dhënë udhëzime konfuze Qeverisë për mënyrën e implementimit të Marrëveshjes së Dytë, si dhe për formën që duhet të ketë akti juridik që duhet të implementojë jo Marrëveshjen e Dytë, e cila efektivisht ishte objekt i kontrollit kushtetues, por Marrëveshjen e Parë që asnjëherë nuk ka mundur të jetë objekt i kontrollit kushtetues për arsye të pengesave kushtetuese për një gjë të tillë (mungesa e juridiksionit *ratione materiae*), siç është konstatuar nga vetë Gjykata me aktgjykimin për Marrëveshjen e Parë.[500] Me këtë veprim, Gjykata ka përdorur Marrëveshjen e Parë si një trampolinë për të folur për Marrëveshjen e Parë, duke i cilësuar detyrimet që dalin nga ajo, pra formimi i Asociacionit të Komunave Serbe, si detyrime ndërkombëtare që duhet vënë në jetë.[501] Se formimi i asociacionit përbën një detyrim ndërkombëtar të Kosovës nuk mund të vihet në pyetje, sepse vetë akti i ratifikimit parlamentar të Marrëveshjes së Parë ka konfirmuar një gjë të tillë. Pikërisht, argumenti i moslejueshmërisë së kontrollit represiv të marrëveshjeve ndërkombëtare në praktikën komparative kushtetuese, bazohet në aktin e ratifikimit të brendshëm parlamentar që zakonisht kërkon një shumicë të kualifikuar, krahas pëlqimit të ekzekutivit. Vetë akti i ratifikimit parlamentar shërben si zëvendësim i kontrollit kushtetues dhe si argument kundër çdo kontrolli kushtetues represiv, pra pas votimit me shumicë të kualifikuar nga ana a Parlamentit të një marrëveshjeje ndërkombëtare, gjithnjë duke supozuar se ekziston në mënyrë simultane edhe pëlqimi i ekzekutivit.

Konstatimi në pjesën operative II, nga ana e Gjykatës, se duhet të formohet Asociacioni i Komunave Serbe, i cili del si konkluzion i pjesës arsyetuese të aktgjykimit në të cilin asnjë precedent komparativ nuk citohet në favor të

[500] Cf. Pikën III të pjesës operative të Aktgjykimit KO 95/13, të 9 shtatorit 2013.
[501] Cf. Pikën II të pjesës operative të Aktgjykimit KO 130/15, të 23 dhjetorit 2015.

këtij konkluzioni,[502] nuk thotë asgjë tjetër veçse deklaron një detyrim ekzistues ndërkombëtar të Kosovës, i marrë nëpërmjet ratifikimit parlamentar të një marrëveshjeje ndërkombëtare konform nenit 18.1 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, duke e marrë kështu rolin e një organi të vlerësimit ndërkombëtar të "kushtetutshmërisë ndërkombëtare", të detyrimeve të marra ndërkombëtarisht nga ana e shtetit të Kosovës. Përveç kësaj, një kontroll represiv kushtetues nuk do të ishte në interes të shtetit sepse do ta dëmtonte seriozisht kapacitetin kontraktues të tij në planin ndërkombëtar,

---

[502] Në fakt, i vetmi referim në burim komparativ gjendet në paragrafin 146 të Aktgjykimit KO 130/15, i cili fare nuk ka të bëjë me arsyetimin e pjesës që mëton ta arsyetojë, aq më pak me pjesën e tij operative. Kjo nuk do të thotë se referimet komparative janë *a priori* të shëndetshme, sepse jo rrallë ato mund të përdoren për të konfirmuar një rrugë të drejtë që e kanë marrë vendet e tjera. Por, anasjelltas, përdorimi i doktrinës dhe i precedentit të huaj mund të përdoret për të vazhduar me ndjekjen e një rruge të gabuar dhe për të mohuar detyrimet kushtetuese të vendit të caktuar, me përdorimin e mekanizmave të brendshëm kushtetues. Rasti i një aktgjykimi, të cilin e nxori Gjykata Kushtetuese e Federatës Ruse më 14 korrik 2015 është një shembull tipik i kësaj. Me këtë aktgjykim, Gjykata e ka bërë të qartë se, në Rusi, ani se ka një pranim formal të monizmit sa i përket vendit e rolit të marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin juridiko-kushtetues rus, megjithatë në praktikë kjo nuk është kështu. Duke përdorur praktikën gjermane, austriake e italiane, Gjykata ka mohuar detyrimet ndërkombëtare të Rusisë për sa i përket zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj). Cf. Gjykata Kushtetuese Ruse, Aktgjykim nr. 21-P/2015, 14 korrik 2015. *Judgment No. 21-P/2015 of 14 July 2015 of the Constitutional Cout of the Russian Federation. Venice Commission, CDL-REF (2016) 019, Opinion No. 832/2015 (Strasbourg, 23 February 2016).*

Kjo qasje ruse ka zhgënjyer jo vetëm anëtarët e plenares së 106 të Komisionit të Venecias, përfshirë autorin e këtyre rreshtave si përfaqësues i Kosovës aty, e mbajtur më 11-12 mars 2016 në Venedik, por edhe autorët rus që kishin shkruar më herët me aq zell e krenari për largimin rus nga izolimi ndërkombëtar dhe përqafimin e teorisë moniste në Kushtetutën e vitit 1993 në këtë vend, fill pas mbarimit të Luftës së Ftohtë. Cf. Gennady M. Danilenko, "The New Russian Constitution and International Law", *American Journal of International Law* vol. 88, no. 3 (July 1994) fq. 451-470.

Rusia edhe mund ta ketë një luks të tillë dhe të mohojë detyrimet e marra ndërkombëtare. Por, vendet e vogla si Kosova duhet të jenë më balancuese kur gjykojnë detyrimet ndërkombëtare që kanë marrë kundruall respektimit të dispozitave të kushtetutave të tyre. Asnjëherë nuk duhet të vihet në pyetje respektimi i kushtetutës nacionale nga të gjithë. Ajo që duhet të vihet në pyetje është fakti se me rastin e gjykimit duhet të kryhet një balancim ndërmjet detyrimeve ndërkombëtare të marra dhe kushtetutës së vendit. Shih më shumë, për rolin pozitiv dhe negativ të doktrinës dhe të precedentit komparativ në të drejtën kushtetuese, librin elokuent të Vicki C. Jackson, *Constitutional Engagement in a Transnational Era* (Oxford UP: Oxford, 2010). Në kapitullin 1 ["Rezistimi i Transnacionales"], autorja flet gjerësisht për modalitetet e rezistimit të përdorimit të burimeve të jashtme, doktrinare e nga praktika gjyqësore, si dhe për arsyet e ndryshme të këtij rezistimi. Nganjëherë, ky rezistim është fisnik dhe i dobishëm, siç është rasti me shtetet e reja në krijim e sipër, por në disa mund të jetë vetizolues dhe vetëshkatërrues për shoqërinë që ndjek një rrugë të tillë.

sic e ka konstatuar vetë Hans Kelsen në vitin e largët 1929.[503] Ka qenë pikërisht ky rol që nuk duhet ta ketë asnjëherë asnjë gjykatë kushtetuese. Ngjashëm me Hans Kelsenin ka thënë edhe vetë Gjykata Kushtetuese e Kosovës, duke u bazuar në praktikën komparative kushtetuese, në Aktgjykimin KO 95/13, të 9 shtatorit 2013.[504] Mënyra e qasjes në Aktgjykimin KO 130/15, pa asnjë dyshim që paraqet marrje të një roli këshillëdhënës dhe interpretativ nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë rast, njësoj si në Aktgjykimin KO 95/13, Gjykata është dashur ta luajë rolin e arbitrit të qartë në zgjidhjen e çdo çështjeje kontestuese kushtetuese që parashtrohet për zgjidhje nga palët e autorizuara dhe sipas procedurave të përcaktuara me nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

Kjo nuk do të thotë se nuk mund të ketë kontroll kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura sipas nenit 18.2 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Përkundrazi. Mendojmë se një gjë e tillë duhet të ndodhë pikërisht për faktin se mungon ratifikimi parlamentar i këtyre llojeve të marrëveshjeve, ashtu që ka rrezik real çdoherë që Presidenti dhe Qeveria të veprojnë *ultra vires*, me ose pa dashje, në vijim të zbatimit të kompetencave të tyre kushtetuese. Ngjashëm më këtë arsyetim ka vepruar edhe Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë në rastin e diskutuar më herët, *Lisbon Treaty*,[505] kur ka theksuar se mund të jetë kompetente për të bërë kontrollin kushtetues të detyrimeve të marra ndërkombëtare në rastet kur organet kushtetuese jopërfaqësuese (ekzekutivi) tejkalojnë kompetencat e tyre dhe veprojnë *ultra vires* duke prekur dispozitat kushtetuese gjermane që cilësohen si përbërëse të identitetit kushtetues gjerman. Këtë është dashur ta bëjë edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës, duke i cilësuar si jokushtetuese dispozitat konkrete të Marrëveshjes së Dytë dhe, për pasojë, duke i nxjerrë të njëjtat dispozita jashtë rendit juridik-kushtetues kosovar. Në të njëjtën kohë, Gjykata është dashur t'u tregojë organeve kushtetuese që janë në ngarkesë me punët e jashtme se çdo herë kur hyjnë në detyrime ndërkombëtare duhet t'i kenë parasysh kufizimet kushtetuese dhe që në të njëjtën kohë kufizimet e tilla du-

[503] Cituar sipas Olivera Vučić, *Austrijsko ustavno sudstvo: čuvar federacije i ustava*, fq. 201, fusnota 269.

[504] Cf. Paragrafët 95-101 e Aktgjykimit KO 130/15.

[505] Shih gjithashtu: Leonard F.M. Besselink, "National and constitutional identity before and after Lisbon", *Utrecht Law Review* vol. 6, issue 3 (November 2010) fq. 36-49.

het t'ua bëjnë me dije edhe partnerëve ndërkombëtarë me rastin e negocimeve dhe me rastin e marrjes së çdo detyrimi ndërkombëtar.[506]

Kjo është dashur të thuhet nga Gjykata, pra t'u tregohet organeve kushtetuese se cilat janë kufizimet kushtetuese me rastin e negocimit dhe të lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare të të gjitha llojeve, jo vetëm të atyre nga paragrafi 2 i nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Nuk ka relevancë dhe nuk ndihmon organet kushtetuese të Kosovës nëse atyre u tregohet *post festum* se kanë cenuar dispozitat e caktuara të Kushtetutës së Kosovës me rastin e veprimit të tyre si aktorë të marrëdhënieve ndërkombëtare. Ajo që ndihmon shumë është qartësimi i secilit kufizim kushtetues, sa më shumë që të jetë e mundur, në mënyrë që kur të ndodhë përsëritja e situatave të ngjashme vendimet nga e kaluara të shërbejnë si një udhërrëfyes për mospërsëritjen e gabimeve të njëjta. Këtë mision e kanë gjykatat kushtetuese, si dhe gjykatat supreme në rastet kur ushtrojnë edhe juridiksion kushtetues. Ndryshe do të duhej çdo ditë të shkruhej nga një kushtetutë, me sa më shumë detaje, në mënyrë që të parashihen e të sanksionohen gjërat e përditshme. Kjo do të thotë rritje enorme e vëllimin fizik të tekstit kushtetues, deri në përmasat e vëllimit në të cilin është shkruar *Epi i Gilgameshit* me mijëra vjet para erës sonë. Në një rast të tillë, teksti kushtetues ditor, përveç që do të ishte i gjatë dhe i pakuptimtë, ai as nuk do të kishte përmbajtje kushtetuese por vetëm epike, njësoj si *Epi i Gilgameshit*.

Përfundim

Kontrolli kushtetues i Marrëveshjes së Dytë ngre një sërë çështjesh të rëndësishme të së drejtës kushtetuese kosovare, siç janë: vendi dhe roli i marrëveshjeve ndërkombëtare të paratifikuara nga Parlamenti në sistemin kushtetues kosovar, statusi i detyrimeve të marra ndërkombëtare nga ana e autoriteteve publike të Kosovës, të cilat akoma nuk janë shpallur në Gazetën Zyrtare, caqet e kontrollit kushtetues të marrëveshjeve ndërkombëtare në përgjithësi, pra edhe atyre të ratifikuara, sepse juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese sot për sot është pa kufi në rast se Presidenti apo Qeveria e Kosovës vendosin të ngrenë një çështje kushtetuese, e kështu me radhë.

Gjykata Kushtetuese ka pasur një rast ideal për të sqaruar dhe për të precizuar juridiksionin e saj kur bëhet fjalë për ngritjen e "çështjeve kushtetuese"

[506] Këtë e ka bërë në mënyrë të shkëlqyeshme Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në *Vendimin nr. 15/2009*, të 15 prillit 2010, që diskutohet në pjesën 3 të këtij punimi.

nga Presidenti dhe nga Qeveria, por edhe për të vënë bazat e një kontrolli kushtetues të balancuar, kur bëhet fjalë për detyrimet e marra ndërkombëtare në mënyrë valide nga ana e organeve kushtetuese kosovare. Lëshimi i këtij rasti vështirë se mund të rikuperohet në të ardhmen kur Statuti i Asociacionit të komunave të vijë për kontroll kushtetues në Gjykatën Kushtetuese, sërish mbi bazën e ngritjes si çështje kushtetuese nga ana e Qeverisë, pra jo siç është paramenduar me Marrëveshjen e Dytë.[507]

Mosmarrja me këto çështje nga ana e Gjykatës Kushtetuese shpjegohet me panikun nën të cilin është marrë vendimi i saj, i krijuar nga situata aktuale jashtëzakonisht e rëndë dhe e tensionuar, ku konflikti social ka rrezik të marrë dimension politik total në të gjitha aspektet e mundshme të tij. Kjo, megjithatë, nuk amniston askënd që të lëshojë pe ndaj vijave të kuqe të profesionit, të cilat asnjëherë nuk duhet të kalohen kur kemi të bëjmë me mbrojtjen e tekstit kushtetues dhe të vlerave të tij. Kjo sepse gjendja aktuale në Kosovë sigurisht se do të kalohet pas një palë zgjedhjesh dhe rolet mund të ndryshojnë, ashtu që ata që sot janë kundër interpretimit të Gjykatës në rastin e Marrëveshjes së Parë dhe që përkrahin në mënyrë naive Marrëveshjen e Dytë, për qëllime krejt politike, në të ardhmen do t'i ndërrojnë rolet me këta që sot kanë mendim të kundërt. Por, teksti i Kushtetutës dhe vlerat që ngërthen ai, janë të përjetshme dhe sublime dhe si të tilla edhe duhet mbrojtur e promovuar sipas standardeve krejtësisht profesionale, pa marrë parasysh çmimin që paguhet nga ndonjëri prej nesh. Fundja, konstitucionalizmi modern, siç e njohim sot dhe të cilit i takojmë si shoqëri, nuk ka kaluar pa dhunë, pa vuajtje, pa konflikt dhe pa akte primitive, të cilat, të gjitha së bashku, kanë synuar të pengojnë arritjen e njeriut në një stad me cilësor të lirisë njerëzore.

[507] Në paragrafin 21 ["Dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare"] të Marrëveshjes së Dytë, thuhet: "Statuti i Asociacionit/Bashkësisë do të hartohet nga Ekipi Menaxhues dhe do të paraqitet në Dialogun e Nivelit të Lartë brenda 4 muajsh nga dita e arritjes së marrëveshjes së këtyre parimeve elementeve, me lehtësim sipas nevojës, duke përfshirë atë të Ministrisë së Qeverisjes Lokale. Statuti do të vërtetohet me dekret pas marrëveshjes në Dialog. Cilido amendament që do të prezantohet nga Asociacioni/Bashkësia do të vërtetohet me dekret dhe do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese."

Kapitulli V

TË GJITHA GJYKATAT E HAGËS, "MURI I JASHTËM I SANKSIONEVE" DHE FILLIMI I ZBATIMIT TË LIGJEVE TË LUFTËS NË KOSOVË

Sfondi historik: Shkrimi i seksionit të parë të këtij kapitulli, "Të gjitha gjykatat e Hagës", ka trajtuar për herë të parë çështjen e Gjykatës së Hagës për ish-Jugosllavinë dhe vendin e saj në sistemin e drejtësisë ndërkombëtare në përgjithësi, dallimet dhe të përbashkëtat e saj me gjykatat e tjera ndërkombëtare, qofshin ato penale apo të juridiksionit të përgjithshëm në të drejtën ndërkombëtare. Për herë të parë u botua në një gazetë javore kosovare që dilte në Tiranë, kurse më pastaj në një revistë akademike, po ashtu në Tiranë[508]. Së pari u botua për publikun e gjerë dhe laik, sepse donim të testonim lexuesin e gjerë lidhur me interesimin e tij për këtë çështje dhe ta sfidonim gjerësisht kureshtjen e tij, në një kohë të pakohë të dhunës serbe ndaj Kosovës dhe letargjisë së përgjithshme në të cilën gjendej qytetari i Kosovës së robëruar[509].

Kontekstin e shkrimit "Muri i jashtëm i sanksioneve", të botuar në *Perceptions*[510], i cili këtu riprodhohet në seksionin e dytë në vijim, lexuesi shqip mund ta kuptojë vetëm nëse ka parasysh situatën shpirtërore dhe politike në Kosovë dhe ndër shqiptarët në Ballkan pas arritjes së Marrëveshjes së Dejtonit në nëntor 1995. Kjo marrëveshje mbi paqen kishte arritur të ndalte luftën dhe gjenocidin në Bosnjë-Hercegovinë, të cilin po e kryenin serbët lokalë, të ndihmuar nga Republika e Serbisë nën drejtimin e diktatorit serb Sllobodan Millosheviq.

Shqiptarët e Kosovës nën udhëheqjen e liderit karizmatik dhe të butë, dr. Ibrahim Rugova, kishin arritur që për vite të tëra të ndërkombëtarizonin kauzën e tyre, duke fituar simpatitë e të dy anëve të Atlantikut. Megjithatë, rruga paqësore e ndjekur nga shqiptarët sikur i mbërriti kufijtë e saj me arritjen e Marrëveshjes së Dejtonit. Kjo sepse menjëherë u krijua bindja ndër shqiptarët se vetëm dhuna po shpërblehej dhe se vetëm ndërrimi i kursit do ta det-

---

[508] Enver Hasani, "Të gjitha gjykatat e Hagës", *Jurisprudenca Shqiptare* nr. 2/96 (Tiranë).
[509] Enver Hasani, "Të gjitha gjykatat e Hagës", *Rilindja Javore* (korrik-gusht 1995).
[510] Enver Hasani, "The 'Outer Wall' of Sanctions and the Kosovo Issue", *Perceptions: Journal of International Affairs* vol. III, no. 3 (September-November 1998).

yronte perëndimin, ShBA-në dhe Evropën, që të ndërmerrnin masa represive ndaj regjimit në Beograd i cili po terrorizonte popullsinë shumicë në Kosovë pa asnjë ndëshkim serioz nga jashtë. Kjo gjendje shpirtërore dhe politike pas Marrëveshjes së Dejtonit për një kohë shumë të shkurtër mori dhenë, ani se konceptualisht ishte gabim i madh krahasimi i Bosnjë-Hercegovinës dhe Marrëveshjes së Dejtonit me rastin e Kosovës. Marrëveshja e Bosnjë-Hercegovinës kishte shërbyer si një dokument për ruajtjen e shtetit të Bosnjë-Hercegovinës nga shpërbërja dhe ndaljen e gjenocidit serb kundër popullsisë myslimane atje. Në termat praktikë, simpatitë për Dejtonin nënkuptonin arritjen e një marrëveshje të ngjashme për Kosovën, ku Serbia do ta ruante sovranitetin ndaj Kosovës, në mënyrë të njëjtë siç e kishte bërë Dejtoni kundrejt shtetit të Bosnjë-Hercegovinës. Kjo në fakt edhe ndodhi në Rambuje (shkurt-mars 1999), kur u arrit një marrëveshje e paqes, por atë nuk e pranoi regjimi serb në Beograd. Kjo pati për pasojë ndërhyrjen e trupave të NATO-s në Kosovë, pas një dëmtimi të rëndë të forcave serbe në terren dhe detyrimin e tyre për tërheqje nga Kosova.

Kështjella e Rambujesë — nga ku kishte shkuar në ekzekutim Marie Antoinette e ku u arrit Marrëveshja për Paqen në Kosovë me ndërmjetësimin e Grupit të Kontaktit (ShBA, Rusia, Franca, Italia dhe Gjermania) — në aspektin juridik nuk ishte e favorshme për Kosovën, sepse bënte një paralele mes Kosovës dhe Republika Srspkas në Bosnjë-Hercegovinë. Pakkush në Kosovë dhe ndër shqiptarët në Ballkanin e kishte pasur të qartë se insistimi për një "Dejton për Kosovën", siç thuhej atëherë, do të nënkuptonte në praktikë një sovranizim të ri serb ndaj Kosovës, por tani me bekimin e bashkësisë ndërkombëtare. Se kjo ka qenë kështu shpjegohet shumë qartë në shkrimin e seksionit të dytë, ku diskutohet origjina e konceptit "muri i jashtëm i sanksioneve", i cili në thelb i ofronte shtetit serb sovranitet mbi Kosovën me kusht që ai të sillej siç ishin sjellë ish-republikat jugosllave në momentin e pavarësimit të tyre. Në këtë shkrim jepen deklaratat e qarta të establishmentit të ShBA-së dhe vendeve të tjera perëndimore, të cilat nuk hezitonin ta qetësonin atë që deri atëherë qe cilësuar si "kasapi i Ballkanit", diktatorin serb Sllobodan Millosheviq. Për një natë, pas arritjes së Marrëveshjes së Dejtonit, Millosheviqi u shpall "hero i paqes[sic!]". Këtë politikë të "marrjes me të mirë" të liderit serb e kishte përjetuar autori i këtyre rreshtave gjatë punës si diplomat i shtetit shqiptar, kur priste që edhe më 1996 Komisioni i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, siç kishte ndodhur viteve të tjera gjatë sesioneve vjetore të këtij organi, të nxirrte një rezolutë të veçantë për gjendjen e mjerueshme të të drejtave të njeriut në Kosovë. Diplomatët perëndimorë, të cilët deri atëherë kishin

sponsorizuar vetë rezoluta të tilla për Kosovën, këtë herë në sesionin e Gjenevës të Komisionit, në pranverë të vitit 1996, insistuan që "mos të shqetësohet Sllobodan Millosheviqi meqë tani ai ishte arkitekti i paqes në Ballkan [sic]". Tepër dekurajuese dhe rrënuese moralisht tingëlloi kjo deklaratë e një diplomati mik dhënë autorit të këtyre rreshtave në margjinat e sesionit vjetor të Komisionit në pranverë të vitit 1996.

Një politikë e tillë e qetësimit të liderit serb Millosheviq nuk do mend se vetëm e ka trimëruar për të vazhduar me gjenocid dhe dhunë ndaj shqiptarëve të Kosovës, deri në shpalljen e hapur të synimit të tij për dëbim masiv të krejt atyre që nuk ishin serbë. Ajo që u cilësua si "muri i jashtëm i sanksioneve" nuk prodhoi asnjë efekt pozitiv në terren. Serbët e morën atë si një vizë për dhunë dhe pastrim etnik të Kosovës, si një pjesë e Serbisë. Këtë bindje ndaj Kosovës, dhe këtë politikë morbide, e përkrahnin edhe opozitarët serbë, me një përjashtim krejt të papërfillshëm. Vetëm atëherë kur shqiptarët e Kosovës filluan të tregonin vendosmëri për të fituar me çdo kusht lirinë e tyre, përfshirë këtu edhe përdorimin e forcës ushtarake paralele në rast nevoje, bashkësia ndërkombëtare e kuptoi mirë se "muri i jashtëm i sanksioneve" kishte dështuar: projektimi i forcës nga ana e popullit shumicë dukej si zgjidhja e vetme e problemit të Kosovës. Ky përdorim i forcës, sado i dobët për nga intensiteti dhe përmbajtja, i hapi rrugë bisedimeve paqësore në Rambuje të Francës dhe, më pastaj, edhe ndërhyrjes ushtarake të trupave të NATO-s për të ndaluar gjenocidin që po kryhej në Kosovë kundër popullit shumicë.

Nëse krahasohet dhuna dhe tragjedia kosovare për kohën 78-ditore sa zgjati bombardimi i NATO-s kundër forcave serbe në Kosovë dhe jashtë saj me atë që ka ndodhur në Bosnjë-Hercegovinë, atëherë del se në Kosovë ka pasur më shumë dhunë e gjenocid. Tragjedia boshnjake ka ndodhur për një kohë të gjatë, gjatë një luftë katërvjeçare, kurse në Kosovë për vetëm 78 ditë janë vrarë mbi 10 mijë vetë dhe janë dëbuar mbi një milion shqiptarë. Po ashtu, shkatërrimet e pronave në Kosovë janë larg më sistematike dhe më të thella se në Bosnjë-Hercegovinë. Kjo ashpërsi e konfliktit në Kosovë shpjegohet me urrejtjen e pakuptimtë që serbët gjatë shekujve e kanë kultivuar në kuadër të nacionalizmit të tyre, duke parë shqiptarët — më shumë se boshnjakët dhe popujt e tjerë — si pengesën kryesore për realizmin e projektit të tyre për Serbinë e Madhe. Në kulmin e luftës gjenocidale në Bosnjë-Hercegovinë, diku gjatë mesit të vitit 1994, një agjenci e pavarur perëndimore kishte bërë një anketë në Serbi lidhur me popujt që serbët urrenin më së shumti: urrejtja ndaj shqiptarëve kishte dalë e para në listë. Kjo pati shkaktuar debate të gjëra në Serbi dhe jashtë saj, lidhur me shkaqet e kësaj urrejtje kaq të thellë

ndaj shqiptarëve, me të cilët serbët atëkohë akoma nuk ishin në luftë të hapur. Shpjegimi i vetëm, sipas autorit të këtyre rreshtave, ka qenë dhe ngelet natyra e nacionalizmit serb dhe vendi i Kosovës në këtë kuadër. Këtë e kemi shtjelluar në mënyrë shkencore në punimin tonë me titull "Refleksione mbi nacionalizmin serb dhe politikën e pastrimit etnik", të cilin e botojmë në kuadër të seksionit të dytë të kapitullit të katërt të kësaj monografie.

Në mënyrë të natyrshme, në seksionin e tretë të këtij kapitulli botohet një intervistë e imja dhënë gazetës *Turkish Daily News* të Ankarasë[511] në kohën e luftës kur sapo isha kthyer nga Konferenca e Rambujesë, ku si këshilltar ligjor kisha dhënë kontribut modest në formësimin e dokumenteve përfundimtare të Konferencës. Këtë intervistë e japim këtu të plotë, sepse ka qenë i vetmi dokument me një autor shqiptar të cilin e kanë cituar miqtë e Kosovës, ekspertët ligjorë amerikanë, pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë kur po shqyrtonte ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Jo vetëm kjo intervistë e imja por edhe disa shkrime të tjera ishin marrë si pikë referimi në prezantimet e miqve të Kosovës pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e cila më 21 korrik 2010 vendosi se nuk kishte pasur asnjë shkelje të asnjë pjese të së drejtës ndërkombëtare në aktin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Këto rrethana autori i ka kuptuar vetëm kur u bënë publike kabllogramet tanimë të njohura si *WikiLeaks*, pjesa për Kosovën.

Shkrimi i katërt dhe i fundit i këtij kapitulli, i bërë së bashku me kolegun prof. dr. Hajredin Kuçi, paraqet gjënë më interesante, sepse lidhet me atë që sot e shohim në Kosovë: vendin, rolin dhe pozitën e ligjeve të luftës, si dhe përgjegjësinë ndërkombëtare për cenimin eventual të tyre. Relevanca e këtij shkrimi është vërtet historike, sepse me kohë e ka bërë të qartë se lufta e drejtë dhe e pastër e UÇK-së është diçka krejtësisht tjetër nga mënyra dhe mjetet që përdorin luftëtarët e saj dhe nga përgjegjësia eventuale penale që mund të mbajnë individët në rrethana të tilla. E para quhet *jus ad bellum*, ose e drejta për luftë, kurse e dyta *jus in bello*, ose mënyra luftimit dhe mjetet e lejueshme për luftim.

Ky shkrim është shkruar dhe botuar shumë kohë para se të shkallëzonte situata në Kosovë në mënyrën që eskaloi, gjatë bombardimeve të NATO-s, me të vetmin qëllim për t'i treguar prijësve të UÇK-së se duhej të kishin kujdes për mënyrën e luftimit dhe mjetet e përdorura në të, përkatësisht se duhej të kishin kujdesin e shtuar për respektim të *jus ad bellum.* Kjo për faktin se

---

[511] "KLA's Legal Expert: First International Protectorate and then Independence", *Turkish Daily News* (Saturday-Sunday, April 10-11, 1999).

një cenim i ligjeve të luftës, në kuptimin më të gjerë të fjalës, do të sillte me vete përgjegjësinë penale ndërkombëtare të llojit më të rëndë, dhe për pasojë, do të njolloste luftën e lavdishme të UÇK-së dhe popullit të saj të përvuajtur. Në fakt, të gjitha ushtritë moderne të vendeve perëndimore kanë manuale për të drejtën ndërkombëtare humanitare, ose të drejtën e luftës siç njihet në terminologjinë laike, për ushtritë e tyre. Këto manuale janë pjesë përbërëse e trajnimeve të ushtrive të rregullta në këto vende dhe pjesë e kulturës së tyre ushtarake. Në njëfarë mënyre, këtë shkrim kemi synuar t'ia përshtatim këtyre nevojave, në një kohë që aktivitetit ushtarak i UÇK-së ishte krejt rudimentar dhe do të duhej kohë e mund për t'i kuptuar të gjitha finesat e ligjeve të luftës dhe rëndësinë e respektimit të tyre gjatë tërë kohës së konfliktit të armatosur me serbët dhe forcat e tyre militare dhe paramilitare. Ky shkrim shpjegon dallimin mes konflikteve të brendshme dhe ndërkombëtare, duke e bërë të qartë se dallimi është jorelevant sa i përket respektimit të *jus in bello* dhe përgjegjësisë penale ndërkombëtare. Ky dallim, siç sqarohet në këtë shkrim, ka ardhur pas Luftës së Ftohtë si rezultat i mbrojtjes së lëvizjeve çlirimtare që luftonin për liri kundër fuqive koloniale të kohës, por më pastaj, ky kuptim u zgjerua, dhe sot përfshin të gjitha lëvizjet për çlirim pa marrë parasysh kundër kujt luftohet.

Artikulli është shkruar në Universitetin Bilkent të Ankarasë, më 22 dhjetor 1998, dhe është botuar për herë të parë në gazetën *Zëri i Kosovës* në Zvicër dhe javorën *Rilindja* (botimi i Tiranës dhe i diasporës) gjatë muajve shkurt-mars 1999. Shkrimi vinte natyrshëm pas shkrimit për të gjitha gjykatat e Hagës, i cili flet për vendin dhe rolin e tyre në sistemin e përgjithshëm të drejtësisë ndërkombëtare.

I. TË GJITHA GJYKATAT E HAGËS

Hyrja

Objekt trajtimi në këtë punim është Gjykata për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, si gjykatë *ad hoc* që është formuar në bazë të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit Nr. 827, datë 25 maj 1993. Kjo rezolutë është e bazuar në Kreun VII të Kartës së OKB-së.

Mirëpo, para se të flasim për këtë gjykatë është e nevojshme të japim disa konsiderata historike lidhur me përgjegjësinë penale individuale në të drejtën ndërkombëtare, historikun e ideve për një gjykatë penale ndërkombëtare (në mënyrë të veçantë rreth punës së Komisionit të OKB-së për të Drejtën Ndërkombëtare), praktikën pas Luftës së Dytë Botërore dhe çështje të tjera të kësaj natyre.

Po kështu, në pika të shkurtra, do të jepen sqarime dhe për Kërkesën e Bosnjë-Hercegovinës kundër Serbisë dhe Malit të Zi, të parashtruar në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës më datën 20 mars 1993 lidhur me zbatimin e Konventës për Pengimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit. Në fund, pasi të kemi trajtuar Gjykatën për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, do të japim pikëpamjet tona se pse Kërkesa e Kosovës lidhur me krimet e pushtetit okupues serb në Kosovë, e bërë në fillim të vitit 1993 në bazë të materialit faktit të përgatitur më 8 dhjetor 1992 nga Këshilli i Prishtinës për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, nuk është trajtuar ende nga Gjykata për Krimet e Luftës.

1. Vështrim i shkurtër historik mbi përgjegjësinë penale individuale

Normalisht, individi në të drejtën ndërkombëtare nuk del si subjekt i posaçëm. Mirëpo, disa krime, për të cilat do të flitet shkarazi në vijim, kanë rëndësi të madhe ndërkombëtare, gjë që sjell që ndaj autorëve të tyre të mund të ndërmerren një sërë veprimesh në bazë të së drejtës penale ndërkombëtare: ata mund të ndiqen, akuzohen, gjykohen dhe të ndëshkohen.

Individi mund të jetë përgjegjës në të drejtën ndërkombëtare, qoftë për arsyen se ka kryer krime të karakterit ndërkombëtar (pa marrë parasysh nëse është implikuar shteti i caktuar në këtë) ose për faktin se ka kryer krime duke vepruar në emër të shtetit. Rasti i fundit ishte i rrallë në të drejtën ndërkombëtare klasike, sepse individi zhdukej prapa ekranit të shtetit.

Nga kjo del se përgjegjësia penale e individit në të drejtën ndërkombëtare mund të ekzistojë si në rastin kur individi ka kryer akte të kundërligjshme me iniciativën e tij, ashtu edhe në rastin kur aktet e kundërligjshme janë kryer nga individi në bazë të urdhrave të eprorëve të tij.

Për sa u përket krimeve ndërkombëtare të kryera me vetiniciativë, duhet theksuar se disa veprime qysh herët janë konsideruar, nga ana e shteteve dhe në të drejtën zakonore ndërkombëtare, si të kundërligjshme, dhe si rrjedhim është shtruar nevoja e ndëshkimit të tyre. Mirëpo, në mungesë të mekanizm-

ave institucionalë ndërkombëtarë, kanë ekzistuar dhe vazhdojnë të ekzistojnë akoma gjykatat kombëtare të cilat në një mënyrë ose tjetër janë kompetente për këtë lloj të veprave penale. Këto gjykata, në përgjithësi, kanë dy mundësi: ose t'i vejnë autorët e këtyre veprave para autoriteteve kompetente ose t'i ekstradojnë autorët e tillë në shtete të tjera, të cilët kanë kompetencë lidhur me çështjen, në çfarëdo baze qoftë (p.sh., në bazë të vendit të regjistrimit të avionit në të cilin është bërë krimi, në bazë të shtetësisë së autorit, etj. etj.).

Ndërsa, për sa u përket krimeve ndërkombëtare të kryera në zbatim të urdhrave të eprorëve, si bazë e dytë për përgjegjësinë penale ndërkombëtare, vlen të thuhet se kjo për herë të parë është parashikuar në Marrëveshjen e Versajës të vitit 1919. Në të vërtetë, në nenin 227 të kësaj marrëveshjeje, Fuqitë Aleate patën akuzuar perandorin gjerman Vilhelmi II për "cenim të rëndë të moralit ndërkombëtar dhe mosrespektim të marrëveshjeve ndërkombëtare". Gjithashtu, në këtë nen qe parashikuar formimi i Gjykatës Speciale, e cila, "duke u udhëhequr nga motivet e frymëzuara prej parimeve më të larta të politikës mes kombeve", do të gjykonte, bazuar në përgjegjësinë penale, përfaqësuesin më të lartë të shtetit gjerman. Mirëpo, kjo klauzolë mbeti letër e vdekur pasi Holanda, si vend strehues i perandorit gjerman, refuzoi dorëzimin e tij.

Fat të njëjtë, pak a shumë, pësoi edhe çështja e listës të cilën Fuqitë Aleate pas Luftës së Parë Botërore i patën dërguar Gjermanisë më 7 maj 1920, listë kjo e përbërë prej 45 personash të akuzuar për krime lufte. Kjo listë në fillim përfshinte 896 persona, mirëpo më vonë ky numër u zvogëlua. Këta duhej të gjykoheshin për krime lufte nga Gjykata Supreme Gjermane e Lajpcigut. Gjykimi filloi më 23 maj 1921, dhe vetëm gjashtë vetë u shpallën fajtorë. Ndërkohë, togeri gjerman Boldt, i cili u dënua me katër vjet heqje lirie, iu shmang vuajtjes së dënimit, kështu që Fuqitë Aleate u detyruan që të heqin dorë nga ndjekja e mëtejshme e personave të akuzuar për krime luftë.[512]

Represioni ndërkombëtar pati rastin të ushtrohet për herë të parë vetëm pas Luftës së Dytë Botërore. Aty u vendos se individi mund të jetë përgjegjës i vetëm për krimet e kryera gjatë shërbimit (lloji i dytë i përgjegjësisë penale individuale në planin ndërkombëtar). Thirrja në zbatimin e urdhrave të marra nga eprorët ishte e kotë, dhe mund të thuhet, ishte shembulli i Nyrnbergut ai i cili e la të gjallë idenë për krijimin e një gjykate penale ndërkombëtare deri në ditët e sotme.

---

[512] James W. Garner, *Recent Developments in International Law* (Univ. of Calcutta: Calcutta, 1925) fq. 455-463.

Gjeneza e Gjykimit të Nyrnbergut duhet të kërkohet shumë më herët se të mbaronte Lufta e Dytë Botërore dhe pikërisht në Deklaratën e Moskës të datës 30 tetor 1943, me anë të së cilës Fuqitë Aleate manifestuan synimin e tyre për të ndëshkuar autorët e krimeve të luftës. Disa prej tyre do të gjykoheshin konform ligjeve të vendit ku kishin kryer krimet. Të tjerët, krimet e të cilëve nuk mund të lokalizoheshin gjeografikisht, ose, parë nga gjerësia e tyre, nuk mund të kufizoheshin në një ose dy shtete, do të gjykoheshin nga një gjykatë penale ndërkombëtare.

Gjykata e Nyrnbergut qe vënë në jetë në bazë të Marrëveshjes së Londrës të datës 8 gusht 1945, e nënshkruar nga ShBA, Franca, Britania e Madhe dhe Bashkimi Sovjetik mbi ndjekjen dhe ndëshkimin e "kriminelëve të mëdhenj të luftës". Kjo Gjykatë përbëhej nga një numër prej katër gjyqtarësh, dhe funksionoi nga 20 nëntori 1946 deri më 1 tetor 1947.

Në mënyrë paralele qe krijuar Gjykata Ndërkombëtare e Tokios për të gjykuar krimet e bëra në Lindjen e Largët, bazuar në Deklaratën e Komandantëve të Fuqive Aleate të datës 19 janar 1946. Në këtë rast, Gjykata qe e përbërë nga 11 gjyqtarë, të cilët përfaqësonin shtetet në luftë me Japoninë. Gjykimi i filluar më 4 qershor 1946 përfundoi më 4 nëntor 1948.

Në këto gjykime u njohën, për herë të parë, tri lloje veprash penale ndërkombëtare: krimet kundër paqes, krimet kundër luftës dhe krimet kundër njerëzimit (neni 6 i Statutit të Gjykatës së Nyrnbergut). Këto krime më vonë u sanksionuan nga Konventat e Gjenevës (1949) dhe Protokollet Plotësuese (1977) mbi të drejtën e luftës dhe të drejtën humanitare ndërkombëtare. Sistemi i sanksioneve penale në këto dokumente është i bazuar në cenimet e rënda të së drejtës së luftës dhe të asaj ndërkombëtare humanitare, si dhe në cenimet e tjera të obligimeve konvencionale.[513]

Kategoria e krimeve kundër paqes përfshin veprimet e përgatitjes, zhvillimit dhe vazhdimit të një lufte agresive e cila cenon sovranitetin dhe integritetin territorial të shteteve. Lufta agresive është denoncuar dhe gjykuar si krim ndërkombëtar për herë të parë nga Gjykata e Nyrnbergut, ku është theksuar se "lufta agresive nuk është vetëm krim ndërkombëtar, por diçka më shumë, sepse përfshin në vetvete të gjitha të këqijat e një krimi".[514] Në doktrinë konsiderohet se kjo kategori e krimeve ndërkombëtare paraqet një inter-

[513] Jean-Dominique Schouwey, "Crimes de guerre : un état des lieux du droit suisse", *Revue internationale de criminologie et de police technique* (Genève) vol. XLVIII, no. 1 (1995) fq. 46.

[514] Cf. "International Military Tribunal (Nuremberg): Judgment and Sentences", *American Journal of International Law* vol. 43, no. 1 (1949) fq. 168.

pretim të Paktit të Parisit të vitit 1928 (Pakti Briand–Kellogg [Brian-Kelog] mbi ndalimin e luftës si mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare). Krimet e luftës, ndërkaq, konsistojnë në cenimin e ligjeve dhe zakoneve të luftës, si p.sh., vrasja ose trajtimi i keq i robërve të luftës, ekzekutimi i pengjeve, etj. etj. Së fundi, krimet kundër njerëzimit përfshijnë veprimet e vrasjes, shfarosjes, mbajtjes së detyruar në skllavëri, deportimeve, sikundër dhe të gjitha veprimet e tjera çnjerëzore të kryera kundër popullatës civile ose veprimet e tjera ndëshkuese për motive politike apo religjioze. Mirëpo, krimet e fundit duhet të jenë kryer në "vazhdën e" ose "lidhur me" dy kategoritë e tjera të krimeve. Në teori, ndërkaq, është bërë edhe një ndarje tjetër e llojeve të krimeve ndërkombëtare. Kështu, ta zëmë, thuhet se të gjitha veprat penale ndërkombëtare mund të ndahen në dy kategori: kategoria e parë përfshin piraterinë, rrëmbimet e avionëve, tregtinë me skllevër, aktet e terrorizmit dhe gjenocidin. Kategoria e dytë përfshin udhëheqjen e një lufte në rastin kur ajo konsiderohet jolegale sipas së drejtës ndërkombëtare, krimet e luftës, krimet kundër paqes dhe krimet kundër njerëzimit.[515]

Gjykatat e Nyrnbergut dhe Tokios nuk patën mision tjetër përveç atij të gjykimit të "kriminelëve të mëdhenj të luftës". Me këtë rast, në Nyrnberg, qenë gjykuar 21 vetë përmes një procesi i cili zgjati më shumë se një vit, kurse vendimi u dha më 1 tetor 1946.

Shumica e të akuzuarve qenë mbrojtur mbi bazën e pohimeve se kanë zbatuar urdhrat e marra. Karakteristikë esenciale e vendimit të Gjykatës është se ai synoi të rrëzonte një mbrojtje të tillë klasike. Në arsyetimin e dënimeve, Gjykata e Nyrnbergut ka vlerësuar se "obligimet ndërkombëtare" të individit duhet të triumfojnë mbi detyrimin për t'iu bindur urdhrave joligjore. Në nenin 3 të Kartës së Gjykatës Ndërkombëtare të Nyrnbergut qe mohuar shprehimisht mbrojtja e të akuzuarve nën justifikimin e zbatimit të urdhrave nga lart dhe se kjo lloj mbrojtjeje e të akuzuarve, eventualisht, do të mund të merrej si një rrethanë lehtësuese. Në mënyrë të njëjtë, Gjykata ka treguar se krimet në të drejtën ndërkombëtare kryhen nga ana e personave e jo nga ana e entiteteve abstrakte. Rrjedhimisht, vetëm me dënimin e këtyre personave mund të arrihet respektimi i së drejtës ndërkombëtare. Ky konstatim pas luftës u konfirmua edhe nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, e cila me rezolutat nr. 3 dhe 95, të miratuara në Sesionin e Parë të Asamblesë më 1946, ripohoi "Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare të njohura nga Stat-

[515] Gerhard von Glahn, *Law Among Nations: An Introduction to Public International Law*, 5th ed. (Macmillan: New York, 1986) fq. 282.

uti dhe Vendimi i Gjykatës së Nyrnbergut". Me këtë, Asambleja konstatoi se këto parime (mbi përgjegjësinë individuale penale në planin ndërkombëtar) përbëjnë pjesën integrale të së drejtës ndërkombëtare zakonore.

Gjykata e Nyrnbergut nuk kishte kompetencë ekskluzive, përveç rasteve të "kriminelëve të mëdhenj", të cilët ajo edhe i ka gjykuar, ashtu që u mbyll me përfundimin e këtij procesi të vetëm. Ndëshkimi i kriminelëve tjerë "të vegjël" mbeti në duart e gjykatave kombëtare në gjithë botën.

Lidhur me këtë kategori të dytë të kriminelëve të Luftës së Dytë Botërore, në procesin e zhvilluar kundër Adolf Eichmann-it (Adolf Ajhman) nga ana e shtetit të Izraelit më 1961, u iniciua edhe një çështje tjetër. Në të vërtetë, aty u parashtrua pyetja nëse një numër i caktuar i kriminelëve të Luftës së Dytë Botërore, të cilët strehoheshin në vendet e ndryshme të botës, mund të gjykoheshin pas kalimit të një kohe të caktuar, si pasojë e veprimit të rregullave mbi parashkrimin e krimeve. Konstatim i kohës ishte se mosparashkrimi i krimeve kundër njerëzimit buronte nga Marrëveshja e Londrës dhe se, përveç kësaj, ky parim është i inkorporuar edhe në rendet juridike nacionale. Asnjë dispozitë e së drejtës së brendshme nuk mund të jetë mbi këtë parim. Duke u bazuar në këtë konstatim, një numër i konsiderueshëm i shteteve në këtë periudhë patën miratuar dispozitat mbi mosparashkrimin e këtyre krimeve. Mund të thuhet se, aktualisht, të gjitha shtetet i kanë përfshirë në legjislacionet e tyre penale dispozitat e përmendura, kurse praktika gjyqësore e ka përpunuar më tej këtë standard.

Në vijim si më sipër, Gjykata Franceze e Kasacionit në një vendim të datës 6 tetor 1983 (rasti i njohur si "Barbie") pati deklaruar se "nocioni i mosparashkrimit" rrjedh jo vetëm nga e drejta e brendshme franceze, por, në të njëjtën kohë, edhe nga rendi represiv ndërkombëtar. Me fjalë tjera, Gjykata ka konfirmuar se ky parim mbrohet para së gjithash nga rendi juridik ndërkombëtar.[516]

Prej vitit 1946, disa marrëveshje ndërkombëtare kanë pasuruar të drejtën ndërkombëtare në këtë fushë. Më e njohura është Konventa mbi Pengimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit, miratuar më 9 dhjetor 1948 (në fuqi prej vitit 1951). Megjithatë, shembulli i Nyrnbergut nuk është përsëritur asnjëherë më pastaj, edhe pse shumë fenomene të ngjashme në vende të ndryshme të botës, si p.sh., Indokina, Vietnami, Afganistani etj., kanë qenë të tilla

[516] Shih më shumë për trajtimet doktrinare franceze dhe të tjera të kësaj teme në Pierre Martens, *L'imprescriptibilité des crimes de guerre et contre l'humanité : étude de droit international et de droit pénal comparé* (Editions de l'Université de Bruxelles: Bruxelles, 1974).

që kanë mund ta arsyetojnë krijimin e një gjykate penale ndërkombëtare. Në aspektin teorik lidhur me këtë çështje, zakonisht konsiderohet se krijimi i gjykatave të Nyrnbergut dhe Tokios u mundësua nga rrethanat pas Luftës së Dytë Botërore dhe miqësia në mes Fuqive Aleate të kohës.

Ristrukturimet e reja pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe krimet e kryera në disa vende të botës e riaktualizuan në mënyre të fuqishme idenë e krijimit të një gjykate penale ndërkombëtare. Një gjë e tillë erdhi në shprehje për rastet e krimeve të kryera në ish-Jugosllavi dhe Ruandë, bazuar në Kreun VII të Kartës së OKB-së. Çështja e Ruandës dhe krimet e kryera atje gjatë pranverës së vitit 1994 nuk trajtohen në këtë punim.

2. Idetë për vënien në jetë të një juridiksioni penal ndërkombëtar

Ideja e vjetër për një institucionalizim të represionit ndërkombëtar, pra ideja e "nostalgjisë" së Nyrnbergut, ka mbetur gjithmonë e gjallë. Nga këndvështrimi i legalitetit ndërkombëtar, është konsideruar dhe vazhdon të konsiderohet se sanksioni për krimet e rënda ndërkombëtare duhet të ekzistojë dhe se duhet të jepet nga mekanizma të rinj institucionalë.

Nga pikëpamja historike, qysh nga fundi i shekullit të kaluar, bashkësia ndërkombëtare i shpalli si krime ndërkombëtare disa vepra penale. I tillë ishte rasti i tregtisë së njerëzve, i cili u shpall si krim ndërkombëtar në Kongresin e Vjenës të vitit 1815, në Marrëveshjen e Londrës të vitit 1841, në Aktin mbi Kongon të vitit 1885 dhe në Aktin e Përgjithshëm të Brukselit të vitit 1890. Konventa e Hagës e vitit 1907 (neni III) parashihte që "nëse pala ndërluftuese cenon dispozitat e rregullave të Hagës do të jetë përgjegjëse, nëse këtë e kërkon rasti, për ta bërë kompensimin e një shume të caktuar". Në këtë konventë nuk thuhet asgjë lidhur me gjykimin ose dënimin e autorëve të veprimeve të tilla, përveç pagesës së një shume të caktuar të hollash. Përpjekja e sipërpërmendur, lidhur me perandorin gjerman Vilhelm II pas Luftës së Parë Botërore, ishte e rëndësishme edhe për faktin se nuk parashikonte dënimin e tij për krime të luftës, por për "cenim të rëndë të moralit ndërkombëtar dhe zbatimin jokorrekt të marrëveshjeve ndërkombëtare".

Në vazhdim të këtyre ideve, më 1926, në kuadrin e Lidhjes së Kombeve u miratua Konventa mbi Çrrënjosjen e Robërisë. Problemi i piraterisë detare u zgjidh në 1958, në bazë të Konventës mbi Detin e Hapët, kurse çështja e mjeteve narkotike u kodifikua më 1961, në bazë të Konventës mbi Mjetet Narkotike (me amendamentet e miratuara gjatë vitit 1978).

Megjithatë, të gjitha këto dokumente parashikuan vetëm sanksionimin e veprave penale ndërkombëtare, pa parashikuar ndonjë institucion kompetent ndërkombëtar për gjykimin e tyre. Konventa mbi Pengimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit e vitit 1948 ishte i pari dokument ndërkombëtar që, pas rastit të Marrëveshjes së Versajës dhe gjykimeve të pas-Luftës së Dytë Botërore, parashikoi një kompetencë të dyfishtë: kompetencën e gjykatave nacionale dhe atë të "Gjykatës Penale Ndërkombëtare", e cila deri sot nuk është krijuar kurrë më.

Konkretizimit të idesë për një gjykatë penale ndërkombëtare iu kushtua vëmendje e veçantë vetëm pas Luftës së Dytë Botërore: OKB, përmes Komisionit për të Drejtën Ndërkombëtare, që nga mbarimi i luftës për të realizuar idenë e formimit të një gjykate të përhershme penale ndërkombëtare e cila do të gjykojë të gjitha llojet e veprave penale ndërkombëtare. Nisur nga kjo rrethanë është e nevojshme që të japim disa konsiderata të shkurtra lidhur me punën e këtij Komisioni të OKB-së.

3. Puna e Komisionit për të Drejtën Ndërkombëtare në realizimin e idesë së formimit të një gjykate penale ndërkombëtare

Në Rezolutën Nr. 177 (II), të datës 21 mars 1947, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ngarkoi Komisionin për të Drejtën Ndërkombëtare për sa vijon:

a. të formulojë parimet e së drejtës ndërkombëtare të njohur nga Statuti i Gjykatës së Nyrnbergut dhe të inkorporuar në Statutin e kësaj Gjykate; dhe
b. të përgatisë një projekt-kod për krimet kundër paqes dhe sigurisë së njerëzimit, duke treguar në mënyrë të qartë vendin që u duhet dhënë parimeve të cekura në pikën e mësipërme.

Në sesionin e vet të parë më 1949, Komisioni emëroi, lidhur me këtë pikë, raporterin special. Në bazë të raporteve të raporterit special, Komisioni:

a. në sesionin e vet të dytë (1950), miratoi një formulim të parimeve të së drejtës ndërkombëtare të njohur nga Statuti i Gjykatës së Nyrnbergut dhe të inkorporuar në vendimin e kësaj gjykate, dhe ia prezantoi këto parime, së bashku me komentet, Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së;

b. në sesionin vet të gjashtë (1954), paraqiti një projekt-kod të krimeve kundër paqes dhe sigurisë së njerëzimit, dhe ia prezantoi këto, së bashku me komentet, Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.[517]

Në bazë të Rezolutës Nr. 897 (IX), datë 4 dhjetor 1954, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së konsideroi se projekt-kodi i krimeve kundër paqes dhe sigurisë së njerëzimit, ashtu siç ishte formuluar nga Komisioni, nxjerr në pah një sërë problemesh të lidhura pashmangshmërisht me definicionin e agresionit. Për këtë qëllim, Komisioni formoi një komitet special për përgatitjen e një raporti lidhur me projektin e definicionit të agresionit, kështu që projekt-kodi u shty për shqyrtim të mëvonshëm deri atëherë kur komiteti special të sillte raportin e tij për definimin e agresionit. Në bazë të rekomandimeve të komitetit special, Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën Nr. 3314 (XXIX), datë 14 dhjetor 1974, miratoi me konsensus definicionin e agresionit.

Më 10 dhjetor 1981, me Rezolutën Nr. 36/106, Asambleja e Përgjithshme ka ftuar Komisionin që të rimarrë në shqyrtim punët e tij për një përpunim të mëtejshëm të projekt-kodit për krimet kundër paqes dhe sigurisë së njerëzimit dhe që të ketë parasysh zhvillimin progresiv të së drejtës ndërkombëtare. Për realizimin e kësaj detyre, përkatësisht të zhvillimit progresiv të së drejtës ndërkombëtare, në sesionin e 34-t (1982) Komisioni emëroi një raporter special. Në sesionin e 43-të (1991), Komisioni e pranoi raportin e raporterit special.

Më 1991, Komisioni miratoi provizorisht disa nene të Projekt-kodit për krimet kundër luftës dhe sigurisë së njerëzimit.[518] Me këtë rast, Komisioni vendosi që, konform neneve 16 dhe 21 të Statutit të vet, këto nene të projekt-kodit t'ia dërgojë qeverive të vendeve të ndryshme me qëllim që këto të japin komentet dhe sugjerimet e tyre lidhur me to.

Vetëm me Rezolutën Nr.45/41, datë 28 nëntor 1990, për herë të parë u ftua Komisioni për të Drejtën Ndërkombëtare që të ekzaminojë anën procedurale të së drejtës penale ndërkombëtare, përkatësisht të shqyrtojë mundësinë e krijimin të një gjykate penale ndërkombëtare ose të krijimit të një

---

[517] *Yearbook of the International Law Commission* vol. II (1950) fq. 374-378, dokumenti A/1316; *Yearbook of the International Law Commission* vol. II (1954) fq. 150-152, dokumenti A/2673. Për tekstin e parimeve dhe të projekt-kodit, shih gjithashtu edhe në *Yearbook of the International Law Commission* vol. II, pt. 2 (1985) fq. 12 dhe 8, dokumenti A/40/10, para. 45 dhe 18.

[518] Dokumentet zyrtare të Asamblesë së Përgjithshme, Sesioni 46, Shtojca Nr. 10-A/46/10, para. 173.

mekanizmi tjetër me juridiksion penal ndërkombëtar. E gjithë kjo do të duhej të ishte në kuadrin e projekt-kodit për krimet kundër luftës dhe sigurisë së njerëzimit. Në sesionin e tij të 44-t (1992), Komisioni shqyrtoi raportin e raportuesit special të emëruar për këtë qëllim. Sipas këtij raporti, u sugjerua që të krijohej një gjykatë penale ndërkombëtare, e cila do të kishte formën e një traktati ndërkombëtar shumëpalësh dhe që në stadin fillestar do të kishte kompetencë vetëm ndaj individëve. Kjo kompetencë do të ishte e kufizuar vetëm për krimet e karakterit ndërkombëtar të përcaktuara nga disa traktate në fuqi, përfshirë këtu, por jo ekskluzivisht, edhe krimet e parapara në Projekt-kodin e krimeve kundër paqes dhe sigurisë së njerëzimit, pas hyrjes së tij në fuqi.

Gjithherë sipas këtij raporti, shtetet do të mund të ishin palë të këtij statuti pa qenë njëkohësisht edhe palë të kodit për krimet kundër luftës dhe sigurisë së njerëzimit. Në fund, organizimi i kësaj gjykate (ose i mekanizmit tjetër pranë gjykatës) qe paraparë se duhej të ofronte garancitë e një procedure të rregullt, të pavarur dhe objektive. Në po këtë sesion, Komisioni, bazuar në raportin e raporterit, arriti në studimin me titull "*mundësia e krijimit të një gjykate penale ndërkombëtare ose të ndonjë mekanizmi tjetër juridiksional të karakterit ndërkombëtar*".

Në sesionin e vet të 46 (1994), Komisioni bëri një progres të konsiderueshëm duke miratuar kështu projekt-statutin për gjykatën penale ndërkombëtare (60 nene) dhe projekt-kodin për krimet kundër luftës dhe sigurisë së njerëzimit (15 nene).[519]

Nga puna e këtij komisioni, gjatë gjithë periudhës së pas-Luftës së Dytë Botërore, shihet synimi i OKB-së për të kopjuar rendin e brendshëm juridik të shteteve, përkatësisht synimi i bashkësisë ndërkombëtare për përsosmërinë e rendit juridik ndërkombëtar sipas modelit të së drejtës së brendshme të shteteve sovrane. Ndoshta, kjo është edhe arsyeja përse realizimi praktik i këtyre projekteve ka zgjatur kaq shumë dhe aktualisht nuk po funksionon.

Sigurisht që shtetet do të pranojnë me vështirësi bartjen e të drejtave të tyre sovrane në një forum tjetër ndërkombëtar siç është gjykata penale ndërkombëtare, për të cilin folëm deri tani.

---

[519] Rapport de la Commission du droit international sur les travaux de sa quarante-sixième session, 2 mai–22 juillet 1994, fq. 21 e tutje.

4. Kërkesa e Bosnjë-Hercegovinës kundër Serbisë dhe Malit të Zi lidhur me krimin e gjenocidit kundër popullit dhe shtetit të Bosnjë-Hercegovinës

Republika e Bosnjë-Hercegovinës ka parashtruar pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë kërkesën kundër të a.q. Jugosllavi (Serbia dhe Mali i Zi) për krimin e gjenocidit, e cila mban datën 20 mars 1993 si datë të regjistrimit të kërkesës në regjistrin e Gjykatës.[520]

Në trupin gjykues të Gjykatës marrin pjesë, përveç gjyqtarëve të rregullt, edhe gjyqtarët *ad hoc*, Hersch Lauterpacht (Hersh Llauterpaht) dhe Millenko Kreqa (Milenko Kreća), ndërsa si përfaqësues të palëve janë Muhamed Shaqirbej (Muhamed Šaćirbej) dhe Francis Boyle (Frensis Bojle) për Bosnjë-Hercegovinën dhe Rodolub Etinski (Rodoljub Etinski), Gjorgje Llopçiq (Djordje Lopčić), Miodrag Mitiq (Miodrag Mitić), Shabtai Rosene (Shabtai Rosen) dhe Lubivoje Zhivkoviq (Ljubivoje Živković) për Serbinë dhe Malin e Zi.

Kërkesa boshnjake përbëhet prej pesë pjesëve dhe konkretisht:

I. Parashtrimi i fakteve (fq. 2-108);
II. Kompetenca e Gjykatës (fq.108-l13);
III. Pretendimet e Bosnjë-Hercegovinës (fq. 14-133);
IV. Vendimi i kërkuar (fq. 134-138);
V. Konkluzionet (fq. 138-140).

Pjesa e parë, përkatësisht parashtrimi i fakteve, paraqet pjesën me rrëqethëse të Kërkesës. Ky parashtrim i fakteve fillon me konstatimin se, që nga krimet e Luftës së Dytë Botërore të kryera nga nazi-fashistët, bota është dëshmitare, për herë të parë, e krimeve të njëjta të cilat po ndodhin në Bosnjë-Hercegovinë. Në këtë pjesë ftohet i tërë opinioni ndërkombëtar që të ndërmarrë masa për të penguar shfarosjen kolektive të popullit boshnjak.

Në pikën B të pjesës së parë, jepet një historik i Bosnjë-Hercegovinës që nga epoka bizantine (shek. X) e deri në ditët tona, kurse në pikën C, trajtohet gjeneza e konfliktit dhe dhunës aktuale në Bosnjë-Hercegovinë. Aty është thënë se shkaku kryesor i luftës është lindja e saj si shtet i ri, së bashku me entitetet e tjera të ish-RSFJ-së, dhe rrënimi i sistemit komunist, i cili ishte pikëmbështetja kryesore e hegjemonisë dhe dominimit serb.

---

[520] "International Court of Justice" (The Hague). Subject: Application Instituting Proceedings: Application of the Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide (Bosnia and Herzegovina v. Yugoslavia (Serbia and Montenegro)).

Në shqyrtimet lidhur me titull "Planifikimi i Serbisë së Madhe", në pikën D flitet për luftën në Bosnjë-Hercegovinë që nga epoka bizantine (shek. X) e deri më sot. Këtu thuhet, gjithashtu, se lufta në Bosnjë-Hercegovinë nuk është bërë spontanisht, por në mënyrë të planifikuar me qëllim të krijimit të Serbisë së Madhe, duke pastruar territoret nga popujt e tjerë joserbë. Plani për Serbinë e Madhe, thuhet më tej po aty, bazohet në dokumentet e hershme të Ilija Garashaninit të vitit 1844, të cilat më vonë u riartikuluan në Memorandumin e Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve të vitit 1984. Si argument tjetër në favor të kësaj ceken edhe synimet dhe praktika shfarosëse e çetnikëve, bazuar në Proklamatën e Drazha Mihajlloviqit të datës 20 dhjetor 1941, si dhe projektet e tjera të mëvonshme për shfarosjen e popullsisë boshnjake joserbe.

Ritheksimi i neneve I-IV të Konventës mbi Pengimin dhe Ndëshkimin e Krimit të Gjenocidit të vitit 1948 bëhet në pikën D të pjesës së parë, ndërsa nën pikën F jepen provat specifike konkrete për aktet e gjenocidit të kryera në Bosnjë-Hercegovinë nga ana e Serbisë dhe Malit të Zi ose nga ana e serbëve të Bosnjë-Hercegovinës, të cilët janë ndihmuar në çdo aspekt në kryerjen e krimeve të gjenocidit atje dhe gjetiu. Me fakte dhe prova konkrete dëshmohet për të gjitha tiparet e figurës së veprës penale të gjenocidit, siç janë:

- mbytja e anëtarëve të grupit (fq. 20-46);
- shkaktimi i lëndimeve serioze mendore ose trupore anëtarëve të grupit (fq. 46-70); dhe
- vënia e masave të dhunshme, të cilat synojnë pengimin e lindjes brenda grupit (fq. 70-72).

Në pikën G të kërkesës citohet në tërësi teksti i Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së Nr. 47/121, datë 18 dhjetor 1992, e titulluar "Situata në Bonjë-Hercegovinë", e cila vërteton të gjitha thëniet e kërkesës të cekura në pikat e mësipërme. Paraqitja e fakteve përfundon me ricitimin e fjalëve të ipeshkvit dhe priftërinjve të Dioqezës së Banjallukës, datë 17 dhjetor 1993, në të cilën apelohet për ndihmë nga bashkësia ndërkombëtare për të penguar gjenocidin ndaj popullit boshnjak (pika H e pjesës së parë).

Pjesa e dytë, përkatësisht "kompetenca e Gjykatës", përmban bazën juridike për vënien në lëvizje të procedurës pranë kësaj gjykate. Kërkesa për kompetencë bazohet në nenin 36, pikën 1 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i cili parasheh se kompetenca e Gjykatës "përfshin [...] të gjitha çështjet e parapara shprehimisht [...] në marrëveshjet dhe konventat në fuqi". Si anëtare të OKB-së, thuhet më tej në paragrafin 88 të kërkesës, Republika e Bosnjë-Hercegovinës dhe e a.q. Jugosllavi (Serbia dhe Mali i Zi)

janë anëtare të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i cili përbën një pjesë integrale të Kartës së OKB-së. Më tutje, në paragrafin 89 të kërkesës thuhet se "Republika e Bosnjë-Hercegovinës dhe Jugosllavia (Serbia dhe Mali i Zi) janë, gjithashtu, palë në Konventën mbi Gjenocidin, e cila është në fuqi gjatë tërë periudhës që nevojitet për këtë kontest". Për të rrumbullakësuar bazën juridike, në paragrafin 90 të kërkesës, citohet neni IX i Konventës mbi Gjenocidin, i cili parashikon se:

> kontestet mes palëve kontraktuese lidhur me interpretimin, zbatimin ose përmbajtjen e kësaj konvente, përfshirë këtu edhe kontestet të cilat i referohen përgjegjësisë së shteteve për gjenocid apo veprim tjetër të përshkruar në nenin III të Konventës, do të parashtrohen para Gjykatës për zgjidhje, bazuar në kërkesën e cilësdo palë në kontest.

Nga konstatimet e mësipërme mbi të cilat bazohet kërkesa boshnjake, shikuar nga aspekti juridik *stricto sensu* mund të vërehet lehtë se nuk ka ekzistuar baza juridike për vënien në lëvizje të procedurës para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Nëse në nenin 34, pikën 1 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë thuhet se "vetëm shtetet mund të jenë palë në çështjet që paraqiten para Gjykatës", atëherë shtrohet pyetja se në bazë të çfarë kritereve pala boshnjake dhe Gjykata kanë konstatuar se e a.q. Jugosllavi (Serbia dhe Mali i Zi) është anëtare e OKB-së, pra, rrjedhimisht, edhe i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe Konventës mbi Gjenocidin. Në fakt, anëtare e OKB-së dhe Konventës mbi Gjenocidin është vetëm pala boshnjake, kurse dikur ishte ish-RSFJ, e cila është zhdukur dhe aktualisht ndodhet në procesin e zgjidhjes së problemeve të suksedimit (trashëgimisë) së saj. RFJ (Serbia dhe Mali i Zi) nuk ka shprehur dëshirën për të qenë trashëgimtare e ish-RSFJ-së, por kontinuitet i saj, gjë që nuk është pranuar nga asnjë shtet në botë. Bosnjë-Hercegovina, ndërkaq, ka deklaruar dëshirën e vet për të qenë trashëgimtare e ish-RSFJ-së, gjë e cila është pranuar nga bashkësia ndërkombëtare: në raport me Konventën mbi Gjenocidin, ministri i jashtëm boshnjak, Haris Sillajxhiq (Haris Silajdžić), me letrën e datës 20 dhjetor 1992, dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së nga ana e përfaqësuesit boshnjak pranë OKB-së, pati deklaruar se shteti i Bosnjë-Hercegovinës hyn në trashëgimi të Konventës mbi Gjenocidin që nga data 6 mars 1992.

Si argumente se RFJ (Serbia dhe Mali i Zi) janë palë të Statutit të Gjykatës dhe të Konventës mbi Gjenocidin, kërkesa boshnjake përmend, në paragrafin 95, vendimin e datës 27 prill 1992 të të a.q. Kuvendi i RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi), sipas të cilit kjo e fundit është "kontinuiteti legal dhe politik i

ish-RSFJ-së dhe zotohet se do të respektojë të gjitha obligimet të cilat i ka marrë ish-RSFJ në arenën ndërkombëtare". Në vijim të këtij argumenti përmenden edhe letra e përfaqësuesit permanent të të a.q. Jugosllavi (Serbia dhe Mali i Zi) pranë OKB-së, datë 27 prill 1992, me të cilën është konfirmuar vullneti i saj që të jetë trashëgimtare e vetme e ish-RSFJ; pastaj, letra e nënsekretarit të përgjithshëm dhe Këshillit Juridik të OKB-së, datë 29 shtator 1992, lidhur me pasojat parciale të Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, datë 22 shtator 1992. Në pjesët përkatëse të kësaj letre është thënë: "Rezoluta as nuk suspendon e as nuk përfundon anëtarësinë e RSFJ-së në OKB [...]. Rezoluta nuk ia merr të drejtën RSFJ-së që të marrë pjesë në punën e organeve të tjera, me përjashtim të organizmave të Asamblesë."

Nëse analizohen *lege artis* mendimet e Komisionit të Badinterit (1992-1993), praktika e Konferencës së Londrës për ish-Jugosllavinë, praktika e shteteve lidhur me shpërbërjen e shteteve, sikundër dhe doktrina e së drejtës ndërkombëtare lidhur me këtë çështje, atëherë del qartë se nuk varet nga dëshira e shtetit të dhënë nëse ai do të jetë trashëgimtar apo vazhdim i një shteti tjetër, gjithashtu të dhënë. Prandaj, mund ta përsërisim edhe njëherë se bazueshmëria juridike e Kërkesës boshnjake është e paqëndrueshme dhe se bazohet kryekëput në argumente politike dhe të humanitetit. Pretendimet e Bosnjë-Hercegovinës (pjesa III, paragrafët 102-134, ose fq. 114-133) konsistojnë për sa vijon:

- se Serbia dhe Mali i Zi, zyrtarët, agjentët dhe surrogatët e tyre kanë shkelur në mënyrë serioze, dhe vazhdojnë të shkelin nenin II, paragrafët a, b, c dhe d, të Konventës mbi Gjenocidin për sa i përket popullit dhe shtetit të Bosnjë-Hercegovinës;
- se Serbia dhe Mali i Zi, zyrtarët, agjentët dhe surrogatët e tyre kanë kryer shkelje të rënda, në masë të madhe dhe konsistente, të nenit III, paragrafët a, b, c, d dhe e, të Konventës mbi Gjenocidin për sa i përket popullit dhe shtetit të Bosnjë-Hercegovinës;
- se udhëheqësit përgjegjës në bazë të Kushtetutës dhe zyrtarët e tjerë publikë të Serbisë dhe Malit të Zi kanë shkelur personalisht nenet II dhe III, paragrafët a, b, c, d dhe e, të Konventës mbi Gjenocidin, qoftë me veprimet e tyre ose me veprimet e agjentëve dhe surrogatëve të cilët janë nën kontrollin ose përkrahjen e tyre direkte apo indirekte;
- se shteti RFJ-së (Serbi-Mali i Zi) mban përgjegjësi objektive, së bashku me personat privatë, për mosndëshkimin e këtyre të fundit për krimet e gjenocidit të bëra në Bosnjë-Hercegovinë. Me këtë, personat përgjegjës në pikëpamje kushtetuese dhe zyrtarët e tjerë serbo-malazezë,

së bashku me shtetin e tyre, kanë shkelur dispozitat e neneve III dhe IV të Konventës mbi Gjenocidin;
- se Gjykata Ndërkombëtare, në bazë të nenit VIII të Konventës mbi Gjenocidin, duhet të ndërmarrë menjëherë të gjitha masat e pengimit dhe dënimit të krimeve të gjenocidit, masa këto të parashikuara në nenin III të Konventës, e të cilat janë kryer nga Serbia dhe Mali i Zi, agjentët dhe surrogatët e tyre kundër popullit dhe shtetit të Bosnjë-Hercegovinës;
- se shtetet anëtare të Konventës janë të obliguara, në bazë të nenit I të Konventës, të ndihmojnë shtetin e Bosnjë-Hercegovinës në çdo aspekt, përfshirë këtu edhe ndihmën ushtarake në pajisje, armë, financa, furnizime të ndryshme etj. Kjo do ta ndihmonte popullin dhe shtetin e Bosnjë-Hercegovinës që të mbrohej nga aktet e shfarosjes të kryera nga Serbia dhe Mali i Zi;
- se Bosnja-Hercegovina, në bazë të nenit 51 të Kartës së OKB-së, gëzon të drejtën në vetëmbrojtje individuale dhe kolektive;
- se Serbia dhe Mali i Zi, vetë dhe me ndihmën e agjentëve dhe surrogateve, kanë shkelur rëndë dispozitat e nenit 2, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, dhe të nenit 33, paragrafi 1, të Kartës së OKB-së (agresioni ndaj një shteti sovran dhe anëtar i OKB-së dhe përfitimet për mbrojtje të shteteve anëtare të OKB-së nga anëtarësimi në të);
- se, meqë Këshilli i Sigurimit i OKB-së nuk ka ndihmuar Bosnjë-Hercegovinën ashtu siç kërkohet nga nenet I dhe VIII të Konventës mbi Gjenocidin, atëherë Bosnjë-Hercegovina ka të drejtën e kërkimit të çfarëdo ndihme, përfshirë këtu edhe atë ushtarake në armë, pajisje, financa, furnizime të ndryshme etj.;
- se embargoja e armëve nuk duhet të vlejë për Bosnjë-Hercegovinën dhe se duhet të hiqet menjëherë pasi është vënë në bazë të pëlqimit të përfaqësuesit të ish-RSFJ-së pranë OKB-së;
- se kjo Gjykatë, Rezolutën Nr.713 (1991) të KS të OKB-së dhe të tjerat që kanë pasuar më pas, duhet t'i interpretojë si joobliguese për Bosnjë-Hercegovinën në pikëpamje juridike në mënyrë që popullit dhe shtetit të Bosnjë-Hercegovinës, si anëtar i OKB-së, t'i jepet mundësia për të mbrojtur vetveten; dhe, së fundi,
- se Serbia dhe Mali i Zi kanë shkelur rëndë dispozitat e Konventave të Gjenevës të gushtit 1949 si dhe dispozitat tjera të së drejtës humanitare dhe asaj të luftës.

Në Pjesën IV (paragrafët 135 apo fq. 134-138) të Kërkesës, e titulluar si "aktgjykimi i propozuar", nga Gjykata Ndërkombëtare kërkohet që të vërtetojë të gjitha thëniet e sipërcekura lidhur me shkeljet e së drejtës ndërkombëtare kundruall popullit dhe shtetit të Bosnjë-Hercegovinës. Në fund të Kërkesës (pjesa V, para. 137-138, fq. 138-140) jepet konkluzioni me titull se "popujt dhe shtetet e botës nuk duhet të largojnë sytë prej Bosnjë-Hercegovinës në kohën kur njerëzimi po i afrohet shekullit të ri. Fati i Bosnjë-Hercegovinës do të jetë fat i njerëzimit". Duhet thënë këtu se kjo pjesë e Kërkesës boshnjake është jo e zakonshme për shkresën me të cilën vihet në lëvizje Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, me seli në Hagë.

Ndërkaq, të a.q. masat e përkohshme, të dhëna me 8 prill dhe 13 shtator 1993 (e para ka 27 faqe, kurse e dyta 465 faqe, përfshirë këtu edhe materialet e të gjitha seancave të mbajtura lidhur me këtë çështje), konsistojnë në urdhrin e dhënë nga ana e Gjykatës për qeverinë e a.q. Jugosllavi (Serbia dhe Mali i Zi) që kjo e fundit të ndërmarrë të gjitha masat për të penguar dhe ndëshkuar krimin e gjenocidit kundër popullit dhe shtetit të Bosnjë-Hercegovinës.

Si përfundim i krejt kësaj, nga ana e jonë, do të ishte se ky konstatim i Gjykatës, i dhënë në këto masa të përkohshme, paraqet një lloj konfirmimi të ekzistencës së krimit të gjenocidit në Bosnjë-Hercegovinë, ashtu që Gjykata për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi e ka si detyrë të vetme sigurimin (gjetjen) dhe nisjen e gjykimit të autorëve të këtyre krimeve në territorin e Bosnjë-Hercegovinës.

5. Gjykata *Ad Hoc* për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi

Formimit të Gjykatës *Ad Hoc* për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi i kanë pararendur disa aktivitete juridiko-politike të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe të organizmave të tjerë ndërkombëtare.

Në paragrafin 10 të Rezolutës Nr. 764 (1992), datë 13 korrik 1992, Këshilli i Sigurimit riafirmoi faktin se të gjitha palët në konflikt janë të detyruara të zbatojnë obligimet e së drejtës humanitare ndërkombëtare, në veçanti Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe se personat të cilët kryejnë lëndime të rënda të këtyre konventave do të jenë individualisht përgjegjës për sa i përket lëndimeve të tilla. Ky vendim i Këshillit të Sigurimit, i shprehur në këtë rezolutë, qartazi tregoi synimin e bashkësisë ndërkombëtare për të ndëshkuar akterët e luftës në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kroaci, të cilët "nuk do të luft-

onin sipas rregullave të së drejtës së luftës". Më vonë, me Rezolutën Nr. 771 (1992), datë 13 gusht 1992, Këshilli i Sigurimit sërish ftoi palët që të heqin dorë nga lëndimet e së drejtës ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe praktikën e "pastrimit etnik", ndërsa nga shtetet dhe organizatat ndërkombëtare kërkoi mbledhjen e provave dhe fakteve lidhur me lëndimet e rënda të së drejtës ndërkombëtare në territorin e ish-Jugosllavisë. Në funksion të kësaj, Këshilli i Sigurimit me Rezolutën Nr. 780 (1992), datë 6 tetor 1992, vendosi për krijimin e një komisioni të paanshëm të ekspertëve, i cili do të ekzaminonte dhe analizonte informacionin e parashtruar konform Rezolutës Nr. 771 (1992), përfshirë këtu edhe ekzaminimin dhe analizën e çdo informacioni të cilin komisioni në fjalë mund ta grumbullojë, si rezultat i hulumtimeve dhe përpjekjeve vetanake. Të gjitha këto bëhen, thuhet më tej në këtë rezolutë, me qëllim që t'i ofrohet Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së një material i mjaftueshëm provues lidhur me lëndimet e rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe të së drejtës ndërkombëtare humanitare në përgjithësi, të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë.

Komisioni i Ekspertëve, i formuar në bazë të Rezolutës Nr. 780 (1992), e cekur si më lart, në raportin e tij Nr. S/25274, konstatoi se vendimi për të formuar një gjykatë *ad hoc* për ngjarjet në ish-Jugosllavi është konsistent me punën e tij. Pas kësaj, me Rezolutën Nr. 808 (1993), paragrafi i parë i saj, Këshilli i Sigurimit vendosi për formimin e një gjykate *ad hoc* ndërkombëtare për krimet e kryera në territorin e ish-Jugosllavisë, ndërkohë që në paragrafin e dytë të saj u përcaktua obligimi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së që t'i raportojë Këshillit të Sigurimit për formimin e kësaj gjykate sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 60 ditë.

Bazuar në paragrafin e dytë të Rezolutës Nr. 808 (1993), Sekretari i Përgjithshëm, më datën 3 maj 1993, i parashtroi Këshillit të Sigurimit të OKB-së raportin lidhur me çështjen e sipërcekura, në 48 faqe.[521] Në këtë raport, Sekretari i Përgjithshëm parashtroi për miratim Projektin e Statutit të Gjykatës *Ad Hoc* Ndërkombëtare për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, i cili përmban 34 nene. Ky raport i Sekretarit të Përgjithshëm, përkatësisht Statuti i Gjykatës, përmbajtur aty, u miratua me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së Nr. 827 të datës 25 maj 1993.

Statuti i Gjykatës për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi përbëhet prej shtatë pjesëve:

Pjesa e parë: Baza juridike për krijimin e Gjykatës (Hyrja e Statutit);

[521] UNSC S/25704, 3 May 1993.

Pjesa e dytë: Kompetenca e Gjykatës (nenet 1-10);
Pjesa e tretë: Organizimi i Gjykatës (nenet 11-17);
Pjesa e katërt: Hetuesia dhe procedura përgatitore (nenet 18-19);
Pjesa e pestë: Procedura e shqyrtimit kryesor dhe pas tij (nenet 20-28);
Pjesa e gjashtë: Bashkëpunimi dhe ndihma juridike (neni 29);
Pjesa e shtatë: Dispozitat e përgjithshme (nenet 30-34).

5.1. Baza juridike për krijimin e Gjykatës

Si bazë juridike për krijimin e Gjykatës, në fakt, është Rezoluta Nr. 808, të cilën e përfolëm më sipër, si dhe Kreu VII i Kartës së OKB-së. Kjo është e thënë në mënyrë shprehimore edhe në pjesën hyrëse të Statutit të Gjykatës. E krijuar nga ana e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në zbatim të Kreut VII të Kartës së OKB-së, Gjykata Ndërkombëtare për Ndëshkimin e Personave Përgjegjës për Lëndimet Serioze të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991, siç thuhet në titullin e plotë të saj, do të funksionojë në pajtim me dispozitat e Statutit, i cili është miratuar me të njëjtën rezolutë me të cilën u themelua kjo gjykatë.

Në rrjedhën normale të gjërave, rruga e cila duhej ndjekur në formimin e një gjykate penale ndërkombëtare do të ishte ajo e lidhjes së një marrëveshjeje ndërkombëtare përmes së cilës shtetet palë do të themelonin gjykatën dhe do të aprovonin statutin. Kjo marrëveshje do të përpilohej dhe miratohej nga ana e organizmit të caktuar ndërkombëtar, p.sh., nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së ose e ndonjë konference të veçantë ndërkombëtare, e thirrur nergut për këtë qëllim. Pas këtij akti, marrëveshja në fjalë do të ofrohej për nënshkrim dhe ratifikim nga ana e shteteve të interesuara. Një procedurë e tillë qe propozuar edhe nga ana e Komisionit për të Drejtën Ndërkombëtare të OKB-së, për punën e të cilit folëm më sipër.

Para një dileme të tillë, pra, lidhur me procedurën që duhej ndjekur, ishte edhe Sekretari i Përgjithshëm me rastin e parashtrimit të raportit të datës 3 maj 1993 (S/25704), i cili bazohej në paragrafin 11 të Rezolutës 808 të Këshillit të Sigurimit. Çështja e sipërcekur do të kishte dy përparësi. Së pari, do t'u lejohej shteteve të ndryshme ekzaminimi i detajuar dhe përpunimi i të gjitha çështjeve të cilat do të dilnin lidhur me formimin e gjykatës. Përparësia e dytë do të konsistonte në lejimin e shteteve që të ushtrojnë, në procesin e bisedimeve dhe të lidhjes së marrëveshjes në fjalë, të drejtat dhe vullnetin e tyre sovran, e veçanërisht për sa i përket asaj nëse ato dëshirojnë të jenë palë në marrëveshje ose jo. Nga ana tjetër, e meta kryesore e kësaj mënyre të formi-

mit të gjykatës është se kjo kërkon kohë të konsiderueshme për krijimin e marrëveshjes si instrument ndërkombëtar për formimin e gjykatës, përfshirë këtu edhe procedurën e gjatë dhe të mundimshme për marrjen e ratifikimeve të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Duke marrë parasysh të metat kontraktore, përkatësisht të lidhjes së marrëveshjes si mënyrë për formimin e gjykatës, në rastin konkret të krimeve të kryera në ish-Jugosllavi, nga njëra anë, dhe nevojën për një zbatim efektiv dhe sa më të shpejtë të vendimit për formimin e gjykatës, nevojë kjo e shprehur në Rezolutën Nr. 808 (1993), në anën tjetër, Sekretari i Përgjithshëm vendosi që Gjykata Penale Ndërkombëtare për Krimet e Kryera në ish-Jugosllavi duhej të formohej me vendim të Këshillit të Sigurimit (duke u bazuar në Kreun VII të Kartës së OKB-së).[522]

5.2. Kompetenca e Gjykatës

Kompetenca e Gjykatës për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi buron nga mandati i dhënë në paragrafin e parë të Rezolutës Nr. 808 (1993). Bazuar në këtë, neni i parë i Statutit, i titulluar si "Kompetenca e Gjykatës Ndërkombëtare", përmban një dispozitë të përgjithshme në të cilën thuhet: "Gjykata Ndërkombëtare do të ketë autorizim për ndëshkimin e personave përgjegjës për lëndimet serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që nga viti 1991, në pajtim me dispozitat e këtij statuti".

Ky nen përmban elementet fundamentale të kompetencës së Gjykatës për Krimet e Luftës, elemente të cilat i referohen: (a) kompetencës lëndore; (b) kompetencës personale; (c) kompetencës territoriale; dhe (ç) kompetencës kohore. Statuti i Gjykatës, përveç këtyre llojeve të kompetencës, rregullon edhe çështjen e kompetencës konkurrente të Gjykatës kundruall gjykatave nacionale.

a.

E drejta humanitare ndërkombëtare paraqet bazën e mjaftueshme për kompetencën lëndore të Gjykatës. Kjo e drejtë ekziston në konventat e ndryshme ndërkombëtare dhe si pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare. Sipas kësaj, parimi *nullum crimen sine lege* kërkon që Gjykata duhet të zbatojë rregullat e së drejtës ndërkombëtare humanitare të cilat janë, pa dyshim, pj-

[522] Shih më shumë për këtë në Karine Lescure et al., *Le Tribunal pénal international pour l'ex-Yougoslavie* (Montchrétien: Paris, 1994) fq. 59 e tutje.

së e së drejtës ndërkombëtare zakonore. Rrjedhimisht, problemi i aderimit të disa shteteve (pra, jo i të gjithave) në konventat specifike të së drejtës ndërkombëtare humanitare nuk shtrohet fare. Si pjesë të së drejtës ndërkombëtare humanitare, të cilat pa dyshim se janë bërë pjesë integrale e së drejtës ndërkombëtare zakonore, konsiderohen dispozitat të cilat zbatohen në konfliktet e armatosura e të cilat janë të mishëruara në instrumentet ndërkombëtare si vijon:

1. Konventat e Gjenevës të datës 12 gusht 1949 për mbrojtjen e viktimave të luftës;
2. Konventa IV e Hagës lidhur me respektimin e ligjeve dhe të zakoneve të luftës në tokë, së bashku me rregullat e bashkëngjitura, datë 18 tetor 1907;
3. Konventa mbi pengimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit (Konventa mbi Gjenocidin) e datës 9 dhjetor 1948;
4. Karta e Gjykatës Ndërkombëtare Ushtarake, datë 8 gusht 1945.

Edhe pse e drejta ndërkombëtare humanitare, siç u përshkrua më sipër, paraqet bazën e mjaftueshme për kompetencën lëndore të kësaj gjykate, prapëseprapë, është i domosdoshëm zbatimi edhe i praktikës së brendshme lidhur me një çështje, atë të dënimeve. Në të vërtetë, në nenin 24, paragrafi 1, të Statutit të Gjykatës është thënë si vijon: "dënimi i dhënë nga trupi gjykues do të jetë vetëm me burg dhe në përcaktimin e kohëzgjatjes së tij, trupi gjykues do të ketë parasysh praktikën e përgjithshme të gjykatave në ish-Jugosllavi lidhur me dënimin me burg".

b.

Në bazë të paragrafit 1 të Rezolutës Nr. 808 (1993) dhe të nenit 1 të Statutit të Gjykatës, kompetenca personale i referohet "personave përgjegjës për lëndimet serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare". Në dritën e kompleksit të rezolutave të cilat kanë sjellë deri te Rezoluta Nr. 808 (1993) dhe nenit 1 të Statutit të Gjykatës, "me persona përgjegjës për krime serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare" nënkuptohen personat fizikë, jo ata juridikë.

Si element i rëndësishëm, lidhur me kompetencën personale të Gjykatës për Krimet e Luftës, është parimi i përgjegjësisë individuale. Një gjë të tillë Këshilli i Sigurimit të OKB-së e ka konfirmuar në disa rezoluta, duke e theksuar se personat të cilët kryejnë lëndime serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare në ish-Jugosllavi do të jenë përgjegjës për lëndimet e tilla. Kon-

form kësaj, neni 7 i Statutit të Gjykatës (i cili përmban katër paragrafë) është i titulluar "Përgjegjësia penale individuale".

c.

Lidhur me kompetencën territoriale dhe kohore të Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Luftës, duhet thënë se ajo gjendet në formulimin e sipërcekur të paragrafit të parë të Rezolutës Nr. 808 (1993), dhe të nenit 1 të Statutit të Gjykatës, sipas të cilave dispozita "lëndimet e së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që nga 1 janari i vitit 1991" janë pika e vetme e referimit për përcaktimin e kompetencave të sipërcekura.

Me territor të ish-Jugosllavisë nënkuptohet territori i ish-RSFJ-së, përfshirë këtu hapësirën tokësore, ajrore dhe atë të ujërave territoriale. Ndërsa, lidhur me kompetencën kohore, në kontekstin e dispozitës së cekur, nënkuptohet periudha prej datës 1 janar 1991 e këndej (neni 8 i Statutit të Gjykatës). Kjo është një datë neutrale, e cila nuk është e lidhur me asnjë ngjarje dhe është futur për t'iu përshtatur botëkuptimit, sipas të cilit, deri në datën si më sipër asnjë gjykim sa i përket karakterit të luftës në ish-Jugosllavi nuk ishte dhënë. Kjo domethënë se deri më datën 1 janar 1991 nuk ka pasur asnjë cilësim lidhur me atë nëse konflikti në ish-Jugosllavi ishte një konflikt i brendshëm apo konflikt ndërkombëtar.

Për sa i përket kompetencës konkurrente, në nenin 9 të Statutit iu është dhënë përparësi Gjykatës Ndërkombëtare përpara kompetencës së gjykatave nacionale. Në këtë kontekst, duhet kuptuar edhe kërkesa e Prokurorit të Gjykatës, z. Richard J. Goldstein (Riçard Goldstajn), bërë më datën 15 maj 1995,[523] me të cilën kërkohet që gjykatat dhe organet e tjera të Bosnjë-Hercegovinës të mos ndjekin liderin e serbëve të Bosnjë-Hercegovinës, Radovan Karaxhiq (Radovan Karadžić), meqë prokurori mendonte që së shpejti do ta fuste atë në listën e kriminelëve të luftës, së bashku me disa anëtarë të suitës së tij. Në korrik u konfirmua edhe zyrtarisht se z. Goldstein i ka akuzuar formalisht R. Karaxhiqin, Ratko Mlladiqin (Ratko Mladić) dhe Millan Martiqin (Milan Martić), së bashku me 12 serbë të tjerë të Bosnjë-Hercegovinës.[524] Sipas njoftimeve të dhëna në seancën e parë publike të mbajtur në Gjykatë, deri më tani po hetohen për krime lufte 22 serbë, prej të cilëve vetëm një është i pranishëm fizikisht, kurse më datën 9 maj 1995, prokurori ka

[523] *EuroNews*, 15 maj 1995, 16:30 CET.
[524] *EuroNews,* 25 korrik 1995, 16:00 CET.

kërkuar lejen për fillimin e hetimeve edhe kundër disa njësive kroate për masakrat e kryera në Mostar.[525]

Respektimi i parimit *ne bis in idem*, përkatësisht se askush nuk mund të gjykohet dy herë për të njëjtën vepër penale, është sanksionuar në nenin 10 të Statutit të Gjykatës.

5.3. Organizimi i Gjykatës

Organizimi i saj reflekton funksionet që kryen: e formuar për të ndëshkuar personat përgjegjës për lëndimet serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare, Gjykata është e përbërë nga trupi gjykues, prokurori dhe sekretaria (neni 11 i Statutit të Gjykatës).

Trupi gjykues përbëhet prej 11 gjyqtarëve dhe ndahet në trupin gjykues që shqyrton çështjen në shkallë të parë dhe trupin gjykues që shqyrton çështjen sipas apelit (ankesës). Këta gjyqtarë, bazuar në nenin 15 të Statutit, nxjerrin rregullat e procedurës dhe ato mbi të provuarit me qëllim të udhëheqjes së fazës përgatitore, të fazës për shqyrtimin kryesor, fazës së apelit, pranimit të provave, mbrojtjes së viktimave dhe të dëshmitarëve, sikur edhe të çështjeve të tjera të rëndësishme lidhur me udhëheqjen e procedurës. Këto rregulla janë nxjerrë në shkurt të vitit 1994. Vlen të theksohet se Rregullat e Procedurës dhe mbi të Provuarit i përkasin, në pjesën dërmuese, sistemit anglosakson të së drejtës.

Prokurori është përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen e personave përgjegjës për lëndimet serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë prej l janarit të vitit 1991 (neni 16 i Statutit). Ai vepron si organ i pavarur i Gjykatës. Prokurori, instruksionet i merr nga secila qeveri apo burim tjetër, kurse zgjedhjen e prokurorit e bën Këshilli i Sigurimit i OKB-së në bazë të nominimit paraprak të bërë nga Sekretari i Përgjithshëm (neni 16 i Statutit të Gjykatës).

Sekretaria e Gjykatës është përgjegjëse për t'i shërbyer Gjykatës, kurse e udhëheq Sekretari (neni 17 i Statutit të Gjykatës).

5.4. Hetuesia dhe procedura përgatitore

Prokurori inicion hetimet *ex officio*, zyrtarisht, ose në bazë të informatave të marra nga çfarëdo burimi, e veçanërisht nga qeveritë e shteteve, organet e OKB-së, organizatat qeveritare dhe joqeveritare. Prokurori vlerëson nëse in-

---

[525] *Radio Zëri i Amerikës* (në gjuhën shqipe), 9 maj 1995, 18:00 CET.

formacioni i marrë është i mjaftueshëm për të vënë në lëvizje procedurën hetimore, dhe merr vendim të veçantë për një gjë të tillë (neni 18 i Statutit të Gjykatës).

Nëse prokurori vendos për ngritjen e aktakuzës, atëherë ajo i dërgohet trupit gjykues të shkallës së parë (neni 18, pika 4 e Statutit), kurse vetë Gjykata, sipas kërkesës së prokurorit, mund të lëshojë urdhëresë për arrestim, mbajtje, dorëzim ose përcjellje të personave të akuzuar (neni 19, pika 2 e Statutit).

5.5. Procedura për shqyrtimin kryesor të çështjes dhe pas tij

Personi kundër të cilit është ngritur aktakuza duhet, sipas urdhëresës së Gjykatës, të mbahet në paraburgim dhe të informohet për akuzat kundër tij dhe duhet që t'i dorëzohet Gjykatës nëse është në mbajtje në një shtet tjetër (neni 20 i Statutit). Nga përmbajtja e nenit në fjalë del se gjykimi nuk mund të fillojë deri kur i akuzuari të jetë prezent fizikisht para Gjykatës. Lidhur me këtë, ekziston një mendim i përhapur ndër juristë ndërkombëtarë se gjykimi në mungesë nuk ka mundur të parashikohet në Statutin e Gjykatës si pasojë e nenit 14 të Konventës së OKB-së për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1996, i cili parasheh se të akuzuarit i duhet dhënë mundësinë e gjykimit në praninë e tij.

Nga kjo shihet qartë se Gjykata nuk ka kompetencë të gjykimit në mungesë të të akuzuarve. Kjo dhe rrethana e vështirësisë së sjelljes në gjykatë të të akuzuarve për krimet e luftës, përshirë këtu edhe mënyrën e mbledhjes së provave në terren, lënë pak vend për optimizëm se gjykimi i tyre do të ketë efekt të madh.[526] Megjithatë duhet pranuar se, në mos asgjë tjetër, ky gjyq do të ketë për rrjedhojë kompromet imin e tërësishëm të luftës së serbëve të Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë dhe kualifikimin e saj ashtu siç duhet, luftë agresive dhe me qëllime të robërimit të popujve të tjerë dhe shfarosjes së tyre fizike. Tek e fundit, edhe pas Luftës së Dytë Botërore, një pjesë e "kriminelëve të vegjël" i patën shpëtuar gjykimit, mirëpo ata kryesorët qenë ndëshkuar. Gjithashtu, kur kësaj i shtohet edhe fakti se çfarë fati pësoi populli gjerman pas Luftës së Dytë Botërore, atëherë konstatimi ynë del i qëlluar.

Gjykata e shkallës së parë (ose gjykata e çështjes) ka të drejtën e dhënies së aktgjykimit dhe të drejtën e sanksioneve (dënimeve) për personat, të cilët kanë kryer lëndime serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Aktgjyk-

[526] Të këtij mendimi janë edhe Karine Lescure et al., *Le Tribunal pénal international,* fq. 131 e tutje.

imit jepet me shumicë votash (neni 23 i Statutit) dhe duhet të jetë i arsyetuar, kurse si sanksion i vetëm mund të jetë dënimi me burg, kohëzgjatja e të cilit bazohet në praktikën e gjykatave të ish-RSFJ-së (neni 24, pika 7 e Statutit të Gjykatës). Vuajtja e dënimit me burg kryhet në shtetin e caktuar nga ana e Gjykatës, i cili zgjidhet prej listës së atyre shteteve të cilët kanë shprehur gatishmëri për të pranuar vuajtjen e dënimit për personat e dënuar për krime të luftës (neni 27 i Statutit të Gjykatës).

Në nenet 25 dhe 26 të Statutit të Gjykatës janë të parashikuara e drejta e apelit (ankesës) dhe e revizionit. Ankesa i dërgohet trupit gjykues ankimor, si i shkallës së dytë, dhe mund të bazohet në zbatimin e gabuar te së drejtës materiale dhe në konstatimin e gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike (neni 25). Kurse procedura e revizionit mund të vihet në lëvizje nëse pas përfundimit të gjykimit konkret janë zbuluar fakte dhe prova të reja (neni 26 i Statutit). Në nenin 28 të Statutit parashihet institucioni i faljes dhe ai i zbutjes së dënimit.

5.6. Bashkëpunimi dhe ndihma juridike

Krijimi i kësaj gjykate në bazë të Kreut VII të Kartës së OKB-së shtron detyrim të obligueshëm për të gjitha shtetet që të ndërmarrin çdo masë që kërkohet me qëllim të vënies në jetë të vendimeve të Gjykatës. Në kuptimin praktik, kjo do të thotë se të gjitha shtetet janë të obliguara të bashkëpunojnë dhe ta ndihmojnë Gjykatën për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi në të gjitha fazat e procedurës. Të gjitha këto çështje janë të sanksionuara në nenin 29 të Statutit të Gjykatës, i cili thotë si vijon:

> 1. [...] shtetet do të bashkëpunojnë me Gjykatën në procesin e ndjekjes dhe hetimit të personave të akuzuar për krimet serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare në territorin e ish-Jugosllavisë;
> 2. shtetet do të zbatojnë pa zvarritje çdo kërkesë për ndihmë apo urdhëresë të lëshuar nga trupi gjykues i shkallës së parë, të cilat i referohen:
>
> a. identifikimit dhe lokalizimit të personave;
> b. marrjes së dëshmisë dhe ofrimit të provave;
> c. ofrimit të dokumentacionit;
> d. arrestimit ose mbajtjes së personave;
> e. dorëzimit ose bartjes së personave të akuzuar pranë Gjykatës.

5.7. Dispozitat e përgjithshme

Dispozitat e përgjithshme (nenet 30-34 të Statutit) i referohen statusit, privilegjeve dhe imunitetit të Gjykatës, selisë së Gjykatës, shpenzimeve, gjuhës dhe raportit vjetor të Gjykatës.

Lidhur me privilegjet dhe imunitetin e Gjykatës, në tërësi zbatohen dispozitat e Konventës mbi Privilegjet dhe Imunitetet e OKB-së, datë 13 shkurt 1946. E njëjta vlen edhe për prokurorinë dhe personelin e saj, sekretarinë dhe personelin e saj (neni 30, pikat 1-3 të Statutit). Kurse personave të tjerë, përfshirë këtu edhe të akuzuarit, u jepet një trajtim, i cili është i domosdoshëm për funksionimin e Gjykatës (neni 30, pika 4 e Statutit).

Lidhur me çështjen e caktimit të selisë së Gjykatës janë marrë parasysh disa elemente para se të përcaktohej Haga si seli e kësaj gjykate. Këto elemente (neni 31 i Statutit) i referohen drejtësisë dhe ndershmërisë, efektivitetit dhe ekonomizimit.

Në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, të cekur më herët, është theksuar se elementi i drejtësisë dhe ndershmërisë nuk do të plotësohej sikur selia e Gjykatës të ishte në territorin e ish-Jugosllavisë ose në ndonjë prej vendeve fqinje të ish-Jugosllavisë. Ndërsa, për arsye të efektivitetit dhe ekonomizimit, thuhet më tej në raport, do të ishte më e dobishme vendosja e selisë së Gjykatës në ndonjë prej vendeve të Bashkësisë Evropiane në të cilat OKB-ja veç ka prezencë të konsiderueshme. Dy qendra plotësonin kriteret e cekura, Gjeneva dhe Haga, dhe më në fund u vendos të jetë Haga seli e Gjykatës për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi.

Shpenzimet e Gjykatës barten nga OKB-ja, përkatësisht nga buxheti i saj në pajtim me nenin 17 të Kartës së OKB-së (neni 32 i Statutit).

Si gjuhë pune të Gjykatës janë gjuha angleze dhe franceze (neni 33 i Statutit të Gjykatës), kurse një herë në vit, Gjykata i paraqet raport mbi punën e vet Këshillit të Sigurimit dhe Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

6. Krimet e kryera ne Kosovë në kontekstin e gjykatave të Hagës

Në Kosovë, sikundër është e njohur, që nga momenti i okupimit të saj në Luftërat Ballkanike më 1912-1913, ekziston një politikë dhe praktikë me tendencë të shfarosjes së shqiptarëve — dhe, jo vetëm në Kosovë, por edhe në trojet e tjera etnike të mbetura nën sundimin e ish-Jugosllavisë (Serbi, Mal i Zi, Maqedoni), sikundër edhe në Greqi. Forumet e ndryshme ndërkombëtare për gjendjen në Kosovë janë deklaruar sa e sa herë se ekziston një shkelje

sistematike e të drejtave të njeriut dhe atyre kombëtare të shqiptarëve në trojet e tyre etnike. Mirëpo, për aktivizimin e procedurës para gjykatave të Hagës nevojitet plotësimi i disa kushteve legale të cilat ne do t'i trajtojmë në vijim.

6.1. Gjykata për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi

Sikundër është vërejtur nga shqyrtimet tona paraprake, kjo gjykatë në rend të parë ka për qëllim përcaktimin e përgjegjësisë individuale, jo të asaj shtetërore. Me fjalë të tjera, procedura pranë kësaj gjykate mund të vihet në lëvizje kundër individëve, zyrtarëve lokalë dhe agjentëve të tyre ekzekutues (p.sh., anëtarët e policisë, të forcave të armatosura ushtarake dhe paraushtarake) ose kundër anëtarëve të lidershipit politik, dhe jo kundër qeverisë shtetërore. Kompetenca territoriale të kësaj gjykate shtrihet ndaj Kosovës përderisa në Statutin e saj është thënë se ajo ka autorizimin e gjykimit të personave përgjegjës për lëndimet e rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë prej datës 1 janar 1991.

E drejta (ligji) ndërkombëtare, e cila do të zbatohet nga ana e Gjykatës, sikundër u cek me herët, ka të bëjë me:

- shkeljet serioze të Konventave të Gjenevës të vitit 1949;
- shkeljet serioze të ligjeve dhe të zakoneve të luftës;
- krimin e gjenocidit; dhe
- krimet kundër njerëzimit.

Ky lloj i krimeve, përkatësisht i dispozitave të cilat normojnë të drejtën që zbatohet për vënien në lëvizje të procedurës gjyqësore dhe sanksionet për shkeljen e tyre, paraqet një pengesë serioze juridike për Kosovën. Kjo nga shkaku se, kur flitet për krimet kundër njerëzimit, rëndom theksohet se veprimet në fjalë duhet të jenë të kryera "në kohën e konfliktit të armatosur". Në mënyrë të ngjashme, Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe ligjet e zakonet e luftës, në përgjithësi, kërkojnë ekzistimin e një "konflikti të armatosur" si kusht për zbatimin e tyre.

Kosova, siç shihet nga disponimi i bashkësisë ndërkombëtare, tani për tani nuk paraqet palë ndaj së cilës do të mund të zbatohej e drejta e konflikteve të armatosura ndërkombëtare. Zakonisht, lidhur me Kosovën, thuhet se është pjesë e së a.q. Jugosllavi (Serbia dhe Mali i Zi). Edhe më vështirë do të ishte argumentimi se e drejta (ligji) për konfliktet e brendshme të armatosura duhet të aplikohet në Kosovë. Kjo nga shkaku se kjo e drejtë (ligj) është më e kufizuar dhe nuk është e domosdoshme të përfshijë dispozitat për "lëndimet serioze dhe të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare", sepse, thjesht,

në Kosovë nuk ka pasur konflikt të brendshëm të organizuar në nivel të mjaftueshëm, i cili kërkohet për raste të tilla.

Kur flitet për krimin e gjenocidit, atëherë duhet theksuar se ai, sipas kritereve të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare, mund të kryhet edhe gjatë kohës kur nuk ekziston "konflikti armatosur". Rrjedhimisht, kjo pjesë e së drejtës (ligjit) ndërkombëtar mund të zbatohet në rastin e Kosovës me kusht që veprimet e krimit të gjenocidit të jenë në vijim e sipër. Mirëpo, edhe me këtë rast ekzistojnë vështirësi, sepse definicioni i gjenocidit është i një natyre të lartë teknike, dhe është e kontestueshme nëse situata në Kosovë përfshihet me këtë term, ashtu siç mund të interpretohet ai nga ana e organizmave ndërkombëtarë (dhe rëndom, gjenocidi interpretohet me një stërhollim të veçantë). Pas Luftës së Dytë Botërore, ekzistojnë raste të shumta në vende të ndryshme të botës ku janë kryer veprimet e gjenocidit, por që bashkësia ndërkombëtare si të tilla ka kualifikuar vetëm dy raste: Bosnjë-Hercegovinën dhe Ruandën.

Përkundër tërë kësaj, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1 të Statutit të Gjykatës për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, sipas të cilit "hetimet mund të iniciohen nga çdo burim", qeveria e Republikës së Kosovës i ka dorëzuar prokurorit të Gjykatës për Krimet në ish-Jugosllavi materialin provues të përgatitur më datën 9 dhjetor 1992 nga Këshilli i Prishtinës për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, për të dëshmuar kështu mbi gjenocidin serb që po ushtrohet ndaj popullatës shqiptare në Kosovë. Qëndron te prokurori i Gjykatës që të ekzaminojë materialin në fjalë dhe të vendosë nëse ekziston ose jo *prima facie* krimi i gjenocidit serb kundër shqiptarëve në Kosovë (neni 18, pika 4 e Statutit). Deri më sot, lidhur me këtë çështje, prokurori është prononcuar vetëm njëherë dhe atë në letrën e datës 17 mars 1995, përmes së cilës e informon ministrin e qeverisë së Kosovës, z. Xhafer Shatri, se ka marrë materialin në fjalë dhe se më tutje do të veprohet sipas dispozitave mbi punën e Gjykatës dhe Prokurorisë.

Duke qenë se kjo gjykatë i referohet përcaktimit të përgjegjësisë individuale, siç u cek, atëherë duhet të thuhet se Rregullat e Procedurës dhe Rregullat mbi të Provuarit kërkojnë mbledhjen e fakteve, lidhur me lëndimet serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare, sipas standardeve të pranuara në pikëpamje të së drejtës ndërkombëtare. Këto fakte, si rregull, duhet të emërojnë personin përgjegjës për lëndimet serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare, pohimet e detajuara dhe natyrën e mjetit provues i cili shkon në favor të akuzimit të personit të caktuar, sikundër dhe përcaktimin e asaj se

përse dhe si ai person është i përzier në veprimet të cilat paraqesin lëndime serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

6.2. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

Vetëm shtetet mund të jenë palë në çështjet që paraqiten para kësaj gjykate (neni 31 i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë). Bazuar në gjendjen e gjërave tani për tani, vetëm Shqipëria mund të bëjë një gjë të tillë. Kurse, bazuar në praktikën me rastin e Bosnjë-Hercegovinës, i cili u shqyrtua më herët, si palë kundërshtare do të ishte e a.q. Jugosllavi (Serbia dhe Mali i Zi). Mirëpo, problemi i themelimit të kompetencës para kësaj gjykate është një proces mjaft teknik dhe i komplikuar.

Kushti i parë i cili kërkohet për vënien në lëvizje të kësaj procedure është pëlqimi. Juridiksioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë "është i kufizuar dhe është pashmangësisht i lidhur me pëlqimin e palës kundërshtare. Ai ekziston vetëm nëse ky pëlqim është dhënë nga ana e palës kundërshtare [...]."[527] Kjo nga shkaku se "juridiksioni i Gjykatës për të shqyrtuar dhe vendosur me të drejtë lidhur me çështjen e caktuar varet nga vullneti i palëve".[528]

Ekzistojnë disa mënyra për të dhënë pëlqimin si mënyrë për themelimin e juridiksionit të Gjykatës, të cilat janë të parashikuara në nenin 36 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Juridiksioni (kompetenca) e Gjykatës shtrihet mbi të gjitha çështjet:

1.

Çështjet të cilat shtetet anëtare (dhe ato joanëtare, bazuar në nenin 35, pikat 2 dhe 3 të Statutit) i paraqesin para saj për zgjidhje. Në këtë rast juridiksioni themelohet përmes marrëveshjes speciale të lidhur mes palëve. Përmes kësaj marrëveshjeje, palët mbajnë në kontroll disa aspekte të procedimit para Gjykatës. Ato mund ta kufizojnë juridiksionin e Gjykatës vetëm ndaj çështjeve specifike dhe të veçanta dhe Gjykata nuk mund t'i kalojë kufijtë e juridiksionit të themeluar në këtë mënyrë nga ana e vetë palëve. Në momentin e tanishëm është vështirë të besohet se e ashtuq. Jugosllavi (Serbia dhe Mali i Zi) do të pajtohej të ishte palë kundërshtare e shtetit shqiptar për të themeluar juridiksionin e kësaj gjykate lidhur me Kosovën;

---

[527] *Mavrommatis Case*, PCIJ ser. A, nr. 2, fq. 16.
[528] *Anglo-Iranian Oil Co. Case*, ICJ (1952) fq. 103.

2.

Çështjet të cilat janë të parashikuara shprehimisht në Kartën e OKB-së. Në teori dhe në praktikën e kësaj gjykate është kontestuese nëse kjo dispozitë i referohet të drejtës së Këshillit të Sigurimit që të rekomandojë ose edhe të detyrojë paraqitjen e kontestit të caktuar mes shteteve para Gjykatës, kontest i cili rrezikon paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Nëse kjo do të ishte e vërtetë, atëherë Këshilli i Sigurimit do mundej, pa pëlqimin e palëve, të themelonte juridiksionin e Gjykatës. Mirëpo, Gjykata i është shmangur prononcimit lidhur me këtë mënyrë të themelimit të juridiksionit, në rastin e Kanalit të Korfuzit. Në vend që të shqyrtonte natyrën juridike të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit, e cila rekomandonte parashtrimin e çështjes para Gjykatës për zgjidhje, Gjykata u mbështet në provën mbi vullnetin e Shqipërisë për të themeluar juridiksionin lidhur me çështjen e sipërcekur;[529]

3.

Çështjet të cilat janë të parashikuara shprehimisht në traktatet ose konventat në fuqi. Futja e të a.q. klauzolave të kompromisit është bërë mjaft e popullarizuar në dritën e dështimit të bashkësisë ndërkombëtare për t'u pajtuar me të a.q. klauzolat e mundshme (për të cilat do të flitet në vijim). Ideja e kësaj mënyre është themelimi i juridiksionit që më parë ose së paku në disa lëmenj të caktuar. Mirëpo, në disa marrëveshje të caktuara parashihet si e mundshme, pjesëmarrja në klauzolat e kompromisit, ashtu që nuk ka garanci se të gjitha palët në marrëveshje do të sillen para Gjykatës. Sidoqoftë, klauzolat e kompromisit kanë shërbyer si bazë për themelimin e juridiksionit në ato raste kur mënyrat e tjera kanë dështuar. Si rast tipik i kësaj është Rasti i Pengjeve. Aty, ShBA ka mundur të bazohet vetëm në pjesëmarrjen e Iranit në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike dhe Konsullore. Për të shfrytëzuar këtë mënyrë, përndryshe të përshtatshme, të themelimit të juridiksionit lidhur me Kosovën, duhen shikuar së pari të gjitha konventat dhe traktatet në të cilat është palë Shqipëria dhe e a.q. Jugosllavi (Serbia dhe Mali i Zi), dhe të veçohen çështjet të cilat mendohen të ngrihen pranë kësaj gjykate. Pastaj, duhet të shikohet nëse këto marrëveshje përmbajnë klauzolat e kompromisit dhe nëse ato janë të pranuara nga të dy palët apo ndoshta ekzistojnë rezervat përkatëse të bëra nga ndonjëra palë.

Kur jemi këtu, te pika e tretë si më sipër, vlen të përsërisim se Konventa mbi Gjenocidin përmban klauzolën e kompromisit dhe se gjykimi në vijim

[529] *Corfu Channel Case*, ICJ (1948).

(për të cilin u fol më herët) i Bosnjë-Hercegovinës kundër RFJ-së (Serbi dhe Malit të Zi) bazohet pikërisht mbi këtë klauzolë. Sidoqoftë, sikur u cek edhe më herët, nuk do të ishte i lehtë rasti i parashtrimit të kërkesës për gjenocidin në Kosovë pranë kësaj gjykate, duke e marrë parasysh anën teknike mjaft të komplikuar të këtij nocioni. Konventat e tjera, të cilat do mund të ishin bazë për themelimin e juridiksionit, janë: Konventa Kundër Torturës, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventa Ndërkombëtare mbi Ndëshkimin dhe Çrrënjosjen e Krimit të Aparteidit, Konventa Kundër Diskriminimit në Edukim dhe Konventa mbi të Drejtat Politike të Gruas. Këto konventa përmbajnë klauzolën e kompromisit, dhe Shqipëria ka aderuar në to vitet e fundit.

4.

Çështjet kundrejt çdo shteti tjetër që pranon të njëjtin detyrim. Shtetet që janë palë të Statutit të Gjykatës kanë deklaruar se e njohin si të detyrueshme *ipso facto* dhe pa marrëveshje të veçantë juridiksionin e Gjykatës mbi të gjitha mosmarrëveshjet e natyrës juridike që kanë të bëjnë me:

a. interpretimin e një traktati;
b. çdo pikë tjetër të së drejtës ndërkombëtare;
c. ekzistencën e çdo fakti i cili, po u vërtetua ekzistenca e tij, do të përbënte shkelje të një detyrimi ndërkombëtar;
d. natyrën dhe madhësinë e një dëmshpërblimi i cili duhet dhënë për shkelje të një detyrimi ndërkombëtar.

Lidhur me këtë bazë për të themeluar juridiksionin që ka të bëjë me çështjen e Kosovës, duhet thënë se, fatkeqësisht, mësa jemi në dijeni, as Shqipëria e as ish-RSFJ nuk e kanë bërë.

5.

Juridiksioni mund të themelohet edhe joformalisht ose, nëse veç është themeluar, ai mund të zgjerohet me vullnetin e palëve edhe ndaj çështjeve të tjera.[530]

Në të gjitha rastet kur shtrohet në provë, çështja nëse Gjykata ka kompetencë ose jo, atëherë është në dorën e vetë Gjykatës që të përcaktojë kompetencën e saj (neni 36, pika 6 e Statutit). Përveç kësaj, Gjykata ndeshet edhe me të a.q. pranueshmëri të kërkesës për vënien në veprim të procedurës pra-

[530] Rasti *Upper Silesia*, PCIJ, ser. A. nr. 15, fq. 24-25; *Corfu Channel Case* [Rasti i Kanalit të Korfuzit], ICJ (1948) fq. 27; etj.

në kësaj gjykate. Apo, thënë me fjalë të tjera, Gjykata mund të jetë kompetente, por mund të mungojë interesi juridik nga ana e palës iniciuese për të ndjekur çështjen në Gjykatë.

Përveç zgjidhjes së kontesteve mes palëve, të cilat u theksuan më herët, Gjykata mund të japë edhe mendime këshillëdhënëse për çështjet e ndryshme juridike (neni 65 i Statutit të Gjykatës). Këto mendime mund të kërkohen nga ana e çdo organi ose institucioni të autorizuar nga OKB-ja e duke u bazuar në Kartën e saj.

Numri i madh i shteteve të përfaqësuara në organet e OKB-së të cilat janë të autorizuara për të kërkuar mendime këshillëdhënëse paraqet një pengesë serioze në rastin e Kosovës. Vështirë të besohet se shtetet e tilla do të pajtoheshin për të iniciuar një procedurë të tillë në favor të Kosovës, pasi ajo do të paraqiste një shembull i cili më vonë do të përdorej kundër vetë tyre. Megjithatë, si çështje konkrete, për të cilën vlen të mendohet dhe e cila do të mund të iniciohej pranë kësaj Gjykatë, kishte për të qenë ajo se çka nënkuptohet me kufij të RFJ-së (Serbisë dhe Mali të Zi), në njërën anë, dhe çfarë është statusi juridik i kufijve të Kosovës të përcaktuar, sikur edhe me rastin e njësive të tjera të ish-RSFJ-së, në bazë të Kushtetutës së fundit në fuqi me rastin e shpërbërjes së ish-RSFJ-së.

Shqyrtime përfundimtare

Bazuar në të drejtën ndërkombëtare (atë konvencionale dhe zakonore), përgjegjësia penale e individit ekziston si në rastin kur ai kryen krimet me vetiniciativë, ashtu edhe kur ato kryhen sipas urdhrave të të tjerëve (eprorëve). Ndërsa, për sa i takon mekanizmit institucional për dhënien e drejtësisë për veprat penale të karakterit ndërkombëtar, pra gjykatave, vlen të theksohet se tani për tani nuk ekziston një gjë e tillë. Dhe, në mungesë të tyre, shtetet kanë dy mundësi: ose vetë t'i dënojnë autorët e veprave të tilla, ose t'ua dorëzojnë ata shteteve, të cilët në një mënyrë ose tjetër, kanë kompetencë për dhënien e drejtësisë. Kjo në asnjë mënyrë nuk do të thotë se në të kaluarën nuk janë bërë përpjekje për institucionalizimin e së drejtës për ndëshkimin e autorëve të veprave penale ndërkombëtare. Kështu, pas Luftës së Parë Botërore me Marrëveshjen e Versajës për herë të parë u parashikua mundësia e formimit të një gjykate speciale për gjykimin e perandorit gjerman Vilhelmi II. Ky tentim nuk pati sukses meqenëse Holanda, si vendi ku ai strehohej pas luftës, refuzoi dorëzimin e tij.

Në anën tjetër, lidhur me përcaktimin e disa llojeve të veprave penale ndërkombëtare, bashkësia ndërkombëtare qysh në shekullin e kaluar sanksionoi disa prej tyre (p.sh., tregtinë me robër), në mënyrë që gjatë tërë këtij shekulli të vazhdonte punën për kodifikimin sa më përmbledhës të të gjitha veprave penale ndërkombëtare.

Lufta e Dytë Botërore, përkatësisht fati i saj, ishte faktori kryesor i cili edhe solli për herë të parë deri në formimin e një gjykate penale ndërkombëtare, gjykatave të Nyrnbergut dhe të Tokios, duke u bazuar në Deklaratën e Moskës dhe Marrëveshjen e Londrës të Fuqive Aleate. Gjatë këtij gjykimi, morën formë tri lloje të veprave penale ndërkombëtare: krimet kundër luftës, krimet kundër paqes dhe krimet kundër njerëzimit. Po në këtë gjykim, u përcaktuan rrugët edhe për parimin *nullum crimen sine lege* dhe për atë të mosvjetërsimit të veprave penale ndërkombëtare në planin ndërkombëtar. Pjesa dërmuese e shteteve, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, futi në legjislacionet e tyre penale veprat e sipërcekura, kurse praktika gjyqësore nacionale, edhe pse e rrallë, u bazua në parimet e Gjykatës së Nyrnbergut.

Pas Luftës së Dytë Botërore, ideja për një gjykatë penale ndërkombëtare, si të përhershme, mbeti e gjallë gjatë tërë kohës. U nxorën një sërë konventash dhe dokumente të tjera ndërkombëtare, të cilët sanksionuan veprat e ndryshme penale ndërkombëtare. Në këtë kontekst, ishte Konventa mbi Gjenocidin ajo e cila e para parashikoi formimin e një gjykate të tillë. Mirëpo, kjo nuk u realizua kurrë.

Një kontribut të çmueshëm në drejtim të kristalizimit të idesë për një institucion penal ndërkombëtar ka dhënë dhe vazhdon të japë Komisioni për të Drejtën Ndërkombëtare i OKB-së, i cili gjatë gjithë kohës së pasluftës ka pasur, pa ndërprerje, në rend të ditës Projekt-kodin për krimet kundër paqes dhe sigurisë së njerëzimit dhe atë për formimin e një gjykate penale ndërkombëtare, si institucion të përhershëm.

Ngjarjet e fundit në ish-Jugosllavi e kanë riaktualizuar çështjen e krijimit të kësaj gjykate. Masakrat e kryera në Bosnjë-Hercegovinë nga ana e serbëve të Bosnjës dhe të Serbisë dhe Malit të Zi, si dhe ato të kryera në Ruanda, e përshpejtuan Këshillin e Sigurimit që të ndërmarrë vendimin për formimin e gjykatave *ad hoc* për krimet e kryera në vendet e cekura. Ndërkohë, Bosnjë-Hercegovina, pas njohjes së saj si shtet dhe anëtarësimit në OKB, bëri kërkesë pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, lidhur me krimin e gjenocidit të kryer në Bosnjë-Hercegovinë nga ana e Serbisë dhe Malit të Zi (1993). Duhet thënë se kjo gjykatë, si e përhershme, nuk është gjykatë penale dhe se nuk është në kompetencë të saj ndëshkimi i shteteve ose personave, p-

or vetëm dhënia e aktgjykimeve dhe mendimeve këshillëdhënëse lidhur me çështje të caktuara juridike. Në rastin e Bosnjë-Hercegovinës, kjo gjykatë duhet të deklarohet në mënyrë të merituar nëse ekziston ose jo shkelja e Konventës mbi Gjenocidin e vitit 1948. Mirëpo, duke marrë parasysh autoritetin që ka kjo gjykatë, atëherë, mund të thuhet se vendimi i saj, qoftë në formën e aktgjykimit, mendimit apo të urdhëresave mbi masat e përkohshme, kanë vlerë të madhe kundruall vendimeve (eventuale) të Gjykatës për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi.

Gjykata për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi është formuar më datën 25 maj 1993 në bazë të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së Nr. 827. Gjykata ka Statutin dhe Rregullat e Procedurës dhe mbi të Provuarit. Vendimi për të formuar këtë gjykatë është marrë më datën 22 shkurt 1993 me Rezolutën Nr. 808 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Detyrë kryesore e kësaj gjykate është përcaktimi i përgjegjësisë penale individuale të personave për "lëndime serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare". Mirëpo, kjo kurrsesi nuk do të thotë se dënimi i personave për këto krime liron shtetet dhe popujt të cilëve ata iu përkasin nga përgjegjësia. Me fjalë të tjera, gjykimi (eventual) i liderëve serbë dhe i të tjerëve do të ketë për pasojë kompromet imin e luftës në Bosnjë-Hercegovinë dhe kualifikimin e saj si luftë agresive dhe me qëllim të shfarosjes së popujve të tjerë, luftë kjo e nxitur dhe e udhëhequr nga Serbia dhe Mali i Zi kundër popullit dhe shtetit të Bosnjë-Hercegovinës. Rrjedhimisht, autori i këtyre rreshtave nuk e konsideron si të kotë formimin e kësaj gjykate, siç thonë disa ndër ne këtyre ditëve. Kur kësaj i shtohet edhe fakti se ajo është formuar duke u bazuar në Kreun VII të Kartës së OKB-së, përkatësisht me qëllim të ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, atëherë konstatimi se kjo gjykatë është e pavlerë del, domosdo, si i gabueshëm. Dhe, jo vetëm kaq. Duhet ditur se zgjidhja e krizës në ish-Jugosllavi nuk është duke u zhvilluar jashtë disa rregullave të qëndrueshme të lojës, aspekti juridik i të cilave është, së paku deri më sot, duke luajtur një rol mjaft të madh. Analizimi i këtyre rregullave dhe nxjerrja e konsekuencave përkatëse për një sjellje konform tyre, është rruga më e preferuar për subjektet shtetërore dhe politike në Kosovë — dhe jo vetëm në Kosovë.

Qeveria e Republikës së Kosovës i ka parashtruar Gjykatës për Krimet e Luftës në-ish-Jugosllavi një material mbi krimet e bëra nga ana e pushtetit serb të instaluar në Kosovë kundër popullsisë shqiptare. Dhe, kjo është bërë duke u bazuar në dispozitën përkatëse të Statutit i cili u referohet "krimeve të kryera në ish-Jugosllavi që nga data 1 janar 1991". Mirëpo, deri më sot, nuk

kemi të dhëna se diçka është vënë në lëvizje, përveç një konfirmimi nga ana e prokurorit të kësaj Gjykate se materialet në fjalë janë marrë.

Dhe, kur jemi këtu, vlen të ritheksohet se e drejta e a.q. materiale, të cilën e zbaton Gjykata për rastet e caktuara, vështirë se mund të zbatohet në rastin e Kosovës, pasi nuk ekziston "konflikti i armatosur" si kusht elementar për t'u zbatuar kjo e drejtë (ligj). Përjashtim të kufizuar bën rasti i Konventës mbi Gjenocidin, edhe përkundër faktit se definicioni i gjenocidit, bazuar në teorinë dhe praktikën e deritanishme ndërkombëtare, është mjaft i komplikuar dhe teknik. Këtë e dëshmojnë edhe rastet e shumta faktike të krimeve të gjenocidit të kryera pas Luftës së Dytë Botërore në vendet e ndryshme të botës, por që nuk u kualifikuan si të tilla dhe, për pasojë, as konventa në fjalë mbi gjenocidin nuk u zbatua asnjëherë.

Edhe mbledhja dhe prezantimi i fakteve para kësaj gjykate është një çështje e komplikuar dhe kërkon një zbatim të përpiktë të rregullave standarde të së drejtës ndërkombëtare mbi të provuarit.

Kur është fjala për Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, pengesa e parë lidhur me Kosovën është se vetëm shtetet e pranuara në pikëpamje ndërkombëtare mund të jenë palë pranë kësaj Gjykate. Aktualisht, i vetmi subjekt i tillë është Republika e Shqipërisë. Mirëpo, duke u bazuar në të drejtën (ligjin) materiale që do të zbatohej në rastin e Kosovës — Konventën mbi Gjenocidin, në të cilën Shqipëria moniste ka vënë rezervën — atëherë edhe në këtë drejtim del vështirësia e pakalueshme. Pikat e tjera, lidhur me themelimin e juridiksionit pranë kësaj Gjykate dhe të drejtën (ligjin) që do të zbatohej në rastin e Kosovës, ndjekin fatin e pikës e cila i referohet gjenocidit.

II. Muri i jashtëm i sanksioneve

Hyrje

Në një dosje të USIA-së (*United States Information Agency* — Agjencia Amerikane e Informimit), lëshuar më datën 23 nëntor 1995, u bë publik, për herë të parë, termi "muri i jashtëm i sanksioneve"[531]. Aty u tha ky mesazh:

[531] Cf. USIA (United States Information Agency), *Wireless File*, November 23, 1995, fq. 38-39. Teksi në dosjen e autorit, i kopjuar nga Ministria e Jashtme e Shqipërisë.

> Një rezolutë do të paraqitet pranë Këshillit të Sigurimit të OKB-së me qëllim të heqjes së embargos së armëve kundër të gjitha shteteve të ish-Jugosllavisë. Sanksionet tregtare kundër Serbisë do të pezullohen, por mund të rivihen sërish nëse Serbia apo ndonjë nga autoritete serbe në rajon dështon në mënyrë të rëndësishme për t'i përmbushur detyrimet që i ka sipas Marrëveshjes së Dejtonit. Një "mur i jashtëm i saknsioneve" do të ngelet derisa Serbia të mos adresojë një numër çështjesh për të cilat ka brenga dhe që janë me interes, përfshirë këtu Kosovën dhe bashkëpunimin me Gjykatën Për Krime të Luftës.

Ky mesazh si më sipër kishte kuptimin se nënshkrimi i Marrëveshjes së Dejtonit sikur e ka transformuar Sllobodan Milosheviqin në një krijues të paqes në Bosnjë-Hercegovinë. Për pasojë, në fillim, KS i OKB-së pezulloi dhe më vonë në tërësi hoqi sanksionet kundër RFJ-së, ashtu siç u përshkrua më lartë. Kjo u bë me rezolutat nr. 1022 (datë 22 nëntor 1995) dhe nr. 1047 (1 tetor 1996)[532].

Duke marrë parasysh këtë rrjedhë të ngjarjeve, mbase më mirë do të ishte sikur ta kishim titulluar këtë punim ashtu që të përfshiheshin të gjitha aspektet që i takojnë konceptit "muri jashtëm i sanksioneve". Kjo për arsye se bazat e problematikës që diskutohen këtu janë vënë që në fillim të krizës në ish-Jugosllavi më 1990-1991 dhe i prekin të gjitha ish-republikat jugosllave. Vetëm RFJ paraqet rastin ekstrem të një entiteti shtetëror ish-jugosllav i cili vepron kundër standardeve të pranuara në planin ndërkombëtar lidhur me kriteret juridiko-ndërkombëtare mbi shpërbërjen e ish-Jugosllavisë. Këto çështje do të diskutohen në vijim. Megjithatë, ky titull i këtij punimi nuk i përfshin të gjitha segmentet e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë.

Këtu duhet të theksohet, në vijim sa më sipër, se përveç Marrëveshjes së Dejtonit dhe kushtet që RFJ duhet t'i plotësojë sa i përket bashkëpunimit me Gjykatën për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, çështjet e tjera lidhur me territorin e ish-Jugosllavisë ngelin të njëjta me ato që kanë pasur të bëjnë dhe janë plotësuar nga ish-republikat jugosllave. Megjithatë, këtu fjala është për diçka tjetër. Kjo sepse kushtet e vëna ndaj RFJ-së janë të tjera dhe kanë për qëllim heqjen e "murit të jashtëm të sanksioneve", koncept ky i ri në territorin ish-jugosllav. Në këtë, një rol të madh luan çështja e Kosovës. Qasja e bashkësisë ndërkombëtare ndaj zgjidhjes së çështjes së Kosovës, si një ndër kushtet kryesore për heqjen e "murit të jashtëm të sanksioneve", vërehet lehtë nga reagimi i shpejtë i bashkësisë ndërkombëtare ndaj ngjarjeve të

[532] Dokumentet ofruar për autorin nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqiprisë.

dhunshme dhe dramatike që nisën në Kosovë shkurt të vitit 1998. Konflikti në Kosovë deri më tani ka marrë jetën e mbi 600 civilëve, kryesisht fëmijë dhe gra. Në deklaratën e Grupit të Kontaktit të shkurtit 1998, nuk u zu në gojë koncepti "muri i jashtëm i sanksioneve", ani se është thuajse e sigurt se ai paraqet, së paku për momentin, mjetin kryesor për t'i bërë presion regjimit në Beograd për zgjidhjen paqësore të çështjes së Kosovës. Ka qenë ky sfondi faktik mbi të cilin u ndërtua ideja jonë për vënien e titullit si më sipër të këtij punimi.

1. Filozofia e "murit të jashtëm të sanksioneve"

Koncepti "muri i jashtëm i sanksioneve" afekton, në rend të parë, anëtarësimin e RFJ-së në organizatat ndërkombëtare dhe qasjen e këtij shteti në institucionet ndërkombëtare financiare. Kjo e fundit paraqet burimin kryesor për ndihmën financiare që synon rimëkëmbjen ekonomike të RFJ-së. Sado që anëtarësimi i RFJ-së në organizatat ndërkombëtare dhe qasja e saj në organizatat financiare ndërkombëtare ka qenë e formuluar në terma politikë si "muri i jashtëm i sanksioneve", origjina e saj bazike dhe e vërtetë qëndron në dokumentet legale të nxjerra në fillim të krizës në ish-Jugosllavi, me fillim që nga mendimet e Komisionit Badinter. Përkundër disa premisave politike, ne argumentojmë në këtë shkrim se koncepti "muri i jashtëm i sanksioneve" reflekton elementet kryesore legale të regjimit aktual ndërkombëtar. Natyra e konceptit që diskutojmë reflekton mjetet që Perëndimi po i përdor për të detyruar RFJ-në që t'u përmbahet standardeve të sjelljes si shtet.

Demokracia, sundimi i ligjit dhe respekti për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve kanë qenë vlerat bazike të Perëndimit të cilat iu ofruan atyre republikave të ish-federatave komuniste të cilat dëshironin të bëhen të pavarura pas mbarimit të Luftës së Ftohtë. Përveç në mendimet e Komisionit Badinter, të dhëna në periudhën prej vitit 1991 deri më 1993, respekti për këto vlera është kërkuar edhe nga të a.q. Kriteret për Njohjen e Shteteve të Reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik (16 dhjetor 1991)[533]. Një qënd-

[533] Për dokumentet, shih Snežana Trifunovska, *Yugoslavia Through Documents: From its Creation to its Dissolution* (Kluwer Academic Publishers: The Hague, 1994) fq. 155. Për analizë akademike të tyre, shih: Alain Pellet, "L'activité de la Commission d'arbitrage de la Conférence européenne pour la paix en Yougoslavie", *Annuaire français de droit international* vol. XXXVIII (Paris, 1992) fq. 220-238; Marc Weller, "The International Response to the Dissolution of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia", *American Journal of Interna-*

rim i tillë është përsëritur që nga fillimi i krizës në ish-Jugosllavi në shumicën e dokumenteve ndërkombëtare, përfshirë së fundi edhe deklaratat e Grupit të Kontaktit për Krizën në Kosovë[534].

Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, RFJ-së nuk iu mohua e drejta për të qenë shtet. Për më tepër, RFJ ka marrë njohjen individuale si shtet sovran dhe i pavarur nga shumica e shteteve anëtare të bashkësisë ndërkombëtare. Ajo çfarë iu mohua RFJ-së ka pasur të bëjë me mënyrën e themelimit të saj më 27 prill 1992, si dhe me vetë mënyrën e qeverisjes me atë shtet. Mënyra jodemokratike e krijimit të këtij shteti ka pasur për synim presionin ndaj të tjerëve në ish-Jugosllavi dhe në bashkësinë ndërkombëtare që ta pranojnë atë si të vetmin trashëgimtar (suksesor) të ish-Jugosllavisë. Përveç mënyrës së themelimit, e cila kontestohet nga bashkësia ndërkombëtare, mënyra jodemokratike e qeverisjes me këtë shtet, moszbatimi i detyrimeve ndërkombëtare që dalin nga Marrëveshja e Dejtonit, si dhe represioni i lartë në Kosovë ndaj popullsisë shumicë shkojnë kundër parimeve që RFJ duhet t'i respektojë deri në fund në marrëdhëniet e saj me bashkësinë ndërkombëtare. Kjo është filozofi e vlerave perëndimore lidhur me mënyrat dhe mjetet që duhet të ndiqen nga të gjithë që synojnë realizimin e vetëvendosjes, përkatësisht shtetësinë e pavarur. Këto vlera, në fakt, përbëjnë thelbin e konceptit "muri i jashtëm i sanksioneve". Qëllim i vetëm i "murit të jashtëm të sanksioneve" është që të paralizojë sjelljen kundër standardeve ndërkombëtare të sjelljes së RFJ-së si dhe ta detyrojë të njëjtën të sillet konform këtyre standardeve ndërkombëtare.

2. Bazat ligjore të konceptit

Në vijim, ne diskutojmë dokumentet legale dhe politike të cilat paraqesin themelet e "murit të jashtëm të sanksioneve". Ky diskutim mbulon mendimet nr. 8, 10 dhe 11 të Komisionit Badinter, Rezolutën Nr. 777 (1992) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, dhe, së fundi, Rezolutën Nr. 47/1 (1992) të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Bazuar në këto dokumente, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore (BB) miratuan dokumente të

---

tional Law vol. 86, no.3 (July, 1992) fq. 569-607; Kasim I Begić, *Bosna i Hercegovina od Vanceove misije do Daytonskog sporazuma* (Bosanska Knjiga: Sarajevo, 1997) fq. 31-44.

[534] Deklaratat për Kosovën të Grupit të Kontaktit, të datave 9 mars (takimi i Londrës), 15 e 25 mars, 29 prill, 9 maj, 12 qershor dhe 8 korrik 1998 (Bon, Gjermani). Në vijë me këto dokumente po ashtu është edhe Rezoluta e KS të OKB-së Nr. 1160 e datës 31 mars 1998.

duhura në të cilat u mishëruan bazat legale dhe politike të "murit të jashtëm të sanksioneve". Pa marrë parasysh që janë vendosur në mënyrë të njëanshme nga ana e ShBA-së, "muri i jashtëm i sanksioneve" në asnjë mënyrë nuk është kategori e pastër politike. Koncepti, siç u tha më sipër, "muri i jashtëm i sanksioneve" ka një bazë të fortë juridiko-ndërkombëtare që pikën nisëse e ka në Marrëveshjen e Dejtonit. Dokumentet e tjera vetëm sa e kanë ndjekur dhe vërtetuar Marrëveshjen e Dejtonit, duke mbështetur fuqishëm themelet e konceptit që diskutojmë. Kanë qenë kryesisht këto dokumente të cilat ne i diskutojmë si bazë e konceptit "muri i jashtëm i sanksioneve", pa harruar këtu rolin që Kosova e luan në heqjen eventuale të tyre në të ardhmen[535].

Për sa i përket shpërbërjes dhe kohës së ndodhjes së saj, kryesuesi i Konferencës për Jugosllavi i kohës i ka kërkuar Komisionit Badinter më datën 18 maj 1992 që të japë një mendim meritor lidhur me shpërbërjen dhe kohën e ndodhjes së saj. Në përgjigjen e vet, Komisioni theksoi së një referendum i mbajtur në Bosnjë-Hercegovinë në shkurt e mars të vitit 1992 ka prodhuar një shumicë në favor të pavarësisë së Bosnjë-Hercegovinës, kurse Serbia dhe Mali i Zi kanë miratuar një kushtetutë të re më 27 prill 1992, kushtetutën e re të shtetit të ri, RFJ. Komisioni më tutje ka vërejtur faktin se territori dhe popullsia e ish-RSFJ-së tanimë gjendeshin nën autoritetin sovran të shteteve të reja dhe se më nuk funksiononin organet dhe trupat e tjerë federalë të pushtetit të ish-RSFJ-së. Përveç kësaj, Komisioni theksonte se Bosnjë-Hercegovina, Kroacia dhe Sllovenia ishin njohur jo vetëm nga të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian, por edhe nga një numër i madh i shteteve të tjera, si dhe ishin pranuar në OKB më 22 maj 1992.

Komisioni po ashtu mori parasysh Rezolutën Nr. 757 të datës 30 maj 1992, e cila i është referuar, për herë të parë, federatës jugosllave si "ish-RSFJ", duke theksuar në të njëjtën kohë se kërkesa e RFJ-së për të vazhduar në mënyrë automatike anëtarësinë e OKB-së në vend të ish-RSFJ-së në përgjithësi nuk pranohet ndërkombëtarisht. Në fund, Komisioni arriti në përfundimin se procesi i shpërbërjes së ish-RSFJ-së, që u konstatua sa ka filluar qysh me mendimin nr. 1 të datës 29 nëntor 1991, tanimë është kryer ashtu që ish-RSFJ më nuk ekziston[536]. Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka përkrahur këtë

---

[535] Cf. Raporti përmbledhës i Departamentit të Shtetit të ShBA-së, përpiluar nga Sylejman Gashi, me titull "ShBA-të ndaj zhvillimeve në Kosovë dhe Serbi: Muri i jashtëm ka themelet në Prishtinë", *Rilindja* (Tiranë, 13 shkurt 1997) fq. 5.

[536] Mendimi Nr. 8 i Komisionit të Arbitrazhit për Paqe në Jugosllavi (Paris, 4 korrik 1992); Mendimi Nr. 11 i Komisionit të Arbitrazhit për Paqe në Jugosllavi (Paris, 16 korrik 1992). Në Snežana Trifunovska, *Yugoslavia Through Documents*, fq. 1017-1020.

konstatim të Komisionit më datën 19 shtator 1992. Në këtë ditë, KS i OKB-së miratoi Rezolutën Nr. 777 (1992), në të cilën thuhet se "shteti më herët i njohur si Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë ka pushuar së ekzistuari [dhe] se Republika Federative e Jugosllavisë ([e përbërë nga] Serbia dhe Mali i Zi) nuk mund ta vazhdojë në mënyrë automatike anëtarësinë e ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në OKB".

Në këtë kontekst, Komisioni i ka rekomanduar Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe vendosi që RFJ duhet të aplikojë për anëtarësim në OKB dhe, për pasojë, deri në një akt të tillë, RFJ nuk duhet të marrë pjesë në punën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Pasi mori këtë rekomandim, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Rezolutën 47/1, në të cilën u theksua se RFJ "nuk mund të vazhdojë në mënyrë automatike anëtarësinë në Kombet e bashkuara ashtu që si e tillë duhet të aplikojë për anëtarësim të ri në OKB dhe se nuk mund të marrë pjesë në punën e Asamblesë së Përgjithshme"[537]. Në dhjetor e shkurt të vitit 1992, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore (BB) përkrahën të njëjtin mendim[538]. Vendimet e fundit kanë qenë pasojë logjike e të parave, përkatësisht pasojë e faktit se edhe një vend joanëtar i OKB-së mund të bëhet anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB). Marrë në tërësinë e tyre, vendimet e mësipërme kanë pasur ndikim direkt për anëtarësimin e RFJ-së (Serbia dhe Mali i Zi) në organizatat dhe trupat e tjerë ndërkombëtarë, siç është OSBE-ja[539].

Më 4 korrik 1992, Komisioni ka prodhuar mendimin nr. 10, me të cilin jepet përgjigja e drejtpërdrejtë në pyetjen e dhënë nga Lordi Carrington, kryesuesi i Konferencës për Jugosllavinë, e cila kishte të bënte lidhur me atë nëse RFJ ishte shtet i ri të cilit i duhej njohja ndërkombëtare. U tha se RFJ përbënte një shtet të ri i cili nuk është trashëgimtar (suksesor) i vetëm i ish-

---

[537] Për tekstin e plotë të dokumenteve, shih "The UN and the Situation in Former Yugoslavia" (1993), botuar nga the UN Department of Public Information (New York, 1993) fq. 72-73.

[538] Cf. Malcolm N. Shaw, "State Succession Revisited", *The Finnish Yearbook of International Law* vol. V (Helsinki, 1994) fq. 53.

[539] Cf. Branislav Milinković, "FRY and the OSCE: Inertia of Suspension", *Review of International Affairs* vol. XLVIII, no. 1056 (Belgrade, 15 May 1997) fq. 14-18. Pas shpërthimit të konfliktit të hapur të armatosur në shkurt të vitit 1998, në mënyrë paradoksale, në një intervistë për televizionin nacional polak (mars 1998), Sllobodan Millosheviq tha se nëse dëshirohet zgjidhja e çështjes së Kosovës, atëherë së pari duhet të kryhet rikthimi i RFJ-së në OSBE në vendin që ka pasur ish-RSFJ. Cf. Gazeta ditore e Beogradit *Naša Borba*, në gjuhën serbe (e hënë, 30 mars 1998).

Jugosllavisë dhe se RFJ nuk mund ta trashëgojë *ipso facto* njohjen ndërkombëtare që ka gëzuar (pasur) RSFJ në rrethana e kohë krejt të ndryshme nga këto të sotit. Kjo do të thotë se shtetet e tjera, nëse e shohin të arsyeshme, mund ta njohin RFJ-në si shtet të ri. Njohja e tillë nga ana e anëtarëve të Bashkimit Evropian, përfundonte Komisioni Badinter, duhet t'i nënshtrohej respektimit të kushteve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare nga ana e RFJ-së, si dhe të atyre që ishin parashtruar në Deklaratën e Përbashkët dhe në Kriteret e Njohjes të datës 16 dhjetor 1991.

Pas arritjes së Marrëveshjes së Dejtonit në nëntor të vitit 1995, BE mori vendimin që shpërblente RFJ-në duke u rekomanduar shteteve anëtare që ta njihnin atë në mënyrë individuale, diçka që ndodhi në fillim të vitit 1996[540]. Asnjë prej kushteve që ishin parashikuar në Kriteret e Njohjes të 16 dhjetorit 1991 nuk qenë plotësuar. Kjo gjendje ngeli deri sa u përkeqësua pafund. Kjo kishte të bënte jo vetëm me mospërmbushjen e kushteve nga Marrëveshja e Dejtonit por edhe me gjendjen e rrezikshme në Kosovë si pasojë e brutalitetit policor kundër popullsisë shumicë, shqiptarëve të Kosovës. Deklaratat e fundit e Grupit të Kontaktit (mars-korrik 1998) lidhur me krizën e Kosovës kishte për qëllim ndalimin e përkeqësimit të situatës në Kosovë, ose së paku ta ndalonte situatën në Kosovë që mos ta rrezikonte paqen dhe stabilitetin në rajon. Gjendja e rëndë dhe e rrezikshme e sigurisë në terren detyroi Këshillin e Sigurimit të OKB-së që të fuste një embargo armësh ndaj RFJ-së, përfshirë këtu territorin e Kosovës (31 mars 1998). Në të gjitha rastet, bashkësia ndërkombëtare ka lutur të gjitha palët që të gjejnë një rrugë paqësore dhe një zgjidhje politike të krizës, bazuar në standardet e pranuara përgjithësisht, siç përcaktohen ato në Kartën e OKB-së dhe në Aktin Final të Helsinkit.

Këto dokumente flasin për praktikën e shteteve, e cila fare nuk ka përkrahur kërkesën e RFJ-së për të qenë vazhdimësi, përkatësisht trashëgimtar i vetëm i ish-Jugosllavisë (RSFJ). Kjo kërkesë po ashtu është refuzuar në mënyrë të vendosur nga ana e të gjitha ish-republikave jugosllave si shtete të barabarta trashëgimtare të ish-Jugosllavisë[541]. Qëndrimi i ish-republikave jugosllave, i cili në të njëjtën kohë është qëndrim i bashkësisë ndërkombëtare, që atëherë nuk ka pësuar ndryshim. Grupi mbi Trashëgimin e ish-Jugosllavisë, i kryesuar nga Arthur Vigts, së fundi ka ndërprerë punën e vet si pasojë e

---

[540] Cf. Predrag Simić, "Ambassadors Return to Belgrade", *Review of International Affairs* no. 1044 (Belgrade, 15 May 1996) fq. 4-8.

[541] Cf. UN Doc. E/CN.4/1995/121 dhe E/CN.4/1995/122; Snežana Trifunovska, *Yugoslavia Through Documents*, fq. 1038-1040; Kasim I Begić, *Bosna i Hercegovina od Vanceove misije do Daytonskog sporazuma*, fq. 36-38; *Naša Borba* (četvrtak, 20 februar 1997).

insistimit të RFJ-së se vetëm ajo është trashëgimtare e ish-Jugosllavisë. Dokumentet mbi Trashëgimin e ish-Jugosllavisë, të draftuara nga ky Grupi për Trashëgim, i cili ka vepruar dhe është formuar në kuadër të Konferencës për ish-Jugosllavinë që nga qershori i vitit 1992, janë refuzuar në sesionet e mars-qershorit të vitit 1998 si pasojë e këtij insistimi të RFJ-së. Në të njëjtën kohë, kjo flet për qëndrimin e pandryshuar të bashkësisë ndërkombëtare lidhur me këtë çështje. Çështja e trashëgimit të ish-Jugosllavisë tani ngelet për t'u zgjidhur nëpërmes një arbitrazhi ndërkombëtar, ashtu siç parashikohet me Marrëveshjen e Dejtonit, i cili duhet t'i zgjidhë të gjitha çështjet kontestuese mes palëve[542].

3. Përmbajtja e "murit të jashtëm të sanksioneve"

Anëtarësimi i RFJ-së në organizata ndërkombëtare, ndihma financiare dhe tjetër nga ana e FMN-së dhe Bankës Botërore, si dhe normalizimi i marrëdhënieve me ShBA-në, i njohur tanimë si "muri i jashtëm i sanksioneve", nënkupton në terma praktikë se RFJ duhet të plotësojë kushtet e njëjta sikur ish-republikat jugosllave të cilat trashëgojnë ish-Jugosllavinë në mënyrë të barabartë. Kushtet që duhen plotësuar nga RFJ buronin në aspektin formal nga Marrëveshja e Dejtonit, por ishin në thelb të njëjta me ato të Kritereve për Njohje të datës 16 dhjetor 1991. Në kontekstin e temës që diskutohet këtu në këtë shkrim, kushtet që duhen plotësuar me qëllim të heqjes së sanksioneve kërkojnë një "progres substancial në zgjidhjen e çështjes së Kosovës". Kjo, *inter alia*, nënkupton se RFJ duhet t'i marrë këta hapa konkretë:

- lejimin e kthimit të menjëhershëm të Misionit Monitorues të OSBE-së në Kosovë;
- themelimin e të gjitha institucioneve demokratike në Kosovë;
- dhënies fund me efekt të menjëhershëm represionit të ashpër nëpër tërë vendin;
- fillimi i negociatave konkrete ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës.

Lidhur me kushtin e fundit kanë ekzistuar disa propozime të cilat janë intensifikuar sidomos gjatë viteve 1996 dhe 1997. Aktivitetet e Grupit të Kon-

---

[542] Cf. "Diplomatski odnosi prioritet, razliciti stavovi o Kosovu i sukcesiji", *Naša Borba* (subota, 21 mart 1998); "Jugoslavija nije jedina naslednica SFRJ", *Naša Borba* (utorak, 24 mart 1998); "Rešavanje životnih problema nekada zahendnickih gradjana", *Naša Borba* (utorak, 25 mart 1998).

taktit dhe të BE-së gjatë pjesës së parë të vitit 1997 janë fokusuar në gjetjen e një zgjidhjeje duke propozuar një autonomi të gjerë për Kosovën në kuadër të Serbisë. Kjo u konsiderua si një hap i duhur në një drejtim të duhur. Gjatë pjesës së dytë të vitit 1997, me insistimin amerikan, Grupi i Kontaktit ka mbajtur qëndrimin se autonomia e gjerë brenda RFJ-së, jo brenda Serbisë, mund të ishte më e përshtatshme. Ky propozim, megjithatë, nuk iu paraqit presidentit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, gjatë vizitës së tij në Departamentin e Shtetit të ShBA-së në verë të vitit 1997. Si i tillë, ky propozim nuk figuroi as në deklaratën e takimit të Këshillit të Ministrave të BE-së, mbajtur më 16 shtator 1997[543]. Së fundi, në fund të vitit 1997, bashkësia ndërkombëtare në tërësi ndryshoi qëndrimin e saj kur foli për zgjidhjen e "çështjeve në Kosovë", jo për "çështjen e Kosovës" siç kishte qenë praktikë e deriatëhershme. Ky degradim, kjo ulje e statusit të Kosovës, ka pasur pasoja serioze lidhur me situatën në terren, sepse edhe më shumë ka radikalizuar forcat e moderuara brenda lidershipit kosovar.

---

[543] Cf. gazetën ditore *Rilindja* (Tiranë) të datave: 17 shtator 1997, fq. 1 dhe 5; 21 shtator 1997, fq. 1 dhe 3; 10 gusht 1997, fq. 1 dhe 5. Për pozicionin e ShBA-së, krahaso deklaratën e James Rubinit (Xhejm Rubin), zëdhënës i Departamentit të Shtetit të ShBA-së, Nr. 97/17, të datës 15 gusht 1997; dokumenti në dosjet e autorit si kopje e dhënë nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.
Sado që Takimi i Luksemburgut i Këshillit të Ministrave të BE-së (16 shtator 1997) nuk pati thënë se "një autonomi më e gjerë për Kosovën duhet të ofrohet", deklarata nga ky takim i referohet takimit të Këshillit Evropian të Ministrave të prillit 1997, në të cilin një gjë e tillë qe thënë. Cf. *Rilindja* (Tiranë, 17 shtator 1997) fq. 1 dhe 5. Një takim tjetër i Këshillit Evropian të Ministrave (24 mars 1997) parashikonte "një autonomi më të gjerë për Kosovën". Cf. *Informatori ditor* nr. 1674, datë 23 mars 1997, Qendra Informative e Kosovës, fq. 1. Një status i ngjashëm për Kosovën do të përmendet edhe në "Dokumentin Strategjik" të lëshuar nga Këshilli Evropian i Ministrave në shkurt të vitit 1997.
Së fundi, ministrat e jashtëm të Grupit të Kontaktit në Nju-Jork, më 24 shtator 1997, dhe në Uashington më 8 janar 1998, përkrahën një "status të ngritur për Kosovën brenda Republikës Federative të Jugosllavisë". Cf. gazeta *Koha Ditore* (Prishtinë, 9 janar 1998). Në vazhdim të takimit të Nju-Jorkut, ministrat francez dhe gjerman të punëve të jashtme, Vedrine e Kinkel respektivisht, lansuan propozimin e përbashkët për zgjidhjen e krizës në Kosovë (19 nëntor 1997). Propozimi parashikonte një status special për Kosovën, por që ishte vetëm njëri prej zgjidhjeve rreth statusit të Kosovës. Cf. *Naša Borba* (Beograd, 22 nëntor 1997).
Në Këshillin Implementues të Bonit, datë 9-10 dhjetor 1997, një shënim u mor rreth eskalimit të situatës në Kosovë. Megjithatë, Këshilli nuk foli për statusin përfundimtar të Kosovës. Cf. *Koha Ditore* (9 janar 1998). Pas shpërthimit të dhunës masivisht në shkurt të vitit 1998, propozimet "për një autonomi të gjerë brenda Serbisë" thuajse në tërësi u braktisën nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. RFJ tani e tutje shërbente si një fokus dhe pikë referimi brenda së cilës duhej kërkuar zgjidhja e statusit përfundimtar të Kosovës, pra jo më në kuadër të Republikës së Serbisë.

Siç u bë e njohur, nga RFJ është kërkuar që të plotësojë kushtet e njëjta si republikat e tjera të ish-Jugosllavisë, përveç atyre që burojnë në mënyrë të posaçme nga Marrëveshja e Dejtonit e që lidhen me bashkëpunimin e RFJ-së me Gjykatën Ndërkombëtare për Krimet e Kryera në ish-Jugosllavi. Kjo nënkupton se nga RFJ kërkohet të garantojë sundimin e ligjit, demokracinë dhe të respektojë të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve brenda kufijve të saj. Dhënia e pavarësisë Kosovës në tërësi qe përjashtuar nga koncepti i "murit të jashtëm të sanksioneve". Shenjat e para që pavarësia e Kosovës në tërësi do të përjashtohej u shfaqën me rastin e caktimit të Van der Stoelit (Van der Stul) si përfaqësues special i OSBE-së për Kosovën (1997). Mandati i tij si Komisionar i Lartë për Minoritete i OSBE-së në vetvete nuk lejon asnjë ndërmarrje që nuk i kontribuon paqes dhe stabilitetit në rajon, një argument shumë shpesh i thënë nga ndërkombëtarët me qëllim të mohimit të pavarësisë së Kosovës. Caktimi i Van der Stoelit tregon në të njëjtën kohë se Kosova, nga ana formale, po trajtohet si një çështje e pakicave në mënyrë të njëjtë që trajtohen shqiptarët etnik në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Në Maqedoni, Komisionari i Lartë për Minoritete i OSBE-së, Van der Stoel, ka vepruar shumë kohë para se të caktohet si përfaqësues special për Kosovën. Pas ngjarjeve dramatike në Kosovë, të cilat filluan në shkurt të vitit 1998, u bë e qartë se një qasje e tillë nuk i përgjigjet gravitetit të situatës në terren.

Ngjarjet e shkurtit të këtij vitit vunë në lëvizje Grupin e Kontaktit për ish-Jugosllavinë. Vendimet e datës 9 dhe 15 mars 1998 sollën vendimin e Këshillit të Sigurimit për futjen e një embargoje të armëve kundër RFJ-së. Ky vendim u mor më 31 mars 1998. Në këto dokumente, si dhe në ato që u miratuan më vonë nga Grupi i Kontaktit, u vunë edhe disa kushte specifike të cilat RFJ duhej t'i plotësonte nëse dëshironte të integrohej në tërësi në bashkësinë ndërkombëtare të shteteve sovrane dhe të pavarura ("muri i jashtëm i sanksioneve"). Edhe pse "muri i jashtëm i sanksioneve" përfshin edhe republikën e vogël të Malit të Zi, në vendimet e marsit të Grupit të Kontaktit u bë përpjekje e madhe për ta kursyer këtë vend nga pasojat që dilnin nga sanksionet. Ky fakt u dëshmua shumë bukur nga Robert Gelbard, i dërguari special i ShBA-së për Ballkanin, në një intervistë dhënë gazetës beogradase *Naša Borba*[544].

Grupi i Kontaktit kërkoi nga RFJ që të zotohej për dialog me liderët e komunitetit shqiptar të Kosovës. Dialogu duhet të ndërmerrej pa asnjë kusht.

---

[544] Cf. *Naša Borba* (subota, 28 mart 1998).

Për këtë qëllim, Grupi i Kontaktit ofroi shërbimet e veta të lehtësuesit të dialogut, duke theksuar se "Grupi konsideron se përfshirja adekuate ndërkombëtare përbën një faktor esencial për arritjen e besimit mes palëve"[545]. Më vonë, Këshilli i Sigurimit konfirmoi këtë qasje. Në Rezolutën Nr. 1160/1690, të datës 31 mars 1998, Këshilli i Sigurimit deklaroi se "pjesëmarrja e një përfaqësuesi të jashtëm, ose disave, konsiderohet i domosdoshëm me qëllim të zgjidhjes së çështjes së Kosovës" (paragrafi 16/a). Në këtë frymë, Grupi i Kontaktit kërkoi që RFJ të pranonte propozimin e OSBE-së për dërgimin e një misioni të ri të udhëhequr nga Filipe Gonzales, përfaqësues personal i kryesuesit të radhës së OSBE-së dhe i Bashkimit Evropian në RFJ. Misoni i ri i Gonzalesit do të përfshinte një mandat specifik për adresimin e problemeve të Kosovës[546]. Kjo kërkesë e bashkësisë ndërkombëtare ka qenë e përsëritur në të gjitha deklaratat e mëpasme, përfshirë deklaratën e korrikut 1998. Në fillim, sikur u dukën disa shenja se misioni i ri po pranohej nga Beogradi.

Në fund, misioni u refuzua nga regjimi i Sllobodan Millosheviqit kur vetë ai urdhëroi një referendum kundër çdo ndërmjetësimi ndërkombëtar në krizën e Kosovës. Ky referendum serb u mbajt më 23 prill 1998. Lidhur me rolin e OSBE-së, përveç ndërmjetësimit në zgjidhejn e çështjes së Kosovës, vlen të përmendet fakti se Grupi i Kontaktit i kërkonte RFJ-së që të rikthente misionin afatgjatë të OSBE-së për Kosovë, Sanxhak dhe Vojvodinë, misioni të cilin Beogradi e kishte dëbuar pas përjashtimit të RFJ-së nga OSBE më 1992[547].

Si përmbledhje për fund, mund të themi se në rast të fillimit të dialogut substantiv për çështjen e Kosovës, së bashku me disa masa të ndërtimit të besimit dhe me përfshirjen ndërkombëtare, bashkësia ndërkombëtare duket e gatshme për ta ndihmuar Beogradin drejt rrugës së integrimit të plotë në bashkësinë ndërkombëtare. Në fakt, deklarata e fundit e Grupit të Kontaktit e datës 8 korrik 1998 në mënyrë shprehimore cek se "qëllimi i saj vazhdon të jetë që Republika Federale e Jugosllavisë duhet t'i vjelë frytet e anëtarësimit në institucione financiare dhe politike" (paragrafi 10).

---

[545] Deklarata për Kosovën, Takim i Londrës i Grupit të Kontaktit i mbajtur më datën 9 mars 1998, paragrafi 7; Deklarata e Grupit të Kontaktit, datë 29 prill 1998, paragrafët 5, 6, 6a.
[546] Cf. Vendimi i Sesionit Special të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, datë 11 mars 1998. Teksti i plotë i Vendimit gjendet në UN Doc. S/1998/246.
[547] Deklarata për Kosovën, Takimi i Grupit të Kontaktit (Londër, 9 mars 1998), paragrafët 7 dhe 7d; Deklarata e Grupit të Kontaktit (Bon, 29 prill 1998), paragrafi 10 i Deklaratës.

4. Efektet e "murit të jashtëm të sanksioneve"

Deri më sot, "muri i jashtëm i sanksioneve" ka nxitur një diplomaci dyrrugëshe: futja e tyre ka pasur për pasojë nisjen e disa bisedimeve jozyrtare mes shqiptarëve të Kosovës dhe opozitës serbe, pa llogaritur këtu Marrëveshjen për Arsim, të nënshkruar nga presidenti serb Sllobodan Millosheviq dhe presidentit në hije të shqiptarëve të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, më 1 shtator 1996. Vënia në jetë e kësaj marrëveshjeve akoma nuk ka ndodhur. Sa i përket bisedimeve si rezultat i diplomacisë dyrrugëshe, ato ndodhën në mars dhe qershor 1996, në Nju-Jork të ShBA-së dhe në Ulqin të Malit të Zi, respektivisht[548]. Në këto bisedime, të organizuara nga Projekti i Nju-Jorkut për Marrëdhënie Etnike, u arrit një konsensus i gjerë sa i përket rrugëve që duhen ndjekur për zgjidhen e çështjes së Kosovës, përkatësisht përmes negociatave dhe rrugëve të tjera paqësore. Si të tilla, bisedimet u bojkotuan nga ana e partisë serbe në pushtet, Partisë Socialiste, çka bëri të paefektshëm tërë procesin e bisedimeve. Në anën tjetër, në të njëjtën kohë, këto bisedime joformale nuk duhen neglizhuar, sepse ofruan një pasqyrë reale të të gjitha interesave të palëve të involvuara, të seriozitetit si dhe të natyrës së komplikuar të çështjes së Kosovës Në këtë kontekst, konsiderojmë se nëse çështja e Kosovës duhet të zgjidhet si duhet, atëherë një diplomaci shumërrugëshe duhet ndjekur, jo si deri më tani. Kjo rrethanë u vërejt nga ana e Grupit të Kontaktit në ndërkohën e vazhdimit të bisedimeve në dy vendet e sipërcekura.

Procesi i ndërmjetësimit të cilin Grupi i Kontaktit e vuri në lëvizje për zgjidhjen e çështjes së Kosovës ka qenë i kushtëzuar me përkeqësimin e shpejtë të situatës në terren në Kosovë. Mosrespektimi nga RFJ i vendimeve të Grupit të Kontaktit, në veçanti kërkesa e këtij të fundit për tërheqjen e trupave policore dhe njësive të tjera nga territori ku zhvillohej konflikti i armatosur brenda në Kosovë, nuk pengoi diplomacinë *shuttle* të ambasadorit kurajoz amerikan, Richard Holbrooke (Riçard Holbruk) nga data 10 deri 13 mars 1998. Misioni i tij u bë lajm i ditës. Në deklaratën nga kabineti i presidentit serb Sllobodan Millosheviq, të lëshuar pas konferencës për shtyp me presidentin e Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, u konfirmua "vullneti i përbashkët për gjetjen e një zgjidhje politike për krizën e Kosovës". Në të njëjtën

[548] Për takimin e Nju-Jorkut, shih *Informatori ditor* (në gjuhën shqipe) i Qendrës Informative të Kosovës me seli në Prishtinë, nr. 1687 (7 prill 1997) fq. 1-2, nr. 1689 (9 prill 1997) fq. 1-2, dhe së fundi, nr. 1690a (10 prill 1997) fq. 1-2.; Për takimin e Ulqinit, krahaso burimin e njëjtë në shqip, nr. 1754 (24 qershor 1997) fq. 1, nr. 1756 (26 qershor 1997) fq. 1-3; dhe së fundi, nr. 1757 (27 qershor 1997) fq. 1-2.

kohë u vendos që të formoheshin grupet punuese me qëllim të diskutimit të mëtejmë të çështjeve kontestuese mes palëve. Takimi i këtyre grupeve punuese duhej të mbahej në Beograd dhe Prishtinë sipas rotacionit. Lidhur me statusin politik të Kosovës, u vu në spikamë se palët ngelin pranë mendimeve të tyre diametralisht të kundërta dhe mospajtuese deri në fund[549].

Nga pikëpamja diplomatike, bisedimet mes Millosheviqit dhe Rugovës paraqesin ndikimin e parë të "murit të jashtëm të sanksioneve". Megjithatë, që nga fillimi ka qenë e qartë se Millosheviqi do t'i përdorte ato për të blerë kohë dhe për të vazhduar në të njëjtën kohë me politikat e tij represive kundër shqiptarëve të Kosovës. Po ashtu, Millosheviqi e përdori këtë periudhë si një moment të përshtatshëm për të shpërlarë hesapet me rivalin e tij të vjetër, presidentin malazez Millo Gjukanoviq (Milo Djukanović). Premtimi i Grupit të Kontaktit se do të konsideronte ndërmarrjen e hapave për heqjen e "murit të jashtëm të sanksioneve", nëse do të kishte një progres substancial në plotësimin e kërkesave të mëhershme të vëna për Serbinë, sikur inkurajoi liderin serb Millosheviq për të ndërmarrë këtë hap për bisedime të drejtpërdrejta me shqiptarët e Kosovës. Megjithatë, diplomacia amerikane akoma paraqitej si shumë e kujdesshme kur bëhej fjalë për anëtarësimin e RFJ-së në OSBE.

Anëtarësimi i RFJ-së në OSBE do të kundërshtohej nga ish-republikat e tjera jugosllave, tani shtete sovrane dhe të pavarura, edhe sikur të ekzistonte zbatimi i plotë i të gjitha kushteve të tjera të vëna nga Grupi i Kontaktit. Bazat e këtij kundërshtimi nga ana e ish-republikave jugosllave, tani shtete sovrane dhe të pavarura, ngelin të njëjta: RFJ nuk paraqet trashëgimtarin (suksesorin) e vetëm të ish-Jugosllavisë dhe, për pasojë, ajo duhet të aplikojë për anëtarësim të ri në të gjitha organizatat ndërkombëtare, në mënyrë të njëjtë siç kishin bërë ish-republikat jugosllave, tani shtete sovrane dhe të pavarura[550].

Përveç sa më sipër, është shumë larg mendsh se gjendja në terren në Kosovë do të përmirësohej dhe se sjelljet e Millosheviqit do të ishin në pajtim me standardet normale te sjelljes që kërkohen sipas standardeve ndërkombëtare të kërkuara nga Grupi i Kontaktit. Çështja e Kosovës, siç shihet, ka qenë një burim i vazhdueshëm i sjelljes irracionale brenda jetës politike dhe sociale serbe. Mosrespektimi nga ana e RFJ-së i standardeve në fjalë qartë tregon se perspektiva për demokratizim në Serbi është e këqe dhe se nuk ka në shoqër-

[549] *Naša Borba* (subota, 16 maj 1998).
[550] *Naša Borba* (petak, 15 maj 1998).

inë serbe një konsensus për sa i përket zgjidhjes paqësore të çështjes së Kosovës. Përkundër situatës ekonomike që po përkeqësohet si rezultat i luftimeve serbe në ish-Jugosllavi dhe izolimit të gjatë serb si pasojë e këtyre luftërave, "muri i jashtëm i sanksioneve" nuk po tregon asnjë shenjë serioze të ndikimit në sjelljet e RFJ-së ndaj botës. Çfarë i mbetet në duar bashkësisë ndërkombëtare për të ndërmarrë me qëllim të ndalimit të sjelljes irracionale të Serbisë? Veprimet e cilësuara si "muri i jashtëm i sanksioneve" si duket janë kthyer në një diçka që nuk ka më asnjë kuptim. Si i tillë, "muri i jashtëm i sanksioneve" përbën një mjet joefektiv për ta detyruar regjimin në Beograd të sillet arsyeshëm, ashtu siç kanë qenë joefektive sanksionet kundër RFJ-së të vëna në vitin e largët 1992.

Në vend të përfundimit

Koncepti i "murit të jashtëm të sanksioneve" nuk është asgjë tjetër veçse një sistem vlerash dhe parimesh të cilat Perëndimi i ka vënë me qëllim të evitimit të pasojave të shkatërrimit të ish-Jugosllavisë. Edhe pse u bënë publike më 1995 dhe në një kuptim tjetër, sanksionet që diskutojmë paraqesin një mjet për të detyruar RFJ-në të respektojë rregullat e lojës në kontaktet e saj me bashkësinë ndërkombëtare. Demokracia, sundimi i ligjit dhe respekti për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve janë ana e brendshme e këtij koncepti. Respektimi dhe nënshtrimi ndaj vlerave dhe parimeve në fjalë paraqet thelbin për anëtarësimin e RFJ-së në organizatat ndërkombëtare dhe për vjeljen e fryteve të institucioneve financiare ndërkombëtare.

Këto vlera e parime si më sipër, që nga fillimi i krizës jugosllave, u patën formuluar si në kuptimin legal ashtu dhe në atë politik, duke nisur me mendimet e Komisionit Badinter (1991-1993) e deri te deklaratat e Grupit të Kontaktit lidhur me krizën në vazhdim në Kosovë. Caqet e zbatimit, ndërkaq, janë më të gjëra sepse fillimisht kanë pasur për qëllim futjen në rrugë të duhur demokratike të ish-vendeve komuniste pas rënies së komunizmit. RFJ, duhet theksuar me këtë rast, ngelet shteti i fundit i cili duhet t'u nënshtrohet këtyre vlerave dhe parimeve të Perëndimit.

Njohja e shtetit është një çështje thelbësisht politike për nga natyra, dhe kjo shihet qartë në rastin e ish-Jugosllavisë më mirë se në çdo rast tjetër. Në rastin e ish-Jugosllavisë, janë vënë disa kritere të cilat shtetet e reja duhej t'i përmbushnin para se të pranoheshin si anëtare me të drejta të plota në bashkësinë ndërkombëtare. Kriteret e tilla përfshinin çështje të gjëra dhe, në ras-

tin e RFJ-së, u vunë edhe disa kritere shtesë që buronin nga Marrëveshja e Dejtonit. Sa i përket çështjes së Kosovës, kriteret që duheshin përmbushur ngelën të njëjta, përkatësisht që RFJ duhej të ndiqte rrugën e njëjtë si ish-republikat jugosllave kur u bënë shteteve të pavarura dhe u pranuan në gjirin e bashkësisë ndërkombëtare si anëtare të barabarta të saj (1992). Duhet pranuar, megjithatë, se konteksti politik në rastin e Kosovës është më i ndryshëm se gjetiu në ish-Jugosllavi. Heqja e "murit të jashtëm të sanksioneve" duhet të ndodhë vetëm atëherë kur RFJ t'i plotësojë kriteret e mësipërme kundrejt Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Sado që koncepti që diskutojmë këtu, "muri i jashtëm i sanksioneve", tingëllon rëndë dhe fuqishëm, efektet e tij të vërteta kanë qenë të papërfillshme. Krejt çfarë është arritur janë disa bisedime joformale mes palëve më 1997 dhe lidhja e Marrëveshjes për Edukimin më 1 shtator 1996. Në dukje, efekti më i prekshëm i sanksioneve në fjalë ka qenë takimi mes Millosheviqit dhe Rugovës më 15 maj 1998. Si takim, megjithatë, pati jetë të shkurtë sa i përket ndonjë rezultati, sepse Millosheviqi e përdori atë për ta shkallëzuar dhunën kundër shqiptarëve në Kosovë dhe për të qëruar hesapet me republikën e vogël të Malit të Zi. Me konfliktin në Kosovë që nuk ka gjasa të ndalet, "muri i jashtëm i sanksioneve" duket i pakuptimtë në tërësinë e vet, si diçka joefektiv sa i përket ndalimit të sjelljeve irracionale serbe. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta ketë të qartë se vetëm ndonjë masë më efektive se sanksionet në fjalë mund ta ndalojnë regjimin në Beograd dhe ta detyrojnë për sjellje racionale sipas standardeve që kërkon bashkësia ndërkombëtare. Cili do të jetë hapi i radhës i bashkësisë ndërkombëtare ngelet të shihet! Pas ofensivës së pafrenuar të Serbisë kundër shqiptarëve të Kosovës që filloi në fund të korrikut 1998, fuqishëm besojmë se ka ardhur koha që Grupi i Kontaktit ta vejë në veprim premtimin nga deklarata e vet e fundit, përkatësisht të përdorë forcën kundër atyre që bllokojnë procesin e paqes në Kosovë. Në të kundërtën, po nuk u bë realizimi i këtij premtimi, atëherë përpjekjet e copëzuara, siç janë "muri i jashtëm i sanksioneve" vetëm do t'i shërbejnë krijimit edhe të një tragjedie tjetër njerëzore të parë tanimë në rastin e Bosnjë-Hercegovinës.

III. Eksperti ligjor i UÇK-së: së pari protektorati ndërkombëtar, pastaj pavarësia

- Sundimi serb në Kosovë mbaroi dhe pavarësia e Kosovës duhet të vijë pas një protektorati të përkohshëm në vend, thotë njeri ndër anëtarët e krahut politik të UÇK-së.
- Në një intervistë për *Turkish Daily News*, Enver Hasani, i cili po ashtu është ekspert ligjor i Delegacionit të Kosovës në negociatat e Rambujesë, thotë se UÇK-ja ka diskutuar me vendet perëndimore opsionin e një protektorati ndërkombëtar mbi Kosovën.
- Hasani thotë se UÇK-ja ka qenë në kontakt të vazhdueshëm më administratën në Uashington dhe se ka ofruar informata për NATO-n lidhur me lëvizjen dhe vendndodhjen e trupave serbe në terren.
- Ai thotë se edhe zyrtarë të rangut të ulët turk kanë pasur kontakte me UÇK-në, por vetëm sa i përket "çështjeve humanitare".
- Hasani ka lavdëruar politikat turke ndaj Kosovës, duke shtuar se në të ardhmen, kur rrethanat të ndryshojnë, Ankara hapur do të avokojë për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës.
- Hasani po ashtu ka theksuar se turqit e Kosovës kanë përkrahur vendosmërinë e shqiptarëve për pavarësi të Kosovës.
- Ai ka thënë se NATO nuk duhet të ndalojë bombardimet e caqeve në Jugosllavi dhe duhet shumë seriozisht ta marrë në shqyrtim futjen e këmbësorisë në terren "nëse NATO dëshiron ta fitojë këtë luftë".
- Në vijim, jepet e plotë intervista me z. Hasani, i cili gjithashtu është asistent hulumtues në Universitetin Bilkent të Ankarasë, ku po bën edhe studimet e doktoratës.

TDN: *Zotëri, ju keni qenë ekspert ligjor i delegacionit shqiptar në Rambuje. Cili ka qenë qëllimi kryesor i delegacionit shqiptar në këto bisedime?*

HASANI: Marrëveshja e Rambujesë nuk ka plotësuar synimet tona parësore, pritjet tona që lidhen me pavarësimin e plotë të vendit. Ajo çfarë ne kërkuam në Rambuje kishte të bënte me zgjidhjen e çështjes së Kosovës në një fazë të mëvonshme në pajtim me parimin e vetëvendosjes, ashtu siç kishin bërë krejt popujt e tjerë në ish-Jugosllavi. Qëllimi ynë ka qenë nënshkrimi i Marrëveshjes në bazë të përkohshme, duke shpresuar se realizimi i vetë-

vendosjes do të vinte pas tri vitesh. Që nga fillimi ne kemi besuar se NATO do të implementonte një kusht të tillë. Nuk ka asnjë rëndësi nëse kjo forcë e NATO-s do të vinte mbi bazën e një rezolutë të KS të OKB-së apo të një vendimi të veçantë të NATO-s.

TDN: *Pala jugosllave thotë se delegacioni shqiptar dhe amerikanët kanë përpiluar draft-marrëveshjen e Rambujesë së bashku. Ata thonë se një tekst i ri është sjellë në tavolinën e tyre vetëm pak orë para se të kalojë afati i mbylljes së konferencës. Cili është komenti juaj?*

HASANI: Jo. Kjo fare nuk është e vërtetë. Nuk ka pasur dokumente të cilat janë vënë në tavolinë në mënyrë klandestine. Çdo gjë ka qenë publike që nga fillimi. Nuk ka pasur asnjë marrëveshje sekrete mes nesh dhe ndonjërit prej anëtarëve të Grupit të Kontaktit. Shumë larg para se të fillojnë negociatat në Rambuje, ne e kemi bërë të qartë se pala jonë nuk do ta pranojë asnjë marrëveshje e cila nuk e parashikon të drejtën tonë për shprehje të vullnetit të lirë të popullit të Kosovës.

TDN: *Shtetet perëndimore, Turqia po ashtu, thonë se ata janë në favor të integritetit territorial të Jugosllavisë, mirëpo neni lidhur me shprehjen e vullnetit të lirë të popullit të Kosovës gjendet në Marrëveshjen e Rambujesë. A nuk është kjo një kontraditë?*

HASANI: Parimi i integritetit territorial të Jugosllavisë në Marrëveshje është i natyrës së përkohshme.

TDN: *A thoni se Perëndimi është në favor të integritetit territorial të Jugosllavisë vetëm për tri vite?*

HASANI: Nuk mund ta them *ad literam* një gjë të tillë. Nëse e krahasoni këtë me dispozitat tjera të draft-marrëveshjes, mund ta shihni se bashkësia ndërkombëtare më shumë është në favor të integrimit të Kosovës në federatë, duke nxjerrë jashtë autoritetet serbe sa më shumë që të jetë e mundur. Ideja duket sikur është që Kosova të bëhet një republikë e tretë brenda federatës jugosllave. Mirëpo, krahas kësaj, ekzistojnë dispozita të cilat e bartin një mesazh të qartë për serbët: nëse vazhdoni kështu gjatë tri viteve të përkohshme, nëse vazhdoni me abuzimin e pushtetit ndaj shqiptarëve në Kosovë, atëherë ju serbët nuk do të keni të drejtë sundimi mbi Kosovën pas tri viteve. Kjo marrëveshje është një lloj testi, si për ne, ashtu dhe për serbët.

TDN: *Pas fillimit të sulmeve të NATO-s, ka shenja se Perëndimi, në veçanti ShBA-ja, do ta favorizojë pavarësinë e Kosovës?*

HASANI: Sa më keq që sillen serbët, më afër është pavarësia jonë. Kështu si janë gjërat sot, disa pjesë të Marrëveshjes së Rambujesë janë të vdekura përgjithmonë. Ta zëmë, në aneksin e sigurisë kanë ekzistuar dispozitat që lej-

onin qëndrimin e një numri të caktuar të forcave serbe në Kosovë për të ruajtur kufijtë e Jugosllavisë. Që tani e tutje është tërësisht e pamundur lejimi i qëndrimit në Kosovë të çfarëdo force serbe.

Sipas meje, i tërë territori i Kosovës duhet të qeveriset si njëfarë kujdestarie ndërkombëtare strategjike, apo si një protektorat, i udhëhequr nga NATO.

Dhe koha prej tre vjetëve nuk mund të jetë më e tillë. Populli i Kosovës ka nevojë për më shumë kohë për t'u këndellur. Protektorati ndaj Kosovës duhet të jetë më i gjatë, diku pesë vite së paku. Vetëm pastaj mund të flasim për statusin e Kosovës.

Përshtypja ime është se UÇK-ja dhe qeveria e Kosovës në këtë fazë nuk do të pranojnë asnjë forcë serbe në Kosovë, por në të njëjtën kohë shumë lehtë do të prananin hyrjen e vendit në një protektorat ndërkombëtar.

TDN: *Pra, ju thoni se sundimi serb në Kosovë ka marrë fund?*

HASANI: Ka marrë fund. Serbët kanë humbur çdo të drejtë për të sunduar në Kosovë në këtë periudhë të përkohshme.

TDN: *A është ky një sugjerim se protektorati ndërkombëtar është duke u diskutuar me vendet e Perëndimit?*

HASANI: Ashtu është.

TDN: *A besoni se Perëndimi mund të pajtohet për një protektorat të tillë ndërkombëtar?*

HASANI: Duhet patjetër të pajtohen. Rruga tjetër do të ishte që të na jepnin armë të mira dhe ne vetë ta fitojmë pavarësinë, ose të na lënë në mëshirë të serbëve për të na vrarë të gjithëve.

TDN: *Çfarë mendoni për Rugovën? Zërat e shumtë thonë se ai akoma ka përkrahjen e shumicës së popullit shqiptar?*

HASANI: Jo. Nuk do të thosha ashtu. Rugova ka pasur një përkrahje të madhe në mesin e shqiptarëve të Kosovës. Mirëpo, me hapat e ndërmarrë së fundi me Millosheviqin, Rugova ka humbur shumë dhe sikur është kompromet uar. Nëse të gjithë liderët shqiptarë në rajon thonë se NATO duhet të vazhdojë me bombardimet kundër serbëve, kurse Rugova thotë se bombardimet duhet të ndalen, atëherë kjo është kompromet uese për të.

Jam shumë i bindur se Rugova është i detyruar që të thotë një gjë të tillë, mirëpo zërat e shumtë thonë se ai nuk është dashur ta sjellë veten në një pozitë të tillë. Populli i Kosovës nuk arrin të kuptojë si Rugova akoma beson në rrugën paqësore si mënyrë të vetme të zgjidhjes së çështjes së Kosovës në një kohë kur populli masakrohet dhe dëbohet me dhunë nga vendi.

TDN: *A është e vërtetë se UÇK-ja po e ndihmon NATO-n, përkatësisht se po i ofron NATO-s informacione lidhur me caqet serbe në terren?*

HASANI: Nuk është se UÇK-ja po e bën këtë në mënyrë sekrete. Një gjë e tillë dihet krejt publikisht.

TDN: *A është e vërtetë se lideri i UÇK-së, Hashim Thaçi, flet me amerikanët çdo ditë?*

HASANI: Po, ekziston një kontakt direkt mes lidershipit të UÇK-së dhe administratës amerikane. Thaçi nuk është vetëm lider i UÇK-së por edhe kryeministër i Kosovës dhe udhëheqës i delegacionit të shqiptarëve që nënshkroi Marrëveshjen e Rambujesë në Paris.

TDN: *Si e vlerësoni politikën e Turqisë ndaj Kosovës?*

HASANI: Shumë sinqerisht mund të them se në këta tetë muajt e fundit Turqia ka pasur një qasje të shkëlqyeshme ndaj Kosovës. Në veçanti, populli turk ka manifestuar një miqësi dhe solidaritet me kosovarët.

TDN: *Mirëpo, Turqia nuk avokon pavarësimin e Kosovës, i cili është qëllimi kryesor i juaji?*

HASANI: As vendet e tjera perëndimore nuk avokojnë pavarësinë tonë. Një gjë të tillë nuk mund ta bëjnë për momentin sepse një gjë e tillë do ta përkeqësonte edhe më shumë situatën në terren.

TDN: *A doni të thoni se Turqia avokon pavarësimin tuaj, por që një gjë të tillë nuk mund ta thotë hapur?*

HASANI: Mendimi im është se, në një situatë tjetër, e cila sigurisht se do të vijë, Turqia do të avokojë pavarësinë tonë. Turqia dhe vendet perëndimore frikësohen se nëse ato përkrahin pavarësimin tonë tani, ne do të kërkojmë shpërbërjen e Maqedonisë, gjë e cila fare nuk është e vërtetë.

Politika ballkanike e Turqisë duhet të jetë pak më aktive, jo vetëm në Kosovë. Turqia duhet të jetë më shumë prezente në Ballkan. Në kuptimin ekonomik, Turqia duhet të jetë e fortë në Ballkan. Turqia duhet të jetë mbrojtëse e sferave të caktuara në Ballkan. Turqia ka një rol stabilizues dhe balancues në Ballkan dhe duhet ta ruajë këtë rol.

TDN: *A ka UÇK-ja kontakte me zyrtarët turq?*

HASANI: Vetëm për qëllime humanitare. UÇK-ja ka pasur kontakte me zyrtarë të ulët turq ne çështjet humanitare, siç janë trajtimi i të plagosurve dhe të sëmurëve, refugjatëve, të cilët janë trajtuar nëpër spitalet turke. Më herët ka pasur përpjekje nga lidershipi i UÇK-së për të takuar zyrtarët e lartë turq, por nuk ka ndodhur asnjë takim i tillë deri më sot.

TDN: *Çfarë mendoni për marrëdhëniet mes turqve dhe shqiptarëve në Kosovë? Disa thonë se ato nuk janë të ngrohta sa duhet dhe se turqit lokalë janë në zjarrin mes serbëve dhe shqiptarëve?*

HASANI: Dëgjoni, djali i liderit të turqve të Kosovës, Partisë Demokratike të Turqve të Kosovës, është me UÇK-në duke luftuar që nga vera e vitit të kaluar. Kjo që ju e thoni është një propagandë serbe.

Turqit në Ballkan kanë mbijetuar dhe jetojnë së bashku vetëm në pjesët ku shqiptarët janë shumicë. Në Bullgari, turqit u dëbuan në masë në vitin 1989. Turqit dhe shqiptarët kanë pasur një fat të përbashkët dëbimi e dhune gjatë shekullit XX në Ballkan. Së fundi, shumica e turqve janë dëbuar me dhunë nga Kosova, njëjtë si shqiptarët.

TDN: *A janë dëbuar apo kanë ikur nga bombardimet?*

HASANI: Çdokush e di që sapo filloi bombardimi i NATO-s ndaj forcave dhe caqeve serbe, serbët do të krijonin me dhunë një krizë refugjatësh. Ata e bënë këtë. Kur Millosheviqi e pa vendosmërinë e NATO-s për ta goditur, atëherë u zmbraps nga kjo politikë sepse nuk i funksionoi.

TDN: *A keni pasur bisedime me komunitetin turk të Kosovës lidhur me statusin e Kosovës? A pajtohen ata me shqiptarët?*

HASANI: Partitë turke në Kosovë, si dhe ato boshnjake, kanë autorizuar palën shqiptare në Rambuje për ta nënshkruar marrëveshjen në emër dhe për dobi të tyre. Përveç kësaj, Kushtetuta e Kosovës, të cilën serbët nuk e njohin, nuk thotë se Kosova është një shtet shqiptar. Kushtetuta thotë se Kosova është shtet i shqiptarëve, malazezëve, serbëve dhe turqve (sipas rendit alfabetik). Kushtetuta ua njeh të gjithëve të drejtën e vetëqeverisjes së punëve që janë interes i tyre.

TDN: *Çfarë mendoni për përfaqësuesit shqiptarë dhe turq në delegacionin serb në Rambuje?*

HASANI: Ata janë individë të izoluar. Nuk përfaqësojnë asnjë parti, asnjë shoqatë ose klub në Kosovë. Asnjëri prej tyre nuk është legjitim.

TDN: *A është pavarësi një qëllim final i Kosovës? Nëse bëhet e pavarur një ditë, a do të kërkojë Kosova bashkim me Shqipërinë?*

HASANI: Sipas së drejtës ndërkombëtare, shtetet e pavarura kanë të drejtë të shkojnë kah të duan dhe me kë të duan, të bashkohen me kë të duan. Nëse kosovarët fitojnë pavarësinë, atëherë ata duan të integrohen në Unionin Evropian në kuadër të integrimeve të përgjithshme evropiane nëse ato një ditë bëhen realitet.

TDN: *A prisni një rebelim të shqiptarëve në Maqedoni?*

HASANI: Jo. Janë dy arsye për këtë, një ndërkombëtare dhe tjetra vendore. Si arsye e brendshme është se Maqedonia është e varfër dhe nuk mund të ndërtojë një forcë fizike të llojit të serbëve për të shtypur shqiptarët, ashtu që do të duhet të bëjnë kompromise me ta. Së dyti, pas pavarësimit të Kosovës, perëndimorët me siguri se do ta detyrojnë Maqedoninë për të moderuar sjelljen ndaj shqiptarëve dhe për të përmirësuar gjendjen e të drejtave të njeriut atje, krejt kjo me qëllim të ndihmës ndërkombëtare të cilën do ta merr ai vend në këmbim.

Problemet e shqiptarëve në Maqedoni burojnë nga politikat e gabuara të Shkupit. Autoritetet maqedone duhet t'i zgjidhin problemet me shqiptarët përmes lidershipit të tyre atje.

Kohëve të fundit, politika maqedone duket sikur ka qenë në një vijë me politikën serbe. Politika maqedone ndaj refugjatëve dhe ndaj shqiptarëve të atjeshëm, për momentin, është shumë e turpshme.

TDN: *Çfarë duhet NATO të bëjë tani e tutje?*

HASANI: NATO nuk duhet ta ndalë bombardimin. Në të njëjtën kohë, duhet të mendojnë për futje në Kosovë përmes trupave tokësore nëse duan ta fitojnë këtë luftë. Kur po thonë "nuk ka trupa tokësore", atëherë kjo po e trimëron Millosheviqin.

TDN: *Faleminderit zoti Hasani.*

HASANI: Ju lutem. Ishte kënaqësi të flisja me ju.

IV. NJË VËSHTRIM MBI TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE TË LUFTËS NË DRITËN E KONFLIKTIT TË ARMATOSUR NË KOSOVË

(Bashkautorë: Enver HASANI dhe Hajredin KUÇI)

Hyrja

E drejta e luftës ndahet në dy pjesë. Në njërën anë ajo përfshin rregullat që kanë të bëjnë me legjitimitetin e përdorimit të forcës, kurse në tjetrën janë rregullat që lidhen me udhëheqjen e armiqësive dhe vetë mënyrën e luftimit. Në tekstet juridike këto dy aspekte zakonisht cilësohen si *jus ad bellum* dhe *jus in bello*. Kjo degë e së drejtës ka pësuar ndryshime në përmbajtjen e saj, edhe pse nocionet bazike kanë qenë dhe mbeten të njëjta që nga kohërat e

lashta. Ne këtu nuk diskutojmë për kohët e tilla, por vetëm për ato ndryshime që kanë ndodhur pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore e deri më sot.

Zhvillimet e pas-Luftës së Dytë Botërore në sferën e procesit të dekolonizimit kanë goditur disa lëmi të së drejtës ndërkombëtare. E drejta e luftës është një ndër ato. Parimi kryesor se lufta mund të zhvillohet vetëm mes shteteve u sfidua seriozisht në atë moment kur luftërat për çlirim nacional (çlirimtare) u kualifikuan si luftëra të karakterit ndërkombëtar. Ky kualifikim pati për rrjedhojë edhe ndryshimet e caktuara në vetë *jus in bello*, e cila u quajt si e zbatueshme edhe ndaj luftërave të tilla. Zbatimi i *jus in bello* në këtë lloj luftërash ka kaluar nëpër një histori të gjatë e të mundimshme. Në disa raste, ai zhvillim ka pasuar njohjen e së drejtës për vetëvendosje, kurse në të tjerat, zbatimi i *jus in bello* ka qenë pasojë e zhvendosjes së raportit të forcave në favor të lëvizjeve për çlirim nacional (lëvizjeve çlirimtare). Ç'është e vërteta, rasti i dytë ka dominuar praktikën ndërkombëtare pas Luftës së Dytë Botërore.

Si luftë për çlirim nacional (luftë çlirimtare) përshkruhet konflikti që zhvillohet nga ana e një bashkësie joshtetërore kundër një qeverie të një shteti ekzistues me qëllim sigurimin e së drejtës së mohuar forcërisht për vetëvendosje në favor të popullsisë në emër të së cilës zhvillohet konflikti[551].

Njohja e së drejtës për vetëvendosje, pa marrë parasysh fatin e realizimit të saj konkret, paraqet një fakt të rëndësishëm, i cili drejtpërsëdrejti godet luftën si për sa i përket legjitimitetit të përdorimit të forcës (*jus ad bellum*), ashtu edhe vetë mënyrës së zhvillimit të luftimeve (*jus in bello*).

Nisur nga ky fakt, ne provojmë këtu parashtrimin e një pasqyre të shkurtër të këtyre dy çështjeve për të shikuar vendin e Kosovës në dritën e ngjarjeve të tetë muajve të parë të vitit 1998, të bindur se rasti i Kosovës nuk është dhe as që mund të jetë jashtë kornizave të rregullave të caktuara ndërkombëtare. Njohjen e këtyre rregullave e konsiderojmë si pikën kyçe në luftën tonë për pavarësi dhe arritjen e suksesit në këtë drejtim. Pa marrë parasysh vëllimin, nuk kemi mundur të mos i trajtojmë pikat esenciale të çështjeve si më sipër

---

[551] Cf. Natalino Ronzitti, "Resort to Force in Wars of National Libetarion", në Antonio Cassese, *Current Problems of International Law: Essays on UN Law and the Law of Armed Conflict* (Dott. A. Guiffre: Milano, 1975) fq. 319; Natalino Ronzitti, "Wars of National Liberation: A Legal Definition", në *Italian Yearbook of International Laws* no. 1 (1975) fq. 197; Abdelmadjid Belkherroubi, "Essai sur une théorie juridique des mouvements de libération nationale", në *Revue egyptienne de droit international* no. 28 (1972) fq. 22; Michel Veuthey, *Guerilla et droit humanitaire* (Institut Henry Dunant: Genève, 1976) fq. 11.

në mënyrë që vetëm pastaj të kalojmë në anën konkrete të problemit, pra në çështjen e Kosovës. Kjo edhe për faktin se pa këtë nuk mund të bëhet asnjë analizë serioze e gjendjes aktuale në Kosovë. Në këtë kontekst, aty ku flasim për Kosovën trajtojmë edhe çështjet e diskursit politik e profesional në Kosovë në dritën e konfliktit të armatosur, shkaqet dhe pasojat e tij në luftën për pavarësimin e Kosovës.

Pas kualifikimit të gjendjes në Kosovë si "konflikt armatosur" nga ana e Gjykatës së Hagës, gjërat është dashur të ndryshojnë në diskursin politik e profesional në Kosovë. Me diskurs këtu kuptohet, siç do të shihet, praktika e veprimit në Kosovë dhe më gjerë gjatë këtyre tetë viteve të fundit. Ne konstatojmë në këtë shkrim se nuk ka dallim në diskursin politik e profesional në Kosovë, pra se fjala është për të njëjtën retorikë morbide veprimi e arsyetimi të së drejtës sonë për vetëvendosje.

1. *Jus ad bellum*

Lidhur me çështjen se kush ka të drejtën ndërkombëtarisht të ligjshme për përdorimin e forcës, dallohen dy periudha historike. E para ka të bëjë me kohën kur dominonte ideja tradicionale, kurse e dyta lidhet me zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare të vetëvendosjes dhe njohjes së saj në favor të popujve dhe kombeve të caktuara. Në të dy rastet, megjithatë, fjala është për konceptin e legjitimitetit, i cili mund të kuptohet në sensin e ngushtë dhe të gjerë.

Kuptimi i parë përfshin të drejtën e përdorimit të forcës që barazohet me bazueshmërinë në "ligjin ndërkombëtar", ndërsa i dyti kuptim është i barasvlershëm me kategorinë e moralit, pra nëse një veprim është apo jo "i drejtë" moralisht. Ky raport kurioz mes legjitimitetit si "ligj ndërkombëtar" dhe si "e drejtë morale" nuk na detyron që problemin e sipërm ta trajtojmë dyanësisht, ngaqë qëllimi ynë final është përcaktimi i së drejtës ndërkombëtare të luftës dhe i mënyrës së evoluimit të saj gradual deri më sot, ashtu që pas kësaj ta kërkojmë vendin e Kosovës në këtë kuadër.

2. Konfliktet e brendshme dhe konfliktet ndërkombëtare

Në vijim të idesë së legjitimitetit, përshkruar si më sipër, ka lindur dhe është zhvilluar teoria dhe praktika mbi konfliktet ndërkombëtare dhe të brendshme. Në rastin e parë, ashtu dhe në të dytin, legjitimiteti për përdori-

min e forcës ka dalluar dhe dallon kualitativisht. Megjithatë, dallimi mes tyre nuk ka qenë, e as që është, sa duhet i qartë.

Gjatë shekullit XIII dominonte ideja se vetëm princërit, qytetet-shtetet, lordët feudalë dhe, në disa raste, papati kishin të drejtën e fillimit dhe zhvillimit të luftës. Vetëm në këto raste lufta quhej si "e drejtë". Që nga Paqja e Vestfalisë (1648) e tutje, kjo e drejtë u qe rezervuar vetëm shteteve sovrane. Ky sistem, edhe pse i kritikuar mjaftë për paaftësinë e vet për të kontrolluar dhunën brenda llojit, pra mes shteteve, u tregua si i aftë në kontrollimin e konflikteve brenda shteteve ekzistuese të kohës.

Ndryshimet socio-politike gjatë shekujve XIII dhe XVI prodhuan ndryshimet në teorinë dhe praktikën e kohës mbi legjitimitetin e përdorimit të forcës, njëjtë siç kishte kushtëzuar procesi i dekolonizimit në mesin e shekullit XX ndryshimet në teorinë dhe praktikën e legjitimitetit të kategorisë së njëjtë. Ky i fundit, për dallim nga sistemi pararendës, kishte zgjeruar rrethin e subjekteve me të drejtën e përdorimit të forcës, përveç subjekteve tradicionale, pra shteteve sovrane dhe të pavarura.

Se fillimisht ishin vetëm shtetet ato që konsideroheshin si legjitime në të drejtën e përdorimit të forcës, mund të shihet nga vetë dokumentet ndërkombëtare të kohës, siç janë, bie fjala, dokumentet e Hagës së viteve 1899 dhe 1907. Në këto dokumente flitet vetëm për shtetet sovrane, gjë që tregon se, deri te fundi i shekullit të kaluar dhe fillimi i këtij shekulli, ka ekzistuar faza e rrënjosjes definitive të konceptit se vetëm shtetet mund të zhvillojnë "luftëra të drejta". Zënia në gojë e *jus in bello*, pra e dokumenteve të Hagës (1899 dhe 1907), nuk duhet ta hutojë lexuesin për sa i përket *jus ad bellum* (së drejtës për të luftuar). Në rastin e parë fjala është për rregullat legale që synojnë "zbutjen" e tmerreve të luftës dhe pasojave rrënuese të saj, gjë që thuhet në të gjitha dokumentet mbi *jus in bello* që nga viti 1899 e deri te Protokollet e Gjenevës të vitit 1977. Në të dytin fjala është për atë se kush ka të drejtën për të luftuar dhe kjo rregull, siç u vërejt, ka ndryshuar që nga mesjeta e deri më sot, duke përfshirë në kategorinë e "subjekteve me të drejtën e luftës" edhe popujt dhe territoret e caktuara (vetëvendosja eksterne dhe njohja e saj), pra jo vetëm shtetet sovrane. Me fjalë të tjera, gjykuar sipas dokumenteve ndërkombëtare mbi *jus in bello*, të nxjerra para Luftës së Dytë Botërore, del se *jus ad bellum* u ka takuar vetëm shteteve sovrane, pa marrë parasysh se dokumentet në fjalë në disa raste flasin për "palët ndërluftuese", "ndërluftuesit", "palët në armiqësi me njëra-tjetrën", ose, thjesht, vetëm për "palët".

Arsyeja pse ne ia tërhoqëm vërejtjen lexuesit për si më sipër lidhet me faktin se jorrallëherë ka ndodhur që *jus ad bellum* të legjitimohet përmes *jus*

in bello, veçanërisht gjatë procesit të dekolonizimit dhe kjo gjë po ndodh edhe me Kosovën që nga momenti kur Gjykata e Hagës ka kualifikuar konfliktin në Kosovë si "konflikt të armatosur". Për këtë do të flasim gjerësisht në vijim.

Praktika tregon se realitetet jetësore janë mbi rregullat juridike. E drejta për përdorimin legjitim të forcës, e njohur vetëm ndaj shteteve, nuk ka mundur të pengojë popujt dhe qytetarët e pakënaqur me statusin e tyre që të përdorin forcën për realizimin e të drejtave të veta. Në këtë kontekst janë zhvilluar tri lloje të konflikteve të brendshme, të cilave teoria legale u ka mveshur (njohur) pasojat e caktuara juridiko-ndërkombëtare. Ato janë: rebelimi, kryengritja dhe gjendja e luftës. I pari ka të bëjë me sfidimin sporadik të qeverisë ekzistuese, kurse kryengritja dhe gjendja e luftës janë faza më të larta të konflikteve të brendshme të armatosura. Në këto raste fjala është për rritjen e vazhdueshme të intensitetit të konfliktit dhe bëhet fjalë vetëm për situatat e caktuara kur ekziston një sfidë serioze ndaj qeverisë (shtetit) dhe kur konflikti zhvillohet gjatë një periudhe të konsiderueshme kohore, në një hapësirë të gjerë territoriale dhe me përfshirjen e një numri të madh të popullsisë brenda shtetit të caktuar[552].

Rebelët nuk gëzojnë asnjë të drejtë në të drejtën ndërkombëtare. Atyre u mohohet ndihma nga ana e shteteve të treta, nuk kanë të drejtën e trajtimit si robër të luftës, etj. etj. Me fjalë të tjera, ata i nënshtrohen tërësisht ligjeve të brendshme të shtetit kundër të cilit luftojnë. Edhe pse e drejta ndërkombëtare nuk parasheh kushtet që rebelët duhet t'i plotësojnë për t'u quajtur kryengritës, ata megjithatë duhet të kenë kontroll të mjaftueshëm mbi territorin e dhënë shtetëror dhe formë solide organizimi ushtarak sa për të goditur interesat e shteteve të treta dhe të bashkësisë ndërkombëtare në mënyrë që këta të fundit të detyrohen të futen në marrëdhënie të caktuara me ta. Ose, thënë ndryshe, edhe pse e drejta ndërkombëtare nuk përcakton qartë kushtet e njohjes së kryengritjes (dhe kryengritësve), arsyet e oportunitetit politik, nganjëherë edhe ato të humanizmit dhe të interesit ekonomik të shteteve dhe bashkësisë ndërkombëtare, mund t'i detyrojnë këta të fundit në futjen e kufizuar në marrëdhënie me kryengritësit[553].

Njohja e kryengritësve si palë ndërluftuese dhe e konflikteve të brendshme si konflikte të armatosura i nënshtrohet disa kushteve më të rrepta dhe

---

[552] Richard A. Falk, "Janus Tormented: The International Law of Internal Wars", në James N. Roseneau, *International Aspects of Civil Strife* (Princeton UP: Princeton, 1964) fq. 197.
[553] Hersch Lauterpacht, *Recognition in International Law* (Cambridge UP: Cambridge, 1947) fq. 276-277.

më të qarta se sa në rastin e mësipërm. Edhe pse në praktikën e së drejtës ndërkombëtare, p.sh., gjatë dy luftërave botërore, Luftës Civile në Spanjë etj., njohja e kryengritësve si palë ndërluftuese ka qenë më shumë një problem teorik se praktik, megjithatë, gjendja e tillë ka prodhuar pasoja të caktuara për shtetet e treta dhe atë në planin nacional (kujdesi për mbrojtjen e pasurisë së tyre të gjetur në territorin e kontrolluar nga kryengritësit), ekonomik (ruajtja e interesave tregtare) dhe politik (arsyet e oportunitetit: mbrojtja e shtetasve të ndodhur në territorin e kontrolluar nga kryengritësit). Që kjo gjendje faktike të prodhojë efektet si më sipër duhet të ekzistojë njohja e disa kushteve. Së pari, konflikti duhet të jetë gjerësisht i përhapur dhe me dimensione të luftës së vërtetë. Së dyti, kryengritësit duhet të kontrollojnë pjesë të konsiderueshme të territorit shtetëror. Dhe, së fundi, interesat e shteteve të treta dhe të bashkësisë ndërkombëtare duhet të goditen në atë masë sa ta bëjë të domosdoshëm pozicionimin e tyre kundrejt konfliktit në vijim.

Shtetet e treta dhe bashkësia ndërkombëtare, ashtu sikur edhe vetë shteti ku zhvillohet konflikti, nuk është e domosdoshme që të bëjnë njohjen formale të gjendjes së konfliktit si u përshkrua më sipër. Në fakt, kjo gjë zakonisht edhe nuk bëhet, por janë arsyet që i cekëm më sipër të cilat diktojnë marrëdhëniet e palës kryengritëse me shtetet e treta dhe bashkësinë ndërkombëtare. Një rrethanë të tillë e ka konstatuar Gjykata e ShBA-së në precedentin *Prize Cases* (1862), dhe kjo logjikë është ndjekur edhe me rastin e Kosovës para disa muajsh kur u bë kualifikimi i konfliktit si "konflikt i armatosur" — u mor vesh për arsye të ndryshme nga ato si më sipër në *Prize Cases*.

Nga sa u tha deri tani, mund të nxjerrim disa konkluzione krejt provizore për çështjet e diskutuara këtu, pra lidhur me llojet e konflikteve të brendshme dhe legjitimitetin e përdorimit të forcës dhe pasojave legale në të drejtën ndërkombëtare.

Para se vetëvendosja të njihej si e drejtë ndërkombëtare, ka ekzistuar dallimi i qartë mes konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe atyre që nuk kanë pasur një cilësim të tillë (konfliktet jondërkombëtare të armatosura, apo të brendshme). Në rastin e parë, autoriteti i vetëm që ka mundur të përdorë forcën e armatosur në mënyrë legjitime ka qenë shteti sovran dhe ndërkombëtarisht i njohur. Edhe në këtë fazë, rregullat ndërkombëtare as që dënonin e as që shpërblenin përdorimin e forcës brenda kufijve të një shteti ekzistues. Por, në rastin e rebelimit, rebelët i nënshtroheshin rregullave të ligjit të brendshëm penal, dhe nuk gëzonin mbrojtjen e së drejtës ndërkombëtare të luftës. Gjendja dallonte kur ishte fjala për kryengritjen, ngaqë kryengritësit kishin disa të drejta të kufizuara dhe detyrime brenda territorit nën kontroll

të vetin, si ndaj shteteve të treta, ashtu edhe ndaj bashkësisë ndërkombëtare. Përcaktimi i statusit të palëve në konflikt (rebel, kryengritës dhe palë ndërluftuese në një konflikt të armatosur) përcaktohej nga suksesi ushtarak në terren dhe jo mbi atë nëse përpjekjet e tyre ishin "të drejta". Me fjalë të tjera, "kauza e drejtë" nuk çonte peshë në kualifikimin (në të drejtën ndërkombëtare) të një konflikti të brendshëm në njërën prej formave të sipërcekura. Këto rregulla pak a shumë vlejnë edhe sot në të drejtën ndërkombëtare pozitive.

4. *Jus in bello*

Përgjatë 500 vjetëve të fundit, gradualisht është zhvilluar ideja se, në luftë, mjetet dhe mënyrat e luftimit nuk janë dhe nuk duhet të jenë të pakufizuara; se grupet e caktuara të popullsisë që nuk marrin pjesë aktive në luftime nuk mund të jenë objekt i goditjes ushtarake të palës kundërshtare; dhe së fundi, se luftëtarët e nxjerrë jashtë përdorimit aktiv (*hors de combat*), si p.sh., të plagosurit, robërit etj., kanë të drejta të caktuara në të drejtën ndërkombëtare. Cenimi i këtyre rregullave, me kalimin e kohës, ka paraqitur krim ndërkombëtar.

Rregullat në fjalë fillimisht janë zbatuar vetëm mes shteteve, për t'u shtirë më vonë edhe ndaj entiteteve të tjera pas njohjes së vetëvendosjes si e drejtë ndërkombëtare. Kjo u bë pas Luftës së Dytë Botërore, kur lëvizjet për çlirim nacional (lëvizjet çlirimtare) u njohën si subjekte dhe entitete ndaj të cilave vlente *jus in bello* me të gjitha të drejtat e detyrimet që dalin nga ajo.

Jus in bello, e cila ndryshe quhet edhe "e drejta ndërkombëtare humanitare", përfshinë rregullat "e vjetra" apo tradicionale, si dhe ato "të reja", të nxjerra pas Luftës së Dytë Botërore. Mirëpo, këto rregulla është vështirë të dallohen ashtu si edhe në rastin e *jus ad bellum* (rregullat që vlenin vetëm mes shteteve sovrane). Kjo nuk është e pamundur, ndërkaq, dhe në këtë shkrim ne kemi provuar ta bëjmë një gjë të tillë, pra dallimin mes rregullave "të vjetra" dhe atyre "të reja" (të lindura këtyre 50 viteve të fundit). Kjo edhe nga shkaku se vetëm nga nja analizë e dallimit të këtyre rregullave mund të fokusohet rasti dhe vendi i Kosovën në të drejtën ndërkombëtare të luftës, ashtu si ekziston sot kjo degë e së drejtës.

5. E drejta ndërkombëtare e luftës para dhe pas procesit të dekolonizimit dhe efektet e këtij procesi në planin ndërkombëtar

Sikundër u pa më herët, e drejta ndërkombëtare humanitare deri më 1949 (prej vitit 1899-1949) ka ofruar mbrojtje legale ndërkombëtare vetëm për ata që luftonin në emër të shtetit. Privilegjet e luftës qenë njohur vetëm kundrejt forcave të armatosura shtetërore, policisë ose trupave vullnetare, lëvizjeve të rezistencës që u takonin shteteve palë në konflikt dhe që respektonin nenin 4(2) të Konventave të Gjenevës (mbajtja e shenjave fikse dhe të dallueshme nga distanca, mbajtja e armëve hapurazi dhe përkatësia e njërës prej palëve në konflikt), personave që shoqëronin forcat e armatosura, si dhe pjesëmarrësit e një *levée en masse* (lëvizjeje të armatosur masive). I vetmi përjashtim në mbrojtjen e përfaqësuesve të entiteteve joshtetërore gjendej në nenin 3 të katër Konventave të Gjenevës së vitit 1949, për çka do të flitet në vijim. Megjithatë, në rastet e konflikteve të brendshme të cilat kishin karakteristikat e një konflikti ndërkombëtar (mes shteteve), pra kur ai ndërkombëtarizohej në përmasa që kalonin kufijtë e shtetit sovran, atëherë vlenin rregullat lidhur me mënyrën e luftimit dhe mjetet e lejueshme luftarake për të luftuar kundërshtarin.

Si në rastin e parë, ashtu edhe në të dytin, problemi ka qenë dhe mbetet ai i njohjes së gjendjes së konfliktit të armatosur. Deri sa në rastin e parë (mes shteteve) kjo nuk ka paraqitur ndonjë problem, në të dytin zakonisht ka qenë e pamundur të konfirmohet gjendja e konfliktit të armatosur brenda shteteve sovrane, përkatësisht ajo është mohuar vazhdimisht nga ana e këtyre shteteve në periudhën para dhe pas procesit të dekolonizimit e deri në fillim të viteve 1990. Pas kësaj kohe, kualifikimin e natyrës së konfliktit të brendshëm e kanë bërë jo vetëm shtetet individuale por edhe vetë bashkësia ndërkombëtare mbi bazën e dispozitave të Kartës së OKB-së që kanë të bëjnë me rrezikimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Në disa raste, këtë kualifikim e kanë bërë në emër të bashkësisë ndërkombëtare organet e caktuara gjyqësore, siç është rasti i Gjykatës së Hagës me rastin e konfliktit në Kosovë, ose i gjykatës së Ruandës për krimet në Ruandë të kryera gjatë pranverës së vitit 1994. Megjithatë, si në rastin e njohjes, ashtu edhe pa këtë akt, në konfliktet e brendshme të armatosura, pa marrë parasysh shkallën e ndërkombëtarizimit të tyre, pozita e të zënëve robër të cilët kanë luftuar shtetin e caktuar është varur tërësisht nga mëshira e autoriteteve shtetërore. E drejta ndërkombëtare ka ofruar një ndihmë për personat si më sipër vetëm me nxjerrjen e nenit 3 të përbashkët për Konventat e Gjenevës të vitit 1949, i cili ka shtruar rrugën për

futjen e mbrojtjes ndërkombëtare edhe për lëvizjet për çlirim nacional (çlirimtare) të viteve 1960. Më vonë, ky nen është shtrirë edhe ndaj rasteve tjera të konflikteve të armatosura brenda shteteve sovrane.

Neni 3 i këtyre konventave parashikon që "personat të cilët nuk marrin pjesë aktuale në armiqësi duhet të trajtohen në mënyrë humane". Për këtë qëllim, ai nen ndalon veçanërisht kryerjen e katër veprimeve: përdorimin e dhunës ndaj personit, marrjen peng, trajtimin nënçmues, dhe gjykimin (ekzekutimin ose veprimet e tjera) pa gjyq. Siç mund të vërehet, neni 3 nuk i pengon qeveritë e shteteve që ta shtypin me forcë kryengritjen dhe t'i dënojnë pjesëmarrësit në të mbi bazën e ligjeve të vendit. Po ashtu, ai nuk ofron asnjë status juridiko-ndërkombëtar për pjesëmarrësit në konfliktin e brendshëm të armatosur, gjë që thuhet shprehimisht në paragrafin e fundit të tij. Qëllimi i tij ka qenë për të treguar dhe për të afirmuar se konfliktet e brendshme nuk janë të lëna tërësisht jashtë mbrojtjes të së drejtës ndërkombëtare. Ky nen mbron, megjithatë, vetëm personat që nuk marrin pjesë aktive në konflikt dhe nuk imponon asnjë kufizim lidhur me vetë mënyrën e zhvillimit të luftës (*jus in bello*). Kjo është e meta e parë e nenit.

E meta e dytë e nenit 3 ka të bëjë me faktin se "konflikti i armatosur jo i karakterit ndërkombëtar" nuk definohet nga vetë ky nen, kurse shtetet zakonisht kanë insistuar dhe insistojnë në trajtimin e konflikteve si të brendshme, pa marrë parasysh shkallën dhe intensitetin e tyre, pra duke i ikur referimit në standardet ndërkombëtare[554]. Praktika e veprimit të shteteve gjatë periudhës së dekolonizimit, por edhe më vonë, e dëshmojnë këtë. Rasti i Malajzisë dhe Qipros, Algjerisë dhe Nigerisë, Angolës dhe Mozambikut janë shembuj të tillë, ashtu siç është edhe rasti i ish Jugosllavisë dhe i Bashkimit Sovjetik.

Cila, pra, ka qenë dhe është baza juridiko-ndërkombëtare mbi të cilën qëndron obligimi i shteteve dhe i entiteteve tjera joshtetërore për respektimin e nenit 3 të Konventave të Gjenevës së vitit 1949? Për shtetet, kjo nuk paraqet problem, pasi ai i obligon ato edhe kur nuk janë palë kontraktuese të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, me supozim se e pranojnë zbatimin e tyre praktik. Po ashtu, pala ndërluftuese së cilës iu është njohur statusi i tillë, qoftë nga vetë shteti kundër të cilit lufton ose nga ana e shteteve të treta apo bashkësia ndërkombëtare, obligohet në respektimin e nenit 3, edhe pse nuk është nënshkruese e konventave në fjalë. Respektimi i dispozitës së nenit 3 në

[554] James E. Bond, *Rules of Riot: Internal Conlict and the Law of War* (Princeton UP: Princeton, 1974) fq. 61.

praktikë, me ose pa deklarim formal se pranon një gjë të tillë, obligon dhe bën përgjegjës ndërkombëtarisht palën ndërluftuese së cilës i është njohur një cilësi e tillë.

Problemi më i madh ka lindur me palët ndërluftuese të cilave nuk iu është njohur statusi i tillë. Në teorinë e së drejtës ndërkombëtare të luftës kanë lindur pikëpamje të ndryshme për bazën e përgjegjësisë së palëve ndërluftuese si më sipër, pra të panjohura, kundrejt respektimit të dispozitave të nenit 3. Kjo çështje në praktikë nuk ka prodhuar ndonjë pasojë dhe ka qenë me shumë problem i diskursit intelektual. Kështu e kemi konceptuar edhe ne në këtë shkrim, për të mos e lodhur lexuesin me finesa krejt teorike. Mjafton të themi këtu se, historikisht shikuar, entitetet joshtetërore të llojit të lëvizjeve për çlirim nacional (çlirimtare) në pjesën dërrmuese të rasteve kanë shprehur gatishmërinë për vënien në jetë të dispozitave të nenit 3, për dallim nga shtetet sovrane. Arsyeja për këtë qëndron në faktin e thjeshtë: lëvizjet për çlirim nacional (çlirimtare), të etshme për njohje dhe përkrahje ndërkombëtare, për dallim nga shtetet, rrezikojnë humbjen e simpative të atyre entiteteve virtytet e të cilave lëvizjet në fjalë i synojnë[555]. Izolimi ndërkombëtar i një lëvizjeje për çlirim nacional (çlirimtare) si pasojë e mosrespektimit të dispozitës së nenit 3 të Konventave të Gjenevës do të thotë kompromet im definitiv i saj dhe përfundimisht vetasfiksim i saj dhe paperspektivë totale.

Njohuritë tona modeste nuk na lejojnë të gjykojmë për ndonjë lëvizje çlirimtare të pas-Luftës së Dytë Botërore që të ketë përfunduar si më sipër. Lëvizjet ushtarake të cilat kanë cenuar tërësisht dispozitat e nenit 3, si dhe të tjerat që kanë të bëjnë me të drejtën ndërkombëtare të luftës, nuk kanë qenë lëvizje për çlirim nacional (çlirimtare) por lëvizje të udhëhequra nga kriminelë, të cilët janë ndjekur dhe ndiqen penalisht nga organet kompetente ndërkombëtare. Në këtë kategori bien lëvizjet e serbëve të Kroacisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, liderët e ndryshëm lokalë në Ruandë etj.

Deri këtu diskutuam çështjen e së drejtës ndërkombëtare të luftës para kristalizimit të idesë se vetëvendosja është një e drejtë ndërkombëtarisht e njohur. Që nga ky moment e deri më sot, kanë ekzistuar këto sfida serioze ndaj së drejtës ndërkombëtare të luftës. Dallimi mes konflikteve ndërkombëtare dhe të brendshme është vënë seriozisht në pyetje; e drejta ndërkombëtare humanitare ka gjetur aplikim në fusha tërësisht të reja; dhe së fundi, vetëvendosja ka rrënuar konceptin tradicional mbi ndalimin e përdorimit të forc-

[555] Heather A. Wilson, *International Law and the Use of Force by National Liberation Movements* (Clarendon Press: Oxford, 1988) fq. 52.

ës ashtu siç qe parashikuar në Kartën e OKB-së. Që kjo sfidë të prodhojë rezultatet e duhura praktike në çështjen si më sipër, është dashur të kalojë nëpër një rrugëtim të gjatë, me fillim nga Deklarata mbi Dekolonizimin numër 1514 (XV) e vitit 1960, Deklarata mbi Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare numër 2625 (XXV) e vitit 1970, Paktet mbi të Drejtat e Njeriut (1966), për të kulmuar më 1977 me nxjerrjen e Protokolleve Shtesë në Konventat e Gjenevës të vitit 1949.

Neni 1(4) i Protokollit të Parë në Konventat e Gjenevës të vitit 1949 futi në kategorinë e të mbrojturve edhe popujt që luftojnë për realizimin e së drejtës për vetëvendosje, përkatësisht ata që luftojnë kundër "dominimit kolonial dhe të huaj, si dhe kundër regjimeve raciste". Protokollet e vitit 1977 patën ndikim si në *jus ad bellum* ashtu edhe në *jus in bello*, gjë që shihet nga vetë formulimi i mësipërm. Ky rrugëtim i gjatë dhe i mundimshëm drejt njohjes ndërkombëtare të *jus ad bellum* dhe *jus in bello* (vetëvendosja në kuptimin e gjerë të fjalës) në favor të lëvizjeve për çlirim nacional (çlirimtare) meriton një trajtim më të gjatë, por që tejkalon caqet e këtij shkrimi. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ne nuk duhet të evidentojmë momentet kyçe të këtij zhvillimi, me fillim që nga çështja polake.

Pas Luftës së Parë Botërore, çështja polake u paraqit me tërë ashpërsinë e saj pas një periudhe më se 100-vjeçare dhe atë falë dy rrethanave ndërkombëtare: shpërbërjes së Austro-Hungarisë, rrjedhimisht, neutralizimit të faktorit gjerman në Evropë, dhe fitores së Revolucionit të Tetorit në Rusi. Njohja e një lëvizje për çlirimi nacional (çlirimtare) pa njohur strukturën shtetërore të krijuar nga vetë lëvizja e tillë, e cila në fakt në rastin polak as që ka ekzistuar, për herë të parë u bë me njohjen e Komitetit Nacional Polak me seli në Paris[556]. Një praktikë e ngjashme ka ekzistuar edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, por që dallimi është se në rastin e fundit janë njohur lëvizjet që kryesisht kanë përfaqësuar shtetet ekzistuese që kishin humbur sovranitetin e tyre efektiv si pasojë e okupimit ushtarak nga ana e shteteve të Boshtit (Gjermania, Italia dhe Japonia). Me fjalë të tjera, rasti i pastër i përfaqësimit të një populli pa shtet paraqet vetëm rastin polak, kurse të tjerat janë raste për të cilat nuk flitet në këtë shkrim.

Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore deri më 1964 janë bërë përpjekje të dështuara të vendeve kryesisht ish-komuniste për t'i dhënë një legjitimitet ndërkombëtar luftës kundër kolonializmit. Në tetor të vitit 1964,

---

[556] Green H. Hackworth, *Digest of International Law* (G.P.O.: Washington, D.C., 1940) fq. "i" dhe 319.

në mbledhjen e mbajtur në Republikën e Guinesë, juristët afrikanë e aziatikë qenë të parët ata që formuluan tezën për të drejtën e popujve kolonialë për luftë kundër shteteve metropole. Qytetarinë ndërkombëtare një formulim i tillë e mori vetëm në Rezolutën numër 2105 (XX) të vitit 1965 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Kjo rezolutë ftoi të gjitha vendet "për të ndihmuar moralisht dhe materialisht lëvizjet për çlirim nacional", në ndërkohë që Këshilli i Sigurimit të OKB-së me rezolutën e vet numër 232 (1966), e cila i referohej Rodezisë (sot Zimbabveja), pohoi legjitimitetin e luftës për sigurimin e së drejtës për vetëvendosje të popullit rodezian. Çështja më kontestuese deri në fund të viteve 1960 mbeti ajo se për çfarë lufte bëhej fjalë — të armatosur apo tjetër.

Vetëm më 1970, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së afirmoi shprehimisht njohjen e legjitimitetit të luftës së popujve kolonial dhe popujve nën sundim të huaj për ushtruar të drejtën e tyre për vetëvendosje dhe pavarësi me të gjitha mjetet në dispozicion të tyre. Për më tepër, Asambleja në një rezolutë tjetër të po këtij viti (Rezoluta numër 2625/XXV) ndaloi përdorimin e forcës nga ana e shteteve metropole me qëllim privimin e popujve nën sundim kolonial dhe të huaj që të ushtrojnë të drejtën e tyre për vetëvendosje dhe autorizoi këta të fundit që "të kërkojnë dhe të pranojnë çdo përkrahje në pajtim me qëllimet dhe parimet e Kartës së OKB-së, e në funksion të realizimit të vetëvendosjes". Kjo gjendje e opinionit nuk u ndryshua dhe vazhdoi deri në vitin 1973, duke u shoqëruar me debate karakteristike për kohën e Lutës së Ftohtë.

Vonë, më 1973, Komiteti i Tretë i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së miratoi një rezolutë, e cila më pastaj do të bëhej Rezoluta numër 3070 (XXVIII) e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, me të cilën u konfirmua "legjitimiteti i luftës për çlirim nacional të popujve kolonialë dhe nën sundim të huaj, me të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë këtu edhe luftën e armatosur". Ky formulim kësisoj i ka hapur rrugën definitive rregullimit juridiko-ndërkombëtar të statusit të luftëtarëve për çlirim nga sundimi kolonial, dominimi i huaj, si dhe të statusit të luftëtarëve kundër regjimeve raciste. Një gjë e tillë u kurorëzua me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së numër 3103 (XXVIII) të po këtij viti, e titulluar si "Rezoluta mbi parimet themelore të statusit legal të luftëtarëve që luftojnë kundër sundimit kolonial dhe të huaj si dhe kundër regjimeve raciste".

Gati paralel me këtë aktivitet ndërkombëtar, siç u vërejt më herët, kryesisht në kuadrin e OKB-së, por edhe brenda organizatave të ndryshme regjionale të Azisë e Afrikës, ka shkuar edhe praktika e veprimit të shteteve e

cila lidhet me institucionin e njohjes ndërkombëtare. Në kuptimin më të gjerë, njohja ndërkombëtare (e shteteve, qeverive, lëvizjeve për çlirim nacional si dhe e gjendjeve tjera statusore të lindura në situatat e konflikteve të armatosura) nënkupton pozicionimin e shteteve ndaj veprimeve të caktuara dhe marrjen e përgjegjësisë për një pozicionim të tillë. Në rastin tonë, pra të lëvizjeve për çlirim nacional (çlirimtare), praktika e shteteve pas Luftës së Dytë Botërore e deri më sot ka shkuar në dy drejtime.

Së pari, shtetet kanë njohur para kohe qeveritë e formuara nga lëvizjet për çlirim nacional (çlirimtare). Në rastin e dytë, janë njohur si legjitime ndërkombëtarisht vetëm lëvizjet për çlirim nacional (çlirimtare). Njohja e parakohshme është bërë me qëllim të konfirmimit të legjitimitetit të objektivave dhe veprimeve të lëvizjeve çlirimtare në luftën e tyre për pavarësi dhe, së dyti, për të diskredituar kolonializmin si sistem represiv dhe për të detyruar shtetet metropole të tërhiqen nga kolonitë e tyre[557]. E njëjta gjë vlen, *mutatis mutandis*, edhe për njohjen vetëm të lëvizjeve për çlirim nacional (çlirimtare) si përfaqësues të popujve të caktuar. Në rastin e parë (njohja e parakohshme e qeverive të formuara nga lëvizjet për çlirim nacional) hyjnë rasti i Indonezisë, Algjerisë, Guine-Bisaos, Saharasë Perëndimore dhe, pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, edhe rastet e IRJ të Maqedonisë, Kroacisë dhe Bosnjë-Hercegovisë. Në të dytin, ndërkaq, futen PLO-ja (në favor të Palestinës), ANC dhe PAC (për Afrikën e Jugut), etj. etj. Këto të fundit më shumë i takojnë historisë, dhe pas Luftës së Ftohtë nuk janë shënuar rastet analoge. Njohja e tyre ka arritur zenitin në mesin e viteve 1969-70, kur Organizata e Unitetit Afrikan (OAU) njohu shumicën prej tyre duke i kthyer ato nga peticionistë të thjeshtë në vëzhgues dhe përfaqësues të popujve të tyre pranë shumicës së organizmave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Fjala është për SWAPO-n (Namibia), ZANU dhe ZAPU (Rodezia e Jugut) dhe FNLA, MPLA, PAIGC e FRELIMO (për ish-territoret nën sundimin portugez)[558].

6. E drejta ndërkombëtare e luftës në luftërat për çlirim nacional (çlirimtare)

Zbatimi i së drejtës ndërkombëtare të luftës (e drejta ndërkombëtare humanitare e konflikteve të armatosura, ose *jus in bello*) në konfliktet për çlirim

[557] Heather A. Wilson, *International Law and the Use of Force by National Liberation Movements*, fq. 116.
[558] Heather A. Wilson, vepra cit., fq. 119-120, fusnota 101.

nacional ka hasur në më pak vështirësi dhe rezistencë se kur është fjala për *jus ad bellum*. Kjo gjë u pa deri diku edhe nga shqyrtimet e deritanishme. Megjithatë, ky "mirëkuptim" i shteteve nuk ka kaluar krejt lehtë, gjë që mund të shihet nga debatet e zhvilluara në Konferencën Diplomatike të Gjenevës përgjatë viteve 1974-1977 mbi të drejtën ndërkombëtare humanitare, e cila u mbyll me nxjerrjen e Protokolleve Shtesë, dy sosh, ndaj Konventave të Gjenevës të vitit 1949.

Roli i OKB-së ka qenë më i vogël në promovimin e *jus in bello* në konfliktet lidhur me luftërat për çlirim nacional (çlirimtare). Zbatimi i së drejtës së luftës në këto luftëra, megjithatë, ka qenë konsekuencë logjike e po kësaj politike të OKB-së, siç u diskutua më sipër, e cila u njohu lëvizjeve çlirimtare statusin e veçantë në të drejtën ndërkombëtare, të dallueshëm nga ai i shtetit kolonizator, shtetit të huaj apo shtetit me regjim racist.

Nga dokumentet më të rëndësishme të OKB-së lidhur me statusin e luftërave për çlirim nacional vlen të përmendën Rezoluta 3103 (XXVIII) e vitit 1973, e cila u zu në gojë më herët. Ky dokument parashikon se "statusi legal që parashihet për luftëtarët e Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe të dokumenteve të tjera ndërkombëtare zbatohet edhe ndaj personave të angazhuar në luftë të armatosur kundër sundimit kolonial, të huaj dhe kundër regjimeve raciste". Me fjalë të tjera, luftëtarët e luftërave çlirimtare gëzojnë mbrojtjen e njëjtë juridiko-ndërkombëtare sikur edhe ata të shteteve sovrane dhe ndaj tyre zbatohet *jus in bello* në tërësi që nga Konventat e Hagës e deri te Protokollet e vitit 1977.

Praktika e veprimit të shteteve, siç u theksua, ka qenë më e prirë kah zbatimi i *jus in bello* në luftërat çlirimtare, u mor vesh, kur konflikti ishte i kualifikuar si "konflikt ndërkombëtar". Mirëpo, në fillim, shtetet zakonisht kanë mohuar se konfliktet në vijim ishin të tilla. Vetëm me kalimin e kohës dhe ndërrimin e raportit të forcave shtetet kanë filluar zbatimin e *jus in bello*. Duhet shënuar, po ashtu, se edhe në fillim të konfliktit shtetet kanë lejuar në shumicën e rasteve punën e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq. Kështu ka ndodhur në Algjeri, Angolë, Mozambik e gjetiu, sikundër edhe gjatë luftërave të fundit në ish-Jugosllavi. Më herët, ashtu edhe në rastin e ish-Jugosllavisë, njohja ndërkombëtarisht e rrethanës se fjala është për një konflikt të armatosur ndërkombëtar ka paraqitur kushtin e domosdoshëm për zbatimin e *jus in bello*. Për kohën derisa një gjë e tillë nuk është bërë, kanë vlejtur ligjet e brendshme (penale) të shtetit kundër të cilit zhvillohej lufta çlirimtare.

Parakushtet për njohjen e një konflikti si "konflikt i armatosur ndërkombëtar", në anën tjetër, janë objektive dhe lidhen me intensitetin e konfliktit dhe të vetë luftimeve. Sigurisht që konfliktet e brendshme, trazirat, çrregullimet politike, demonstratat etj. nuk hyjnë në kategorinë e konflikteve të armatosura. Kjo thuhet shprehimisht në nenin 1(2) të Protokollit të Dytë Shtesë. Në anën e shtetit, ndërkaq, kërkohet që ai konflikt t'i ketë të angazhuar në të, përveç policisë, edhe forcat tjera të armatosura, para së gjithash ushtrinë e rregullt[559]. Lëvizjes çlirimtare nuk i kërkohet që ta ketë nën kontroll tërë territorin për t'u plotësuar kushti i mësipërm i "konfliktit të armatosur ndërkombëtar" me qëllim të zbatimit të tërësishëm të *jus in bello.* Krejt çka kërkohet nga lëvizja çlirimtare ka të bëjë me pasjen e një komande unike dhe të përgjegjshme dhe që t'i nënshtrohet një disipline të brendshme sistematike e cila garanton se lëvizja çlirimtare është e aftë për të zbatuar dhe respektuar tërësisht *jus in bello*. Ky kusht, po ashtu, parashihet në nenin 43 të Protokollit të Parë Shtesë.

7. Vendi i Kosovës në të drejtën ndërkombëtare të luftës (*jus in bello* dhe *jus ad bellum* në rastin e Kosovës)

Përkundër praktikës tradicionale të Gjykatës së Hagës për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, sipas të cilës nuk bëhen komente lidhur me hetimet që janë në vijim, prokurorja e kësaj gjykate, Louise Arbour (Luiz Arbur), më 10 mars 1998 deklaroi se Zyra e Prokurorit "është duke mbledhur informacione dhe dëshmi mbi incidentet në Kosovë dhe se do të vazhdojë vëzhgimin e çdo zhvillimi të mëvonshëm". Në shpjegimin e vet për këtë ikje nga praktika tradicionale, prokurori theksoi se "ngjarjet e fundit në Kosovë paraqesin një rrethanë të jashtëzakonshme". Për të larguar çdo dyshim lidhur me mandatin dhe juridiksionin e Gjykatës, Prokurori e bëri të qartë se dhuna e fundit në Kosovë binte nën juridiksionin e Gjykatës së Hagës[560]. Në vijim të kësaj, në muajin maj të këtij viti edhe filloi procedura e krijimit të një ekipi hetues për ngjarjet në Kosovë (Tribunal Update No. 75, 4-9 May 1998).

Këto lëvizje të autoriteteve zyrtare të Gjykatës paraqesin fillimin e internacionalizimit të mirëfilltë juridiko-ndërkombëtar të çështjes së Kosovës, gjë e cila kulmoi me deklarimin e fillimit të qershorit 1998 të zëvendësprokurorit të Gjykatës, Greiham Blewitt (Grejham Bluvit). Blewitt u prononcua lidhur

[559] Heather A. Wilson, po aty, fq. 165.
[560] *Tribunal Update* (The Hague) no. 67 (9-14 March 1998).

me natyrën e konfliktit në Kosovë duke thënë se "padyshim që atje ekziston konflikt i armatosur". Fillimisht, pohoi Blewitt, "shpjegimi zyrtar i Beogradit dhe të tjerëve ishte se atje flitej për veprime anti-terroriste, mirëpo aksionet në vijim nuk lanë asnjë dyshim se në Kosovë nuk është fjala për asgjë tjetër pos për një konflikt të armatosur". Meqenëse në pikëpamje territoriale kurrë nuk ka qenë kontestuese se Gjykata e Hagës përfshin edhe Kosovën, kualifikimi i konfliktit si "konflikt i armatosur" ka hapur rrugën për ndjekjen penale të kryesve të veprave penale ndërkombëtare, para së gjithash të krimit të gjenocidit. Si lajmëtar i parë i një kualifikimi të tillë ishte Këshilli i Sigurimit të OKB-së, i cili në mars të këtij viti kërkonte nga Gjykata që të filloheshin hetimet për krimet eventuale në Kosovë.

Baza juridiko-ndërkombëtare për një definim të tillë të natyrës së konfliktit në Kosovë u gjet nga Gjykata duke u bazuar në një vendim të saj të mëhershëm të dhënë sipas ankesës në rastin e a.q. Tadiq. Me atë rast Gjykata pati konsideruar se:

> një konflikt i armatosur ekziston atëherë kur kemi të bëjmë me përdorimin e forcës së armatosur mes shteteve ekzistuese, ose, kur ajo përdoret mes autoriteteve qeveritare dhe grupeve të organizuara të armatosura, apo, mes vetë grupeve të tilla brenda një territori shtetëror të caktuar.

E drejta ndërkombëtare humanitare e konflikteve të armatosura (*jus in bello*) zbatohet që nga fillimi i konflikteve të tilla dhe shtrihet përtej ndërprerjes së armiqësive, përkatësisht deri sa të lidhet marrëveshja e përgjithshme mbi paqen, apo, kur është fjala për konfliktet e brendshme, deri sa të arrihet një zgjidhje paqësore e konfliktit të tillë të brendshëm. Edhe pse zëvendësprokurori Blewitt nuk e përmend shprehimisht, nga një kualifikim i tillë si më sipër i konfliktit në Kosovë del se, përveç gjenocidit dhe krimeve tjera kundër njerëzimit, edhe krimet e luftës (cenimi i ligjeve dhe zakoneve të luftës) futen nën mandatin dhe juridiksionin e Gjykatës së Hagës[561].

Në Kosovë, nga si më sipër, shihet se është bërë vetëm kualifikimi i konfliktit pa treguar fare nëse është fjala për konflikt të brendshëm apo ndërkombëtar. Dhe çfarë janë pasojat e kësaj? Nisur nga krahasimi me lëvizjet për çlirim nacional (çlirimtare) të kohës së dekolonizimit, të cilat u kualifikuan si konflikte ndërkombëtare në Protokollet e vitit 1977, por që edhe më herët kishin pasur një status të tillë, rasti i Kosovës del sikur është tjetër, përkatësisht se bëhet fjalë për konflikt të brendshëm. E megjithatë, fjala është për fenomenin e njëjtë, por që forma e evoluimit të lëvizjeve për çlirim nacional

[561] *Tribunal Update* (The Hague) no. 80 (23-13 June 1998).

(çlirimtare) të kohës së dekolonizimit dhe këtyre të pasmbarimit të Luftës së Ftohët ndryshojnë, ashtu siç ndryshon vetë fenomeni i luftës dhe mënyra e manifestimit të këtij ndryshimi në dy rastet që diskutohen këtu.

Në vitet 1960 dhe 1970, respektimi i *jus in bello* nga ana e shteteve të involvuara në luftë kundër lëvizjeve për çlirim nacional (çlirimtare) është bërë me qëllim të ikjes nga implikacioni se fjala ishte për njohjen e vet lëvizjeve, pra, respektimi i *jus in bello* bëhej kryesisht me referencë arsyet humanitare (neni 3 i përbashkët për Konventat e Gjenevës të vitit 1949). Në anën tjetër, aktiviteti ndërkombëtar i kohës, i zhvilluar kryesisht nën patronatin e OKB-së, ka qenë i koncentruar kah promovimi i së drejtës për vetëvendosje të këtyre lëvizjeve si mënyrë detyrimi të vendeve metropole (koloniale) në respektimin e *jus in bello* në konfliktet e armatosura me lëvizjet për çlirim nacional (çlirimtare). Arsyeja kryesore këtu ka qenë se kolonitë nuk janë konsideruar si pjesë integrale të shteteve koloniale (metropole) si pasojë e distancës së tyre gjeografike reciproke.

Në rastin e Kosovës, ndërkaq, por edhe në rastet tjera të konflikteve pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, fjala ka qenë dhe është për shpërbërjen e shteteve sovrane dhe për proceset socio-politike dhe legale të shpërbërjes së shteteve. Luftërat e zhvilluara në vijim të shpërbërjes së këtyre shteteve po ashtu kanë pasur dhe kanë një natyrë tjetër, fakt që në doktrinë janë quajtur si "luftërat e llojit të tretë". Ky lloj i luftërave zhvillohet brenda shteteve ekzistuese dhe për çështjet e statusit të komuniteteve të caktuara, intensiteti dhe ashpërsia e të cilave ngjasojnë më shumë me luftërat mesjetare të "tokës së djegur" dhe të "luftërave nëpër fshatra", veçanërisht shikuar nga prizmi i veprimit të autoriteteve shtetërore që synojnë ruajtjen e tërësisë së tyre territoriale. Ky lloj luftërash ka ndërruar tërësisht konceptin klasik klauzevician mbi luftën mes shteteve, rregullat mbi neutralitetin në luftë, armëpushimin dhe ndërprerjen e armiqësive, mbarimin e luftës dhe statusin e palëve në konflikt dhe, mbi të gjitha, rregullat mbi mënyrën dhe mjetet e luftimit (*jus in bello*)[562].

Meqenëse kjo është kështu, pra se fjala është për një shfytyrim të tërësishëm të rregullave mbi *jus in bello* në këtë lloj të luftërave, veçanërisht gjykuar nga prizma e sjelljes së shteteve të involvuara, atëherë bashkësia ndërkombëtare dhe shtetet individuale nuk kanë pasur alternativë tjetër veçse të bëjnë

[562] Martin van Creveld, *The Transfromation of War* (The Free Press: London, 1991) fq. 35-37, 48-49, 192-223; Kalevi J. Holsti, *The State, War, and the State of War* (Cambridge UP: Cambridge, 1996) fq. 13-40.

përpjekjet maksimale për të frenuar dhe kufizuar ashpërsinë dhe tmerret e luftërave të "llojit të tretë". Në anën tjetër, në të njëjtën kohë, shtetet në shpërbërje e sipër janë treguar gati tërësisht të pavullnetshme për të zbatuar dhe respektuar *jus in bello*, të bindura se sovraniteti territorial u siguronte atyre të drejtën e përdorimit pakufi të tërë forcës fizike të cilën e kishin në disponim. Kjo ka pasur për rrjedhojë edhe kryerjen e krimeve të cilat, në mungesë të kualifikimit të konflikteve si të "armatosura", do të kishin kaluar pa u ndjekur penalisht nga institucionet relevante ndërkombëtare.

Në vijim të kësaj duhet shikuar edhe roli dhe rëndësia e kualifikimit të konfliktit në Kosovë si "konflikt i armatosur". Kjo do të thotë, praktikisht, se përgjegjësia penale është e barabartë sikur në rastet e konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe atë për të dyja palët, përfshirë këtu edhe përgjegjësinë për krimet e luftës (cenimi i rregullave dhe zakoneve të luftës). Mbi po këtë logjikë duhet gjykuar edhe kategoria e përcaktimit të vlefshmërisë kohore të së drejtës ndërkombëtare të luftës (*jus in bello* në rend të parë, por, sikundër do të shihet në vijim, me pasoja për *jus ad bellum*), siç janë formuluar në fjalitë "deri në arritjen e një marrëveshjeje të përgjithshme" dhe "deri në zgjidhjen paqësore të konfliktit" (të cilat u përmendën më sipër). Sado që me këtë rast Gjykata ka synuar bërjen e një dallimi mes konflikteve të brendshme dhe të armatosura, vetë fakti se kjo bëhet për qëllim të tregimit të momentit kohor të vlefshmërisë së zbatimit të së drejtës ndërkombëtare humanitare, *jus in bello*, si tërësi dhe pa asnjë përjashtim të ndonjë pjese të saj, tregon se një dallim i tillë është i paqëndrueshëm në praktikë. Po të ishte ndryshe, nuk do të kishte përgjegjësi penale për cenimin e ligjeve dhe të zakoneve të luftës, të cilat vlejnë kryesisht dhe vetëm mes shteteve. Në një rast të tillë, vetëm krimet kundër njerëzimit dhe përgjegjësia për veprën penale të gjenocidit do të kishin vlefshmëri, kurse Karaxhiqi e Mlladiqi do të liroheshin nga pjesa dërrmuese e akuzës së tyre, ndoshta fare edhe nga aktakuza. Kjo tregon njëkohësisht dhe kualifikimi i konfliktit si "i armatosur" ka qenë dhe është mënyrë e legjitimimit të së drejtës për vetëvendosje dhe mosinkurajim i terrorizmit si mënyrë luftimi, përkatësisht ndëshkim i akteve kriminale, kurse vetë realizimi efektiv i kësaj të drejte i lihet raportit të forcave mes palëve në konflikt. Se kjo është kështu do të zbërthehet në vijim të tekstit këtu, pasi të kemi bërë një paraqitje të shkurtër të rëndësisë së njohjes së rregullave juridiko-ndërkombëtare për çështjet e luftës dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me zgjidhjen e krizës në ish-Jugosllavi.

Nga puna e deritanishme e Gjykatës së Hagës rreth krizës në Kosovë, lexuesi mund të nxjerrë lehtë konkluzionet e duhura për vendin e Kosovës në të

drejtën ndërkombëtare të luftës, tani dhe në të kaluarën. Kjo veçanërisht po të kihen parasysh shqyrtimet e mësipërme rreth së drejtës së luftës. Në po këtë mënyrë, lexuesi mund të vërejë se rregullat juridiko-ndërkombëtare çojnë peshë mjaft të madhe në luftën e një kombi për çlirim nacional. Zaten, vetëm përpjekja për liri nuk sjell rezultatet e duhura po nuk u shoqërua me një njohuri solide të regjimit, rregullave aktuale si dhe njohje të institucioneve ndërkombëtare, objekt diskutimi i të cilave ka qenë Kosova këtu e tetë vite. Me fjalë të tjera, përdorimi i forcës në të drejtën ndërkombëtare, ashtu si çdo përpjekje tjetër politike, i nënshtrohet rregullave të caktuara ndërkombëtare, njohja e të cilave është e domosdoshme nga ana e atyre që ushtrojnë forcë ose bëjnë përpjekje të caktuara për arritjen e qëllimeve politike relevante. Po të mos ishte kështu, pra sikur përdorimi i forcës në të drejtën ndërkombëtare të ishte i pakufizuar, ish-Bashkimi Sovjetik nuk do të shpërbëhej kurrë, ashtu sikur që edhe vetë Serbia do të mbante me dhunë të gjitha ish-republikat jugosllave dhe ndoshta do të okuponte edhe ndonjë vend tjetër fqinj.

Në këtë drejtim, pra në sensin e mosnjohjes së rregullave ndërkombëtare për përdorimin e forcës në rrugën e vet për kurorëzimin e përpjekjeve për liri dhe pavarësi, lidershipi i Kosovës dje, ashtu si edhe sot, duket qartë se nuk ka qenë sa duhet koshient. Qëllimi i këtij shkrimi ka qenë dhe është dhënia e një kontributi sado modest në nxitjen e kësaj koshience, edhe pse në paraqitjet publike, njëri nga autorët e këtyre rreshtave, Enver Hasani, nuk ka hezituar kurrë për të vënë në pah gjërat si më sipër dhe të atyre në vijim. I pari shkrim publik për rregullat që duhet njohur sa i përket përdorimit të forcës është bërë që në korrik të vitit 1995 në shkrimin me titull "Të gjitha Gjykatat e Hagës", botuar në *Rilindja Javore* e Tiranës. Shkrimi në fjalë pati qenë reagim implicit ndaj deklaratave pompoze të disa juristëve në Kosovë për "përfshirjen e Kosovës në procedurën para Gjykatës së Hagës", gjë që fare nuk ishte e vërtetë dhe paraqiste mosnjohjen elementare të rregullave të kësaj Gjykate dhe të atyre rregullave që flasin për përdorimin e forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Atëherë, ashtu si edhe sot, kemi konsideruar se diskursi politik dhe mënyra se si mendojmë ka shumë rendësi dhe ndikim në rrjedhat politike në Kosovë, marrë parasysh kulturën politike të përgjithshme ndër ne. A nuk ishte vetëm një përpjekje minimale politike e liderëve gjatë viteve 1989-90 se në Kosovë duhet ndjekur rruga paqësore për liri dhe pavarësi ajo që i qetësoi dukshëm qytetarët e Kosovës dhe i rreshtoi ata në një front të përbashkët të emërtuar si "rezistenca aktive paqësore"? Po kështu, a nuk u desh shumë mund pas vitit 1995 e deri sot që të binden po këta qytet-

arë të Kosovës se edhe alternativa tjetër e kundër me atë të rrugës paqësore nuk është e përjashtueshme në rrugën e lirisë dhe të pavarësisë? Këto dy momente i cekëm për të treguar se sa ndikim kanë në Kosovë liderët politikë dhe sa mund të jetë tragjike ndjekja e një diskursi tjetër, me ose pa vetëdije, i cili mund të bie ndesh më vullnetin politik të deklaruar që më 1991. Dhe, ky diskurs i tillë kundër këtij vullneti është ndjekur dhe po ndiqet kohë pas kohe nga liderë të caktuar dhe intelektualë të Kosovës. Rreshtat në vijim i dedikohen kësaj çështje. Kjo analizë duhet vazhduar me problemin e kualifikimit të konfliktit në Kosovë, pra aty ku mbetëm më herët, sepse përmes kësaj kategorie reflektohet e tërë problematika e çështjes së Kosovës.

Kualifikimi i gjendjes në Kosovë nga ana e Gjykatës së Hagës si "konflikt i armatosur" është bërë me qëllim të krijimit të parakushteve për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare të luftës. Ky kualifikim ka për pasojë tri gjëra. Së pari, kualifikimi është shenjë e dallueshme për ndjekjen penale ndërkombëtare të të gjithë atyre që mund të kenë kryer krime lufte dhe krime të tjera kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare humanitare. Së dyti, në mënyrë të tërthortë, kualifikimi ka për rrjedhojë njohjen e lëvizjes së armatosur në Kosovë si një lëvizje për çlirim nacional (çlirimtare), pra jo si lëvizje terroriste, qëllimi i të cilës është realizimi i së drejtës për vetëvendosje, të mohuar forcërisht nga Serbia. Së fundi, ai kualifikim ka hequr prej dorës së Serbisë argumentin se fjala është për një çështje të brendshme në zgjidhjen e të cilës mund të përdoret në mënyrë legjitime e gjithë forca shtetërore serbe. Nuk çon fare peshë moslejimi nga ana e Serbisë i vizitës së prokurores së Gjykatës së Hagës, Louise Arbour, më 5 nëntor 1998, në emër të sovranitetit serb mbi Kosovën dhe argumenteve të tjera se fjala është për një problem të brendshëm të të a.q. RFJ (Serbia dhe Mali i Zi)[563]. Respektimi i vendimeve dhe vetë autoritetit të kësaj gjykate herët a vonë do të ndodhë për të gjitha palët në Kosovë dhe më gjerë. Vendimi i Këshillit të Sigurimit të OKB-së i datës 17 nëntor 1998 e bën të qartë këtë mesazh.

Ky partneritet në kualifikimin e konfliktit në Kosovë mes kriterit objektiv (territori i Kosovës si pikë referimi e pashmangshme në kualifikimin e konfliktit si "të armatosur") dhe atij subjektiv (realizimi i së drejtës për vetëvendosje të popullit shumicë në Kosovë) përbën bërthamën e së drejtës ndërkombëtare legjitime për përdorimin e forcës nga ana e UÇK-së si forcë e armatosur e popullit shumicë të Kosovës. Ky legjitimim kësisoj, i bërë në mënyrë të tërthortë, pra përmes *jus in bello*, duhet të vlerësohet seriozisht dhe mbi të

[563] CNN, *News*, 20:00 CET.

gjitha me veprime ushtarake korrekte në terren, por edhe me një mençuri të krahut politik të UÇK-së gjatë proceseve eventuale politike, me fillim që nga marrëveshjet lokale ose të përgjithshme për armëpushim, marrëveshjet për këmbimin e robërve dhe të të plagosurve e deri te negociatat rreth statusit të Kosovës (të përkohshëm dhe përfundimtar).

E lidhur ngushtë me statusin e Kosovës është edhe vetë pozita e UÇK-së kundrejt së drejtës së saj për përdorimin legjitim të forcës në të drejtën e sotme ndërkombëtare. Kjo çështje kërkon sqarime të tjera edhe më të thella nga sa më sipër, para së gjithash, sqarim të fakteve që lidhen me pozitën aktuale juridiko-politike të Kosovës. Me fjalë të tjera, duhet spastruar njëherë e përgjithmonë dhe në mënyrë kompetente e të argumentuar kuadrin ligjor ndërkombëtar brenda të cilit Kosova trajtohet sot dhe është trajtuar deri dje. Vetëm pasi të jetë bërë kjo mund të përcaktohet saktësisht edhe caku i fundit deri ku mund të arrihet me luftë të armatosur dhe, e kundërta, çka tolerohet nga bashkësia ndërkombëtare, përkatësisht çka quhet përdorim legjitim i forcës nga ana e UÇK-së në kuptim të rregullave të së drejtës pozitive ndërkombëtare. Pa një shikim retrospektiv të historikut të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe të diskursit politik të ndjekur në Kosovë në këto vite, kjo gjë nuk mund të përcaktohet lehtë.

Në fillim të shpërbërjes së atij shteti, bashkësia ndërkombëtare u ndesh me një rast fare të ri të vetërrënimit të një shteti ekzistues, pra me realizimin e së drejtës për vetëvendosje jashtë kontekstit kolonial. Në këtë drejtim praktika e shteteve ishte fare e varfër, gjë që detyroi bashkësinë ndërkombëtare, në radhë të parë Unionin Evropian (atëherë Bashkësia Evropiane, BE) që të mbështetej kryesisht në praktikën ndërkombëtare të procesit të dekolonizimit. Se kjo do të jetë kështu qe parë qartë më herët nga një deklaratë e ish-sekretarit të jashtëm britanik, Douglas Hogg (Daglas Hog), i cili i propozoi Sllobodan Millosheviqit në verën e vitit 1991 që të respektonte parimin e mosndryshimit të kufijve të ish-republikave jugosllave (parimi i a.q. *uti possidetis*, i cili ishte zbatuar në Amerikë Latine, Afrikë e Azi gjatë procesit të dekolonizimit). Kjo qe shenja e parë se vetëvendosja në ish-Jugosllavi, pra edhe përdorimi eventual i forcës, kur realizmi i saj mohohej nga tjerët, do të jetë territorialisht i bazuar, me referencë fillestare kufijtë e ish-republikave. Kundrejt Serbisë dhe Kroacisë dhe përpjekjeve të tyre të Karagjorgjevës për zgjerim territorial përmes ndarjes së Bosnjë-Hercegovinës, kjo paraqiste një goditje të rëndë dhe apriori delegjitimonte ndërkombëtarisht çdo përdorim force jashtë territoreve të tyre respektive. Kjo rregull, që më vonë u operacionalizua deri në detaje në mendimet e Komisionit Badinter (1991-93) dhe në

Kriteret Unionit Evropian për Njohjen e Shteteve të Reja në Bashkimin Sovjetike dhe në Evropën Lindore (16 dhjetor 1991), nuk ndryshoi që atëherë. Marrëveshja e Dejtonit (1995) shënoi kurorëzimin e kësaj filozofie të bashkësisë ndërkombëtare. Në dokumentet në fjalë, si kritere korrektuese përveç territorit u parashikuan edhe sundimi i ligjit, demokracia dhe respekti për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve. Mosrespektimi i këtyre rregullave e bënte realizimin e vetëvendosjes të bazuar territorialisht të pavlefshme ndërkombëtarisht, për të qenë rasti i të a.q. RFJ (Serbia dhe Mali i Zi) shembull tipik në territorin e ish-Jugosllavisë.

Mjetet për detyrimin e atyre entiteteve të reja për t'i respektuar rregullat si më sipër në fillim u dukën sikur janë joefektive. Vënia e sanksioneve ekonomike më 1992 ndaj Serbisë dhe Malit të Zi ("RFJ") dhe më vonë sulmet ushtarake të NATO-s mbi bazat serbe në Bosnjë-Hercegovinë, të ndërmarra në pajtim me dispozitat e Kreut të VII të Kartës së OKB-së, qartë treguan për një efektivitet më të madh në zbatimin e rregullave ndërkombëtare mbi mënyrën e realizimit të vetëvendosjes. Vënia e "murit të jashtëm të sanksioneve" (1995) qe deri vonë mjeti i vetëm i detyrimit të Serbisë dhe Malit të Zi ("RFJ") për respektimin e rregullave si më sipër kundrejt Kosovës, por pa ndonjë sukses. Vetëm atëherë kur u bë kërcënimi serioz për zbatimin e kreut të VII të Kartës së OKB-së, regjimi në Beograd u detyrua të bëjë koncesione, sado që jo të mjaftueshme, të cilat lidhen me kriteret e sipërcekura. Sigurisht që aspektet gjeostrategjike si në njërin rast ashtu dhe në tjetrin e kanë luajtur rolin vendimtar në zbatimin e rregullave të paracaktuara të lojës lidhur me vetëvendosjen, sado që rasti i Kosovës ka qenë i trajtuar që nga fillimi në një kuadër më të dobët juridiko-ndërkombëtar se Bosnjë-Hercegovina. Kjo në një mënyrë ka pasur për rrjedhojë trajtimin e Kosovës dhe të a.q. RFJ (Serbia dhe Mali i Zi) sikur ish-republikat tjera jugosllave para shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, pra duke i mohuar gradualisht legjitimitetin regjimit në Beograd mbi bazën e natyrës së tij represive në Kosovë dhe mënyrën koloniale të qeverisjes së Kosovës.

Sado që duket paradoksale, "muri i jashtëm i sanksioneve" nuk ka pasur për qëllim dobësimin ose rrënimin e të a.q. RFJ, por pikërisht njohjen dhe konfirmimin e saj si shtet të ri në të drejtën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, por jo edhe si kontinuitet (vazhdimësi) i ish-Jugosllavisë. "Muri i jashtëm i sanksioneve" ka pasur për detyrë parësore futjen në binarë të komunikimit normal ndërkombëtar të këtij shteti të ri, pra, që ta detyrojë atë në sjellje konform ambientit ndërkombëtar që e rrethon. Në vijim të kësaj logjike duhen shikuar edhe përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për të joshur Malin e

Zi në një distancim të theksuar nga regjimi në Beograd, që njëkohësisht ka qenë edhe kërcënim për Beogradin se shteti i ri sërish mund të shpërbëhet dhe, në të njëjtën kohë, tolerimin e dhunës së vazhdueshme në Kosovë. Kulmi i kësaj logjike u arrit në fillim të marsit 1998, kur Robert Gelbardt, i dërguar amerikan, deklaroi se "UÇK-ja edhe mund të jetë [terroriste]", në një intervistë dhënë një reviste në Beograd, për të pohuar në qershor të po këtij viti se ajo nuk është e tillë.

Sado që reagimet e shqiptarëve ndaj deklaratës së parë kanë qenë naive dhe të pamatura, mesazhi i saj megjithatë nuk ka qenë i drejtuar as kundër UÇK-së e as kundër Kosovës dhe së drejtës së saj për vetëvendosje. Ajo është bërë me referencë në sistemin juridik amerikan dhe ka paraqitur edhe një test serioz për Beogradin për të matur forcën e tij kundrejt vullnetit politik të popullsisë në Kosovë: nëse UÇK-ja do të ishte e tillë, atëherë regjimi në Beograd do ta shuante atë rrufeshëm (çka edhe ka shpresuar) e nëse jo, atëherë do të dilte në pah (ashtu siç doli) paaftësia e regjimit në fjalë për të sunduar një territor dhe popullsi sipas standardeve të përcaktuara ndërkombëtare në dokumentet e sipërcekura të Komisionit Badinter dhe të UE-së. Ky delegjitimim kësisoj, në rastin e Amerikës Latine, Afrikës dhe të Azisë gjatë procesit të dekolonizimit shprehej me fjalët *carence de souveraineté* (mungesë sovraniteti) ndaj një territori dhe popullsie të caktuar. Një situatë e tillë, përkthyer në terminologjinë juridiko-ndërkombëtare, barazohet në të drejta dhe detyrime për palët me gjendjen e okupimit ushtarak ose me kategorinë e sundimit të huaj. Në fakt, se një gjendje e tillë ekziston në Kosovë u pohua që në mars të vitit 1997 nga vetë Sekretarja amerikane e Shtetit, Madeleine Albright (Medlin Olbrajt), dhe më 20 shtator të po këtij viti edhe nga i dërguari i posaçëm amerikan, Richard Holbrooke (Riçard Holbruk). Ky i fundit foli për "*freedom fighters*" (luftëtarët e lirisë) në Kosovë. Këtu nuk duhet harruar edhe dëshminë mjaft të hershme para Kongresit Amerikan të ish-Sekretarit të Shtetit, James Baker (Xhems Bejker), e bërë në verën e vitit 1991, i cili e karakterizoi regjimin në Beograd si okupues dhe tejet represiv.

Këto konfirmime publike të situatës në Kosovë, krahas atij të bërë nga ana e Gjykata e Hagës, paraqesin njohjen më të fortë juridiko-ndërkombëtare dhënë Kosovës në rrugën e saj të legjitimimit të së drejtës për vetëvendosje dhe përdorim force në një kohë kur realizimi i kësaj të drejte filloi të mohohej nga Serbia. Këto arsyetime ngërthejnë bindjen implicite ndërkombëtare se në Kosovë fjala është për "mungesë sovraniteti" mbi një territor saktësisht të definuar, definim që del nga vetë fakti i banimit të tij me një shumicë dërrmuese shqiptare, e jo mbi bazën e ndonjë interpretimi dogmatik të Kushtetutës

së vitit 1974.

Po çfarë ka qenë dhe është diskursi politik, juridik dhe profesional në Kosovë lidhur me këto çështje?

> Meqenëse Kosova binte në pikëpamje kushtetuese në kategorinë diskrete, jo sovrane, të entiteteve federale, bazuar në nenin 4 dhe jo 3 të Kushtetutës së vitit 1974, argumenti i Kosovës për barazim me republikat tjera u injorua. Në retrospektivë, duket të ketë qenë më mirë për kosovarët sikur të kishin ndjekur linjën tjetër të argumentimit: meqenëse Badinteri është thirrur në parimet tradicionale antikoloniale, me qëllim të kuptimit dhe të sqarimit të pozitës së elementeve federalë (*uti possidetis*), dhe duke marrë parasysh definimin territorial të Krahinës së Kosovës, pozitën e saj kushtetuese dhe natyrën e sundimit serb atje, kosovarët kanë pasur mundësi të mbështeten në referencën e Badinterit mbi kolonializmin dhe të argumentojnë se rasti i tyre nuk është edhe aq problem që futet në shpërbërjen e rrëmujshme të një federate komuniste se sa çështje e një kolonializmi të drejtpërdrejtë.

Këto fjalë nuk janë të autorëve të këtij shkrimi, por fjali të një eksperti të njohur ndërkombëtar për çështjet ushtarako-politike dhe juridike[564], të cilat reflektojnë tërë mesazhin të cilin ne e kemi përsëritur këtyre tetë viteve në shkrimet tona publike dhe që do ta ripërsërisim në mënyrë të kondensuar edhe në vijim. Fjalët e sipërme janë njëkohësisht edhe pasqyrë intelektuale në të cilën duhet të shikojnë dhe aty ta kërkojnë turpin dhe mjerimin e vet kreatorët e diskursit politik e profesional në Kosovë gjatë këtyre tetë viteve, pa përjashtim. Këtu nuk është fjala për finesa teorike legale, veçse për një diskurs politik të ndjekur dhe të kultivuar këtyre viteve me paramendim, gjë që ka pasur për pasojë viktimizimin e panevojë dhe përtej mase të popullsisë shumicë në Kosovë. Për të qenë paradoksi më i madh, as UÇK-ja nuk bën përjashtim nga ky diskurs, përfundim që ne e kemi nxjerrë nga një promemorie e saj të lëshuar në mesin e muajit shtator të vitit 1998, publikuar nga Qendra për Informim e Kosovës në një nga numrat e saj të atyre ditëve.

Nga leximi i kësaj promemorie menjëherë vërehet dhe të bien ndërmend të gjitha ato shkrime morbide për historinë legale dhe tjetër të Kosovës, të cilat opinioni kosovar dhe më gjerë i ka dëgjuar këtyre viteve në të gjitha nivelet, prej konferencave për shtyp të liderëve politikë e sindikalë e deri te tubimet me pretendime shkencore. Ku qëndron, në të vërtetë, morbiditeti i këtij diskursi ndër ne? Për t'u përgjigjur në këtë pyetje, çdo gjë duhet filluar

---

[564] James Gaw, *Triumph of the Lack of Will: International Diplomacy and the Yugoslav War* (Columbia UP: New York, 1997) fq. 76, fusnota 26.

me historinë e teorisë dhe praktikës komuniste, të cilat rrënjët të kësaj teorie dhe praktike gjenden te Stalini dhe koncepti i tij famoz lidhur me zgjidhjen e "çështjeve nacionale".

Para se të fillojmë me Stalinin, duhet të sqarojmë se çka nënkuptohet këtu me "diskurs politik e profesional" në kontekstin kosovar dhe më gjerë, për të mos qenë të akuzuar se fjala është për stërhollime teorike pa asnjë pasojë praktike. Diskursi në kontekstin tonë nuk është sinonim i gjuhës së përdorur. Ai i referohet një spektri të gjerë praktikash socio-politike, i cili i ka dhënë kuptimin vet mënyrës sipas së cilës populli shumicë në Kosovë e ka kuptuar vetveten dhe sjelljen e tij. Një diskurs si ky ka prodhuar dhe po prodhon kategoritë kuptimore përmes së cilave realiteti kosovar perceptohet dhe shpjegohet. Më saktë, diskursi i tillë ka bërë dhe po bënë që "realiteti" i përshkruar nga ai të jetë kuptimplotë kundrejt çdo gjëje tjetër. Duke bërë këtë, diskursi politik e profesional në Kosovë, me referencë Kushtetutën e vitit 1974, ka krijuar dhe po krijon parakushtet socio-politike e linguistike brenda të cilave teoria dhe praktika e tyre "realiste" duhet të zhvillohet dhe, mbi këtë bazë të zgjidhet edhe çështja e Kosovës dhe e së drejtës së saj për vetëvendosje. Ky diskurs i shfytyruar ka krijuar dhe po krijon definimin e gjërave të cilat në asnjë mënyrë nuk përkojnë me realitetin. Konferenca Ndërkombëtare mbi të Drejtën e Kosovës për Vetëvendosje, mbajtur në Beograd nga data 22-23 nëntor 1998, nën patronatin e Komitetit Serb të Helsinkit, paraqet shembullin e fundit të këtij diskursi. Pjesëmarrësit nga Kosova në Konferencë, thuhej në raportin e *Deutsche Welle*-s ("Dojçe Vele", emisioni në gjuhën shqipe) të ditës së fundit të punimeve, u pajtuan se vetëm Kosova e barabartë me Serbinë dhe Malin e Zi është zgjidhje reale e problemit të Kosovës, e pranueshme për shqiptarët. U mor vesh, në emër të Kosovës folën në tubimin e cekur po ata individë që në emër të "realpolitikës" dhe "guximit qytetar" kishin mbushur revistat e huaja me propozime "reale" për Kosovën si "republikë të tretë" ose diçka ngjashëm me "autonominë e vitit 1974". Gjithnjë në këtë vijim, këta individë, kryesisht të "shoqërisë së hapur", vullnetin politik të Kosovës e kanë gjykuar dhe e gjykojnë jo mbi bazën e Referendumit të vitit 1991, por në mënyrën tipike staliniste, nga edhe e kanë marrë edukatën e tyre politike, me ose pa vetëdije.

Premisa staliniste, siç dihet, për gjykimin e një vullneti politik (individual e kolektiv) është fare e thjeshtë: populli e individi nuk dinë asgjë, prandaj në vend të tyre duhet të flasin dhe vendosin të tjerët diku gjetiu. Ky digresion i shkurtër na hap rrugën për t'iu kthyer çështjes së Stalinit që u cek më sipër.

Para Revolucionit të Tetorit, Lenini kishte angazhuar Stalinin që, duke mos qenë rus, të përpilonte një koncept komunist mbi kombin dhe zgjidhjen e "çështjeve nacionale". Ky vendim famëkeq i Leninit do të prodhojë në vitet në vijim pasoja të paparashikueshme për problemet nacionale nëpër ish-vendet komuniste. Esenca e tij, në fakt, ishte realpolitika dhe sanksionimi i raportit të forcave brenda këtyre shteteve. Ai koncept stalinian bazohej në definimin e kombit mbi mbështetjen në elementet e a.q. objektive (gjuha, territori, popullsia, tradita etj.), pa marrë parasysh anën subjektive të çështjes, pra çka dhe si ndihej vetë individi në pikëpamje nacionale dhe si pjesëtar i kolektivitetit të caktuar. Të drejtën për deklarim të tillë e kishin vetëm partitë komuniste si avangardë, jo individët. Kjo ua dha mundësinë komunistëve që të mohonin kombet ekzistuese (p.sh., hebrenjtë, kalmukët, tatarët etj., në Bashkimin Sovjetik, ose shqiptarët dhe hungarezët në ish-Jugosllavi) dhe krijimin brenda nate të kombeve që nuk kishin ekzistuar më herët (p.sh., rasti i maqedonëve, myslimanëve boshnjakë etj.). Përveç këtij plani sociologjik, implikimi tjetër i teorisë komuniste ishte edhe në planin juridiko-politik, çka neve këtu na intereson më së shumti.

Komunistët zbuluan konceptin juridiko-kushtetues të autonomisë politiko-territoriale, mbi bazën e konceptit të sipërcekur për zgjidhjen e "çështjeve nacionale", për t'ua imponuar atë koncept kombeve të caktuara dhe për të mundësuar ndarjen arbitrare të territoreve etnikisht kompakte. Statusi juridiko-politik i republikës u rezervua vetëm për kombet, pa marrë parasysh nëse populli i caktuar ishte i tillë apo jo në momentin e krijimit të "republikës komuniste". Kjo është tërë filozofia e teorisë dhe praktikës komuniste, e cila vlen edhe për Kosovën dhe Konferencën e Bunjajt (1943-1944), Kushtetutën e ish-RSFJ dhe të KSA të Kosovës (1974) dhe tërë historikun komunist të Kosovës.

Bunjaj u organizua si kundërpeshë e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, fakt që është shpjeguar shumë qartë nga Noel Malcolm (Noel Malkolm) në *Kosova: një histori e shkurtër* (1998). Vetë koncepti i saj për vetëvendosjen, si u përshkrua më sipër, ka qenë i gjykuar të dështojë mu ashtu siç ka ndodhur në praktikë në mbledhjen e Prizrenit (1945). Në vijim të kësaj logjike, territoret shqiptare u vunë në ankand publik me pyetjen nëse ato do t'u takonin Serbisë, Maqedonisë apo Malit të Zi. Partia Komuniste e Jugosllavisë, si avangardë e ndihmuar edhe nga kuadrot komuniste shqiptare, vendosi që Kosova t'i "takonte" Serbisë, kurse viset e tjera t'u jepen fqinjëve për t'i bërë ata me republikë dhe, rrjedhimisht, edhe për t'i futur në procesin e formimit si kombe/republika të reja. Arsyetimi komunist i kohës ishte po ai që e kishte

bërë Lenini kur kundërshtoi ndarjen e Polonisë nga Rusia. Ngjashëm kishte ndodhur edhe kur ishte thyer rezistenca fillestare e Malit të Zi për të qenë republikë, fakt që vetë Millovan Gjilas e pohon në memoaret e veta. Ajo u thye nga Tito dhe avangarda komuniste meqenëse ai, pra Mali i Zi, i duhej Titos në lojën e tij të brendshme të raportit të forcave dhe luftës për pushtet. Në vijim të kësaj, duhet shikuar edhe themelimin e IRJ të Maqedonisë më 1945, rrethanë e krijuar nga vetë Tito për të kontrolluar "çështjen maqedone" në luftën e tij për hegjemoni rajonale (ideja e Stalinit dhe e bullgarëve për një Federatë të Ballkanit), në njërën anë, dhe për të përzier duart më lehtë në Luftën Civile në Greqi, në anën tjetër.

Edhe Kushtetuta e vitit 1974 dhe autonomia e Kosovës kanë qenë në kuadër të këtyre kombinacioneve të realpolitikës komuniste, në asnjë mënyrë fryt i ndonjë "demokratizimi të Jugosllavisë", aq më pak si instrument i bërë për të transformuar Kosovën në ndonjë *corpus separatum* kundrejt Serbisë, siç thuhet në diskursin morbid në Kosovë. Përkundrazi, autonomia e vitit 1974 ka qenë kulmi i "ekstazës komuniste të tipit avangardë", i arbitraritetit të skajshëm në prishjen e identitetit ekzistues fizik dhe politik të trojeve etnike shqiptare në Ballkan.

Kjo është gjendja në të cilën është gjendur ish-Jugosllavia në momentin e shpërbërjes. Nga kjo situatë kanë përfituar kombet sllave, pa asnjë dyshim, nisur edhe nga vetë logjika se shteti në fjalë është definuar si shtet i sllavëve të jugut (me përjashtim të bullgarëve). Meqenëse kjo është kështu, pse atëherë kaq shumë është vajtuar dhe vajtohet pozita e Kosovës së viteve 1974-1989? Deri në vitin 1997, autorët e këtyre rreshtave kanë besuar se një gjë e tillë po bëhej për arsye të mosnjohjes së ligjshmërisë së krijimit dhe shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, sado që në diskursin kosovar qartë vëreheshin shenjat e një nostalgjie për të kaluarën komuniste. Kur një pjesë e autorëve të këtij diskursi filloi të botojë në gjuhë të huaj, atëherë njëri prej koautorëve të këtij shkrimi, Enver Hasani, u detyrua që të futej në polemikë publike me disa prej tyre. Qëllimi i vetëm ishte dhe mbetet ai i pengimit të riprodhimit të mëtejmë të ideve morbide për historikun e vetëvendosjes së Kosovës dhe të çështjes shqiptare në përgjithësi. Lexuesit shqip do t'i kujtohet polemika në fjalë e botuar në *Rilindja* e muajit korrik 1997 (botimi në Tiranë dhe në diasporë).

Ishte ky sfondi intelektual që koautorët e identifikuan dhe e patën parasysh kur lexuan promemorien e sipërcekur të UÇK-së. Pse, tani, UÇK-ja duhet të vazhdojë një diskurs të tillë, politik e profesional, të dështuar? Shpjegimi i këtij fenomeni, nuk do mend, kërkon një analizë të ngjarjeve të

këtyre muajve (shkurt-tetor 1998).

Pa u futur në shkaqet e lindjes së UÇK-së, simpatitë e skajshme që ajo ka gëzuar dhe gëzon brenda dhe jashtë Kosovës, paraqitja e saj në skenën politike ka treguar se fjala është për një strukturë të organizuar mirë dhe serioze. Mbajtja e shenjave dalluese, uniformës ushtarake dhe disiplina komanduese e saj qenë tregues të qartë se themeluesit e UÇK-së i kishin analizuar mirë rregullat ndërkombëtare për mënyrën e përdorimit të forcës (*jus in bello*). Edhe veprimet e saj, të drejtuara kryesisht kundër uniformës okupuese serbe në Kosovë, treguan po të njëjtën gjë. Megjithatë, në prag të ofensivës serbe të parë dhe të dytë, ambiciet idealiste duket sikur e kanë dominuar strukturën e saj komanduese. Takimi i Richard Holbrookeut në Junik (verë 1998) me një nga guerilasit e UÇK-së ishte shenjë e qartë për lidershipin e saj dhe më gjerë se kah duhej (territorialisht) të koncentrohej forca ushtarake e UÇK-së, pra, vetëm në territorin e Kosovës. Në të kundërtën, amerikanët qartë e dhanë mesazhin se nuk do mund t'i ndalonin evropianët në rrugën e tyre të asfiksimit dhe diskreditimit të faktorit ushtarak në Kosovë. Me fjalë të tjera, mesazhi amerikan ka qenë dhe mbetet se projektimi i forcës jashtë Kosovës, pra kundër parimit *uti possidetis*, e veçanërisht në IRJ të Maqedonisë, do të jetë i palejueshëm ndërkombëtarisht dhe se ata, pra amerikanët, do të jenë të pafuqishëm në paralizimin e politikës evropiane si më sipër, mu ashtu siç kishte ndodhur në Bosnjë-Hercegovinë në dy vitet e para të luftës. IRJ e Maqedonisë ka qenë dhe mbetet kufiri përtej të cilit amerikanët nuk kalojnë dot. Në fakt, shikuar në retrospektivë historike, ai territor ka qenë *alfa* dhe *omega* e realpolitikës së tërë Mesdheut, që nga Leka i Madh e deri më sot. Meqë kjo është kështu, dhe ne jemi të bindur në këtë, atëherë politika amerikane ndaj aleatëve evropian e me qëllim diskreditimin e regjimit në Beograd mbi bazën e shembullit të ish-kolonive ("mungesa e sovranitetit" në Kosovë) u tregua e pafuqishme si pasojë e goditjes nga ana e UÇK-së së interesave vitale amerikane në Ballkan. Se amerikanët kishin qenë më të favorshëm ndaj Kosovës dhe më konsekuentë në diskreditimin e politikës serbe në Kosovë, përveç shembujve të cekur më herët, mund shihet edhe në insistimin e tyre në Grupin e Kontaktit, që nga shtatori i vitit 1997 e tutje, se mbrojtje eventuale ndërkombëtare mund të gëzojë vetëm e a.q. RFJ (Serbia dhe Mali i Zi), por jo Serbia. Kjo e fundit nuk duhet të jetë, sipas amerikanëve, kuadri i zgjidhjes së çështjes së Kosovës.

Ky qëndrim, i cili dallon dukshëm nga ai evropian, ashtu si dhe me rastin e Bosnjë-Hercegovinës, në diskursin kosovar u interpretua në mënyrë krejt naive, duke e ndjellë thirrjen e një "Dejtoni të Dytë" për Kosovën. Pa u largu-

ar shumë nga objekti ynë këtu, le të përmbledhim me pak fjalë situatën politike që i pararendi ofensivës së dytë serbe dhe tolerimin e saj gjakftohtë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare.

E gjetur në mes të mungesës së kontrollit total efektiv të tërë Kosovës nga ana e UÇK-së dhe kërcënimeve ndaj saj për mosprojektim të forcës jashtë Kosovës, politika amerikane provoi si hap të fundit lojën e "foljes me një zë" të faktorit politik shqiptar, apo, siç u interpretua gabimisht, "futjes së UÇK-së nën kontroll politik". Si ide, në fakt, kjo ishte më shumë evropiane dhe tregonte qartë "gogolin" që duhej treguar amerikanëve për neutralizimin e tyre në Kosovë. Dhe, meqë në kushtet e pluralizmit është e pamundur "folja me një zë", tolerimi i ofensivës serbe edhe nga vetë amerikanët u përdor si mjet për ta vënë UÇK-në në binarët ndërkombëtarë të lejueshëm të përdorimit të forcës (*jus ad bellum*), ashtu siç u fol më herët dhe, sipas mundësisë, të detyrojë faktorin shqiptar në Kosovë që në bisedat për statusin e saj të lëvizë në relacionin evropiano (Serbi)–amerikan ("RFJ: Serbi-Mal i Zi").

Juristët që e kanë shkruar promemorien e lartcekur në emër të UÇK-së duket se nuk i kanë pasur parasysh rrethanat si më sipër, apo kështu na pëlqen të besojmë. Me supozim se konstatimi i dytë është i saktë, pra se fjala është për po atë lloj intelektualësh të cilët nuk kanë njohur e as që njohin ligjshmërinë e krijimit dhe të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, historinë e saj legale dhe tjetër, neve nuk na mbetet veçse të ripërsërisim pikëpamjet tona lidhur me legjitimitetin ndërkombëtar të përdorimit të forcës (*jus ad bellum*) nga ana e UÇK-së.

Nuk ka dyshim se ofensiva serbe ka legjitimuar ndërkombëtarisht UÇK-në si faktor i vetëm legjitim me të drejtën e përdorimit të forcës në emër të popullit shumicë në Kosovë, ashtu siç është jashtë çdo dyshimi se projektimi i forcës jashtë Kosovës ka qenë dhe mbetet ndërkombëtarisht krejt i palejueshëm. Kjo nuk do të thotë, megjithatë, se UÇK-ja duhet të kalojë në ekstremin morbid dhe të arsyetojë të drejtën për vetëvendosje me koncepte të deshtuara të Kushtetutës së vitit 1974, ngaqë ajo logjikë e kthen Kosovën pikërisht aty ku ka filluar, pra nën juridiksionin serbo-jugosllav, duke legjitimuar objektivisht kreaturën e fundit serbo-malazeze. Këtij entiteti bota ia mohon të drejtën e pasjes së sovranitetit mbi Kosovën, ashtu si kuptohet ky koncept në të drejtën aktuale ndërkombëtare. Po të ishte se e drejta jonë për vetëvendosje buron nga Kushtetuta e vitit 1974, atëherë çështja e Kosovës do të ishte harruar kaherë në po atë mënyrë si janë harruar ish-republikat jugosllave, tani shtete sovrane dhe të pavarura. NATO, në vijim të kësaj, nuk do të kishte fare dyshim për sa i përket qëllimit politik të intervenimit ushtarak në Kosovë.

Dihet se në Bosnjë-Hercegovinë ai qëllim ishte i thjeshtë: pengimi i agresionit serb dhe ruajtja e integritetit territorial të atij shteti. Në Kosovë gjendja është ndryshe, sado që në pikën e dytë (ruajtja e integritetit territorial) është e ngjashme, por për arsye të tjera. Kjo gjendje e disfavorshme dhe kjo pangjashmëri e Kosovës me Bosnjë-Hercegovinën i dedikohet pikërisht filozofisë së Kushtetutës së vitit 1974 dhe diskursit dhe praktikës së bazuar në të.

Kërcënimi i NATO-s se do të intervenojë në Kosovë është bërë për arsye të ruajtjes së paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare, por edhe për arsye të a.q. "të ndërhyrjes ndërkombëtare humanitare". Megjithatë qëllimi politik i një intervenimi të tillë kurrë nuk ka qenë i qartë, as dje e as sot. Që ai qëllim të ishte i tillë, duhej të synonte ruajtjen me forcë të integritetit territorial të një shteti ("Republika Federative e Jugosllavisë"), i cili e ka të dyshimtë mënyrën e vet krijimit më 1992. Në anën tjetër, intervenimi me qëllim politik ndihmën ndaj një lëvizjeje për pavarësi, akoma të panjohur tërësisht, ka paraqitur dhe paraqet precedentin e rrezikshëm të cilin NATO nuk mund ta krijojë. Së këndejmi, zgjedhja e rrugës së ndërmjetme ishte për NATO-n mënyra më e mirë e marrjes me krizën në Kosovë. Ajo rrugë e ndërmjetme konsiston në mbajtjen e kërcënimit real për intervenim ushtarak në Kosovë për arsye thjeshtë humanitare dhe vënien e kordonit të sigurisë rreth Kosovës, në IRJ të Maqedonisë para së gjithash, me qëllim të ruajtjes së paqes dhe sigurisë rajonale dhe më gjerë, si dhe të interesave vitale amerikanë në rajon. Ky qëndrim kësisoj ka për rrjedhojë praktike ecjen kah balancimi gradual i raportit të forcave ushtarake në Kosovë, me synim zgjidhjen hap pas hapi dhe me mjete politike të çështjes së Kosovës.

Këtë konstelacion të ri të forcave në Kosovë duhet ta shfrytëzojnë UÇK-ja dhe lidershipi politik në Kosovë duke respektuar me përpikëri *jus ad bellum*, të njohur në mënyrë implicite nga Gjykata e Hagës, NATO dhe liderët e ndryshëm politik të botës, si dhe *jus in bello*, pra, duke mos lejuar veprime dhe metoda e mjete ushtarake që kompromet ojnë të drejtën e Kosovës për pavarësi dhe *jus ad bellum* të UÇK-së konform parimit kolonial *uti posidetis*. Raporti i forcave në Kosovë dhe rreth saj, e jo interpretimi morbid i Kushtetutës së vitit 1974, është baza e së drejtës së Kosovës për vetëvendosje dhe ushtrim të dhunës kundër Serbisë si një forcë e huaj. Në krijimin e kësaj baze për legjitimimin ndërkombëtarë të *jus ad bellum* dhe *jus in bello* kanë ndikuar, përveç vetë faktorit shqiptar në Kosovë, edhe regjimi aktual në Beograd dhe interesi gjeostrategjik euro-amerikan, përkatësisht ndeshja e tyre në Kosovë, gjë që shihet nga sjelljet e NATO-s ndaj krizës në Kosovë gjatë tetë muajve të parë të vitit 1998.

Përfundim

Përdorimi i forcës kundër një qeverie nga ana e bashkësisë së caktuar joshtetërore e me qëllim sigurimin dhe realizimin e së drejtës së mohuar forcërisht për vetëvendosje quhet luftë për çlirim nacional (çlirimtare). Ky lloj i përdorimit të forcës në të drejtën ndërkombëtare është i kohës së re dhe lidhet me kohën e pas-Luftës së Dytë Botërore, më saktësisht me fillimin e procesit të dekolonizimit.

Më parë, e drejta në përdorimin e forcës (*jus in bello*) qe njohur vetëm në favor të shteteve. Ky koncept u sfidua seriozisht pas fillimit të procesit të dekolonizimit dhe njohjes së vetëvendosjes si një e drejtë në dobi të kategorive të caktuara të popujve dhe territoreve. Legjitimimi i këtyre kategorive në sensin e së drejtës për përdorimin e forcës nuk u bazua në kategoritë morale, pra nëse lufta ishte apo jo e drejtë, por në dokumente juridiko-ndërkombëtare.

Më parë se kategoritë morale, ndarja e konflikteve në të brendshme dhe ndërkombëtare ka paraqitur gurë themelin mbi të cilin qëndroi legjitimiteti i përdorimit të forcës në të drejtën ndërkombëtare. Në fillim vetëm konfliktet ndërkombëtare gëzonin mbrojtje ndërkombëtare. Më vonë, gradualisht u zhvilluan edhe konceptet tjera të cilat synonin vënien nën mbikëqyrje të rasteve të caktuara të konflikteve të brendshme (jo midis shteteve). Të tilla ishin rastet e rebelimit, kryengritjes dhe gjendjet e luftës. Mbrojtja që e drejta ndërkombëtare u ofroi këtyre rasteve varej nga intensiteti dhe shkalla e konfliktit dhe pasojat e tij politike, ekonomike dhe ushtarake për shtetet e treta dhe vetë bashkësinë ndërkombëtare. Nëse kauza ka qenë e drejtë nuk çonte fare peshë në kualifikimin e konfliktit sipas kategorive të sipërcekura. Kualifikimi i një konflikti si "gjendje lufte" ka paraqitur dhe paraqet shkallën më të avancuar të mbrojtjes juridiko-ndërkombëtare për sa i përket kuadrit të konflikteve të brendshme. Rastet e tilla i korrespondojnë kategorisë së "konflikteve të armatosura" të pasmbarimit të Luftës së Ftohtë dhe barazohen me to në pasojat e tyre praktike.

Rregullat për mënyrën e përdorimit të forcës (*jus in bello*) janë zhvilluar paralel me ato mbi të drejtën e përdorimit të forcës (*jus ad bellum*). Pasojat praktike të lënies anash të konflikteve të brendshme janë zbutur përmes nenit 3 të përbashkët për Konventat e Gjenevës së vitit 1949, i cili nen parashikon trajtimin human të "personave të cilët nuk marrin pjesë aktuale në armiqësi". Megjithatë, ky nen nuk prek në statusin e pjesëmarrësve në një konflikt të armatosur. Vetëm atëherë kur në kategorinë e konflikteve ndërkombëtare u futën edhe luftërat për çlirim nacional (çlirimtare), u bë e mundur vë-

nia nën mbrojtje (dhe thirrja në përgjegjësi penale ndërkombëtare) e të gjitha situatave praktike (dhe individëve të cilët kishin lidhje direkte ose indirekte me konfliktin).

Zbatimi i *jus in bello* në luftërat për çlirim nacional (çlirimtare) ka qenë konsekuencë logjike e njohjes së vetëvendosjes si një e drejtë në favor të popujve dhe territoreve te caktuara. Ky zbatim, megjithatë, ka hasur në rezistencë nga ana e shteteve. Mohimi se bëhej fjalë për konflikt ndërkombëtar, në rastin e luftërave për çlirim nacional (çlirimtare), ka qenë shoqërues i rregullt i retorikës shtetërore, sado që puna e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar nuk është penguar aq shumë. Ndryshimi i raportit të forcave ka quar në përmirësimin e pozitës së luftëtarëve në luftërat për çlirim nacional (çlirimtare). Kështu ka ndodhur në Algjeri, Angolë, Mozambik, ish-Jugosllavi dhe Bashkimin Sovjetik.

Pas fillimit të agresionit serb të hapur ndaj Kosovës dhe popullit të saj shumicë në fillim të vitit 1998, Gjykata e Hagës për Krimet në ish-Jugosllavi ka bërë një deklaratë në të cilën pranon se në Kosovë fjala është për konflikt të armatosur. Ky fakt shënon fillimin e internacionalizimit të mirëfilltë të çështjes së Kosovës dhe hap rrugën për thirrje në përgjegjësi penale ndërkombëtare të të gjithë atyre që mund të kenë kryer krime kundër njerëzimit dhe së drejtës ndërkombëtare humanitare. Gjykata nuk tregoi nëse fjala është për konflikt të brendshëm apo ndërkombëtar. Megjithatë, pasojat praktike të këtij kualifikimi barazohen me rastet e luftërave për çlirim nacional (çlirimtare), si për sa i takon *jus ad bellum* (së drejtës për përdorimin e forcës) ashtu edhe *jus in bello* (së drejtës lidhur me mënyrën dhe mjetet e luftës). Kjo pasojë rezulton nga ndryshimet e bëra pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, si në vetë konceptin e luftës ashtu edhe në mënyrën e ushtrimit të së drejtës për vetëvendosje.

Po të mos ishte kështu, pra sikur kualifikimi i një konflikti si "i armatosur" të mos barazohej në pasoja praktike me rastet e luftërave për çlirim nacional (çlirimtare), atëherë do të mbeteshin pa u ndëshkuar kryesit e veprave penale ndërkombëtare si më sipër dhe atë në emër të mbrojtjes së sovranitetit territorial të shteteve të dhëna. Një gjë të tillë e konfirmojnë edhe rregullat juridiko-ndërkombëtare që kanë të bëjnë me zgjidhjen e krizës në ish-Jugosllavi, veçanërisht me mënyrën e zgjidhjes së kësaj krize. Njohja e këtyre rregullave, kemi argumentuar në këtë shkrim, ka qenë dhe mbetet një segment shumë i rëndësishëm i luftës sonë për pavarësi. Anasjelltas, mosnjohja e tyre deri më sot ka pasur për pasojë viktimizimin përtej mase të popullsisë shumicë në Kosovë. Në vijim të kësaj, qëllimi i këtij shkrimi ka qenë dhe mbetet ai

i dhënies së një kontributi sado modest në nxitjen e koshiencës në Kosovë dhe më gjerë lidhur me rëndësinë e njohjes së këtyre rregullave. Gjithnjë në këtë vijim, përpjekjet e autorëve të këtij shkrimi kanë qenë dhe mbeten të drejtuara kah kundërvënia dhe paralizimi i diskursit aktual, politik e profesional, në Kosovë që për bazë ka Kushtetutën e vitit 1974 dhe historikun komunist të Kosovës.

Kemi konsideruar dhe konsiderojmë akoma se braktisja e këtij kursi është e vetmja rrugë për arritjen e pavarësisë së Kosovës dhe ndërtimin e një filozofie të re shtetformuese, të një filozofie që duhet të shtrojë rrugën për gjeneratat në vijim për të kuptuar si duhet historinë tonë nacionale dhe të popujve që na rrethojnë. Sa më herët të kuptohet kjo, aq më mirë për Kosovën. Kuptimi i vonshëm i kësaj gjëje nuk sjell veçse dëmtimin e tepruar të popullsisë shumicë në Kosovë dhe më gjerë, në ndërkohë që proceset socio-politike do të ecin rrugës së vet të pavarur e tjerët do të zbulojnë shumë gjëra që sot ne jemi dëshmitarë se po ndodhin. Nëse gjenerata e pas-Luftës së Dytë Botërore disi mund të falet për paaftësinë për të kuptuar se, ta zëmë, Lufta Civile në Greqi dhe kryengritja e Shaban Polluzhës ishin shenjat e para reale të fillimit të Luftës së Ftohtë dhe ndarjes së sferave të interesit, një privilegj të tillë nuk mund ta gëzojë gjenerata e fundit e Luftës së Ftohtë. Ta mbyllim këtu me shpresë se kësaj radhe gjërat janë ditur me kohë. Së paku, kësaj radhe disa gjëra janë thënë me kohë nga ata që panë vitet e fundit të Luftës së Ftohtë me të gjitha pasojat e saj kur mbaroi më 1990.

Literatura

1. Libra

Aleksa Djilas, *The Contested Country: Yugoslavia and Communist Revolution 1919-1953* (Harvard UP: Cambridge, Mass., 1991).

Aleksandar Pavković, *The Fragmentation of Yugoslavia: Nationalism in a Multinational State* (Macmillan: London, 1997).

Aleksandar Pavković, *The Fragmentation of Yugoslavia: Nationalism and War in the Balkans* (Palgrave Macmillan UK: Basingstoke, 2000).

Allan R. Brewer-Carias, *Constitutional Courts as Positive Legislators, A Comparative Law Study* (Cambridge UP, Cambridge, 2011).

Anne Appelbaum, *Iron Curtain: The Crushing of Eastern Europe, 1944-1956* (Anchor Books: New York, 2013).

Annie Gruber, *Le Droit international et la succession d'États* (Faculte de Droit — Paris V: Paris 1986).

Anthony Aust, *Modern Treaty Law in Practice* (Cambridge UP: Cambridge, 2000).

Arangio Ruiz, *Gli enti soggeti dell ordinamento internazionale* (Giufrre: Milano 1951).

Arthur Berriedale Keith, *The Belgian Congo and the Berlin Act* (Clarendon Press: Oxford, 1919).

Arrigo Cavaglieri, *Corso di Diritto Internazionale* (Editoriale Scientifica: Napoli 1932).

August Reinisch, *State Responsibility for Debts: International Law Aspects of External Debt and Debt Restructuring* (Bohlau: Vienna 1995).

Barry Buzan, *People, States and Fear* (Harvester Wheatsheaf: UK, 1991).

Barry E. Carter — Philip R. Trimble, *International Law: Cases and Materials* (Aspen: New York, 1995).

Bill Clinton, *Ne luftën, ju paqen: mesazhe, artikuj, konferenca shtypi, intervista dhe fjalime për Kosovën*, Lutfi Dervishi, përkth. (Tiranë, 2000).

Bogdan Krizman, *Vanjska Politika Jugoslovenske Države 1918-1941*, (Školska Knjiga: Zagreb, 1975).

Boris Krivokapić, *Enciklopedijski rečnik medjunarodnog prava i medjunarodnih odnosa* (JP Službeni Glasnik: Beograd, 2010).

Brad R. Roth, *Governmental Illegitimacy in International Law* (Oxford UP: Oxford, 1999).

Branimir Jankoviq, *Balkan u medjunarodnim odnosima* (Naučna Knjiga: Beograd, 1988).
Christian N. Okeke, *Controversial Subjects of Contemporary International Law* (Rotterdam UP: Rotterdam, 1974).
Christopher R. Rossi, *Equity and International Law: A Legal Realist Approach to International Decision Making*, Serie de Monografias del Bid (Transnational Publishers: Irvington, N.Y., 1993).
Daniel P. O'Connel, *State Succession in Municipal and International Law* vol. I (Cambridge UP: Cambridge 1967).
Daniel P. O'Connell, *International Law*, 2nd ed. (Stevens: London, 1979).
David Weissbrodt and Connie de la Vega, International Human Rights: An Introduction (Univ. of Pennsylvania Press: Philadelphia, 2007).
Dieter Mahncke (ed.), *Old Frontiers — New Frontiers: The Challenge of Kosovo and Its Implications for the European Union* (Peter Lang: Bern, 2001).
Dinah Shelton (ed.), International Law and Domestic Legal Systems. Incroporation, Transformation, and Persuasion (Oxford UP: Oxford, 2011).
Dionisio Anziloti, *Corso di Diritto Internazionale* I (CEDAM: Padova, 1964).
Donald Clark and Robert Williamson (eds.), *Self-Determination: International Perspectives* (Plagrave Macmillan UK: Basingstoke, 1996).
Dušan Josipović, *Principi političko-territorialne podele u Jugoslaviji* (RAD: Beograd, 1963) (vetëm në alfabetin cirilik).
Dušan Subotić, *Misli o ustavu i politici* (Naučna Knjiga: Beograd, 1919).
Enver Hasani — Ivan Čukalović, *Kushtetuta e Kosovës: Komentar* (GIZ: Prishtinë, 2013).
Enver Hasani, *Self-Determination, Territorial Integrity and International Stability: the Case of Yugoslavia* (National Defense Academy and Bureau for Security Policy: Vienna, 2003).
Francis Fukuyama, *The End of History and the Last Man* (Avon Books: New York, 1992).
Franck C. Newman and David Wiessbrodt, International Human Rights: Law, Policy, and Process (Anderson: Cincinati, Ohio, 1996).
Frantz Despagnet, *Cours de Droit International* (Librarie de la Société du Recuiel Sirey: Paris, 1910).
Frantz Despagnet, *Essai sur les protectorats* (Pedone: Paris, 1896).
Gabriella Venturini, *Il Riconoscimento nel Diritto Internazionale* (Giuffre: Milano 1946).
Gaettano Morreli, *Nozioni di Diritto Internazionale* (Cedam: Padova 1967).
Gary King, Robert O. Keohane & Sidney Verba, *Designing Socian Inquiry* (Princeton UP: Princeton 1994).
George Thomson, *From Marx to Mao Tse-Tung*: *A Study in Revolutionary Dialectics* (Garden City Press: UK, 1971).

Georges Kaeckenbeeck, *The Protection of Vested Rights in International Law* (Oxford UP: Oxford, 1936).
Gerhard von Glahn, *Law Among Nations: An Introduction to Public International Law*, 5th ed. (Macmillan: New York, 1986).
Glen Fisher, *Mindsets: The Role of Culture and Perceptions in International Relations* (Nicholas Brealey America: London, 1997).
Green H. Hackworth, *Digest of International Law* (G.P.O.: Washington, D.C., 1940).
Greg Campbell, *The Road to Kosovo: A Balkan Diary* (Westview Press: Oxford, 1999).
Guy Hollis and Karin Plokker, *Towards Democratic Decentralisation: Transforming Regional and Local Government in the New Europe* (Tacis: England, 1995).
Hanna Bokor-Szego, *New States and International Law* (Akademiai Kaido: Budapest, 1970).
Harold James, *Europe Reborn: A History, 1914-2000* (Routledge: London, 2003).
Heather A. Wilson, *International Law and the Use of Force by National Liberation Movements* (Clarendon Press: Oxford, 1988).
Heather Wilson, *International Law and the Use of Force by National Liberation Movements* (Oxford UP: Oxford, 1998).
Herch Lauterpacht, *The Development of International Law by the International Court* (Stevens & Sons: London, 1958).
Hersch Lauterpacht (ed.), *Oppenheim's International Law.* vol. II, 7th ed. (Longman: London, 1952).
Hersch Lauterpacht, *Recognition in International Law* (Cambridge UP: Cambridge, 1947).
Hugh Miall (ed), *Minority Rights in Europe* (Pinter Publishers: UK, 1994).
Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 4th ed. (Oxford UP: Oxford, 1990).
Ian Brownlie, *Principles of Public International Law*, 6th ed. (Oxford UP: Oxford, 2003).
Ivor Jennings, *The Approach to Self-Government* (Cambridge UP: Cambridge, 1956).
James Crawford, *The Creation of States in International Law* (Oxford UP: Oxford, 1979).
James E. Bond, *Rules of Riot: Internal Conlict and the Law of War* (Princeton UP: Princeton, 1974).
James Gaw, *Triumph of the Lack of Will: International Diplomacy and the Yugoslav War* (Columbia UP: New York, 1997).
James Gow, *The Serbian Project and Its Adversaries: A Strategy of War Crimes* (Hurst: London, 2003).

James N. Roseneau, *International Aspects of Civil Strife* (Princeton UP: Princeton, 1964).
James W. Garner, *Recent Developments in International Law* (Univ. of Calcutta: Calcutta, 1925).
Jasmina Udovicki and James Ridgeway (eds.), *Yugoslavia's Ethnic Nightmare* (Lawrence Hill: New York, 1995).
Jasna Bakšić-Muftić & Liljana Mijović (eds.), *Citanka ljudskih prava* (Centar za ljudska prava Univ. u Sarajevu: Sarajevo, 2001).
John Hutchinson and Anthony Smith (eds.), *Nationalism* (Oxford UP: Oxford, 1994).
John Lewis Gaddis, *The Cold War: A New History* (Penguin Books: London, 2006).
John Williams, *Legitimacy in International Relations and the Rise and Fall of Yugoslavia* (Palgrave Macmillan UK: Basingstoke, 1998).
Jose Maria Beneyto / Ingolf Pernice (eds.), Europe's Constitutional Challenges in the Light of the recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond (Nomos: Baden-Baden, 2011).
Josip Metelko, *Sukcesija država s posebnim osvrtom na raspad bivše SFRJ* (Pravni Fakultet: Zagreb, 1999).
Jove Dimitrija Talevski, *The Borders of the Republic of Macedonia, with Supplements* (Kiro Dandaro: Bitola, 1998),
Joze Pirievec, *Le guerre jugosllave, 1991-1999* (Einaudi: Torino, 2001).
Julie A. Mertus, *Kosovo: How Myths and Truths Started a War* (Univ. of California Press: Los Angeles, 1999)
Justin McCarthy, *Death and Exile: the Ethnic Cleansing of Ottoman Muslims:* 1821-1922 (Darwin Press: Univ. of Michigan, 1995).
Jusuf Osmani dhe Ramë Manaj, *Ndarja administrative-territoriale e Kosovës 1944-2010* (AShAK: Prishtinë, 2014).
Kalevi J. Holsti, *Peace and War: Armed Conflicts and International Order 1648-1989* (Cambridge UP: Cambridge, 1991).
Kalevi J. Holsti, *The State, War, and the State of War* (Cambridge UP: Cambridge, 1996).
Karine Lescure et al., *Le Tribunal pénal international pour l'ex-Yougoslavie* (Montchrétien: Paris, 1994).
Kasim Begić, *Bosna i Hercegovina od Vanceove misije do Daytonskog sporazuma: 1991-1996* (Bosanska Knjiga: Sarajevo, 1997).
Kenneth N. Waltz, *Man, the State and War* (Columbia UP: New York, 1954, 1959).
Kosta Čavoški, *Revolucionarni makijavelizam i drugi eseji* (Rad: Beograd, 1989)
Kristina Marek, *Identity and Continuity of States in Public International Law* (DROZ: Geneva, 1954).

Louis Henkin et al., *International Law: Cases and Materials* (West Publishing: St. Paul, Minn., 1993).
Malcolm N. Shaw, *International Law* (Cambridge UP: Cambridge, 1995).
Mampuya Tashiabo, *Émergence des États nouveaux et droit international* (Presses universitaire du Zaire: Kinshasa, 1984).
Marcelo G. Kohen (ed.), *Promoting Justice, Human Rights and Conflict Resolution Through International Law: Liber Amicorum Lucius Caflisch* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2007).
Marek Stanislav Korovicz, *La souveraineté des États et l'avenir du droit international* (Pedone: Paris, 1945).
Marie-Françoise Allain et al. (eds.), *L'ex-Yougoslavie en Europe : de la faillite des démocraties au processus de paix* (L'Harmattan: Paris, 1997).
Mark Almond, *Europe's Backyard War: The War in the Balkans* (Heinemann: London, 1994).
Martin van Creveld, *The Transformation of War* (The Free Press: New York 1991).
Martin van Creveld, *The Transfromation of War* (The Free Press: London, 1991).
Mauro Mazza, *L'ordinamento costituzionale del Kosovo* (Jovene Editore: Napoli, 2008).
Meir Ydit, *Internationalized Territories* (A. W. Sythoff: Leyden, 1961).
Michael A. Sells, *The Bridge Betrayed: Religion and Genocide in Bosnia* (Univ. of California Press: Los Angeles, 1996).
Michael Roux, *Les albanais en Yougoslavie : minorité nationales, territoire et développent* (Fondation de la Maison des science de l'home: Paris, 1992).
Michel Veuthey, *Guerilla et droit humanitaire* (Institut Henry Dunant: Genève, 1976).
Milan Bartos, *Medjunarodno javno pravo*, knjiga prva (Kultura: Beograd, 1952).
Milan Bartos, *Medjunarodno javno pravo*, treća knjiga (Kultura: Beograd, 1952).
Milan Šahović (ed), *Medjunarodno pravo i jugoslovenska kriza: zbornik radova* (Službeni list SRJ: Beograd, 1996).
Miodrag Zečević & Bogdan Lekić, *Granice i unutrasnja territorijalna podela Jugoslavije* (Gradjevinka knjiga: Beograd, 1991).
Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1999).
Noel Malcolm, *Kosovo: A Short History* (New York UP: New York, 1998).
Norman Rich, *Great Power Diplomacy: 1814-1914* (McGraw-Hill: New York, 1992).
Oliver Dörr, Kirsten Schmalenbach (eds.), *Vienna Connvention on the Law of Treaties: A Commentary* (Springer: Verlag, 2012).
Olivera Vučić, *Austrijsko ustavno sudstvo: čuvar federacije i ustava*, disertacion (Univ. Beogradit, 1995).
Oscar Randi, *I Popoli Balcanici* (Cremonese: Roma, 1929).

Ove Bring and Said Mahmoudi (eds.), *Current International Law Issues: Nordic Perspectives Essays in Honor of Jerzy Sztucki* (Kluwer Law International: The Hague, 1994).
P.K. Menon, *The Succession of States in Respect to Treaties, State Property, Archives and Debts* (The Edwin Mellen Press: Lewiston, N.Y., 1991).
Pasquale Stanislao Mancini, *Della Nazionalita come Fondamento del Diritto delle Genti* (Universita di Torino: 1851).
Patric Daillier et Alain Pellet, *Droit international public*, 5-é ed. (L.G.D.J.: Paris, 1994).
Patrick Cabanel, *Nation, Nationalites et Nationalisms en Europe: 1850-1920* (Editions Ophrys: Paris, 1996).
Paul de La Pradelle, *La frontière : étude de droit international* (Les Editions internationales: Paris, 1928).
Paul R. Vioti & Mark V. Kauppi, *International Relations Theory: Realism, Pluralism, Globalism* (Macmilian Publishing, 1993).
Philip J. Cohen, *Serbia's Secret War: Propaganda and the Deceit of History* (Texas A&M UP: Texas, 1996).
Pierre Martens, *L'imprescriptibilité des crimes de guerre et contre l'humanité : étude de droit international et de droit pénal comparé* (Editions de l'Université de Bruxelles: Bruxelles, 1974).
Pierre Michel Eismann & Martti Koskenniemi (eds.), *La succession d'États : la codification à l'epreuve des faits / State Succession: Codification Tested Against the Facts* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2000).
Radoslav Stojanović, *Jugoslavija, nacije i politika* (Kultura: Beograd, 1988).
Ray Murphy, *UN Peacekeeping in Lebanon, Somalia and Kosovo* (Cambridge UP: Cambridge, 2007).
Reneo Lukić and Allen Lynch, *Europe from the Balkans to the Urals: The Disintegration of Yugoslavia and the Soviet Union* (Stockholm International Peace Research Institute: Stockholm, 1996).
Richard Holbrooke, *To End a War* (Random House: New York, 1998).
Robert Jennings and Sir Arthur Watts (eds.), *Oppenheim's International Law.* vol. I, 9th ed. (Longoman: London, 1992).
Robert Kagan, *Of Paradise and Power: America and Europe in the New World Order* (Vintage: USA, 2003).
Roger Cohen, *Hearts Grown Brutal: Sagas of Sarajevo* (Random House: New York, 1998).
Ronald St. John Macdonald (ed.), *Essays in Honour of Wang Tieya* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1994).
Rupert Emmerson, *From Empire to Nation* (Harvard UP: Harvard, 1960).
Saadia Touval, *Mediation in the Yugoslav Wars: The Critical Years, 1990-95* (Palgrave Macmillan UK: Basingstoke, 2002).

Samuel Bowels dhe Richard Edwards, *Razumjevanje Kapitalizma* [Understanding Capitalism] (Informator: Zagreb 1991).
Slobodan Jovanović, *Ustavno pravo Kraljevine Srba, Hrvata i Slovenaca* (GZ "Makarije": Zemun, Beograd, 1924).
Smilja Avramov — Milenko Kreća, *Medjunarodno javno pravo* (Savremena Administracija: Beograd, 1983).
Snežana Trifunovska, *Yugoslavia Through Documents: From its Creation to its Dissolution* (Kluwer Academic Publishers: The Hague, 1994).
Stefano Ruzza and Anja P. Jakobi, *Non-State Challenges in a Re-Ordered World: The Jackals of Westphalia* (Routledge: New Yok, 2016).
Stevan Djordjević, *O kontinuitetu država s posebnim osvrtom na medjunarodnopravni kontinuitet Kraljevine Jugoslavije i FNRJ* (Beograd: Naučna Knjiga, 1967).
Stevan Djordjević, *Republike i pokrajine u medjunarodnim odnosima jugoslovenske federacije* (Naučna Knjiga : Beograd, 1985)
Steve Terrett, *The Dissolution of Yugoslavia and the Badinter Arbitration Commission: A Contextual Study of Peacemaking Efforts in the Post-Cold War World* (Ashgate: Dartmouth, 2000).
Stjepan G. Meštrović (ed.), *Genocide after Emotion: The Post-Emotional Balkan War* (Routledge: New York, 1996).
Surya P. Sharma, *Territorial Acquision, Disputes and International Law* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1997).
Tim Judah, *Kosovo: War and Revenge* (Yale UP: Yale, 2000).
Tomaso Perassi, *Lezioni di Diritto Internazionale* vol. I (Cedam: Padova, 1950).
Thomas Cushman and Stjepan G. Meštrović (eds.), *This Time We Knew* (New York UP: New York, 1996).
Thomas D. Grant, *The Recognition of States: Law and Practice in Debate and Evolution* (Praeger: Westport, Conn., 1999).
Thomas Joseph Lawrence, *Les principes de droit international* (Imprimerie de la Université: Oxford, 1920), 766
Vicki C. Jackson, Constitutional Engagement in a Transnational Era (Oxford UP: Oxford, 2010).
Vladimir Ibler, *Rječnik medjunarodnog javnog prava* (Informator: Zagreb, 1972).
Vladimir Potemkin (ed.), *Istorija diplomatije*, Tom III (Savremena Administracija, Beograd, 1951).
Vladimir-Djuro Degan, *L'équité et le droit international* (Martinus Nijhoff, La Haye, 1970).
Wolfgang Petrisch, *Bosna i Hercegovina od Daytona do Evrope* (Svjetlost: Sarajevo, 2000).
Xhezair Zaganjori, *Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare* (Morava: Tiranë, 2011).

Yao Kunalè Eklo, *Le principe de droits acquis : la nationalisation et les "nouveaux États"* në serinë *Cahiers libres de l'Institut national de la recherche scientifique* vol. 1 (Institut national de la recherche scientifique: Lomé, Togo, 1974).
Yoram Dinstein (ed.), *International Law in Time of Perplexity* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1989).
Zbigniew Brzezinski, *The Choice: Global Domination or Global Leadership* (Basic Books: New York, 2004).
Zejnullah Gruda, *E Drejta Ndërkombëtare Publike* (Rilindja: Prishtinë 1988).
Zejnullah Gruda, *Kufijtë në dëm të shqiptarëve (Demarkacioni i vijës kufitare Kosovë-Mali i Zi në kontekstin historik, ish-jugosllav dhe të së drejtës ndërkombëtare)* (Koha: Prishtinë, qershor 2016).

2. Artikuj

A.V. Lowe and Colin Warbrick, "Current Developments: Public International Law", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 41, part 2 (1992).
A.V. Lowe and Colin Warbrick, "Recognition of States", *International and Comparative Law Quarterly* vol. 41, no. 2 (April 1992).
Abdelmadjid Belkherroubi, "Essai sur une théorie juridique des mouvements de libération nationale", *Revue egyptienne de droit international* no. 28 (1972).
Adam Roberts, "Prolonged Military Occupation", *American Journal of International Law* vol. 84, no. 1 (January 1990).
Alain Pellet, "L'activité de la Commission d'arbitrage de la Conférence européenne pour la paix en Yougoslavie", *Annuaire français de droit international* vol. 38 no. 1 (1992).
Alain Pellet, "L'activité de la Commission d'arbitrage de la Conférence européenne pour la paix en Yougoslavie", *Annuaire français de droit international* vol. XXXVIII (Paris, 1992).
Alain Pellet, "Note sur la Conference Europeenne pour la Paix en Yougoslavie", *Annuaire Francais de Droit International* XXXVIII (1992).
Alain Pellet, "Note sur la Conference Europenne pour la Paix en Yougoslavie", *Annuaire Française de Droit International* vol. XXXVIII (1992).
Alain Pellet, "The Opinions of the Badinter Arbitration Committee: A Second Breath for the Self-Determination of Peoples", *European Journal of International Law* vol. 3, no. 1 (1992).
Alejandro Álvarez, "Latin America and International Law", *American Journal of International Law* vol. 3, no. 2 (April 1909).
Aleksa Djilas, "Imagining Kosovo: A Biased New Account Fans Western Confusion", *Foreign Affairs* (September-October 1998).

Alfied de Zayas, "The Right to One's Homeland: Ethnic Cleansing and the International Criminal Tribunal for Former Yugoslavia", *Criminal Law Forum* vol. 6, no. 2 (1995).
Ali A. Mazrui, "The United Nations and Some African Political Attitudes", *International Organization* vol. 18, no. 3 (Summer 1964).
Ana Stanić, "Financial Aspects of State Succession: The Case of Yugoslavia", *European Journal of International Law* vol. 12, no. 4 (2001).
Andrea Gioia, "State Succession and International Financial Institutions", në Pierre-Michel Eisemann et Martti Koskenniemi (eds.), *La succession d'États : la codification à l'epreuve des faits / State Succession : Codification Tested Against the Facts* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2000).
Andrew Bell-Fialkoff, "A Brief History of Ethnic Cleansing", *Foreign Affairs* vol. 72, no. 3 (Summer 1993).
Anne Peters, "Supremacy Lost: International Law Meets Domestic Constitutional Law", *Vienna Journal on International Constitutional Law* vol 3, issue 3 (September 2009).
Antonio Cassese, "*Ex iniuriaius oritur*: Are We Moving Towards International Legitimation of Forcible Humanitarian Countermeasures in the World Community?", *European Journal of International Law* vol. 10, no. 1 (1999).
Antonio Cassese, "Self-Determination of Peoples and the Recent Break-Up of USSR and Yugoslavia", në Ronald St. John Macdonald (ed.), *Essays in Honour of Wang Tieya* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1994).
Anthony D'Amato të librit "*Rethinking the Sources of International Law* by G.J.H. van Hoof", *American Journal of International Law* vol. 78, no. 4 (1984).
Arthur W. Spencer, "The Balkan Question — Key to a Permanent Peace", *The American Political Science Review* vol. 8, no. 4 (November 1914).
Arthur Watts, "Introductory Note to the Agreement on Succession Issues Between the Five Successor States of the Former State of Yugoslavia", *ILM* vol. 41 (2002).
Barton Gellman, "Allies Facing the Limits of Air Power", *Washington Post* (28 March 1999).
Barry Buzan, "From International System to International Society: Structural Realism and Regime Theory Meet the English School", *International Organization* vol. 47, no. 3 (Summer 1993).
Besnik Krasniqi, "Forumi 2015: Veriu do të jetë çështje tensionesh e problemesh", *Koha Ditore* (Prishtinë, e mërkurë, 5 shtator 2012) fq. 2.
"Big Powers Demand Deal on Kosovo Within Weeks", *HRI* (January 29, 1999).
Bojko Bučar, "Medjunarodni aspekti jugoslovenske reforme i osamostaljenje Slovenije", *Medjunarodna politika* nr. 988 (Beograd, 1 qershor 1991) fq. 4.
Branislav Milinković, "FRY and the OSCE: Inertia of Suspension", *Review of International Affairs* vol. XLVIII, no. 1056 (Belgrade, 15 May 1997).

Bruno Simma, "NATO, the U.N. and the Use of Force: Legal Aspects", *European Journal of International Law* vol. 10, no. 1 (1999).
"Burkina Faso and Niger exchange 18 towns to settle border dispute", *The Guardian* (8 May 2015).
C. Economides, "The Relationship Between International and Domestic Law", *Science and Technique of Democracy* no. 6, CDL-STD 006 (Vennice Commission: Strasbourg, 1993).
C.G. Fenwick, "The Honduras-Nicaragua Boundary Dispute", *American Journal of International Law* vol. 51, no. 4 (October 1957).
Carl Bildt, "Kosovo Should Have the Same Status as Montenegro", në QIK, *Daily Report* 1736 (Prishtina, 3 June 1997).
Carsten Stahn, "The Agreement on Succession Issues of the Former Socialist Federal Republic of Yugoslavia", *American Journal of International Law* vol. 96, no. 2 (April 2002).
Carsten Thomas Ebenroth & Matthew James Kemner, "The Enduring Political Nature of Questions of State Succession and Seccession and the Quest for Objective Standards", *University of Pennsylvania Journal of International Economic Law*, vol. 17, no. 3 (Fall 1996).
Chandler P. Anderson, "The Costa Rica-Panama Boundary Dispute", *American Journal of International Law* vol. 15, no. 2 (April 1921).
Charles Ingrao, "Understanding Ethnic Conflict in Central Europe: An Historical Perspective", *Nationalities Papers* vol. 27, no. 2 (1999).
Charles Truchart, "Bosnia-Yugoslavia to Swap Embassies", *Washington Post Foreign Service* (4 October 1996).
Charles W. Kegly, Jr., "The Neorealist Moment in International Studies? Realist Myths and the New International Realities", *International Studies Quarterly* vol. 37 (1993).
Christine M. Chinkin, "Kosovo: A 'Good' or 'Bad' War?", *American Journal of International Law* vol. 93, no. 4 (October 1999).
Christopher Harland, "Making Effective the Use of Human Rights and Freedoms in Bosnia-Herzegovina", në Jasna Bakšić-Muftić & Liljana Mijović (eds.), *Citanka ljudskih prava* (Centar za ljudska prava Univ. u Sarajevu: Sarajevo, 2001).
"Colons allemands au Pologne", CPJI serie B, no. 6 (1923).
"Contact Group Sets Deadline", *RFE/RL Newsline* (February 15, 1999).
Daniel de Leon, "The Conference at Berlin on the West-African Question", *Political Science Quarterly* vol. 1, no. 1 (March 1886).
Daniel N. Nelson, "Kosovo Futures, Western Dilemmas", *International Spectator* vol. 37, no. 2 (April-June 2002).
Daniel P. O'Connell, "Economic Concessions in the Law of States Succession", *British Yearbook of International Law* vol. 27 (1950).

Daniel Thym, "From Ultra Vires Control to Constitutional-Identity-Review: The Lisbon Judgement and German Constitutional Court", në Jose Maria Beneyto / Ingolf Pernice (eds.), *Europe's Constitutional Challenges in the Light of the recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond* (Nomos: Baden-Baden, 2011).

Danilo Türk, "Recognition of States: A Comment", *European Journal of International Law* vol. 4, no. 1 (1993).

David Sloss "Non-Self-Executing Treaties: Exposing a Constitutional Fallacy", *U.C. Davis Law Review* vol. 36, no. 1 (November 2002).

Detlev F. Vagts, "State Succession: The Codifiers' View", *Virginia Journal of International Law* vol. 33, no. 2 (Winter 1993).

Dimimos Triantaphyllou, "Kosovo Today: Is There No Way Out of the Deadlock?", *European Security* vol. 5 (1996).

"Diplomatski odnosi prioritet, razliciti stavovi o Kosovu i sukcesiji", *Naša Borba* (subota, 21 mart 1998).

Duško Sekulić, "The Creation and Dissolution of the Multinational State: The Case of Yugoslavia", *Nations and Nationalism* vol. 3, part 2 (July 1997).

Eli Nathan, "The Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts", në Yoram Dinstein (ed.), *International Law in Time of Perplexity* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1989).

Enrico Milano, "Security Council Action in the Balkans: Reviewing the Legality of Kosovo's Territorial Status", *European Journal of International Law* vol. 14, no. 5 (2003).

Enver Hasani, "Disa çështje lidhur me Konventat e Vjenës mbi Trashëgimin e Shteteve", në *Fjala* (Prishtinë, prill 1992).

Enver Hasani, "KLA's Legal Expert: First International Protectorate and then Independence", intervistë, *Turkish Daily News* (Saturday-Sunday, April 10-11, 1999).

Enver Hasani, "Kritikë konceptit shtet në një vepër të Keneth Uallc (Kenneth Waltz)". *E drejta/Law* nr. 1-4 (2000).

Enver Hasani, "Marrëveshja ia njeh pushtetin kushtetutbërës Asociacionit", *Zëri Ditor* (4 nëntor 2015) fq. 10-11.

Enver Hasani, "Mbretëria e Serbëve-Kroatëve-Sllovenëve nuk është vazhdimësi juridike e Mbretërisë së Serbisë", *Fjala* nr. 23 (Prishtinë, qershor, 1991) fq. 10-11.

Enver Hasani, "Reflections on Serbian Nationalism and the Policy of Ethnic Cleansing", *Perceptions* vol. IV, no. 4 (December 1999/February 2000).

Enver Hasani, "Reflektime mbi nacionalizmin serb dhe politikën e spastrimit etnik", *Rilindja* (Tiranë, 31 janar–7 shkurt 1998).

Enver Hasani, "Self-Determination under the Terms of the 2002 Union Agreement between Serbia and Montenegro: Tracing the Origins of Kosovo Self-Determination", *Chicago-Kent Law Review*, vol. 80, no. 1 (2005).

Enver Hasani, "Sovraniteti dhe vetëvendosja", *Fjala* nr. 24 (Prishinë, 1990) fq. 3.
Enver Hasani, "Sovraniteti dhe vetëvendosja", kumtesë e lexuar më 24 maj 1991, në simpoziumin shkencor më titull *Shqiptarët dhe Evropa, dje dhe sot*, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (mbajtur në Prishtinë, më 23-26 maj 1991).
Enver Hasani, "Specifikat e trashëgimit të ish-Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të", *E drejta/Law* nr. 1 (2012).
Enver Hasani, "Suksedimi i shtetit jugosllav dhe instrumentalizimi juridiko-ndërkombëtar i subjektivitetit të Kosovës", kumtesë e lexuar në simpozium shkencor ndërkombëtar *Shqiptarët në rrjedhat ballkanike*, organizuar nga AShAK dhe Instituti Albanologjik (mbajtur në Prishtinë, prill 1992).
Enver Hasani, "Të gjitha gjykatat e Hagës", *Jurisprudenca Shqiptare* nr. 2 (Tiranë, 1996).
Enver Hasani, "Të gjitha Gjykatat e Hagës", *Rilindja Javore* (Tiranë, korrik-gusht 1995).
Enver Hasani, "The 'Outer Wall' of Sanctions and the Kosovo Issue", *Perceptions: Journal of International Affairs* vol. III, no. 3 (September-November 1998).
Enver Hasani, "The Evolution of the Succession Process in the Former Yugoslavia", *Thomas Jefferson Law Journal* vol. 29, no. 1 (Fall 2006).
Enver Hasani, "The Evolution of the Succession Process in the Former Yugoslavia", *Miskolc Journal of International Law* vol. 4, no. 2 (2007).
Enver Hasani, "*Uti Possidetis Juris*: From Rome to Kosovo", *Fletcher Forum of World Affairs* vol. 27, issue 2 (Summer/Fall 2003).
Enver Hasani, "Vendimi i Arbitrazhit (s) është i drejtë", *Fjala* (Prishtinë, dhjetor 1991).
Enver Hasani: "Specifikat e trashëgimit të ish-Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të", *E drejta*, nr. 1 (2012) fq. 7-53.
Eric Kolodrer, "Population Transfer: the Effects of Settler infusion on a Host Population's Right to Self-Detemrination", *New York University Journal of International Law and Politics* vol. 27, no. 1 (Autumn 1994).
Eric Stein, "International Law in Internal Law: Towards Internationalisation of Central — Eastern European Constitutions", *American Journal of International Law* vol. 88, no. 3 (July 1994).
Espen Barth Eide, "The Internal Security Challenge in Kosovo", *International Spectator* vol. 35, no. 1 (January-March 2000).
F.C. Fisher, "The Arbitration of the Guatemalan-Honduras Boundary Dispute", *American Journal of International Law* vol. 27, no. 3 (July 1933).
Fadil Hysa, "Krijimi i vetëdijes shtetëformuese", intervistë, *Fjala* (Prishtinë, 12 shkurt 1992) fq. 6-7.

Ferguson Yale & Richard Mansbach, "Between Celebration and Despair: Constructive Suggestions for Future International Theory", *Inernational Studies Quarterly* vol. 35 (1991).
Francis Fukuyama, "The End of History", *National Interest* (Summer 1989).
Francis Vallat, "First Report on Succession of States in Respect of Treaties", *The Yearbook of the International Law Commission* vol. II (1974).
Frank Hoffmeister, "Consent to be bound by a treaty expressed by ratification, acceptance or approval", te Oliver Dörr, Kirsten Schmalenbach (eds.), *Vienna Connvention on the Law of Treaties: A Commentary* (Springer: Verlag, 2012).
Frederich von der Heydte, "Discovery, Symbolic Annexation and Virtual Effectiveness in International Law", *American Journal of International Law* vol. 29, no. 3 (July 1935).
Friedrich Kratochwil, "Of Systems, Boundaries, and Territoriality: An Inquiry into the Formation of the State System", *World Politics* vol. 39, no. 1 (October 1986).
Gaetano Arangio Ruiz, "Stati e altri enti (soggetività internazionale)", në *Novissimo Digesto Italiano* vol. XVIII (UTET, Torino, 1971).
Gennady M. Danilenko, "The New Russian Constitution and International Law", *American Journal of International Law* vol. 88, no. 3 (July 1994).
Georg Maier, "The Boundary Dispute between Ecuador and Peru", *American Journal of International Law* vol. 63, no. 1 (January 1969).
Georg Winfield Scott, "Hague Convention Restricting the Use of Force to Recover on Contract Claims", *American Journal of International* Law vol. 2, no. 1 (January 1908).
George Karipsiadis, "State Succession in the Balkans: Its Impact Upon International Boundaries", në *Southeast European Yearbook* (1994).
Georges Abi-Saab, "Le principe de l'uti possidetis : son rôle et ses limites dans la contentieux territorial international", në Marcelo G. Kohen (ed.), *Promoting Justice, Human Rights and Conflict Resolution Through International Law: Liber Amicorum Lucius Caflisch* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2007).
Georges-Marie Chenu, "Les limites des interventions européennes", në Marie-Françoise Allain et al. (eds.), *L'ex-Yougoslavie en Europe : de la faillite des démocraties au processus de paix* (L'Harmattan: Paris, 1997).
Gideon Rottem, "Land, Island and Maritime Frontier Dispute" *American Journal of International Law* vol. 87, no. 4 (October 1993).
Giovanni Distefano, "The Conceptualizaion (Construction) of Territrial Title in the Light of the International Court of Justice Case Law", *Leiden Journal of International Law* vol. 19, issue 4 (2006).
Giovanni Sperduti, "Stati", në *Novissimo Digesto ltaliano* vol. VXII (Torino, 1971).

Giuseppe Sperduti, "STATI (Riconoscimento Internazionale Degli)", në *Novissimo Digesto Italiano* vol. XVIII (UTET: Torino 1971).
Gregory H. Fox, "Self-Determination in the Post-Cold War Era: A New Internal Focus?", *Michigan Journal of International Law* vol. 16, no. 3 (Spring 1995).
Guido Acquaviva, "The Dissolution of Yugoslavia and the Fate of Its Financial Obligations", *Denver Journal of International Law and Policy* vol. 30, no. 2 (Spring 2002).
Habib Gherari, "Quelque observations sur les États ephemere", *Annuaire français de droit international* vol. 40, no. 1 (année 1994).
Hanna Bokor-Szego, "Questions of State Identity and State Succession in Eastern and Central Europe", në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1999).
Henry H. Perritt, Jr., "Introduction", në *Chicago Kent Law Review* vol 3, no. 80 (2005).
Hubert Beemelmans, "State Succession in International Law: Remarks on Recent Theory and State Praxis", *Boston University International Law Journal* vol. 15, no. 1 (Spring 1997).
Hugh Poulton, "The Rest of the Balkans", në Hugh Miall (ed), *Minority Rights in Europe* (Pinter Publishers: UK, 1994).
Ibrahim F.I. Shihata, "Matters of State Succession in the World Bank's Practice", në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1999).
Isabelle Poupart, "Succession aux traite et droit de l'home: vers la reconnaissance d'une protection ininterrompue des individus", në Pierre-Michel Eisemann et Martti Koskenniemi (eds.), *La succession d'États : la codification à l'epreuve des faits / State Succession : Codification Tested Against the Facts* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2000).
Ivan Veković, "Prilog razumevanju etničkih sukoba na Balkanu i Kavkazu", *Republika* no. 174 (Beograd, 1997).
J.E.S. Fawcett, "Some Foreign Effects of Nationalization of Property", *British Yearbook of International Law* vol. 27 (1950).
"Jackson për Marrëveshjen e Kumanovës: Çështja e kufirit u diskutua vetëm për largimin e serbëve", *Gazeta Blic* (20 shtator 2016).
James Brady, "History Proves Again Balkan's Bite is Worse Than its Bark", *Advertising Age* (July 13, 1998) fq. 25.
James Brown Scott, "The Swiss Decision in the Boundary Dispute Between Colombia and Venezuela", *American Journal of International Law* vol. 16, no. 3 (July 1922).
James Gow, "Serbian Nationalism and the Hissssing Ssssnake in the International Order: Whose Sovereignty? Which Nation?", *Slavonic and East European Review* vol. 72, no. 3 (July 1994).

Janusz Bugajski, "Act Now in Kosovo, or Regret it Later", *Christian Science Monitor* (March 11, 1998) fq. 19.
Jean-Dominique Schouwey, "Crimes de guerre : un état des lieux du droit suisse", *Revue internationale de criminologie et de police technique* (Genève) vol. XLVIII, no. 1 (1995).
Jean-Marc Sorel et Rostane Mehdi, "L'uti possidetis entre la consécration juridique et la pratique : essai de réactualisation", *Annuaire Francais de Droit International* vol. 40 no. 1 (1994).
Jeffrey Herbst, "The Creation and Maintenance of National Boundaries in Africa", *International Organization* vol. 43, no. 4 (Autumn 1989).
Jesse S. Reves, "International Boundaries", *American Journal of International Law* vol. 38, no. 4 (October 1944).
John J. Mearsheimer, "Back to the Future. Instability in Europe After Cold War", *International Security* vol. 15, no. 1 (Summer 1990).
Jonathan Chamey, "Anticipatory Humanitarian Intervention in Kosovo", *American Journal of International Law* vol. 93, no. 4 (October 1999).
Jonathan S. Landay, "NATO's Drums Beat Louder Over Kosovo", *Christian Science Monitor* (September 25, 1998) fq. 1, 7.
Josef L. Kunz, "Guatemala vs. Great Britain: In Re Belice", *American Journal of International Law* vol. 40, no. 2 (April 1946).
Joseph Grieco, "Anarchy and the Limits of Cooperation: A Realist Critique of Newest Liberal Institutionalism", *International Organization* vol. 42, no. 3 (Summer 1988).
Joshua Castellino, "Territoriality and Identity in International Law: The Struggle for Self-Determination in the Western Sahara", *Millennium: Journal of International Studies* vol. 28, no. 2 (1999).
"Jugoslavija nije jedina naslednica SFRJ", *Naša Borba* (utorak, 24 mart 1998).
Jure Vidmar, "Confining New International Borders in the Practice of Post-1990 State Creations", *Zeitschrift für ausländisches öfentliches Recht und Völkerrecht / Heidelberg Journal of International Law* vol. 70, no. 2 (2010).
Jure Vidmar, "International Legal Responses to Kosovo's Declaration of Independence", *Vanderbilt Journal of Transnational Law* vol. 42, no. 3 (2009).
Justin Brown, "Living in Cross Hairs of NATO", *Christian Science Monitor* (October 7, 1998) fq. 11.
Justin Brown, "Uncomfortable Peace in Kosovo", *Christian Science Monitor* (14 October 1998) fq. 1.
Karl Strupp, "Les règles générales du droit de la paix", *Recueil de Cours de l'Academie de Droit International* vol. 47 Tome I (1934).
Kenneth Waltz, "Anarchic Orders and Balances of Power", në Robert O. Keohane (ed.), *Neorealism and Its Critics* (Columbia UP: New York, 1986).
Konstandin Obradović, "Again on the Problem of Continuity: Is FR Yugoslavia 'Old' or 'New' State?", *Medjunarodni problemi* nr. 3 (Beograd, 1994).

Konstantin Obradović, "Problemi vezani za sukcesiju SFRJ", në Milan Šahović (ed), *Medjunarodno pravo i jugoslovenska kriza: zbornik radova* (Službeni list SRJ: Beograd, 1996).

Lech Antonowitcz, "The Disintegration of the USSR from the Point of View of International Law", *Polish Yearbook of International Law* vol. 19 (1991-1992).

Leonard F.M. Besselink , "National and constitutional identity before and after Lisbon", *Utrecht Law Review* vol. 6, issue 3 (November 2010).

Lester Hood Woolsey, "Boundary Disputes in Latin America", *American Journal of International Law* vol. 25, no. 2 (April 1931).

Lester Hood Woolsey, "The Ecuador-Peru Boundary Controversy", *American Journal of International Law* vol. 31, no. 1 (January 1937).

Ljubivoje Ačimović, "Continuity of International Legal Personality of Yugoslavia and Its Membership in the United Nations", *Medjunarodni problemi* nr. 3 (Beograd, 1994).

Louis Henkin, "Kosovo and the Law of 'Humanitarian Intervention'", *American Journal of International Law* vol. 93, no. 4 (October 1999).

Louis Henkin, R.C. Pugh, Oscar Schachter, and Hans Smit, *International Law: Cases and Materials* (West Publishing: St. Paul, Minn., 1993).

Maja Nastić, "Constituional Review of International Agreements: Comparative Law Perspective", *Facta Universitatis*, Series: *Law and Politics* vol. 13, no 1 (Niš, Serbia, 2015).

Malcolm N. Shaw, "State Succession Revisited", *The Finnish Yearbook of International Law* vol. V (Helsinki, 1994).

Malcolm Shaw, "The Heritage of States: The Principle of *Uti Possidetis* Today", *British Yearbook of International Law* vol. 67 (1996).

Manuel Szapiro, "Will the Kosovo Crisis Rejuvenate CFSP and European Defence?", në Dieter Mahncke (ed.), *Old Frontiers — New Frontiers: The Challenge of Kosovo and Its Implications for the European Union* (Peter Lang: Bern, 2001).

Marc Weller, "The International Response to the Dissolution of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia". *American Journal of International Law* vol. 86, no. 3 (July 1992).

Marcello Gustavo Kohen, "L'uti possidetis revisité: L'arrêt du 11 septembre 1992 dans l'affaire El Salvador / Honduras", *Revue générale de droit international public* Tome 97, no. 4 (1993).

Marco Martins, "An Alternative Approach to the International Law of State Succession: Lex Naturae and the Dissolution of Yugolsavia". *Syracuse Law Review* vol. 44, no. 3 (1993).

Maria Isabel Torras Cazorla, "Rights of Private Persons on State Succession: An Approach to the Most Recent Cases", në Pierre-Michel Eisemann et Martti Koskenniemi (eds.), *La succession d'États : la codification à l'epreuve des faits*

/ *State Succession : Codification Tested Against the Facts* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2000).
Marija Oblak-Carni & Born Bohte, "Succession to the Archives of the Former SFR Yugoslavia", në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1999).
Marina Stambuk-Skalić, "Hrvatska istočna granica u u dokumentima 1945-1947", *Fontes: izvori za hrvatsku povjest* vol. 1, no. 1 (Zagreb, novembar 1995).
Mario Zucconi, "The West and the Balkan Conflict", në Stefano Bianchini and Robert Craig Nation (eds.), *The Yugoslav Conflict and Its Implications for International Relations* (The Modern Library: New York, 1998).
Mark Dennis, "Kosovo: Locked and Loaded", *Newsweek* (October 19, 1998) fq. 50.
Martti Ahtisari, "Nuk e kam kërcënuar Millosheviçin", *Kosova Sot* (Prishtinë, 26 korrik 2000) fq. 8.
Martti Koskenniemi, "Report of the Director of the Studies of the English-Speaking Section of the Centre", në Pierre-Michel Eisemann et Martti Koskenniemi (eds.), *La succession d'États : la codification à l'epreuve des faits / State Succession : Codification Tested Against the Facts* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2000).
Martyn Rady, "Self-Determination and the Dissolution of Yugoslavia", *Ethnic and Racial Studies* vol. 19, no. 2 (1996).
Mary Ellen O'Connell, "The U.N., NATO, and International Law After Kosovo", *Human Rights Quarterly* vol. 22, no. 1 (February 2000).
Mattias Wendel, "Lisbon Before the Courts: Comparative Perspectives", në Jose Maria Beneyto / Ingolf Pernice (eds.), Europe's Constitutional Challenges in the Light of the recent Case Law of National Constitutional Courts: Lisbon and Beyond (Nomos: Baden-Baden, 2011).
Matthew C.R. Craven, "The European Community Arbitration Commission on Yugoslavia", *British Yearbook of International Law* vol. 66 (1995).
Matthew C.R. Craven, "The Problem of State Succesion and Identity in Under International Law", *European Journal of International Law* vol. 9, no. 1 (1998).
Maurizio Ragazzi, "Introduction", ILM vol. 31 (1992).
Michael C. Wood, "Participation of Former Yugoslav States in the United Nations and in multilateral Treaties", *Max Planck Yearbook of United Nations Law* vol. I (1997).
Michael Hirsh, "The Balkans: Holbrooke's Nervy Game of Chicken", *Newsweek* (October 26, 1998) fq. 50-51.
Michael V. Kryukov, "Self-Determination from Marx to Mao", *Ethnic and Racial Studies* vol. 19, no. 2 (1996).

Michla Pomerance, "The Badinter Commision: The Use and Misuse of the International Court of Justice's Jurisprudence", *Michigan Journal of International Law* vol. 20, no. 1 (Fall 1998).
Milan Bartos, "Krystyna Marek: Identity and Continuity of States in Public International Law (Geneve 1954)", *Jugoslovenska revija za Medjunarodno pravo* vol. I, nr. 1 (Beograd: 1954).
Milan Šahović, "Raspad SFRJ i stvaranje novih država", në Milan Šahović (ed), *Medjunarodno pravo i jugoslovenska kriza: zbornik radova* (Službeni list SRJ: Beograd, 1996).
Mile Milenkoski and Jove Talevski, "Delineation of the State Border Between the Republic of Macedonia and the Federal Republic of Yugoslavia", *IBRU Boundary and Security Bulletin: Articles Section* (Summer 2001).
Milenko Kreća, "A Few Remarks About the Continuity of FR Yugoslavia", *Medjunarodni problemi* nr. 3 (Beograd, 1994).
Mirjam Skrk, "Recognition of States and Its (Non-)Implications on State Succession: The Case of Successor States to the Former Yugoslavia", në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1999).
Mladen Klemenčić, "The Border Agreement Between Croatia and Bosnia-Herzegovina: The First but not the Last", në *IBRU Boundary and Security Buletin: Articles Section* (Winter 1999-2000).
Mohammed Bedjaoui, *Ninth Report on Succession of States in Respect of Matters Other Than Treaties* (Doc. A/CN.4/301 and Add. 1 of 13 and 20 April 1977).
Mohammed Bedjaoui, *Thirteenth Report on Succession Of States in Respect of Matters Other Than Treaties* (Doc. A/CN.4/345/Add. 1 of 29 May 1977).
Mojmir Mrak, "Apportionment and Succession of External Debts: The Case of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia", në *Research Reports* No. 259 (Vienna Institute for International Economic Studies, August 1999).
Mojmir Mrak, "Succession to the Former Yugoslavia's External Debt: The Case of Slovenia", në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1999).
Mr. Igor Spirovski, *The Competence of the Constitutional Court to Control the Conformity of Laws With International Treaties: New Trends in Constitutional Justice*, CDL-JU (2009) 036 (Vennice Commission, Strasbourg, 17 November 2009).
N.R. Doman, "Post War Nationalization of Foreign Property in Europe", *Colombia Law Review* vol. 48, no. 8 (December 1948).
Natalino Ronzitti, "Resort to Force in Wars of National Libetarion", në Antonio Cassese, *Current Problems of International Law: Essays on UN Law and the Law of Armed Conflict* (Dott. A. Guiffre: Milano, 1975).
Natalino Ronzitti, "Wars of National Liberation: A Legal Definition", në *Italian Yearbook of International Laws* no. 1 (1975).
"NATO Statement on Kosovo", *HRI* (January 31, 1999).

Norman Kempster, "Warring Sides in Kosovo Get Ultimatum", *Los Angeles Times* (30 January 1999) fq. 1.
O Robarz, "Da li je naša Kraljevina nova ili stara država", *Arhiv za pravne i društvene nauke* knjiga XXIII (Beograd: 1933).
Orla McBreen, "The Diplomatic Involvement of the EU in the Kosovo Crisis", në Dieter Mahncke (ed.), *Old Frontiers — New Frontiers: The Challenge of Kosovo and Its Implications for the European Union* (Peter Lang: Bern, 2001).
Ove E. Bring, "Correspondents' Agora: U.N. Membership of the Former Yugoslavia", *American Journal of International Law* vol. 87, no. 2 (April 1993).
Paschalis M. Kitromilides, "'Balkan Mentality': History, Legend, Imagination", *Nations and Nationalism* vol. 2, no. 2 (1996).
Patricia Berko Wild, "The Organisation of African Unity and the Algeria-Morocco Border Conflict: A Study of New Machinery for Peacekeeping and for the Peaceful Settlement of Disputes Among African States", *International Organization* vol. 20, no. 1 (Winter 1996)
Patrick T. Egan, "The Kosovo Intervention and Collective Self-Defence", *International Peacekeeping* vol. 8, no. 3 (2001).
Paul Goble, "Another Precedent From Kosovo?", *RFE/RL Newsline* (November 9, 2000).
Paul R. Williams, "State Succession and the International Financial Institutions: Political Criteria v. Protection of Outstanding Financial Obligations", *The International and Comparative Law Quarter*ly vol. 43, no. 4 (October 1994).
Paul Williams & Jennifer Harris, "State Succession to Debts and Assets: The Modern Law and Policy", *Harvard International Law Journal* vol. 42, no. 2 (Summer 2001).
Payam Akhavan, "Self-Determination and the Disintegration of Yugoslavia: What Lessons for the International Community?", në Donald Clark and Robert Williamson (eds.), *Self-Determination: International Perspectives* (Plagrave Macmillan UK: Basingstoke, 1996).
Peter Radan, "The Badinter Arbitration Commission and the Partition of Yugoslavia", *Nationalitites Papers* vol. 25, no. 3 (1997).
Peter Sugar, "Nationalism in Eastern Europe", në John Hutchinson and Anthony Smith (eds.), *Nationalism* (Oxford UP: Oxford, 1994).
Philip J. Cohen, "The Complicity of Serbian Intellectuals in Genocide in the 1990s", në Thomas Cushman and Stjepan G. Meštrović (eds.), *This Time We Knew* (New York UP: New York, 1996).
Pierre Michel Eisemann, "Rapport du directeur d'études de la section de langue française du Centre", në Pierre-Michel Eisemann et Martti Koskenniemi (eds.), *La succession d'États : la codification à l'epreuve des faits / State Succession : Codification Tested Against the Facts* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2000).

Pierre-Michel Eisemann, "Rapport du Directeur d'études de la section de langue française du Centre", në Pierre-Michel Eisemann et Martti Koskenniemi (eds.), *La succession d'États : la codification à l'epreuve des faits / State Succession : Codification Tested Against the Facts* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2000).

Predrag Simić, "Ambassadors Return to Belgrade", *Review of International Affairs* no. 1044 (Belgrade, 15 May 1996).

R.W. Apple, Jr., "A Fresh Set of U.S Goals", *New York Times* (25 March 1999).

Raju G.C. Thomas, "Nations, States, and Secession: Lessons from the Former Yugoslavia", *Mediterranean Quarterly* vol. 5, no. 4 (Fall 1994).

Ralph Wilde, "From Danzig to East Timor and Beyond. The Role of International Territorial Administration", *American Journal of International Law* vol. 95, no. 3 (2001).

Ravi L. Kapil, "On the Conflict Potential of Inherited Boundaries in Africa", *World Politics* vol. 18, no. 4 (January 1966).

Regime Theory Meet the English School", *International Organization* vol. 47, no. 3 (Summer 1993).

Rein Mullerson, "The Continuity and Succession of States by Reference to Former USSR and Yugoslavia". *International and Comparative Law Quartelry* vol. 42, part 3 (July 1993).

"Rešavanje životnih problema nekada zahendnickih gradjana", *Naša Borba* (utorak, 25 mart 1998).

Rexhep Qosja, "The Albanian National Question in Serb Political Programmes during the Years 1937-1944", *International Journal of Albanian Studies,* vol. I, issue I (Fall 1997).

Richard A. Falk, "Janus Tormented: The International Law of Internal Wars", në James N. Roseneau, *International Aspects of Civil Strife* (Princeton UP: Princeton, 1964).

Richard A. Falk, "Kosovo, World Order, and the Future of International Law", *American Journal of International Law* vol. 93, no. 4 (October 1999)

Robert Badinter, "L'Europe du droit", *European Journal of International Law* vol. 4, no. 1 (1993).

Robert L. Solomon, "Boundary Concepts and Practices in Southeast Asia", *World Politics* vol. 23, no. 1 (October 1970).

Robert M. Hayden, "Bosnia's Internal War and the International Criminal Tribunal", *The Fletcher Forum of World Affairs* vol. 45, no. 22 (Winter/Spring 1998).

Robert O. Keohane (ed.), *Neorealism and Its Critics* (Columbia UP: New York, 1986).

Roland Rich, "Recognition of States: The Collapse of Yugoslavia and the Soviet Union". *European Journal of International Law* vol. 4, no. 1 (1993).

Ronald Steel, "Hijacked", *New Republic* (July 13, 1998) fq. 10.

Rupert Emerson, "Pan-Africanism", *International Organization* vol. 16, no. 2 (Spring 1962).
Ruth Wedgwood, "NATO's Campaign in Yugoslavia", *American Journal of International Law* vol. 93, no. 4 (October 1999).
S.V. Man, "The 1971 War on the Indian Subcontinent and the International Law", *Indian Journal of International Law* vol. 12 (1972).
Said Mahmoudi, "Recogntion of States: The Case of Former Yugoslav Republics", në Ove Bring and Said Mahmoudi (eds.), *Current International Law Issues: Nordic Perspectives Essays in Honor of Jerzy Sztucki* (Kluwer Law International: The Hague, 1994).
Samuel P. Huntington, "The Clash of Civilizations?" *Foreign Affairs* (Summer 1993).
Sandrine Maljean-Dubois, "La rôle de l'équité dans le droit de la succession d'États", në Pierre-Michel Eisemann et Martti Koskenniemi (eds.), *La succession d'États : la codification à l'epreuve des faits / State Succession : Codification Tested Against the Facts* (Martinus Nijhoff: The Hague, 2000).
Saskia Hille, "Mutual Recognition of Croatia and Serbia (+Montenegro)", *European Journal of International Law* vol. 6, no. 4 (1995).
Scott Pegg, "*De Facto* States in the International System", në Institute of International Relations of the University of British Columbia, *Working Paper* No. 21 (February 1998).
Sergei A. Voitovich, "Annex: Decision of the Council of Heads of State of the Commonwealth of Independent States", *European Journal of International Law* vol. 4, no. 3 (1993).
Sergei A. Voitovich, "The Commonwealth of Independent States: An Emerging Institutional Model", *European Journal of International Law* vol. 4, no. 3 (1993).
Slaven Letica, "The Genesis of the Current Balkan War". Stjepan G. Meštrović (ed.), *Genocide after Emotion: The Post-Emotional Balkan War* (Routledge: New York, 1996).
Slavko Čuruvija and Iran Todorov, "The March to War: 1980-1990", në Jasmina Udovicki and James Ridgeway (eds.), *Yugoslavia's Ethnic Nightmare* (Lawrence Hill: New York, 1995).
Stefan Oeter, "State Succession and the Struggle Over Equity: Some Observations on the Laws of State Succession with Respect to State Property and Debts in Cases of Separation and Dissolution of States", *German Yearbook of International Law* (1995).
Stefan Talmon, "Recognition of Governments: An Analysis of the New British Policy and Practice", *The British Yearbook of International Law* 63 (1992).
Stephen Alvstad, "The Quebec Secession Issue, With an Emphasis on the 'Cultural' Side of the Equation", *Temple International and Comparative Law Journal* vol. 18, no. 89 (Spring 2004).

Steven Ratner, "Drawing a Better Line: *Uti Possidetis* and the Borders of New States", *American Journal oflnternational Law* vol. 90, no. 4 (1996).
Steven Ratner, "Drawing a Better Line: *Uti Possidetis* and the Borders of New States", *American Journal of International Law* vol. 90, no. 4 (October 1996).
Susan L. Woodward, "Kosovo and the Region: Consequences of the Waiting Game", *International Spectator* vol. 35, no. 1 (January-March 2000).
Sylejman Gashi, "ShBA-të ndaj zhvillimeve në Kosovë dhe Serbi: Muri i jashtëm ka themelet në Prishtinë", *Rilindja* (Tiranë, 13 shkurt 1997) fq. 5.
Shlomo Avineri, "The Future of Kosovo", *East European Constitutional Review* vol. 8, no. 3 (Summer 1999).
Timothy William Waters, "The Naked Land: The Dayton Accords, Property Disputes, and Bosnia's Real Constitution", *Harvard International Law Journal* vol. 40, no. 2 (Spring 1999).
Todor Djunov, "Succession of States in Respect of Citizenship: The Case of Former SFRY", *Development and Cooperation* vol. XII, no. 23 (December 1996).
Tomas Frank, "The Emerging Right to Democratic Governance", *American Journal of International Law* vol. 86, no. 1 (1992).
"The Guatemala-Honduras Boundary", *Geographical Review* vol. 23, no. 2 (1933); në rrjet: http://www.jstor.org/stable/209082 (shikuar së mbrami më 27 tetor 2016).
Thomas Baty, "Can an Anarchy be a State?", *American Journal of International Law* vol. 28, no. 3 (July 1934).
Thomas Burgenthal, "Modern Constitutions and Human Rights Treaties", *Columbia Journal of Transnational Law* vol. 36, Special Double Issue (1997).
Thomas Ebenroth & Matthew James Kemner, "The Enduring Political Nature of Questions of State Succession and Succession and the Quest for Objective Standards", *University of Pennsylvania Journal of International Economic Law* vol. 17, no. 3 (Fall 1996).
Thomas M. Franck, "Lessons of Kosovo", *American Journal of International Law* vol. 93, no. 4 (1999).
Viktor Černomirdin, "Nismo izdali Srbiju" (intervistë), *NIN* (Beograd, 14 oktobar 1999) fq. 49.
Virginia Tilley, "The Terms of Debate: Untangling Language about Ethnicity and Ethnic Movements", *Ethnic and Racial Studies* vol. 20, no. 3 (July 1997).
Vladimir Djuro Degan, "L'arbitrage juridique ignore : la jurisprudence de la Commission Badinter", në Marie-Françoise Allain et al. (eds.), *L'ex-Yougoslavie en Europe : de la faillite des démocraties au processus de paix* (L'Harmattan: Paris, 1997).
Vladimir-Djuro Degan et al., "Correspondents' Angora: U.N. Membership of the Former Yugoslavia", *American Journal of International Law* vol. 87, no. 2 (April 1993).

Vladimir-Djuro Degan, "Disagreements over the Definition of State Property in the Process of State Succession to the Former Yugoslavia", në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1999).
Vladimir-Djuro Degan, "Equity in Matters of State Succession", në Ronald St. John Macdonald (ed.), *Essays in Honour of Wang Tieya* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1994).
Vladimir-Djuro Degan, "Jugoslavija u raspadu: Misljenje arbitražne komisije br. 1 od 7 prosinca 1991", *Politička Misao* vol. XXVIII, nr. 4 (1991).
Vladimir-Djuro Degan, "L'arbitrage juridique ignore : la jurisprudence de la Commission Badinter", në Marie François Allain et al. (eds.), *L'ex-Yougoslavie en Europe: de la fallite des democraties au processus de paix* (L'Harmattan: Paris, 1997).
Vladimir-Djuro Degan, "Samoopredeljenje naroda i teritorijalna celovitost država u uvjetima raspada Jugoslavije", *Naša Zakonitost* vol. 46, no. 4 (Zagreb, 1992).
Vladimir-Djuro Degan, "State Succession, Especially in Respect of State Property and Debts", *The Finnish Yearbook of International Law* vol. 4 (1993).
Vladimir-Djuro Degan, "Yugoslavia in Dissolution: Opinion No. 1 of the Arbitration Commission of 7 December, 1991", *Croatian Political Science Review* vol. I, no. 1 (Zagreb, 1992).
Vladislav Jovanović, "The Status of the Federal Republic of Yugoslavia in the United Nations", *Fortham International Law Journal* vol 21, no. 5 (June 1998).
Vladmir-Djuro Degan, "Disagreements over the Definition of State Property in the Process of State Succession to the Former Yugoslavia", në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States* (Martinus Nijhoff: The Hague, 1999).
W. Michael Reisman, "Kosovo's Antinomies", *American Journal of International Law* vol. 93, no. 4 (October 1999).
W. Michael Reisman, "Protecting Indigenous Rights in International Adjudication", *American Journal of International Law* vol. 89, no. 2 (April 1995).
Warren Zimmermann, "The Demons of Kosovo", *National Interest* issue 52 (Spring 1998) fq. 5-6.
Yehuda Blumm, "UN Membership of the 'New' Yugoslavia", *American Journal of International Law* vol. 86, no. 4 (1992).
Zoran Lutovac, "Options for Solution of the Problem of Kosovo", *Review of International Affairs* vol. 48 (15 May 1997).

3. Dokumente dhe materiale të tjera

Agreed Conclusions of 2 September 2011 (Cadastral Records). [Marrëveshje Kosovë–Serbi për librat kadastralë.]

Agreed Conclusions of 2 September 2011 (Civil Registry Books). [Marrëveshje Kosovë–Serbi për regjistrat civilë.]
Agreement on Normalization of Relations and Promotion of Cooperation between Macedonia and the Federal Republic of Yugoslavia, 8 prill 1996. *Flaka e Vëllazërimit* (Shkup, 9 prill 1996).
Agreement on Normalization of Relations between the Federal Republic of Yugoslavia and Croatia. 23 August 1996. *Review of International Affairs* vol. XLVII, no. 1048 (Beograd 1996).
Agreement on Succession Issues and Annexes A to G. Marrëveshje mbi Çështje e Trashëgimit dhe Anekset A deri në G. nënshkruar më 29 qershor 2001 mes Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Sllovenisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë ("Unioni Serbi dhe Mali i Zi"). *ILM* vol. 41 (2002).
Aktit Final të Berlinit mbi Kongon. The General Act of the Berlin Congo Conference (1845).
American Journal of International Law vol. 30 (1936), *Supplement*.
B92. *Odraz B92 Vesti* (Beograd, 11 nëntor 1997).
B92 Open Serbia (Beograd, 6-7 nëntor 1997).
BB. Press Release No. 93/543, 26 February 1993.
CNN, *News*, 20:00 CET.
Cuban–American Treaty of Relations, 1903. Traktati i Havanës Kubë–ShBA.
Declaration on the Guidelines on the Recognition of New States in Eastern Europe and in the Soviet Union, miratuar në mbledhjen e jashtëzakonshme ministrore të Konferencës për Paqen në Jugosllavi, Bruksel 16 dhjetor 1991. *ILM* vol. 31 (1992).
Deklarata e Alma-Atas mbi formimin e Komonuelthit të Shteteve të Pavarura, datë 21 dhjetor 1991.
Deklarata e Minskut. *ILM* vol. XXXI, no. 1 (January 1992).
Dekreti DMN-003-2016 i Presidentes së Republikës së Kosovës për Ratifikim të Marrëveshjes Ndërkombëtare, datë 3 shkurt 2016.
Dieter Kastrup, përfaqësues i përhershëm gjerman pranë OKB-së. Letër, datë 6 maj 1999, drejtuar kryetarit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Annex, U.N. SCOR, 54th Sess., U.N. Doc. S/1999/516 (1999).
Eritrea-Ethiopia Boundary Commission. Decision Regarding Delimitation of the Border Between the State of Eritrea and the Federal Democratic Republic of Ethiopia of 13 April 2002. *Reports of International Arbitral Awards* vol XXV.
EU Council of Ministers, Strategic Document. February 1997.
EU Council of Ministers. Deklaratë. Luksemburg, 16 shtator 1997. *Rilindja* (Tiranë, 17 shtator 1997) fq. 1 dhe 5.
EuroNews, 15 maj 1995, 16:30 CET.
EuroNews, 25 korrik 1995, 16:00 CET.
European Community: Declaration on Yugoslavia on the Guidelines on the Recognition of New States in Eastern Europe and the Soviet Union. *ILM* vol.

31. Deklarata e Bashkimit Evropian për Njohjen dhe Kriteret. 16 dhjetor 1991.
Forum 2015, *Mëngjesi një ditë pas: jeta pa mbikëqyrje* (KFOS: Prishtinë, gusht 2012).
General Act of the Berlin-Congo Conference. 1885.
General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina. December 14, 1995. *ILM* vol. 35 (1996).
Grupi i Kontaktit. Deklarata e Grupit të Kontaktit (Bon, 29 prill 1998).
Grupi i Kontaktit. Deklarata për Kosovën. Londër, 9 mars 1998.
Grupi i Kontaktit. Deklaratat për Kosovën, të datave 9 mars (takimi i Londrës), 15 e 25 mars, 29 prill, 9 maj, 12 qershor dhe 8 korrik 1998 (Bon, Gjermani).
GjND. *Anglo-Iranian Oil Co. Case*. ICJ (1952).
GjND. Application of the Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide: *Bosnia and Herzegovina v. Yugoslavia (Serbia and Montenegro)*. 20 March 1993.
GjND. Case Concerning Land, Island and Maritime Frontier Dispute (*El Salvador/Honduras: Nicaragua Intervening*). Judgement of 11 September 1992. ICJ Reports (1992).
GjND. Case Concerning Sovereignty Over Pulau Ligitan and Pulau Sipadan (*Indonesia/Malaysia*). Judgement of 16 September 2002. ICJ Reports (2002).
GjND. Case Concerning Temple of Preah Vihear (*Cambodia v. Thailand*). Judgement of 26 May 1961. ICJ Reports (1961).
GjND. Case Concerning the Land and Maritime Boundary between Cameroon and Nigeria (*Cameroon v. Nigeria: Equatorial Guinea Intervening*). Judgment of 10 October 2002. ICJ Reports (2002).
GjND. *Corfu Channel Case* [Rasti i Kanalit të Korfuzit], ICJ (1948).
GjND. Frontier Dispute (*Benin/Niger*). Judgment of 12 July 2005. ICJ Reports (2005).
GjND. Frontier Dispute (*Burkina Faso/Niger*). Judgement of 16 April 2013. ICJ Reports (2013).
GjND. Frontier Dispute (Libya/Chad). Judgmetn of 1994. ICJ Reports (1994).
GjND. Frontier Dispute, (*Burkina Faso/Republic of Mali*). Judgment of 22 December 1986. ICJ Reports (1986).
GjND. *Mavrommatis Case*. PCIJ ser. A, nr. 2.
GjND. Pajtueshmëria me të Drejtën Ndërkombëtare e Shpalljes së Njëanshme të Pavarësisë në lidhje me Kosovën. Mendim Këshillëdhënës. 22 korrik 2010. — International Court of Justice. Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo (Request for Advisory Opinion). General List No. 141. 22 July 2010. *Në rrjet:* http://www.refworld.org/docid/4c5151002.html (qasur së fundi më 2 qershor 2016).
GjND. Rasti *Upper Silesia*. PCIJ, ser. A. nr. 15.

GjND. *Salvador v. Honduras* (Nikaragua si ndërhyrës gjyqësor) (1992).
GjND. Subject: Application Instituting Proceedings: Application of the Convention on the Prevention and Punishment of the Crime of Genocide (Bosnia and Herzegovina v. Yugoslavia (Serbia and Montenegro)).
GjND. *Western Sahara Case* [Rasti i Saharës Perëndimore]. ICJ Reports (1975).
Gjykata e Lartë e ShBA-së. *United States v Percheman*, 32 US 51 (1833).
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 1 korrik 2014. Rasti KO 103/14. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës, përkitazi me vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 84(14) [Kompetencat e Presidentit] me nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 20 shtator 2011. Rasti KO 98/11. Parashtrues: Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 20 shtator 2012. Rasti KO 57/12. Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/1-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 22 dhjetor 2010. Rasti KO 97/10. Kërkesa e parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 23 dhjetor 2015. Rasti KO 130/15. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës. Lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë –Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës).
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 23 dhjetor 2015. Rasti KO 130/15. Parashtrues: Presidentja e Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë së parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë — Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, me nenin 3.1 [Barazia para Ligjit], me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 7 tetor 2010. Rasti KO 80/10. Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Tij, dr. Fatmir

Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim, 9 shtator 2013. Rasti KO 95/13. Parashtrues: Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 04/L-199 për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje. Nr. ref.: AGJ469/13.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktvendim, 11 shkurt 2014. Rasti KO 18/14. Parashtrues: Vesna Mikić dhe 20 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kërkesë për interpretim të dispozitave të Kushtetutës së Kosovës lidhur me vendet e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
Gjykata Kushtetuese e Rusisë. Aktgjykim nr. 21-P/2015, 14 korrik 2015. Judgment No. 21-P/2015 of 14 July 2015 of the Constitutional Cout of the Russian Federation. Venice Commission, CDL-REF (2016) 019, Opinion No. 832/2015 (Strasbourg, 23 February 2016).
Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë. Vendim nr. 15/2009, 15 prill 2010, lidhur me marrëveshjen e paratifikuar mbi kufirin detar Greqi-Shqipëri.
Gjykata Supreme e Austrisë. *Republic of Croatia et al. v. Girocredit Bank A.G. Der Sparkassen*. 17 dhjetor 1996. *ILM* vol. 36 (1997).
ILC Report on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts. *The Yearbook of the International Law Commission* vol. II, part 2 (1981).
IMF. Press Release, 15 December 1992.
Institut de droit international, Résolution, 24 april 1936. *Annuaire de l'Institut* vol. II (Bruxelles, 1936).
Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo (February 23, 1999), U.N. Doc. S/1999/648 (June 7, 1999).
International Law Association, *Report of the Fifty-Fourth Conference held at the Hague*, 23rd-20th August, 1970 (London: 1971).
International Law under Fire. *Fletcher Forum of World Affairs* vol. 27, issue 2 (Summer/Fall 2003).
International Military Tribunal (Nuremberg): Judgment and Sentences. *American Journal of International Law* vol. 43, no. 1 (1949).
James Rubinit (Xhejm Rubin), zëdhënës i Departamentit të Shtetit të ShBA-së. Deklaratë Nr. 97/17, të datës 15 gusht 1997. Dokumenti në dosjet e autorit si kopje e dhënë nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.
Karta e Komonuelthit të Shteteve të Pavarura (22 qershor 1993). Sergei A. Voitovich, "Annex: Decision of the Council of Heads of State of the Commonwealth of Independent States", *European Journal of International Law* vol. 4, no. 3 (1993).

Karta e OKB-së. UN Charter.
Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale (Rome 1984). European Charter of Local Self-Government (October 15, 1985), në *European Treaty Series* no. 122.
KDMSP. Establishment of the Kosovo Debt Menagement Support Program (KDMSP), dated June 9, 2008, Confidential: R 2008-0135, IDA/R 2008-0218, June 12, 2008.
Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare. Vendimi që miraton Raportin dok. 12462, të 7 janarit 2011, lidhur me pretendimet për krimet e kryera ndërkufitare dhe ndërkombëtare gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij.
Koha Ditore (9 janar 1998).
Komisioni Badinter. [Vendim për Kosovën.] Gazetën *Fjala* nr. 47 (Prishtinë, 1991) fq. 4.
Komisioni Badinter. Deklaratë mbi Hapjen e Konferencës së Paqes, 7 nëntor 1991. *Medjunarodna politika* no. 995-7 (Beograd, 1991) fq. 28.
Komisioni Badinter. Kërkesa e Republikës së Kosovës. Gazeta *Bujku* nr. 206 (Prishtinë, 24 dhjetor 1991) fq. 1.
Komisioni Badinter. Mendim. *Fjala* nr. 47 (Prishtinë, 1991) fq. 4.
Komisioni Badinter. Mendime. Conference on Yugoslavia, Arbitration Commission. Opinions on Questions Arising from the Dissolution of Yugoslavia. *ILM* vol. 31 (1992).
Komisioni Badinter. Mendimet e janarit 1992. Gazeta *Bujku* (Prishtinë, 17, 18 dhe 19 janar 1992).
Komisioni Badinter. Mendimi nr. 1. Conference on Yugoslavia, Arbitration Commission. Opinion No. 1. *ILM* vol. 31 (1992).
Komisioni Badinter. Mendimi nr. 2.
Komisioni Badinter. Mendimi nr. 4.
Komisioni Badinter. Mendimi nr. 5.
Komisioni Badinter. Mendimi nr. 6.
Komisioni Badinter. Mendimi nr. 7.
Komisioni Badinter. Mendimi nr. 8.
Komisioni Badinter. Mendimi nr. 9. Conference for Peace in Yugoslavia, Arbitration Commission. Opinion No. 9. *ILM* vol. 31 (1992).
Komisioni Badinter. Mendimi nr. 10.
Komisioni Badinter. Mendimi nr. 11.
Komisioni Badinter. Mendimi nr. 12. — International Conference on the Former Yugoslavia. Abritration Commission. Opinion No. 12. *ILM* vol. 32 (1993).
Komisioni Badinter. Mendimi nr. 13. — International Conference on Former Yugoslavia, Arbitration Commission. Opinion No. 13. *ILM* vol. 32 (1993).

Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, Raport për takimin e organizuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Prishtinë, 3 gusht 2016.

Konferenca Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (Konferenca e Londrës). Deklarata mbi parimet. 26 gusht 1992. — International Conference on the Former Yugoslavia. Statement of Principles (LC/C2/FINAL). 26 August 1992. *ILM* vol. 31 (1992).

Konventa e Hagës mbi Kufizimin e Përdorimit të Forcës për Nxjerrjen e Borxheve Kontraktuale. Convention Respecting the Limitation of the Employment of Force for the Recovery of Contract Debts. 1907.

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e shpallur si Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 9/2001, më 15 maj 2001.

Kuvendi i Kosovës me vendimin e vet nr. 03-V-203 të datës 17 tetor 2009 ka bërë ratifikimin e Marrëveshjes për Demarkacionin Fizik të Kufirit Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.

KV I. Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin ndaj Traktateve Ndërkombëtare e vitit 1978. Vienna Convention on Succession of States in Respect of Treaties, August 23, 1978. U.N. Doc. A/CONF. 80/31 (1978).

KV II. Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin ndaj Pronës, Arkivave dhe Borxhit të Jashtëm e vitit 1983. Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts, April 8, 1983. U.N. Doc. A/CONF. 117/14 (1983).

KVDT. Konventa e Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve, e vitit 1980.

Ligji kushtetues mbi ndarjen e pasurisë së Çekosllovakisë mes Çekisë dhe Sllovakisë. 13 nëntor 1992.

Ligji nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës. 20 shkurt 2008.

Ligji nr. 04/L-199 të cekur më sipër.

Ligji nr. 05/L-053 për dhomat speciale dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. 3 gusht 2015.

Marrëveshja e Alma-Atas mbi krijimin e Komonuelthit të Shteteve të Pavarura. Dhjetor 1991. *ILM* vol. XXXI, no. 1 (January 1992).

Marrëveshja e Minskut, datë 4 dhjetor 1991.

Marrëveshja e Njejit mbi Senë, datë 27 nëntor 1919, për kufijtë e Maqedonisë me Bullgarinë dhe Greqinë.

Marrëveshja e Përgjithshme Kuadër për Paqen në Bosnjë-Hercegovinë [Marrëveshja e Dejtonit]. 14 dhjetor 1995. General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina [Dayton Accords]. December 14, 1995. *ILM* vol. 35.

Marrëveshja e Përkohshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës mbi Organizimin e Institucionit të Gjykatës Speciale të Kosovës i Zhvendosur në Holandë, e lidhur në Prishtinë, më 26 janar 2016.

Marrëveshja e Përkohshme për Paqen dhe Vetëqeverisjen në Kosovë [Marrëveshja e Rambujesë]. Interim Agreement for Peace and Self-Government in Kosovo [Rambouillet Agreement]. 1999.
Marrëveshja e Sen-Zhermenit, datë 10 shtator 1919, për kufijtë e Austrisë më Kroacinë.
Marrëveshja e Trianonin, datë 4 qershor 1920, për kufijtë mes Serbisë dhe Hungarisë.
Marrëveshja mbi Parimet mes Serbisë dhe Malit të Zi në kuadër të Unionit të Shteteve, Beograd më datën 14 mars 2002.
Marrëveshja për përcaktimin dhe përshkrimin e kufirit shtetëror të datës 23 shkurt 2001, ratifikuar më 9 maj 2001, kurse ka hyrë në fuqi më 16 qershor 2001. *Službeni list SRJ* 16.1, aneks "Medjunarodni ugovori" (Beograd, 2001).
Marrëveshja për Telekomunikacionin në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, aprovuar me Vendimin e Qeverisë nr. 03/148.
Memorandum i Mirëkuptimit. *ILM* vol. XXXI, no. 1 (January 1992).
MK. Marrëveshja Ushtarake Teknike mes NATO-s dhe RFJ-së, 9 qershor 1999 [Marrëveshja e Kumanovës]. Military Technical Agreement, between NATO and FRY, 9 June 1999 [Kumanovo Agreement].
MT. Marrëveshjes së Vjenës për Trashëgimin e ish-Jugosllavisë, 10 prill 2001.
Multilateral Treaties Deposited with the Secretary-General: Status as on December 31, 2005, U.N. Doc. ST/LEG/SER/E 19 (2005).
Naša Borba (četvrtak, 20 februar 1997).
Naša Borba (petak, 15 maj 1998).
Naša Borba (ponedeljak, 30 mars 1998).
Naša Borba (subota, 16 maj 1998).
Naša Borba (subota, 28 mart 1998).
Naša Borba (subota, 22 novembar 1997).
NATO. Deklaratë speciale e Këshillit të NATO-s, datë 8 dhjetor 1998. QIK, *Informatori ditor* nr. 2264B (8 dhjetor 1998).
NATO. Press Release. Statement on Kosovo Issued by the Heads of State and Government Participating in the Meeting of the North Atlantic Council in Washington, D.C. on 23rd and 24th April 1999.
NATO. Press Statement by Dr. Javier Solana, Secretary General of NATO. 23 mars 1999.
NATO. Secretary General Javier Solana, Press Conference after the Extraordinary Meeting of the North Atlantic Council at Foreign Ministers Level. April 12, 1999.
Organization of American States. Charter.
OSBE. Vendim i Sesionit Special të Këshillit të Përhershëm, datë 11 mars 1998. U.N. Doc. S/1998/246.
Peace Implementation Council. Konkluzionet e Këshillit për Implementimin e Paqes. Londër, 8 dhjetor 1995.

Position of SFR Yugoslavia on the Question of Internal Borders of Yugoslavia (Belgrade, December 30, 1991). Rishtypur në *Review of International Affairs* vol. XLIII (Belgrade, February 5, 1992).
Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës [Plani i Ahtisaarit], datë 26 mars 2007.
Protokolli i Firencës, korrik 1926, mbi kufirin Shqipëri–Jugosllavi.
QIK, *Daily Report* no. 1677 (Prishtina, January 29, 1999).
QIK, *Daily Report* no. 1945 (Prishtina, January 1997).
QIK, *Daily Report* no. 2308B (Prishtina, January 22, 1999).
QIK, *Informatori ditor* nr. 1674 (23 mars 1997).
QIK, *Informatori ditor* nr. 1677 (29 janar 1999).
QIK, *Informatori ditor* nr. 1687 (7 prill 1997).
QIK, *Informatori ditor* nr. 1689 (9 prill 1997).
QIK, *Informatori ditor* nr. 1690A (10 prill 1997).
QIK, *Informatori ditor* nr. 1754 (24 qershor 1997).
QIK, *Informatori ditor* nr. 1756 (26 qershor 1997).
QIK, *Informatori ditor* nr. 1757 (27 qershor 1997).
QIK, *Informatori ditor* nr. 1945 (janar 1997).
QIK, *Informatori ditor* nr. 2264B (8 dhjetor 1998).
QIK, *Informatori ditor* nr. 2308B (22 janar 1999).
Radio Slobodna Evropa (1 prill 2001).
Radio Slobodna Evropa (17 dhjetor 1999).
Radio Zëri i Amerikës, 18:00 CET (9 maj 1995).
Rapport de la Commission du droit international sur les travaux de sa quarante-sixième session, 2 mai–22 juillet 1994.
Report of the International Commission for Inquiry into the Causes of the Balkan Wars, *The Other Balkan Wars* (Carnegie Endowment for International Peace: Washington DC, 1994).
Rilindja (Tiranë, 10 gusht 1997).
Rilindja (Tiranë, 17 shtator 1997).
Rilindja (Tiranë, 21 shtator 1997).
Treaty between the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Macedonia Concerning the Delineation and Description of the State Border, nënshkruar më 23 shkurt 2001. *Službeni list SRJ* 16.1, aneks "Medjunarodni Ugovori" (Beograd, 2001).
Tribunal Update (The Hague) no. 67 (9-14 March 1998).
Tribunal Update (The Hague) no. 80 (23-13 June 1998).
U.N. Doc. E/CN.4/1995/121.
U.N. Doc. E/CN.4/1995/122.
UN Department of Public Information, "The UN and the Situation in Former Yugoslavia" (New York, 1993).

UN General Assembly. Dokumentet zyrtare të Asamblesë së Përgjithshme, Sesioni 46, Shtojca Nr. 10-A/46/10.
UN General Assembly Resolution 47/1, 22 September 1992. Rezoluta nr. 47/1 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, datë 22 shtator 1992. Recommendation of the Security Council of 19 September 1992, G.A. res. 47/1, 47 U.N. GAOR Supp. (No. 49) at 12, U.N. Doc. A/47/49 (1992).
UN General Assembly Resolution 47/121. Rezoluta nr. 47/121 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, datë 18 dhjetor 1992. The situation in Bosnia and Herzegovina, G.A. res. 47/121, 47 U.N. GAOR Supp. (No. 49) at 44, U.N. Doc. A/47/49 (1992).
UN Security Council Report, 3 May 1993. UNSC S/25704.
UN Security Council Resolution 752, 15 May 1992. U.N. Doc. S/RES/752 (1992).
UN Security Council Resolution 757, 30 May 1992. U.N. Doc. S/RES/757 (1992).
UN Security Council Resolution 1022, 22 November 1995. U.N. Doc. S/RES/1022 (1995).
UN Security Council Resolution 1031, 15 December 1995. U.N. Doc. S/RES/1031 (1995).
UN Security Council Resolution 1160, 31 March 1998. U.N. Doc. S/RES/1160 (1998).
UN Security Council Resolution 1203, 24 October 1998. U.N. Doc. S/RES/1203 (1998).
UN Security Council Resolution 1244, 10 June 1990. U.N. Doc. S/RES/1244 (1999).
UN Security Council, Official Record, No. 68 (New York, 1948).
USIA (United States Information Agency), *Wireless File* (November 23, 1995). Teksi në dosjen e autorit, i kopjuar nga Ministria e Jashtme e Shqipërisë.
Vendimi i Kuvendit të Kosovës, nr. 03-V-159, datë 24 korrik 2009, për ratifikimin e traktatit për anëtarësimin e Kosovës në FMN dhe në grupimin e organizatave të BB më datën 24 korrik 2009.
Vendimi i Kuvendit të Kosovës, nr. 03-V-203, datë 17 tetor 2009, për ratifikimin e Marrëveshjes për demarkacionin fizik të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.
Venice Commission, "The Relationship Between International and Domestic Law", *Science and Technique of Democracy* no. 5, CDL-STD (1995) 005 (Strasburg, 15 September 1993).
Vlada Crne Gore, Ministarstvo unutrašnjih poslova, *Izveštaj o vodjenju pregovora na pripremama za zaključivanje Sporazuma o državnoj granici izmedju Crne Gore i Republike Kosovo* (Podgorica, april 2015).
Vladislav Jovanović, *Charge d'Affaires AI* i RFJ-së pranë OKB-së. Letër, datë 28 korrik 1998, dërguar kryetarit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Annex 2-4, U.N. SCOR, 54th Sess,, Doc. S/1999/828/1999.
Yearbook of the International Law Commission vol. II (1950), dokumenti A/1316.

Yearbook of the International Law Commission vol. II (1954), dokumenti A/2673.
Yearbook of the International Law Commission vol. II, pt. 2 (1981).
Yearbook of the International Law Commission vol. II, pt. 2 (1985), dokumenti A/40/10.
Zakon br. 22/11-2/30 o teritorijalnoj organizaciji Crne Gore. 2 novembar 2011.

Treguesi

Amerika Latine, 55, 145, 147, 148, 152, 153, 164, 171, 172, 189, 191, 356, 358
arbitrazhi, 4, 5, 18, 84, 85, 166, 170, 171, 176, 181, 186, 189, 191, 192, 195, 211, 323
Asociacioni i Komunave Serbe, viii, xii, 201, 254, 256, 259, 260, 272, 274, 278, 379, 394
Badinter. *Shih* Komisioni Badinter
BB, xxi, 87, 92, 103, 106, 107, 117, 118, 319, 321, 323, 392, 400
Bosnjë-Hercegovina, x, xiii, xxii, 8, 9, 33, 43, 51, 52, 53, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 67, 70, 74, 77, 79, 81, 85, 92, 94, 101, 103, 105, 114, 140, 141, 142, 156, 157, 162, 172, 176, 177, 179, 180, 187, 197, 199, 200, 204, 206, 210, 211, 212, 213, 222, 223, 230, 232, 233, 235, 237, 240, 241, 247, 251, 254, 257, 262, 279, 280, 281, 284, 293, 294, 295, 296, 297, 298, 303, 305, 309, 310, 312, 314, 315, 317, 320, 330, 345, 348, 356, 357, 363, 365, 392, 397
Britania e Madhe, 149, 248, 261, 266, 286
BRSS, 50, 62, 89, 104, 131, 146, 155, 156, 171, 208, 228, 245, 286, 318, 344, 354, 361, 367
Bujku, 2, 15, 31, 37, 396
Bullgaria, 253, 268, 273
Burkina-Fasoja, 141, 154, 156, 166, 168, 169, 172, 174, 175, 178, 192, 215, 378, 393
Çeçenia, 67, 146, 204, 223, 237
Çekia. *Shih* Çekosllovakia
Çekosllovakia, 50, 84, 86, 88, 98, 103, 104, 105, 146, 155, 156, 163, 171, 193, 205, 209, 220, 228, 237, 397
Djordjević. *Shih* Stevan Gjorgjeviq
e drejta e luftës. *Shih* konfliktet
Fjala, xv, 1, 2, 5, 7, 8, 9, 10, 15, 25, 27, 30, 163, 184, 206, 208, 212, 214, 215, 227, 235, 246, 263, 348, 379, 380, 396
Florim Isufi, 145
FMN, xxi, 87, 92, 101, 103, 104, 105, 106, 107, 117, 118, 319, 321, 323, 400
Franca, 54, 65, 135, 149, 248, 266, 280, 281, 286
Greqia, 253, 268
Gjermania, 28, 35, 54, 65, 134, 149, 198, 208, 249, 254, 266, 268, 269, 276, 280, 285, 346
GjND, xiii, xxi, 13, 18, 55, 95, 97, 118, 141, 152, 154, 215, 235, 258, 282, 293, 294, 295, 298, 310, 314, 316
Gjykata e Hagës, xiii, 197, 235, 242, 279, 283, 284, 298, 299, 300, 301,

302, 303, 304, 305, 306, 307, 308, 309, 315, 317, 338, 340, 343, 350, 351, 353, 354, 355, 358, 365, 367, 380
Gjykata për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi. *Shih* Gjykata e Hagës
Hajredin Kuçi, 145, 282
Iliriana Islami, 2, xvii, 145
Institut de droit international, 32, 208, 395
ish-Jugosllavia. *Shih* RSFJ
Italia, 23, 65
jus cogens, xii, 173, 223, 224, 240
Kenneth Waltz, vii, x, 45, 120, 121, 122, 123, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130, 132, 133, 134, 135, 136, 137, 372, 379, 383
Komisioni Badinter, vii, ix, x, xv, 1, 4, 5, 6, 10, 12, 13, 15, 16, 20, 21, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 41, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 55, 56, 57, 58, 59, 62, 63, 79, 84, 86, 87, 88, 91, 97, 100, 104, 116, 117, 119, 140, 155, 156, 172, 176, 181, 185, 189, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 224, 229, 232, 235, 238, 239, 241, 318, 319, 320, 322, 329, 356, 358, 375, 376, 380, 386, 387, 388, 390, 391, 396
Konferenca e Rambujesë. *Shih* Rambujeja
konfliktet
  e armatosura, 224, 302, 308, 340, 341, 344, 348, 350, 351, 352, 353, 366
  e brendshme, 283, 308, 340, 341, 343, 344, 350, 351, 353, 366
  jus ad bellum, xiv, 282, 336, 337, 339, 342, 346, 349, 350, 353, 364, 365, 366, 367
  jus in bello, xiv, 282, 283, 336, 337, 339, 340, 342, 344, 346, 348, 349, 350, 351, 352, 353, 355, 363, 365, 366, 367
  lufta çlirimtare, xiv, 337, 344, 345, 346, 348, 349, 351, 352, 355, 366, 367
  ndërkombëtare, xiv, 134, 338, 366
Konventa mbi Gjenocidin, 295, 302, 311, 314, 316
Konventat e Gjenevës, 286, 297, 298, 299, 302, 308, 343, 344, 345, 346, 349, 352, 366
Kosova, vii, viii, ix, x, xi, xii, xiii, xiv, xv, xvi, xvii, xviii, xxi, xxii, xxiii, 1, 2, 3, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 22, 26, 33, 34, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 48, 49, 50, 51, 52, 57, 58, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72,73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 81, 82, 85, 91, 95, 107, 110, 114, 115, 116, 117, 118, 119, 120, 131, 136, 139, 140, 142, 143, 144, 145, 146, 155, 158, 159, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 171, 173, 176, 177, 178, 179, 180, 181, 182, 183, 184, 185, 186, 187, 188, 190, 191, 192, 193, 194, 195, 197, 199, 200, 201, 204, 212, 213, 214, 215, 216, 239, 241, 242, 248, 250, 253, 254, 255, 256, 257, 258, 259, 260, 262, 263, 264, 265, 266, 267, 268, 270, 271, 272, 273, 274, 275, 276, 277, 278, 279, 280, 281, 282, 283, 284, 307, 308, 309, 310,

311, 312, 313, 315, 316, 317, 318, 319, 320, 321, 322, 323, 324, 325, 326, 327, 328, 329, 330, 331, 332, 333, 334, 335, 336, 337, 338, 340, 341, 342, 343, 350, 351, 352, 353, 354, 355, 356, 357, 358, 359, 360, 361, 362, 363, 364, 365, 367, 368, 369, 370, 372, 376, 380, 385, 390, 391, 392, 393, 394, 395, 396, 397, 398, 399, 400
Kroacia, xxii, 7, 9, 17, 33, 43, 51, 52, 55, 56, 57, 59, 61, 62, 70, 77, 81, 85, 92, 94, 101, 103, 105, 140, 141, 142, 156, 157, 162, 172, 176, 177, 179, 180, 187, 199, 204, 206, 210, 211, 212, 213, 222, 223, 230, 232, 233, 237, 240, 241, 246, 257, 268, 298, 305,320, 345, 348, 356, 392, 398
kufijtë
administrativë, 43, 52, 55, 56, 58, 66, 140, 141, 142, 145, 148, 149, 153, 154, 155, 156, 159, 168, 172, 178, 182, 188
caktimi, xi, 26, 119, 143, 144, 148, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 169, 170, 171, 172, 175, 176, 180, 181, 182, 186, 187, 189, 191, 192, 193, 194, 195, 268, 397
kolonialë. *Shih* kufijtë administrativë
ndërkombëtarë, xxi, 43, 66, 130, 141, 142, 143, 148, 150, 152, 154, 155, 156, 157, 161, 162, 163, 164, 165, 172, 174, 178, 179, 181, 184, 185, 190, 194, 211, 215, 397, 398
terra nullius, 147, 148
uti possidetis, xi, 22, 39, 52, 55, 130, 139, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 150, 152, 153, 154, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 161, 164, 165, 168, 171, 172, 173, 174, 175, 176, 177, 178, 183, 185, 187, 189, 190, 191, 194, 208, 230, 356, 359, 363, 381, 383, 384
Kushtetuta 1974, 2, 33, 70, 107, 177, 180, 181, 194, 359, 360, 361, 362, 364, 365, 368
Kushtetuta e Kaçanikut, 38, 216, 242, 335
Kushtetuta e Kosovës, xxii, 40, 185, 256, 260, 262, 265, 267, 271, 272, 277, 395
KV, 2, 12, 13, 17, 43, 217
KV I, xxii, 10, 17, 18, 43, 44, 55, 80, 81, 82, 83, 84, 89, 90, 99, 397
KV II, xxii, 10, 18, 19, 43, 44, 80, 81, 82, 83, 84, 86, 89, 90, 97, 98, 99, 100, 101, 102, 105, 107, 108, 109, 397
KVDT, xxii, 263, 264, 265, 268, 269, 397
lufta. *Shih* konfliktet
Lufta e Dytë Botërore, 24, 27, 29, 33, 35, 134, 135, 147, 148, 149, 163, 188, 194, 198, 199, 200, 214, 215, 225, 231, 239, 240, 245, 250, 257, 284, 285, 286, 288, 289, 290, 292, 293, 305, 309, 314, 316, 337, 339, 342, 345, 346, 348, 366, 368
Lufta e Parë Botërore, 10, 24, 27, 91, 123, 124, 135, 164, 177, 194, 249, 285, 289, 313, 346

Mali, 141, 154, 156, 166, 172, 174, 175, 178, 215, 393
Mali i Zi, vii, ix, xi, xiii, xxii, xxiii, 19, 25, 28, 30, 34, 41, 42, 43, 48, 52, 56, 57, 61, 66, 67, 68, 71, 72, 73, 75, 76, 77, 91, 93, 94, 101, 118, 119, 130, 139, 140, 142, 143, 144, 145, 146, 158, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 172, 176, 177, 178, 179, 180, 181, 182, 183, 184, 185, 186, 187, 188, 189, 191, 192, 193, 194, 195, 216, 235, 236, 242, 253, 257, 258, 284, 293, 294, 295, 296, 297, 298, 307, 308, 310, 311, 312, 314, 315, 320, 321, 325, 327, 330, 355, 357, 358, 360, 361, 362, 363, 364, 376, 392, 398
Maqedonia, xxii, 9, 33, 34, 43, 51, 52, 56, 62, 67, 72, 77, 78, 85, 92, 94, 101, 103, 105, 119, 130, 140, 142, 143, 163, 164, 172, 177, 179, 180, 184, 185, 187, 191, 194, 206, 213, 237, 247, 257, 261, 269, 307, 325, 334, 335, 336, 348, 361, 362, 363, 365, 392, 397,400
Marrëveshja e Dejtonit, 48, 58, 59, 64, 65, 66, 75, 76, 94, 114, 180, 182, 197, 209, 223, 232, 262, 279, 280, 317, 319, 320, 322, 323, 325, 330, 357, 397
Marrëveshja e Rambujesë. *Shih* Rambujeja
Millan Bartosh, 16, 28, 37, 93, 373, 386
MT, x, xxii, 2, 43, 44, 77, 78, 79, 80, 81, 85, 87, 88, 89, 90, 92, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 113, 114, 116, 118, 119, 120, 398
Murat Meha, 144, 161, 181
muri i jashtëm i sanksioneve, xiii, 197, 280, 281, 316, 317, 318, 319, 320, 323, 325, 327, 328, 329, 330, 357
nacionalizmi serb, viii, xii, 1, 66, 197, 198, 199, 200, 201, 242, 243, 245, 246, 247, 248, 251, 282, 379
NATO, xv, xxii, 41, 54, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 72, 73, 159, 177, 184, 223, 248, 254, 280, 281, 282, 331, 332, 333, 334, 335, 336, 357, 364, 365, 378, 383, 385, 386, 389, 398
Nigeri, 169, 176, 192, 378, 393
Nigeria, 51, 155, 176, 344, 393
nocioni shtet, vii, xi, 36, 38, 126, 133, 137, 138, 197, 200, 202, 204
OKB
  Karta, 15, 17, 21, 37, 38, 39, 40, 55, 58, 156, 203, 211, 225, 226, 227, 229, 233, 234, 235, 283, 289, 295, 297, 300, 301, 306, 307, 311, 315, 322, 343, 346, 347, 357, 396
  KS, xxii, xxiii, 21, 32, 41, 48, 58, 65, 66, 67, 69, 70, 73, 74, 76, 77, 78, 81, 85, 92, 118, 143, 158, 159, 183, 209, 234, 235, 236, 258, 283, 297, 298, 299, 300, 301, 302, 304, 307, 311, 314, 315, 317, 319, 320, 321, 322, 325, 326, 332, 347, 351, 355, 392,400
Paqja e Vestfalisë, 46, 128, 135, 183, 204, 339
pavarësia, viii, xiv, xvii, 9, 11, 15, 17,

20, 24, 33, 48, 52, 53, 58, 63, 64, 66, 69, 74, 75, 81, 83, 98, 100, 115, 118, 119, 141, 142, 143, 147, 150, 151, 152, 153, 154, 156, 157, 158, 159, 162, 163, 164, 165, 168, 172, 173, 174, 175, 177, 178, 179, 189, 190, 194, 211, 213, 214, 215, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 230, 232, 239, 240, 241, 244, 258, 282, 320, 325, 331, 332, 333, 334, 335, 337, 347, 348, 354, 355, 365, 367, 368
Përparim Ahmeti, 145
Plani Ahtisaari, 72, 73, 78, 81, 85, 110, 115, 116, 118, 120, 143, 161, 164, 181, 182, 183, 185, 194, 258
protektorati ndërkombëtar, viii, xiv, 331, 333
Qiproja, 46, 130, 220, 222, 223, 231, 237, 344
Rambujeja, x, 48, 65, 68, 69, 70, 71, 72, 74, 75, 76, 158, 159, 200, 280, 281, 282, 331, 332, 334, 335, 398
referendumi, 9, 34, 53, 58, 62, 63, 66, 213, 214, 216, 242, 320, 326, 360
Remzije Istrefi, 145
Rezoluta 1244, x, xxii, xxiii, 41, 48, 65, 66, 69, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 118, 158, 159, 183, 184, 257, 400
RFJ, x, xxii, 25, 41, 48, 52, 56, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 76, 77, 78, 79, 80, 85, 91, 92, 93, 94, 101, 103, 104, 105, 118, 119, 130, 139, 142, 143, 146, 158, 163, 164, 177, 179, 183, 184, 187, 191, 194, 235, 236, 242, 295, 296, 312, 313, 317, 318,319, 320, 321, 322, 323, 324, 325, 326, 327, 328, 329, 330, 355, 357, 363, 364, 365, 392, 398, 400
Rilindja, 6, 28, 197, 200, 235, 279, 283, 320, 324, 354, 362, 376, 379, 380, 390, 392, 399
RSFJ, vii, x, xii, xv, xxi, xxii, 1, 2, 3, 7, 10, 11, 12, 15, 16, 17, 19, 20, 23, 25, 26, 27, 31, 33, 34, 36, 37, 38, 40, 41, 42, 43, 44, 48, 49, 50, 51, 53, 55, 57, 61, 62, 64, 70, 75, 77, 78, 79, 80, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100, 101, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 113, 115, 116, 117, 118, 119, 120, 139, 140, 141, 142, 144, 157, 160, 162, 163, 171, 176, 177, 178, 180, 182, 185, 187, 188, 191, 194, 195, 199, 205, 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 219, 220, 226, 227, 228, 229, 230, 231, 235, 236, 237, 238, 239, 241, 243, 245, 248, 250, 251, 252, 253, 257, 279, 293, 295, 296, 297, 299, 300, 301, 303, 304, 306, 307, 308, 312, 313, 317, 319, 320, 321, 322, 323, 325, 328, 329, 349, 356, 357, 361, 362, 364, 380, 397, 398
Rusia, 65, 72, 84, 88, 89, 217, 218, 234, 275, 280, 362, 395
Serbia, xii, xxii, 19, 25, 41, 42, 43, 48, 52, 53, 56, 61, 66, 68, 71, 72, 73, 76, 85, 93, 94, 95, 101, 110, 115, 119, 139, 140, 141, 142, 146, 158, 163, 165, 172, 177, 179, 182, 183, 185, 187, 188, 191, 192, 210, 211, 212, 215, 229, 235, 236, 242, 243, 246, 247, 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 264, 265, 268,

280, 281, 293, 294, 295, 296, 297, 298, 308, 310, 311, 315, 317, 320, 321, 328, 354, 355, 357, 358, 360, 363, 374, 379, 384, 389, 392, 393, 394
Serbia e Madhe, xii, 59, 61, 63, 65, 74, 93, 199, 246, 248, 249, 250, 251, 252, 253, 281, 294
Sllobodan Millosheviq, xv, xxii, 42, 43, 53, 56, 63, 68, 72, 73, 91, 93, 94, 95, 139, 197, 248, 279, 280, 281, 321, 326, 327, 328, 330, 333, 335, 336, 356
Sllovakia. *Shih* Çekosllovakia
Sllovenia, xxii, 7, 9, 17, 33, 43, 51, 52, 56, 62, 77, 85, 92, 101, 103, 105, 140, 142, 156, 172, 176, 177, 206, 211, 212, 213, 237, 246, 257, 320, 392
sovraniteti, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 14, 17, 22, 25, 26, 28, 31, 38, 39, 41, 42, 48, 51, 65, 66, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 82, 83, 84, 95, 110, 111, 112, 114, 117, 131, 139, 143, 144, 146, 147, 148, 149, 152, 154, 157, 158, 159, 162, 164, 165, 166, 170, 183, 192, 206, 213, 218, 219, 220, 221, 225, 226, 227, 231, 249, 258, 265, 266, 280, 286, 331, 346, 353, 355, 358, 363, 364, 367, 380
Stevan Gjorgjeviq, 6, 28, 84, 93, 375
subjektiviteti, vii, ix, 2, 6, 11, 15, 22, 25, 30, 36, 37, 38, 39, 40, 202, 203, 206, 210, 213, 220, 229, 380
suksedimi, vii, ix, x, xv, xviii, 1, 2, 3, 5, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 22, 26, 28, 30, 31, 34, 38, 40, 42, 43, 44, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 92, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100, 101, 103, 104, 107, 108, 109, 110, 114, 115, 116, 117, 118, 119, 120, 142, 143, 144, 163, 164, 165, 173, 177, 179, 184, 191, 194, 212, 217, 257, 295, 323, 380
ShBA, xviii, xxiii, 4, 23, 29, 32, 36, 41, 42, 54, 64, 65, 73, 78, 131, 139, 192, 199, 201, 218, 249, 255, 257, 280, 286, 311, 320, 323, 324, 325, 327, 332, 341, 390, 392, 394, 395
Shpejtim Bulliqi, 145
Shqipëria, xvii, xxi, 12, 34, 40, 72, 92, 130, 143, 144, 164, 177, 184, 185, 191, 194, 200, 218, 261, 268, 277, 310, 311, 312, 316, 324, 335, 395, 400
terra nullius. *Shih* kufijtë
trashëgimi. *Shih* suksedimi
UÇK, viii, xiv, xxiii, 65, 282, 331, 333, 334, 335, 355, 356, 358, 359, 362, 363, 364, 365
UNMIK, xxiii, 41, 49, 65, 74, 75, 76, 78, 179, 258, 397
USMZ, xxiii, 48, 49, 50, 64, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 91, 103, 104, 105, 118, 119, 142, 158, 165, 177, 257, 258
uti possidetis. Shih kufijtë
vetëvendosja, vii, ix, x, xv, xvi, 2, 8, 10, 25, 37, 38, 41, 48, 49, 50, 51, 53, 58, 64, 65, 66, 69, 70, 73, 75, 76, 77, 140, 147, 151, 152, 156, 157, 159, 173, 174, 207, 209, 210, 212, 213, 214, 220, 222, 223, 224, 225, 226, 227, 228, 229, 230, 231, 238, 239, 240, 241, 319, 331, 332,

337, 338, 339, 341, 342, 345, 346, 347, 352, 353, 355, 356, 357, 358, 360, 361, 362, 364, 365, 366, 367, 380
Xhezair Zaganjori, xvii, 2, 268, 375
Zejnullah Gruda, 6, 28, 144, 145, 376

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

34: 327(042.3)(075.8)

Hasani, Enver
Tema të zgjedhura nga e drejta dhe marrëdhëniet ndërkombëtare / Enver Hasani. – Prishtinë ; Hjuston : Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; "Jalifat Publishing", 2016. – 409 f. ; 24 cm. – (Biblioteka Besa)

Literatura : f. 369-401. – Treguesi : f. 403-409

ISBN 978-9951-00-186-1